



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I DREJTËSISË  
DEPARTAMENTI I SË DREJTËS PUBLIKE**

**DISERTACION  
PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE  
“DOKTOR”**

**PËRGJEGJËSIA JASHTËKONTRAKTORE E  
ORGANEVE PUBLIKE NË SHQIPËRI**

**DOKTORANTE**

**Rezarta MATAJ**

**UDHËHEQËSI SHKENCOR**

**Prof. Dr. Ermir DOBJANI**

**TIRANË, 2017**

© E drejta e autorit: **Rezarta MATAJ, 2017.**

Ky punim shkencor është formatuar sipas kërkesave të Rregullores së Rektoratit “Për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoratave”, miratuar në Mbledhjen e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës me vendimin Nr. 20, datë 13.11.2008.

## PARATHËNIE

*Gjetja e kësaj teme ka ndodhur që në korrik 2007, kur përfundova temën e vitit të dytë në Shkollën e Magjistraturës. Desertacioni “Mbi dëmin jopasuror, shpërblimi i tij dhe praktika gjyqësore shqiptare” u mbrojti me sukses, aq sa shërbeu edhe si material teorik mbi nenin 625 të Kodit Civil për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë për të unifikuar praktikën gjyqësore në vendimin nr. 12 datë 13 shtator 2007.*

*Trajtimi i fushave të së drejtës të paeksploruara gjithmonë më kanë tërhequr. Nuk e kam fjalën për ato ligje që sapo dalin dhe të gjithë kanë kuriozitetin për t'i studiuar por për ato institute a ligje që kanë hyrë në fuqi me vite por askush nuk “kujdeset” a t'i ketë në vëmendje, janë pak të njohura apo të zbatueshme duke shtuar pikëpyetjet se diçka nuk shkon me to.*

*Kjo ka qënë arsye që në disa revista juridike jam munduar të trajtoj institute të veçanta si renta jetësore, dëmin jopasuror, kontratën e qirasë financiare (lizingun), shpenzimet gjyqësore, të drejtën sportive etj. Tani që i citojmë, çdo kush mendon sesa të panjohura janë.*

*Prandaj, edhe e drejta kushtetuese e çdo qytetari për dëmet e shkaktuara nga shteti, paraqitet e pastudiuar thellësisht me ndonjë studim doktorat. Përpjekiet e para në Shqipëri janë të Prof.Dr Eralda Met'hasani<sup>1</sup> në një konferencë shkencore ndërkombëtare (2010) dhe më pas nga një student nën udhëheqjen e saj, për marrje të dipolomës së masterit shkencor (2011).<sup>2</sup>*

*Ndihem shumë e lumtur që jam thelluar për herë të parë deri në detaj tek ligji nr. 8510 datë 15 korrik 1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” dhe kam zbuluar aq shumë mbi të. Kjo ka bërë që hulumtimi në doktrinën dhe jurisprudencën shqiptare të jetë shumë i vështirë, herë herë i lodhshëm dhe pa ndonjë rezultat konkret. E kundërta ndodh gjatë kërkimit në shtetet e tjera sidomos tek jurisprudenca e Gjykatave të Luksemburgut, Strasburgut. ku teoritë e përgjegjësisë civile të shtetit paraqiten mjaft të elaboruara.*

*Në fakt, duhet të ndihemi të përkëdhelur që legjislatori këtë të drejtë, që shumë shtete e kanë të parashikuar vetëm me një nen në Kushtetutë apo në legjislacionin civil, adminisrativ etj. ne e kemi të parashikuar në një ligj komplet të veçantë.*

*Paraqitet e nevojshme të realizohet një komentari mbi këtë institut duke ndihmuar qytetarët që ta shfrytëzojnë më mirë të drejtën e tyre kushtetuese për tu shpërblyer nga shteti për çdo lloj dëmi pasuror dhe jopasuror. Nga ana tjetër, thellimi mbi këtë përgjegjësi civile të organeve publike do të ndihmoj punonjësit e saj, vetë organet publike që të njohinë përgjegjësitë, llojet, dallimet mes njëri-tjetrit, mënyrën sesi shpërblehet dëmi etj.*

*Megjithatë, në mungesë të një komentari të mirfilltë shpresoj që ky hulumtim do ndihmoj qytetarët, studiuesit e së drejtës administrative, civile, studentët e së drejtës, gjyqtarë, avokatë etj. që të shikojnë interpretime të reja të përgjegjësisë civile të organeve publike. Për të kuptuar raportin e dëmit dhe shpërblimit mes shtetit dhe qytetarit mendoj se ky është një punim që i drejtohet cilido.*

---

<sup>1</sup> Eralda Çani (Met'hasani) “Non-Contractual Administrative Responsibility as a Means to Better Redress Juridical and Physical Persons Interests and Better Address Public Interests: Reforms Needed to the Albanian Legislation and European Standards” Konferencë Shkencore Ndërkombëtare, Fakulteti I Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, dhjetor 2010.

<sup>2</sup> Mentor Bimi “Përgjegjësia e administratës publike në kontekstin krahasues dhe përfaqja me të drejtën komunitare”, Punim diplome Master në të Drejtën Kushtetuese të Krahasuar dhe Evropiane, Tiranë, 2011.

*Jeta është e gjatë dhe dedikime për fëmijet, bashkëshortin do ketë plot,*

*Por mirënjohja më e parë i takon vetëm asaj,  
nënës sime, e ve, në një qytet të varfër e të largët si Kukësi,  
na lidhi ngushtë me librin si i vetmi çelës për të gjetur suksesin .*

## *Jo thjesht kllishe, por dy fjalë të thella mirënjohje*

*Realizimi i një teme doktorature është moment më i vështirë për një akademik, pasi ndan periudhën mes teorisë, të lexuarit pambarimisht, shkruarit dhe studiuarit cilësisht, të maturon në shkrimin akademik, në kërkimin shkencor dhe të nxit për pjesmarrje në konferenca.*

*Për mua e gjithë kjo periudhë tre vjeçare ka qënë aq e bukur dhe dinamike. Më duhej të shfletojë libra, të kaloja netë të gjata përpara kompjuterit, të shkarravizja dhe skicoja ide, të kthehesha dhe rikthehesha faqeve. Por, në fund, nuk ka kënaqësi më të madhe t'ua prezantosh të tjerëve atë për të cilën ti ke investuar aq shumë, me shpresën se do të pëlqehet dhe do të vlerësohet maksimalisht.*

*E vetme asgjë nuk arrihet.*

*Falenderime të singerta shkojnë për udhëheqësin tim, **Prof. Dr. Ermir Dobjanin** i cili përtej sugjerimeve, ideve dhe literaturës që më ka vënë në dispozicion, më ka inkurajuar për të mos u stepur në asnjë çast pasi çdo gjë arrihet.*

*Mirënjohje shkon për **Universitetin Jopublik "New Your Tirana** dhe punonjësën e bibliotekës **Znj. Aleksandra Xhamo**" e cila më vuri në dispozicion në sallën e leximit, dhe aksesin në bibliotekën online të **SUNY Empire State College New York USA** ku kam gjetur një pjesë të mirë të materialeve.*

*Në fund, dua përmend **bashkëshortin tim Blendin**, dy vajzat tona **Ana** dhe **Viktoria** të cilët më kanë kuptuar edhe kur ua kam prishur fundjavat për të punuar për disertacionin.*

***Ju faleminderit të gjithëve !***

## LISTA E SHKURTIMEVE TË TERMAVE TË PËRDORURA

### Lista e shkurtimeve -Termi i gjatë

KC i RFGJ	Kodi Civil i Republikës Federale të Gjermanisë
RFGJ	Republika Federale e Gjermanisë
GJS RFGJ	Gjykata Supreme e Republikës Federale të Gjermanisë
KC	Kodi Civil në fuqi i Republikës së Shqipërisë, 1994
KP	Kodi Penal në fuqi i Republikës së Shqipërisë 1995
KPRA	Kodi i Proçedurave Administrative, 1999
KPRA i Ri	Kodi i Proçedurave Administrative hyrë në fuqi në 28 maj 2016
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
AP	Administratë Publike
OAP	Organe të Adminsitratës Publike
OP	Organ Publik
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
GJL	Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë
GJK	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
KB të GJL	Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë
GJRRGJ	Gjykata e Rrethit Gjyqësor
GJASH I-rë	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë
GJAA	Gjykata e Apelit Administrative Tiranë
KPAC	Kanuni i Përshtatshëm i Administratës Civile
SOSH	Statutin Organik të Shqipërisë
SZL	Statuti i Zgjeruar i Lushnjës
PTT	Posta, Telegrafët, Telefonat

LVJD	Ligji për veprimet juridike dhe detyrimet, 1956
FTCA	Federal Tort Claims Act i Shteteve të Bashkuara të Amerikës
BE	Bashkimi Evropian
GJED	Gjykata e Evropiane e Drejtësisë para Traktatit të Lisbonës, 2009.
GJDBE	Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KEE	Komuniteti Ekonomik Evropian
TFEU	Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit e lidhur mes Shqipërisë dhe vendeve antare të Bashkimit Evropian.
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
IEVP	Institucion i Ekzekutimit të Vendimeve Penale
USD	Dollarë Amerikanë

## PËRMBAJTIA E TEMËS

Faqe

Hyrje .....	1
-------------	---

### **KREU I**

#### **HISTORIKU I PËRGJEGJËSISË JASHTËKONTRAKTORE TË ADMINISTRATËS NË SHQIPTAR**

1.1.Periudha nga shteti bizantin fillim shekull IV e.s e deri në shtetin e pavarur shqiptar në vitin 1912 .....	8
1.2 Periudha nga viti 1912 deri në vitin 1944, dekadat e para të shtetit të pavarur shqiptar.....	9
1.3 Periudha e regjimit komunist në vitet 1944 deri 1991.....	11
1.4 Periudha nga viti 1991 e në vijim.....	19

### **KREU II**

#### **SUBJEKTET DHE OBJEKTI I PËRGJEGJËSISË JASHTË KONTRAKTORE TË ORGANEVE PUBLIKE SHQIPTARE**

2.1 Subjektet e përgjegjësive së administratës shtetërore .....	25
2.1.1 Presidenti i Republikës së Shqipërisë .....	25
2.1.2 Deputetët e Kuvendit të Shqipërisë.....	27
2.1.3 Gjyqtarët në Republikën e Shqipërisë.....	29
2.1.3.1 Gjyqtarët të Gjykata të Shkallëve të Para dhe Gjykatave të Apelit.....	29
2.1.3.2 Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë.....	33
2.1.3.3 Imuniteti dhe përgjegjësia civile e gjyqtarëve në botë.....	34
2.2. Organet administrative shtetërore/publike si organe që i nënshtrohen përgjegjësive jashtëkontraktore.....	39
2.2.1 Nëpunësit e organeve të administratës publike.....	44
2.2.2 I dëmtuari nga organet e administratës shtetërore dhe përgjegjësia ndaj tij.....	45
2.2.2.1 Personat direkt të dëmtuar .....	46
2.2.2.2 Personat indirekt të dëmtuar .....	49



2.3 Objekti i Përgjegjesisë jashtëkontraktore .....	50
---	----

### **KREU III**

## **ANALIZA E ELEMENTËVE TË DËMIT JASHTËKONTRAKTOR NË ADMINISTRATËN PUBLIKE**

3.1 Veprimet dhe mosveprimet e paligjshme si shkak për përgjegjësi të organeve të administratës publike.....	54
3.2 Faji.....	58
3.2.1 Shkallëzimi i fajit.....	59
3.2.2 Përgjegjësitë nga përgjegjësia jashtëkontraktore.....	61
3.2.3 Llojet e përgjegjësive jashtëkontraktore.....	63
3.2.3.1 Përgjegjësia me faj direkt.....	64
3.2.3.2 Përgjegjësia jashtëkontraktore me faj të prezumuar për veprimet e tjetrit.....	65
3.2.3.3 Përgjegjësia jashtëkontraktore me faj të prezumuar për sendet dhe kafshët që janë nën përgjegjësi.....	66
3.2.3.4 Përgjegjësia jashtëkontraktore pa faj, për shkak të ligjit (strict liability).....	66
3.3 Lidhja shkakore .....	68
3.4 Pasoja, dëmi i ardhur.....	70
3.5 Llojet e dëmeve në përgjegjësinë jashtëkontraktore të Organeve Publike .....	74
3.5.1 Raporti mes përgjegjësive së administratës shtetërore dhe nëpunësve të tyre.....	75
3.5.2. Dëmet për shkak të vendimeve të paligjshme.....	77
3.5.3 Dëmet për shkak të veprime a mosveprime të kundërligjshme.....	78
3.5.4 Dëmet për refuzim të paligjshëm për të marrë vendime.....	79
3.5.5 Dëme për dhënie të informacioneve shkresore të pasakta.....	80
3.5.6 Dëme për veprime a mosveprime të ligjshme, por që sjellin dëmtimin e interesave të ligjshme të personave fizike a juridike private.....	81
3.5.7 Dëme për veprime a mosveprime të ligjshme që, u shkaktojnë një dem të pabarabartë subjekteve të cilëve u drejtohet ky veprim a mosveprim.....	84
3.5.8 Dëme për shkak të mosfunksionimit të mjeteve teknike.....	85
3.5.9 Dëme nga një rrezik i vazhdueshëm i personave fizike a juridike private.....	87
3.5.10 Dëme nga një akt korruptiv gjatë ushtrimit të funksionit.....	88

3.5.11 Dëme në rastet e shpronësimeve bazuar në ligjin nr. 8561/1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.....	91
3.5.12 Dëmi nga ndryshimi i një situatë juridike ose faktike me origjinë nga akte të administratës shtetërore.....	92
3.5.13 Dëme për çdo shkak tjetër të parashikua me ligj.....	94

## **KREU IV**

### **GJYKIMI I PADIVE MBI DËMIN JASHTËKONTRAKTOR NDAJ ORGANEVE PUBLIKE**

4.1 Hyrje.....	99
4.2 Juridiksioni i gjyqimit të kërkimeve.....	99
4.3 Gjykata kompetente .....	104
4.4 Legjitimimi pasiv i organit shtetëror.....	110
4.5 Provat që mund të merren në gjyqim .....	113
4.6 Barra e provës .....	117
4.7 Disponimi i gjykatës mbi shpërblimin e dëmit .....	119
4.8 Parashkrimi i padive për shpërblim të dëmit jashtëkontraktor.....	120
4.9 Afati për parashkrimin apo dekadencës.....	122
4.10 Vendimarrja e Gjykatës.....	124

## **KREU V**

### **SHPËRBLIMI I DËMIT JASHTËKONTRAKTOR PREJ ADMINISTRATËS PUBLIKE**

5.1 Shpërblimi i dëmit pasuror dhe kriteret që merren parasysh.....	129
5.1.1 Mënyrat e shpërblimit të dëmit pasuror .....	130
5.1.1.2 Shpërblimit i dëmit jopasuror, në mënyrë fillestare në natyrë .....	130
5.1.1.3 Shpërblimi i plotë i dëmit .....	132
5.1.1.3 Ndryshueshmëria e shpërblimit të dëmit .....	133
5.1.1.4 Mënyra e copëzimit të shpërblimit (pagesa me këste).....	133
5.2 Shpërblimi i dëmit jopasuror dhe kriteret që merren parasysh.....	134
5.2.1 Parimi i shpërblimit të plotë (restitutio in integrum).....	135

5.2.2 Shpërblimi i drejtë .....	136
5.2.3 Shpërblimi ne mënyrë unike .....	138
5.2.4 Mënyra e shpërblimit simbolik ose deklarues.....	139
5.3 Kriteret që merren parasysh për shpërblimin e demit.....	140
5.4 Shpërblimi i demit sipas jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut (nenet 13 dhe 41).....	140
5.5 Shpërblimi i demit në mardhëniet ndër-shtetërore sipas Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara .....	152

## **KREU VI**

### **VËSHTRIM KRAHASUES NDËRKOMBËTAR MBI PËRGJEGJËSINË JASHTËKONTRAKTORE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE NË DISA SHTETE TË TJERA TË EUROPËS DHE SHBA**

6.1 Italia.....	155
6.6 Franca.....	160
6.2.1 Përgjegjësia me faj e organeve të administratës publike.....	160
6.2.2 Përgjegjësia pa faj e organeve të administratës publike në Francë.....	164
6.3 Gjermania.....	166
6.4 Mbretëria e Bashkuar .....	170
6.5 Shtetet e Bashkuara të Amerikës.....	174
6.6 Kosova .....	179

## **KREU VII**

### **TRAJTIMI I DËMEVE JASHTËKONTRAKTORE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE NGA GJYKATA EUROPIANE E BASHKIMIT EUROPIAN**

7.1 Hyrje.....	183
7.2 Parashikimet në të drejtën komunitare mbi përgjegjësini civile të Institucioneve të Bashkimit Evropian dhe të tjera raste.....	184
7.3 Kushtet e përgjegjësisi jashtëkontraktore sipas të drejtës komunitare dhe jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.....	187
7.4 Përgjegjësia jashtëkontraktore sipas të drejtës komunitare për shkaqe të paligjshme (unlawful acts).....	190

7.5 Përgjegjësia jashtëkontraktore për akte të paligjshme (unlawful acts) të kryera nga punonjësi i institucionit të Bashimit Evropian .....	196
7.6 Përgjegjësia jashtëkontraktore e shtetit për veprime të ligjshme të Institucioneve .....	199
7.7 Faji si element i rëndësishëm i përgjegjësisë jashtëkontraktore në të drejtën komunitare.....	202
7.8 Llojet e dëmeve në përgjegjësinë jashtëkontraktore në të drejtën komunitare....	204
7.9 Mënyrat e shpërblimit nga Institucionet Komunitare për përgjegjësinë jashtëkontraktore .....	206
7.10 Parashkrimi i së drejtës për të kërkuar shpërblim dëmi nga Institucionet e Bashimit Evropian .....	209
<b>PËRFUNDIME DHE SUGJERIME.....</b>	<b>211</b>
<b>BIBLIOGRAFIA .....</b>	<b>218</b>
<b>ABSTRAKT .....</b>	<b>229</b>

**HYRJJE**

Përgjegjësia për punimin e disertacionit të ciklit të tretë të studimeve “Përgjegjësia jashtëkontraktore e organeve të administratës publike në Shqipëri” ka qenë shumë e madhe. Kjo nisur nga pesha e studimit për herë të parë të gjësë ku nuk duhet të lihej asgjë pa u cekur, nevojat nga prakticienët por edhe teoricienët në pasjen e një teme të tillë për t’i ndihmuar në fushat e përkatëse dhe së fundi vështërsinë në gjetjen e materialeve në gjuhën shqipe apo edhe të referimeve në praktikën gjyqësore.

Në mënyrë të përmbledhur i gjithë punimi pasqyrohet si më poshtë:

Në **Kreun e Parë**, paraqitet një historik i legjislacionit shqiptar nga mesjeta e deri më tani të institutit të përgjegjësive së shtetit karshi dëmeve të shkaktuar qytetarëve. Ajo paraqitet modeste dhe jo shumë e elaboruar si në ligje, jurisprudencë apo doktrinë.

Përgjegjësia e shtetit, organeve të tij administrative apo e nëpunësve karshi shtetasve të tij është njohur që nga koha e Perandorisë Bizantine (për aq sa tregojnë dokumentet, por kjo nuk përjashton faktin se mund të jetë edhe më e hershme si institut i së drejtës). Duket qartë se fillimisht kjo përgjegjësi në Mesjetë dhe në kohën e Perandorisë Osmane shkarkohej drejtpërdrejtë të personi i veshur me pushtet shtetëror, veprimet e të cilit kanë shkaktuar dëm të shtetasi etj. Ndërsa më pas kjo përgjegjësi u mbajt e përbashkët mes shtetit dhe nëpunësit të tij (shih Statutin Themeltar të Republikës dhe të Mbretërisë së Shqipërisë në vijim).

Po ashtu mënyra e zhdëmtimit të individëve përpara shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë ishte vetëm me detyrimin e ofiqarëve, nëpunësve për të mos kryer atë veprim p.sh, ndalimi së bëri keq banorëve dhe nuk ndahej nga përgjegjësia disiplinore apo penale. Në rast rëndimi (të përkeqësimit) të situatës dhe përsëritjes së veprimeve nga ofiqari passillte shkarkimin e tij dhe dënimin deri me vdekje.

Ndërsa me krijimin e shtetit shqiptar u njohën format e riparimit të dëmit të personit të dëmtuar. Institucionet shtetërore mund t’i kërkonin punonjësit fajtor me padi regresi atë çfarë kishin paguar për dëmin e shkaktuar nga ai. Për shkak të ideologjisë së shtetit komunist, gjendjes ekonomike të shtetit të kohës etj. personi i dëmtuar nuk mund të pretendonte fitim të munguar apo shpërblim për dëm moral. Ai mund të shpërblehej për dëmin material të shkaktuar nga institucionet e shtetit në formën e zëvendësimit, riparimit apo pagimin e çmimit të asaj çfarë ishte dëmtuar.

Ndërsa forma të reja të shpërblimit nga dëmet që i shkaktohen personave nga organet e administratës publike u parashikuan në Kodin e Proedurave Administrative të vitit 1999 dhe me ligjin nr. 8510/1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” i cili paraqitet për kohën avangardë. Ky ligj parashikon disa forma shpërblimi të cilat në atë kohë as vetë Kodi Civil, Kushtetuta apo ligje të tjera nuk i njihnin si dëmi jopasuror (shih trajtimin më poshtë).

Gjithësesi, ashtu siç janë vërejtur edhe nga institucione të specializuara të cilat vëzhgojnë dhe japin opinione mbi zbatimin efektiv të ligjit si p.sh, Avokati i Popullit, problematike pas hyrjes në fuqi të këtij ligji specifik është moszbatimi i plotë i tij duke passjellë edhe dëme të rënda ekonomike për shtetin.

Në të gjitha ato raste gjyqësore që Avokatura e Shtetit ka qenë përfaqësuese e organit të administratës publike nuk rezulton që për dëmin jashtëkontraktor që i paguan të dëmtuarit siç ka urdhëruar gjykata, të kenë ngritur padi regresi (kthimi) ndaj fajtorit, organit administrativ apo punonjësit, për të rimarrë shumën e paguar.

Të njëjtën problematikë për mos efikasitet maksimal të këtij ligji shpreh edhe Avokati i Popullit në raportin e veçantë të vitit 2012 “Për situatën e krijuar nga moszekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë” ku ceket se: “Në ligjin nr. 8510 datë 15.7.1999 parashikohet përgjegjësia dhe detyrimi i organeve dhe i punonjësve të tyre, në rastet kur u shkaktojnë dëme pasurore dhe jopasurore personave fizikë apo juridikë privatë, vendas apo të huaj. Ky ligj bën pjesë në ato ligje që nuk ka gjetur zbatim dhe nuk ka justifikuar qëllimin e ligjvënësit.”

Në **Kreun e Dytë** flitet për subjektet dhe objektin e përgjegjësisë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike në Shqipëri. Paraqitet një përkufizim i shkurtër dhe aktual i organit publik me hyrjen në fuqi të K.Pr.A të Ri (28 Maj 2016) dhe kuptimin më të gjerë që ka ndaj rrethit të organeve të administratës shtetërore dhe publike në ligjet e mëparshme.

Në këtë kre listohen dhe organet kushtetuese të cilat kryejnë veprimtari administrative dhe përgjegjësinë që kanë për dëmet që i shkaktojnë të tretëve. Në Republikën e Shqipërisë, referuar edhe ndryshimeve të fundit të normave të së drejtës administrative, këto organe publike mbajnë përgjegjësi jashtëkontraktore për veprimet, mosveprimet apo akte të tjera organet e administratës publike.

Edhe përse njihet ky parim kushtetues, sot krahas ligjit nr. 8510/1999 i cili rregullon specifikisht përgjegjësinë jashtëkontraktore të administratës shtetërore, nuk ka ndonjë ligj i cili rregullon përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve publike, pavarësisht se ligji zgjerohet dhe zbatohet edhe për to. Ky konkluzion del nga interpretimi i Kushtetutës, parimet e vetë Kodit të Ri të Proçedurave Administrative ku çdo organ shtetëror mban përgjegjësi për veprimet a mosveprimet e padrejta që kryen duke pasqyruar dëm për shtetasit, në mënyrë direkte apo indirekte (shih nenin 15 të KPRA 2016).

Nëpunësit publikë njihen si përgjegjës përfundimtar në “zinxhirin e shkarkimit”, për dëmin e pësuar nga të tretët kur dëmi ka ardhur nga veprimet vetjake të paligjshme dhe me keqbesim. Përpos kësaj, organi administrativ ka për detyrë të shpërblejë të dëmtuarin dhe më pas mund t’i kërkojë kthimin e shpërblimit nëpunësit që ka shkaktuar dëmin.

Në këtë kre paraqitet mospasja e përgjegjësisë civile sipas legjislacionit tonë nga ana e gjyqtarëve të tre shkallëve të gjykimit dhe deri te Gjykata Kushtetuese, ndryshe nga shtete e tjera, si psh., si Italia ku njihet përgjegjësia civile që mbajnë gjyqtarët në rast se u shkaktojnë palëve ndërgjyqëse a të tretëve për dhënien e një vendimi të padrejtë apo dëmet nga zvarritjet e gjykimit, etj.

Në **Kreun e Tretë** analizohen elementët e dëmit jashtëkontraktor të administratës publike. Elementët klasikë që njihen edhe neni 608 të KC siç janë: veprimet dhe mosveprimet e paligjshme, faji dhe shkallëzimi tij, lidhja shkakësore dhe dëmi i ardhur. Si lloje njihen përgjegjësia me faj direkt, me faj të prezumuar nga veprimet e tjetrit, nga sendet dhe kafshët nën përgjegjësi, përgjegjësia pa faj, etj.

Dëmi që pësojnë të dëmtuarit mund të jetë direkt ose indirekt, i dëmtuari mund të jetë person fizik apo juridik, dëmi mund të jetë pasurore por edhe jopasurore. Meqënëse ligji nr. 8510/1999 referon se kuptimi i dëmit dhe i shpërblimit të tij do të bazohen te Kodi Civil, njihen si të tilla sipas jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjatës së Lartë mbi nenin 625 të KC, dëm jopasurore në formën e dëmit biologjik, dëm ekzistencial dhe dëm moral.

Si element i katërt i përgjegjësisë trajtohet hollësisht dëmi që vjen nga përgjegjësia jashtëkontraktore e organeve të administratës publike konkretisht

konfigurohet në formën e dëmeve: 1) për shkak të vendimeve të paligjshme, 2) për shkak të veprimeve apo mosveprimeve të kundërligjshme, 3) për refuzim të paligjshëm për të marrë vendime, 4) për dhënie të informacioneve shkresore të pasakta, 5) për veprime a mosveprime te ligjshme, por që sjellin dëmtimin e interesave të ligjshme të personave fizikë a juridikë privatë, 6) për veprime apo mosveprime të ligjshme që u shkaktojnë një dëm te pabarabarte subjekteve te cilëve u drejtohet ky veprim apo mosveprim, 7) për shkak te mosfunksionimit të mjeteve teknike me të cilat organet e administratës shtetërore ushtrojnë veprimtarinë e tyre, kur personave fizikë a juridikë private u cënohen ne interesat e tyre te ligjshme, 8) nga një rrezik i vazhdueshëm personave fizike a juridike private, 9) nga një akt korruptiv gjatë ushtrimit të funksionit, 10) nga ndryshimi i një situatë juridike ose faktike me origjinë nga akte te administratës shtetërore, 11) për çdo shkak tjetër të parashikuar me ligj.

I gjithë ky kapitull është ilustruar me raste praktike gjyqësore dhe me ligje, akte nënligjore dhe akte ndërkombëtare si p.sh, Konventa e Këshillit të Europës “Mbi përgjegjësinë civile nga aktet korruptive”, ligji “Për kompensimin për burgim të padrejtë”, etj.

**Në Kreun e Katërt** studimi “ulet” në praktikën gjyqësore ku zbatohet ligji nr. 8510/1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” në harmoni me ligjin nr. 49/2012 “Mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, Kodi i Procedurave Administrative i vitit 1999 dhe vitit 2016, etj.

Merren në analizë elementët e tërë gjykimin të çështjeve të tilla në Gjykatën Administrative duke nisur që nga hetimi mbi juridiksionin e gjykimin të kërkimeve, kompeëncën lëndore dhe tokësore të këtyre çështjeve, legjitimimi pasiv i organit shtetëror, provat që mund të merren në gjykim, barra e provës, disponimi i gjykatës mbi shpërblimin e dëmit, parashkrimi i padive për shpërblim të dëmit jashtëkontraktor, afati parashkrimit apo dekadencës dhe deri te vendimmarrja e gjykatës. Ky kapitull është ilustruar më së shumti me jurisprudencë të Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Apelit Admnsitrativ, Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë dhe Shkodër.

**Në Kreun e Pestë** analizohet detyra e dytë e gjykatës apo organit publik kur konstaton (se është shkaktuar një) dëm jashtëkontraktor: shpërblimi i këtij dëmi. Referuar doktrinës por edhe jurisprudencës njihen disa forma shpërblimi në administratën publike për të dëmtuarit nga dëmet jashtëkontraktore, dëmet civile. Më konkretisht shtjellohen shpërblimi i dëmit pasuror dhe kriteret që merren parasysh, mënyrat e shpërblimit të dëmit pasuror dhe jopasuror, kriteret që udhëheqin gjykatat apo edhe organet publike në shpërblim në natyrë, në të holla, të copëzuar me këste, etj. Kriteret që merren parasysh janë identike me shpërblime të tilla në gjykime civile dhe interpretimet e jurisprudencës mbi të. Edhe në të drejtën administrative njihen mënyrat e shpërblimit të plotë (restitutio in integrum), parimi i shpërblimit të drejtë, shpërblimi unik, etj.

Përveç kësaj jemi ndalur edhe në shpërblimin e dëmit sipas kriterëve që merren nga Gjykata Europiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Gjykata e Strasburgut) ku paraqiten kriteret në të cilat bazohet zakonisht kjo gjykatë në shpërblimet e dëmeve jopasurore për shkeljet e hasura nga shtetet nga ku përmendim gjëndjen ekonomike të të dëmtuarit, kategoria vulnerabël e të dëmtuarit, fakti se shpërblimi i dëmit civil është i pavarur nga gjykimi penal, mosnjohja e natyrës ndëshkuese të shpërblimit të dëmit, afatet për shqyrtimin e të tilla kërkesave, etj. Merret për studim krahasues ligji “Mbi përgjegjësinë e shteteve për veprime ndërkombëtare të

paligjshme” të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (2001).

**Në Kreun e Gjashtë** trajtohen në mënyrë krahasimore, legjislacione të vendeve të ndryshme si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Italisë, Francës, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Kosovës. Po ashtu janë paraqitur rastet më të njohura të këtyre shteteve në lidhje me interpretimet ligjore ose orientimet e jurisprudencës. Mund të themi se përgjegjësia jashtëkontraktore ose përgjegjësia administrative në Francë është mjaft e zhvilluar dhe sqaron edhe një herë përse Franca është djepi i së drejtës administrative dhe lokomotiva ndërkombëtare e zhvillimit të koncepteve të reja të kësaj fushe. Doktrina dhe jurisprudenca për vetë legjislatorin francez ka qenë udhëheqese në nxjerrjen e ligjeve dhe dekreteve ku përmbahen koncepte të reja doktrinare dhe jurisprudenciale të papërmendura më parë.

**E drejta gjermane** mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore (civile) të organeve të administratës publike është e rregulluar mjaft mirë si nga Kushtetuta, ashtu edhe nga Kodi Civil, por edhe nga ligje të tjera të së drejtës administrative. Dallohet fakti se në Gjermani, shteti mban përgjegjësi primare për çdo lloj dëmi që pëson personi nga veprimeve të padrejta ndaj tyre, dhe rrallë flitet për përgjegjësi personale të punonjësve. Po ashtu, llojet e dëmeve, kriteret që kërkohen për të pasur dëm, lidhja shkakësore, janë mëse të trajtuara në Kodin Civil, i cili është baza në të cilën i dëmtuari kërkon shpërblimin përkatës. Kompensimi është monetar si për dëm jopasuror ashtu edhe për atë pasuror dhe nuk njihet e drejta e kompensimit në natyrë por vetëm në vlerën monetare ekuivalente të tyre. Gjithashtu, jurisprudenca e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese të RFGJ e kanë pasuruar trajtimin e kësaj përgjegjësie karshi të tretëve, sidomos mbi kriteret që duhen plotësuar për të caktuar shpërblimin e dëmit, të cilët më në detaje do t'i përmendim në vijimësi.

**Në Mbretërinë e Bashkuar** çdo organ publik përveç gjyqtarëve, ka përgjegjësi për dëmet jashtëkontraktore që mund t'i sjellin të tretëve gjatë ushtrimit të detyrës. Këtu përgjegjësia e administratës publike për punonjësit është një përgjegjësi me faj, strikte dhe me karakter objektiv, mjafton që të provohet se ka qenë e kryer me një pakujdesi të dukshme.

Dhoma e Lordëve me jurisprudencën e saj ka zhvilluar përgjegjësinë e administratës publike në shumë drejtime, duke shtuar llojshmërinë e përgjegjësive, duke vendosur standarde të vlerësimit të veprimeve të administratës apo punonjëve të saj karshi të dëmtuarve si të drejta apo të padrejta, etj. Duhet të ketë prova të plota bindëse për lidhjen shkakësore midis dëmit të pësuar dhe pakujdesisë së treguar nga administrata publike dhe punonjësit e saj, pakujdesi e cila është nën standardin minimal. Pasoja për dëmin e ardhur të duhet jetë e evidente, llogjikisht prezente dhe e drejtë.

**Shtetet e Bashkuara të Amerikës** që nga koha e krijimit të Kushtetutës kanë një legjislacion të ngjeshur mbi përgjegjësinë e shtetit për veprimet e padrejta të punonjësve karshi shtetasve.

Nacionin e shtetit si i paditur në gjykim, SHBA e njohu që në amendamentin e njëmbëdhjetë të Kushtetutës dhe më pas me rregullime të veçanta si ligji “Për paditë federale ndaj përgjegjësive jashtëkontraktore” (1946) më pas me ligjin Westfaller në vitin 1988, me Ligji “Mbi përgjegjësinë e shtetit për radioaktivitetet”, eksperimentet atomike, etj.



Vlen të theksohet se shteti ka pozita mbrojtëse karshi punonjësve të saj kur ai i kryen veprimet brenda kompetencave dhe diskrecionit të dhënë dhe në këtë rast nuk mund të paraqitet padi pasi konsiderohet se shteti dhe punonjësi i tij kanë kryer veprime të ligjshme. Nëse qytetari pretendon se ka një të drejtë kushtetuese të shkelur ose një të drejtë të parashikuar në të drejtën zakonore (statutory law) ai mund të padisë nëpunësin e shtetit dhe ky mban përgjegjësi personale për dëmin e shkaktuar nga pakujdesia, duke vepruar përtej detyrave të tij shtetërore. Po ashtu, jurisprudenca e Gjykatës Supreme ka luajtur një rol domethënës dhe ligjkrijuese mbi këtë institut aq sa vendime të tjera si Bievens, Westfall, Fares etj. janë plotësuese të ligjeve ekzistuese si Ligji FTCA apo Ligji Westfaller, etj.

**Në Kosovë** përgjegjësia e administratës shtetërore nuk është e parashikuar në mënyrë të detajuar në një ligj si në Shqipëri, por ajo nxirret në ndërthurje të parashikimeve të Kushtetutës, ligjeve për procedurën administrative, për administratën shtetërore, për nëpunësin civil, për konfliktet administrative, për marrëdhëniet e detyrimeve, etj. Në përmbajtje nuk ka ndonjë ndryshim me legjislacionet e shteteve të tjera ku njihet detyrimi i shtetit për të qenë përgjegjës karshi të dëmtuarve për veprimet e padrejta që kryejnë punonjësit në kapërcim të detyrave të tyre ose jo. Ajo çfarë bën diferencën është se shteti gjithmonë del përgjegjës dhe nuk ka përgjegjësi solidare me punonjësin karshi të dëmtuarit. Ndërsa në lidhje me fajësinë e punonjësit nëse veprimi apo mosveprimi është kryer me qëllim, me pakujdesi të rëndë, nga mungesa e profesionalizmit, shtetit i lind e drejta të kërkojë kthimin e shpërblimit në favor të të dëmtuarit.

**Në Kreun e Shtatë** paraqitet një pasqyrë mbi jurisprudencën e dëmeve jashtëkontraktore të administratës publike të konsoliduar me praktikë gjyqësore të Gjykatës Europiane të Bashkimit European konkretisht:

1. parashikimet në të drejtën komunitare mbi përgjegjësinë civile të organeve të Institucioneve të Bashkimit European.
2. kushtet për të ekzistuar përgjegjësia jashtëkontraktore sipas të drejtës komunitare dhe jurisprudencës së GJDE janë:
3. përgjegjësia jashtëkontraktore sipas të drejtës komunitare për shkaqe të paligjshme (unlawful acts, të kryera nga punonjësi i institucionit të BE-së, - përgjegjësia jashtëkontraktore e shtetit sipas të drejtës komunitare për akte të ligjshme,
4. llojet e dëmeve në përgjegjësinë jashtëkontraktore në të drejtën komunitare, mënyrat e shpërblimit nga Institucionet Komunitare për përgjegjësinë jashtëkontraktore,
5. parashkrimi i së drejtës për të kërkuar shpërblim dëmi nga Institucionet e Bashkimit European.

**Në Kreun e Tetë** paraqiten disa përfundime mbi çfarë u trajtua në këtë temë dhe disa sugjerime që duhet të merren parasysh për ndryshime në legjislacion, detaje për t'u pasur parasysh nga gjykatat administrative, për referenca në jurisprudencat ndërkombëtare etj.

**Metodologjia** e punimit ka qënë ndër më të përzgjedhurat dhe më të larmishmet.

Së pari, është përdorur metodologjia krahasuese ndërkombëtare. Krahasimi me shtetet e tjera si në ligje por edhe ne case-study (jurisprudencë) nxjerr në pah se si e rregullojnë shtete e tjera këtë institut civil. Po ashtu jurisprudenca e këtyre shteteve e ka zhvilluar më tej legjislacionin dhe shpesh e ka udhëhequr në ndryshimet pasuese. Praktika dhe teoria e hulumtuar në vënde si SHBA, Francë, Gjermani etj. ka qënë e pafund.

Së dyti, është përdorur metodologjia e vëzhgimit historik, pra në të gjithë kohën e ekzistencës së shtetit shqiptar është vërejtur në legjislacionet përkatës sesi është parashikuar përgjegjësia civile e shtetit karshi qytetarëve ndërsa praktika gjyqësore apo teoria në këtë fushë ka qënë pothuaj inekzistente para vitit 1990.

Së treti, është përdorur metodologjia analizuese normative ku vlen për tu përmendur analiza e një sërë ligjesh, madje disa prej të cilave u miratuan gjatë kohës së punimit të tezës si p.sh Kodi i Proçedurave Adminsitrative i Riu i cili hyri në fuqi më 28 maj 2016, ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe sidomos ligjit nr. 8510/1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe mosmarrëveshjet administrative” etj.

Janë analizuar edhe një sërë ligjesh që parashikojnë përgjegjësinë e shtetit si p.sh Kodi Civil, ligji për Kompensim për burgim të padrejtë, ligjet dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave për shpronësimet publike, Kushtetuta e vitit 1998 dhe Dispozitat Kushtetuese të vitit 1991 etj.

Përveç analizës normative është përdorur metodologjia analizuese e jurisprudencës shqiptare sidomos vendime nga Seksioni Administrativ tek Gjykatat e Rretheve Gjyqësore para se të krijoheshin gjykatat administrative para vitit 2013, vendime të Gjykatave Administrative të Shkallëve të Para si Tiranë, Shkodër etj. vendime të Gjykatës së Apelit Tiranë para vitit 2013 dhe më pas vendime të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, vendime të Kolegjit Civil të Gjykatë së Lartë para vitit 2013 dhe vendime të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe vendime të Gjykatës Kushtetuese.

Metodologjia deduktive dhe induktive janë përdorur për të interpretuar më mirë normat ligjore dhe ato nënligjore, për të kuptuar interpretimin e vetë gjykatave kur ato kanë qënë evazive apo lënë shteg për dykuptimësi.

Rëndësi të veçantë ka pasur përgjegjësia jashtëkontraktore e Institucioneve dhe punonjësve të Bashkimit Evropian dhe trajtimit të tyre nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (Gjykata e Luksemburgut). Kjo jo vetëm jep pasqyrë se si parashikohet nga Traktati i Funksionimit të Bashkimit Evropian por edhe sesi gjykatat i kanë dhënë “ngjyrim” këtyre dispozitave të së drejtës komunitare. Këto jurisprudenca kanë shërbyer për të sugjeruar ndryshimet ligjore kombëtare.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut është analizuar për të deduktuar mënyrën sesi kjo gjykatë shpërben dëmet që shtetet i shkaktojnë individëve në rast se institucionet e tyre nuk i përgjigjen qytetarëve në kohë, në mënyrën e duhur etj. Është marrë parasysh edhe rezoluta e Asambles së Kombeve të Bashkuara mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore të mardhënieve ndërkombëtare ndër-shtetërore por edhe Konventa e Këshillit të Evropës për përgjegjësinë civile nga akte korruptive të punonjësve, e ratifikuar edhe nga Shqipëria.

Si përfundim, mund të themi se metoda e krahasimit ndërkombëtare, metoda e hulumtimit të literaturave, jurisprudencës kombëtare dhe ndërkombëtare, akteve ndërkombëtare dhe gjykatave të organizmave të ndryshme si Gjykata e Luksemburgut apo e Strasburgut kanë sjellë një punim që nxjerr të meritat, të metat dhe mangesitë e ligjit të brëndshëm dhe mundësisë për tu rritur standardet apo nevoja për ndryshime. Metodat e tjera si zbatimi i të ligjit, teknike-normative, krahasuese historike etj. ka ndikuar në arritjen e një punimi që ekspozon traditën tonë mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve publike karshi qytetarëve, evoluimin e tij ndër vite dhe nivelin aktual të teorisë dhe jurisprudencës, mangesitë, kufijtë e zbatueshmërisë dhe vëndet për ndryshim.

Shumëllojshmëria e metodologjisë e bën konkluzionet dhe sugjerimet më të sakta dhe më të qëndrueshme në kohë.

**KREU I****HISTORIKU I PËRGJEGJËSISË JASHTËKONTRAKTORE TË ADMINISTRATËS NË SHQIPTAR**

- 1.1 Periudha nga shteti bizantin, fillimi i shekullit IV e.s e deri në shtetin e pavarur shqiptar në vitin 1912;
- 1.2 Periudha nga viti 1912 deri në vitin 1944;
- 1.3 Periudha e regjimit komunist nga viti 1944 deri në vitin 1991;
- 1.4 Periudha post-komuniste, demokratike nga viti 1991 e në vijim.

**1.1 Periudha nga shteti bizantin, fillimi i shekullit IV e.s e deri në shtetin e pavarur shqiptar në vitin 1912**

Sipas dokumenteve arkivore mbi veprimtarinë e organeve të herëshme në shtetin ilir, në principatën e Arbërisë, qytetet mesjetare etj., njihet përgjegjësia e funksionarëve të shtetit për të mos kryer veprime përtej rregullave të kohës, në të kundërt mund të ndëshkoheshin civilisht me kthimin e situatës në gjendjen e mëparëshme në formën e zhdëmtimit në para, kthimin e të njejtës pasuri nëse vazhdon të ekzistojë në duart e ofiqarit, detyrimin për të mos vepruar me këtë gjëndje të paligjshmërisë e deri te ndëshkimet penale si dënimi me bugim ose me vdekje.

Në aktet juridike të së drejtës në Shqipëri të mbledhur nga Prof. Dr. Aleks Luarasi<sup>1</sup> përmendet Ligji i perandorit bizantin Valentinian (365-375 e.s) ku në librin XI parashikohet kapitulli me titullin “Që të mos pësojnë dëme provincialët” ku ndër të tjera thuhej se: *“Në qoftë se ndonjëri prej atyre nëpunësve, që gjenden nën urdhërat e sundimtarëve të provincave, të cilët udhëheqin zyrat e ndryshme dhe që nën çfarëdo preteksti detyrimi kundrejt shtetit kallin frikën me sjelljet e tyre të keqe, cilido qoftë ai që detyron fshatin t’i nënshtrohet pors i skllav i tij ose përdor shërbimet dhe nevojat e veta qoftë skllavin, qoftë kaun e tij, qoftë edhe nëse përvetëson dhuratat ose shërbimet që i kanë bërë shtetit fshatarët sipas kërkesave të ligjit, qoftë edhe nëse pranon dhuratat e ryshfetet e propozuara , gjë që nuk është e lejuar, atij i konfiskohet e gjithë pasuria dhe të dënohet me vdekje. Një dënim i rreptë t’i jepet edhe fshatarit, i cili kur e pyesin përgjigjet se vullnetarisht ka pranuar të punojë te ky nëpunës. Po një dënim i tillë i rreptë t’u jepet edhe atyre, të cilët i detyrojnë pronarët e tokave t’u bëjnë atyre dhurata ose të kryejnë shërbime, ose nuk e kthejnë atë që u ofrohet. Shpallur në Agripinë, më 30 Shtator në kohën e konsujve Valentinian dhe Valens Augustë.”*

Përgjegjësia e nëpunësit karshi shtetasve nuk ndahet mes asaj civile dhe penale, megjithatë kjo tregon se vetë nëpunësi gjithësesi në rast të sjelljeve të këqija, si për shembull përvetësimin pa të drejtë të pasurisë së shtetasit etj., mban përgjegjësi. Kjo tregon se në Shqipëri, në periudhën e Perandorisë Bizantine administrata në vetevete nuk dilte përgjegjëse karshi dëmeve që u shkaktonin qytetarëve nëpërmjet nëpunësve, por shkarkonin përgjegjësinë direkt te nëpunësi që vepronte me keqbesim a në kundërshtim me ligjet e kohës.

Në periudhën e qyteteve shqiptare të mesjetës në shekujt XIII-XV në një vendim të Senatit të Venedikut për disa kërkesa të Komunës së Durrësit datë 31 Tetor 1401 u morën këto masa për veprime të padrejta të funksionarëve të shtetit Venedikas. Konkretisht rektorëve të qytetit u ngarkohej detyrë që qytetarët të paguajnë për shkresat

<sup>1</sup> Luarasi, A, “Aktet juridike. Për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri. Pjesa I”, SHBLU Tiranë 2001, faqe 39.

që hartojnë vetëm shumën e caktuar më parë dhe në rast se kancelarët kundërveprojnë: “të pësojë si dënim kthimin e asaj që do të marrë dhe të paguajë dyfishin e asaj që do të shkojë përtej caktimit të vendosur prej të quajturit zotit Pjetër Mihali dhe një e tretë e këtij dyfishi të jetë e paditësit dhe një e treta rektorit dhe teprica t’i mbetet komunës sonë”. Pra kancelari ndëshkohet civilisht duke paguar dyfishin e shumës së marrë tepër dhe i paguante dëmin qytetarit që i kishte marrë me tepër për kartën e shkruar, duke i kthyer një e treta e dyfishit.<sup>2</sup>

Gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, në Sanxhakun e shtetit shqiptar në periudhën mesi i shekullit XV deri XVIII janë gjetur vendime nga gjykatat e kazave, me ferman të Sulltanit etj., mbi paditë, ankesat e qytetarëve për veprime të paligjshme të kryera karshi tyre si gjatë mbledhjes së taksës së avarizit nga persona të paautorizuar<sup>3</sup>, apo me mbledhjen e taksës së xhizjes te ato banorë që e kishin pranuar islamit<sup>4</sup>, për padrejtësitë mbi vjeljen e taksës së dhenëve.<sup>5</sup> Në këto raste përgjithësisht Këshilli i Sheriatit porositi funksionarët të mos e kryejnë më këtë veprim karshi shtetasve dhe nuk njihet përgjegjësia civile që mund të ketë shteti osman apo vetë funksionarët për të dëmshpërblyer banorët e sanxhaqeve.

## 1.2 Periudha nga viti 1912 deri në vitin 1944, dekadat e para të shtetit të pavarur shqiptar

E drejta administrative nuk përfshihet ndër të drejtat më të studiuara në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë kjo nuk e zhvleftëson faktin se njihet përgjegjësia e autoriteteve që kanë vepruar në shtetin shqiptar në lashtësi, mesjetë si dhe pas krijimit të shtetit Shqiptar pas vitit 1912, për dëmet që u shkaktojnë të tretëve. Përgjegjësia e administratës shtetërore shfaqet më tepër në kuadrin e një përgjegjësie disiplinore dhe maksimalisht në rast se veprimi a mosveprimi përmban elementë të veprës penale, nëpunësit apo pjestarë të tjerë të administratës të mos kenë përgjegjësi penale. Hulumentimi mbi të këtë institut ndër aktet historike është bërë duke kërkuar përgjithësisht mbi organizimin e qeverisë, administratës shtetërore ku në nene të veçanta parashikohen edhe rastet se kur mund të mbajë përgjegjësi administrata shtetërore.

Kanuni i Përshtatshëm i Administratës Civile (më tej KPAC) të Shqipërisë i miratuar më 22 Nëntor 1913<sup>6</sup> mund të themi së është i pari rregullim i së drejtës administrative të shtetit të parë të pavarur shqiptar. Përveç ndarjes administrative të territorit, organizimit të administratës në prefektura, nënprefektura dhe në krahina, ky ligj nuk parashikonte përgjegjësinë e organeve të administratës dhe aq më pak atë jashtëkontraktore. Megjithatë ndërmjet artikujve (kështu ndahet kanuni) mund të gjesh parashikime ku indirekt njihet detyrimi i administratës në rast dëmi të shkaktuar qytetarëve dhe me pasoja kryesisht disiplinore që passjellin për ta. Kështu në Art. 11 §2 të Kanunit parashikohet se në rast se pjestarë të administratës shtetërore gabojnë duke u shkaktuar dëm qytetarëve, prefekti, nëse janë kategoria e nëpunësve që emërohen dhe

<sup>2</sup> Po aty, faqja 101.

<sup>3</sup> Shih po aty, Vendimi i Gjykatës së Beratit datë 09 prill 1681 mbi ankesën e banorëve të fshatit Zhapë të Tepelenës për mbledhje dy herë të taksës së avarizit, faqe 173.

<sup>4</sup> Po aty, shih ankesën e fshatit Ujanik të Beratit kundër xhizjedarëve, faqe 180 dhe Ankesa e datës 27 dhjetor 1701 të banorëve të sanxhakut të Vlorës drejtuar Këshillit të Sheriatit, faqe 192.

<sup>5</sup> Po aty, shih ankesën e datës 24 qershor 1687 të banorëve të fshatit Kostren Kazaja e Beratit drejtuar Këshillit të Sheriatit, faqe 189.

<sup>6</sup> Grup autorësh Krisafi, Ballanca, Luarasi, Gjika, Zaganjori, Elezi, Nova, Omari, Hysi, Brozi, Gjilani, “Akte Juridike për Historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri, pjesa II”, Shtëpia botuese “Luarasi”, Tiranë 1999, faqe 19.

shkarkohen nga ai, i detyron të heqin dorë dhe në rast se janë të emëruar nga administrata qendrore, u drejtohet qarqeve.<sup>7</sup> Vihet re se përgjegjësia që mbajnë nëpunësit e administratës shtetërore në atë kohë shkonte deri në shkarkim si masë disiplinore dhe nëse kjo sjellje e gabuar përbënte vepër penale, ai i përcillej gjykatës penale.

Në kohën kur Shqipëria sipas vendimit datë 29 Korrik 1913 të Konferencës së Ambasadorëve në Londër u konstitua si principatë autonome, rregullimi i shtetit dhe në mes saj edhe i administratës publike u bë me Statutin Organik të Shqipërisë (SOSH) i miratuar më 10 Prill 1914 në Vlorë.<sup>8</sup> Princ Vilhem Vidi ishte kryetar i administratës publike.

Në Kapitullin V, pjesa B “Organizimi i shërbimit të shtetit”, pikat 90 deri 92 parashikojnë përgjegjësinë e nëpunësve të administratës për të përmbushur detyrat me ndërgjegje në të kundërt mund të shkarkohen a ndëshkohen. Pra ndryshe nga KPAC tashmë njihet jo vetëm përgjegjësia disiplinore e administratës shtetërore për dëmet që u shkakton të tretëve gjatë kryerjes së detyrës, por edhe ndëshkimi. Nuk flitet për një ndëshkim të veçantë, por lihet i hapur interpretimi për një ndëshkim disiplinor, penal dhe civil. Shkelja e detyrave si ruajtja e fshehtësisë profesionale, bindja e urdhërave ligjor të eprorëve, passillnin ndëshkimet disiplinore (i përmendur posaçërisht nga vetë pika 92-shën.R.M), trajtoheshin vetëm nga gjykatat e zakonshme dhe ishin në formën e qortimit, pezullimit të funksioneve, të rrogës si edhe shkarkimi.

Ajo çfarë vlen për t’u përmendur nga SOSH është se për herë të parë krijohen gjykata të posaçme për konfliktet administrative (sot gjykatat administrative) të cilat parashikohen në kapitullin e fundit, XVII. Në katër paragrafë parashikohet lënda e tyre pra, ankesat e personave fizikë apo juridikë kundër veprimeve dhe mosveprimeve të organeve administrative, për të vënë në vend një të drejtë të fituar. Ajo vepronte në dy nivele: si instancë e parë e vendosur në kryeqendrën e çdo sanxhaku dhe në nivel Apeli e cila ishte një në tërë principatën dhe në të njëjtin vend ku kishte selinë qeveria.<sup>9</sup>

Më 31 Janar 1920 në Lushnje, delegatë nga të gjitha krahinat, për të nxjerrë vendin nga kriza ku ishte përfshirë, afirmuan pavarësinë me Statutin e Lushnjes vetëm me 6 nene. Ky statut me 14 dhjetor 1914 u zgjerua dhe u krijua Statuti i Zgjeruar i Lushnjës (më tej SZL). Në Kaptinën e fundit, IV parashikonin se të gjithë zyrtarët dhe nëpunësit e shtetit civil apo ushtarakë përgjigjen për veprimet e tyre kur janë në kundërshtim me Statutin dhe dënohen për rastet e parashikuar nga ligji apo kur shpërdorojnë detyrën. (pika 127§2).

Gjatë kësaj periudhe konstitucionalisti Nikolla D. Mole në librin e tij “Konstitucionalismi” (1923), trajton për herë të parë përgjegjësinë e administratës publike të ndarë në përgjegjësi ministrare (e ministrave) dhe të nëpunësve. Për të parën, shprehet se kanë përgjegjësi politike kur ajo nuk votbesohet nga parlamenti dhe rrezohet ashtu siç ministrat kanë përgjegjësi penale kur kanë bërë një krim ndaj lirisë apo pasurisë së shtetasve. Ndërsa për përgjegjësinë e dytë Mole shprehet: *“Po veç në Shtetet e Bashkuara dhe në Angli, as në një vend tjetër s’ka një përgjegjësi të vërtetë të nëpunësve. Në Angli çështja e përgjigjesisë ministriale është e plotë. Atje*

<sup>7</sup> Art.11 §2: *“Në qoftë se ndodhen nëpunës, të cilët me gabimet e tyre që bajnë mund të shkaktojnë turbullim në administratën e atejshme dhe dam për vendin, ahëre, në janë prej atyne nëpunsave që ka të drejtë prefekti t’i pushojë dhe ti’emënojë, i shtërgon të heqin dorë drejt për së drejt, për ata, që pushohen dhe emërohen nga administrata qendrore, drejtohet në qarqet që u përkasin këta nëpunës. Në qoftë se shkaku i pushimit asht një delikt, a një krim shëmtim, fajtorët I shtie në gjyq.”*

<sup>8</sup> Luarasi. A *“Akte Juridike për Historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri, pjesa II”*, Shtëpia botuese “Luarasi”, Tiranë 1999, faqe 31.

<sup>9</sup> Po aty faqe 57.

*plotësisht njihet suvereniteti i ligjit dhe e drejta e gjyqit që ta mprojë këtë suverenitet kundër çdo ministrie ose nëpunës, ashtu që nëpunësi është përgjegjës për çdo keqbërje, ose paligjësi e bërë me iniciativën e tij ose me urdhër prej lart. Atje në është se një nëpunës i ka çkatëruar të drejtat të nja banuesit me iniciativën e tij ose me urdhër të ministrit, ay detyrohet të vijë përpara gjyqit dhe ky e gjykon pa pyetur në ka urdhër prej lart ose e ka bërë me iniciativën e tij atë çkatërim. Dhe në qoftë abuzimi është bërë me urdhër prej një ministri atëherë gjykohet nëpunësi dhe ministri”.*<sup>10</sup>

Më tej Mole përmend edhe vetë Tocqueville ku shprehet se në një komb të lirë si Shtetet e Bashkuara çdo banues gjykon nëpunësit ashtu si çdo gjykatës. Për kohën kur Mole cek përgjegjësinë e administratës shtetërore, ky institut akoma mbetej tabu për vënde të zhvilluara perëndimore përveç Anglisë dhe SHBA dhe ishte në kufijtë e mosdijes si koncept për vënde të sapo krijuar politikisht dhe administrativisht si Shqipëria.

Vendosja e administratës në përgjegjësi për çdo veprim të kundërligjshëm që mund të kryejë, parashikohej edhe në programin e Qeverisë Demokratike të Kryeministrit Fan S. Nolit ku për këtë situatë mund të miratohej ligj në të ardhmen. Me formimin e qeverisë synohej krijimi i një administrate të aftë, jo militante, e përgjegjshme dhe me pak shpenzime.<sup>11</sup> Për shkak të jetës së shkurtër të kësaj qeverisje (Qershor deri Dhjetor 1924), ky projekt për demokratizimin e mëtejshëm të administratës mbeti në letër.

Me krijimin e Republikës Shqiptare me 21 Janar 1925 me Kryetar Ahmet Zogun, Statuti Themeltar (më tej STRSH), si akti më i lartë i shtetit edhe pse detajonte në kapitull të veçantë të drejtat e qytetarëve si ajo e lirisë personale, të drejtën e pronës dhe të një shpërblimi të drejtë, të paprekshmërisë së banesës, e korrespondencës etj., nuk parashikonte të drejtën e tyre për t’u shpërblyer në rast të një keqadministrimi nga administrata shtetërore.

E njëjta situatë parashikohet edhe në Statutin Themeltar të Mbretënisë Shqiptare të dekretuar me datë 10 Dhjetor 1928, me kryetar shteti tashmë Mbretin Zogu I-rë. Në kapitullin VI “Të drejtave e qytetasve”, në Art. 212 parashikohej përgjegjësia e autoriteteve kompetente apo parlamentit që t’u përgjigjej me shkresë sa më shpejt çdo personi fizik a juridik kur u drejtohen për çështje private a publike.<sup>12</sup> Ndërsa vetë administrata shtetërore rregullohej me një ligj të veçantë “Mbi administratën shtetërore” (1928) si dhe ligje të tjera si Ligji “Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkive” dhe “Mbi bashkinë e kryeqytetit”. Në këto ligje parashikoheshin edhe përgjegjësitë civile të nëpunësve të administratës shtetërore që passillnin deri shkarkimin apo pezullimin e tyre nga puna.<sup>13</sup>

### 1.3 Periudha e regjimit komunist në vitet 1944-1991

Më 29 Nëntor 1944, me mbarimin e luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, Qeveria e Përkohëshme Demokratike hedh themelet e krijimit të shteti të ri komunist. Asambleja Kushtetuese me datë 11 Janar 1945 shpall Republikën Popullore të

<sup>10</sup> Mole N.D, “Konstitucionalism”, Luarasi Tiranë 1997, faqe 46.

<sup>11</sup> Shih Grup autorësh Krisafi, Ballanca, Luarasi, Gjika, Zaganjori, Elezi, Nova, Omari, Hysi, Brozi, Gjilani, “Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri”, Luarasi, Tiranë 2001, faqe 348-349.

<sup>12</sup> Luarasi, A, “Akte Juridike për Historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri, pjesa II”, Shtëpia botuese “Luarasi”, Tiranë 1999, faqe 133.

<sup>13</sup> Grup autorësh Krisafi, Ballanca, Luarasi, Gjika, Zaganjori, Elezi, Nova, Omari, Hysi, Brozi, Gjilani, “Akte Juridike për Historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri, pjesa II”, Shtëpia botuese “Luarasi”, Tiranë 1999, faqe 390.

Shqipërisë<sup>14</sup> ndërsa në Mars 1946 miratoi Kushtetutën e vendit. Në këtë kushtetutë duke qënë se klasa punëtore në fshat dhe në qytet kishte mbrojtje të veçantë u njihej edhe e drejta për t'iu drejtuar dhe ankuar për veprimet e “këqija” të administratës shtetërore.

Në nenin 32, tek kapitulli i të drejtave parashikohej se: *“Shtetasit kanë të drejtë t’u parashirojnë kërkesa dhe ankime organeve të pushtetit shtetëror. Shtetasit kanë të drejtë të ankohen kundra të gjitha vendimeve të kundraligjshme ose të parregullta të dhëna prej organeve të administratës së shtetit si dhe atëherë kur nëpunësit veprojnë keq.”* Pra vihet re një parashikim më i drejtëpërdrejtë i të drejtave të qytetarëve karshi veprimeve të padrejta të organeve të administratës shtetërore si entitet apo edhe kur punonjësit e tyre veprojnë padrejtësisht. Për këtë arsye parshikohej që mund t’i drejtoheshin gjykatës kompetente (neni 33) dhe mund t’i kërkohej edhe dëmshpërblim (neni 34)<sup>15</sup>. Në konkluzion të të tre neneve mund të themi se si raste kur qytetari legjitimohej për të kërkuar shpërblim për dëme të shkaktuara atij janë kur nëpunësi vepron keq, në mënyrë të paligjshme apo nga administrata me një vendimarrje e parregullt ose të kundërligjshme, etj.

Po gjatë kësaj periudhe referuar Treguesit Bibliografik Alfabetik të Legjislacionit për vitet menjëherë pas luftës (1944 deri 1955) Kuvendi Popullor ka miratuar disa dekrete dhe ligje mbi përgjegjësinë materiale të funksionarëve të shtetit. Përmendim Dekret-Ligj Nr. 727 datë 18.08.1949 *“Mbi përgjegjësinë materiale të funksionarëve dhe nëpunësve t’administratës, t’instituteve dhe t’organizatave ekonomike shtetërore kooperativiste që shkelin disiplinën financiare dhe u shkaktojnë këtyre dëme materiale“*, Urdhëresë nr. 23, datë 04.10.1952 *“Për shpërblimin dhe dënimin disiplinor të disa punonjësve në lidhje me veprimtarinë e tyre rreth paraqitjes së bilanceve”*<sup>16</sup>. Megjithatë vihet re se më tepër përgjegjësinë e mban nëpunësi apo funksionari i administratës, si ajo disiplinore, civile apo edhe penale, se sa administrata karshi qytetarit të dëmtuar.<sup>17</sup>

Me hyrjen në fuqi me datë 01 Mars 1957 të ligjit nr. 2359 datë 15 Nëntor 1956 *“Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet”* si dhe ligjit nr. 2360 datë 25 Nëntor 1956 *“Mbi zbatimin e ligjës mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet”*, rregullimi i detyrimeve të shtetit dhe organeve të tij karshi personave juridikë a fizikë të dëmtuar rregullohet nga kapitulli XXVIII *“Mbi detyrimet që lindin nga shkaktimi i dëmit”*. Në nenin 472 të saj parashikohet se: *“Personi që me faj (me dashje ose nga pakujdesia) i shkakton dëm, në mënyrë të paligjshme një tjetri në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj”*.

Referuar Kushtetutës së kohës, çdo individ ka të drejtë t’i drejtojë kërkesa organeve të pushtetit shtetëror madje të ankohet për vendime të paligjshme të organeve të administratës shtetërore apo nëpunësve (neni 32). Po ashtu shteti jo në të gjitha

<sup>14</sup> Sufaj F. *“Sistemi i ndëshkimeve në Shqipëri, gjatë regjimit komunist”*, desertacion për mbrojtien e gradës doktor, Fakulteti i Historisë, Universiteti i Tiranës, 2015, Faqe 39, <http://www.fhf.edu.al/doktorata/Femi%20Sufaj.pdf>, akses janar 2016.

<sup>15</sup> Neni 33 *“Çdo shtetas ka të drejtë të ankohet në gjykatat kompetente kundër nëpunësve për padrejtësi të bëra në ushtrimin e detyrës.* Neni 34 *“ Në konditat e caktuara me ligjë shtetasit kanë të drejtë të kërkojnë prej shtetit ose nëpunësve të tij një shpërblim për dëmin që kanë pësuar nga fakti i kryerjes së një shërbimi në kundërshtim me ligjën ose në mënyrë të parregullt”*.

<sup>16</sup> [http://www.parlament.al/web/pub/legjislacioni\\_shqiptar\\_0919451955122661.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/legjislacioni_shqiptar_0919451955122661.pdf), akses Janar 2016.

<sup>17</sup> Dekret nr. 1400, datë 17.01.1952 *“Mbi përgjegjësinë penale për nxjerrjen e prodhimit të keq nga ndërmarrjet industriale dhe për vënien në shitje të prodhimit të keq nga ndërmarrje tregëtare”*. -Gazeta Zyrtare Nr. 1, 28 Fruer 1952, f. 7-8.



rastet kishte përgjegjësi karshi të tretëve. Shteti paraqitej si subjekt të drejtash dhe detyrimesh karshi të tretëve: “Vetëm në marrëdhëniet juridike që lindin nga disponimi drejt për drejt prej tij i mjeteve buxhetore dhe i pasurisë shtetërore që nuk u është dhënë për administrim organeve të ndryshme shtetërore dhe në marrëdhëniet e tjera juridike në të cilat ai merr pjesë drejtpërdrejt.” (neni 26 i LVJD). Këtu si përfaqësues i shtetit del Ministria e Financave dhe organet financiare lokale.

Kush mund të përfshihet në organet shtetërore apo administratë shtetërore?

Si organe të administratës shtetërore në atë kohë ishin institucionet shtetërore, persona juridikë që krijohen me ligj, sipas nenit 28 të ligjit nr. 2022 datë 2 Prill 1955 “Mbi pjesën e përgjithshme të Kodit Civil të Republikës Popullore të Shqipërisë”.

Mendojmë, se duke qenë se e tërë ekonomia e vendit ishte e përqëndruar pothuajse në duart e shtetit referuar nenit 7<sup>18</sup> dhe 8<sup>19</sup> të Kushtetutës së vitit 1948 mund të themi se përgjegjës për veprime të tjera të padrejta karshi personave duke iu referuar të njejtave dispozita që rregullohen nga LVJD është edhe çdo person juridik në varësi të organeve shtetërore, që krijohen nga organe shtetërore apo këto japin pëlqimin për krijimin e këtyre.

Persona juridikë si institucione shtetërore përfshihen:

- Institucione me karakter jo ekonomik si p.sh.: institucionet shtetërore pranë këshillave popullorë, organizatave shoqërore, sportive, kulturore, teknike, shkencore, organizata e bashkimeve profesionale etj., institucionet që veprojnë pranë këtyre personave juridikë me karakter joekonomik sot mund të krahasohen me entet publike dhe përgjegjësini që kanë ato si pjesë e administratës publike.
- Institucione dhe ndërmarrje me karakter ekonomik: institucion shtetëror buxhetor, ndërmarrje dhe organizata ekonomike shtetërore që veprojnë në hazrasçot (llogari më vete), në fushën e telekomunikacionit, banka, posta, telegrafët, telefonat (PTT), në burimet e nëntokës dhe mbi tokë si miniera, pyje etj., organizatat kooperativiste etj., organizime bujqësore të tjera kooperativiste si ferma etj.

Vihet re sipas neneve 35 dhe 37 të Kodit Civil (Pjesa e Përgjithshme) se personi juridik është përgjegjës për dëmet që shkaktojnë organet e tij gjatë ushtrimit të detyrës dhe përgjigjet deri në kufijtë e pasurisë së tij ndërsa vetë organet shtetërore nuk kanë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë njëri-tjetrit, apo shteti në tregtinë e jashtme (shih neni 37) përveç kur ka një parashikim ligjor ndryshe.

Kjo logjikë e legjislatorit shkon sipas ideologjisë së Republikës Popullore të Shqipërisë se pasuria, mjetet e prodhimit të personave juridikë gjenden në duart e shtetit dhe përgjegjësia e anëtarëve karshi njëri-tjetrit do të jetë një marrëdhënie kompensimi mes kredisë dhe debisë.

<sup>18</sup> Neni 7 “Në Republikën Popullore të Shqipërisë mjetet e prodhimit përbëhen prej pasurisë së përbashkët të popullit që gjendet në duart e shtetit, prej pasurisë së organizatave kooperativiste popullore dhe prej pasurisë së personave privatë, fizikë ose morale.

Janë pasuri e përbashkët e popullit të gjitha minierat dhe pasuritë e tjera të nëntokës, ujrat, burimet natyrale, pyjet dhe kullotat, mjetet e komunikacionit ajror, hekurudhor e detar, postat, telegrafet, telefonat, radiostacionet dhe bankat.

Tregëtia e jashtëme është nën kontrollin e shtetit. Shteti gjithashtu rregullon dhe kontrollon gjithë tregtinë e brëndëshme të shtetit.”

<sup>19</sup> Neni 8 “Për të mbrojtur interesat jetësore të popullit dhe për të ngritur shkallën e mirëqenies së tij i dhe për të shfrytëzuar të gjitha mundësitë e të gjitha fuqitë ekonomike, shteti drejton jetën dhe zhvillimin ekonomik në bazë të një plani ekonomik të përgjithshëm. Duke u përshtetur (mbështetur) në sektorin ekonomik shtetëror dhe në sektorin kooperativist, aty ushtron një kontroll të përgjithshëm mbi sektorin privat të ekonomisë.

Për realizimin e planit ekonomik të përgjithshëm, shteti mbështetet në bashkimet profesionale të puntorëve dhe të nëpunësve, në kooperativat e fshatarëve si dhe në të tjera organizata të masave të punonjësve.”

Lidhja shkakësore mes dëmit të ardhur në pasuri apo në shëndet, jetë etj., dhe veprimet të paligjshëm të organit të insitucionit shtetëror apo punonjësit të tij duhet të jetë një lidhje e drejtpërdrejtë.

1. Referuar neneve 472 deri 500 të LVJD vihet re se në kuadrin e një veprimi të paligjshëm organet shtetërore: ndërmarrjet, institucionet, organizatat e tjera, karshi të tretëve mbajnë përgjegjësi:

- Strikte (për shkak të ligjit) si p.sh., për veprimtari me burim rreziku të shtuar të ndërmarrjet që prodhojnë lënde kimike të cilat mund të sjellin shpërthime për punonjësit apo për zonën përreth, puset e naftës që drejtoheshin nga ndërmarrjet shtetërore etj. (neni 473).<sup>20</sup>
- kur punonjësit apo organet e tij u kanë shkaktuar dëm të tretëve me faj, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre kur provohet se punësimi i punonjësve shkaktues të dëmit, është bërë në kundërshtim me ligjin, si persona të papërshtatshëm, të pakualifikuar ose kur organi i personit juridik nuk ka ushtruar mbikqyrjen e duhur karshi punonjësit (neni 481).<sup>21</sup>
- Për personat juridikë shtetërorë që me ligj mbajnë ose administrojnë pasuri, të holla, në çdo rast mbajnë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga veprimet e parregullta të punonjësve të tyre (neni 482).<sup>22</sup>
- Personi juridik për dëmin e shkaktuar një të treti i cili synonte të sprapste dëmin që mund të pësonte pasuria socialiste (neni 483)<sup>23</sup>

2. Në lidhje me dëmet që mund të shkaktohen nga organet e administritës shtetërore apo organeve të personave juridikë shtetëror njihen: dëmi material, dëmi në shëndet ose vdekja<sup>24</sup>.

3. Në lidhje me formën e fajësisë LVJD njih dashjen dhe pakujdesinë. Megjithatë njih edhe një formë tjetër të pakujdesisë, atë të rëndë por kjo kur kryhet nga i dëmtuari i cili kontribuon në ardhjen e pasojës (neni 485)<sup>25</sup>.

4. Në lidhje me shpërblimin e dëmit vihet re se organet e personave juridikë shpërblejnë dëmin pasuror ashtu edhe atë në shëndet a jetën e personit. Sipas nenit 484 të LVJD si formë e shpërblimit njihet ajo e ekzekutimit në natyrë dhe nëse kjo nuk është e mundur, paguhen humbjet dhe fitimi i munguar. Ky shpërblim paguhej menjëherë ose me këste.

<sup>20</sup> Ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat e tjera si dhe personat që zhvillojnë një veprimtari të tillë e cila është burim rreziku të shtuar për vendin rreth e përçark, përgjigjen për dëmin e shkaktuar nga burimi i rrezikut të shtuar, përveç kur provojnë se dëmi është shkaktuar nga një forcë madhore.”

<sup>21</sup>Neni 480 “Personi juridik është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga organet e tij në kryerjen e detyrave të tyre. Personi juridik si dhe çdo person tjetër përgjigjet për dëmin e shkaktuar me faj nga nëpunësit dhe puntorët e tij në lidhje me kryerjen e shërbimit të tyre por vetëm kur për fajin e vet ose të organeve të tij janë marrë në shërbim nëpunësa ose puntorë të papërshtatshëm se nuk është ushtruar mbikqyrje e duhur mbi veprimet e tyre.”

<sup>22</sup> Neni 481 “Për dëmin e shkaktuar nga veprimet e parregullta të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave të administrimit shtetërore që u janë ngarkuar, personi juridik shtetëror përgjigjet vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligja.

Në çdo rast, personi juridik shtetëror është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga veprimet e parregullta të personave zyrtarë në lidhje me pasuritë (të hollat) që në zbatim të një dispozite ligjore ose të një vendimi ose urdhëri të organit kompetent shtetëror u janë dorëzuar personave juridike shtetëror”

<sup>23</sup> Neni 483 “Për dëmin që i shkaktohet një personi, kur ai është duke prapsur një dëm që i kanoset pasurisë socialiste, përgjigjet personi juridik të cilit i përket pasuria.”

<sup>24</sup> Nenet 484, 488, 489 të LVJD.

<sup>25</sup> Neni 485: “Kur dëmi ose shtimi i sasisë së tij është shkaktuar edhe me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e të dëmtuarit, si dhe kur ky nuk ka treguar kujdesinë e duhur për pakësimin e dëmit, gjykata sipas rastit, mund të pakësojë shpërblimin e dëmit ose të çkarkoj krejt dëmtuesin nga detyrim për të shpërblyer dëmin” .

Në rastin kur veprimi i paligjshëm i organeve të institucioneve të shtetit passillte vdekje apo dëmtim në shëndet, ky nuk mbulonte dëmin drejtpërdrejtë nëse kishte një mekanizëm tjetër shpërblyes si p.sh., nga sigurimet shoqërore në formën e një pensioni familjar, invaliditeti etj. Pra, shpërblimi për dëmin në shëndet a në rast vdekje nuk njihej sipas nenit 490 të KC, por i dëmtuari përfitonte nga shërbimi spitalor, ambulatoriv që mbulohej tërësisht nga shteti etj<sup>26</sup>.

5. Kriteret që merren parasysh në matjen e dëmit material në pasuri është humbja e pësuar dhe fitimi i munguar. Në shpërblim zbritet rasti kur i dëmtuari ka kontribuar me dashje apo nga pakujdeisa e rëndë në ardhjen e pasojës, gjendja pasurore e të dëmtuarit dhe dëmtuesit. Nëse i dëmtuari është person juridik shtetëror nuk merret parasysh gjendja ekonomike si i dëmtuar (neni 486).

5.1 Në rastin kur dëmi pasuror i shkaktohet për shkak të humbjes së jetës apo humbjes së aftësisë për punë, shpërblimi i caktuar nga gjykata për rastin kur dëmi nuk mbulohet aspak ose vetëm në një pjesë nga sigurimet shoqërore shtetërore merret parasysh: gjendja ekonomike e të dëmtuarit, nëse i dëmtuari ka ndikuar me faj në ardhjen e pasojës, fakti nëse ka qënë i punësuar në kohën e ndodhjes së dëmit duke iu referuar pagës mesatare e vitit të fundit (neni 493) në të kundërt merret si referencë paga bazë që mund të merrte një punëtor i asaj kategorie (neni 496).

5.2 Moshë e të dëmtuarit merret parasysh për bazën e vlerësueshme për matjen e dëmit:

- Nëse ishte nën 18 vjeç dhe i papunë paguhej vetëm për shpenzimet e nevojshme të mjekimit, vënia e protezave, shpenzimet e tjera në lidhje me shëndetin. (neni 493).
- Kur arrin moshën 16 vjeç dhe nuk ka qënë i punësuar, ka të drejtë të kërkojë një shpërblim për humbjen e aftësisë për punë sipas pagës mestare bazë të një punëtori të pakualifikuar (neni 494§2).
- Nëse ishte 14 deri 18 vjeç dhe ishte i punësuar shpërblehej për humbjen e aftësisë për punë sipas të ardhurave që nxirrte, por jo më pak se paga mestare e një punëtori të pakualifikuar. Me të mbushur moshën 18 vjeç këtij shpërblimi i shtohet edhe diferenca mujore që mund të merrte ai si një punëtor i asaj kategorie që do të kishte fituar ose duhet të kishte fituar, po të mos kishte ndodhur dëmi.
- Në rast vdekje, shpërblehen personat e mitur dhe të paaftë për punë në ngarkim të të vdekurit plotësisht ose pjesërisht si dhe personat që kishin të drejtën e ushqimit prej tij (neni 489).
- Në të gjitha rastet e dëmeve pasurore për humbje të aftësisë për punë ose në rast vdekje shpërblimi ishte në këste mujore. (neni 499).

6. Masa e shpërblimit ishte e ndryshueshme me kërkesë të të dëmtuarit kur vërente se gjendja e tij shëndetësore po përkeqësohej dhe masa e shpërblimit nuk i

<sup>26</sup> Neni 491: “Personi juridik dhe çdo person tjetër që e ka siguruar të dëmtuarin me sigurimet shoqërore shtetërore nuk detyrohet të shpërblejë dëmin për rastin e vdekjes ose të dëmtimit të shëndetit të siguruarit. Por kur vdekja ose dëmtimi i shëndetit është shaktuar nga faji i personit juridik ose i çdo personi tjetër që është i detyruar të sigurojë të dëmtuarin ose nga faji i punonjësit të tij për rastet që ay ka përgjegjësi, i dëmtuari, në qoftë se nuk merr shpërblimin e plotë të dëmit sipas rregullave të sigurimeve shoqërore shtetërore, ka të drejtë të kërkojë nga personi juridik ose nga çdo person tjetër që i është detyruar t’i sigurojë pjesën e pashpërblyer të dëmit.

Organi i sigurimeve shoqërore shtetërore që ka paguar shpërblimin e dëmit në rastin e sipërm ka të drejtë të kërkojë nga personi tjetër, për fajin e të cilit është shaktuar dëmi, kthimin e shpërblimit të dëmit.”

mbulonte më shpenzimet të tjera të ardhura (neni 497). Por mund të kërkohej pakësimi i shpërblimit kur aftësia e të dëmtuarit për punë është përmirësuar (neni 498).

7. Në rast kur shkaktues të dëmit janë organe të disa personave juridikë përgjegjësia është solidare (neni 487). Pra shpërblimi mund të kërkohej dhe të paguhet qoftë edhe nga një institucion, ndërsa për sa i takon përgjegjësisë individuale të secilit, kjo zgjidhet mes vetë debitorëve apo edhe gjykatës duke kërkuar secili me padi regresi atë çfarë ka paguar tek i dëmtuari.

8. Parashkrimi për padinë e shpërblimit të dëmit ndryshe nga parimet e përgjithshme që fillon me lindjen e padisë, këtu për shkak të rrethanave, afati fillon nga dita që i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin dhe personin që e ka shaktuar atë (neni 500).

Sipas nenit 82§1 shkronja "b" Pjesa e Përgjithshme e Kodit Civil, e drejta e padisë parashkruhet me kalimin e tre vjetëve për konflikte midis privatëve ose midis privatëve dhe institucioneve shtetërore (ndërmarrjeve, organizatave shtetërore, kooperativiste ose shoqërore), me përjashtim të konflikteve në lidhje me të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme<sup>27</sup> për të cilat e drejta e padisë parashkruhet me kalimin e gjashtë viteve.<sup>28</sup>

Ky parashikim përveç rasteve të përgjithshme të parashkrimit pezullohet sipas nenit 500§2 i LVJD në rastin kur i dëmtuari apo personat përfitues në rastin e vdekjes së të dëmtuarit, kanë paraqitur kërkesën për caktim pensioni deri në një vendim pranimit të refuzimit nga organi i sigurimeve shoqërore.

9. Njihet e drejta e organit të personit juridik shtetëror që të kërkojë me padi regresi, kthimin e shumave që ka paguar për nëpunësin e tij kur ai është tërësisht fajtor në ardhjen e pasojës kjo, në përputhje me nenin 482 të LVJD.

10. Raste përjashtimore kur nëpunësi nuk mund të ketë faj dhe shkarkohet nga përgjegjësia është kur ai ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, në nevojë ekstreme apo kur provohet se dëmi është shkaktuar nga një forcë madhore.<sup>29</sup>

Me datë 28.12.1976 u miratua Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste e Shqipërisë, e cila ndryshoi edhe mënyrën e organizimit të shtetit, zhdukuri konceptin e pronës private. Ajo ashpërsoi linjën ndëshkuese me masat edhe më represive karshi institucioneve apo funksionarëve të cilët mund të shkaktonin dëme shtetit apo të tretëve, duke e rritur akoma më shumë përgjegjësinë shtetërore.

Ndryshe nga Kushtetuta e mëparshme e cila e parashikonte në tre nene përgjegjësinë e administratës dhe nëpunësve të saj ndaj qytetarëve, në Kushtetutën e re parashikohet vetëm në paragrafin e dytë të nenit 59, citojmë: "*Shtetasit kanë të drejtë të bëjnë kërkesa, ankesa, vërejtje dhe propozime në organet kompetente për çështje personale, shoqërore dhe shtetërore.*

*Shtetasit, sipas kushteve të caktuara me ligj, kanë të drejtë të kërkojnë zhdëmtim nga shteti ose nga nënpunësit e tij për dëmet që u shkaktohen nga veprimet e paligjshme të organeve shtetërore dhe të nëpunësve gjatë ushtrimit të detyrës*".

Vihet re se paragrafi i parë nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me paragrafin e dytë pasi e para ka të bëjë me të drejtën e qytetarëve për ankesë për çdo lloj çështje ndërsa

<sup>27</sup> Me konflikte në lidhje me të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme kuptohen vetëm padi reale të rivendikimit dhe të njohjes të së drejtës së barrës e parashikuar nga neni 103 dhe 114 të Dekretit mbi Pronësinë. Shënimi i bërë nga Ministria e Drejtësisë, në përmbledhjen e ligjeve në të cilën është marrë edhe LVJD dhe ligji "Mbi pjesën e përgjithshme të Kodit Civil" faqe 41.

<sup>28</sup> Megjithatë ky afat parashkrimi nuk duhet ngatërruar me afatin dy vjeçar që parashikon neni 83§"d" i Kodit Civil, Pjesa e përgjithshme për pagimin e shpërblimit sipas kontratës së sigurimit.

<sup>29</sup> Nenet 474, 473 të LVJD.

paragrafi i dytë ka të bëjë me të detyrimin e shtetit për të zhdëmtuar çdo veprim të paligjshëm me pasoja për qytetarin.

E vetmja lidhje që të krijohet nga leximi i parë i këtij neni bazuar edhe në ideologjinë e shtetit Popullor Socialist është se qytetarët i vënë në vëmendje shtetit problemet deri tek ato personalet, dhe shteti ka për detyrë t'i zgjidhë ato, në të kundërt administrata apo nëpunësit mbajnë përgjegjësi. Kjo ideologji shkon për shtat edhe me vetë diktaturën e proletariatit dhe të mbizotërimit të interesave të njeriut të ri socialist përkundrajt çdo lirie dhe të drejte të individit.

Gjithësesi sipas këtij neni, është ligji i posaçëm i cili rregullon më në detaj zhdëmtimin e qytetarit nga shteti për veprimet e padrejta të tij dhe të nëpunësve të tij. Sipas nenit 341 të Kodit Civil të Republikës Popullore Socialiste miratuar me ligjin nr. 6340, datë 26.6.1981, hyrë në fuqi më datë 01 Janar 1982 parashikohet se: *“Kur dëmi është shkaktuar nga organi i personit juridik, në kryerjen e punës ose të detyrës, zhdëmtimi bëhet nga personi juridik.*

*Personi juridik përgjigjet për dëmin e shkaktuar me faj nga nëpunësi dhe punëtorët e tij në lidhje me kryerjen e shërbimit të tyre, por vetëm kur për fajin e vet ose të organeve të tij janë marrë në shërbim nëpunës a punëtorë të papërshtatshëm, ose kur nuk është ushtruar mbikëqyrja e duhur mbi veprimet e tyre”.*

Vihet re se rastet që parashikon tashmë Kodi Civil i RPS të Shqipërisë hyrë në fuqi më datë 01 Janar 1982, ndryshe nga Kodi Civil i vitit 1957, Pjesa e Përgjithshme është me ngushtuar. Neni 342<sup>30</sup> parashikon specifikisht se personi juridik do të mbajë përgjegjësi për veprimet e parregullta të punonjësve, vetëm për rastet e parashikuara në ligj, pra këtu nënkupto kreun VIII “Detyrimet që lindin nga shkaktimi i dëmit” të Kodit Civil (neni 336 deri 349), që rregullon rastet më të detajuara se kur një nëpunës apo organ i administratës shtetërore mban përgjegjësi.

Pa rënë në përsëritje, pasi janë të njejtat parashikime si në LVJD, edhe këtu përgjegjësia e personit juridik (këtu nënkupto administrata shtetërore) është absolute kur bëhet fjalë për dëme ndaj të hollave që ruhen prej tij të shkaktuar në mënyrë të padrejtë nga nëpunësit, apo dëme nga veprimtaria me rrezik të shtuar e personave juridikë shtetërore dhe e punonjësve të saj.

Për dëmet e shkaktuara nga nëpunësit, shteti “penalizohet” duke i shpërblyer dëmin qytetarit, personit juridik etj., me arsyetimin se ai mban përgjegjësi për personat që rekruton si nëpunës, për kualifikimin dhe mbikëqyrjen mbi veprimet e tyre (shih nenin 341 të KC). Kjo nuk i mbron të drejtën e shtetit, organeve të tij, që me padi regresi t’u kërkojë shkaktuesve të vërtetë të dëmit kthimin e shpërblimit që ka paguar.

Ajo çfarë dallon tashmë (kjo nisur dhe nga ideologjia e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, ku çdo ekonomi dhe pronë ishte shtetërore përveç asaj vetjake të individit) është shpërblimi i personave të dëmtuar. Ai ka vaktësi në llojshmërinë, masën e shpërblimit madje nga 13 nene që kishte LVJD, Kodi Civil i 1981, parashikonte vetëm një nen shtetëror. Konkretisht neni 349 parashikonte se: *“Kur shkaktohet vdekja, shpërblehet dëmi që kanë pësuar personat e mitur dhe të paaftë për punë, të cilët kanë qenë në ngarkim të të vdekurit.*

*Kur shkaktohet dëmtimi i shëndetit, shpërblehet dëmi që ka ardhur nga humbja ose pakësimi i aftësisë për punë, si edhe shpenzimet e bëra në lidhje me dëmtimin e shëndetit. Masa e shpërblimit mund të hiqet, pakësohet ose të shtohet në varësi nga*

<sup>30</sup> Neni 342 *“ Për dëmin e shkaktuar nga veprimet e parregullta të nëpunësve gjatë kryerjes së detyrave të administrimit shtetëror që u janë ngarkuar, personi juridik përgjigjet vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji.”*

gjendja shëndetësore. Shpenzimet e bëra për mjekim në institucionet shtetërore janë falas dhe përballohen nga shteti.

Në rastet e mësipërme, kur i dëmtuari ose personat në ngarkim të të vdekurit përfitojnë nga sigurimet shoqërore shtetërore, dëmi shpërblehet nga organi i sigurimeve shoqërore shtetërore në mënyrën e caktuar me dispozita të veçanta. Në rastet e tjera dëmi shpërblehet nga personi fajtor.

Organi i sigurimeve shoqërore shtetërore që ka paguar shpërblimin e dëmit ka të drejtë të kërkojë kthimin e shpërblimit të dëmit nga personi që me faj e ka shkaktuar atë”.

Njësoj si LVJD, ky nen i sipërcituar përmbledh të njejtat koncepte mbi llojet e dëmit, subjektet përfitues por mungojnë bazat e pagës referuese për gjykatën se sa duhet të shpërblehet i dëmtuari sipas gjëndjes së tij shëndetësore, sipas moshës etj. Pra në rast se i dëmtuari është i siguruar dhe përfiton nga sigurimet shoqërore shpërblehet nga këto organe shtetërore. E kundërta, kur ai nuk është i siguruar për shkak të moshës, të qënies i papunë etj., kërkesën për shpërblimin e dëmit ia kundrejtojnë personit që ka shkaktuar dëmin, duke u trajtuar si një marrëdhënie civile jashtëkontraktore. Paragrafi i fundit i nenit 349 i KC njih të drejtën e padisë së regresit për organet e sigurimeve shoqërore drejtuar drejtpërdrejtë dëmtuesit.

Koncepti i parashikuar si në Kushtetutë dhe në Kodin Civil për përgjegjësinë e organeve apo nëpunësve për dëmet shkaktuar të tretëve nuk duhet ngatërruar me konceptin e përgjegjësisë materiale të punëmarrësit, nëpunësit karshi punëdhënësit (ndërmarrjes, institucionit ku punon etj.) i cili trajtohej gjerësisht në Kodin e Punës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë i miratuar me ligjin Nr. 6200, datë 28.06.1980<sup>31</sup>. Megjithatë vlen për t’u ndalur në pesë lloje përgjegjësisë që has nëpunësi publik i kohës për veprimet e paligjshme që ai kryen:

- Përgjegjësia politike e nëpunësve të aparatit shtetëror zakonisht i takonte nëpunësve në hierarki më të lartë, kryesisht anëtarë të Komiteteve Ekzekutive, deputetë etj., të cilët nuk i qëndrojnë besnikë idealeve të klasës puntore dhe masave të tjera të punonjëve. Pra veprimi konkret nuk duhet të jetë as penal, as civil por vetëm në mosrespektim të ideologjisë që funksiononte diktatura e proletariatit. Ndëshkimi për këtë lloj përgjegjësie është po ashtu politik duke e shkarkuar këtë punonjës nga ky pozicion.<sup>32</sup>
- Përgjegjësi penale është ajo lloj përgjegjësie, më e rënda për nëpunësin shtetëror nisur edhe nga ndëshkimi me burgim si dhe heqja e të drejtave për të ushtruar detyra të tjera të aparatit shtetëror. Kjo lloj përgjegjësie hasej kur nëpunësi shtetëror kryente vepër penale si: mitëmarrje, shpërdorim detyre apo vepra të specifikuara për funksionarët e shtetit.<sup>33</sup>
- Përgjegjësia administrative zbatohet kur nëpunësi shtetëror nuk respekton rregulloren e organit ku ushtron detyrën, nuk respekton rregullat disiplinore si higjieno-sanitare, të mbrojtjes kundër zjarrit, sigurimit teknik të pajisjeve elektrike etj. Ai mban përgjegjësi kur i shkel këto rregulla ose i neglizhon.<sup>34</sup>
- Përgjegjësia disiplinore e nëpunësve shtetërorë duhet dalluar nga përgjegjësia e mësipërme administrative, e cila ndodh kur punonjësi shkel detyrimet e tij sipas Kodit të Punës apo akteve të tjera të dala në zbatim të tij. Në këtë rast ndëshkimi është më tepër edukativ si p.sh., qortim, vërejtje, etj.<sup>35</sup>

<sup>31</sup> Shih kapitullin X, nga nenet 87 deri 92.

<sup>32</sup> Jani Çomo “E drejta administrative e Republikës Popullore të Shqipërisë, dispenca III”, Fakteti i Shkencave Politike Juridike, Universiteti i Tiranë, Tiranë, 1974, faqe 462.

<sup>33</sup> Po aty, faqe 463.

<sup>34</sup> Po aty faqe 464.

<sup>35</sup> Po aty faqe 464.

- Përgjegjësia civile është përgjegjësia individuale që mban punonjësi për dëmet e shkaktuara ndërmarrjes apo edhe të tretëve nga veprimet e mosveprimet e tij të paligjshme dhe me faj. Në këtë rast përgjegjësia do të rregullohet sipas Kodit të Punës ose Kodit Civil.<sup>36</sup>

#### 1.4 Periudha nga viti 1991 e në vijim

Me ardhjen e regjimit pluralist dhe vendosjen e demokracisë në vend ndryshuan edhe organet qeverisëse, legjislacionit iu shtuan të drejtat dhe liritë themelore të individëve, etj.

Ligji themelor i cili vendosi piketat për ndërtimin e Republikës Parlamentare të Shqipërisë ishte ligji nr. 9491 datë 29 Prill 1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Ky ligj shfuqizoi Kushtetutën e vitit 1976 dhe hyri në fuqi menjëherë deri në miratimin e Kushtetutës së vitit 1998.

Vlen të përmendet fakti se në 46 nenet e tij, nuk kishte kapitull më vete për të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve siç kishin dy Kushtetutat e mëparshme. Për një vit nga krijimi i saj, kjo Kushtetutë ka ndryshuar pesë herë dhe më pas dy herë të tjera në vitin 1993 dhe 1997. Kjo tregon se sa i pakonsoliduar ka qenë ligji themeltar për rregullimin e çdo aspekti të jetës së re post-komuniste.

Kapitulli për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut u shtua me ligjin nr. 7692, datë 31.03.1993 “Për një shtojcë në ligjin nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Në nenin 14 të këtij kapitulli parashikohet e drejta e rehabilitimit dhe zhdëmtimit ku: *“Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta të rehabilitohet dhe zhdëmtohet në përputhje me ligjin në rast se ai është dënuar për shkak të mosushtrimit të rregullt të drejtësisë ose është cënuar nga një akt administrativ i paligjshëm. Kushdo ka të drejtën e zhdëmtimit në përputhje me ligjin për dëmin që ka pësuar nga veprimet e të tjerëve. Asnjë të burgosuri nuk mund t’i mohohet trajtimi njerëzor dhe rehabilitimi moral”*. Në fakt vetëm paragrafi i parë specifikon të drejtën e individit për t’u dëmshpërblyer nëse është cënuar nga një akt administrativ i paligjshëm, ndërsa zhdëmtimet e tjera që i takojnë individit lidhen me një proces gjyqësor ose kur është dëmtuar civilisht nga të tretët, etj.

Me daljen e firmave rentiere të cilat kulmuan me falimentimin e tyre në vitin 1997 u plotësuan dispozitat kushtetutese me ligjin nr. 8255, datë 19.11.1997, konkretisht në nenin 10 të saj u shtua një paragraf i dytë. Në këtë nen njihej e drejta e institucioneve publike speciale kombëtare dhe ndërkombëtare që të administrojnë dhe kontrollojnë për të mbrojtur interesat e të dëmtuarve, pasurinë e subjekteve private që kanë vepruar në mënyrë të paligjshme.

Po ashtu u njoh e drejta e firmave rentiere për zhdëmtim nga institucionet shtetërore gjatë procesit të kontrollit, administrimit të pasurive të ligjshme.<sup>37</sup> Pra, me

<sup>36</sup> Po aty faqe 464.

<sup>37</sup> Neni 14-“Veprimtaria e kundërligjshme e subjekteve private që prek në masë interesat e individëve dhe grupeve sociale, që është në kundërvënje e në dëm të parimeve të ekonomisë së tregut e të politikave ekonomike e financiare kombëtare e ndërkombëtare, që cenon stabilitetin ekonomik e social të vendit, vihet nën kontrollin dhe administrimin e institucioneve publike kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara.

*Shkalla e ndërhyrjes, si dhe kompetencat e kontrollit dhe të administrimit të këtyre subjekteve private nga ana e institucioneve të lartpërmendura, përcaktohet me ligj.*

*Në këto raste shteti ka të drejtë dhe detyrë të disponojë mbi pasurinë e subjekteve private vetëm në mbrojtje të interesave të të dëmtuarave.*

këtë parashikim edhe pse administratorët e firmave piramidale do të gjykoheshin penalisht, përsëri me dispozitat kushtetuese u njihej e drejta për të kërkuar shpërblim për dëmin që këto institucione mund t'i shkaktonin atyre.

☑ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë i miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, hyrë në fuqi më 01 Nëntor 1994, në Titullin IV “Detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit” parashikon në nenin 618 përgjegjësinë e punëdhënësit si person fizik a juridik nëse punonjësi, organi i tij, i shkakton dëm të tretit gjatë ushtrimit të detyrave që i janë besuar. Madje në nenin 619 parashikohet se në rast se një person që nuk ka aftësitë e duhura, mban përgjegjësi karshi të tretit bashkë me punëdhënësin.

Me ligjin nr. 8417 datë 21 Tetor 1998 miratohet Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e cila paraqitet më e plotë dhe përmbledh edhe ndryshimet e ligjit kushtetues i cili vepronte deri në atë kohë.

Në nenin 44 të Kushtetutës parashikohej se: *“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.”*

Referuar edhe Treguesit Bibliografik Tematik të Legjislacionit Shqiptar 1991-2000 dhe Treguesit Bibliografik Tematik të Legjislacionit Shqiptar 2001 deri 2009<sup>38</sup>, i vetmi akt i cili rregullon përgjegjësinë e administratës shtetërore, e më konkretisht atë jashtëkontraktore pas kësaj Kushtetute, është ligji nr. 8510, datë 15 Korrik 1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”.

Ky ligj që nga koha e krijimit ka pasur vetëm një ndryshim në vitin 2008, duke përligjur faktin se ai është shumë pak i referuar, i përdorur dhe i diskutuar në praktikën administrative, gjyqësore, sa që nuk është parë e rastit as të sugjerohen ndryshme të mëtejshme edhe sot pas 17 vitesh.

Kodi i Procedurave Administrative renditet i dyti si ligj, si nga koha e hyrjes në fuqi ashtu edhe nga pesha, që normon këtë institut. Ky Kod është miratuar me ligjin nr. 8485 datë 12 Maj 1999 dhe ka hyrë në fuqi gjashtë muaj pas botimit në fletoren zyrtare (pra në fillim të vitit 2000).

Në këtë Kod parashikohet specifikisht parimi i përgjegjshmërisë së organeve të administratës publike dhe e punonjësve të tyre: *“Për dëmet që u shkaktojnë personave privatë nëpërmjet: a) marrjes së vendimeve të paligjshme; b) refuzimit të paligjshëm për të marrë vendime; c) dhënies së informacioneve shkresore të pasakta për personat privatë, si dhe për çdo shkak apo rast tjetër të parashikuar me ligj.”* Po ashtu, parimi i përgjegjshmërisë së administratës njihet edhe te paragrafi i dytë i nenit 9 “Parimi i ligjshmërisë” ku për aktet administrative të nxjerra në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi por që janë të vlefshme, palët e dëmtuara kanë të drejtë të kompensohen për humbjet eventuale në bazë të dispozitave ligjore, që rregullojnë përgjegjësinë e administratës publike.<sup>39</sup>

---

*Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për t'u ankuar në gjykatë kundër masave të kontrollit, të administrimit e të disponimit të pasurisë së tij, si dhe për të kërkuar shpërblimin e plotë të dëmeve të shkaktuara.”*

<sup>38</sup> [http://www.parlament.al/web/pub/legjislacioni\\_shqiptar\\_2001\\_2009\\_9834\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/legjislacioni_shqiptar_2001_2009_9834_1.pdf) (akses 03 Janar 2013).

<sup>39</sup> Shih nenin 9 “Parimi i ligjshmërisë- 1. Organet e Administratës Publike e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë aderon, ligjet e Republikës së Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca.

2. Aktet administrative të nxjerra në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi janë të vlefshme, në qoftë se rezultati i kërkuar në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme nuk mund të arrihet me mjete të tjera.



Ligj tjetër i rëndësishëm që parashikon dhe rregullon gjykimin e këtyre çështjeve është ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, hyrë në fuqi me 03 Nëntor 2013.

Ky ligj parashikon se gjykimi i mosmarrëveshjeve që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik janë në lëndë të Gjykatave Administrative. Ligji rregullon afatin se kur mund të ngrihet padia përpara kësaj gjykate, mënyrën e gjykimit, etj.<sup>40</sup>

Ndërsa në ligjin e ri nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”<sup>41</sup> i cili hyri në fuqi më 28 Maj 2016 përgjegjësini jashtëkontraktore e administratës publike, e shpreh në një nen parimor dhe duke ia lënë parashikimet e mëtejshme ligjit të posaçëm. Konkretisht neni 15 parashikon se “Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin përkatës.”

Përgjegjësia e organeve të administratës publike është parashikuar diku tangencialisht edhe me nene të veçanta në disa ligje që rregullojnë fusha të ndryshme si ajo e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit<sup>42</sup>, Policinë e Shtetit,<sup>43</sup> Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes<sup>44</sup> në fushën e mbrojtjes,<sup>45</sup> te ligji i barazisë

---

*Palët e dëmtuara nga aktet e lartpërmendura kanë të drejtë të kompensohen për humbjet eventuale në bazë të dispozitave ligjore, që rregullojnë përgjegjësinë e administratës publike.”*

<sup>40</sup> Neni 7§”b”, 17

<sup>41</sup> Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 87, datë 28 maj 2015 dhe hyn në fuqi një vit pas botimit në Fletoren Zyrtare (neni 189).

<sup>42</sup> Ligj nr.9723, datë 3.5.2007 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit” Neni 73” Përgjegjësia jashtëkontraktore “QKR-ja, në përputhje me ligjin për dëmin jashtëkontraktor të administratës publike, përgjigjet për dëmet e shkaktuara nga mosveprimi ose nga veprimi në kundërshtim me ligjin.”

Po aty, neni 59§2 - Autoriteti publik, që pengon nisjen e veprimtarisë së subjektit, sipas këtij neni, përgjigjet sipas ligjit për dëmin jashtë kontraktor të administratës publike

<sup>43</sup> Ligj nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit” Neni 105 Masat ndaj palëve të treta dhe e drejta e kompensimit “... 5. Lloji dhe masa e kompensimit përcaktohen duke mbajtur parasysh përgjegjësinë e palëve dhe përfitimin nga shërbimi i ofruar, në përputhje me legjislacionin për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore dhe Kodin Civil.

6. kur subjekti i cenuar nuk bie dakord me llojin dhe masën e kompensimit ka të drejtën e ankimit në gjykatë”.

<sup>44</sup> Ligj Nr. 65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes” tek neni 47-Dëmi i shkaktuar të tretëve” 1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar nga punonjësi i kësaj agjencie, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj ndaj personave fizikë e juridikë.

2. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, sipas rrethanave, kërkon nga punonjësi përgjegjës për dëmin e shkaktuar shpenzimet e zhdëmtimit.

3. Për përgjegjësinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përgjegjësinë vetjake të punonjësve të saj, rastet e shkaktimit të dëmit ndaj personave fizikë e juridikë, privatë, si dhe dëmshpërblimin e dëmeve të shkaktuara zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”.

<sup>45</sup> Ligji Nr. 65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes” Neni 47-Dëmi shkaktuar të tretëve- “1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar nga punonjësi i kësaj agjencie, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj ndaj personave fizikë e juridikë. 2. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, sipas rrethanave, kërkon nga punonjësi përgjegjës për dëmin e shkaktuar shpenzimet e zhdëmtimit. 3. Për përgjegjësinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përgjegjësinë vetjake të punonjësve të saj, rastet e shkaktimit të dëmit ndaj personave fizikë e juridikë, privatë, si dhe dëmshpërblimin e dëmeve të shkaktuara zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore.”

gjinore,<sup>46</sup> te ligji Urbanistikës, Kodi Rrugor, inspektimet ku në shumicën e rasteve ato njohin përgjegjësinë jashtëkontraktore të organit përkatës dhe mënyrën e trajtimit, sipas ligjit të posaçëm nr. 8510/1999.

Ka ligje të posaçëme si p.sh., ligji për të drejtën e informimit<sup>47</sup> të cilët i referohen konceptit të dëmit jashtëkontraktor të parashikuar nga Kodi Civil dhe jo ligjit nr. 8510/1999. Megjithatë ka edhe ligje si p.sh., ligji nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave" i shfuqizuar sot me ligjin nr.53/14 "Për sigurimin e depozitave" të cilët përjashtojnë zbatimin e ligjit nr. 8510/1999 te punonjësit e tyre kur u shkaktojnë dëm të tretëve. Në nenin 16/1§1,5 parashikohet se: "1. Agjencia, punonjësit e saj dhe anëtarët e këshillit drejtues nuk janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve, nga veprimet ose mosveprimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës funksionale dhe përmbushjes së përgjegjësi të tyre ligjore, të përcaktuara në këtë ligj.

...

5. Dispozitat e ligjit nr.8510, datë 15.7.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore" nuk zbatohen për të përcaktuar përgjegjësinë jashtëkontraktore të Agjencisë, si dhe të organeve apo punonjësve të saj."

Në fakt ky nen i cili përjashtonte Agjencinë e Sigurimit të Depozitave nga përgjegjësia administrative karshi të tretëve u vlerësua nga legjislatori si një shmangie e parimit kushtetues që çdo person ka të drejtë të dëmshpërblehet për dëmin e shkaktuar nga një organ shtetëror (neni 44). Kjo është arsye që me ligjin e ri në nenin 55 me titullin "Mbrotjtja ligjore gjatë ushtrimit të detyrës" parashikon se vetëm Agjencia ka përgjegjësi dhe jo punonjësit pra: "1. Agjencia mban përgjegjësi ligjore vetëm për dëmet e shkaktuara të tretëve, si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme dhe me faj.

2. Anëtarët e këshillit drejtues, personat që janë ose kanë qenë të punësuar, apo të kontraktuar që të veprojnë në emër dhe interes të Agjencisë, nuk mund të paditen nga palët e treta për veprimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës funksionale dhe përmbushjes së përgjegjësi të tyre ligjore, të përcaktuara në këtë ligj. Kjo mbrotjtje nuk zbatohet në rastet e procedimeve penale.

3. Në rastet kur Agjencia, me vendim të gjykatës, shpallet përgjegjëse për veprime ose mosveprime të kryera nga personat e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, Agjencia ka të drejtën të kërkojë nga këta të fundit rimbursimin e dëmshpërblimit dhe shpenzimeve të lidhura.

4. Agjencia mbulon shpenzimet e përfshirjes së personave të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni në procedimet e ngritura ndaj tyre.

5. Këshilli drejtues mund të prokurojë mbulim me sigurim për rreziqet e dëmshpërblimit ndaj të tretëve."

Neni 16/1 i Ligjit nr.8873/2002 "Për sigurimin e depozitave" u shtua në vitin 2009 si reflektim nga parashikimet që bëri ligji i ri për bankat. Konkretisht, ky nen (paragrafin e parë dhe të pestë e sipër cituam) është identik me nenin 132 të ligjit nr. 9962/2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Neni 132 "Mbrotjtja ligjore gjatë ushtrimit të detyrës" parashikon se: "1. Banka e Shqipërisë, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, administratorët dhe çdo punonjës i saj nuk

<sup>46</sup> Ligj nr.9970, datë 24.7.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri" në nenin 30 "3. Nëse shkelja është bërë nga nëpunësit e administratës publike, zbatohen dispozitat e ligjit nr.8510, datë 15.7.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore". "

<sup>47</sup> Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" në nenin 26 shpërblimi i dëmit parashikon: "çdo person, që ka pësuar një dëm, për shkak të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar, në përputhje me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë".

janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve nga veprimet ose mosveprimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës funksionale dhe përmbushjes së përgjegjësive të tyre ligjore, të përcaktuara me ligjin organik të Bankës së Shqipërisë dhe me këtë ligj.

2. Punonjësit e Bankës së Shqipërisë, përjashtimisht, mund të përgjigjen për dëmet që u shkaktajnë personave fizikë ose juridikë privatë, vetëm kur provohet se ata kanë vepruar me keqbesim.

3. Në rastet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, Banka e Shqipërisë, pasi dëmshpërblen palën e dëmtuar, ka të drejtë të kërkojë nga punonjësi fajtor kthimin e shpërblimit që ka paguar.

4. Në rastet kur punonjësi i paditur, në bazë të pikës 2 të këtij neni, deklarohet i pafajshëm me vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente, Banka e Shqipërisë është e detyruar t'i rimbursojë atij shumën e plotë të shpenzimeve që ai ka kryer për të realizuar përfaqësimin dhe mbrojtjen e tij ligjore.

5. Dispozitat e ligjit nr.8510, datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore" nuk zbatohen për të përcaktuar përgjegjësinë jashtëkontraktore të Bankës së Shqipërisë, si dhe të organeve apo punonjësve të saj."

Mendojmë se ashtu si ligji "Për sigurimin e depozitave bankare" i cili në parashikimet e reja në vitin 2014 njohu<sup>48</sup> përgjegjësinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave i cili është një ent publik, nën mbikqyrjen e Bankës së Shqipërisë, legjislatori duhet të reflektojë edhe mbi ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërië", mbi parimin e përgjegjshmërisë karshi të tretëve duke bërë ndryshime të pjesshme apo tërësore.

Nga ana tjetër, gjykatave në të tilla raste u duhet të interpretojnë mbi hierarkinë e normave zbatuese sipas nenit 116 të Kushtetutës<sup>49</sup>. Pra, neni 44 i cili parashikon përgjegjësinë e çdo organi shtetëror karshi veprimeve a mosveprimeve të paligjshme dhe po ashtu neni 16 të Kodit të Procedurave Administrative 2016 të cilët janë ligje që nga pikëpamja normative miratohen me një shumicë të cilësuar ndryshe nga ligji nr. 9962/2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" i cili është një ligj i miratuar me shumicë të thjeshtë.

Në vendimin nr. 16/2015 Gjykata Kushtetuese mbi hierarkinë e normave është shprehur se: "25. Një shtet i së drejtës orientohet drejt hierarkisë së normave juridike, prandaj hierarkia, statusi dhe efekti i normave ligjore janë të parashikuara në Kushtetutë. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër (shih vendimin nr. 2, datë 3.2.2010)."

Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar është një

<sup>48</sup> Ky ligj është përafuar me direktivën 94/19/KE e Parlamentit dhe e Këshillit "Mbi skemat e garantimit të depozitave", e ndryshuar me direktivën 2009/14/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të datës 11.3.2009. (CELEX: 32009L0014:OJ L 68, 13.3.2009, faqe 3 – 7). [http://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/10/ligj\\_nr\\_53\\_dt\\_22\\_5\\_2014\\_17839\\_11.pdf](http://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/10/ligj_nr_53_dt_22_5_2014_17839_11.pdf), akses 10 shkurt 2016.

<sup>49</sup> Neni 116 I Kushtetutës: "1.Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

a) Kushtetuta;

b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;

c) ligjet;

ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.

3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre."

ligj i miratuar me shumicë të cilësuar sipas nenit 81§2 i Kushtetutës si ligj që rregullon veprimtarinë dhe funksionimin e një organi kushtetutës siç është Banka e Shqipërisë.

Rezulton se në asnjë dispozitë të këtij ligji nuk parashikohet mosmbajtja e përgjegjësisë së Bankës së Shqipërisë, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, administratorët dhe çdo punonjës i saj për dëmet e shkaktuara të tretëve nga veprimet ose mosveprimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës. Ky përjashtim është i parashikuar në nenin 132 të ligjit nr. 9962/2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, ligji i miratuar me shumicë të thjeshtë.

Në këtë mënyrë edhe pse Banka e Shqipërisë është një person juridik publik, ent publik i kategorizuar nga KPRA i Ri, përsëri nuk mban përgjegjësi për dëmet jashtëkontraktore të shkaktuara të tretëve. Kjo e përcaktuar jo nga ligji i saj organik nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i miratuar me shumicë të cilësuar sipas nenit 81§2 i Kushtetutës<sup>50</sup>. Ky përjashtim, për mosmbajtje të përgjegjësisë e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, administratorëve dhe çdo punonjësi së Bankës së Shqipërisë, është i parashikuar në nenin 132 të ligjit nr. 9962/2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, ligji i miratuar me shumicë të thjeshtë.

Përjashtimi nga një parim kushtetues, për mospasje përgjegjësi bie në kundërshtim edhe me nenin 13 të KEDNJ ku parashikohet se secili duhet të ketë mjet ligjore për t’u kompensuar nga organet e shteteve anëtare. Nëse ligjvënësi ka dashur të shmangë përgjegjësinë e këtij organi shtetëror nga parimi i përgjegjshmërisë do ta kishte bërë me ndryshimet që i ndodhen vetë ligjit “Për Bankën në Republikën e Shqipërisë” në vitet 1998, 2002, 2014.

Fakti tregon se ligjvënësi nuk ka pasur qëllim të shmangë asnjë organ shtetëror nga përgjegjshmëria për veprimet që kryen. Në vendimin nr.7/2015 Gjykata Kushtetuese mban të njëjtin qëndrim pra: *“Nga pikëpamja e burimeve të së drejtës, ligjet organike ose të cilësuar qendrojnë më lart se ligjet e zakonshme. Nga kjo pikëpamje, ligjet e zakonshme nuk mund të trajtojnë çështje që janë parashikuar të trajtohen nga kodet apo ligjet organike. Nëse kushtetutbërësi do të kishte dëshiruar një trajtim të njëjtë të tyre, neni 81, pika 2, i Kushtetutës nuk do të ekzistonte (shih vendimet nr. 9, datë 23.03.2010 dhe nr. 1, datë 12.01.2011 të Gjykatës Kushtetuese).”*

Mund të themi se neni 132 i ligjit nr.9962/2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” bie në kundërshtim me nenin 44, nenin 15 të KPRA dhe nenin 13 të KEDNJ prandaj si i tillë ai mund të rishikohet edhe një herë nga legjislatori ose të goditet për antikushtetueshmëri në Gjykatën Kushtetuese sipas nenit 135 të Kushtetutës duke referuar edhe për këtë sektor publik të ligji nr. 8510/1999 ose në nenin 608 e vijues të Kodit Civil.

<sup>50</sup> Si ligj që rregullon veprimtarinë dhe funksionimin e një organi kushtetutës siç është Banka e Shqipërisë.

**KREU II****SUBJEKTET DHE OBJEKTI I PËRGJEGJËSISË JASHTË KONTRAKTORE TË ORGANEVE PUBLIKE SHQIPTARE.**

- 2.1 *Subjektet e përgjegjësive së administratës shtetërore*
  - 2.1.1 *Presidenti i Republikës së Shqipërisë*
  - 2.1.2 *Deputetët e Kuvendit të Shqipërisë*
  - 2.1.3 *Gjyqtarët në Republikën e Shqipërisë*
    - 2.1.3.1 *Gjyqtarët e Gjykatave të Shkallëve të Para dhe Gjykatave të Apelit*
    - 2.1.3.2 *Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë*
    - 2.1.3.3 *Imuniteti dhe përgjegjësia civile e gjyqtarëve në botë*
- 2.2 *Organet e administratës shtetërore dhe publike si subjekte të përgjegjësive jashtëkontraktore*
  - 2.2.1 *Nëpunësit e organeve të administratës publike*
  - 2.2.2 *I dëmtuari nga organet e administratës shtetërore dhe përgjegjësia ndaj tij*
  - 2.2.3 *Personat direkt të dëmtuar*
  - 2.2.4 *Personat indirekt të dëmtuar*
- 2.3. *Objekti i përgjegjësive jashtëkontraktore*

**2.1 Subjektet e përgjegjësive së administratës shtetërore**

Në nenin 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (1998) parashikohet se: “Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.” Në analizë të elementëve të saj mund të themi se koncepti i përgjegjësive që jep Kushtetuta për organet e saj nuk shtrihet vetëm tek organet e administratës shtetërore por edhe te çdo organ tjetër publik i cili me veprimet e tij mund të shkaktojë dëm tek të tretët.

Kur bëhet fjalë për rehabilitim apo zhdëmtimim, këto forma janë të njohura si mënyra të shpërblimit. Në Kushtetutë është parashikuar se të gjithë insitucionet publike mund të mbajnë përgjegjësi për dëmet e shkaktuara prej tyre, përveç atyre. që Kushtetuta i përjashton shprehimisht nga pasja e përgjegjësive gjatë ushtimit të detyrës (interpretim i së kundërtës).

**2.1.1 Presidenti i Republikës së Shqipërisë**

Presidenti në Republikën e Shqipërisë është organi më i lartë individual (monokratik) kushtetutes. Atij i vishen kompetenca që konfigurohet si organ administrativ, si organ i lartë i Forcave të Armatosura, organ vendimmarrës në pushtetin gjyqësor, në pushtetin legjislativ etj.

Që në betimin e tij përpara Kuvendit të Republikës, Presidenti merr përgjegjësi për zbatim të ligjeve, të drejtave dhe lirive të shtetasve, për zbatimin e ligjeve, Kushtetutës dhe të drejtave dhe lirive të shtetasve <sup>51</sup>.

<sup>51</sup> Neni 88 i Kushtetutës: “3. Presidenti fillon në detyrë pasi bën betimin para Kuvendit, por jo më parë se të ketë mbaruar mandati i Presidentit që largohet. Presidenti bën këtë betim: “Betoem se do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, do të respektoj të drejtat dhe liritë e shtetasve, do të mbroj pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe do t’i shërbej interesit të përgjithshëm dhe përparimit të Popullit Shqiptar.” Presidenti mund të shtojë edhe: “Zoti më ndihmoftë!”

Presidenti pas betimit të tij dhe marrjes së detyrës mban përgjegjësi penale për veprimet e kryera prej tij kur konsumon një vepër penale por nuk mban përgjegjësi civile për veprimet a mosveprimet e tij. Kjo parashikohet shprehimisht në nenin 90: “1. *Presidenti i Republikës nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij.*

2. *Presidenti i Republikës mund të shkarkohet për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë. Propozimi për shkarkimin e Presidentit në këto raste mund të bëhet nga jo më pak se një e katërta e anëtarëve të Kuvendit dhe duhet të mbështetet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij.*”

Kur flitet për papërgjegjshmëri të Presidentit për aktet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës së tij themi se presidenti nuk përgjigjet civilisht për dekretet që lëshon pasi mban përgjegjësi të tjera politike, penale apo administrative.

Sipas nenit 93 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës nxjerr dekrete si për ligjet<sup>52</sup>, për miratimin dhe shkarkimin e ministrave<sup>53</sup>, për miratimin apo shkarkimin e qeverisë në tërësi<sup>54</sup>, për vendosjen e gjendjes së luftës në shtet<sup>55</sup>. Sipas nenit 90 të Kushtetutës presidenti nuk mban përgjegjësi civile për dekretet apo veprimet e tij. Nxjerrja e dekretëve të sipërcituara nuk është e vetmja kompetencë e Presidentit. Në nenin 93 të Kushtetutës ku parashikohet se Presidenti:

- a) *i drejton mesazhe Kuvendit;*
- b) *ushtron të drejtën e faljes sipas ligjit;*
- c) *jep shtetësinë shqiptare dhe lejon lënien e saj sipas ligjit;*
- ç) *jep dekorata e tituj nderi sipas ligjit;*
- d) *jep gradat më të larta ushtarake sipas ligjit;*
- dh) *emëron dhe liron përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare;*
- e) *pranon letrat kredenciale dhe tërheqjen e përfaqësuesve diplomatikë të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë;*
- ë) *lidh marrëveshje ndërkombëtare sipas ligjit;*
- f) *me propozim të Kryeministrit, emëron drejtorin e shërbimit informativ të shtetit;*
- g) *emëron Kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe rektorët e universiteteve sipas ligjit;*
- gj) *cakton datën e zgjedhjeve për Kuvendin, për organet e pushtetit vendor dhe për zhvillimin e referendumeve;*
- h) *kërkon mendim dhe të dhëna me shkrim nga drejtuesit e institucioneve shtetërore për çështje që kanë të bëjnë me detyrat e tyre”.*

Në çështjen nr. 1360 datë 14.12.2001 të Gjykatës së Lartë të RSh, shtetasi Bullgar N. paditi Presidentin e Republikës së Shqipërisë për shfuqizimin e dekretit për revokim të dhënies së shtetësisë pasi ishte bazuar në dokumente të falsifikuar. Në padinë e tij paditësi nuk pretendonte dëm jashtëkontraktor nga ky revokim i Presidentit por vetëm shfuqizim të këtij akti administrativ individual.

## 2.1.2 Deputetët e Kuvendit të Shqipërisë

<sup>52</sup> Neni 85 i Kushtetutës.

<sup>53</sup> Neni 98 i Kushtetutës.

<sup>54</sup> Neni 105 i Kushtetutës.

<sup>55</sup> Neni 172 i Kushtetutës.

Referuar nenit Neni 73 të Kushtetutës<sup>56</sup> parashikohet se: “1. Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe për votat e dhëna prej tij. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes.

2. Deputeti nuk mund të ndiqet penalisht pa autorizimin e Kuvendit. Autorizimi kërkohet edhe në rastin kur ai do të arrestohet.

3. Deputeti mund të ndalohe ose të arrestohet pa autorizim kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Prokurori i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton menjëherë Kuvendin, i cili, kur konstaton se nuk ka vend për procedim, vendos për heqjen e masës.”<sup>57</sup>

Ky parashikim përputhet edhe me atë çfarë merr përsipër deputeti edhe gjatë betimit të tij para Kuvendit (kolegëve, publikut etj.) se “Do të kryej me ndërgjegje detyrën si deputet i popullit në Kuvend. Do të përfaqësoj denjësisht popullin, do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve.”<sup>58</sup> Nga ky parashikim vërehet se deputeti mban përgjegjësi penale për çdo veprim që kryen, qoftë edhe për shpifje që kryen, për mendimet që paraqet në interpelancat në Kuvend, por ai nuk mban përgjegjësi civile, disiplinore, apo ndonjë lloj përgjegjësie tjetër për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij. Ky status kushtetues është sqaruar në vendimin nr. 44/2011 të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi i Shqipërisë kundër Ilir Beqja nënkupton: “Nisur nga parimi i pavarësisë së mandatit parlamentar ose i mandatit të lirë, i cili është i garantuar nga neni 70/1 i Kushtetutës, deputeti gëzon një status kushtetues si pjesë e rëndësishme e parlamentit me të drejtat e veta. omissis ... Gjithashtu, edhe të drejta të tjera si: mbrojtja nga ndjekja penale (imuniteti penal), mospërgjegjësia për deklaratimet dhe votën e dhënë (indemniteti), e drejta për të përfituar një shpërblim për punën e tij si anëtar i parlamentit (bashkë me përfitime të tjera) janë pjesë e statusit të tij kushtetues, të cilat ai i gëzon nga momenti i anëtarësisë në parlament<sup>59</sup>. Vetëm duke i parë të plota të drejtat dhe detyrimet, si pjesë e tërë e mandatit parlamentar, mund të kuptohet siç duhet kompleksiteti i rolit të përfaqësimit, parashikuar nga neni 2/2 i Kushtetutës sonë”.

Po në këtë vendim, gjykata Kushtetuese është shprehur se “imuniteti” për përgjegjësi civile, deputetit i fillon në momentin që kandidati shpallet fitues nga KQZ-ja. Gjykata Kushtetuese mbi këtë moment arsyeton se: “Kuvendi i vazhdon punimet deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri (neni 65/3). Gjykata çmon se duke i interpretuar literalisht këto dispozita dhe në tërësi arrihet në përfundimin se: i) deputeti konsiderohet i tillë që në momentin e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve dhe vazhdon të jetë deputet deri në konstituimin e parlamentit pasardhës, pra në mbledhjen e parë të tij; ii) deputeti fillon ushtrimin e detyrës së tij në momentin e betimit, pas të cilit fillon dhe gëzimi i disa të drejtave dhe detyrave që lidhen me mandatin parlamentar; iii) Kuvendi i ri fillon mandatin në mbledhjen e parë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve dhe vazhdon deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri.”

Shtrohet pyetje nëse anëtarët e Këshillit të Ministrave<sup>60</sup>si Ministrat, Zëvendësministrat apo edhe Kryeministri mbajnë përgjegjësi civile, jashtëkontraktore për veprimet a

<sup>56</sup> I ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008, i shpallur me dekretin nr. 5700, datë 6.5.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 61/2008.

<sup>57</sup> I ndryshuar me ligjin nr. 76/2016” Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8417, Datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

<sup>58</sup> Neni 4 i Rregullores së Kuvendit.

<sup>59</sup> Shih për më tepër ligjin nr. 8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit”.

<sup>60</sup> Sipas nenit 95 të Kushtetutës “1. Këshilli i Ministrave përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat”.

2. Këshilli i Ministrave ushtron çdo funksion shtetëror, i cili nuk u është dhënë organeve të pushteteve të

mosveprimet e tyre si organe të pushtetit ekzekutiv apo gëzojnë imunitet referuar nenit 103§3 të Kushtetutës ku parashikohet se “Anëtarët e Këshillit të Ministrave gëzojnë imunitetin e deputetit”. Mendoj se anëtarët e Këshillave të Ministrave, qofshin apo jo deputetë, gëzojnë imunitetin e deputetit siç parashikohet nga neni 73 të Kushtetutës për mendimet në publik, për votën e tyre etj.

Këshilli i Ministrave referuar nenit 95§2 i Kushtetutës ushtron çdo funksion shtetëror, i cili nuk u është dhënë organeve të pushteteve të tjera shtetërore ose të qeverisjes vendore. Pra nga tre pushtetet që qeveriset shteti,<sup>61</sup> Këshilli i Ministrave ushtron pushtetin ekzekutiv pasi atë ligjvënës e ushtron Kuvendi, e parashikuar nga sipas neneve 81 deri 85 të Kushtetutës<sup>62</sup> dhe pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat e të tre niveleve të gjykimit sipas nenit 135<sup>63</sup> të Kushtetutës.

Sipas nenit 44 të Kushtetutës parashikohet se organet shtetërore mbajnë përgjegjësi kur parashikohet me ligj dhe detyrohen të zhdëmtojnë ose/dhe rehabilitojnë çdo person i cili dëmtohet nga aktet, veprimet, mosveprimet e paligjshme të tyre. Konkretisht, organet shtetërore administrative kanë përgjegjësi sipas ligjit për veprimtarinë e tyre, e parashikuar kjo në Ligjin nr. 8485 datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”<sup>64</sup> i ndryshuar, me Kodin e Ri të Procedurave Administrative të miratuar me ligjin nr. 44/2014, ashtu edhe me ligjin nr. 8510/1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”.

Si konkluzion themi se anëtarët e pushtetit ekzekutiv për sa kohë ushtrojnë detyrën e deputetit përpara Kuvendit apo në përmbushje të kësaj detyre nuk mbajnë përgjegjësi për mendimet, votat e dhëna kur passjellin dëme civile tek të tretët. Në rast se ky fakt përbën element të veprës penale apo edhe shpifje mbahet përgjegjësi penale, dhe i njejti rregull vlen edhe për anëtarët e Këshillit të Ministrave.

Përgjithësisht antarë të Këshillit të Ministrave që mund të gëzojnë edhe statusin e deputetit janë Ministrat dhe Kryeministri<sup>65</sup> ndërsa Zëvendësministrat janë më të ekspozuar karshi përgjegjësive civile, politike, penale. Ndërsa, antarët e Këshillit të Ministrave që nuk janë deputet në veprimtarinë e tyre administrative, ekzekutive-urdhërdhënëse mbajnë përgjegjësi sipas ligjeve përkatëse për çdo veprim, mosveprim apo akt administrative që passjellin dëm të tretëve.<sup>66</sup>

Dy ligjet kryesore që rregullojnë këtë përgjegjësi janë ato të cituara më sipër, por kjo nuk do të thotë që ligje të fushave të veçanta të mos parashikojnë përgjegjësinë

tjera shtetërore ose të qeverisjes vendore.

<sup>61</sup> Neni 7 i Kushtetutës “Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.”

<sup>62</sup> Kreu “Proçesi ligjvënës”

<sup>63</sup> Neni 135 “1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.”

<sup>64</sup> Neni 14- Parimi i përgjegjshmërisë “Organet e administratës publike dhe punonjësit e tyre mbajnë përgjegjësi për dëmet që iu shkaktojnë personave privatë nëpërmjet: 1. Marrjes së vendimeve të paligjshme; 2. Refuzimit të paligjshëm për të marrë vendime; 3. Dhënies së informacioneve shkresore të pasakta për personat privatë, si për çdo shkak apo rast tjetër të parashikuar me ligj”.

<sup>65</sup> Përveç kur nuk ka marrëveshje politike mes koalicioneve apo programin e partisë fituese. Kështu në koalicionin “Aleanca për Shqipërinë Europiane” fitues të vitit 2013, konkretisht programin e partisë së Partisë Socialiste “Rilindja” parashikohej se Ministrat që kanë rezultuar edhe fitues në zgjedhjet qendrore duhet të hiqnin dorë nga detyra e deputetit.

<sup>66</sup> Pavarësisht se në Kushtetutë, neni 44 parashikon se mbajnë përgjegjësi për veprime, mosveprime apo akte të paligjshme, në KPRA por edhe në ligjin nr.8510/1999 parashikohet se mbahet përgjegjësi edhe kur këto organe kanë vepruar në përputhje me ligjin por që rezulton se ka pasoja për interesat, të drejtat e personave që iu drejtohen. Neni 3: “...b) kur kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, por që sjellin dëmtimin e interesave të ligjshme të personave fizike a juridike private; c) kur, megjithëse kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, u shkaktojnë një dem të pabarabartë subjekteve të cilëve u drejtohet ky veprim a mosveprim;”



jashtëkontraktore të organeve të tij përkundrejt të tretëve si p.sh., te ligji që rregullon veprimtarinë e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Policinë e shtetit etj.<sup>67</sup>

Sipas Dr. Kristo Floqit përgjegjësia e ministratve për veprimtarinë e tyre është tre llojesh: përgjegjësi parlamentare, përgjegjësi penale dhe përgjegjësi civile. Këtë të fundit Dr. Floqi e shpjegon se ministri mban përgjegjësi bashkarisht ose veçmas nga nëpunësit e tij për dëmin që i shkakton qytetarëve. Padia mund të ngrihet ndaj qeverisë si person juridik i cili përfaqësohet nga Ministri i Financave, karshi disa ministrave (përgjegjësi e përbashkët) ose ndaj një ministri (përgjegjësi e posaçme).<sup>68</sup>

### 2.1.3 Gjyqtarët në Republikën e Shqipërisë

Nëse do i referohemi termit të përdorur nga Kushtetuta mbi organin shtetëror në një kuptim të ngushtë do të kuptoheshin organe të administratës shtetërore dhe në një kuptim më të gjerë do të kuptoheshin jo vetëm organe të administratës publike (neni 3)<sup>69</sup> por edhe të të gjitha organeve të tjera të pushtetit legjislativ dhe të pushtetit gjyqësor, organe të pushtetit vendor, organe të tjera kushtetuese të cilat së bashku përbëjnë organet me të cilin shteti ushtron qeverisjen (neni 7).<sup>70</sup>

Edhe Gjykata Kushtetuese italiane në vendimin nr. 2/1968 interpretoi se neni 28 i Kushtetutës<sup>71</sup> (analog me nenin 44 Kushtetutës së RSH pa dyshim që zbatohet edhe për gjyqtarët të cilët ushtrojnë veprimtari të zakonshme shtetërore: “*Autonomia dhe pavarësia e gjyqësorit dhe e gjyqtarëve nuk mund të jetë përtej asaj shtetërore, sikur legibus soluta (e privilegjuar ndaj zbatimit të ligjit, pa përgjegjësi) dhe përtej organizimit të shtetit*“.<sup>72</sup>

#### 2.1.3.1 Gjyqtarët e Gjykatave të Shkallëve të Para dhe Gjykatave të Apelit.

Organe shtetërore të pushtetit gjyqësor janë Gjykata e Lartë, Gjykatat e Apelit dhe Gjykatat e shkallëve të para (neni 135 i Kushtetutës). Gjithashtu edhe Gjykata Kushtetuese edhe pse nuk është pjesë e pushtetit gjyqësor është organ shtetëror kushtetues.

Pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal me 01.06.1995<sup>73</sup> e deri me hyrjen në fuqi të vendimit nr. 11 datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarët penalisht kishin përgjegjësi për dhënien e një vendimi përfundimtar haptazi të padrejtë (nenin 315).<sup>74</sup> Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese që gjeti këtë nen si antikushtetues ndër të tjera arsyetoi : “ ... mundësia e fillimit të ndjekjes penale ndaj një gjyqtari për dhënien e një vendimi përfundimtar, ndërkohë që vendimi mund të shqyrtohet nga një gjykatë më e lartë, krijon një presion të papërshtatshëm mbi këtë të fundit, çka mund të çënojë dhënien e drejtësisë.” Në atë vendim Gjykata Kushtetuese nuk shprehet për ndonjë përgjegjësi

<sup>67</sup> Shih kapitullin i “Historiku i përgjegjësive jashtëkontraktore në shtetin shqiptar, Nënkapitulli “Periudha post-komuniste, regjimi pluralist demokratik 1991-2016”.

<sup>68</sup> Kristo Floqi “Administrata ose e drejta sundimore”, Pjesa e përgjithshme, Shtypshkronja “Vlora”, Vlorë, (1923) faqe 149.

<sup>69</sup> Qendra e Publikimeve Zyrtare, “Kodi i Proedurave Administrative” Tiranë 2013 faqja 5 .

<sup>70</sup> Albjuris , “Kushtetuta e Shqipërisë me interpretime të Gjykatës Kushtetuese” Tiranë 2008 faqja 13 .

<sup>71</sup> “Funksionarët dhe vartësit e shtetit dhe të enteve publike janë drejtëpërdrejtë përgjegjës , sipas ligjeve penale, civile dhe administrative për veprime të kryera në shkelje të të drejtës . Në të tillë rastesh përgjegjësia civile shtrihet tek shteti dhe tek entet publike ”

<sup>72</sup> Rezarta Mataj “Përgjegjësia civile e gjyqtarit. vështrim, krahasues në shtetet e rajonit” Konferenca Shkencore, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, faqe 16.

<sup>73</sup> Qendra e Botimeve Zyrtare “Kodi penal i përditësuar.-Tiranë, 2013 faqja 107.

<sup>74</sup> Qendra e Publikimeve Zyrtare, “Kodi i Proedurave Administrative” Tiranë 2013 faqja 5 .

civile të gjyqtarirt veçse atë disiplinore nëse një vendim është i pabazuar në prova dhe ligj.

Me ndryshimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar hyrë në fuqi me datë 11 Gusht 2016, ndryshuan parashikimet mbi pushtetin gjyqësor, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve.

Këto ndryshime në Kushtetutë u pasuan me një sërë ndryshimesh të tjera ligjore për të realizuar të ashtëquajturën “Reforma në Drejtësi” konkretisht: 1) Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, 2) Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, 3) Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, 4) Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, 5) Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, 6) Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ose ligji i vettingut, 7) Ligji Nr. 99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i shfuqizuar me ligjin nr. 98/2016, rregullonte veprimtarinë e gjykatave të Shkallëve të Para dhe të Gjykatës së Apelit në Shqipëri ndërsa funksionimi i Gjykatës së Lartë rregullohej me një tjetër ligj të veçantë. Sipas këtij ligjin, gjyqtarët e dy shkallëve të para mund të mbajnë përgjegjësi :

- Penale për vepër penale të kryer gjatë ushtrimit të detyrës (neni 29);
- Disiplinore për shkelje të ligjit dhe për kryerjen e akteve që diskretitojnë pozicionin dhe figurën e gjyqtarit (neni 31);
- Civile përjashtimisht vetëm për raste të parashikuar në ligj (neni 30).<sup>75</sup>Pra

themi që në Shqipëri gjyqtarët kanë imunitet ndaj çdo padie civile që lidhet me ushtrimin e profesionit pasi nuk ka në fuqi asnjë ligj që parashikon rastet se kur gjyqtari mund të paditet civilisht. Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 12 datë 02 Mars 2011 ka vlerësuar gjykimi i një çështje administrative në Shkallë të Parë për 36 seanca (2007 deri 2011) pa u dhënë një vendim përfundimtar kësaj çështje, është tejzgjatur për shkaqe që i ngarkoheshin sjelljes së autoriteteve shtetërore në përgjithësi, dhe konkretisht trupit gjykues/gjyqtarës së çështjes, nëpunësit gjyqësor, dhe të paditurit/personave të tretë, organe këto të gjitha të pushtetit publik. Megjithatë vazhdon Gjykata: “... *po të pranohet që ligji nr. 8510/1999, përbën bazë të mjaftueshme ligjore për të kërkuar rivendosjen e së drejtës kushtetuese për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, si dhe pagimin e dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar nga vonesa në gjykim, do të arrihet rrjedhimisht në konkluzionin e pranimi, qoftë edhe parimisht, të përgjegjësisë civile të gjyqtarëve për vendimet që ata japin në kuadër të një gjykimi. Pranimi i kësaj përgjegjësie, qoftë edhe parimisht, do të binte në kundërshtim me parimin e pavarësisë së gjyqtarëve (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese, nr. 11, datë 02.04.2008).*”

Megjithatë gjatë kësaj kohe i vetmi rast kur gjyqtari indirekt mbante përgjegjësi civilisht është në nenin 467/a § 1 të Kodit të Proçedurës Civile pra “Kur vendimi prishet për shkak të moszbatimit të detyrave të caktuara nga Gjykata më e lartë, pa u marrë

<sup>75</sup> Neni 30 - “Gjyqtari nuk përgjigjet në një padi civile, e cila lidhet me kryerjen e detyrave të tij profesionale, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.”

vendim i veçantë sipas nenit 467<sup>76</sup> të këtij Kodi, Gjykata e Apelit, me kërkesë të palëve ngarkon trupin gjykuës përkatës me shpenzimet e bëra për këtë shkak”.

Sipas nenit 467 të KPRC kur çështja priset dhe i dërgohet për rigjykim përsëri gjykatës së shkallës së parë, kjo e fundit është e detyruar t’i përmbahet vendimit të gjykatës së apelit për çdo veprim procedural të vendosur në të si p.sh thirrja e personave të tretë, marrja e një mendimi eksperti, pyetja e dëshmitarëve, kqyrja në vend, etj.

Nëse Gjykata e shkallës së parë konstaton se këto detyra të lëna nga Gjykata e Apelit janë të panevojshme për t’u marrë, për shkak të rrethanave të reja të dala gjatë rigjyimit, vendos me vendim të ndërmjetëm të mos zbatojë detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit. Kjo vlen edhe për detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë apo Gjykata Kushtetuese. Për shëmbull në rast se në Gjykata e Apelit lë si detyrë për t’u marrë edhe një mendim eksperti kontabël për të matuar interesat në formën e kamatë vonesave për detyrimin e papaguar dhe në rigjykim pala heq dorë nga kjo pikë e objektit, gjykata me vendim të ndërmjetëm në referencë të nenit 171/1 b, 315 dhe 467<sup>77</sup> të K.Pr.C., revokon vendimin e ndërmjetëm për të marrë këto lloj prove me ekspert. Kundër këtij vendimi për moszbatim të detyrave të Gjykatës së Apelit mund të bëhet ankim i veçantë.

Jo paqëllim, legjislatori ka parashikuar se në rast se nuk zbatohen detyrat nga një gjykatë më e ulët ajo duhet ta arsyetojë dhe ta disponojë me vendim të ndërmjetëm. Kjo rrit përgjegjshmërinë e gjyqtarit por përcjell edhe detyrimin për të zbatuar orientimet e një gjykate më të lartë.

Në rast se gjyqtari nuk respekton këtë procedurë sipas nenit 467 të KPRC (me vendim të ndërmjetëm refuzon orientimin e gjykatë më të lartë) ajo mund të “ndëshkohet” për shpenzimet e bëra për tërë gjykimin më pas.

Rezulton në praktikë se kjo dispozitë që nga momenti i krijimit në 1995 asnjëherë nuk është zbatuar. Kjo për të mos krijuar edhe pakënaqësi mes trupës gjyqësore për shkak të detyrës por nisur edhe nga fakti se sipas Kushtetutës paga e gjyqtarit është e pandryshueshme dhe nuk mund të zvoglohet.<sup>78</sup> Duke paguar shpenzimet e një gjykimi sipas nenit 467 të KPRC, paga e gjyqtarit ulet dhe shkel këtë parashikim kushtetutes.

Po ashtu ky nen, nuk i njeh gjyqtarit të gjobitur mundësinë e ankimit të vendimit të Gjykatës së Apelit mbi gjobën. Kjo bie në kundërshtim me nenet 6, 13 të KEDNJ, ku çdo shtet duhet të ketë mjete efektive kombëtare për të dhënë mundësi çdo qytetarit të ankohet dhe të dëgjohet. Në referencë të gjobave që u vihet institucioneve që nuk kthejnë përgjiigje në kohë sipas nenit 224 dhe 167 të KPRC, palës së gjobitur sipas nenit 169 të K.Pr.C i jepet mundësia për ta ankimuar gjobën brenda 3 ditëve nga dita që merr dijani.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016 parashikohet për herë të parë qartazi përgjegjësia e shumëfishtë e funksionarëve të drejtësisë: penale, civile dhe disiplinore. Konkretisht në nenin 1 në objektin e këtij ligji parashikohet se: “1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i statusit të magistratëve, duke parashikuar rregulla në lidhje me: ...d) përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile të tyre;...”. Ndërsa në Pjesën V

<sup>76</sup> “Në rigjykim gjykata e shkallës së parë është e detyruar t’i përmbahet vendimit të gjykatës së apelit për çdo veprim procedural të vendosur në të. Me vendim të ndërmjetëm, gjykata mund të mos kryejë këto veprime të caktuara kur shihen të panevojshme” (neni 467 § 2, 3).

<sup>77</sup> Neni 467§ 2,3 i KPRC “Gjykata e shkallës së parë në rigjykim është e detyruar t’i përmbahet vendimit të gjykatës së apelit për çdo veprim procedural të vendosur në të. Me vendim të ndërmjetëm, gjykata mund të mos kryejë veprime të caktuara kur për rrethana të reja të dala në rigjykim, shihen të panevojshme. Ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë.”

<sup>78</sup> Neni 138 “Koha e qëndrimit të gjyqtarëve në detyrë nuk mund të kufizohet; paga dhe përfitimet e tjera të tyre nuk mund të ulen”.

“Përgjegjësia disiplinore, civile dhe penale“ parashikon në detaj të tre këto përgjegjësi. Në vendimin nr. 34 datë 10.04. 2017 të Gjykatës Kushtetuese u shfuqizuan për shkak se mënyra e formulimit të tyre nuk plotëson kërkesën kushtetuese për qartësi, qëndrueshmëri, besueshmëri dhe efektivitet të neneve 101<sup>79</sup>, 102<sup>80</sup> dhe 103<sup>81</sup> të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve” që përmbajnë rregulla mbi përgjegjësinë disiplinore, civile dhe penale të magjistratëve.

<sup>79</sup> Neni 101-Shkeljet disiplinore dhe çështje të veprimtarisë

“1. Magjistrati kryen shkelje disiplinore në këto raste: a) kur vepron me pakujdesi në ushtrimin e detyrave që rrjedhin nga funksioni, sipas parashikimeve të bëra në pikën 2 të këtij neni; b) kur haptazi nuk i referohet ligjit ose fakteve për shkak të pakujdesisë së rëndë, siç përcaktohet në treguesit e pikës 2, të këtij neni, ose dashjes, ose kur ka paafësi të dukshme profesionale; c) në çdo rast tjetër që, në mënyrë të pajustificuar, kryen akte dhe sjellje të papërshtatshme gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose që dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë.

2. Pakujdesia në ushtrimin e detyrës nga magjistrati konsiderohet shkelje disiplinore vetëm në rastet kur vërehen gabime, të cilat tejkalojnë ato që mund të ndodhin në rrethana normale nga një magjistrat mesatar. Kufijtë midis çështjeve që kanë lidhje me ushtrimin e funksionit dhe shkeljeve të disiplinës nga magjistrati caktohen duke marrë në konsideratë këta tregues: a) shkallën e pakujdesisë; b) shpeshhtësinë e kryerjes së gabimit; c) pozicionin e magjistratit në sistem; ç) nëse fusha e ligjit, në të cilën magjistrati ushtron funksionin, vlerësohet si shumë e ndërlikuar, e re ose nuk është zhvilluar sa duhet nga jurisprudenca gjyqësore ose e prokurorisë; d) mundësinë e ardhjes së dëmit dhe intensiteti i pasojave të mundshme nga shkelja; si dhe dh) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme me keqfunksionimin e sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë si një i tërë.

3. Në zbatim të këtij neni, shkeljet kryhen përmes veprimit dhe mosveprimit të magjistratit. Magjistrati që kryhen shkeljet disiplinore, në veçanti në rastet e parashikuara në nenet 102 deri në 104, të këtij ligji, ka përgjegjësi disiplinore sipas këtij ligji.”

<sup>80</sup> Neni 102 -Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit

“1. Sipas parashikimeve të shkronjës "a" ose "b", të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor janë në veçanti aktet dhe sjelljet e magjistratit si më poshtë:

a) mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme sipas ligjit procedural, nëse magjistrati është ose vihet në dijeni të rrethanave të tilla;

b) kërkesa e magjistratit për heqje dorë dhe miratimi i saj, sipas rastit, nga kryetari, nëse këto veprime:

i) nuk bazohen në shkaqet e parashikuara në ligj;

ii) bëhen në mënyrë të qëllimshme për të krijuar përfitime të padrejta për palët dhe të tretët ose kur synojnë të shmangin magjistratin nga detyrimi ligjor për shqyrtimin e çështjes ose synojnë të krijojnë mundësinë e shqyrtimit të saj nga magjistratë të tjerë;

iii) janë të vonuara në mënyrë të konside-rueshme;

c) sjelljet, aktet dhe veprimet e tjera të magjistratit, të cilat, krijojnë përfitime të padrejta ose dëme për palët pjesëmarrëse në gjykim/ hetim ose ndjekja e objektivave, të cilat nuk kanë lidhje me detyrimet e magjistratit;

....

5. Përveç parashikimeve në pikën 4, të këtij neni, zbatimi dhe interpretimi i këtij ligji nga magjistrati, ashtu si dhe vlerësimi i fakteve dhe provave në çështjet të hetuara nga ai nuk është objekt i procedimit disiplinor.”

<sup>81</sup> Neni 103-Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit

“Sipas parashikimeve të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë në veçanti aktet dhe sjelljet e magjistratit si vijon:

...

d) përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpër-drejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat, qoftë edhe me anë të veprimeve të ligjshme, i jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e përdorimit prej tij të pozicionit të magjistratit;

dh) shkelje të kryera të detyrimeve të ligjit, në veçanti në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktit të interesit, sipas ligjit

e) sjellja e papërshtatshme në përmbushjen e detyrimeve, në marrëdhëniet dhe në komuni-kimin me institucionet shtetërore dhe funksio-narët e tyre, dhe raste të tjera me sjellje të papër-shtatshme të pajustificuar.”

### 2.1.3.2 Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë

Kjo kategori gjyqtarësh nuk mbajnë asnjë lloj përgjegjësie (civile, penale, disiplinore) për mendimet ose votën e shprehur për çështje në shqyrtim por, ndiqet penalisht për vepra penale të kryer gjatë ushtrimit të detyrës sipas nenit 16 § 1 i ligjit nr. 8577 /2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

E njëjta situatë paraqitet edhe në ligje të tjera si: në ligjin nr. 8588/2008 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 9110 /2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimet e rënda” si dhe në ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Sipas fjalorit të Gjuhës Shqipe<sup>82</sup> imunitet në kuptimin ligjor është “*e drejta e një përfaqësuesi të huaj për të mos iu nënshtruar disa ligjeve shtetërore të një vëndi ; e drejta e një deputeti a e dikujt tjetër me detyrë të rëndësishme që të mos ndiqet penalisht ose që të mos arrestohet pa miratimin e organit kompetent; paprekshmëri , padhunueshmëri*”.

Në raportin e Shtatorit 2011 të Euraliusit mbi “Imunitetin e gjyqësorit në Shqipëri”<sup>83</sup> konkludohet se imuniteti në common law është më i gjerë sesa në të drejtën kontinentale. Ai ka kuptimin e një kufizimi ndaj një detyrimi ligjor, ndëshkim a ndjekje dhe ndahet në: 1) imunitet absolut pra papërgjegjshmëri e plotë ndaj asnjë ligji, pacënueshmëri dhe 2) imunitet relativ pra një papërgjegjshmëri e përkohëshme ose e kushtëzuar ndaj procedimeve penale. Ndërsa në të drejtën civil law, e zbatueshme në kontinentin europian, imunitet nënkupton papërgjegjshmëri, krijim i barrierave ligjore ndaj ndjekjes së një krimi.

Në panoramën e paraqitur më sipër përfundimisht konkludohet se në Shqipëri por edhe në Europë gjyqtari përveç përgjegjësisë disiplinore nuk mban përgjegjësi tjetër për rastet kur: merr një vendim gjyqësor me keqbesim, me një pakujdesi të hapur dhe të pafalshme, kur vendos mbi bazën e një ligji të shfuqizuar, kur për sjelljen e tij të qëllimshme zvarritet procesi gjyqësor, etj.

Edhe juristë të tjerë në Shqipëri<sup>84</sup> kanë paraqitur nevojën aktuale për përgjegjësi civile të gjyqtarit për vendimmarrjen e tij p.sh., në Raportin e Euraliusit sugjerohet se:

- Gjyqtarët duhet të mbrohen vetëm ndaj padive civile dhe kërkesave penale bazuar në opinionet e shprehura ose votat e dhëna gjatë ushtrimit të funksioneve.
- Nëse tregohet qëllimi ose keqdashja në një vendim gjyqësor gjyqtari mund të ndiqet penalisht dhe të jetë gjithashtu civilisht përgjegjës për rezultatin e këtyre veprimeve.<sup>85</sup>

Karta universale e gjyqtareve datë 17.11.1999 (vendi ynë nuk është anëtar) në nenin 10 parashikon se: “*Padia civile , në shtetet ku është e lejueshme dhe kalëlzimi penal duke*

<sup>82</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë , Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, “*Fjalor i gjuhës Shqipe*” Tiranë 2006, faqja 403 .

<sup>83</sup> Raportin Euraliusit mbi “Imunitetin e gjyqësorit në Shqipëri ”, shtatori 2011, faqe 4.

<sup>84</sup> Shih Dr. Dorian Droboniku “*Përgjegjësia civile e gjykatës*” Revista e Universitetit Marin Barleti “Zëra Studentorë ” nr 15 . vitit 2013 faqja 5 .

<sup>85</sup> Faqja 25, akses në internet dhjetor 2013

*përfshirë edhe arrestimin e një gjyqtari, duhet të jetë i lejuar vetëm në rrethana që nuk ndikon në pavarësinë e tij”<sup>86</sup>.*

Duke qenë se kjo lloj përgjegjësie është tepër e debatueshme pasi ka shtete si Italia të cilat e kanë parashikuar me ligj përgjegjësinë civile të gjyqtarëve (ligji Pinto), ka vende të tjera të cilat e njohin ligjërisht por praktika nuk ka sjellë asnjë rast ashtu siç ka shtete që nuk e parashikojnë fare këtë lloj përgjegjësie.

Edhe në Shqipëri me nenin 159 të ligjit nr. 96/2016 parashikohet përgjegjësia civile vetëm kur magjistrati<sup>87</sup> gjatë ushtrimit të funksionit ka manifestuar minimalisht pakujdesi të rëndë<sup>88</sup>. Kjo do të thotë që për pakujdesi të rëndë ose për dashje magjistrati mban civile kur kanë ardhur pasoja ekonomike ose jo tek të tretët.

Në lidhje me rastet kur magjistrati për të njëjtin fakt mund të kishte përgjegjësi disiplinore dhe penale, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 34/2017 duke konstatuar antikushtetuesenent 101 deri 103 të ligjit nr.96/2016, mbi masat disiplinore u shpreh se: *“Gjykata thekson se ashpërsia e masës disiplinore plotësuese me natyrë financiare në rastin konkret është e tillë sa ajo në thelb shndërrohet në dënim penal, që konsiston në pagimin në favor të shtetit të një shume të hollash e barabartë me pagën bruto të përfutur nga magjistrati i dënuar për veprën penale të korrupsionit gjatë vitit të fundit të ushtrimit të detyrës. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se parashikimi njëkohësisht si nga Kodi Penal, ashtu dhe neni 112, pika 1, e ligjit i dy dënimeve penale për të njëjtin fakt bie ndesh me parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër.”*

Po ashtu edhe në ligjin nr. 99/2016 i cili ka ndryshuar pothuaj tërësisht mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese parashikohen vetëm përgjegjësi penale dhe përgjegjësi disiplinore (Kreu II/1 me titull "Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese" neni 10 e vijues), për shkak të ushtrimit të detyrës dhe jo përgjegjësi civile.

### 2.1.3.3 Imuniteti dhe përgjegjësia civile e gjyqtarëve në botë

Le të hedhim një vështrim të shkurtër në SHBA, në disa shtete të Europës perëndimore por edhe në Ballkan.

Imuniteti gjyqësor në fakt është një koncept i mirëfilltë i të drejtës anglo-amerikane. Në disa vende të **Shteteve të Bashkuara të Amerikës** e kanë normuar këtë doktrinë me ligj ndërsa në disa shtete të tjera i kanë lënë në dorë gjyqësorit që rast pas rasti të shprehet për imunitetin gjyqësor. Në dy çështjet më thelbësore të jurisprudencës së

<sup>86</sup> Dokumenti i Këshillit Qëndror i Shoqatës Ndërkombëtare të Gjyqtarëve Taivan, 17.11.1999, marrë nga www. hjpc.ba, akses shkurt 2014.

<sup>87</sup> Nënkupto gjyqtarët dhe prokurorët në të tre shkallët e gjyqësorit nga shkalla e parë, Apelit dhe Gjykata e Lartë.

<sup>88</sup> Kuptimi i pakujdesisë paraqitej tek neni 101§2 I ligjit nr. 96/2016 (tashmë I shpallur si antikushtetuee nga ana e Gjykatës Kushtetuese) ku:” 2. *Pakujdesia në ushtrimin e detyrës nga magjistrati konsiderohet shkelje disiplinore vetëm në rastet kur vërehen gabime, të cilat tejkalojnë ato që mund të ndodhin në rrethana normale nga një magjistrat mesatar. Kufijtë midis çështjeve që kanë lidhje me ushtrimin e funksionit dhe shkeljeve të disiplinës nga magjistrati caktohen duke marrë në konsideratë këta tregues:*

a) shkallën e pakujdesisë;

b) shpeshësinë e kryerjes së gabimit;

c) pozicionin e magjistratit në sistem;

ç) nëse fusha e ligjit, në të cilën magjistrati ushtron funksionin, vlerësohet si shumë e ndërlikuar, e re ose nuk është zhvilluar sa duhet nga jurisprudenca gjyqësore ose e prokurorisë;

d) mundësinë e ardhjes së dëmit dhe inten-siteti i pasojave të mundshme nga shkelja; si dhe

dh) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme me keqfunksionimin e sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë si një i tërë.”

Gjykatës Supreme Federale të SHBA mbi imunitetin e gjyqtarit ndaj padive civile veçojmë çështjen *Bradly k. Fisher* dhe *Stump k. Sparkman*.

Në çështjen e parë *Bradly k. Fisher*, avokati Bradly ishte mbrojtësi i të pandehurit John H. Suratt, i akuzuar si bashkëpunor në vrasjen e presidentit Abraham Lincoln. Kur gjyqtari Fisher vendosi ndërprerje të seancës, Bradly me një mënyrë fyese akuzoi gjyqtarin për përdorim të komenteve fyese. Për shkak se juria në çështjen e Suratt-it nuk arriti të dilte me një vendim ajo u shpërnda (*hang jury*) dhe gjyqtari Fisher kërkoi që emri i avokatit Bradly të hiqej nga lista e mbrojtësve pranë Gjykatës Supreme të Distriktit të Kolombias. Bradly paditi Fisher për dëme të shkaktuar nga humbja e punës por juria vendosi në favor të gjyqtarit Fisher (1868).

Në Gjykatën Supreme të SHBA vendimi u la në fuqi duke u interpretuar fakti se gjyqtarët për veprime të tyre me keqdashje mund të shkarkohen por vetëm nëpërmjet një procedure impachment-i nga senati ose nëpërmjet largimit nga Gjykata. Megjithatë Gjykata Supreme e Sh.B.A parashikoi se imuniteti i gjyqtarit nuk mund të jetë absolut madje kur kryen veprime pakujdesie mbi punësimin apo shkarkimin e punonjësve të tij, për vendime deklarative në të tillë raste gjyqtari detyrohet të paguajë vetëm shpenzimet gjyqësore.

Ndërsa në çështjen e dytë *Stump k. Sparkman*, Ora McFarlin, nëna e një vajze 15 vjeç, me prapambetje mendore i drejtohet me kërkesë Gjykatës së Kontesë së DeKalb, Indiana për sterilizimin e saj, për shkak të mardhënieve të pakontrolluara që kishte me meshkuj më të rritur nga ku mund të vinin pasoja të pariparueshme. Gjyqtari Harold D. Sparkman në vitin 1971 miratoi kërkesën në dhomë këshillimi (pa thirrur dhe pa dëgjuar asnjë palë), pa u regjistruar si një çështje gjyqësore dhe pa qënë prezent dhe as nëpunësi gjyqësor. Pas dy vjetësh, e mitura Linda Stump martohet dhe në përpjekje për të pasur fëmijë, mëson rastësisht se ishte sterilizuar (lidhje tubash) dhe nuk mund të bëhej asnjë herë nënë.

Linda Stump paditi gjyqtarin Sparkman duke i kërkuar shpërblim për dëmin që i kishte shkaktuar me vendimin e tij të padrejtë, duke mos e dëgjuar në gjykim, duke mos e vënë në dijeni për ndërhyrjen gjinekologjike, etj. Gjykata Supreme në vitin 1978 vendosi që gjyqtari për çdo veprim që kryen gjatë detyrës edhe nëse është në kundërshtim me ligjin apo jashtë procedurës nuk mund të mbajë përgjegjësi civile. Ndërsa në mendimin e pakicës gjyqtarët Powell, Marshall, Stewart u shprehën se gjyqtari nuk mund të jetë imun se ndodhet në një sallë gjyqi, vesh togën dhe nënshkruan një vendim të padrejtë duke justifikuar se vepron brënda kompetencave gjyqësore, përkundrazi ata duhet të mbajnë përgjegjësi për të tilla vendime.

Tashmë jurisprudenca sugjeron që gjykatat në interpretimin e një procesi të drejtë gjyqësor të kufizojë imunitetin e gjyqtarëve me arsyetimin se askujt nuk mund t'i shkelen të drejtat kushtetuese pa u njoftuar, dëgjuar dhe pa iu dhënë mundësia e ankimit në një gjykatë më të lartë. Në këtë mënyrë çdo vendim gjyqësor, çdo veprim i gjyqtarit gjatë procesit gjyqësor mund të kontrollohet dhe të korigjohet nga një gjykatë më lartë

Në Europë, avangardë paraqitet **Italia** e cila që me 08 Nëntor 1987 mbajti referendumin popullor për shfuqizimin e neneve 55, 56 dhe 74 nga Kodi i Procedurës Civile të cilët parashikonin përgjegjësinë civile të gjyqtarëve. Në referendum u shtrua pyetja nëse duhet të përcaktoheshin rastet e përgjegjësisë dhe të shfuqizohen “filtrat autorizues” që kufizonin përgjegjësinë e gjyqtarëve. Pothuaj 80% e votuesve u shprehën pozitivisht.

<sup>89</sup> Robert Craig Waters “Imuniteti Gjyqësor kunder proces gjyqësor i së drejtës : Kur duhet të paditet një gjyqtar ? “ faqja 13 ,akses shkurt 2014, [www.object.cato.org](http://www.object.cato.org) .

Pas këtij referendumi hyri në fuqi ligji nr. 117 datë 13.04.1988 “Per shpërblimin e dëmeve të shkaktuar nga ushtrimi i funksioneve gjyqësore dhe përgjegjësia civile e gjyqtarit”. Subjektet e këtij ligji janë gjyqtarët e zakonshëm, gjyqtarë të fushës administrative, kontabël, ushtarake dhe të fushave të tjera. Ndërsa rastet kur mbahet përgjegjësi parashikohen në nenet 2<sup>90</sup> dhe 3<sup>91</sup> të ligjit ku padia mund të ngrihet ndaj shtetit dhe konkretisht palë e paditur paraqitet Kryetari i Këshillit të Ministrave. Gjyqtari vullnetarisht mund të ndërhyjë në procesin gjyqësor si palë. Po ashtu parashikohet se shteti me padi kthimi mund t’i kërkojë gjyqtarit gjithçka që ka dëmshpërblyer qytetarin për faj të tij.

Megjithatë masa e dëmshpërblimit që gjyqtari duhet të paguajë nuk mund të kalojë më tepër se 1/3 e të ardhurave vjetore të tij. Gjithashtu, shteti ngre padi regresi ndaj gjyqtarit brenda një viti nga pagesa e dëmshpërblimit.<sup>92</sup> Hetimi disiplinor mund të ecë paralelisht me padinë civile.

Ky ligj ndër vite ka pësuar ndryshime, shfuqizime nga Gjykata Kushtetuese dhe një sërë iniciativash për ndryshimin e ligjit ku kritikohet krijimi i një “imuniteti” i gjyqtarëve. Përmendim, iniciativat ligjore të senatorëve Alberti Casellati në 2002 Tomassini në 2003 që të ngrihet padia ndaj shtetit dhe gjyqtarit ose drejtpërdrejt gjyqtarit.

Gjithashtu një tjetër ligj i cili parashikon përgjegjësinë civile të gjyqtarit për shpejtësinë e gjykimit është edhe ligji nr. 89/2001 “Parashikimet për shpërblim të drejtë në rast të shkëljes së afateve të arsyeshme të procesit gjyqësor dhe ndryshim i nenit 375 të Kodit të Procedurës Civile”, (ndryshuar me ligjin 83/2012, me ligjin nr.64/2013 dhe me 25 Tetor 2015 nr. 21115, i ashtuquajtur ligji Pinto, për nder të propozuesit me titull).

Si kohë e arsyeshme gjykimi konsiderohen, deri në tre vjet për gjykimin në shkallë të parë, dy vjet për gjykimin në shkallë të dytë (apel) dhe një vit për gjykimin në Gjykatën e Kasacionit (të Lartë) pra në tërësi gjashtë vjet gjykim. Gjyqtari paguan një shpërblim

<sup>90</sup> Neni 2 -“Përgjegjësia për keqbesim apo dëm i padrejtë “ : “1. Çdo gjyqtar që ka shkaktuar një dëm të padrejtë si rezultat i një sjellje , një veprimi apo vendimi gjyqësor me keqbesim apo me faj të rëndë ose duke mohuar drejtësinë mund të pretendoj ndaj shtetit shpërblim të dëmeve pasurore ose jo pasurore që rrjedhin nga privimi i lirisë personale.

2. Në ushtrimin e funksionit gjyqësor nuk mund të përbëjë përgjegjësi rasti i interpertimit të normës së të drejtës apo të vlersimit të faktit dhe të provave .

3. Përbëjnë dëm të padrejtë :

a. shkelje e rëndë e ligjit me neglizhencë të pajustifikueshme;

b. pranim i një fakt sipas një pakujdesie të pajustificuar, ekzistenca e të cilit është e aprovuar nga provat e gjykimit;

c. mohimi i një fakti sipas një pakujdesie të pajustificuar, ekzistenca e të cilit është tërësisht e provuar nga provat e gjykimit;

d. marrja e një vendimi mbi të drejtat e njeriut përtej rasteve të parashikuar nga ligji ose pa arsytetim “

<sup>91</sup> Neni 3 – “Mohim i drejtësisë” parashikon se: “1. Përbën mohim të drejtësisë refuzimi, heqja ose vonesa e gjyqtarit në kryerjen e veprimeve pas afateve ligjore për realizimin e aktit, pala ka paraqitur kërkesë për vendim dhe janë kaluar pa asnjë arsye, tridhjetë ditë nga data e depozitimit të kërkesës në Kancelari. Nëse nuk është parashikuar afat duhet në çdo rast të këndë kaluar pa ndonjë arsye, tridhjetë ditë nga data e depozitimit të kërkesës për marrje të vendimi.

2. Afati tridhjetë ditë mund të shtyhet, para mbarimit të afatit nga gjyqtari me vendim të arsyetuar, për zgjatje të një afati tre muaj nga data e depozitimit të kërkesës .Kur arsyetim të vendimit të një çështje komplekse , gjyqtari me një tjetër vendim të arsyetuar para afatit të mbarimit, mund të zgjasë edhe tre muaj të tjerë afatin e arsytimit të vendimit kompleksiteti të çështjes .

3. Kur heqja apo vonesa pa ndonjë shkak çënojnë lirinë personale të kërkuarit, afati i paragrafit të parë, reduktohet në pesë ditë, pa të drejtë zgjatje nga data e depozitimit të kërkesës ose kur ka lindur shkaku ose kur bëhet i papërshtatshëm zgjatja e një masë kufizuese të lirisë personale ”.

<sup>92</sup> John Adenitire -“Judicial independence in Europe. The Swedish, talian, German Prespectives” faqe 15.



të drejtë prej 500 euro deri 1500 euro për çdo vit vonesë ose për çdo gjashtë muaj për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, që tejkalon kohën e arsyeshme të gjykimit.

Në **Gjermani**, gjyqtari mban përgjegjësi si çdo nëpunës tjetër shtetëror sipas nenit 839§2 i Kodit Civil kur: 1) veprimet e tij përbëjnë vepër penale dhe kanë sjellje pasojë për të tretët, 2) ose kur dëmi është shkaktuar nga pakujdesia në ushtrimin e detyrës dhe i tretë nuk ka mënyra të tjera për t'u kompensuar 3) ose edhe në rastet kur veprimet nuk përbëjnë vepër penale, por shkelja e detyrës konsiston në refuzimin për të vendosur ose vonesën në vendimmarrje te qytetari.

Kushti kryesor për të gjitha rastet është se i dëmtuari duhet të ketë apeluar edhe në gjykatë më të lartë dhe nuk ka përfituar shpërblim për të.

Si palë e paditur është shteti i cili për veprime të qëllimshme ose për pakujdesi të rëndë ngre padi regresi për gjyqtarin përgjegjës.<sup>93</sup>

Në **Francë** nuk parashikohet përgjegjësi individuale e gjyqtarëve, por shteti njih përgjegjësinë për veprimet e gjyqtarëve për vendimmarrjen e tyre pa ngritur padi regresi karshi dëmit të shpërblyer të tretit.

Kjo lloj përgjegjësie parashikohet jo vetëm në Kodin Civil<sup>94</sup> por edhe në nenin 781 të Kodit "Për Organizimin e Gjyqësorit" ku parashikohet se: "*Shteti është përgjegjës për dëmet e ardhura nga gabimet gjatë detyrës së organeve gjyqësore. Kjo përgjegjësi lidhet vetëm për pakujdesi të rëndë ose mohim me dashje të drejtësisë. Shteti mban përgjegjësi edhe për dëmet e shkaktuara të dëmtuarëve nga gabimet personale të gjyqtarëve, pa pasur të drejtën për të kërkuar kthimin e dëmshpërblimit nga gjyqtarët.*"

Në çështjen *Magiera kundër Francës*, kjo e fundit u ndëshkua nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut për shkelje të vazhdueshme të nenit 6 §1 dhe 13 të Konventës, për mos gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

Këshilli i Shtetit (i cili është organi më i lartë gjyqësor në Francë) vendosi se çfarë do lloj dëmi si pasuror, jo pasuror, fitim të munguar, mungesë e mundësive në të ardhmen, shteti do të shpërblejë qytetarët. Po ashtu në këtë mënyrë shteti mban përgjegjësi jo vetëm për veprimet e gjyqtarëve, por edhe të stafit administrativ të gjykatës.<sup>95</sup>

Në **Mbretërinë e Bashkuar** mbizotëron teoria absolute e imunitetit të gjyqtarit si dhe teoria e përgjegjësisë individuale të gjyqtarit për veprimet e tij gjatë gjykimit që shpjegohet me faktin se gjyqtari nuk mban përgjegjësi për veprime të kryera gjatë gjykimit, por përjashtimisht mban përgjegjësi për veprime të kryera jashtë kompetencave, të tij apo gabime që nuk i takojnë procesit gjyqësor. Nuk ka ndonjë ligj që parashikon rastet se kur gjyqtari vepron jashtë kompetencave por kjo vlerësohet nga gjykata rast pas rasti.<sup>96</sup>

Në **Ukrainë** ky institut rregullohet me ligjin nr. 266 datë 01.12.1994 "Mbi procedurën e shpërblimit për dëmet e shkaktuara individëve nga veprime të paligjshme të organeve hetimore, prokurorisë dhe gjyqësore" e cila më tepër shtrihet për dënimet, konfiskimet, arrestimet e padrejta etj., në fushën penale.

Ndërsa përgjegjësia civile e gjyqësorit normohet në nenin 1147 të Kodit të Civil ku shteti është përgjegjës për sjelljet e padrejta të nëpunësve të tij gjatë ushtrimit të pushtetit shtetëror, por vetëm kur ato përbëjnë vepër penale. Megjithatë nuk përjashtohet mundësia që qytetarët të padisin shtetin për t'u shpërblyer për dëmet që u kanë ardhur nga veprime të paligjshme. Siç shihet në Ukrainë nuk njihet përgjegjësia

<sup>93</sup> Po aty, faqe 23.

<sup>94</sup> E trajtuar në kapitullin II "Vështirim krahasues ndërkombëtar mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore të administratës publike", rubrika Franca.

<sup>95</sup> Oleksander Iegrashyn, Universiteti Europian Qëndror datë 31.03.2008 "Përgjegjësia e shtetit për gabimet gjyqësore. Analizë krahasuese në Mbretërinë e Bashkuar, Francë dhe Ukrainë" faqja 26.

<sup>96</sup> Po aty faqe 29.

civile e shtetit për veprime të padrejta të organeve gjyqësore qoftë edhe për tejzgjatje të procesit gjyqësor.<sup>97</sup>

Në **Rumani**, në nenin 52§3 të Kushtetutës parashikohet se shteti mban përgjegjësi për çfarëdo lloj dëmi pasuror të shkaktuar të tretëve, si pasojë e gabimeve gjyqësore<sup>98</sup>. Ndërsa në ligjin nr. 303/2004 “Mbi statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit” parashikohet se shteti përgjigjet për veprimet e paligjshme të gjyqtarëve të tretët vetëm për dëmet materiale dhe jo ato morale<sup>99</sup>, ku konsiderohen gabime gjyqësore në rastet kur: 1) Vendimi gjyqësor jo i formës së prerë është prishur nga Gjykata e Apelit dhe ndryshuar; 2) Një vendim i formës së prerë është prishur nga Gjykata e Apelit dhe ndryshuar; 3) Kur është marrë një vendim gjyqësor jo i formës së prerë, por i ekzekutueshëm që ka sjellë pasoja të tretët dhe prishet nga Gjykata e Apelit dhe vendoset ndryshe mbi masat provizore; 4) Konsiderohen si gabime të gjyqësorit të cilat janë me keqdashje apo me pakujdesi e rëndë: zbatim i një ligji të shfuqizuar, arsyetimi i kundërt me dispozitivin e vendimit, mungesa tërësisht e arsyetimit, mosmarrja parasysh e provave të debatuar në gjykim, ose arsyetimi i vendimit në prova që nuk janë marrë gjatë gjykimit, marrja e vendimit në opinionet e publikut, etj.

Në **Serbi** është në fuqi ligji “Mbi gjyqtarët” i cili gjatë draftimit ka marrë orientime edhe nga Komisioni i Venecias.<sup>100</sup> Në këtë ligj bëhet diferenca mes imunitetit<sup>101</sup> dhe përgjegjësisë<sup>102</sup>. Me imunitet konceptohet mospërgjegjësia personale e gjyqtarit për mendimin, votën e tij gjatë gjykimit përveç kur përbën vepër penale. Ndërsa për sa i përket përgjegjësisë së gjyqtarit, shteti përgjigjet për çdo dëm të kryer përmes një pune të paligjshme apo të gabuar por ka të drejtë t’i kërkojë gjyqtarit me padi kthimin e shumës.<sup>103</sup> Ky parashikim vlen edhe për prokurorin.<sup>104</sup>

Në **Suedi** gjyqtari nuk ka imunitet ndaj padive civile, masave disiplinore apo ndjekies penale. Sipas ligjit për “Dëmin jashtëkontraktor” (1972), gjyqtari si çdo shtetas tjetër mban përgjegjësi për dëmet dhe shpërblen të dëmtuarit nga veprimet e pakujdesshme. Raste të tillë janë harresa e një parashikimi ligjor, një mangësi në shifër a në fjalë, mosprishja e një vendimi haptazi neglizhent nga Gjykata e Apelit, etj. Megjithatë rastet kur një gjyqtar mban përgjegjësi penale, disiplinore a civile në Suedi janë jashtëzakonisht të rralla gjë që tregon për një përgjegjësi të lartë të gjyqtarëve në kryerjen e detyrës në këtë shtet.<sup>105</sup>

<sup>97</sup> Oleksander Iegrashyn, Universiteti Europian Qëndror 31.03.2008 “Përgjegjësia e shtetit për gabimet gjyqësore. Analizë krahasuese në Mbretërinë e Bashkuar, Francë dhe Ukrainë” faqja 30-31.

<sup>98</sup> Ndërsa përpara ndryshimeve të këtij nenit 48 § 3 i Kushtetutës parashikonte përgjegjësinë e gjyqtarëve për dëmet pasurore të shkaktuara vetëm kur veprimet e tyre përbënin vepër penale.

<sup>99</sup> Radu Iosof “Discussion on state liability for judicial errors in other trials than the criminal cases” publikuar 2009, [www.uab.ro](http://www.uab.ro), akses shkurt 2014.

16. Rekomandime CM/Rec (2010)12 të datës 25.12.2012 Komisionit të Venecias mbi “Ligjin e gjyqtarëve në Serbi” dhe Opinioni CDL (2013) 010 akses Dhjetor 2013, [www.venice.coe.int](http://www.venice.coe.int).

<sup>101</sup> Neni 5 i ligjit

<sup>102</sup> Neni 6 i ligjit.

<sup>103</sup> Neni 6 § 2 (i ndryshuar sipas propozimeve të Komisionit) parashikohet se: “Nëse Republika e Serbisë (me vendim përfundimtar) paguan dëmin sipas paragrafit të parë, mund t’i kërkojë gjyqtarit kthimin e shumës së paguar kur dëmi është shkaktuar me qëllim ose me neglizhencë të rëndë”.

<sup>104</sup> Neni 6 § 3 parashikohet se: “Prokurori mund t’i kërkojë Këshillit të Drejtësisë mendim nëse ekzistojnë kushtet për të nisur një procedurë për shpërblimin nga gjyqtari të pagesës sipas paragrafit të parë dhe të dytë. Këshilli i Drejtësisë duhet të jap mendimin brenda 30 ditëve.”

<sup>105</sup> John Adenitire -“Judicial independence in Europe. The Swedish, Italian, German Perspectives” Faqe 7.

## 2.2. Organet administrative shtetërore/publike si organe që i nënshtrohen përgjegjësive jashtëkontraktore

Shteti dhe organet e tij mbajnë përgjegjësi civile, jashtëkontraktore për dëmet që u shkaktojnë të tretëve.

Në fakt edhe ligji nr. 8510/1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” rregullon ekskluzivisht përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore dhe kjo shkon në harmoni edhe me nenin 15 të KPRA i Ri.

*Lind pyetja, a ka vërtetë dallim midis organeve të administratës publike dhe atyre të administratës shtetërore?*

Në fakt edhe në Kushtetutë<sup>106</sup>, në Kodin e Procedurave Administrative të vitit 1999<sup>107</sup> dhe në ligjin e posaçëm që rregullon këtë lloj përgjegjësie atë me nr.8510/1999,<sup>108</sup> vihet re se nuk është i konsoliduar termi administratë publike apo administratë shtetërore apo organ publik dhe organ shtetëror, dhe të dy konceptet gabimisht apo qëllimisht i gjejmë në tekstet e ligjeve të sipërcituar.<sup>109</sup> Madje termat organ publik, autoritet publik, nëpunës publik a ent publik nuk ekzistonin në të drejtën administrative para vitit 1990.<sup>110</sup>

Më e qartë është situata me hyrjen në fuqi të KPRA i Ri, 2016 ku njihet termi i unifikuar organ publik ku sipas nenit 3§6 kuptohet: “çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ i enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative, çdo organ i pushtetit vendor që kryen funksione administrative, çdo organ i Forcave të Armatosura për aq kohë sa kryejnë funksione administrative si dhe çdo person fizik ose juridik të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi e drejta e ushtirimit të funksioneve të administratës publike.”

Studiuesit e të drejtës administrative e kanë të qartë se koncepti i parë: administratë publike është më i gjërë dhe e përfshin edhe administratën shtetërore. Pra një organ administrativ shtetëror përbën një organ administrativ publik por e kundërta jo domosdoshmërisht qëndron. Qëllimi i legjislatorit është të mos bëj ndarje.

Autori, Prof. Dr. Ermir Dobjani shprehet se kuptimi i organit publik apo i organit të administratës publike është i lidhur ngushtë me atë të organit të administratës shtetërore.<sup>111</sup> Megjithatë termi organ publik sugjerohet të përdoret më tepër pasi është më gjithëpërfshirës.

Qëllimi primar i ndarjes së administratës shtetërore nga menaxhimet private që bënin shoqëritë tregtare ishte se e para kishte më tepër karakter publik. Ndërsa sot konceptet janë përzier pasi edhe shteti shfaqet në shumë raste si subjekt privat dhe me interesa të

<sup>106</sup> Neni 23, neni 44 i Kushtetutës referon organ shtetëror ndërsa neni 48, 147 për organ publik.

<sup>107</sup> Neni 147§2 referon për organ shtetëror tek aktet reale, neni 151 organ i administratës shtetërore ndërsa i referohet organeve të administratës publike në nenin 1,2,3, 6,7,9,10,13,14,21,105 ndërsa si administratë publike i referohet në nenet 5,9, 10,11,14,16,17,37,132,149.

<sup>108</sup> Teknika legjislativë dhe qëllimi i legjislatorit paraqitet më i qartë tek ky ligj ku gjatë gjithë kohës shtjellon detyrimet dhe përgjegjësitë vetëm për Organet e administratës shtetërore nga neni 1 deri 4,8,9,11,13 deri 20 flet për organe të administratës shtetërore, nenet 6,7 flet për administratë shtetërore.

<sup>109</sup> Kushtetuta referon për administratë publike në nenet: 60§1 “Avokati i Popullit”, neni 63§3,107 (nëpunësit e administratës publike). Neni 69§ “e”,112 referon për funksionar të lartë të administratës shtetërore,

<sup>110</sup> Prof. Dr. Ermir Dobjani “E drejta administrative, pjesa e përgjithshme”, Shtëpia Botuese “Emal” Tiranë, 2016, faqe 23.

<sup>111</sup> Po aty faqe 177.

lidhura ngushtësisht me përfitimet e tij ekonomike njësoj si një subjekt privat si p.sh., tek kontratat civile që ai lidh. Por nga ana tjetër ka edhe mjaft shoqëri tregtare që në aktivitetin e tyre të kenë qëllime në shërbim të publikut.

Prof. Asoc. Dr. Sokol Sadushi bën ndarjen se: *“Nocioni administratë publike është më i gjerë se sa nocioni administratë shtetërore, sepse ai përfshin në vete përveç veprimtarisë së administratës shtetërore edhe veprimtarinë e institucioneve përkatëse të cilat nuk kanë karakter shprehimor të organeve shtetërore, por ushtrojnë punë të karakterit publik”*.<sup>112</sup>

Prof. Esat Stavileci në “Fjalor shpjegues të termave administrative”, e konsideron imediate unifikimin e termave administrativë në gjuhën shqipe që shpesh i sjell të ngatërruara për shkak të mosnjohjes së drejtë të kuptimit, ndikimit të gjuhëve të huaja etj.<sup>113</sup> Kështu sipas Prof. Stavileci administratë publike është tërësia e punës së administratës publike dhe institucioneve të administratës publike bazë e së cilës është interesi i përgjithshëm. Ai ka një shtrirje jo vetëm tek organet e administratës shtetërore por edhe në organe dhe organizata të tjera që ushtrojnë punë administrative.<sup>114</sup>

Në këtë fjalor gjejmë edhe dallimin mes organeve të administratës shtetërore dhe organeve të administratës publike ku i pari shpjegohet si *“organ i veshur me tagra të pushtetit shtetëror, të cilat shprehen në të drejtat dhe detyrat e tij që të nxjerrë aktet administrative më të cilat manifestohet vullneti i pushtetit shtetëror dhe që mbron dhe zbaton ligjet nga çdo shkelje dhe me përdorimin e fuqisë shtërnguese”*<sup>115</sup>. Ndërsa organe të administratës publike shpjegohet si: *“organe të administratës publike qëndrore dhe publike lokale dhe organet e tjera në vartësi të tyre”*.<sup>116</sup>

Ndërsa një ndarje më të qartë të administratës shtetërore dhe organeve ë saj e përcakton ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” ku në nenin 2 të saj përcaktohet se: *“1. Administrata shtetërore është aparati organizativ dhe profesional, që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore”*.

Sipas nenit 4 §2 i po këtij ligji administrata shtetërore përbëhet nga këto institucione:

- Organe qëndrore si, Kryeministria, Ministrat të cilat njihen dhe si organe më të larta të administratës shtetërore;
- institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave ku këtu përfshihen: a) sekretari i përgjithshëm; b) drejtoritë e përgjithshme; c) drejtoritë; ç) sektorët, etj.
- njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, si lokale apo qëndrore nën varësinë e Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara e krijuar me ligjin Nr.13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë.”
- agjencitë autonome si ajo që pritet të krijohet Agjencia e Auditimit të Fondeve të Bashkimit Evropian në Shqipëri<sup>117</sup>, Fondi Shqiptar i Zhvillimit etj.

<sup>112</sup> Prof.Asoc.Dr Sokol Sadushi, cikël leksionesh mbi “Parime të përgjithshme të Administratës publike”, Shkolla e Lartë Jopublike “Luarasi, Tiranë 2013, faqe 15.

<sup>113</sup> Stavileci E. “Fjalor Shpjegues i termave administrative” Akademia e Shkencave de e Arteve e Kosovës, Prishtinë (2010), faqe 13.

<sup>114</sup> Po aty, faqe 23.

<sup>115</sup> Po aty faqe 133.

<sup>116</sup> Faqe 136.

<sup>117</sup> Shih projektligjin korrik 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së auditimit të programeve të asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian në Republikën e Shqipërisë ” në faqen elektronike zyrtare të Parlamentit të RSh, <https://www.parlament.al/ep-content/uploads/2016/07/ORGANIZIMI-I-AGJENCISE-SE-AUDITIMIT-PER-ASISTENCEN-NGA-BE.pdf>, akses shtator

- administrata e prefektit.

Në Kodin e Ri të Procedurave Administrative e miratuar me ligjin nr. 44/2015<sup>118</sup> i referohet jo organeve të administratës publike por parashikon konceptin e përgjithshëm të organit publik. Ky nen paraqitet analog me nenin 3 të KPRA (2015) cili jepet në mënyrë të detajuar se çfarë përmbajnë organet e administratës publike: “Në kuptimin e këtij Kodi, organe të administratës publike janë:

- a) organet e pushtetit qendror të cilat kryejnë funksione administrative;
- b) organet e enteve publike në masën që ato kryejnë funksione administrative;
- c) organet e pushtetit vendor që kryejnë funksione administrative;
- d) organet e Forcave të Armatosura, si dhe çdo strukturë tjetër, punonjësit e të cilës gëzojnë statusin e ushtarakut, për aq kohë sa këto kryejnë funksione administrative.”

Pra te KPRA i ri vihet re se ka zgjeruar konceptin e organit publik në ndryshim nga ai i organit të administratës publike, duke përfshirë edhe çdo person fizik a juridik që me ligj a me akte të tjera nënligjore ushtron funksione të administratës publike p.sh., një institucion arsimor privat i cili është i krijuar me ligj, kryen funksione me karakter publik dhe funksione të përgjithshme ku jepet e drejta për të ushtruar funksione të administratës publike si në organizim, kompetenca, etj.

Në këtë mënyrë kur flasim për organe publike do të kuptojmë: 1) organe të administratës publike plus, 2) çdo person juridik të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi e drejta e ushtrimit të funksioneve të administratës publike por, edhe 3) çdo person fizik që vepron si punonjës i policisë së shtetit, inspektor të drejtorisë rajonale të tatimeve, nëpunës i gjendjes civile apo çdo punonjës tjetër i punësuar në organe publike të pushtetit vendor a qendror.<sup>119</sup>

Pra termi organ publik është termi që do të unifikojë në vitet në vijim termin organ publik apo organ shtetëror. Megjithatë duhet të kemi të qartë se edhe në ato raste ku në ligj vazhdon të citohet termi “administratë shtetërore”, “organ i administratës shtetërore” apo “organ i administratës publike” duhet të kuptohet organ publik.

Sipas Prof. Dr. Ermir Dobjani, dy janë karakteristikat që një organ publik të jetë i përcaktuar si i tillë: parashikim në dispozitat ligjore dhe të kryejë funksione (veprimtari) administrative publike. Ndër të cilat përmenden si organe qendrore Presidenti i Republikës, Komisioneri për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtien e të dhënave Personale, Inspektori i Lartë i ILKDPKI-së, Drejtori i Përgjithshëm i Arkivës së Shtetit etj., në nivel vendor Kryetar Bashkie, Kryetar i Këshillit të Qarkut, organe të forcave të armatosura si Komandanti i Forcave Detare, Tokësore etj., organe të enteve publike që kryejnë funksione administrative si rektoratet, dekanatet etj., personat juridikë privat si Dhoma Kombëtare e Noterisë, Avokatisë etj.. si person fizik privat që ushtron funksione administrative njihen përmbauesit gjyqësor privat.<sup>120</sup>

Ligjet më të reja në fushën administrative si ligji nr. 49/2012 “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative” i ndryshuar dhe ligji nr. 44/2015 “Për Kodin e Procedurave Administrative” kanë evoluar dhe tashmë përdorin këtë nocion përmbledhës, organ

2016.

<sup>118</sup> Hyn në fuqi një vit mbas botimit në fletoren zyrtare. Botuar në fletoren zyrtare nr. 87 datë 28 maj 2015 fillon efektet si ligj më 29 maj 2016.

<sup>119</sup> Prof. Dr. Ermir Dobjani “E drejta administrative, pjesa e përgjithshme”, Shtëpia Botuese “Emal” Tiranë, 2016, faqe 177.

<sup>120</sup> Po aty faqe 180 deri 181.

publik. Kështu që edhe në termat që do të ndeshen në ligje më të herëshme të fushës administrative terma si administratë shtetërore duhen nënkuptuar si organ publik. Sipas autorit Prof. Dr. Ermir Dobjani: “... në administratën shtetërore të Republikës së Shqipërisë, në kuptim të gjerë, bëjnë pjesë veç institucioneve që përmenden në pikën 2, të nenit 4 të këtij ligji, edhe organe të tjera të tilla, siç janë psh. Aparati organizativ dhe profesional i pushtetit vendor, ai i institucioneve të pavarura kushtetutes apo të atyre të krijura me ligj të posaçëm, etj. E themi këtë sepse të gjitha organet e sipërpërmendura bëjnë pjesë në administratën shtetërore (publike), sepse ndonëse janë jashtë përgjegjësisë dhe varësisë së Këshillit të Ministrave ato kanë aparatet e tyre organizativ dhe profesional, zbatojnë legjislativon në fuqi dhe i shërbejnë interesit publik me paanësi, duke kryer shërbime publike dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore në fushat përkatëse ku veprojnë.”<sup>121</sup>

Në vendimin nr. 473 datë 26 Shkurt 2015 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka konsideruar çështjen mes paditësve A.K, A.K, V.K etj., ndaj Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” me objekt: “Detyrimin e palës së paditur për të dëmshpërblyer paditësin për dëmin pasuror dhe jopasuror nga dëmtimi i shëndetit ardhur gjatë lindjes së foshnjës, A.K, me datë 26.01.2012.” Pala e paditur në këtë gjykim është thirrur referuar V.K.M Nr.70, datë 15.02.2001 “Për statusin e spitaleve universitare” ku parashikohet se është ent publik në formën e qendrës kombëtare të injektimit, të arsimit dhe të kërkimit, që kryen gjithashtu shërbimin spitalor sekondar.

Kolegji ka vlerësuar se entet publike ushtrojnë veprimtari administrative në përputhje me nenin 3 të KPRA të 1999, për këtë arsye paditë mbi mosveprimin e organit publik dhe shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor janë në kompetencë lëndore të Gjykatës Administrative, referuar nenit 7/b<sup>122</sup> të ligjit 49/2012 dhe ligjit nr. 8510/1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”.

Duhet treguar kujdes në ato organe shtetërore të cilët ushtrojnë së pari një veprimtari që i takon një pushteti tjetër si ai gjyqësor apo legjislativ, por nga ana tjetër organi drejtues kryen edhe detyra të tjera administrative për efekt të organizimit dhe funksionimit të institucionit. E tillë është rasti i prokurorisë e cila sipas Kushtetutës, në nenin 148 ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, por nga ana tjetër bazuar në ligjin Nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, prokurorët kryejnë edhe funksione të tjera.

Kështu, sipas nenit në nenin 27/1 shkronja “g” të ligjit të sipërcituar parashkohet se: “kryejnë detyra të tjera, në funksion të drejtimit administrativ të prokurorisë, të parashikuara në aktet ligjore ose nënligjore në fuqi”. Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë<sup>123</sup> ka rrëzuar padinë e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat ndaj XH.S., për kthimin e shumës prej 930 457 lekë si dëm që vjen nga auditimi i fletëve të udhëtimeve dhe normativave të harxhimit të karburantit me automjetin e punës si Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat.

Gjykata e Apelit Administrativ duke renditur arsyet se përse duhet rrëzuar padia si e pabazuar në prova argumenton edhe sa i takon kornizës ligjore që zbatohet në këto raste mes organit shtetëror dhe drejtuesit të saj kur shkakton dëm: “Ajo është një marrëdhënie

<sup>121</sup> Po aty faqe 27 dhe 29.

<sup>122</sup> Neni 7/b “...mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik...”

<sup>123</sup> Shih vendimin nr. 1676 datë 12 maj 2014 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë që ka lënë në fuqi vendimin nr.106, datë 07.02.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

juridike që ka një rregullim të posaçëm juridik, për shkak të karakteristikave që përfaqëson në ushtrimin e detyrës prokurori, qoftë për shkak të përfaqësimit të akuzës në gjyq në emër të shtetit dhe ushtrimit të ndjekjes penale, qoftë në drejtimin administrativ të prokurorisë si organ shtetëror. Në këtë marrëdhënie juridike nuk mund të gjejë zbatim parimi i subsidiaritetit i sanksionuar në nenin 4 të Kodit të Punës, pasi për rastin në gjykim ka një parashikim të shprehur ligjor.<sup>124</sup> Nëse pala paditëse konstaton shkelje të Drejtuesit të Prokurorisë në drejtimin administrativ përse i takon zbatimit të ligjit nr. 10160 datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë”, mund të aplikojë sanksionin e parashikuar në nenin 7 të këtij ligji: përdorimi i automjeteve për shërbime jashtë detyrave funksionale përbën kundërvajtje administrative dhe shkelje të etikës profesionale dhe dënohet sipas akteve ligjore në fuqi.”

Një tjetër moment për t’u ndalur është edhe zbatimi i parimit të solidaritetit mes organeve administrative, ku secili prej tyre përgjigjet karshi të dëmtuarit për të gjithë dëmin. Sipas nenit 14 të ligjit nr. 8510/1999 këto organe kanë përgjegjësi solidare karshi kreditorit dhe më pas organi që paguan tërësisht shpërblimin e dëmit mund të ngre padi karshi organit tjetër për të kërkuar masën e shpërblimit të dëmit që ka ardhur edhe për fajin e tij.<sup>125</sup>

Ndërsa kur dëmi është i prejardhur nga veprimet a mosveprimet e kundërligjshme të një organi tjetër, organi administrativ ka të drejtë të kërkojë me padi regresi atë çfarë ka paguar karshi të dëmtuarit. Zakonisht ndodh tek ato organe, puna e të cilëve është e varur nga puna apo veprimtaria e një organi tjetër. Meqënëse organi final ka edhe kontaktin me qytetarin, normalisht përgjegjësinë primare e mban ky dhe mund të shkarkojë këtë përgjegjësi nëse provon lidhjen shkakësore se nëse nuk do të ishte veprimi i kundërligjshëm i organit tjetër administrativ nuk do të vinte pasoja.<sup>126</sup>

Kjo duhet dalluar nga organe që kryejnë një veprimtari të deleguar nga një organ tjetër dhe gjatë kësaj kohe shkaktojnë dëm palëve apo të tretëve. Sipas nenit 16 të Ligjit nr. 8510/1999 përgjegjësinë e mban organi delegues, që ka kompetencën fillestare.<sup>127</sup> Kuptimi i delegimit jepet si në KPRA e 1999<sup>128</sup> ashtu edhe në KPRA e Ri<sup>129</sup> ku nënkuptohet kalimi i kompetencave të një organi të administratës publike në vartësi të tij ose jo, në këtë rast, delegohen vetëm ato kompetenca që ligji apo ndonjë akt tjetër ia njuh të drejtën organit të administratës publike për t’ia deleguar një tjetër organi. Delegimi duhet të shpallet publikisht për t’u njohur nga qytetarët.

Rastet përjashtimore me pasojë pavlefshmëri delegimi parashikohen:

- kur delegimi nuk është i lejuar me ligj apo akte të tjera nënligjore;
- Kur organet kolegjiale i delegojnë kompetencat e tyre drejtuesit të organit;

<sup>124</sup> Dispozita të veçanta të këtij Kodi zbatohen edhe ndaj personave, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për problem të lidhura me mardhëniet e punës. Ligjin Nr.8737, datë 12.2.2001 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i shfuqizuar aktualisht me ligjin nr. 97/2016.

<sup>125</sup> Neni 14 “Debitorët solidare: Kur përgjegjës për shkaktimin e demit janë disa organe të administratës shtetërore, secili prej tyre mban përgjegjësi për të gjithë dëmin. Ata përgjigjen kundrejt të dëmtuarit si debitorë solidare”

<sup>126</sup> Neni 15 -Kërkimi i shpërblimit- “Ne rastet kur organi i administratës shtetërore shkakton një dem, si rezultat i një akti ose veprimi të kundërligjshëm të një organi tjetër, organi i parë mund t’i kërkojë shpërblimin organit të dytë, në qoftë se nuk parashikohet ndryshe nga ligji. ”

<sup>127</sup> Neni 16 Pushteti i deleguar “Në rast se subjekti, që shkakton dëmin, nuk është organ i administratës shtetërore, por vepron në bazë të autorizimit nga pushteti publik, përgjegjësinë e mban autoriteti publik, i cili ka kompetencën fillestare. Ne rast se subjekti i deleguar e shkakton dëmin për faj të tij, autoriteti delegues mund të kërkojë dëmshpërblim, sipas nenit 15. ”

<sup>128</sup> Nenet 27 deri 34.

<sup>129</sup> Nenet 28, 29.

- Kur organi i nëndelegon kompetencën një organi tjetër.

Në rast se një organ vepron në kundërshtim me këto raste ndaluese bëmi përsëri shpërblehet nga autoriteti delegates, por këtij i lind e drejta me padi kthimi të kërkojë dëmshpërblimin përkatës. Padi e kthimit është e parashikuar në nenin 15 të ligjit nr. 8510/1999 ku parashikohet se: *“Ne rastet kur organi i administratës shtetërore shkakton një dëm, si rezultat i një akti ose veprimi të kundërligjshëm të një organi tjetër, organi i parë mund t’i kërkojë shpërblimin organit të dytë, në qoftë se nuk parashikohet ndryshe nga ligji.”*

Në çdo rast kur konstatohet se një nëpunës i OAP, qoftë edhe në hierarkinë më të lartë të tij në rang sekretari të përgjithshëm, ka vepruar pa pasur ndonjë delegim specifik nga titullari, vlerësohet përgjegjës për çdo dëm të ardhur te të tretët. Në rastin e A.H ndaj Ministrisë së Brëndshme, Gjykata e Lartë në vendimin nr. 190 datë 12 Maj 2009 u ka tërhequr vëmendje gjykatave më të ulëta që janë marrë me themelin e çështjes nëse duhet të zhdëmtohet paditësja për shumën 50 000 lekë si rezultat i raportit të KLSH që e gjeti me faj në procedurat e tenderimit publik. Më tej Kolegji Civil argumenton se: *“Në kushtet kur nuk ka rezultuar ndonjë delegim për sekretarin e përgjithshëm nga ana e titullarit të institucionit (të paditurit), Kolegji Civil çmon se jemi përpara një akti administrativ (urdhëri) absolutisht të pavlefshëm, sepse është nxjerrë nga një organ i cili nuk njihet nga ligji si organi që mbart pushtetin dhe vullnetin juridik për të nxjerrë aktin e kontestuar.”*

### 2.2.1 Nëpunësit e organeve të administratës publike

Nëpunësit dhe organet ku ato bëjnë pjesë sipas konceptit të KPRA që pritet të hyjë në fuqi, mbajnë përgjegjësi karshi palëve kur u shkaktojnë dëme. Nëpunësit publikë janë personat fizikë të punësuar pranë organeve të administratës publike që zbatojnë drejtpërdrejtë politikën, detyrat ekzekutive-urdhërdhënëse të organit, detyrat administrative dhe detyra të tjera të përcaktara në ligjin organik dhe ligje të tjera mbi të cilët (në bazë të të cilëve) vepron organi, detyrimet në kontratën e punës etj.<sup>130</sup> Koncepti i nëpunësit mund të haset edhe me termin punonjës<sup>131</sup>, nëpunës shtetëror apo thjesht nëpunës<sup>132</sup> siç ishte e parashikuar tek KPRA i vitit 1999.

Koncepti i nëpunësit dhe të drejtat e tij parashikohen edhe në nenin 107 të Kushtetutës ku: *“1. Nëpunësit publikë zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit. 2. Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji. 3. Garancitë e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i nëpunësve publikë rregullohen me ligj.”*

Referuar parashikimit të nenit 15 të KPRA (2016) duket se përgjegjësia është solidare mes organeve dhe nëpunësit publik për dëmet e shkaktuar palëve në një procedim administrativ. Ky nen parashikon se: *“Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin përkatës”*. Përgjegjësia është solidare sipas nenit 626 të KC kur bëmi është shkaktuar nga shumë persona së bashku dhe këta përgjigjen ndaj të dëmtuarit solidarisht. Pra përgjegjësi solidare do të kishim në rast se bëmi ka

<sup>130</sup> Shih Ligjin nr. 152/2013“Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe ligjin nr. 9131 datë 08 shtator 2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”

<sup>131</sup> Neni 14 : *“Organet e administratës publike dhe punonjësit e tyre mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë personave privatë ...”*

<sup>132</sup> Nenet 39§1, 41§2, 67, 68 i KPRA i 1999.



ardhur edhe për faj të organit administrativ dhe për faj të nëpunësit i cili nuk ka zbatuar korrektësisht deyrat e tij.

Në fakt pavarësisht se mban përgjegjësi edhe nëpunësi, padinë i dëmtuari ia drejton organit nga veprimtaria e të cilit erdhi pasoja e paligjshme dhe përgjithësisht për dëmet shkaktuar të tretëve përgjegjësi mban fillimisht organi shtetëror. Në rast se provohet se dëmi ka ardhur për faj tërësisht apo pjesërisht të nëpunësit mund të ngrejë padinë e kthimit të shumës. Kjo padi parashikohet nga neni 627 i KC: *“Personi që ka shpërblyer dëmin ka të drejtë të kërkojë nga secili shkaktar i dëmit pjesën e tij në përpjestim me shkallën e fajësisë të secilit dhe të tërësisë së pasojave të rrjedhura. Kur kjo nuk mund të përcaktohet, prezumohet se shkalla e fajësisë është e barabartë”*.

Përgjegjësia e organit publik apo e organit të administratës publike karshi punonjësit, nëpunësit të saj mund të jetë me faj ose pa faj (përgjegjësi strikte).

Konsiderohet përgjegjësi me faj të punëdhënësit për punëmarrësin kur ky i fundit ka passjellë një dëm të tretëve për shkak të kualifikimit të dobët të tij, mos mbikqyrjes, moskontrollit të punëmarrësit etj. Ndërsa kemi përgjegjësi pa faj të punëdhënësit kur ai ka vepruar me keqbesim apo në kundërshtim të hapur të detyrës së caktuar me ligj.

Në nenin 4 të ligjit nr. 8510/1999 parashikohet se: *“omissis ... 2. Punonjësit e organeve të administratës shtetërore, përjashtimisht, përgjigjen për dëmet që u shkaktajnë personave fizikë a juridikë privatë, kur vërtetohet se ata kanë vepruar me keqbesim. 3. Në rastet e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, organi shtetëror punëdhënës, pasi dëmshpërblen palën e dëmtuar, ka të drejtë të kërkojë nga punonjësi fajtor kthimin e shpërblimit që ka paguar.”*

Mund të themi se në të dy rastet, si me faj edhe pa faj (por për faj të punonjësit), organi mban përgjegjësi karshi të tretëve për nëpunësit. Ai del si i paditur karshi të dëmtuarit-paditës. Të njëjtin parashikim bën edhe KC ku përcakton marrëdhënien e përgjegjësisë deliktore (jashtë kontraktore) mes punëdhënësit dhe punëmarrësit.<sup>133</sup>

Diferencë bën dallimi i momentit se kur ka të drejtë organi publik të ngrejë padinë e regresit (kthimit)<sup>134</sup> dhe të kërkojë nga punonjësi atë çfarë i ka shpërblyer personit të dëmtuar. Kjo ndodh vetëm kur kemi përgjegjësi pa faj të organit publik punëdhënës dhe provohet se punonjësi ka vepruar në kundërshtim me urdhërat e detyrës, ka vepruar me keqbesim, ka kryer një vepër penale, etj. Në këtë rast, me anë të një gjykimi të dytë, shkarkohet përgjegjësia që ka organi publik karshi të dëmtuarit dhe punëmarrësi (tashmë si i paditur) mban përgjegjësi vetjake për veprimet e tij.

Nënvizojmë se marrëdhënia i dëmtuar dhe punëmarrës - punëdhënës nuk është marrëdhënie detyrimore solidarë pra paditësi i dëmtuar nuk ka të drejtë të zgjedhë se cilin prej tyre të padisë pasi nga secili prej tyre do të marrë shpërblimin dhe më pas debitori solidar do t'i kërkojë debitorit tjetër dëmin e paguar.

Detyrimi solidar është një detyrim që lind nga vullneti i palëve ose me ligj. Duke qënë se deliktet lindin vetëm nga ligji edhe marrëdhënia detyrimore solidarë mes kreditorit (këtu nënkupto të dëmtuarin paditës) dhe debitorin (dëmtuesin punëdhënës,

<sup>133</sup> Neni 618 *“Punëdhënësi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve për fajin e punonjësve që janë në shërbim të tij, gjatë ushtrimit të detyrave që u janë besuar prej tij. Personi juridik është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga organet e tij në kryerjen e detyrave të tyre”*.

<sup>134</sup> Kodi Civil, neni 627 - Padia e kthimit *“Personi që ka shpërblyer dëmin ka të drejtë të kërkojë nga secili shkaktar i dëmit pjesën e tij në përpjestim me shkallën e fajësisë të secilit dhe të tërësisë së pasojave të rrjedhura. Kur kjo nuk mund të përcaktohet, prezumohet se shkalla e fajësisë është e barabartë.*

*Prindërit ose kujdestarët që kanë paguar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga të miturit ose nga personat të cilëve u është hequr krejt zotësia për të vepruar, nuk kanë të drejtë të kërkojnë nga këta kthimin e shpërblimit të dëmit që kanë paguar.”*

ose punëmarrës kur ka vepruar me keqbesim) të jetë e përcaktuar shprehimisht në ligj.<sup>135</sup> Detyrimi solidar është kur kreditori ose secili nga kreditorët ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e të njëjtit detyrim tërësisht apo pjesërisht si nga debitorët së bashku, ashtu dhe nga secili prej tyre veç e veç.<sup>136</sup>

Në këtë mënyrë, i gjithë gjykimi fillimisht do të përqëndrohet në hetimin nëse pala e paditur, organi i administratës publike ka shkaktuar dëmin me faj apo pa faj por që gjithësesi do të mbajë përgjegjësi karshi të dëmtuarit për dëmin e pësuar.<sup>137</sup> Më pas, organi administrativ ka të drejtë të ngrejë padi për kthim kur gjykata vendos se faji për ardhjen e dëmit është faj vetjak i nëpunësit publik.

Në ligjin nr. 8510/1999 kjo lloj marrëdhënie është e parashikuar shprehimisht kur thuhet që organi shtetëror punëdhënës, pasi dëmshpërblen palën e dëmtuar, ka të drejtë të kërkojë nga punonjësi fajtor kthimin e shpërblimit që ka paguar.<sup>138</sup>

Paditë e të dëmtuarit karshi punonjësit drejtpërdrejtë janë të destinuara të rrëzohen pasi në vlerësim të marrëdhënies mes palëve ndërgjyqëse, marrëdhënia do të jetë e huaj dhe e panjohur më parë, pasi i dëmtuari ka hyrë në marrëdhënie me organin e administratës publike dhe jo me të paditurin si individ. I padituri ka vepruar në këtë rast si përfaqësues, i punësuar në organin publik dhe domosdoshmërisht sqarohet kjo situatë kur organi administrativ është i paditur. Ky i fundit si person juridik mban përgjegjësi për veprimet e punonjësve të tij dhe ndan se ku ka vepruar nëpunësi, punonjësi brenda detyrës dhe ku jashtë saj me keqbesim.

Inkurajohen në fakt ato padi ku kemi të paditur edhe organin administrativ edhe nëpunësin e tij në mënyrë që me një proces të vetëm të shqyrtohet i njëjti fakt, u jepet mundësi të dy protagonistëve për të paraqitur variantin e tyre të fakteve dhe për të hetuar mbi fajin e gjithësecilit. Variantet e përfundimit mund të jenë nga më të ndryshmet: asnjëri nuk është fajtor në ardhjen e pasojës dhe padia rrëzohet, kur dëmi ka ardhur vetëm për faj të organit administrativ ndërsa punonjësi ka vepruar në përputhje me ligjin, këtu padia pranohet për organin administrativ dhe rrëzohet për nëpunësin ose e anasjelltas, të dy kanë vepruar në kundërshtim me ligjin dhe me faj duke u pranuar padia për të dy të paditurit dhe duke pasur përgjegjësi solidare.

Nëse nuk është ngritur padia njëkohësisht ndaj organit administrativ dhe ndaj punonjësit gjykata do ishte me e udhës ta thërriste punonjësin në cilësinë e personit të tretë sipas nenit 193 të Kodit të Proçedurës Civile ose edhe paditësi të shtonte të bashkë të paditurit sipas nenit 161 të Kodit të Proçedurës Civile.

## 2.2.2 I dëmtuari nga organet e administratës shtetërore dhe përgjegjësia ndaj tij

### 2.2.2.1 Personat direkt të dëmtuar

Po t'i referohemi konceptit të përgjegjësisë civile të organeve të shtetërore në Kushtetutë, legjitimohet të kërkojë shpërblim ose rehabilitim kushdo, pra çdo person fizik, person juridik, shtetas shqiptar, të huaj, pa shtetësi etj. Kjo shkon në unison edhe me nenin 1 të ligjit nr. 8510/1999 ku parashikohet se: *“Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet pasurore dhe jopasurore jashtëkontraktore, që u shkaktajnë personave fizikë a juridikë, privatë, vendas a të huaj.”*

<sup>135</sup> Shih Kodin Civil, neni 424.

<sup>136</sup> Po aty, neni 423.

<sup>137</sup> Këtu përjashtoj rastin kur kemi dëm për shkak të forcës madhore, mbrojtjes së nevojshme etj.

<sup>138</sup> Shih nenin 4§3.

Po ashtu sipas paragrafit të dytë të po këtij neni kjo lloj përgjegjësie rregullohet edhe sipas nenit 608 e vijues të KC të R.Sh. Edhe ky i fundit njeh si person të dëmtuar çdo person<sup>139</sup>.

Nëse do i referohemi ligjeve si KPRA (1999) apo Ligji nr. 8510/1999 që dolën pas Kushtetutës së vitit 1998, me të dëmtuar njihen dy koncepte: personat privatë dhe palë të interesuara. Ndërsa neni 15 i KPRA (2016) shprehet se organet mbajnë përgjegjësi për dëmin që u shkaktojnë palëve.

Në nenin 14 të KPRA i vitit 1999 parashikon se organet e administratës publike mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë personave privatë. Në pamje të parë duket se përgjegjësia e institucioneve fokusohet vetëm te kjo kategori, pra si persona jo palë të procesit administrativ, që në mënyrë rastësore, indirekte apo tangenciale janë dëmtuar nga efektet e drejtpërdrejta apo të tërthorta të aktit administrativ.

Termi person privat përdoret në KPRA të vitit 1999, në parimin e mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave private<sup>140</sup>, në parimin e barazisë dhe proporcionalitetit,<sup>141</sup> në parimin e bashkëpunimit të administratës me personat privatë<sup>142</sup> në parimin i marrjes së vendimeve në lidhje me çështjet që u përkasin drejtpërsëdrejti personave privatë<sup>143</sup>, parimi i efijencës dhe i deburokratizimit,<sup>144</sup> parimi i kontrollit të brendshëm dhe atij gjyqësor që synon që të mbrojë drejtat kushtetuese dhe ligjore të personave private.<sup>145</sup>

Po ashtu në një sërë disozitash vijuese të KPRA të vitit 1999 termi “person privat” përmendet edhe te parimet se çdo person që hyn në marrëdhënie me administratën publike si një palë e interesuar, mund t’i bashkohet në vijimësi ose krijon një marrëdhënie me organin pasi ka përfunduar procedimi administrativ për shkak se i ka sjellë pasojë në interesat e tij kushtetuese apo ligjore.

Ky nocion nuk duhet ngatërruar me atë të palës së interesuar që parashikohej në Pjesën e Katërt “Palët e interesuara në procedimin administrativ”<sup>146</sup> ku flet për person fizik, shoqatë, organizatë të cilët iniciojnë dhe marrin pjesë në një proces administrativ si grupe të interesit, persona të interesuar, etj. Ata kanë të drejtë të fillojnë procedimin administrativ.<sup>147</sup>

<sup>139</sup> Neni 608§1 “Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton **tjetrit** një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.”

<sup>140</sup> Neni 11 i KPRA 1999.

<sup>141</sup> Neni 12 i KPRA 1999.

<sup>142</sup> Neni 13 i KPRA 1999.

<sup>143</sup> Neni 15 i KPRA 1999.

<sup>144</sup> Neni 16 i KPRA 1999.

<sup>145</sup> Neni 18 i KPRA 1999.

<sup>146</sup> Neni 44 Pjesëmarrja në procedimin administrativ: “1. Çdokush që ka interes të ligjshëm ka të drejtë të marrë pjesë në procedimin administrativ personalisht ose/dhe i përfaqësuar. 2. Zotësia për të marrë pjesë në procedimin administrativ rregullohet sipas dispozitave të së drejtës civile mbi zotësinë juridike për të vepruar.”

<sup>147</sup> Neni 45§2 “1. Mbajtësit e të drejtave dhe interesave të ligjshme, të cilat preken nga vendimet që merren gjatë procedimit administrativ, kanë të drejtë të fillojnë procedimin administrativ, si dhe të marrin pjesë në të. Të drejtat e mësipërme i kanë dhe shoqatat apo organizatat.

2. Në mbrojtje të interesave të gjera, të cilat mund të preken nga procedimi administrativ, kanë të drejtë të fillojnë një procedim administrativ dhe/ose të marrin pjesë në të edhe:

a) personat të cilëve procedimi administrativ u shkakton ose mund t’u shkaktojë dëme në të drejtat e përbashkëta si psh. shëndeti publik, arsimimi, trashëgimia kulturore, mjedisi, si dhe në cilësinë e jetës;

b) personat që jetojnë brenda apo pranë një prone publike, e cila mund të dëmtohet nga procedimi administrativ;

c) Avokati i Popullit.

Ndërsa një person privat i cili ka të drejtë sipas nenit 14 të KPRA të vitit 1999 vepron pasi ka ndodhur një proces administrativ, një veprim a mosveprim i mëparshëm administrativ dhe si pasojë e kësaj sjellje ai inicion një proces gjyqësor apo administrativ shtesë për t'u shpërblyer apo rehabilituar për veprimet e padrejta të kryera më parë nga administrata.

Këtë diferencë ka dashur ta tejçojë legjislatori edhe te parashikimet mbi ankimin administrativ.<sup>148</sup> Personit të interesuar i njihet e drejta që të ankohet kundër një akti administrativ ose kundër refuzimit për nxjerrjen e aktit administrativ si dhe ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës vetëm pasi të ketë ezauruar rekursin administrativ.<sup>149</sup> Po ashtu i njihet e drejta personit të interesuar për t'u njoftuar gjatë shqyrtimit të ankimit, etj.<sup>150</sup>

Pra me person të interesuar kuptohet personi i cili ka filluar një procedurë administrative për të cilën ka të drejtë të ndjekë të gjitha shkallët e rekursit administrativ (nëse e parashikon ligji përkatës) e më pas t'i drejtohet gjykatës. Ndërsa në lidhje me personin privat, njihet e drejta e gjithë personave privatë që të ankimojnë një akt administrativ.<sup>151</sup>

Në KPRA e Ri, ka një unision mes personave që janë përballë organit publik, duke i konsideruar përgjithësisht si palë<sup>152</sup>. Në disa nene detajohen si palë në proces<sup>153</sup>, në disa raste si palë të interesuara,<sup>154</sup> palë të përfshira, palë në procedurë<sup>155</sup>, në raste të tjera palë të treta,<sup>156</sup> etj.

Vlen të theksohet se neni 15 i KPRA i ri, mbi parimin e përgjegjësisë së organeve publike fillimisht të konfondon pasi duket se ia njeh këtë të drejtë vetëm palëve në proces administrativ por në fakt këtë të drejtë, ashtu siç ka qënë logjika e mëparëshme në KPRA e vitit 1999, i jepet edhe çdo personi tjetër i cili mund të dëmtohet nga kjo procedurë pavarësisht se nuk ka qënë subjekt i interesuar në të.

Kjo sqarohet mjaft mirë te neni 3 pika 7 i KPRA të ri, ku me termin "palë" duhet kuptuar jo vetëm çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative por edhe një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, por që të drejtat ose interesat e tij të ligjshme mund të cënohen nga rezultati i procedurës. Neni 3 pika 8 përcakton se me termin "person" duhet kuptuar çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës.

3. Shoqatat që veprojnë në mbrojtje të interesave të gjera të publikut, kanë të drejtë të fillojnë apo të marrin pjesë në procedimin administrativ."

<sup>148</sup> Seksioni VI nenet 135 deri 146.

<sup>149</sup> Neni 137.

<sup>150</sup> Neni 145.

<sup>151</sup> Neni 135 "Parimet e përgjithshme "1. Personat privatë kanë të drejtë të kërkojnë revokimin, shfuqizimin ose modifikimin e akteve administrative në përputhje me rregullat e vendosura nga ky Kod. 2. E drejta e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të ushtrohet në mënyrat e mëposhtme:

a) me anën e një kërkesë jo formale drejtuar punonjësit ose organit përgjegjës për aktin;

b) me anën e një ankimi drejtuar organit që ka nxjerrë aktin e ankimit ose eprorit të

punonjësit/organit përgjegjës, organit kolegial kur punonjësi përgjegjës është anëtar i tij dhe organit delegates."

<sup>152</sup> Neni 45, 46, 67, 78, 83.101.103.

<sup>153</sup> Neni 6.

<sup>154</sup> Neni 30, 67, 105.

<sup>155</sup> Neni 69.

<sup>156</sup> neni 119.

### 2.2.2.2 Personat indirekt të dëmtuar

Personi i dëmtuar jo drejtpërdrejtë nga administrata publike është parashikuar për herë të parë nga neni 13 i ligjit nr. 8510/1999. Ky nen me titullin “Pretendime të dëmtuarve jo drejtpërdrejtë” parashikon se: *“1. Në rastet e vdekjes, cënimit të paprekshmërisë trupore ose të shëndetit, si dhe në rastin e heqjes së padrejtë të lirisë, si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të organeve të administratës shtetërore, të tretit, të cilit i dëmtuari ka qenë i detyruar t'i bëjë shërbime në shtëpi ose në punën e tij, i paguhet një dëmshpërblim në të holla për demin që i shkaktohet nga shërbimet e perealizuara.*

*2. Në rast se është shkaktuar vdekja e një personi, për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të organeve të administratës shtetërore, këto të fundit janë të detyruara të dëmshpërblejnë shpenzimet e varrimit të atij që ka detyrimin ligjor për t'i paguar ato.*

*3. Kur i vdekuri, në çastin e shkaktimit të demit, ka qenë ligjërish i detyruar për t'i dhënë një të treti detyrim ushqimor ose mund t'i vihej një detyrim i tillë, dhe kur i treti ka mbetur pa këtë detyrim ushqimor, si rezultat i vdekjes së të detyruarit, atëherë atij i dëmshpërblehet demin nëpërmjet caktimit të një pensioni në të holla. ... omissis ...”*

Ky koncept i ri i panjohur më parë në të drejtën civile bashkë me konceptin e dëmeve jopasurore të parashikuar nga neni 12 sfidonte haptazi parashikimet e ngushta të Kodit Civil për përgjegjësinë nga dëmet jashtëkontraktore. Kështu sipas këtij ligji njihen si persona të dëmtuar jo drejtpërdrejtë si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të organeve të administratës shtetërore:

- Personi të cilit i dëmtuari ka qenë i detyruar t'i bëjë shërbime në shtëpi ose në punën e tij por që nuk kryhen më pasi i dëmtuari direkt ka vdekur, është cënuar në paprekshmërinë trupore ose të shëndetit (plagosur), si dhe në rastin e heqjes së padrejtë të lirisë,
- Personit që ka detyrimin ligjor për t'i paguar shpenzimet e varrimit për të dëmtuarin që i është shkaktuar vdekja p.sh., prindit për fëmijën e mitur nën 18 vjeç apo beqar ku zakonisht detyrimet zakonore mortore kryhen të shtëpia e prindërve kur ata janë gjallë ose tek i vëllai nëse prindërit i kanë vdekur. Në rast se është i martuar, bashkëshortes në banesën e përbashkët zakonisht kryehen edhe cermonia mortore, shpenzimet e varrimit etj. Në rast të një të moshuari, fëmija me të cilin ka jetuar kohët e fundit i ndjeri, etj.
- Personi i cili përfitonte detyrim ushqimor nga i dëmtuari me vendim gjyqësor ose mbështetjen ekonomike që ia siguronte i dëmtuari i vdekur.
- Personi i cili është i zënë por jo i lindur në kohën e vdekjes së të dëmtuarit të vdekur, i njihet e drejta e përfimit për detyrim ushqimor.

Megjithatë masa e shpërblimit që u jepet këtyre të dëmtuarve do të jetë në proporcion edhe me fajin që ka pasur i dëmtuari kryesor në ardhjen e pasojës.<sup>157</sup> Në rast se organet e administratës shtetërore përjashtohen nga përgjegjësia për demin e ardhur tek i dëmtuari kryesor (por jo për mos funksionim të mjeteve teknike) nëse demin nuk mund të shmangej edhe me një kujdes normal edhe për të dëmtuarit e drejtpërdrejtë nuk mbajnë përgjegjësi.

Tashmë, personat e tretë të dëmtuar janë konfiguruar më mirë me Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuarë të GJL nr. 12 datë 14 Shtator 2007 ku në interpretim të neneve 608, 625, 643/a e vijues të K.Civil, Kolegjet e Bashkuara të

<sup>157</sup> Shih nenin 11 të ligjit nr. 8510/1999.

Gjykatës së Lartë kanë unifikuar se: *”Çdo subjekt i cënuar në të drejta dhe interesa të ligjshme personale e pasurore nga fakti i paligjshëm, edhe nëse nuk është ai vetë subjekti pasiv i atij fakti, ka të drejtën subjektive, legjitimimin aktiv, për të kërkuar (ius proprius) dëmshperblimin e dëmit pasuror e jopasuror të pësuar. Ky legjitimim aktiv, në parim, nuk kushtëzohet me gëzimin e cilësisë së trashëgimitarit të një personi të dëmtuar, por vetëm me cilësinë e vetë paditësit si i dëmtuar nga fakti i paligjshëm”.*

Më tej KB të GJL kanë interpretuar se përveç rastit më të rëndë, vdekje të të dëmtuarit, ku prezumohet se ka dëmtim të prindërit, vëllezërit, motrat, bashkëshortja, gjyshërit, bashkëjetuesit e tjerë, edhe në rast të dëmit në shëndet prezumohet se nuk pëson dëm të tillë vetëm i dëmtuari në rast të cënimit të integritetit fizik, por dëm në shëndet dhe të formave të tjera<sup>158</sup> pësojnë edhe persona të tretë të lidhur me të si bashkëshortja, fëmijet, prindërit, bashkëjetuesi etj., pa e kufizuar rrethin e personave të rrethi i trashëgimtarëve ligjorë.

Po sipas këtij vendimi, familjarët mund të kërkojnë shpërblim për të gëzuar të drejtën e mbajtjes dhe të ushqimit nga i afërmi, edhe në rastet kur viktimat (i dëmtuari direkt i vdekur) është madhor apo i mitur, ishte pjesëtar i “familjes” e “banonte” me pasjetuesit.<sup>159</sup>

Si përfundim themi se, edhe në dëmet që sjellin organet e administratës publike, të dëmtuarit direkt legjitimohen për të kërkuar shpërblim për shpenzimet e kryera si shpenzime varrimi dhe shpërblim për dëm jopasuror si e drejta e mbajtjes me ushqim për familjarët e tij.

### 2.3 Objekti i Përgjegjësisë jashtëkontraktore

Nëse bëjme një krahasim mbi zhvillimin e konceptit të përgjegjësië civile të shtetit mund të themi se ajo është fenomen i shekullit XIX dhe XX, fillimisht në SHBA e më pas në shtete si Francë, Angli, etj. Në Mesjetë, njihet doktrina e mospërgjegjësisë së shtetit dhe organeve të tij për veprimet e paligjshme që kryenin ndaj qytetarit pasi mbizotëronte parimi “I të drejtave hyjnore të mbretit,” dhe ai si fytyra e Zotit në tokë, nuk mund të gabonte, nuk mund të paditej dhe të gjykohej nga gjykatat e tij.

Koncepti i përgjegjësisë jashtëkontraktore e administratës shtetërore ose publike në Shqipëri është më i ngushtë se konceptet analoge që gjenden në botë. Kështu njihen përgjegjësia administrative e shtetit, përgjegjësia civile e organeve publike, përgjegjësia qeveritare, përgjegjësia e shtetit për dëmin jashtëkontraktor, etj. E rëndësishme është se Shqipëria, si shumë vende demokrtike, i është bashkuar grupit të shteteve ku mbahet përgjegjësi për veprimet a mosveprimet e organeve shtetërore karshi shtetasve në Shqipëri.

Sipas Fjalorit të Gjuhës Shqipe fjala “përgjegjësi” nënkupton detyrimin që ka dikush për t’u përgjigjur për veten a për diçka që ka ndodhur ndërsa “përgjegjës” është ai që përgjigjet dhe jep llogari për diçka që ka ndodhur.<sup>160</sup>

<sup>158</sup> Ekzistencial, moral, biologjik, material. Për më tej do e shtjellojmë në kapitujt në vijim.

<sup>159</sup> “Në mbështetje të neneve 608 dhe 643/a të Kodit Civil, anëtarët pasjtuës të familjës, në lidhje të afërt dhe të qëndrueshme më të ndjerin e mitur që ka humbur jetën për shkak të një fakti të paligjshëm, kanë të drejtën e dëmshperblimit në lidhje me dëmin pasuror të pësuar në formën e fitimit të munguar, si një pamundësi për të përfituar, në rrjedhën normale të jetës, solidaritetin dhe kontributin reciprok të të ndjerit të mitur, jo vetëm si përkujdesje në tërësi, por edhe si mbështetje ekonomike e tij për familjen në të ardhmen. Për efekt të lëgjitimitit aktiv për kërkimin e dëmshperblimit nuk ka rëndësi rrethana që në kohën e vdekjes së të miturit, prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes gëzojnë osëe jo të ardhura të mjaftueshme për ushqim dhe jetesë.”

<sup>160</sup> J.Thomai, M.Samara, P.Haxhillazi, H.Shehu, Th.Feka V.Memisha, A.Goga “Fjalori i Gjuhës Shqipe”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2006, faqe

Duke qënë se në Shqipëri ky fenomen, është zhvilluar vetëm në shekullin e XX, nuk ka ndonjë koncept të konsoliduar mbi termin e përgjegjësive jashtëkontraktore të organeve shtetërore dhe në përgjithësi atë të administratës publike.

Kështu për autorin Sokol Sadushi ky institut përkufizohet si *“detyrim i organve të administratës shtetërore për të shpërblyer dëmin që këto të fundit i kanë shkaktuar interesave të personave privatë në ushtrim e sipër të funksioneve të tyre publike”*.<sup>161</sup>

Objekti i përgjegjësive jashtëkontraktore është çdo akt dhe veprim tjetër i organeve të administratës publike/shtetërore që brenda ose jashtë një procedure administrative, i ka sjellë një dëm çdo personi fizik ose juridik i cili mund të ishte ose jo palë në një marrëdhënie juridike administrative me organin publik.

Objekti i përgjegjësive administrative do të përfshijë fushën e veprimit të përgjegjësive që mbajnë subjektet e saj karshi të tretëve që ka sjellë pasoja ekonomike ose jo për to. Nëse i referohemi të kundërtës së konceptit mund të themi se rregullohet çdo lloj përgjegjësie e cila nuk vjen nga marrëdhënie të mëparshme të qytetarit, personit juridik vëndas a të huaj me administratën publike. Zakonisht përjashtohen përgjegjësitë që vijnë nga një marrëdhënie kontraktore ku të paktën njëra nga palët është organ publik. E thënë ndryshe, përjashtohen nga objekti i përgjegjësive jashtëkontraktore, detyrimet që lindin palëve nga një kontratë administrative. Këtë qëndrim mban edhe autori, Dr. Erajd Dobjani kur flet për parimin e mosakumulimit të përgjegjësive kontraktore me përgjegjësinë jashtëkontraktore.

Sipas këtij autori të dy këto përgjegjësi nuk duhet ngatërruar me njëra-tjetrën pasi: *“nga njëra anë, organi publik palë në një kontratë nuk mund të kërkojë shpërblimin e dëmit të ardhur nga një veprim ose mosveprim i kontraktuesit privat i lidhur me kontratën administrative, në bazë të përgjegjësive civile jashtëkontraktore dhe nga ana tjetër, kontraktuesi privat nuk mund të kërkojë ekzekutimin e këtij vendimi. Shpërblimin e dëmit të ardhur nga një veprim ose mosveprim i organit publik i lidhur me kontratën administrative në bazë të përgjegjësive jashtëkontraktore të organeve të administratës publike .... Nga momenti që palët janë në një marrëdhënie kontraktore të së drejtës publike, përgjegjësia kontraktore e së drejtës publike prevalon mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore të së drejtës publike.”*<sup>162</sup>

Koncepti i kontratës administrative jepet tek KPRA (1999)<sup>163</sup> por edhe tek KPRA i ri (2015)<sup>164</sup> me pothuajse të njejtën përmbajtje pra si një marrëveshje që krijon, ndryshon apo shuan një marrëdhënie ku të paktën njëra nga këto palë kërkohet të jetë organ publik. Më të konkretizuara si lloj kontrakte ishin të paraqitura në KPRA e vitit 1999<sup>165</sup> ky listim kontratash nuk ekziston në KPRA e Ri<sup>166</sup> pra llojet e kontratave nuk mund të jetë shteruese dhe mund të përfshihen kontratat e parashikuar më parë si: a) sipërmarrjet e punëve publike; b) prokurimi i punëve publike; c) prokurimi i shërbimeve publike; ç) licencimi i lojërave të fatit; d) kontratat e furnizimit të

788.

<sup>161</sup> Prof. Asoc. Dr. Sokol Sadushi, cikël leksionesh mbi “Parime të përgjithshme të Administratës publike”, Shkolla e Lartë Jopublike “Luarasi”, Tiranë 2013.

<sup>162</sup> Erajd Dobjani “Kontratat administrative në të drejtën shqiptare-desertacion për mbrojtine e gradës doktor” Tiranë (2015), faqe 262.

<sup>163</sup> Neni 7 “Kontrata administrative do të quhen ato marrëveshje, ku të paktën njëra nga palët, është organ i administratës publike dhe të cilat synojnë të krijojnë, të ndryshojnë ose të anulojnë marrëdhënie juridike në fushën e së drejtës publike.”

<sup>164</sup> Neni 3§4 “Kontrata administrative” është një marrëveshje, e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas së drejtës publike dhe në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik”

<sup>165</sup> Neni 151§2

<sup>166</sup> Kreu i II “Mbi kontratat administrative”, nenet 119 deri 125.

vazhdueshëm; dh) kontraktimi i shërbimeve të subjekteve private në rastet e fatkeqësive natyrore, por edhe kontrata të reja tipike ose jo.

Sipas autorit Erajd Dobjani ajo çfarë e dallon kontratën administrative nuk është numri i personave që marrin pjesë në të por edhe përmbajtja, shtrirja dhe efekti të saj “Kriteri i dallimit nuk është i lidhur me numrin e personave apo organeve që janë në origjinë të aktit. Nuk ka asnjë dyshim se një akt që ka një organ publik, si autor të vetëm të tij, nuk mund të jetë gjë tjetër veçse një akt administrativ i njëanshëm. Por, akti mjaft mirë mund të jetë një akt administrativ i njëanshëm edhe pse në origjinë të tij janë dy ose më shumë persona....

*Kriteri i dallimit është i lidhur me përmbajtjen e aktit. Nëse akti i administratës publike ka për objekt të rregullojë marrëdhëniet e personave që nuk janë autorët e tij, dhe për rrjedhojë ka efekte dhe pasoja erga omnes, kundrejt të gjithëve, ose kundrejt një personi apo subjekti të caktuar, apo kundrejt një kategorie personash apo subjektësh të caktuar, atëherë bëhet fjalë për një akt administrativ të njëanshëm (individual ose nënligjor normativ) ose veprim tjetër administrativ. ...*

*Nëse akti i administratës publike ka për objekt të rregullojë marrëdhëniet midis personave që janë autorët e tij dhe për rrjedhojë, në parim, ka efekte dhe pasoja juridike vetëm kundrejt këtyre personave që e kanë nxjerrë aktin, atëherë akti në fjalë është një akt i dyanshëm apo i shumëanshëm, ose për të përdorur termin e zakonshëm, është kontratë”<sup>167</sup>.*

Ajo çfarë vlen për të kuptuar nga kontratat administrative është se legjislatori në të tilla marrëdhëni të cilat janë veçanërisht civile, porse parashikohen dhe normohen nga KPRRA referon te mënyra se si i rregullon Kodi Civil apo legjislacione të tjera civile mbi institutin. Që do të thotë se edhe institutin e përgjegjësive jashtëkontraktore, deliktet (*tort apo delict*) që është tipike një institut i së drejtës civile, e drejta administrative vetëm vë disa konture të domosdoshme për ta pranuar në familjen e së drejtës administrative porse në përmbajtje dhe detaje i lë hapësirë për të nënkuptuar si organeve, palëve, zbatuesve të së drejtës etj., që do të referohen aty ku rregullohen më tej.

Për shembull, në kontratën administrative e domosdoshme është që një nga palët të jetë organ publik. Vihet re që edhe vetë legjislatori pranon se këtu kemi një ndërthurje të paevitueshme mes dispozitave të Kodit Civil mbi detyrimet në përgjithësi dhe kontratat e parashikuara nga neni 419 e vijues të Kodit Civil<sup>168</sup> apo në rastet e pavlefshmërive të kontratave do të merren parasysh dispozitat e Kodit Civil mbi pavlefshmëritë e veprimeve juridike, nenet 92 e vijues<sup>169</sup>.

Për këto arsye edhe referenca e elementëve të përgjegjësive jashtëkontraktore të organeve të administratës publike vazhdon në parashikimet e Kodit Civil mbi institutin e përgjegjësive civile jashtëkontraktore në nenet 608 deri 702.<sup>170</sup> Kjo shkon në harmoni me parashikimin e bërë në nenin 1 të ligjit nr. 8510/1999 ku parashikohet se

<sup>167</sup> Dr. Erajd Dobjani “Kontratat administrative në të drejtën shqiptare-desertacion për mbrojtine e gradës doktor” Tiranë (2015), faqe 36.

<sup>168</sup> Neni 124 -Zbatimi i dispozitave të tjera ligjore “Për çështjet e parregulluara shprehimisht nga ky Kod për kontratën administrative, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë apo të parashikimeve të posaçme ligjore”.

<sup>169</sup> Neni 122 -Pavlefshmëria e kontratës administrative “Pavlefshmëria e kontratës administrative rregullohet sipas dispozitave të Kodit Civil që parashikojnë pavlefshmërinë e veprimit juridik.”

<sup>170</sup> Titulli IV “Detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit” dhe titulli i V “Shpërblimi i dëmit” nga nenet 608 deri 652.



*“Përgjegjësia jashtëkontraktore e organeve të administratës shtetërore rregullohet me dispozitat e këtij ligji dhe të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë”.*

Në nenin 608 të KC ku jepet nocioni i dëmit jashtëkontraktor si dhe parashikimeve që bën neni 15 i KPRA i vitit 2016, përcaktohet se objekti ku vepron përgjegjësia jashtëkontraktore e administratës publike është aty ku organi i administratës publike apo nëpunësit e tyre, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkaktojnë një pale ose personave të tjerë të lidhur, një dëm në personin ose në pasurinë e tyre.

### **KREU III**

## **ANALIZA E ELEMENTËVE TË DËMIT JASHTËKONTRAKTOR NË ADMINISTRATËN PUBLIKE**

- 3.1 Veprimet dhe mosveprimet e paligjshme si shkak për përgjegjësi të organeve të administratës publike*
- 3.2 Faji*
  - 3.2.1 Shkallëzimi i fajit*
  - 3.2.2 Përjashtimet nga përgjegjësia jashtëkontraktore*
  - 3.2.3 Llojet e përgjegjësive jashtëkontraktore*
    - 3.2.3.1 Përgjegjësia me faj direkt*
    - 3.2.3.2 Përgjegjësia jashtëkontraktore me faj të prezumuar për veprimet e tjetrit*
    - 3.2.3.3 Përgjegjësia jashtëkontraktore me faj të prezumuar për sendet dhe kafshët që janë nën përgjegjësi*
    - 3.2.3.4 Përgjegjësia pa faj (strict liability)*
- 3.3 Lidhja shkaksore*
- 3. 4. Pasoja, dëmi i ardhura*
- 3. 5. Llojet e dëmeve në përgjegjësinë jashtëkontraktore të OAP*
  - 3.5.1 Raporti mes përgjegjësive së administratës shtetërore dhe nëpunësve të tyre.*
  - 3.5.2 Dëmet për shkak të vendimeve të paligjshme*
  - 3.5.3 Dëmet për shkak të veprime a mosveprime te kundërligjshme;*
  - 3.5.4 Dëmet për refuzim të paligjshëm për të marrë vendime.*
  - 3.5.5 Dëme për dhënie të informacioneve shkresore të pasakta*
  - 3.5.6 Dëme për veprime a mosveprime te ligjshme, por qe sjellin dëmtimin e interesave te ligjshme te personave fizike a juridike private.*
  - 3.5.7 Dëme për veprime a mosveprime te ligjshme, që u shkaktojnë një dëm të pabarabarte subjekteve të cilëve u drejtohet ky veprim a mosveprim*
  - 3.5.8 Dëme për shkak te mosfunksionimit të mjeteve teknike*
  - 3.5.9 Dëme nga një rrezik te vazhdueshëm personave fizike a juridike private.*
  - 3.5.10 Dëme nga një akt korruptiv gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre*
  - 3.5.11 Dëme në rastet e shpronësimeve bazuar në ligjin nr. 8561/1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”*
  - 3.5.12 Dëme në rastet e shpronësimeve*
  - 3.5.13 Dëmi nga ndryshimi i një shtate juridike ose faktik me origjinë nga akt te administratës shtetërore*
  - 3.5.14 Dëme për çdo shkak tjetër të parashikuar me ligj*

Në çdo lloj dëmi të shkaktuar si në të drejtën civile, në të drejtën administrative apo në të drejtën penale duhet të ekzistojnë katër elementë kumulativ (të përbashkët) konsumimi i të cilave nga subjekti sjell pasojën tek të dëmtuarit. Ato janë fakti i

paligjshëm të formëzuar në veprime a mosveprime të paligjshme, lidhja shkakësore, faji i subjektit si dhe dëmi i ardhur tek i dëmtuari.

Në vendimin nr. 123 datë 01 mars 2016, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbi çështjen mes P.N dhe Inspektoriat Ndërtimor Urbanistik Kombëtare, mbi këto kushte shprehet:” 29. Në analizë të nenin 3 të Ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i ndryshuar, i titulluar “Rastet e përgjegjësive së organeve shtetërore”, për të përcaktuar përgjegjësinë e organeve të administratës shtetërore është e domosdoshme që të plotësohen në mënyrë kumulative, kushtet e parashikuara në këtë dispozitë, të cilat duhet të jenë në harmoni dhe me kushtet e parashikuara në nenin 608 të Kodit Civil, të cilat janë: 1. Ekzistenca e dëmit pasuror; 2. Paligjshmëria e veprimit ose mosveprimit; 3. Ekzistenca e fajit; dhe 4. Lidhja shkakësore. Ekzistenca e këtyre katër elementëve bën që organi shtetëror të përgjigjet për dëmin jashtëkontraktor. Mungesa qoftë dhe e njërit prej tyre, përjashton organin nga kjo lloj përgjegjësie. ”

Këto kritere nxirren qartë dhe nga neni 608 të KC i cili parashikon se:” *Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.*

*Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj.*

*Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.”*

Mënyrën e paligjshme autori Prof.Dr. Ardian Nuni e përkufizon si:”... rast kur veprimtaria e personit dhe sjellja e tij është në kundërshtim me një normë urdhëruese të ligjit. .... Pra do të konsiderohen të paligjshme ato sjellje që bien ndesh me një nga të drejtat apo interesat e parashikuara e të mbrojtura nga ligji dhe që nuk justifikohet nga ndonjë kusht shfajësues si mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme etj ”<sup>171</sup>

### 3.1 Veprimet dhe mosveprimet e paligjshme si shkak për përgjegjësi të organeve të administratës publike

Po ti referohemi konceptit të dëmit në nenin 608§1 të KC duhet të kemi paligjshëmri të veprimeve apo mosveprimeve të autorit, pra ky nen parashikon” *Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.”*

Në rastin e dëmit të kryer nga një organ i administratës publike, format e paligjshmërisë mund të jenë të parashikuara në ligj të posaçëm ose jo por në fund i mbetet në diskrecion të organit administrativ epror apo të gjykatës që të vlerësoj për ato raste të paligjshmërisë kur në ligj nuk janë të detajuara rastet.

Në nenin 44 të Kushtetutës është e parashikuara se organet shtetërore (nënkupto edhe organet publike) mbajnë përgjegjësi për veprime ose mosveprime të paligjshme të tyre. Me *veprime* mund të konsiderojmë rastet kur në mënyrë aktive, dëmtuesi mund të sjell pasoja duke shkelur apo cënuar interesat dhe të drejtat të cilët janë të pranuar dhe mbrojtur nga rendi juridik apo nga zakonet e mira. Me *mosveprime*, dëmtuesi mund të shkaktoj dëm në rast se ai ka pasur detyrim ligjor për ta shmangur apo mënjanuar një ngjarje dhe përkundrazi nuk ka vepruar për ta penguar atë por ka lënë atë që të ndodh e si pasojë i ka cënuar të dëmtuarit në të drejta dhe interesa që mbrohen nga rendi juridik apo nga zakonet e mira. P.sh në rastin kur Komisariati i Policisë nuk nxjerr në kohën e duhur pasaportën individit që ka aplikuar dy muaj më parë, duke i humbur atij mundësinë për të aplikuar në universitet.

<sup>171</sup> Ardian Nuni “E drejta e Biznesit, për fakultetin e Ekonomisë” Tiranë 2012, faqe 635.

Koncepti i rendit juridik dhe i zakoneve të mira bazohet tek neni 608§3 i KC, kur flitet për përgjegjësinë për dëmin jashtëkontraktor që i referon edhe ligji nr. 8510/1999, një fakt i paligjshëm konsiderohet në formën: "... e veprimeve apo mosveprimeve që shkel apo çënon interesat dhe të drejtat që mbrohen nga rendi juridik apo nga zakonet e mira "

Për rendin juridik Akademiku Luan Omari e përkufizon si "terësia e marrëdhënieve të njërëzve në shoqëri që shprehen dhe sanksionohen në të drejtën, në normat juridike, pra rendi juridik është pjesë përbërëse e rendit shoqëror, rendi i marrëdhënieve të njërëzve që mbështeten në ligjshmëri".<sup>172</sup> Sot kjo mund të kuptohet në Kushtetutë, ligj, akte të tjera nënligjore, marrëveshjet ndërkombëtare etj.

Minimalisht, do të gjejmë mbrojtje nga çdo veprim i padrejtë të drejta dhe liri themelore të cilët janë të parashikuar si nga Kushtetuta, ashtu edhe nga akte ndërkombëtare që mbrojnë këto të drejta dhe liri themelore si p.sh Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe ngjyrimet që i kanë dhënë Gjykata Kushtetuese ashtu edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Gjykata e Strasburgut) bëhet fjalë për të drejta të cilët janë të pacënueshme, të patrashëgueshme si: e drejta e jetës<sup>173</sup>, integriteti fizik dhe shëndeti<sup>174</sup> liria personale<sup>175</sup>, liria e privatësisë dhe paprekshmëria e banesës dhe e korrespondencës etj.<sup>176</sup> Duke nisur nga Kushtetuta e R.Sh si ligj më i lartë i rendit juridik shqiptarë të drejtat dhe interesat themelore të individit parashikohen në pjesën e dytë të saj, nga neni 15 deri 63.

Me zakone të mira do të kuptojmë "një rregull sjellie që është vendosur si rezultat i zbatimit të tij në fakt gjatë një kohe pak a shumë të vazhdueshme."<sup>177</sup> Pra zakone të mira janë norma shoqërore të zbatuara vazhdimisht për një periudhë të gjatë nga komuniteti i një vëndi, popullsia e një shtetit etj. aq sa pranohet si një normë e pashkruar nga të gjithë.

Sipas komentarit të Kodit Civil të 1929, botim i Ministrisë së Drejtësisë, thuhet se për të caktuar nëse një vepër cakton zakone të mira ose jo, nuk duhet të kufizohemi në opinionin subjektiv të palëve ose të gjyqtarit mbi çështje morale, por në opinionin mesatar të personave të ndershëm dhe të arsyshëm.<sup>178</sup>

Termin zakone të mira e hasim në KC në fuqi, në fushën e pronësisë tek pronat fqinje (neni 158), për caktimin e çmimit të kontratës së qirasë (neni 831§2), caktimi i çmimit në kontratën e sipërmarrjes (neni 851), shpërblimi për kontratën e porosisë (neni 920), koncepti i vonësive në kontratën e komisionit (neni 948), masa e shpërblimit tek

<sup>172</sup> Luan Omari "Parimet dhe institucione të së drejtës publike " botimi i gjashtë, Shtëpia botuese "Elena Gjika, Tiranë 2004 faqja 193.

<sup>173</sup> Neni 21: "Jeta e personit mbrohet me ligj".

<sup>174</sup> Neni 25: "Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruar.

Neni 28: "Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij."

<sup>175</sup> Neni 27: "1. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj".

<sup>176</sup> Neni 36: "Liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjete tjetër të komunikimit janë të garantuara.

Neni 35: "1. Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij. 2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

Neni 37: "Paprekshmëria e banesës është e garantuar."

<sup>177</sup> Luan Omari "Parimet dhe institucione të së drejtës publike " botimi i gjashtë Botimet "Elena Gjika Tiranë 2004 faqja 311.

<sup>178</sup> "Obligimet dhe kontratat përgjithësisht" Shtëpia botuese Luarasi, botuar sipas orgjinalit të vitit 1932, Tiranë 1998 Faqja 181.

kontrate e spedicionit (neni 948), shpërblimi i agjentit tek kontrata e agjencisë (neni 953), shpërblimi i ndërmjetësit tek kontrata e ndërmjetësimit (nenet 974, 976). Njihet po ashtu termi zakon tregtar (nenet 673, 738) dhe zakon bankar (neni 1024).

Pra, termi i zakoneve të mira përdoret kryesisht për kritere subjektive që lidhen me çmim të kontratës, me shpërblim të një pale kontraktuale për shërbimin që kryen, me kohën që përbën vonesë në përmbushje etj. Në këtë mënyrë edhe veprime që janë të padrejta për shkak të zakoneve të mira të vendit ku është kryer dëmi do të konsiderohet në mënyrë subjektive çdo gjë që nuk është një sjellje normale e një personi me intelekt mesatar të atij vendi, komuniteti etj.

Megjithatë ekziston edhe termi veprime apo mosveprime të padrejta dhe veprime dhe mosveprime të kundërligjshme.<sup>179</sup> Sipas Gjyqtarit Dvorani edhe pse në nenin 608 të KC është parashikuar paligjshmëria në fakt duhet nënkuptuar e padrejta, e cila është një koncept më i gjërë sesa ligji kjo për të mos rënë edhe në një kufizim apo zgjerim të gabuar në interpretimin dhe zbatimin e normës.<sup>180</sup>

Në vazhdim të konceptit të padrejtësisë së dëmit gjejmë edhe interpretimin e KB të GJL në vendimin nr. 12/2007 ku shprehen se: *“Në thelb, me dispozitën e nenit 608 të KC dhe atë të nenit 18 të dekretit nr. 295 datë 15.09.1992 ligjvënësi parashikon mbrojtien nga fakti i paligjshëm i të drejtave të njeriut, posaçërisht të të drejtave subjektive (absolute a relative) të personalitetit dhe të pronësisë (reale), sikurse janë e drejta e jetës, shëndetit, personalitetit, dinjitetit, familjes, jetës private, pronësi etj. Në rast të cënimit të këtyre të drejtave nga fakti i paligjshëm, i dëmtuari gëzon të drejtën subjektive relative të kërimit të dëmshpërblimit jashtëkontraktor.”*

Mendoj se koncepti i kundërligjshëm që parashikon neni 608 i KC, është shumë më konkret se sa koncepti i paligjshmërisë dhe akoma më konkret po të krahasohet me konceptin e padrejtësisë e cila nuk mbështetet vetëm tek ligji por edhe tek zakonet e mira.

Kundërligjshmëria paraqitet në rastin kur ekziston një dispozitë ndaluese urdhëruese për personat që i kundërejtohet me kushtin se para se të kryhet ky veprim a mosveprim ai bie në kundërshtim me një normë dhe ka një pasojë konkrete etj. Karakteristikë e veprimeve a mosveprimeve të kundërligjshme janë ato të parashikuar nga normat penale të cilat janë të qarta, konkrete dhe nuk lënë vend as për analogji dhe as për interpretim të zgjeruar. Pra, që të kemi kundërligjshmëri duhet të kemi raste specifike të parashikuar në ligj se kur veprime konkrete do të konsiderohen të paligjshme.

Në vendimin nr. 25/2014 të Gjykatës Kushtetuese konceptin e kundërligjshmërisë e kanë interpretuar si vijon: *“... Gjykata vlerëson se koncepti i kundërligjshmërisë duhet të jetë i lidhur qartë me rastet specifike të përcaktuara saktë si të tilla që bien ndesh me legjislacionin në fuqi. Përcaktimi i situatave të kundërligjshme duhet të jetë i tillë që të mos lërë vend për interpretim të zgjeruar të tij, me qëllim shmangien e situatave abuzive në të cilat mund të gjenden subjektet që preken nga veprimi i aktit konkret. Përveç qartësisë që duhet të ketë norma në parashikimin e rasteve të kundërligjshmërisë, Gjykata thekson se nisur edhe nga koncepti i dhënë për të në legjislacion shqiptar dhe atë të huaj, kundërligjshmëria duhet të lidhet me rastet e ndërtimeve pa leje të miratuar nga organet kompetente ose me mosrespektimin*

<sup>179</sup> Neni 3§1: *“Organet e administratës shtetërore përgjigjen për demet që u shkaktojnë personave fizike a juridike private ne rastet që vijojnë: a) kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme”;*

<sup>180</sup> Dvorani A., *“Dëmi Jashtëkontraktor dhe përgjegjësitë që rrjedhin prej tij”*, Sesion trajnues, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë shkurt/mars 2015, faqe 2.

(tejkalimin, ndryshimin etj) e lejes së ndërtimit të dhënë nga autoritetet kompetente dhe jo me vlefshmërinë e lejes si akt administrativ....”<sup>181</sup>

Ndërsa rasti i veprimeve a mosveprimeve të paligjshëm apo të padrejta të lënë vënd dhe për interpretim të zgjeruar, për analogji apo edhe për interpretim bazuar në zakone.

Përveç këtyre koncepteve mbi paligjshmërinë, haset edhe koncepti i parregullsisë si p.sh tek neni 60§1 i Kushtetutës ku parashikohet se: *”1. Avokati i Popullit mbrohet të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. ...”* Si veprim i parregullt konsiderohet akti apo veprimi i zvarritur, i kryer apo i nxjerrë jo në kohën e duhur. I paligjshëm do të ishte kur ky akt është nxjerrë përtej afatit të caktuar me ligj. Parregullsia lidhet me diskrecionin dhe të drejtën e vetveprimit të OAP në kohën optimale, të duhur për personat që kanë pasur të njëjtat kushte por që nuk janë trajtuar njësoj p.sh dikujt i jepet leja e ndërtimit brënda një jave dhe dikujt tjetër ditën e fundit të afatit ligjor ndonëse të dy kërkesat janë paraqitur në të njëjtën ditë dhe nuk kanë pasur mangësi në dokumentacion.

Si përfundim, mund të themi se gjen mbrojtje çdo dëm që vjen nga një veprim i padrejtë, i kundërligjshëm, i paligjshëm dhe që vjen në kundërshtim qoftë edhe me zakone të mira dhe që plotëson edhe kushtet e tjera të kërkuar nga ligji për dëmin jashtëkontraktor.

### 3.2 Faji

Sipas Fjalorit të së Drejtës së Henry Black<sup>182</sup> me faj (fault) kuptojmë: *” 1) pakujdesi, një gabim ose e metë në përceptim(gjykim) ose në sjellje, çdo devijim nga matura, detyra, ndërshmëria,2) çdo e mete ose pakujdesi në sjellje e cila vjen nga hutimi, paaftësia ose mendjelehtësia ose një tendencë, motiv e veprim i gabuar ose me keqbesim ose nga mungesa e organizimit.”* Referuar po këtij fjalori duhet bërë dallimi mes fajit *culpa* nga *dolus* ku e para është në formën e pakujdesisë dhe ndahet në: *lata culpa* ose pakujdesi e rëndë, neglizhencë, *levis culpa* ose pakujdesi normale dhe *levissima culpa* ose pakujdesi e lehtë. Ndërsa faji *dolus (doli)* është një veprim me dëshirën e plotë ose e qëllimshme. Konsiderohet se kur vepron me një pakujdesi (*culpa*) ekstreme barazohet me qëllimin po aq sa ka raste kur edhe pse vepron me neglizhencë të lehtë, të përjashtohesh nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar.<sup>183</sup>

Dashjes dhe pakujdesisë që përkufizon e drejta penale i referohet edhe doktrina jonë kur shpjegon fajin në të drejtë civile<sup>184</sup> konkretisht citojmë se në nenin 14§2 i Kodit Penal parashikohet se quhet me faj personi që e kryen veprën me dashje ose me pakujdesi. Ku respektivisht nenet 15 dhe 16 të KP japin nocionet mbi dashjen: *” Vepra penale kryhet me dashje, kur personi i parashikon pasojat e veprës penale dhe dëshiron ardhjen e tyre ose, megjithëse i parashikon dhe nuk i dëshiron ato, me ndërgjegje lejon ardhjen e tyre”* dhe për pakujdesinë *”Vepra penale kryhet me pakujdesi kur personi,*

<sup>181</sup> Kërkesa e 36 deputetëve për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimit nr.932, datë 30.09.2013 të Këshillit të Ministrave “Për unifikimin e kompetencave të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK) në zonat me rëndësi kombëtare dhe në territor” dhe pezullimin e këtij vendimi deri në shpalljen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese.

<sup>182</sup> Henry Campbell Black, M. A. “Black’law Dictionary 6th Edition” St. Paul, Minnesota, West Publishing Co.1990, Faqe 621.

<sup>183</sup> Po aty faqe 673.

<sup>184</sup> Shih Prof.Dr Ardian Nuni “E drejta e Biznesit, për fakultetin e Ekonomisë” Tiranë 2012, faqe 632 apo Prof.Dr Mariana Semini (Tutulani) “E drejta e detyrimeve dhe e kontratave “ Pjesa e Përgjithshme, botimi i tretëTiranë 2002.

*megjithëse nuk i dëshiron pasojat, e parashikon mundësinë e ardhjes së tyre dhe me mendjelehtësi shpreson t'i shmangë ato, ose nuk i parashikon, megjithëse sipas rrethanave duhej dhe kishte mundësi t'i parashikonte.*"

Po ashtu, doktrina penale më tej ka ndarë dashjen në dashje direkte<sup>185</sup> dhe dashje indirekte<sup>186</sup> dhe pakujdesinë në neglizhencë<sup>187</sup> dhe në vetëbesim të tepruar<sup>188</sup>. Shumicën e rasteve, dëmi jashtëkontraktual vjen nga faji në formën e pakujdesisë e konkretisht në atë të neglizhencës.

Duhet të nënvizojmë faktin se përgjegjësia jashtëkontraktore ndryshe nga ajo penale është një përgjegjësi objektive. Pra mjafton të provohet dëmi, fakti i padrejtë që ka sjellur atë dhe lidhjen shkakësore mbahet përgjegjësi për ardhjen e tij.

Në nenin 608 të KC, parashikimi i dy paragrafëve mbi fajësinë e autorit të dëmit të ngre pikëpyetjen nëse ai duhet të ketë faj dhe ta provoj apo faji prezumohet. Në fakt po ti referohemi fjalisë së parë të këtij neni parashikohet se: "Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit..." ndërsa në paragrafin e dytë të këtij neni parashikohet se: "Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj." Kjo tregon se i dëmtuari ka për detyrë të provoj në një gjykim civil, administrative se ka pësuar dëmin, nga veprimet e padrejta të të dëmtuesit dhe se ekziston lidhja shkakësore mes tyre. I dëmtuari nuk i bie barra e provës për të provuar fajësinë në ardhjen e dëmit jashtëkontraktor, pasi ai prezumohet se është kryer me faj nga dëmtuesi.

Nëse dëmtuesi ka vepruar pa faj, për të rrëzuar prezumimin e fajësisë i takon atij që të provoj të kundërtën. Ai më mirë se kusho di se çfarë e ka shtyre të kryej veprimin apo të mos veproj dhe se cila ka qënë sjellja e tij pasi ndodhi dëmi për të mënjeluar ardhjen e pasojave. Faji është qëndrim<sup>189</sup>, vullneti i brëndshëm i manifestuar në botën e jashtme me veprime a mosveprime konkrete prandaj legjislatori ia ka ngarkuar dëmtuesit të provoj se ka vepruar pa faj për tu shkarkuar nga përgjegjësia.

### 3.2.1 Shkallëzimi i fajit

Shkallëzimi i fajit është një element që merret parasysh nga gjykata për të shtuar apo ulur përgjegjësinë e dëmtuesit karshi bashkëdëmtuesve të tjerë apo karshi të dëmtuarit. Ajo shërben si shkak edhe për të shkarkuar tërësisht apo pjesërisht shkaktuesin e dëmit nga përgjegjësia. Kështu në përgjegjësinë jashtëkontraktore shkallëzimi i fajit përveç faktit se ndahet mes dy llojeve ose formave<sup>190</sup>: dashje dhe pakujdesie mund të ketë edhe nënloje. P.sh lloji pakujdesi mund të klasifikohet në pakujdesi normale a të zakonshme dhe pakujdesi të rëndë.

Edhe në të detyrimet që rrjedhin nga kontrata, debitori i cili nuk përmbush detyrimin duhet të ketë vepruar me faj: me dashje apo nga pakujdesia.<sup>191</sup> Kjo e fundit në një sërë nenesh haset edhe në formën e pakujdesisë së rëndë: p.sh në kontratën e

<sup>185</sup> "kur personi i parashikon pasojat e veprës penale dhe dëshiron ardhjen e tyre".

<sup>186</sup> "megjithëse i parashikon dhe nuk i dëshiron ato, me ndërjegje lejon ardhjen e tyre".

<sup>187</sup> "kur personi, megjithëse nuk i dëshiron pasojat, e parashikon mundësinë e ardhjes së tyre dhe me mendjelehtësi shpreson t'i shmangë ato".

<sup>188</sup> "nuk i parashikon, megjithëse sipas rrethanave duhej dhe kishte mundësi t'i parashikonte".

<sup>189</sup> Prof.Dr. Mariana Semini (Tutulani) "E drejta e detyrimeve dhe e kontratave "pjesa e përgjithshme botimi i tretë, Tiranë 2002 faqja 161.

<sup>190</sup> Neni 647/a§"c" të KC në llogaritjen e shpërblimit të dëmit për shpifje, fyerje etj. merren parasysh format dhe shkallën e fajësisë.

<sup>191</sup> Neni 480: "Kur ekzekutimi i detyrimit bëhet i pamundur për fajin e debitorit, kreditori ka të drejtë të kërkojë prej tij shpërblimin e dëmit të shkaktuar. Debitori është me faj kur, me dashje ose nga pakujdesia, ka krijuar rrethana që e kanë bërë të pamundur ekzekutimin ose kur nuk ka marrë masa për ta ndaluar atë.

dhurimit<sup>192</sup>, në kontratën e qirasë,<sup>193</sup> kontratën e transportit,<sup>194</sup> kontrata e depozitës,<sup>195</sup> kontrata e sigurimit<sup>196</sup>.

Në nenin 627 të KC parashikohet se personi që ka shpërblyer dëmin ka të drejtë të kërkoj tek secili bashkëshkaktor dëmi në përpjestim me shkallën e fajësisë të paguaj dëmin. Në rast se ajo nuk përcaktohet prezumohet se shkalla dhe lloji i fajësisë është i njëjtë. Po ashtu, në nenin 644 të KC parashikohet se nëse shkaktuesi i dëmit ka përfituar nga ky fakt i paligjshëm, gjykata ka të drejtë të llogarisë përfitimin nisur edhe nga shkalla e fajit. Po ashtu edhe në nenin 647/a§"c" të KC në llogaritjen e shpërblimit të dëmit për shpifje, fyerje etj. merren parasysh format dhe shkallët e fajësisë. Si shkallë faji merret rasti kur i njëjti person vepron me të njëjtën pakujdesi disa herë rrjesht do të konsiderohet si rast i një pakujdesie të rëndë kjo përsëritje

Sipas mendimit tonë "Në të dy rastet dëmi i kryer me dashje apo nga pakujdesia apo dëmi nga pakujdesia e lehte apo nga ajo e rënda do të merren parasysh nga gjykata për të caktuar shpërblimin. Shpërblimi do të jetë me i madh nëse dëmi është shkaktuar me dashje se sa nga pakujdesia. Shpërblimi dotë jetë më i madh për të dëmtuarin nëse dëmtuesi ka vepruar me pakujdesi të rënde se sa të ishte munduar të mënjanonte rrethanat etj." <sup>197</sup> Mbi pakujdesin e rëndë jurisprudenca e KC të GJL ka pranuar rastin kur një gazetë boton mbi një artikull me titullin "Durrës kapet banda e rreme e muzikantëve" fotografinë e artistëve të tjerë, që nuk i takonte lajmit.

II. Në ligjin nr. 8510/1999 përveç OAP i cili ka përgjegjësi në rastet e parashikuar në ligj për dëmin e shkaktuar kur ai vepron me faj është e rëndësishme të përcaktohet në hetim gjyqësor veprimet a mosveprimet me faj të atij që kanë sjellë pasojën e drejtpërdrejtë. Kështu në ligj dallohen rastet kur shteti mban përgjegjësi për veprimet me faj të punonjësit (neni 4), të organit që i ka deleguar kompetencat (neni 16), kur fajtor në ardhjen e pasojës ka qënë edhe një organ tjetër bashkërendues (14) etj. Në dy rastet e para OAP do të shkarkohet nga përgjegjësia duke ia kaluar atë përgjegjësve të vërtetë ose do mbaj përgjegjësi solidare me organin tjetër bashkëfajtor.

Përveç fajit të organit të administratës shtetërore njihet edhe faji i të dëmtuarit të cilën gjykata duhet ta marrë parasysh në vlerësimin e shpërblimit të dëmit përkatës real dhe në zbritjen e masës së dëmit që i ngarkohet OAP. Kjo parashikohet shprehimisht

<sup>192</sup> Neni 766 "Dhuruesi për mospërbushjen ose vonesën në dhurim, është përgjegjës vetëm për qëndrime të kryera me dashje ose me pakujdesi të rëndë".

<sup>193</sup> Neni 816§2 "Kur qiramarrësi nuk ka të drejtë kompensimi, vlefte e përmirësimeve mund të kompensojë dëmtimet që kanë ndodhur për pakujdesinë e rëndë të qiramarrësit".

<sup>194</sup> Neni 893 "Marrja në dorëzim pa rezervë e sendeve të transportuara duke paguar transportuesin për aq sa i takon, heq mundësinë për ngritje të padisë që rrjedh nga kontrata, përveç rastit të mashtrimit ose të pakujdesisë së rëndë të transportuesit".s

<sup>195</sup> Neni 998 "Kur sendi i lënë depozitë nuk është tërhequr në afatin e caktuar në kontratë ose pas lajmërimit që i ka bërë depozitari, ky nuk përgjigjet për humbjen ose dëmtimin e sendit që ngjan pas kalimit të afatit, përveç kur humbja ose dëmtimi është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e tij."

<sup>196</sup> Neni 1119 "Dhënia e informatave të pasakta në kërkesën ose në dokumentet e paraqitura, në bazë të të cilave është lidhur kontrata e sigurimit, ose lënia në harresë e informatave kur vërtetohet se nuk janë bërë me dashje ose nga pakujdesia e rëndë, nuk përbën shkak për zgjidhjen e kontratës, ..."

Neni 1143 "Siguruesi shkarkohet nga detyrimi për të paguar shpërblimin e sigurimit, në qoftë se rasti i sigurimit është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e të siguruarit ose e personit në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit.

Në sigurimin e pasurisë së personave, siguruesi shkarkohet nga detyrimi për të paguar shpërblimin e sigurimit edhe kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e anëtarëve madhorë të familjes së të siguruarit."

<sup>197</sup> Rezarta Mataj "Aspekte teorike dhe praktike mbi dëmin jopasuror dhe shpërblimin e tij në Republikën e Shqipërisë" Shkolla e Magjistraturës, Temë dipolome Tiranë. (2007) faqe 48.



tek neni 11§1 i ligjit nr. 8510/1999: *“Ne rast se, përveç veprimeve dhe mosveprimeve të organit të administratës shtetërore, në shkaktimin e demit kanë ndikuar edhe veprimet ose mosveprimet e të dëmtuarit, masa e dëmshpërblimit, që duhet të jepet, varet nga masa në të cilën demit është shkaktuar edhe nga i dëmtuari.”*

### 3.2.2 Përjashtimet nga përgjegjësia civile

I. Në Kodin Civil parashikohen rastet kur personi edhe pse ka sjell dëm nuk ka faj në ardhjen e tij. Në këtë rast i duhet të provoj se nuk ka vepruar me faj, në formën e dashjes apo të pakujdesisë, për ardhjen e saj.

Situata kur personi ka kryer një veprim të padrejtë, ka ardhur edhe demit për shkak të tij por, nuk mban përgjegjësi, paraqitet tek rasti i mbrojtjes së nevojshme.

Sipas nenit 611: *“Nuk është përgjegjës, ai që i shkakton dëm tjetrit për mbrojtjen e nevojshme të tij ose të një të treti.”* Kushtet e mbrojtjes së nevojshme e jep neni 19 i KP ku: *“Nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer veprën duke qenë i detyruar të mbrojë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tij ose të një tjetri, nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit me kusht që, karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit.”* E tillë është situata kur një person për të mbrojtur pasurinë a jetën e tij apo të një të treti i shkakton dëm një qytetari rastësor në ngjarje.

Ndryshe nga e drejta penale ku nevoja ekstreme është rast i papërgjegjshmërisë penale në të drejtën civile kjo njihet si rast përgjegjshmërie për çdo dëm të ardhur.

Në rast se gjykata e vlerëson sipas rrethanave që i dëmtuari nuk kishte mënyrë tjetër për ta shmangur mund ta shkarkoj atë totalisht ose pjesërisht nga përgjegjësia. Sipas nenit Neni 612 parashikohet se: *“Personi që ka shkaktuar dëmin duke qenë i shtrënguar nga nevoja për të shpëtuar veten ose të tjerët nga rreziku i atëçastëm i një demit të rëndë, rrezik i cili nuk ka qenë shkaktuar dhe as nuk mund të mënjanohej prej tij, detyrohet të shpërblejë dëmin. Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e posaçme të çështjes, mund ta shkarkojë plotësisht ose pjesërisht këtë person nga detyrimi i shpërblimit të demit.”* P.sh kur një shtetas në një zënkë në rrugë për të shmangur plagosjen e rëndë të tij nga një goditje me thikë e zbmpras atë dhe gërvisht automjetin e parkuar në rrugë. Në këtë rast i sulmuari nuk mban për gjegegjësi ndaj pronarit për dëmin material, gërvishtjen e makinës.

Ky rast është analog me rastin e nenit 20 të KP i cili parashikon se: *“Nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer veprën nga nevoja për të përballuar një rrezik real dhe të çastit që e kërcënon atë, një person tjetër apo pasurinë nga një dëmtim i rëndë dhe i pashmangshëm me mënyra të tjera, me kusht që të mos jetë i provokuar prej tij dhe demit i shkaktuar të mos jetë më i madh së demit i zbrapsur.”*

Mendojmë se, kjo dispozitë, neni 612 i KC, duhet riparë pasi në përmbajtje të saj duket se legjislatori kërkon ta paraqes më tepër si një rast kur gjykata duhet ta përjashtoj tërësisht nga përgjegjësia sesa ta konsideroj dëmtuesin si përgjegjës për dëmin e ardhur. Edhe në të drejtën penale, veprimet në kufijtë e mbrojtjes së nevojshme dhe ato të nevojës ekstreme passjellin padënueshmërinë e autorit, duke u barazuar me njëra-tjetrën këto dy raste. Vetë rrethanat e posaçme që parashikon neni 612 i KC, pra për të shpëtuar veten a të tjerët, nga një rrezik i papritur që nuk është shkaktuar prej tij dhe nuk kishte mënyrë të tjera për ta menjanuar nuk mund të çoj në përgjegjësi të shkaktuesit, përkundrazi gjykata duhet ta shkarkoj tërësisht atë.

Ky rregullim do harmonizohet edhe me nenet 613 deri 615 të KC ku edhe personat që nuk mbajnë përgjegjësi për fajin e tyre direkt si p.sh prindi, instruktori I automjetit, edukatori/mësuesi, mjeshtri etj. Këta shkarkohen nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga i mituri, nxënësi, çiraku etj. kur provojnë se demit nuk mund të ndalej me asnjë mënyrë tjetër.

Në legjislacione të tjerë si ai Italian, Francez etj. nevoja ekstreme është rast ku shkaktuesi i dëmit përjashtohet nga përgjegjësia civile.

**II.** Rast tjetër kur kemi përjashtim nga përgjegjësia jashtëkontraktore në Kodin Civil është kur shkaktuesi i dëmit është i pa zotë për të vepruar. Këtu bëhet ndarja mes të miturit nën moshën 14 vjeç dhe atij 14 vjeç deri 18 vjeç.

I mitur nën moshën 14 vjeç përjashtohet automatikisht nga përgjegjësia civile për dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar për shkak të papjekurisë së tij psikike, fizike dhe mos fitimit akoma të zotësisë për të vepruar. Ashtu si e drejta penale për krimet<sup>198</sup> edhe e drejta civile e ka përjashtuar nga deliktet.

Në nenin 613 të KC parashikohet se: *”I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç dhe personat që janë krejt të pazotë për të vepruar nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar.”* Kjo nuk do të thotë se të dëmtuarit nuk i shlyhet dëmi, pasi në këtë rast subjekti përjashtohet nga përgjegjësia jo se nuk ka faj por për shkak se ligji mbron personat e pazotë për të vepruar nën moshën 14 vjeç.

Megjithëse janë futur nën një titull *”Dëmi nga personat pa zotësi për të vepruar”* legjislatori ka përjashtuar nga përgjegjësia vetëm personat nën moshën 14 vjeç pa një ditë (që nuk i kanë mbushur moshën 14 vjeç) ndërsa personat mbi 14 vjeç mbajnë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar por, vetëm nëse kanë pasuri të tyre si p.sh të trashëguar apo janë të punësuar dhe nxjerrin të ardhura. Në rast se nuk plotësohet kushti i pasjes së pasurisë vetjake, përsëri jemi në të njëjtën situatë të nenit 612 të KC ku i mituri, 14 deri 18 vjeç do të përjashtohet nga përgjegjësia civile për shkak jo të moshës apriori por për shkak të mospasjes së kredive, pasurive.

**III.** Rast tjetër të përjashtimit nga përgjegjësia është dëmi i ardhur nga një rast faktor ose force madhore dhe nuk ishe e mundur të ndalohet nga asnjë person (as nga i dëmtuar, as dëmtuesi apo mbikëqyrësi i tij.) Ky rast nuk është i shprehur tekstualisht në Kodin Civil siç kemi rastin e mbrojtjes së nevojshme apo për të miturin por nxirret nga përjashtimet e neneve 613 deri 615 të KC ku përmbledhim:

- Prindërit, kujdestari ose ata të cilëve u janë besuar ose kanë në mbikëqyrje persona të pazotë për të vepruar, janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga veprimet e paligjshme të fëmijve nën moshën katërmbëdhjetë vjeç, të personave madhorë por që janë të pazotë për të vepruar përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.
- I mituri që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, përgjigjet për dëmin e paligjshëm të shkaktuar prej tij. Prindërit ose kujdestari përgjigjen për dëmin e mësipërm kur i mituri nuk nxjerr të ardhura nga puna ose nuk ka vetë pasuri, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.
- Mësuesit dhe personat e tjerë që kanë nën mbikëqyrje të mitur ose personat që u mësojnë të tjerëve një mjeshtëri ose profesion, janë përgjegjës për dëmin e paligjshëm të shkaktuar të tjerëve nga nxënësit ose personat që kanë nën mbikëqyrje, ose personat që mësojnë mjeshtëri apo profesion pranë tyre, të shkaktuar gjatë kohës që kanë qënë nën mbikëqyrje të tyre të drejtpërdrejtë, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.

**IV.** Juristët kanë evidentuar faktin se Kodi Civil ka nevojë për ndryshime në disa nene duke përfshirë edhe parashikimi i një neni mbi mospërgjegjësinë për shkak të forcave madhore apo rastit faktor. Mendojmë se me rast faktor referuar edhe Kodit Civil

<sup>198</sup> Neni 12- Moshë për përgjegjësi penale” *Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç.”*

francez dhe atij italian do kuptohen:1) rastet e paritura, fatkeqe (faut fateur) të cilat janë të befashme dhe të pamundura për tu ndaluar me çfardo lloj përpjekie ndërsa 2) forcat madhore përfshihen forcat e natyrës si ortek, rrebesh, përmbytje, tërmet, vullkan dhe ato të shkaktuara nga njeriu si kryengritje, protesta që pengojnë personin të realizoj një detyrë.<sup>199</sup> Pra pamundësia e ndalimit të shkaktimit të dëmit në tre nenet e mësipërme lidhet me një pamundësi fizike a mendore të çdo personi normal në një situatë konkrete që e bën atë (dëmtuesin) apo edhe çdo person tjetër (të dëmtuarin, një i tretë etj.) të pafuqishëm në ndalimin e ardhjes së dëmit.

Rast tjetër i cili mendoj se duhet të ishte përfshirë në rastet e përjashtimit nga përgjegjësia civile është ajo e parashikuar nga neni 616 i KC. Sipas këtij neni:” Për dëmin përgjigjet edhe personi që në momentin që e ka shkaktuar atë, nuk ka patur ndërgjegjien e veprimeve të tij.

Gjykata, mund të ulë masën e dëmshpërblimit, duke marrë parasysh moshën, shkallën e ndërgjegjes për veprimet e kryera, si dhe kushtet ekonomike të palëve, përveç kur për fajin e tij ka sjellë veten në këtë gjendje”. Në të drejtën penale, mospasja e ndërgjegjies për të kryer veprime paraqitet kur personi vuan nga ndonjë turbullim psikik ose neuropsikik dhe i pandehuri përjashtohet nga përgjegjësia penale (neni 17 i Kodit Penal). Sipas neni 10 të KC parashikohet se personit madhor për shkak të sëmundjes psikike a zhvillimit të metë mendor mund t’i hiqet ose kufizohet zotësia për të vepruar, kjo në varësi të shkallës së sëmundjes.

Ashtu siç është sot neni 616 i KC, duhet interpretohet në favor të palës me nivel më të ulët intelektualisht. Pra nëse provohet se në momentin e shkaktimit të dëmit, personi nuk ka ndërgjegjie për ngjarjen e ndodhur të mos ketë përgjegjësi për pasojat.

Mendoj se ky koncept i pasjes së ndërgjegjies për veprimet që kryhen, duhet riparë në koherencë edhe me parashikimet e shteteve të tjera si në Francë e Itali ku vlerësohet si person që nuk mban përgjegjësi civile për dëmin jashtëkontraktor të kryer në këtë gjendje dhe për të përgjigjet prindi, kujdestari ligjor etj.<sup>200</sup>

### 3.2.3 Llojet e përgjegjësive jashtëkontraktore:

Në Shqipëri, nisur nga përcaktimet e neneve 613 deri 625 të Kodit Civil mund të themi se dallojmë këto lloj përgjegjësish<sup>201</sup>:

#### 1. Nisur nga subjekti që shkakton dëmin dallojmë:

- Përgjegjësi e shkaktuesit të dëmit si p.sh përgjegjësi për dëmin jopasuror (neni 625), përgjegjësi për mjedisin (neni 623) etj.<sup>202</sup>;

<sup>199</sup> Rezarta Mataj “Rishikimi i dispozitave të dëmit jashtëkontraktor, kërkesë e kohës.” Jeta Juridike, nr. 1, Mars 2015 faqe 100.

<sup>200</sup> Po aty faqe

<sup>201</sup> Shih më tej Rezarta Mataj “Rishikimi i dispozitave të dëmit jashtëkontraktor, kërkesë e kohës.” Jeta Juridike, nr. 1, Mars 2015 faqe 99.

<sup>202</sup> Po aty autore Rezarta Mataj shprehet se:”Tipik është rasti i dëmit në mjedis ku personi mban përgjegjësi civile dhe/ose penale për të njëjtin fakt të kryer. Si vepra penale kundër mjedisit në nenet 201-207 në Kodin Penal parashikohen ndotja e ajrit, ujit, peshkimi i ndaluar, prerja e paligjshme e pyjeve, pemëve dekorative, frutor, transportimi i lëndëve toksike, shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor etj. Të dëmtuarit nga mjedisi si pronari, përdoruesi, shteti kanë të drejtë të kërkojnë dëmtuesit të dëmshpërblejë në natyrë me mbjellje të reja, blerje fidanësh, shtimin e rasantit të peshkut, heqjen e mbeturinave toksike ose kompensoj në të holla.

Për përgjegjësinë civile mjafton të provohet elementët e kërkuar nga ligji pra të jetë dëmtuar mjedisi, të jetë gjendur personi dëmtues, të ekzistoj lidhja shkakë-pasojë e të mos jetë në një nga rastet e përjashtimit nga përgjegjësia civile. Këto elementë nuk kërkojnë provimin e fajsisë së i dëmtuari ka kryer një nga veprat penale kundër mjedisit.”

- përgjegjësi nga jo shkaktuesi i dëmit si p.sh kujdestari ligjor/ gjyqësor për të mitur dhe personat e pazotë për të vepruar, përgjegjësia për personat nën mbikqyrje p.sh prindi për fëmijën, i përfaqësuar për përfaqësuesin, kujdestari për të pazotin për të vepruar, punëdhënësi për punëmarrësin, instruktori për praktikantin, mjeshtri për çirakun etj. Apo përgjegjësi për sendet, kafshët që i ke nën vëzhgim, nën drejtim (përgjegjësi ndaj kafshëve, nga ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme, përgjegjësia për ndërtimet, ndërtesat etj.) .  
Kur flitet për mbikqyrje nuk duhet kuptuar ngushtësisht që t'i kesh përpara syve por edhe në rast se kafsha, i mituri largohet apo edhe humbet dhe ka qënë nën kujdesin tënd si pronar i kafshës apo si kujdestar ligjor i fëmijës, mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar.<sup>203</sup>
- 2. Duke u nisur nga faji i kryerjes së dëmit përgjegjësia jashtëkontraktore e ndajmë:
  - Përgjegjësi me faj direkt: përgjegjësia për mjedisin, përgjegjësia për dëmin jopasuror etj. përgjegjësia për produktin, për publikime mashtroese, për konkurrencë të pandershme.;
  - Përgjegjësi pa faj direkt ose me faj të prezumuar (për fajin e të tretëve, për sendet dhe kafshët si p.sh dëm i shkaktuar nga personi që ke nën kujdestari a mbikqyrje, nga kafshët etj. Në vendimin nr. 414/2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë rezultoi se shtetasit T.P, F.B, Q.G, N.SH, S.A, M.SH, F. G., trashëgimtar të të ndjerës H.G, vranë nga pakujdesia gjatë një operacioni policor i kundërdrejtohen Policisë së Qarkut Fier të shpërlejnë dëmet pasurore e jo pasurore të ardhura nga vrasja e nënës nga punonjësi i policisë A.K.
  - Përgjegjësia strikte ose për shkak të ligjit, nuk ka faj në ardhjen e pasojës por mban përgjegjësi për pasojën e ardhur si rezultat i veprimtarive të rrezikshme apo ndërtimeve që sjellin rrezikshmëri të vazhdueshme për banuesit apo fqinjët e saj.

### 3.2.3.1 Përgjegjësia me faj direkt

Në dëmet jashtëkontraktore që të mbaj përgjegjësi personi që ka kryer veprimin a mosveprimin si rregull duhet të jetë me faj. Pra, personi që shkakton dëmin nëse nuk provon që ka vepruar pa faj do mbaj përgjegjësi. Megjithatë ndryshe nga e drejta penale ku përgjegjësia ka karakter subjektiv pra lidhet me dëshirën a pakujdesinë e autorit në ardhjen e faktit kriminal, në të drejtën civile përgjegjësia ka karakter objektiv dhe subjektiv. Pra qëllimi i ligjit është se ku ka dëm duhet të rivendoset e drejta dhe të dëmshpërblehet i dëmtuari. Këtu mund të mbaj përgjegjësi për dëmin e shkaktuar edhe një person i cili nuk ka ndonjë qëndrim psikik mbi ardhjen e pasojave: dashje apo pakujdesi porse mban përgjegjësi pasi ligji e parashikon si të tillë.

Përgjegjësia me faj pati një evoluim të domodoshëm deri sot në përgjegjësia për veprime të të tjerëve dhe sendeve të veçanta. Sipas Prof. Gerard Légier po të kishte mbetur përgjegjësia civile nga dëmet jashtëkontraktore vetëm tek domosdoshmëria e provimit të fajësisë shumë të dëmtuar do të mbeteshin të pa dëmshpërblyer.<sup>204</sup> Si një doktrinë e ndërmjetme u zhvillua ajo e prezumimit të fajit që u elaborua në France përpara se të konsolidohej teoria e riskut dhe e garancisë për fajin.

Teoria e prezumimit të fajit ngarkon me faj çdo person i cili ka për detyrë që të mbikqyrë një send, kafshë apo një person ku nga mungesa e kësaj, shkaktohet dëmi jashtëkontraktor, p.sh mësuesi mban përgjegjësi për nxënësin duke konsideruar si përgjegjësi të prezumuar të fajit pasi po të kujdesej siç duhej nxënësi nuk do të kishte

<sup>203</sup> Geneviève Légier, “*Le obligations (Detyrimet)*” Botimet Papirus, Tiranë (2009), faqe 142.

<sup>204</sup> Po aty faqe 128.

kryer faktin e paligjshëm.<sup>205</sup> Kjo teori ka ekzistuar vonë si në Francë ashtu edhe në Gjermani<sup>206</sup> deri sa zhvillimi industrial solli lloje të reja përgjegjësish ku duhej shpërbleheshin edhe dëme të cilat merreshin përsipër jo se në mes ekzistonte faji por se ishin veprimtari të rrezikshme apo për ti dhënë një garanci të dëmtuarve nga kompani që kishin fitime kolosale.<sup>207</sup>

Sipas prof. Légier, në fund të shekullit XIX u krijua teoria që i takjnë përgjegjësishë pa faj ose për fajin e të tretit konkretisht:

- teoria e riskut e mbështetur nga juristët e famshëm në Francë, Raymond Saleilles<sup>208</sup> dhe Louiss Josserand ku u pranua që personi që ushtron një aktivitet me veprimtari të rrezikshme ose me përfitime ekonomike do të përgjigjet për dëmin që kjo veprimtari u shkatton të tretëve. Ky ishte një interpretim i gjërë që të dy këto dy teoricien i bënë nenit 1384§1 i Kodit Civil Francez.

-Teoria e garancisë e trajtuar nga Boris Starck mbështet idenë se shteti duhet të garantoj jo vetëm të drejtat kushtetuese të individit por edhe të garantoj të drejtën për tu shpërblyer në rast se dikush me faj ose jo i shkel apo i cënon ato<sup>209</sup> p.sh prodhuesit e cigareve duhet të garantojnë se cënimi i jetës apo i shëndetit të përdoruesve do të shpërblehet nga ata për çdo dëm të shkaktuar nga duhani.

Në këtë mënyrë përgjegjësishë pa faj e kemi rënditur:

- Përgjegjësi me faj të prezumuar e cila ndahet në përgjegjësishë me faj të prezumuar për veprimet e tjetrit (vicarious liability) dhe përgjegjësishë për sendet apo kafshët nën përgjegjësi, mbikqyrje.
- Përgjegjësi strikte ose për shkak të ligjit.

### 3.2.3.2 Përgjegjësia jashtëkontraktore me faj të prezumuar për veprimet e tjetrit

Në linjë të teorive të mësipërme, po e vërtetojmë se për cilët dëme sipas Kodit tonë Civil, personat që nuk kanë shkaktuar dëmin prezumohen se mbajnë përgjegjësi. Në të gjitha këto raste i takon palës së paditur, shkaktuesit të dëmit që të rrëzojnë prezumimin se nuk kanë pasur faj në ardhjen e pasojës.

Konkretisht mund të themi se mbajnë përgjegjësi:

Prindërit, kujdestari përgjigjen për dëmin e padrejtë të shkaktuar të tretit nga fëmija e tyre nën moshën 14 vjeç por edhe në moshën 14 deri 18 vjeç kur nuk kanë pasuri apo të ardhura nga puna (neni 613, 614 të KC).

Në lidhje me përgjegjësishë e prindit ndaj fëmijës, në Francë me vendimin datë 24 prill 1989 si dhe në vendimin datë 19 shkurt 1997 (vendimi Samda) të Dhomës së dytë Civile të Gjykatës së Kasacionit, u përcaktua se në rast se prindërit jetojnë të ndarë (të shkurorëzuar, të veçuar etj.) mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga fëmija, prindi ku ai jeton në kohën e dëmit. Pra në momentin kur bashkëjetesa mes fëmijës e

<sup>205</sup> Po aty 128.

<sup>206</sup> Prof. Dr. Ardian Nuni, "E drejta e Biznesit -Për Fakultetin e Ekonomisë" Tiranë (2012), faqe 648. Prof. Nuni përmend shkollën Pandektiste që mbizotëron në shekullin XIX në Gjermani ku pranonte se punëdhënësi nuk mban përgjegjësi për punëmarrësin por mban përgjegjësi për fajin e tij si punëdhënësi që kishte zgjedhur atë punëmarrës apo nuk e kishte mbikqyrur. Në këtë mënyrë shmangej frika se duke mbajtur përgjegjësi punëdhënësi për punëmarrësin mund të dëmtohej biznesi i madh apo i vogël.

<sup>207</sup> G. Légier, "Le obligations (Detyrimet)" Botimet Papyrus, Tiranë (2009), faqe 129, 130.

<sup>208</sup> R."Saleilles *Essai d'une Théorie générale de la responsabilité civile*", Paris 1947

<sup>209</sup> André Tunct "A little-noticed theory in the law of tort: Boris Starck's theory of guaranty", University of Pennsylvania Law Review, Vol. 121:618, faqe 623.

njërit prind ndërpritet edhe përkujdesia intensive ndaj fëmijës ndërpritet prandaj prindi nuk mund t'i ngarkohet përgjegjësia për dëmin e shkaktuar larg tij.<sup>210</sup>

- Personi që i është besuar ose ka në mbikëqyrje persona të pazotë për të vepruar, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga veprimet e paligjshme të fëmijëve nën moshën katërbëdhjetë vjeç.
- Mësuesit, edukatorët, dadot, mjeshtrit që mësojnë një profesion janë përgjegjës për dëmin shkaktuar të tjerëve nga nxënësit ose personat që kanë nën mbikëqyrje, të shkaktuar gjatë kohës që kanë qënë nën mbikëqyrje të tyre të drejtpërdrejtë. (neni 614).
- Punëdhënësi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve për fajin e punonjësve që janë në shërbim të tij, gjatë ushtrimit të detyrave që u janë besuar prej tij (neni 618). Duhet të bëjme kujdes se në rastin e personi juridik nuk themi se është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga organet e tij në kryerjen e detyrave të tyre (neni 618) por mban përgjegjësi për veprimet e kryera prej tij drejtpërdrejtë. Organet e personit juridik si person i krijuar nga ligji nuk mund të konsiderohen si persona të tretë apo përfaqësues.
- I përfaqësuari mban përgjegjësi për veprimet e përfaqësuesit brenda ushtrimit të tagreve të pushtetit (neni 620).

### 3.2.3.3 Përgjegjësia jashtëkontraktore me faj të prezumuar për sendet dhe kafshët që janë nën përgjegjësi

Një tjetër lloj përgjegjësie jashtëkontraktore pa faj është edhe ajo e përgjegjësisë për për sende, kafshë nën pronësinë, mbikëqyrjen e personit që përgjigjet për dëmin që ato kryejnë, ku këtu përfshihen rastet:

- Pronari ose mbajtësi i kafshës është përgjegjës për dëmin e shkaktuar gjatë kohës që e ka nën kontroll sjelljen e kafshëve (neni 621).
- Pronari i një ndërtese ose i një ndërtimi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve, nga të metat që lidhet me ndërtimin ose me mirëmbajtjen e tij (neni 623<sup>211</sup>). Në fakt ka shtete të cilat e konsiderojnë ndërtimin si një përgjegjësi pa faj dhe për shkak të ligjit. Ndërtimi është objekt me rrezikshmëri pasi mos ndërtimi brenda parametrave passjell shkatërrim të sigurt nga përmbytjet, tërmetet, rrëshqitje të dherave etj. dhe si pasojë sjell pasoja katastrofike në jetën, shëndetin e njërzve, pasuritë e tyre etj. Në Kodin tonë Civil kjo përgjegjësi nuk trajtohet si e tillë pasi neni 623 i jep të drejtën pronarit të ndërtesës, ndërtimit që të shkarkoj përgjegjësinë tek çdo i tretë për faj të të cilit ka ardhur dëmi i shkaktuar.<sup>212</sup>

### 3.2.3.4 Përgjegjësia jashtëkontraktore pa faj, për shkak të ligjit (strict liability)

Përgjegjësi të tilla janë pothuaj objektive pasi shkaktuesi i dëmit nuk shkarkohet nga përgjegjësia edhe pse nuk ka pasur asnjë lloj faji në ardhjen e pasojave por për shkak të mjeteve që ai përdor apo veprimtarisë, përbën rrezik për të tretët. Kjo lloj përgjegjësie

<sup>210</sup> R. Mataj “Rishikimi i dispozitave të dëmit jashtëkontraktor, kërkesë e kohës.” Jeta Juridike, nr. 1, Mars 2015 faqe 103.

<sup>211</sup> Neni 623” Pronari i një ndërtese ose i një ndërtimi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga të metat e çdo ves tjetër që ka lidhje me ndërtimin ose me mirëmbajtjen e tyre. Por pronari i ndërtesës ose i ndërtimit ka të drejtë t’u kërkojë personave përgjegjës ndaj tij, të shpërblejnë dëmet që ka pësuar.”

<sup>212</sup> Neni 623§2 “Por pronari i ndërtesës ose i ndërtimit ka të drejtë t’u kërkojë personave përgjegjës ndaj tij, të shpërblejnë dëmet që ka pësuar”

është një përgjegjësi e cila vjen bazuar në teorinë moderne të riskut pra persona të cilët kanë përfitime dhe sjellin risk të tretëve apo përdorin sende që janë potencialisht të rrezikshme për jetën, shëndetin dhe pasurinë e të tretit domosdoshmërisht do mbahet përgjegjësi për to. Në këto lloj përgjegjësi përfshihen:

- Përgjegjësinë e personit që kryen një veprimtari me natyrë të rrezikshme ose sendet e përdorura janë të dëmshme për personat e tjerë.  
Nisur nga natyra e sendeve përmendim: automjetet, makineritë, energjia e elektrike, helmet, eksplozivët etj. Nisur nga veprimtaria e rrezikshme konsiderohen: prodhimi i energjisë nga centrale atomike, përdorimi i eksplozivëve apo substancave toksike për prodhim të lëndëve të tjera, shpimet e puseve të naftës<sup>213</sup>, transportimi i lëndëve djegëse shpërthyes si gaz etj.  
Autori detyrohet të shpërblejë dëmin, përveç kur provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit (neni 622).  
Në vendimin nr. 1259 datë 26 mars 2015 të GJASHK I-rë Tiranë, mbi padinë e familjarëve të një prej viktimave të shpërthimit të fabrikës së demontimit në Gërdec Vorë, gjykata e vlerësoi përgjegjësinë e Ministrisë të Mbrojtjes pa faj duke arsyetuar: *“Veprimtaria e demilitarizimit dhe demontimit të municioneve luftarake, sikurse edhe ajo e prodhimit, transportimit, depozitimit dhe përdorimit të tyre, janë veprimtari ekstremisht të rrezikshme, që përfaqësojnë gjendjet klasike të burimit të rrezikut të shtuar. Për këtë arsye, ushtrimi dhe mbikqyrja e veprimtarisë nga të paditurit për transferimin, transportimin, depozitimin, demontimin e municioneve luftarake, si dhe ajo për depozitimin e barutit dhe lëndëve të tjera shpërthyes të mbetura nga ky proces teknologjik, përbëjnë një veprimtari burimi rreziku të shtuar, gjë që sipas nenit 622 të Kodit Civil, passjell vetvetiu përgjegjësinë objektive të autoriteteve shtetërore dhe të personave të autorizuar prej tyre, për cfaredo lloj dëmi të shkaktuar nga një veprimtari e tillë.”*
- Përgjegjësia e prodhuesit për produktet difektoze ose me të meta që tregton<sup>214</sup>. Në SHBA prodhimi i produkteve difektoze është po aq e rrezikshme për të tretët sa edhe një person që ushtron një aktivitet të rrezikshëm të cilët u njihet e drejta për tu çliruar vetëm nga një Act of God (forcë madhore)<sup>215</sup>, ndërhyrje e paparashikuar e një personi të tretë etj.
- Përgjegjësia për dëmin shkaktuar mjedisit dhe të tretëve ose siç quhen ndryshe përgjegjësia për dëmet ekologjike. Të gjithë shtetet antarë të Bashkimit Evropian e kanë njohur këtë lloj përgjegjësi sipas direktivës 2004/35/EC “Mbi përgjegjësinë e mjedisit”. Ajo konsiderohet si një përgjegjësi pa faj, strikte dhe ngarkohen të gjitha shtetet antare ta rëndisin si një lloj përgjegjësi të tillë kur dëmi në mjedis shkaktohet nga veprimtari ose sende të rrezikshme si p.sh <sup>216</sup> transporti me gazsjellës. Në këtë kontekst, një rast shumë i mire do ishte të ngrihej padi nga komuniteti i zonës së Gërdecit dhe fshatrave përteth në të cilën janë dëmtuar flora, fauna, pjelloria e tokës etj. nga shpërthimi i eksplozivëve që në vitin 2008.

<sup>213</sup> Michel Fromont “Sistemet e huaja më të mëdha të të drejtës”, Papirus Tiranë (2009), Faqe 131.

<sup>214</sup> Sipas nenit 630 produkte difektoze janë:” Një send quhet se është me të meta kur nuk jep sigurinë që pritet prej tij, duke patur parasysh gjithë rrethanat e në veçanti:

a) paraqitjen e produktit;

b) përdorimin e arsyeshëm që pritet prej produktit;

c) kohën e vënies në qarkullim të produktit.

Produkti nuk mund të quhet se është me të meta duke u nisur nga fakti se një produkt më i perfeksionuar është vënë në qarkullim me vonë se ai.”

<sup>215</sup> Michel Fromont “Sistemet e huaja më të mëdha të të drejtës”, Papirus Tiranë (2009), Faqe 131.

<sup>216</sup> [http://ecologic.eu/sites/files/neës/2015/efface\\_directive\\_2004\\_35\\_ec\\_on\\_environmental\\_liability.pdf](http://ecologic.eu/sites/files/neës/2015/efface_directive_2004_35_ec_on_environmental_liability.pdf)

### 3.3 Lidhja shkakësore

Lidhja shkakësore është ajo pa të cilin nuk vjen dëmi tek i dëmtuari. Pra mund të ketë dëm por për të lidhur veprimin a mosveprimin e padrejtë me dëmin e shkaktuar duhet të ketë një lidhje të drejtëpërdrejtë dhe determinante në ardhjen e pasojës ose siç jemi shprehur: *”në mënyrë figurative në zinxhirin që lidh faktin e paligjshëm dhe dëmin të mos ketë as një hallkë të këputur.”*<sup>217</sup>

Ekzistojnë dy teori mbi lidhjen shkakësore sipas prof. Légier ajo e teorisë së ekuivalencës së kushteve dhe teoria e shkakut adekuat. E para ka të bëjë me çdo ngjarje që është kusht për dëmin dhe detyrohet autori i ngjarjes të shpërblejë dëmin plotësisht.<sup>218</sup>

Tek kjo teori është bazuar edhe parimi i njohur, “Eggshell skull” ose e krisjes së lëvozhgës së vezës, në tort law (e drejta e përgjegjësive jashtëkontraktore) që vepron në vendet e Common Law si Britani e Madhe, SHBA, Australi etj. Ky parim nënkupton se çfarëdo lloj dëmi që i shkaktohet të dëmtuarit, edhe pse ai është aq delikat nga natyra si lëvozhga e vezës, përgjegjësi detyrohet të shpërblejë të gjitha dëmet e ardhura pavarësisht se në dëm ka kontribuar edhe faktor të tjerë që i përkasin të dëmtuarit.

Në këto vende janë të njohura çështjet ku është mbajtur përgjegjësi tërësisht kur puntori digjet në buzë, nga një ngarkesë që ra nga vinçi dhe vdes nga kanceri në lëkurë pas tre vitesh (djegia u konsiderua si stimulues i përhapjes së kancerit)<sup>219</sup>, kur një nxënës humbi këmbën për shkak të goditjes nga shoku i klasës në pulpë, në kohën që po rrëshqiste në korridor të shkollës,<sup>220</sup> një i sëmurë kronik kardiak pëson një aksident automobilistik dhe pas gjashtë ditësh vdes për shkak të një ataku kardiak. Drejtuesi i automjetit tjetër mbajti përgjegjësi pasi ishte shkak i cili i solli atakun kardiak përfundimtar<sup>221</sup> kur për shkak të një dëmtimi të pakujdesshëm në shpatull nga rënia e mallrave në një dyqan, gruaja myslimane detyrohet të pres flokët e saj të gjatë pasi nuk kujdeset dot nga dhimbja e kokës që pësoi. Për shkak se nuk mori pelqimin e bashkëshortit, martesë u prish sipas zakonit islam. Depresioni që pësoi paditësja nga kjo situatë, iu ngarku pronarit të dyqanit si fajtor për sëmundjen duke u shpërblyer me 90 000 dollar australian.<sup>222</sup>

Ndërsa teoria e dytë konsideron si shkak adekuat (të duhur) ngjarjen e cila në rrjedhjen e natyrshme të ngjarjeve passjell dëmin.<sup>223</sup> Si ilustrim merret rasti kur pronari i një automjeti harron çelësin në kuadër dhe një person e vjedh dhe shkakton aksident me pasojë vdekjen e këmbësorit. Karshi këmbësorit sipas teorisë së parë mban përgjegjësi edhe pronari i automjetit. Ndërsa sipas teorisë së dytë, pronari i automjetit nuk ishte shkak determinant në ardhjen e pasojës.

Sipas nenit 609 të KC parashikohet se: *”Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtëpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit. Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjeluar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar.”*

<sup>217</sup> Rezarta Mataj, *“Temë diplomë-Aspekte teorike dhe praktike mbi dëmin jopasuror dhe shpërblimin e tij në Republikën e Shqipërisë”* Tiranë :Shkolla e Magjistraturës, (2007) faqe 49.

<sup>218</sup> Légier G., *“Le obligations (Detyrimet)”* Botimet Papirus, Tiranë (2009), faqe 158.

<sup>219</sup> Çështja Smith kundër Leech Brain & Co në Britaninë e Madhe.

<sup>220</sup> Çështja Vosburg kundër Putney, Gjykata Federale e Winsconit.

<sup>221</sup> Çështja Benn kundër Thomas, SHBA (1994) <https://freelawschooloutlines.wordpress.com/11-case-briefs/torts-spring-case-briefs/>

<sup>222</sup> Çështja Kavanagh kundër Akhtar, Sidney Australi (1998).

<sup>223</sup> Po aty faqe 158.



Kur themi i *drejtëpërdrejtë* nuk duhet nënkuptuar se dëmi i takon vetëm personit që i është kundërtuar shkak i paligjshëm si p.sh personit ndaj të cilit është kryer shpifja, personi i plagosur në një aksident etj. por mes veprimit apo mosveprimit dhe dëmit jopasuror të mos ketë faktor të tjerë ndërhyrës që ndërpresin procesin e vazhdueshëm, shkak –pasoje.<sup>224</sup> Si shembull merret rasti kur një mjek paditet nga pacientja e tij për neglizhencë në diagnostikimin e saktë të sëmundjes dhe efektet dytësore të barnave që ka përdorur, mjeku nuk mund të mbaj përgjegjësi kur dëmi i ardhur ishte si rezultat afatit të skadencës së barnave të përdorura nga pacientja. Dëmi i ardhur (efektet dytësore) nuk janë pasojë e drejtëpërdrejtë e veprimit të mjekut, por janë pasojë e pakujdesisë së farmacistit dhe të vetë pacientit në kontrollimin e afatit të skadencës së barnave.

Po ashtu kur themi i *menjëhershëm* nuk duhet nënkuptuar se dëmi duhet të jetë i dukshëm dhe atëçastshëm pasi ndodh që nga një dëm primar si p.sh nga shndërrimi në një tetraplegjik të përhershëm nga aksidenti, të vijë pasoja të tjerë të mëvonshme si dëm biologjik psiqik etj. Në këtë rast dëmi edhe pse ka ardhur shumë më vonë dhe jo aty për aty, shkakuesi i dëmit do të mbaj përgjegjësi edhe për këtë lloj dëmi të pësuar p.sh paranojë, skizofreni etj. pasi po të mos ndodhte aksidenti, personi nuk do të shëndërrohej në tetraplegjik dhe si rrjedhim nuk do të pësonte sëmundjen psiqike si rezultat i kësaj gjëndje të padurueshme nga i dëmtuari. Kjo shkon në harmoni edhe parimin që udhëheq *ius aquiliana* (e drejta deliktore) që i dëmtuari duhet të shpërblehet plotësisht njësoj sikur dëmi të mos ketë ndodhur (*restitutio in integrum*).

Siç shikohet edhe nga interpretim, ne kemi mbështetur teorinë adekuate të lidhjes shkakësore ose e thënë sipas Kodit tonë kërkohet një lidhje të drejtëpërdrejtë dhe të menjëhershme mes veprimit a mosveprimit të dëmtuesit pra edhe nëse ka disa faktor që kanë ndikuar në ardhjen e pasojës kërkohet për shkakun përcaktues në ardhjen e saj. Shkaqet e tjera si p.sh sjellja me faj e vetë të dëmtuarit etj. mund të ndikojnë në uljen e masës së shpërblimit të dëmit nga ana e vetë dëmtuesit.

Sipas vendimin nr. 12/2007 të kB të GJL lidhjen shkakësor e kemi dy llojesh: materiale dhe juridike. Kështu KB interpretojnë se:

- *Lidhja shkakësore materiale vërtëton së cili është personi përgjegjës (subjekti aktiv) dhe lidhja shkak-pasoje ndërmjet tre elementëve objektive e subjektive të faktit të paligjshëm (ngjarjes së dëmit): sjelljes së paligjshme (objektiv) e me faj (subjektiv) dhe pasojës së ardhur prej tyre, pra dëmtimit të një tjetri në personin a pasurine e tij (objektiv). Në këtë rast zbatohet parimi juridik *condicio sine qua non*, sipas të cilit, ardhja e pasojës së dëmshme nuk do të vërtëtohej nëse nuk do të kishte ndodhur shkak, sjellja e paligjshme dhe me faj e personit përgjegjës për shkaktimin e dëmit.*

- *ndërsa, lidhja shkakësore juridike vërtëton lidhjen shkak-pasoje ndërmjet faktit të paligjshëm në tërësinë e tij dhe cenimeve konkrete të pesuara në të drejta dhe interesa të ligjshme, si të subjektit pasiv mbi të cilin ka vepruar direkt ky fakt i paligjshëm, ashtu edhe të personave të tjere që rezultojnë të dëmtuar si rrjedhojë e pasojave që pranohet së vijne normalisht e zakonisht nga i njëjti fakt të paligjshëm, sipas parimeve të rregullshmerisë dhe efijçences së lidhjes shkakësore (*id quod plerumque accidit*).”*

Mund të themi se ky lloj interpretimi rrit mundësinë për t’u shpërblyer edhe persona të cilët janë dëmtuar nga sjellja e padrejtë, e paligjshme e shkakuesit të dëmit si në pasuri ashtu edhe në të mirat jopasurore. Në zbatim të nenit 609 të K.Civil për pranimin e përgjegjesisë civile jashtëkontraktore, duhet të vërtetohet lidhja shkakësore materiale ndërmjet sjelljes (veprimit a mosveprimit) së paligjshme e me faj dhe dëmit

<sup>224</sup> Rezarta Mataj, “*Temë dipolome-Aspekte teorike dhe praktike mbi dëmin jopasuror dhe shpërblimin e tij në Republikën e Shqipërisë*” Tiranë :Shkolla e Magjistraturës, (2007) faqe 50.

të shkaktuar. Në vijim, për përcaktimin e dëmtimeve (cënimeve) konkrete që rrjedhin nga ky fakt i paligjshëm dhe caktimin e dëmshperblimit përkates, duhet të vërtetohet edhe lidhja shkakësore juridike ndërmjet tyre.

Në varësi të llojit të përgjegjësisë me faj ose jo në përgjegjësinë civile jashtëkontraktore konkludojmë se në përgjegjësinë pa faj lidhja shkakësore ka karakter objektiv, pra mjafton që të vijë dëmi i shkaktuar, për paditësin e dëmtuar nuk ka ndonjë detyrim për të provuar nëse dëmtuesi veprimi me faj apo pa faj, duke kryer një veprim të ligjshme ose jo. Këtë qëndrim ka mbajur edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i cili në vendimin nr. 70/2010 shprehet se: “*Nuk ka asnjë rëndësi, në kuptim të zbatimit të ligjit, nëse veprimet a mosveprimet e të paditurit janë ose jo të kundërligjshme apo nëse, janë kryer me faj prej tij. Nuk ka asnjë rëndësi, në kuptim të zbatimit të ligjit, nëse ndaj të paditurit është vendosur mosfillimi i procedimit penal në lidhje me ngjarjen. Nuk ka asnjë rëndësi, në kuptim të zbatimit të ligjit, nëse moti ishte i keq, nëse avaria në motor ishte e papritur e të tjera rrethana e motive ku janë bazuar gjykatat e faktit. Këto rrethana nuk janë nga ato që, sipas ligjit, përjashtojnë personin që ushtron veprimtari të rrezikshme nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar.*”

Ndërsa në përgjegjësinë me faj kërkohet të cilësohet se cili formë dhe shkallë faji ka ndikuar në ardhjen e pasojës mes faktit të paligjshëm dhe dëmit të ardhur. Këtu përgjegjësia është subjektive njësoj si në të drejtën penale apo tek detyrimet kontraktore.

Sipas Prof.Galgano “...për të përcaktuar nëse dëmi është pasojë e shkakut veprim apo mosveprim i dëmtuesit përdoret i ashtëquajtur i rregullim statistikor , nëse mbi bazën e një probabiliteti mund të shfaqet kjo pasojë e paevitueshme dhe e parashikueshme.Shkaqet determinante duhen dalluar nga shkaqet e tjera rastësore të thjeshta.”<sup>225</sup> Pra, në rast se pasoja ka ardhur nga disa veprime apo mosveprime njëkohësisht atëherë do të përcaktohet nëpërmjet mendimit edhe të ekspertëve por edhe me një vlerësim logjik të vetë gjykatës se cili ka qënë veprimi apo mosveprimi përcaktues, determinant në ardhjen e pasojës.

### 3.4 Pasoja, dëmi i ardhur

Nuk do të kemi përgjegjësi jashtëkontraktore kur tek i treti nuk ka ardhur asnjë dëm. Imagjinoni sikur një person në gjëndje të dehur nën drejtimin e automjetit, shkel rregullat e qarkullimit rrugor, pasi është vonë në një takim pune dhe si pasojë godet një motorçiklist i cili bie në anë të një lumi. Rezulton se as motori dhe as motorçiklisti nuk kanë dëme të shkaktuar. Nga pikëpamja penale, personi mund të mbaj përgjegjësi për drejtim të automjetit në gjëndje të dehur e parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, ku si ndëshkim administrativ dhe dënim penal plotësues mund t’i hiqet edhe leja e drejtimit të automjetit, porse nga pikëpamja civile nuk ka asnjë përgjegjësi pasi nuk ka dëm edhe pse ishin të tre elementët e tjerë të nenit 609 të KC pra: shkak i paligjshëm, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor referuar Kodit Rrugor dhe drejtimi i automjetit në gjëndje të dehur referuar Kodit Penal, nuk jemi në kushtet e shkarkimit të përgjegjësisë pa faj, ka një lidhje shkakësore mes këtij veprimi të padrejtë të qëllimshëm dhe mundësisë për të ardhur pasoja materiale apo jo pasurore. Mungon elementi kryesor pasoja në shëndetin, jetën apo në pasuri që për arsye të tjera si manovrimi në kohë i shoferit, shmangia e zgjuar e motorçiklistit, kaska mbrojtëse e motorçiklistit etj. nuk erdhën.

<sup>225</sup> Francesco Galgano, “E drejta private”, Tiranë, Shtëpia Botuese “Luarasi” botimi i parë 1999, faqe 361.

Dëmi është një humbje apo pakësim i pasurisë, shëndetit fizik a psikik, psikologjik, reputacionit dhe emrit etj. Nisur edhe nga interpretimi i nenit 608 por edhe të neneve 640 dhe 625 të KC pasoja e ardhur cënon pasurinë dhe personin.

Në rast se kemi dëmtim a humbje të pasurisë ajo përbën dëm pasuror. Këtu përfshihen humbja e pësuar dhe fitimi i munguar dhe çdo lloj shpenzimi tjetër të kryer nga i dëmtuari menjëherë pas ndodhjes së veprimit a mosveprimit të padrejtë por edhe në vijimësi.<sup>226</sup> KB të GJL kanë sqaruar në vendimin nr. 12/2007 se si humbja e pësuar dhe fitimi i munguar janë një dëm pasuror që pëson i dëmtuari duke u shprehur se” *Lidhur me demin pasuror, nenet 486 dhe 640 të K.Civil dallojnë humbjen e pësuar nga pakesimi i pasurisë, që njihet si demi aktual apo demi emergjent (damnum emergens) dhe fitimin e munguar (lucrum cessans). Në parim, dallimi ndërmjet demit emergjent (quantum mihi abest) dhe fitimit të munguar (quantum lucrari potui), qëndron në aktualitetin ose jo të interesit pasuror të cenuar. Në rastin e pare objekt i demit është pakesimi, humbja e një interesi pasuror aktual, pra e një pasurie që i perket (in re ipsa) të demtuarit në çastin e shkakimit të demit. Në rastin e fitimit të munguar kemi të bëjmë me pamundesinë e përfitimit të një interesi pasuror të ardhshëm, pra të një pasurie që ende nuk i perket të demtuarit në çastin e shkakimit të demit.”*

Në lidhje me fitimin e munguar, ai bazohet kur provohet dëmi real që ka pësuar pala e dëmtuar dhe jo si një retorikë sa herë kërkohet shpërblim dëmi. Në vendimin nr. 72 datë 27 janar 2014, Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë ka rrëzuar padinë e Shoqërisë A....Shqipëri shpk ndaj degës së Dogonave Shkodër për shkak të bllokimit të aktiviteti për një vit për shkak të një borxhi doganor të pashlyer me arsyetimin se:” *Pala paditëse ka patur detyrimin ligjor që në bazë të nenit 640 të Kodit Civil të provonte më parë ekzistencën e demit pasuror dhe më pas të kërkonte fitimin e munguar mbi këtë dëm. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër duke detyruar palën e paditur Degën e Doganës Shkodër t’i shpërblejë paditësit Shoqëria A...-Shqipëri sh.p.k demin në vlerën 258.318.389 lekë, që në fakt përbën vetëm fitimin e munguar të pretenduar nga shoqëria, nuk ka argumentuar se cili ishte dëmi real pasuror që i është shkaktuar shoqërisë.”<sup>227</sup>*

Ndërsa në lidhje me demin jopasuror do kuptojmë çdo humbje pra një pasuri që nuk e ke më dhe dëmtim pra një pasuri që i është pakësuar vlëra por që mund të rekuperohet dhe të kthehet si më parë në shëndet, në ndër dhe reputacion, në jetën private etj.<sup>228</sup> Madje edhe kujtimi i një të vdekuri bashkëshort ose afërm deri në shkallë të dytë (gjyshja-nip, vëllezër-motra dhe lidhjet me fëmijet respektiv të tyre) përbën një të drejtë jopasurore. Ja si e përkufizojnë KB të GJL këtë dëm: “*Demi jopasuror, i parashikuar në nenin 625 të Kodit Civil, si një kategori e gjere dhe gjithëpërfshirëse e dëmeve jashtëkontraktore, përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cënimi i të drejtave dhe*

<sup>226</sup> Neni 640 “Dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar.

*Shpërblehen gjithashtu shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur ose pakësuar demin, ato që kanë qenë të nevojshme për të përcaktuar përgjegjësinë dhe masën e demit, si dhe shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore.”*

<sup>227</sup> Vendimi nr. 72 datë 27 janar 2014 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.

<sup>228</sup> Neni 625 :” *Personi që pëson një dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet kur:*

- a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij;
- b) është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij;
- c) është cenuar e drejta e emrit;
- ç) është cenuar respektimi i jetës private;
- d) është cenuar kujtimi i një të vdekuri. Në këtë rast bashkëshorti i personit të vdekur ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë mund të kërkojnë shpërblimin e demit jopasuror.”

*interesave jopasurore që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut dhe që nuk janë subjekt vleresimi të drejtperdrejte ekonomik ne treg.*"<sup>229</sup>

Në Francë dëmet që pësohet nga një shkak i paligjshëm, i padrejtë ndahet në 1) dëm material e cila përfshin tërësisht pasurinë efektive dhe atë të ardhshme; 2) dëmtimin e paprekshmërisë fizike ose dëm trupor i cili ndahet në dëm ekonomik që vjen nga dëmi trupor p.sh pamundësia për të sjellë të njëjtat të ardhura që sillte si i punësuar apo nga ndonjë përfitim tjetër, ose shpenzimet mjeksore që kryen për dëmin e ardhur, shpenzimet e varrimit në rast vdekje etj. dhe dëm jo material për shkak të dëmit trupor ku ndahet në: dëm i lidhur me dhimbjen fizike (*pretium doloris*), dëmi estetik dhe dëmi i ushtrimit<sup>230</sup> që nënkupton pamundësi për të gëzur jetën, për të ushtruar një art, një sport etj. 3) dëmi moral i cili ndahet në dëme që rrjedhin nga nderi, jeta private apo e drejtë e personalitetit si dhe dëmi afektiv për shkak të vdekjes apo degradimit të një të afërmi.<sup>231</sup>

Ndërsa në Shqipëri, evidentimi i llojeve të tëra që mund të pësoj i dëmtuari dhe të afërmit e tij (viktima indirekte) dhe masa dhe mënyrat e shpërblimit të tyre u konsoliduan dukshëm në praktikë pas vendimit unifikues të KB të GJL nr. 12/2007. Më së shumti bëhet fjalë për dëmin jopasuror pasi dëmi pasuror është i qartë për vetë parashikimin konkret që ka bërë Kodi Civil si për dëmit kontraktore<sup>232</sup> ashtu edhe për dëmet jashtëkontraktore.<sup>233</sup>

Si lloje dëmsh jo pasurore në Shqipëri njihen dëmi moral, dëmi ekzistencial dhe dëmi biologjik, por edhe çdo lloj dëmi tjetër i cili cënon të drejta, vlera apo liri të njohura nga rendi juridik apo zakone të mira.

KB të GJL në vendimin e sipërcituar kanë unifikuar konceptet si:

- Dëmtimi i shëndetit (dëmi biologjik) përbën, në thelb, cënimin e së mires së shëndetit, të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut. Ky dëm jopasuror, i parashikuar nga shkronja "a" e nenit 625 të Kodit Civil, është objekt kërkimi dhe dëmshperblimi i pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore të pësuar nga i demtuari për shkak të të njëjtit fakt të paligjshëm.
- **Dëmi moral** (*pretium doloris* ose *pecunia doloris*) është shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejte (*non iure perturbatio*) të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm. Cilido që pëson cënime në sferën e shëndetit dhe të personalitetit të tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj të një të treti ka të drejtën të kërkojë edhe dëmshperblimin e dëmit moral të pësuar.
- **Dëmi ekzistencial** i shkaktuar nga fakti i paligjshëm i të tretit cënon të drejtat e personalitetit të njeriut duke dëmtuar thuasë në mënyre të përhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e perditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkeqësim të cilesisë së jetës nga ndryshimi dhe

<sup>229</sup> Vendimi nr. 12 datë 14 shtator 2007, çështja Yska, Alidmadhi, Baliqi kundër Byrosë Shqiptare të Sigurimit.

<sup>230</sup> Atë çfarë në Shqipëri njihet si dëm ekzistencial.

<sup>231</sup> Shih G. Légier, "Le obligations (Detyrimet)" Botimet Papyrus, Tiranë (2009), faqe 131,132.

<sup>232</sup> Neni 486 "Dëmi që duhet të shpërblehet nga debitori për mosekzekutimin e detyrimit përbëhet nga të gjitha humbjet e pësuar nga pakësimi i pasurisë, si dhe fitimi që mund të nxirret në kushtet e zakonshme të tregut (fitimi i munguar). Bëjnë pjesë në shpërblimin për riparimin e dëmit edhe shpenzimet e arsyeshme e të nevojshme për të parandaluar ose për të pakësuar dëmin, që kanë lidhje me rrethanat mbi të cilat bazohet përgjegjësia e palës, shpenzimet e arsyeshme e të nevojshme për të përcaktuar dëmin dhe përgjegjësinë, si dhe ato që janë nevojitur për të gjetur një zgjidhje jashtë gjyqësore të përmbushjes së detyrimit."

<sup>233</sup> Neni 640 i Kodit Civil.

prishja e ekuilibrit, sjelljes së zakoneve të jetes, të marredhenieve personale e familjare.

Ajo çfarë vlen për tu përmëndur është se dëmi është një kriter objektiv për llojin dhe masën e tij i dëmtuari/të dëmtuarit duhet të provojnë atë çfarë kanë humbur dhe pësuar. Përrjashtim bën vetëm dëmi moral i cili prezumohet se çdo person e pëson në rastin e vdekjes a dëmtimit të një të afërmi përson një turbullim psiqik, dhimbje për humbjen e të afërmit të tij deri sa nuk provohet nga i padituri se ky dëm nuk është pësuar nga i dëmtuari/ët.

Një lloj dëmi i cili u fut në legjislacionin e tërë vendeve të BE pas mbyjtes se anijes Erika është **dëmi ekologjik**. Me 12 dhjetor 1999, anija çisternë Erika IV, malteze u fundos në brigjet e Britanisë (Brittany coast) në Francë. Sipas vendimit të datës 25 Shtator 2012 të Gjykatës së Kasacionit Francez pronari i anijes u detyrua të dëmshpërblej 203.8 milion euro nga ku 165.4 mllion për dëm pasuror, 34.1 milion për dëm moral dhe 4.3 milion dëm mjedisor (ekologjik). Për Francën ky ishte hera e parë që njihej ky lloj dëmi. Legjitimohet për ta kërkuar çdo autoritet lokal ku flora, fauna, mjedisi dhe ekosistemi i së cilit është dëmtuar nga ndotja e naftës në det po ashtu legjitimohet të ngrejë padi edhe organizatat jofitimprurese mjedisore.<sup>234</sup>

Të tre këto lloj dëmësh jopasurore janë analizuar nga GJASH I-rë Tiranë në vendimin nr. 1954 datë 26 mars 2015 mbi pretendimet e prindërve, motrës dhe vëllait për vdekjen e E.D me datë 15 mars 2008 nga shpëthimi në Gërdec. Palët e paditura Ministria e Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave, Shoqëritë “Albademil” shpk dhe “MEICO”shpk detyrohen të shpërblejnë solidarisht dëmin e shkaktuar paditësave.

---

<sup>234</sup> [http://www.crpm.org/pub/docs/402\\_tp\\_cpmr-\\_erika.pdf](http://www.crpm.org/pub/docs/402_tp_cpmr-_erika.pdf) , akses 26 janar 2016.

## Pjesa e II-te

### 3.5 Llojet e dëmeve në përgjegjësinë jashtëkontraktore të OAP

Duke qënë se edhe vetë ligji parashikon se për çfarë i takon përgjegjësisë jashtëkontraktore, rregullat, parimet e Kodit Civil vlejnë edhe për rastin e OAP përkundrejt dëmeve jashtëkontraktore të qytetarëve. Megjithatë, për ta fokusuar objektin e studimit, do të trajtojmë në mënyrë të veçantë figurat e dëmeve që hasim në administratën publike në rastin e kësaj përgjegjësie jashtëkontraktore.

Nisur edhe nga hierarkia e normave sipas nenit 116 të Kushtetutës, fillimisht po trajtojmë llojet e dëmeve që ka parashikuar neni 14 KPRA i 1999. Për kujtesë ky nen parashikon se: *“Organet e administratës publike dhe punonjësit e tyre mbajnë përgjegjësi për dëmet që iu shkaktojnë personave privatë nëpërmjet:*

- marrjes së vendimeve të paligjshme;
- refuzimit të paligjshëm për të marrë vendime;
- dhënies së informacioneve shkrese të pasakta për personat privatë, si për çdo shkak apo rast tjetër të parashikuar me ligj.”

Ndërsa neni 15 i KPRA i Ri (28 maj 2016), parashikon në mënyrë të zgjeruar parimin e përgjegjësisë pra: *“Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin përkatës.”*

Në ligjin e vetëm të posaçëm për këtë lloj përgjegjësie, nr. 8510/1999 si raste ku OASH mban përgjegjësi për dëmet jashtëkontraktuale që i shkakton personave fizik dhe juridik privatë janë të parashikuar në nenin 3 të saj:

- a) *“kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme;*
- b) *kur kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, por që sjellin dëmtimin e interesave të ligjshme të personave fizike a juridike private;*
- c) *kur, megjithëse kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, u shkaktojnë një dëm të pabarabartë subjekteve të cilëve u drejtohet ky veprim a mosveprim;*
- ç) *kur, për shkak të mosfunksionimit të mjeteve teknike me të cilat organet e administratës shtetërore ushtrojnë veprimtarinë e tyre, persona fizike a juridike private cenohen në interesat e tyre të ligjshme;*
- d) *kur u shkaktojnë një rrezik të vazhdueshëm personave fizike a juridike private”*
- dh) *kur kryejnë një akt korruptiv gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Duket së dy rastet e para që parashikon si ligji nr. 8510/1999 dhe KPRA e 1999 kanë përsëritur njëra-tjetrën. Në fakt nuk është ashtu. Tek rasti i parë i KPRA së vjetër mbahej përgjegjësi për dëme të ardhura nga vendime të paligjshme të OAP ndërsa ligji i posaçëm parashikon dëmet e ardhura nga veprime a mosveprime të kundërligjshme.

Pra, njëra flet për vendime, tjetri për veprime a mosveprime pra ligji i posaçëm paraqitet më i zgjeruar. Në nenin 2 pika 8 e ligjit nr. 49/2012 por edhe tek ligji nr.44/2015 mbi Kodin e Procedurave Administrative parashikohen veprime të tjera administrative që nënkupton se jo çdo veprim a mosveprim i administratës mund të konkludohet me një vendimarrje. Veprimi mund të shfaqet me akte të tjera administrative si me heshtje, me kthim-përgjigje, me një udhëzim gojor etj.<sup>235</sup>

<sup>235</sup> Neni 2 pika 8 e ligjit nr. 49/2012 *“Veprim tjetër administrativ” është çdo formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik, në kryerjen e funksionit publik dhe që nuk plotëson kushtet për të qenë akt administrativ apo kontratë dhe që krijon pasojë juridike mbi të drejtat subjektive apo interesat e ligjshëm.”*

Neni 3 pika 11 I ligjit nr. 44/2015 *“11. “Veprim tjetër administrativ” është çdo formë e njëanshme e*

Po ashtu kemi paligjshmëri dhe kundërligjshmëri që i kemi trajtuar me detaj më sipër prandaj themi se këto janë raste që nuk paraqiten të njëjta dhe do shtjellohen në veçanti.

Në përmbledhje të këtyre dy legjislacioneve<sup>236</sup> që parashikon në detaj përgjegjësinë jashtëkontraktore të administratës shtetërore themi se kemi tjetër raste të përmendura kur mbahet përgjegjësi për dëmet që vijnë tek privatët. Kjo listë nuk është shteruese për sa kohë që e drejta për tu dëmshpërblyer dhe për tu rehabilituar është e drejtë themelore dhe gjen mbrojtje në çdo rast sipas nenit 44 të Kushtetutës.

Rast i veçantë për tu trajtuar është edhe përgjegjësia e shtetit dhe organeve konkrete të administratës për të shpërblyer në mënyrë të drejtë personat që shpronësohen për interesa publik. Sipas nenit 41 të Kushtetutës, personit të shpronësuar për mosmarrëveshje në lidhje me masën e shpërblimit ka të drejtë t'i ankohet gjykatës.<sup>237</sup>

Në çështjen me nr. 277 datë 30.11.2016 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mbi padinë e katër antarëve të familjes Podgorica ndaj Bashkisë Tiranë për shpërblim të dëmit për shkak të pamundësisë së kthimit fizik të truallit prej 1320m<sup>2</sup> të njohur nga KKK ish Pronarëve Bashkia Tiranë u shpreh se: *“Kolegji Civil referuar asaj që ka rezultuar në këtë gjykim si dhe parashikimeve kushtetuese dhe ligjore çmon, se procedura e shpronësimit duhet të bëhet nga pala e paditur Bashkia Tiranë me ligj dhe kundrejt një shpërblimi të drejtë, referuar edhe ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private”, që në rastin në shqyrtim nuk rezulton të jetë ndjekur.”*

Në këto kushte, Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi të dy vendimet e gjykatave më të ulëta duke i njohur si shpërblim shumë prej 36.510, 681 lekë për dëmin e shkaktuar nga Bashkia Tiranë për mospërdorim të sendit të njohur dhe kthyer, pasi mbi të janë ndërtuar blloqe banimi (shpronësim faktik).

### 3.5.1 Raporti mes përgjegjësive së administratës shtetërore dhe nëpunësve të tyre.

Organet e Administratës Publike duke qënë persona juridik (jo frymor) të gjithë funksionimin e tyre e realizojnë nëpërmjet punonjësve të tyre. Lind pyetja si mund të ndahet përgjegjësia kur nëpunësi ka vepruar në tejkallim të kompetencave të tij duke sjell pasoje tek qytetari.

Në Shqipëri si në KPRA aktual<sup>238</sup> dhe ai KPRA<sup>239</sup> që ka hyrë në fuqi në 28 maj 2016 parashikohet se përgjegjësia është e organeve të administratës publike por edhe e nëpunësve të tyre.

---

*veprimtarisë së organit publik në ushtrimin e funksioneve të tij publike, që nuk plotëson kriteret për të qënë akt administrativ apo kontratë”*

<sup>236</sup> Paçka që KPRA i 1999 është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 44/2015, KPRA i Ri, i referohemi këtij Kodi për trajtime teorike të formave të njohura në legjislacion, jurisprudencë, doktrinë etj. të përgjegjësive jashtëkontraktore të OAP karshi personave.

<sup>237</sup> Neni 41 *“...3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.*

*4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.*

*5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.”*

<sup>238</sup> Neni 14- Parim i përgjegjshmërisë *“Organet e administratës publike dhe punonjësit e tyre mbajnë përgjegjësi për dëmet që iu shkaktojnë personave privatë ...”*

<sup>239</sup> Neni 15- Parimi i përgjegjësive *“Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktajnë palëve, në përputhje me legjislacionin përkatës.”*

Po ti referohemi nenit 44 të Kushtetutës ashtu edhe nenit të parë të ligji 8510/1999 parashikon se përgjegjësia primare dhe e drejtëpërdrejtë shkon tek administrata shtetërore/publike dhe organet e saj për çdo lloj dëmi të shkaktuar personit. Kjo lloj përgjegjësie me faj të prezumuar njihet edhe në nenin 618 të Kodit Civil, ku parashikohet se punëdhënësi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve për fajin e punonjësve që janë në shërbim të tij, gjatë ushtrimit të detyrave që u janë besuar prej tij (neni 618).

Ndërsa si përjashtim ligji nr. 8510/1999 specifikon situatën se kur punonjësi i saj mban përgjegjësi karshi qytetarit për dëmin e shkaktuar. Kështu në nenin 4 të këtij ligji parashikohet përgjegjësia vetjake e punonjësve të organeve të administratës shtetërore: *”Në ushtrimin e funksioneve shtetërore, punonjësit e organeve të administratës shtetërore nuk përgjigjen për dëmet shkaktuar personave fizike a juridike private në rastet e parashikuara në nenin 3.”*<sup>240</sup>

*Punonjësit e organeve të administratës shtetërore, përjashtimisht, përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizike a juridike private, kur vërtetohet se ata kane vepruar me keqbesim.*

*Ne rastet e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, organi shtetëror punëdhënës, pasi dëmshpërblen palën e dëmtuar, ka të drejtë të kërkojë nga punonjësi fajtor kthimin e shpërblimit që ka paguar”.*

Pra, rezulton se punonjësi mban përgjegjësi përjashtimisht kur dëmi ka ardhur gjatë kohës së ushtrimit të detyrës dhe ky ka vepruar me keqbesim. Në këtë rast përsëri si i paditur del organi i administratës publike/shtetërore karshi personit fizik, juridik të dëmtuar ndërsa i njihet e drejta OAP që të kërkoj me padi punonjësit të saj atë çfarë ka paguar të dëmtuarit. Mund të themi se shteti duhet të dal si mbrojtës i interesave të publikut dhe jo shkelës dhe dëmtues i tyre. Kjo justifikon edhe parashikimin ligjor në Shqipëri sesi i paditur paraqitet gjithmonë OAP dhe nëse dëmi ka ardhur nga veprimi a mosveprimi me keqbesim i punonjësit të tij. Shteti ka të drejtë t’i kërkoj punonjësit të tij, me padi kthimi atë çfarë ka paguar tek i dëmtuari.

E ilustron me një rast tw praktikws, familjarët e viktimës të vdekur si rezultat i dhunës së paligjshme të punonjësit e policisë, ngrënë padi për shpërblim dëmi jopasuror ndaj Drejtorisë së policisë së Qarkut Korçë. Në dy shkallë e para të gjykimit është rrëzuar padia me arsyetimin se OAP nuk ka legjitimitet pasiv sipas nenit 618 § 1 i Kodit Civil por është përgjegjësia e punonjësit. Gjykata e Lartë ka kthyer çështjen për rishqyrtim duke orientuar gjykatën e shkallës së parë që interpretimi i nenit 618/1 të Kodit Civil duhet të behet në harmoni me nenin 4 të ligjit nr.8510, date 15.07.1999 *“Për përgjegjësine jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”*, ku termi i perdorur në këtë ligj *“organ i administratës shtetërore”* përfshihet brenda konceptit *“të punëdhënësit”* në kuptim të nenit 618/1 të Kodit Civil.<sup>241</sup>

Rast tjetër është përgjegjësia për shkakimin e një paralize parciale të shtetasit P.L si rezultati i dhunës së ushtruar nga tre punonjësit e policisë në ambjentet e Komisarariatit të Shkodrës. Me vendim të formës së prerë, punonjësit janë dënuar përkatësisht me nga dy vjet burgim për *“Shkelja e rregullave të shoqërimit”* neni 44§2 të Kodi Penal Ushtarak. Padia administrative dhe civile u rrëzua si e parashkuar.<sup>242</sup>

<sup>240</sup> Neni 3 është neni i cili parashikon rastet e përgjegjësive jashtëkontraktore, të listuara në pikën 2 të këtij punimi”Llojet e përgjegjësive jashtëkontraktore të administratës në Shqipëri”.

<sup>241</sup> Vendimi nr. 307 datë 23.03. 2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të R.Shqipërisë .

<sup>242</sup> Vendimi nr. 5194 datë 15.06.2009 të Gjykatës Së Rrethit Gjyqësor Tiranë .



### 3.5.2. Dëmet për shkak të vendimeve të paligjshme

Siç thotë edhe Prof.Asoc.Dr Eralda Çani<sup>243</sup> ky lloj dëmi është ndër më klasikët dhe parashikohet si një rast kur administrata mban përgjegjësi për dëmet e shkaktuar ndryshe nga rastet e tjera që janë më tepër raste të parashikuar pas vitit 2000 kur hyri në fuqi KPRA i 1999. Dëmet për shkak të vendimeve të paligjshme të administratës janë rastet më të shpeshta të jurisprudenës kur një OAP mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar individit. Neni 109 i KPRA i 2016 parashikon si akte administrative të paligjshme nëse:

- a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;
- b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;
- c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;
- ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas nenit 4§2 të këtij Kodi;
- d) është në kundërshtim me ligjin material;
- dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme;
- e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Kur flasim për dëme nga vendime të paligjshme këtu duhet sqaruar nga vendime si absolutisht të pavlefshme apo vendime relativisht të pavlefshme kur kërkohet të rregullohen pasojat nga pala e dëmtuar. Kjo formë e dëmit jashtëkontraktor duhet dalluar nga rasti i dëmeve që vijnë nga veprime a mosveprime të kundërligjshme të OASH (shih ligjin nr. 8510/1999, neni 3§ “a”).

Vlerësojme se kemi të bëjme me formë të ndryshme pasi tek akti administrativ i pavlefshëm, organi administrativ vepron në bazë të një vendimi konkret të marrë, i kaluar në një procedurë administrative, ku palës që iu është drejtuar ka pasur të drejtë të jetë aktiv në këtë procedurë, të ndjekë rekursin administrativ por nga një kontroll gjyqësor apo nga një kontroll i brëndshëm administrativ rezulton se është i paligjshëm.

Ndërsa rasti kur organi administrativ vepron ose jo në kundërshtim me ligjin është jo domosdoshmërisht i formalizuar me një vendimarrje por kryesisht është një veprim a mosveprim arbitrar i OAP të cilët veprojnë direkt duke i mohuar a çenuar të drejtën subjektive individit pa pasur një “pjekie” institucionale të situatës.

Në mbështetje të kësaj ndarje dhe për të mos i konfunduar, edhe vetë Kushtetuta në nenin 44 të saj, i ka rënditur si të veçanta pra: “...në rast se është dëmtuar për shkak të një akti<sup>244</sup>, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.”

Ilustrojmë me dy raste konkrete të praktikës gjyqësore: Shoqëria MR.I. Shpk si paditës dhe ndërhyrësja dytësore në favor të kësaj pale Administratorja e saj L.K padit Inspektoriatin Kombëtar i Ndertimit INUK (Drejtorja e Policise se ndertimit), Inspektoriati Ndertimor i Qarkut Tirane (Policia e Ndertimit - Dega Tirane, Ministria e Puneve Publike Transportit dhe Telekomuni -kacionit për shperblim i demit pasuror shkaktuar nga veprimet e paligjshme te Policise se Ndertimit, Dega Tirane. Gjykata e Apelit Tiranë<sup>245</sup> e gjen të drejtë këtë vendimi me arsyetimin se: “pala e paditur nuk ka paraqitur asnjë provë që të vërtetojë se prishjen e objektit të palës paditëse e ka bërë

<sup>243</sup> E.Çani “ Non-contractual administrative responsibility as a means to better redress juridical and physical persons interests and better address public interests. Reforms needed to the Albanian legislation and European standards”, www.academia.edu.

<sup>244</sup> Nënkupto akt administrativ, e cila në vetvete përbën vendimarrje të organit administrativ.

<sup>245</sup> Vendimi nr. 193 datë 19 shkurt 2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

në respektim të dispozitave ligjore që e lejojnë kryejen e këtij veprimi. Konkretisht nuk ka paraqitur asnjë fakt për verifikimin e kundravajtjes administrative të ndërtimit pa leje të palës paditëse, mbajtjen e proces verbalit të konstatimit të kundravajtjes administrative të komunikuar palës paditëse dhe së fundi vendimin e organit për prishjen e objektit. Këto kërkesa janë parashikuar në ligjin 8408 /1998 "Për Policine e Ndërtimit", dhe ligjin 7697/1993 "Për Kundravajtjet e Administrative".

Ndërsa rasti kur një OAP ka sjell dëme si rezultat i një vendimi të paligjshëm ilustruhet me vendimin e Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ku detyroi Komunën Shëngjin të dëmshpërblej monetarisht paditësin P.M për shkak se i kishin prishur ndërtimin dy katësh prej druri me aktivitet "Bar-Restorant" e ndërtuar me leje në fshatin Kunë Lezhë. Ky ndërtim u prish në bazë të një akti administrativ të INUV Komuna Shëngjin i cili me vendimin nr. 249 datë 17.05.2013 të Gjykatës së Apelit Shkoder u shpall absolutisht i pavlefshëm.<sup>246</sup>

Rregullisht si vendime të paligjshme që legjitimojnë palët për të kërkuar shpërblim të dëmit janë vendime gjyqësor apo të një organi më të lartë administrativ i cili ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ. Për ilustrim sjellim padinë e shoqërisë "A." shpk ndaj Ministrisë së Financave pasi është shkaktuar një dëm pasuror dhe jo pasuror në shumën 60 milion lekë nga akti administrativ i revokimit të lejes së ushtrimit të veprimtarisë së lojrave të fatit meqënëse ky akt administrativ u anulua me vendim gjyqësor si i paligjshëm.<sup>247</sup>

### 3.5.3 Dëmet për shkak të veprimeve a mosveprime të kundërligjshme

Për veprime a mosveprime të paligjshme të OAP (neni 3§ "a" e ligjit nr. 8510/ 1999) janë pranuar nga Gjykatat paditë për: dëmin e shkaktuar një furre buke nga Bashkia Tiranë, si rezultat i hapjes nga pakujdesia të portave të liqenit artificial duke i dëmtuar të gjitha makineritë dhe pajisjet e furrës<sup>248</sup>, humbjen e biletave (vajtje –ardhje) të linjës së avionit Shqipëri- Romë-Kubë për shkak se punonjësia e aeroportit Shtetëror të Tiranës "Nënë Tereza", i ndaloi të katër udhëtarët për shkaqe të pajustificuara<sup>249</sup>, revokimin e paligjshëm nga Ministrisia e Financave të lejes së ushtrimit të veprimtarisë në lojrat e fatit për një afat tre vjeçar për shkak të punimeve jo cilësore të shoqërisë tregtare A., për dëm pasuror nga refuzimi i lidhjes së kontratave të sipërmarrjes nga Posta Shqiptare sh.a.,<sup>250</sup> prishje të ndërtimit dhe shpronësim pa shpërblim dhe në mungesë të një procedure nga organet përkatëse.<sup>251</sup>

Konstatohet në praktikë se rasti më i përhapur i padive për veprime a mosveprime të kundërligjshme është ai i shpronësimeve publike të organeve lokale pa u ndjekur procedura nga Këshilli i Ministrave sipas Ligjit Nr.8561, date 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik". Në këto raste pronarit i zaptohet prona private pa shpërblim ndërsa organet lokale kanë filluar ndërtimin e një vepër publike si trotuar, rrugë etj.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër në çështjen mes paditësit B.R ndaj Komunës Velipojë është shprehur se: " ... veprimet e pales së paditur Komuna Velipojë për zbatimin e projektit të zgjerimit të rrugës publike nr.9 Plazh Velipojë kanë krijuar një situatë faktike, si pasojë e të cilës paditësit rezultojnë të kenë pësuar humbje

<sup>246</sup> Vendimi nr. 837 datë 30 dhjetor 2014 i Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Shkodër.

<sup>247</sup> Vendimi nr 1082 datë 06.07.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

<sup>248</sup> Vendimi nr. 923 datë 06.02.2008 të Gjykatës Së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>249</sup> Vendimi nr. 3855 datë 29.04.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>250</sup> Vendimi nr. 310 datë 01.07.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

<sup>251</sup> Vendimi nr. 1856/29.02.2008 të Gjykatës Së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

*në pasurine e tyre, humbje kjo e parikuperuar financiarisht për shkak të mosrespektimit të procedurave ligjore, mungese procedure kjo, që e ka vene në pamundesi paditesit të parashitrojnë, e kërkojnë dhe me e rendeshmja te ushtrojne të drejtat e ankimit të njohura nga ligji. Po kështu, në situaten e krijuar, është e pamundur që demi efektiv i shkaktuar paditesit të ndreqet në mënyrë të drejtperdrejte duke iu kthyer sipërfaqja e transformuar në pronë publike (rrugë+trotuar), me sipërfaqe 143.0m2.”<sup>252</sup>*

Në çështjen Z.D etj. (trashëgimtar të fëmijës S.D) të vrarë nga shpërthimi në Fabrikën e Demontimit në Gërdec, Gykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në vendimin nr. 1594 datë 26 mars 2015 e konsideron tipike veprimtari të rrezikshme përdorimi i mjeteve luftarake dhe municioneve, demonitimi i tyre prandaj ajo duhej të mbikqyrej nga forcat e armatosura nën përgjegjësinë e organit epror, Ministrit të Mbrojtjes. Në këtë vendim Gjykata shprehet mbi mënyrën e mosveprimit të organit shtetëror, konkretisht të Ministrisë së Mbrojtjes:” *Po kështu në këtë proces nuk u zbatuan parashikimet ligjore, të cilat e rregullonin atë dhe nuk u kryen veprimet e zakonshme që e shoqërojnë një aktivitet kaq të rrezikshëm. Me mosveprimet apo me veprimet e tyre, pjesëmarrësit në këtë aktivitet kanë bërë që të kryhej një aktivitet ku ishin të punësuar njerëz të pamësuar dhe të patrajnuar, të cilëve nuk u ishte bërë e qartë mënyra se si të përdornin municionin, nuk ishin të pajisur me veshje speciale, jashte kushteve teknike të sigurisë duke e vënë në rrezik jetën e tyre. Përbërësit e nxjerrë nga procesi i çmontimit vazhdonin të përbënin rrezik, e aq më tepër që ky rrezik sa vinte e shtoej në gjëndjen në të cilën ato ndodheshin mbas procesit dhe kushtet ku vendoseshin. Përveç moszbatimit të VKM nr. 138, datë 14.03.2007 në lidhje me llojin e kalibrave të municioneve, pasi në këtë vendim është parashikuar çmontimi dhe çmilitarizimi vetëm i kalibrave të vegjël (kalibrat deri në 14.5 mm referuar kontratës së parë të lidhur ndërmjet “SAC inc” sh.p.k, dhe MEICO), janë konstatuar nga gjykata edhe (1) Mosrespektimi i vendit të realizimit të procesit të çmontimit dhe çmilitarizimit të municioneve, (2) Mosrespektimi i rregullave për ruajtjen e ambientit, ku realizohej ky proces, (3) Mosrespektimi i rregullave të distancës së vendit nga qendrat e banuara ku realizohet një proces i tillë.”*

#### **3.5.4 Dëmet për refuzim të paligjshëm për të marrë vendime**

Administrata publike vepron me vendime, veprime apo edhe mosveprime etj. Mund të ndodhe që një qytetar i drejtohet OP për të disponuar me vendim në favor të interesave të tij dhe organi refuzon për të disponuar paçka se ka detyrimin për të marrë vendimi qoftë pozitiv ose jo. Zakonisht sipas KPRA i Ri, koha që OP duhet të marrë vendim është brënda 30 ditëve nga momenti kur është regjistruar kërkesa e personit të interesuar. Në rast se nuk është marrë një vendim brënda këtij afati, konsiderohet si refuzim për të marrë vendimin dhe e legjitimon palën për të ndjekur rekursin administrativ nëse ka ose edhe për t’iu drejtuar gjykatës.

Në vendimin nr. 6440 datë 21.12.2015 të GJASH I-rë Tiranë shtetasi H.GJ në vitin 1977 është strehuar nga ana e ish Komitetit Ekzekutiv Tiranë, një dhomë me sipërfaqe prej 30 m2. Sipas kontrates së privatizimit date 02.12.1993, e lidhur ndërmjet tij dhe NK Banesa ka fituar pronësinë mbi këtë sipërfaqe për të cilën ka edhe çertifikatë pronësie të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë më datë 09.04.2014. Po sipas pretendimeve te tij, në vitin 1982 ka ndërtuar edhe një shtesë prej

<sup>252</sup> Vendimi nr. 377 datë 11 maj 2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

84 m<sup>2</sup>. Shtesa prej 84 m<sup>2</sup> dhe 300 m<sup>2</sup>, në përdorim të paditësit janë ende të parregjistruar në ZVRPP Tiranë, ndërkohë që trualli në fjalë është pronë shtetërore.

Me datë 10.11.2006 paditësi ka aplikuar për legalizimin e shtesës sipas Ligjit 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin urbanizimin, dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Me vendimin Nr.1134, datë 18.11.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e pronësise së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale” është vendosur që paditësit ti kaloj në pronësi sipërfaqja ndërtimore 60.37.<sup>253</sup>

Me datë 05.02.2014 me VKM nr.122 “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës)” është vendosur që H.GJ i është shpronësuar një sipërfaqe toke truall prej 30 m<sup>2</sup>, me çmimin 69,285 lekë/m<sup>2</sup> në total shpërblimi për truallin është 2,078,550 lekë. Paditësi pretendon që të ishte shpronësuar edhe për sipërfaqen e futur në legalizim pasi që nga vitit 2006 e deri në 2015 nuk ka qënë faji i tij pse organet administrative kompetente nuk kanë marrë vendim. Po të ishte marrë vendimi në kohë, ai do të ishte pronar i ligjshëm e do të ishte shpronësuar për tërë pronën që faktikisht ai nuk posedon nga shpronësimi.

Pas një korrespondence institucionale mes Avokatit të Popullit dhe ALUIZNI Tiranë për trajtimin korrekt të praktikës së legalizimit të H.Gj, rezulton se nuk gjëndeje më ndërtimi informal në gusht 2015 (e prishur nga Autoriteti Rrugor Shqiptar pasi po ndërtohej Unaza e Madhe e Tiranës) e për këtë arsye është përjashtuar H.Gj nga procesi i legalizimit. Ndërsa më parë sipas palës së paditur nuk është bërë legalizimi pasi duke qënë objekt i cili ndodhet një një projekt ndërtimi rruge publike përjashtohet me VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, pavarësisht se për këtë vetdeklarues H.Gj është kryer verifikimi i objektit, është përgatitur materiali për kalimin e pronësisë dhe subjekti ka kryer pagesën e tarifës së shërbimit, taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe penalitetin për vetëdeklarim me vonesë.

GjASH I-rë Tiranë rrëzoi padinë e paditësit me arsyetimin se nuk provoi se prona e tij është ndërtuar para 10.08.1991 ku mund të përfitonte nga VKM. Mendojmë se ky vendim është i drejtë meqënëse ligji për legalizimet nuk ka afat se kur duhet të përfundoj procesi i legalizimit dhe aq më tepër që nuk mund të pretendohet shpronësim për një pronë e cila akoma nuk i është kaluar paditësit në pronësi por pritej si e tillë në të ardhmen pas procesit të legalizimit në të ardhmen.

### 3.5.5 Dëme për dhënie të informacioneve shkresore të pasakta

Në fakt gjatë veprimtarisë së tyre, OP kanë detyrimin që të japin edhe informacione të përgjithshme që i takojnë një çështje, informacione mbi të dhënat personale të individëve etj. E drejta e informimit për shtetasit është e garantuar me Kushtetutë (neni 23) për më detajë i përket ligjit të posaçëm për ta rregulluar. Ndërsa në KPRA e Ri e drejta e informimit i jepet çdo individ mbi veprimtarinë e organit publik, pa qënë i detyruar të shpjegojë motivet.

Edhe KPRA i Ri rregullimin më në detaj ia lë ligjit të posaçëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit. Ligji që rregullon me detaj këtë të drejtë është ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit.” Kjo e drejtë më herët është e rregulluar nga ligji nr.. 8503, datë 30.6.1999, “Për të drejtën e informimit për

<sup>253</sup> Nga 84 m<sup>2</sup> që pretendonte paditësi.

dokumentet zyrtare”.<sup>254</sup> Aktualisht institucion i cili detyrohet të mbikqyr zbatimin e këtij ligji është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale<sup>255</sup> që ka zëvendësuar organin e mëparshëm, Avokati i Popullit.

Informacioni i dhënë nga OP janë:

- pa kërkesë të veçantë por më tepër më karakter informues për publikun si p.sh: informacion mbi ligjet, mbi procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit, informacion për procedurat e prokurimit etj (neni 8);
- informacion tip të dhëna më parë një qytetari (neni 9);
- si përgjigjie për kërkesat e qytetarëve (neni 10). Në këtë rast përgjigjia duhet të kthehet brënda 10 ditëve nga moment i regjistrimit të saj. Në rastet kur informacioni i kërkuar refuzohet, organi publik merr vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban edhe udhëzimet për ushtrimin e së drejtës për ankim dhe i njoftohet menjëherë palëve në proces.

Në nenin 26 të ligjit nr. 119/2014 parashikohet se çdo person, që ka pësuar një dëm, për shkak të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar sipas Kodit Civil. Fakti se ky ligji nuk i referohet specifikisht nenit 8510/1999 nuk e përjashton nga trajtimi i këtyre çështjeve si mosmarrëveshje administrative. Pasi fakti se informacioni i dhënë, i refuzuar për tu dhënë nga titullari i institucionit, i jep të drejtën çdo personi t’i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit.

Komisioneri e trajton këtë lloj lënde si çështje administrative. Në nenin 25 të ligjit parashikohet se njihet e drejta e ankimit pas vendimit të Komisionerit në gjykatën administrative kompetente. Kësisoj edhe dëmet që vijnë nga kjo çështje administrative do të jetë lëndë administrative.

Përgjegjësia për dëmin jopasuror shkaktuar shtetasve nga OAP (neni 12 i ligjit nr. 8510/1999) ilustron me rastin e praktikës gjyqësore të një fakti të rremë në vërtetimin e gjëndjes gjyqësore nga Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve. Paditësja pretendon se pas aplikimit për dëshmi penalteti pranë Drejtorisë së Burgjeve të Ministrisë së Drejtësisë erdhi me shënimin se ishte dënuar me 25 vite burgim. Ky fakt i pavërtetë i ka çenuar rëndë nderin dhe personalitetin e saj, iu mohua e drejta e konkurimit për një vend pune, është penguar të lëvizë lirshëm jashtë shtetit, është ndjerë e përçmuar për shkak të një dënimi penal të pa qënë. Gjykata detyroi Ministrinë e Drejtësisë të dëmshpërblej paditësn në masën 200 000 lekë<sup>256</sup>

### 3.5.6 Dëme për veprime a mosveprime te ligjshme, por qe sjellin dëmtimin e interesave te ligjshme te personave fizike a juridike private

Përgjegjësia për veprime të ligjshme të OAP por që kanë sjell dëmtim tek shtetasit (neni 3 § “b” i ligjit nr. 8510/1999) janë raste më të rralla pasi prezumohet se i tërë shteti funksionon në bazë të ligjeve, normave të cilat rregullojnë jetën shoqërore të vëndit pa synuar që ti sjellin pasoja të dëmshme. Megjithatë rastet janë të

<sup>254</sup> Në nenin 17 “Shpërblimi i demit” të ligjit nr. 8503/1999 parashikohej:” Çdo person, qe ka pësuar një dem për shkak të shkeljes se dispozitave te këtij ligji, ka te drejte te kërkojë shpërblimin e demit nga subjekti qe shkel te drejtën. Procedurat për ankim dhe për shpërblimin e demit rregullohen me ligj.”

<sup>255</sup> I krijuar më 2008 shih më tej Rezarta Mataj “The Judiciary as Garant of Personal Data in Albania”, LUMEN Conference Iasi Rumani (2015).

<sup>256</sup> Vendimi nr.2689 datë 20.03.2012 të Gjykats së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

paevitueshme për sa kohë që edhe legjislatori në raste të veçanta i parashikon dhe u njej shtetasve shpërblim për dëmin e shkaktuar edhe pse dëmi ka ardhur në kryerje të rregullt të veprimtarisë së OAP. Kështu në ligjin nr. nr.9952, datë 14.7.2008 “Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it” i ndryshuar, në nenin 39 parashikohet dëmshpërblimi në rast infektimi me HIV: *“Institucionet shëndetësore dëmshpërblejnë personin e infektuar me HIV, sipas legjislacionit në fuqi, në rastet kur ky infektim është pasojë e dhënies së shërbimit shëndetësor ose e zbatimit të procedurave mjekësore.”*

Paraqitet tepër e vështirë të ndash rastet e mjekimit të pakujdesshëm nga rastet e kryerjes së veprimtarisë së rregullt të punonjësit të shëndetësisë konform ligjit, rregulloreve të shërbimit spitalor ku punon, urdhërit të mjekut, infermierit dhe dëmit që mund ti ketë ardhur të dëmtuarit.

Në çështjen me nr. 5532 datë vendimi 20.05.2013 të GjRRGJ Tiranë, L.P, pesë vjeç, paditur Qëndrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë dhe person të tretë Infermierën F.A shpërbleu paditësen në shumën prej 3,591,000 lekë si rezultat i shkaktimit të dëmit në shëndet nga mjekimi i pakujdesshëm. Rezulton nga faktet se me datë 02 qershor 2006 paditësja për shkak të temperaturës së lartë është shtruar në urgjencës e QSUT dhe mjeku roje ka rekomanduar infermierën F.A për trajtim me paracetamol intramuscular, injeksion si dhe perfusion (serum) për permiresimin e gjendjes së saj klinike. Në momentin e berjes së injeksionit e mitura ka reaguar menjehere, duke qare deri ne nxirje, ndersa kemba e majte i ka ngelur e ngrire. Nga konstatimi i mjekut të rojes rezultoi se kemba ku ishte bere injeksioni kishte humbur ndjeshmerine dhe pas shtrimit 10 ditor kjo paciente ka dale nga spitali me rekomandimin per ne KMCAP. Nga akti i ekseptimit gjyqësor, mjeko-ligjor u provua se: *“nuk rezulton asnje ngjarje apo rrethane tjetër që të lidhet me dëmin që i është shkaktuar femijes L.P, përveç injeksionit të bere ne muskujt e çapokut, të medikamentit paracetamol, i cili në vetvete nuk jep efekte anesore të dëmtimit lokal të nervave të regjionit ku injektohet. Dëmtimet e pesuara tek shtetasja L.P kane ardhur si rezultat i faktorit traumatic si pasojë e veprimit mekanik”*.Për këtë fakt, infermierja është shpallur edhe fajtoare nga GjRRJG Tiranë për veprën penale të mjekimit të pakujdesshëm e parashikuar ng neni 96 i KP.<sup>257</sup>

Në praktikë ngatërrohet përgjegjësia që ka shteti për të siguruar punonjësit apo edhe të miturit nën moshën 18 vjeç për të mbuluar nga çdo rast sëmundje, trajtime me medikamente etj. me përgjegjësinë që kanë këto institucine në rast se ato mjekojnë në mënyrë të pakujdesshëm duke i passjell dëm në shëndet, jetë, pasuri pacientit. Kjo e dyta është përgjegjësi jashtëkontraktore e cila në varësi të llojit të shërbimit spitalor publik a privat ndahet mes përgjegjësisë sipas nenit 3 të ligjit nr. 8510/1999 si organ i administratës shtetërore apo sipas nenit 608 e vijues të KC si çdo person fizik a juridik privat.

Në çështjen me nr. 7758 datë 05 korrik 2013 të GjRRGJ Tiranë rezulton se paditësja F.B, e vitlindjes 2001, është shtruar në spital me datë 16 nentor 2004 për tu trajtuar në QSUT “Nënë Tereza” me bronkopneumopati e më pas është nënshtruar një ndërhyrje kirurgjikale për shkak të një mase tumorale të trurit. Pas një viti është shtruar përsëri për tu trajtuar për shkak të ataksie ku është trajtuar me antibiotike, glukoze, calciglukonat vitaminoterapi etj. dhe me datë 11 maj 2005 është aplikuar nje flakon plazem grupi B i dhuruar.

<sup>257</sup> Neni 96” Mjekimi i pakujdesshëm i të sëmurëve nga ana e mjekut ose e personelit tjetër mjekësor, si dhe moszbatimi i terapisë ose i porosive të mjekut nga personeli mjekësor apo farmacist, kur ka shkaktuar dëmtimin e rëndë të shëndetit, ka rrezikuar jetën e personit ose ka shkaktuar vdekjen e tij, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar infektimin e të sëmurëve me infeksionin HIV/AIDS, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet”.

Me datë 03 dhjetor 2007-27 maj 2008 paditësja shtrohet ne spital me diagnozen hepatit C, meduloblastome. Sipas aktit të ekspertimit mjeko-ligjor të marrë në gjykim relatohet se: *“bazuar ne te dhenat e dokumentacionit mjeksore te permendura me lart arrijme ne keto perfundime infektimi i femijes se mitur E.B. me hepatit “C” ka ardhur si pasoje e veprimeve apo mosveprimeve te ekipti mjeksore qe eshte marre me trajtimin e saj ne Qendren Spitalore Universitare Tirane gjate periudhes se shtrimit te te semures ne kete institucion ne harkun kohore 2004-2006 ...omissis”.*”

Gjykata ka rrëzuar padinë me arsyetimin se nuk jemi para një përgjegjësia civile jashtëkontraktore pasi raporti i krijuar midis pacientit dhe Institucionit Shëndetësor përfaqëson një raport kontraktual (neni 2, 3, 4 të Ligjit nr.9106, date 17.07.2003 “Për Shërbimin Spitalore në Republikën e Shqipërisë”) ku sipërmarresi shëndetësor merr përsipër detyrimin për të përdorur të gjithë infrastrukturen e tij si edhe trajtimet farmaceutike për të realizuar shërimin shëndetësor të pacientit dhe të marrë të gjitha masat me qëllim parandalimin e përkeqësimeve të papritura.<sup>258</sup>

Sipas ligjit nr. 9106, date 17.07.2003 “Per Shërbimin Spitalore ne Republikën e Shqipërisë” parashikohet se shërbimi spitalor ne Republikën e Shqipërisë është publik dhe jopublik, i përgjithshëm dhe i specializuar. Ndarja në spitale bëhet në baze të përkatësisë së pronës dhe të financimit, si dhe në bazë të qëllimit të ushtrimit të veprimtarisë (neni 5).

Ky ligj njeh përgjegjësinë e Spitaleve publike dhe jopublike (neni 50 i ligjit) të dëmshpërblejnë të sëmurin e dëmtuar, sipas Kodit Civil, kur dëmtimi ka ardhur nga mosrespektimi i rregullave gjate ushtrimit te detyrës nga personeli mjekësor ose mosdhënia ne kohe e ndihmës urgjente mjekësore. Ndërsa neni 6 i ligjit parashikon se spitalet publike dhe jopublike janë të detyruara te shtrojnë e t'i japin ndihme mjekësore shtetasve shqiptare dhe të huaj, të siguruar ose jo, që kanë nevojë për shërbim spitalor urgjent për çfarëdo sëmundje ose aksident.

Për sa kohë që vetë neni 50 dhe 6 i ligjit parashikon se për çdo dëm që i ndodh një personi të siguruar apo jo, i huaj apo shqiptar, spitali publik ose privat do të mbaj përgjegjësi për çdo dëm të shkaktuar nga veprimet a mosveprimet e stafit të tij mjeksor.

Pra mardhënia e krijuar mes tyre përjashton mardhëniet kontraktore të sigurimeve shoqërore e shëndetësore që krijon shteti me të punësuarit, jo të punësuarit sipas ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” I ndryshuar. Ajo është një mardhënie jashtëkontraktore referuar Kodit Civil dhe ligjeve që rregullojnë përgjegjësinë jashtëkontraktore të administratës shtetërore. Për sa kohë që QSUT është një ent publik nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë, përgjegjësia do të rregullohet për rastin e trajtimit të pakujdesshëm nga ligji nr. 8510/1999 dhe nenit 608 e KC për aq sa nuk rregullon ky ligj i posaçëm.

Në harmoni me këtë qëndrim është edhe interpretimi i GjRRGJ Tiranë në vendimin nr. 6301 datë 05 qershor 2013 ku paditësia E.R padit Spitalin Privat Amerikan Tiranë për humbje të zërit tërësisht për shkak të një interventi kirurgjikal për tiroidet. Sipas gjykatës detyrohet pala e paditurit ‘UNIVERS –ALB’ sh.a (pronare e Spitalit) ti paguaj paditeses dëmin pasuror dhe jo pasuror shkaktuar nga dëmtimi i shendetit të saj si rezultat i mjekimit të pakujdesshëm pranë anës së paditur në shumën 5 912 809 lekë. Gjykata konkludoi se: *“mjeku kirurg, i cili ka kryer ndërhyrjen kirurgjikale në rastin konkret ka qenë i palicencuar në momentin e kryerjes së kësaj ndërhyrjeje, në kundërshtim të plotë me urdherimet e ligjit nr. 8615 date 01.06.2000 “Për Urdherin e Mjekeve në Republikën e Shqipërisë”, nuk i ka shpeguar pasojat e mundeshme nga*

<sup>258</sup> Shih Vendimin me nr. 7758 datë 05 korrik 2013 të GjRRGJ Tiranë , paditës E.B ndaj QSU “Nënë Tereza” Tiranë. Ky vendim është prishur nga GJAP Tiranë me vendimin nr. 647 datë 28 shkurt 2014.

nderhyrja që do të behet pasi e gjithë dokumentacioni ishte në gjuhën turke si dhe sipas aktit të ekseptimit mjeko-ligjor rezultoi se si rezultat i kësaj ndërhyrje kirurgjikale është shkaktuar paralizë, është dëmtuar nervi i kordes vokale (se vërtetë) të majtë, gjë e cila ka çuar në paralizë të kësaj korde zanore”.

Rast tjetër është padia e shoqërisë tregtare “A.D.F.D” shpk ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Degës së Doganave Rinas ku nxjerrja VKM nr. 258 dt 24.04.2003 që shfuqizonte një VKM të mëparshme duke e ndaluar shitjet e pijeve alkoolike dhe cigareve për rreth 11 muaj në dyqanet Duty Free në Aeroportin e Rinasit. Për humbjen e pësuar dhe fitimin e munguar nga një akt normativ i ligjshëm të cilën e ajo e ka zbatuar i cili u shfuqizuar më vonë, Shoqëria pretendoi dëm ekonomik në masën 19.638.013 lekë.<sup>259</sup>

Ndërsa rasti më i famshëm i Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian janë çështjet e bashkuara C-120/06 P dhe C-121/06 P me kërkes FIAMM dhe FIAMM Technologies<sup>260</sup> dhe Giorgio Fedon & Figli SpA, Fedon America, inc kundër Këshillit të Bashkimit Europian Komisionit të Komunitetit Europian. Gjykata e Luksemburgut edhe pse e rrëzoi ankimin e dy shoqërive, u pranua teoria e përgjegjësive të institucioneve të BE për veprime të ligjshme por që sjellin dëm tek të tretët. Tre kushtet sipas kësaj teorie janë lidhja shkaksore e drejtpërdrejtë, e menjëhershme dhe një dëm jashtë të zakonshmes.

Në rastin FIAMM, GJD e BE vlerësoi se nuk ka veprime të kundër ligjshme porse se dëmi i pësuar nga pala ankimuese nuk ishte i jashtëzakonshëm, por një dëm i zakonshëm i pësuar në një tregti ndërkombëtare.<sup>261</sup> Më tej do të trajtohet në kapitullin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Luksemburgut mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore në të drejtën evropiane.

### 3.5.7 Dëme për veprime a mosveprime të ligjshme, që u shkaktojnë një dëm të pabarabarte subjekteve të cilëve u drejtohet ky veprim a mosveprim

Parimi i barazisë është i parashikuar në KPRA e Ri parashikohet në dy paragrafët e parë të nenit 17 ku citojmë: “1. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë.<sup>262</sup> 2. Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë.... omissis.”

Kuptohet që ajo çfarë i ka mëshuar KPRA i Ri është se OAP e kanë për detyrë që për të njëjtat situata që janë identike, palët që iu drejtohet kjo veprimtari administrative, akt administrativ etj. të trajtohen në mënyrë të barabartë. Po ashtu edhe e kundërta, në rast se ky OAP për të njëjtën situatë objektive u shkakton dëm personave që iu drejtohet, ky dëm të jetë i barabartë në të kundërt mbahet përgjegjësi për mos trajtim të barabartë dhe shkelje të parimit të pabarazisë.

Sipas nenit 3 pika “c” e ligjit nr. 8510/1999 parashikon se: “c) kur, megjithëse kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, u shkaktojnë një dëm të pabarabarte subjekteve të cilëve u drejtohet ky veprim a mosveprim.” E ilustruam me një shëmbull,

<sup>259</sup> Në vendimin nr. 10877 /24.12.2009 të Gjykatës Së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>260</sup> Akronimi per Fabbrica italiana accumulatori motocarri Montecchio SpA.

<sup>261</sup> [http://curia.europa.eu/juris/document/document\\_print.jsf;jsessionid=9ea7d2dc30dd8ef116b1077c4c2da8e0f0db23077d49.e34KaxiLc3qMb40Rch0SaxuSaNj0?doclang=EN&text=&pageIndex=0&docid=71983&cid=790016](http://curia.europa.eu/juris/document/document_print.jsf;jsessionid=9ea7d2dc30dd8ef116b1077c4c2da8e0f0db23077d49.e34KaxiLc3qMb40Rch0SaxuSaNj0?doclang=EN&text=&pageIndex=0&docid=71983&cid=790016). § 5.

<sup>262</sup> Neni 18§1 i Kushtetutës parashikon se: “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.”



shpronësimi i 100 familjeve në një zonë, për ndërtimin e një rruge publike duhet të dëmshpërblejë në mënyrë të barabartë të gjithë të shpronësuarit. KPRA parashikon edhe përjashtim për trajtim të pabarabartë por kjo vetëm kur provohet se personi që është trajtuar ndryshe është për shkak të karakteristikave të veçanta në lidhje me rastin konkret.

Neni 3 pika “c” i ligjit nr. 8510/1999 është tepër i ngjashëm me rastin e parashikuar në nenin 3 pika “b”<sup>263</sup> të po këtij ligji dhe duket si nën lloj a shtojcë e dëmeve nga veprimet a mosveprimet e ligjshme që u sjellin dëm interesave të ligjshme të personave. Diferenca është se target grupi i të dëmtuarve është më i vogël pasi këtu të dëmtuar duhet të jenë vetëm persona që iu është drejtuar nominalisht akti administrativ individual ose veprimi a mosveprimi administrativ dhe nga këto ka disa që kanë pësuar një dëmtim shumë më të madh se të dëmtuarit e tjerë. Ndërsa tek rasti i nenit 34 pika “b” i ligjit të posaçëm mban përgjegjësi OAP për dëmet e shkaktuar çdo personi privat, fizik ose juridik, kjo tregon se dëmi vjen nga një akt administrativ kryesisht normativ dhe jo individual.

### 3.5.8 Dëme për shkak të mosfunksionimit të mjeteve teknike

OAP në funksionimin e tyre ndihmohen nga mjaft mjete teknike si: automjete, fotokopje, pasije të tjera elektronike, të automatizuar etj. Kjo përgjegjësi i është vënë drejtëpërdrejtë OAP i cili duhet të ketë staf të specializuar për kujdesin e mjeteve të tij teknike pra për ti riparuar, zëvendësuar kur janë të prishura etj. por edhe staf të trajnuar për ti përdorur korrektësisht këto mjete teknike.

Pikërisht mospërdorimi siç duhet i këtyre mjeteve teknike me pasojë mosfunksionimin e tyre ose amortizimin apo prishjen e tyre për shkak të mosrregullimit në kohë, moszëvendësimit etj. i pasjell përgjegjësi OAP për çdo dëm shkaktuar. E ilustruam me një shëmbull. Një person aplikon për pasaportë të re biometrike me procedurë të përshpejtuar me dy fishin e çmimit, për ta marrë atë për tre ditë nga momenti i aplikimit. Mund të ndodhë që Ministria e Brëndëshme dhe ALEAT sh.a, shoqëria e kontraktuar për të realizuar lëshimin e pasaportave, nuk kanë rregulluar printerin duke pasjell lëshimin e pasaportës pas pesë ditëve. Qytetari ka të drejtë të padisë Ministrinë e Brëndëshme dhe/ose Aleat sh.a të cilët për faj të tyre, nuk e mori në kohë pasaportën dhe humbi të drejtën për tu intervistuar në Ambasadën e SHBA.

Në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë, i miratuar me ligjin nr.10 040, datë 22.12.2008 parashikohet kjo lloj përgjegjësie për shkak të mos funksionimit të mjeteve si avionët.

Sipas këtij ligji, avionë shtetërorë janë avionët në përdorim të ushtrisë, doganës dhe policisë dhe nën varësi të këtyre autoriteteve shtetërore pra të Ministrisë së Mbrojtjes, Ekonomisë dhe të Brëndshme. Përgjegjësia për veprimtarinë e avionëve shtetëror parashikohet në nenin 135- Dëmtimet ndaj palëve të treta, kreun V ku: *“Në rast se një avion shtetëror shkakton dëmet e përmendura në nenin 116 të këtij Kodi, operatori është përgjegjës sipas dispozitave të këtij kreu, me përjashtim të nenit 119 të këtij Kodi.”*

Duhet bërë dallimi se përgjegjësia ndaj të tretëve rregullohet nga ky ligj dhe trajtohet si përgjegjësi jashtëkontraktore e organeve të administratës shtetërore, në rastin konkret të Ministrisë në varësi të së cilës është avioni shtetëror. Ndërsa për dëmet shkaktuar pasagjerëve (neni 136 i ligjit), trajtohet si një përgjegjësi kontraktore e lidhur

<sup>263</sup> “kur kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, por që sjellin dëmtimin e interesave të ligjshme të personave fizikë a juridikë privatë”.

mes operatorit të avionit shtetëror dhe pasagjerit, kur ka blerë biletën përkundrejt çmimit.

Tipik është rasti kur gjatë një stërvitje përgatitore apo edhe gjatë një fluturimi për transportim personeli, një avion shtetëror i ushtrisë pëson difekt teknik, rrëzohet dhe bie në banesën e një qytetari duke e shkatërruar plotësisht. Sipas nenit 116 “Përgjegjësia për dëmtimet ndaj palëve të treta” të Kodit Ajror dëme që mund ti shkaktohet të tretit janë: “1. Operatori i avionit është përgjegjës për dëmtime të shkaktuara në rast vdekjeje ose dëmtimi trupor të një personi apo për dëmtime të pronës, në rast se aksidenti, që shkakton dëmin, ndodh gjatë operimit të avionit.

2. Në kuptim të këtij kreu, termi "operator" është personi, i cili po përdorte avionin në kohën kur u shkaktua dëmtimi, ose personi me drejta për të përdorur avionin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i cili ka mbajtur kontrollin e lundrimit të avionit. Një person konsiderohet se po përdor një avion, kur ai e përdor personalisht ose kur punonjësit apo agjentët e tij përdorin avionin gjatë periudhës së punësimit të tyre, pavarësisht nëse është apo jo brenda qëllimit të detyrave të tyre.

Pronari i regjistruar i avionit prezumohet operator dhe njihet si personi përgjegjës, përveç rasteve kur, gjatë procesit gjyqësor për përcaktimin e përgjegjësisë së tij, ai provon se operatori ishte një person tjetër.

Në kuptim të këtij Kodi, "operimi i avionit" përfshin përdorimin e një avioni nga çasti kur forca ushtrohet mbi motorët, për qëllim lëvizjeje ose ngritja në fluturim, derisa ai kthehet në tokë dhe motorët e tij janë fikur plotësisht. Gjithashtu, ky term nënkupton lëvizjen e një avioni nga mjetet tërheqëse ose shtytëse, apo nga fuqi, që janë karakteristike për zhvendosjen dhe ngritjen në ajër të avionit, veçanërisht rrymat ajrore...”

Përgjegjësia e autoritetit operues për avionin shtetëror nuk i referohet nenit 119 të Kodit Ajror, i cili vlen për përgjegjësinë e autoriteteve për avionet civil që parashikon se shumat përkatëse që mbulohen në rast të aksidentit karshi pasagjerëve në varësi të MMN (masa maksimale e ngritjes) së avionit pra: a) më pak se 500 kg MMN shuma e shpërblimit është deri në 750 000 SDR<sup>264</sup>; b) më pak se 1 000 kg deri në 1 500 000 SDR dhe deri ...g) 500 000 kg dhe më shumë deri në 700 000 000 SDR. 3. Në rastet e vdekjeve dhe të dëmtimeve trupore, përgjegjësia është e kufizuar deri në 100 000 SDR. 4. Në rast se shuma totale e kompensimit të viktimave të të njëjtit aksident tejkalon shumën maksimale, që jepet në pikën 2 të këtij neni, kompensimi për çdo viktimë duhet të zvogëlohet, në mënyrë të barabartë, në përputhje me raportin e shumës totale të kërkuar me shumën maksimale.

5. Në rast se kërkohet kompensimi për dëmtim vetjak dhe dëmtim material, dy të tretat e shumës maksimale, sipas pikës 2 të këtij neni, do të paguhen për dëmtimet vetjake. Në rast se kjo shumë nuk është e mjaftueshme për të mbuluar të gjitha kërkesat, ajo duhet të jepet në mënyrë të përpjesshme. Një e treta e shumës maksimale duhet të jepet në mënyrë të përpjesshme për dëmtimet materiale dhe për dëmtimet personale, të cilat nuk janë mbuluar ende.”

<sup>264</sup> Një SDR (Special Drawing Right)= 172.27 lekë.

### 3.5.9 Dëme nga një rrezik te vazhdueshëm i personave fizike a juridike private

Konceptin e rrezikut të vazhdueshëm e shpjegon ligji nr. 8510/1999 në nenin 2 §2 me të cilin kuptohet mundësia e përhershme për të shkaktuar dem, si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të administratës shtetërore.

Kjo formë përgjegjësie, njihet edhe në të drejtën civile, si formë e përgjegjësise jashtëkontraktore ku në nenin 622 të KC “Përgjegjësia nga ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme” parashikon: *“Personi që kryen një veprimtari të rrezikshme nga natyra e saj ose nga natyra e sendeve të përdorura dhe u shkakton dëm personave të tjerë, detyrohet të shpërblejë dëmin, përveç kur provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për menjanimin e dëmit.”*

Pra në referencë të këtij neni mund të themi se një OP që kryen një veprimtari që për nga natyra e saj ose sendet që ajo përdor është i detyruar të shpërblejë dëmin. Përjashtimisht nuk mban përgjegjësi kur provon se ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të menjanuar dëmin. Tipik është rasti i tragjedisë së Gërdecit, ku depoja e demontimit të armëve dhe vetë demontimi si veprimtari përbënte një vënd dhe akt me karakter të rrezikshëm në mënyrë të vazhdueshme për të cilën GJASH I-rë Tiranë në vendimin nr. 1259 datë 26 mars 2015 gjeti fajtoresh Ministrinë e Mbrojtjes për humbjen e jetës së 26 personave. Gjykata arsyeton se: *“Ministri shmangu Forcat e Armatosura për të mbikqyrur veprimtarinë e rrezikshme, tejkaloj kufijtë (kalibrat e vegjël deri 14.5 mm) e përcaktuar nga VKM nr. 138 dt. 14.03.2007 përse i përket kalibrave të municioneve. Duke nxjerrë Urdhërin nr. 2044 dt. 07.12.2007, me anë të të cilit urdhëroi demontimin e kalibrave të mëdhenj nga 20 deri 152 mm, urdhëroi kryerjen e kësaj veprimtarie në një vend të palicensuar si depo municioni siç ishte reparti i tankeve në Gërdec, si dhe ka urdhëruar kryerjen e kësaj veprimtarie nga kompani të palicensuara përse i përket teknologjisë së përdorur, siç shprehen ekspertët në raportin e ekspertimit tekniko-ushtarak të administruar si provë shkresore.”*

Në vendimin nr. 3101 datë vendimi 08 qershor 2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë mbi rastin e shpërblimit të dëmit pasuror (shkatërrim i banesës) si rezultat i dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar nga Ministria e Mbrojtjes, Meico shpk dhe Albademil shpk me datë 15 mars 2008, ndalet në dy momente të rëndësishme nga pikëpamja teorike: veprimtaria e rrezikshme dhe faji i shkaktuesit të dëmit.<sup>265</sup>

Mbi pikën e parë kjo Gjykatë shprehet se: *“nacioni i veprimtarisë së rrezikshme është i njëjtë dhe për rastin konkret nuk ka mëdyshje se aktiviteti i urdhëruar, i mbikqyrur dhe kryer nga të paditurit është i një rrezikshmërie të lartë. Është e qartë se ligjvënësit e kanë parashikuar këtë dispozitiv me qëllimin e vetëm për të mbrojtur palët e treta nga një dëmtim i mundshëm e që në rastin konkret bëhet më i domosdoshëm se kurrë.”*

Ndërsa mbi pikën e dytë shprehet se përgjegjësia nga ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme siç parashikon neni 622 i KC nuk kërkon vërtetim të fajësisë por: *“autoritetet shtetërore janë ata që kanë barrën e provës të vërtetimit se kanë marrë çdo lloj mase të zbatueshme që mund të ekzistoj, pavarësisht nëse ishin të ditura ose jo prej tyre, për parandalimin e ngjarjes së dëmeve, pra edhe të aksidenteve teknologjike. Duke qenë se kjo nuk u provua, nuk është e nevojshme as të vërtetohet fakti nëse personi juridik ose punonjësit e tij që autorizojnë, mbikqyrin apo ushtrojnë veprimtarinë e rrezikshme, kanë apo jo faj, janë apo jo përgjegjës penalisht për shkaktimin e dëmit dhe pasojat e ardhura prej ngjarjes. Gjykata vlereson se veprimtaria e demilitarizimit dhe*

<sup>265</sup> Vendimi nr. 3101 datë 08 qershor 2015 të GJSHA I-rë Administrative faqe 16.

*demontimit të municioneve luftarake, sikurse edhe ajo e prodhimit, transportimit, depozitimit dhe përdorimit të tyre, janë veprimtari ekstremisht të rrezikshme, që përfaqësojnë gjendjet klasike të burimit të rrezikut të shtuar. Për këtë arsye, ushtrimi dhe mbikqyrja e veprimtarisë nga të paditurit për transferimin, transportimin, depozitimin, demontimin e municioneve luftarake, si dhe ajo për depozitimin e barutit dhe lëndëve të tjera shpërthyes të mbetura nga ky proces teknologjik, përbëjnë një veprimtari burimi rreziku të shtuar, gjë që sipas nenit 622 të Kodit Civil, pasjell vetvetiu përgjegjësinë objektive të autoriteteve shtetërore për çfaredo lloj dëmi të shkaktuar nga një veprimtari e tillë. ”*

Referuar po KC në këtë titull dëmsh që vijnë nga një veprimtari e rrezikshme është përfshirë edhe neni 623 i cili njeh si nënloj i veprimtarive me rrezik të vazhdueshëm janë ndërtimet dhe mirëmbajtja e tyre etj. Çdo e metë, ves që pasjellë dëm tek përdoruesit e saj është përgjegjës pronari dhe në rastin e përgjegjësisë administative për analagji do të jetë OAP që ka në pronësi, administron ndërtimin, ndërtesën të paguaj dëmet e shkaktuar përdoruesit apo pronarit të mëpasshëm të ndërtimit. Nëse provohet sipas nenit 623§2 të KC pronari i ndërtesës ose i ndërtimit ka të drejtë t’u kërkojë personave përgjegjës ndaj tij, të shpërblejnë dëmet që ka pësuar.

Kësisoj mund të themi se ndërtimi i objekteve me karakter publik si: shkolla, kopshte, spitale, godina për administratën, ndërtesave sociale etj. rrugë, aeroporte, hekurudha etj. përbëjnë veprimtari me karakter të vazhdueshëm rreziku dhe shteti, organet kontraktuese mbajnë përgjegjësi për çdo ves të ndërtimit, ndërtesës dhe pasjell dëm ekonomik, në shëndet apo në jetë të banuesve, përdoruesve të tyre.

Megjithatë në referencë të KC por edhe të ligjit nr. 8510/1999 kur provohet se vesi ka ardhur nga ndërtimi me cilësi të dobët i shoqërisë tregtare sipërmarrëse a nënsipërmarrëse, OAP mund të shkarkoj përgjegjësinë tek kjo shoqëri e cila sipas nenit 866 të KC parashikohet: *“Kur sipërmarrja ka për objekt ndërtesa ose sende të tjera të paluajtshme të cilat, për nga natyra e tyre, kanë destinim afatgjatë, po qe se, gjatë një periudhe prej dhjetë vjetësh nga përfundimi, vepra, për shkak të tokës ose për defekt të ndërtimit, shëmbet tërësisht ose pjesërisht, ose paraqet rrezik të dukshëm shëmbjeje ose defekte të tjera të rënda, sipërmarrësi përgjegjet kundrejt porositësit dhe palëve që fitojnë të drejta prej tij, me kusht që denoncimi i tyre të bëhet brenda një viti nga zbulimi. E drejta e porositësit parashkruhet brenda një viti nga kallëzimi.”* Detyra kryesore OAP mbi këto defekte të konstatuara në ndërtesë është të bëjë denoncimin brenda një viti tek shoqëria sipërmarrëse pasi e drejta e tij për të shkarkuar përgjegjësinë shuhet dhe dëmin i duhet të mbulojë vetë tërësisht.

### **3.5.10 Dëme nga një akt korruptiv gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre**

Përgjegjësia e administratës shtetërore për akte korruptive të funksionarëve të tyre apo të institucionit nuk ishte parashikuar fillimisht tek ligji nr. 8510/1999. Ligji nr.10 005, datë 23.10.2008 “Për një shtesë në ligjin nr.8510, datë 15.7.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore" është i vetmi ndryshim që i është bërë këtij ligji, ku neni 3 iu shtua edhe shkronja “dh”: *“kur kryejnë një akt korruptiv gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Korrupsion është e përcaktuar në nenin 2 të ligjit nr. 8635, datë 6.7.2000 “Për konventën Civile për Korrupsionin” e cila nënkupton: *“të kërkuarit, ofrimin, dhënies ose pranimit drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë të një mitëmarrje ose çdo lloj tjetër avantazhi ose përfitimi që deformat kryerjen e çdo detyre ose sjellje të kërkuar nga pranuesi i mitëmarrjes, për pasojë dhe të avantazhit e përfitimit të padrejtë.”*

Për të pretenduar shpërblim dëmi jashtëkontraktor nga ana e OAP kemi rastin kur vetë organi i administratës publike si person juridik apo punonjësit e tij janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e veprave penale të korrupsionit. Si shkak i këtyre fakteve penale ka ardhur edhe dëm për personin e tretë. Padi tësit i mbetet për të provuar që dëmi ka ardhur nga veprime të paligjshme/ të kundërligjshme të punonjësit të OP i dënuar për korrupsion.

Akti korruptiv, vlerësojmë se është i lidhur në mënyrë të ngushtë me punonjësin e administratës shtetërore pasi për shkak të veshjes së shtetit me legjitimitet dhe me zbatim të së drejtës nuk mund të mendohet se shteti do të kryente një akt korruptiv vetë. Megjithatë, legjislacioni aktual e njeh përgjegjësinë e organeve publike për vepra korruptive. Në ligjin nr. 9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” njihet përgjegjësia penale e personave juridik publik. Ndaj personave juridikë, që kanë përgjegjësi për kryerjen e veprës penale, jepen këto masa ndëshkuese (neni 8, 9 i ligjit): a) dënime kryesore të llojit gjobë ose mbarim i personit juridik dhe b) dënime plotësuese.

Megjithatë janë disa kategori personash juridik që nuk mund tu jepet dënim kryesor apo dënim plotësues. Neni 9§2 i ligjit parashikon se: “2. Dënimi kryesor, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, nuk zbatohet për njësitë e qeverisjes vendore, për personat juridikë publikë dhe për partitë politike e sindikatat.” Po ashtu në nenin 10§2 të këtij ligji parashikohet se dënimet plotësuese, të parashikuara në shkronjat “a”<sup>266</sup>, “b”<sup>267</sup>, “d”<sup>268</sup> dhe “dh”<sup>269</sup> të pikës 1 të këtij neni, nuk zbatohen për njësitë e qeverisjes vendore, personat juridikë publikë, partitë politike dhe sindikatat.

Kjo do të thotë se për persona juridik publik, bashkitë dhe qarqet, partitë apo sindikatat nëse kryejnë një vepër penale dënohen vetëm me dënime plotësuese të parashikuara nga neni 10 shkronjat “c”, “ç” dhe “e” i ligjit nr. 9754/2007 konkretisht: “c) ndalimi për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit të fondeve publike; ç) heqja e së drejtës së marrjes ose përdorimit të licencave, autorizimeve, koncesioneve ose subvencioneve; e) detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor.” Po ashtu, këto persona juridik publik mund tu konfiskohen mjetet e kryerjes së veprës penale dhe të produkteve të veprës penale.

Çdo palë e tretë që pretendon se ka pësuar një dëm pasuror a jopasuror nga veprimet korruptive të personit juridik publik a punonjësit të tij mund ti drejtohet me padi OP për shpërblimin e dëmit të shkaktuar. Vetë organi kur provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë se faji ishte i punonjësit të tij mund t’ia shkarkoj përgjegjësinë ose gjatë gjykimit duke e thirrur si person të tretë ose me padi regres. Këtë qëndrim mban edhe Konventa Civile për Korrupsionin ku shtetet nënshkruese të saj, përfshi edhe Shqipërinë duhet që të parashikojnë në ligje të brëndshme procedurat e duhura për të kërkuar kompensim nga shteti ose në rastin e një pale joshtetërore, nga autoritetet zyrtare përkatëse kur dëmi ka ardhur nga ndonjë akt korruptiv i funksionarit (neni 5).

Si akte korruptive Kodi Penal parashikon jo vetëm ato që lidhen me korrupsionin aktiv apo pasiv por edhe veprime të tjera që synojnë të ndikojnë tek nëpunësi publik për të mos e kryer apo shpërdoruar detyrën:

<sup>266</sup> a) mbyllja e një ose më shumë veprimtarive apo strukturave të personit juridik;

<sup>267</sup> b) vendosja e personit juridik në administrim të kontrolluar;

<sup>268</sup> d) ndalimi për të kërkuar publikisht fonde dhe burime financiare;

<sup>269</sup> dh) heqja e së drejtës së ushtrimit të një apo më shumë veprimtarive ose operacioneve;

- Neni 244 “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”<sup>270</sup>, Neni 245 “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”<sup>271</sup>,
- Neni 245/1 “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”<sup>272</sup>,
- Neni 259 “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”<sup>273</sup>,
- Neni 260-“Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”<sup>274</sup>

Veprat e korrupsionit në praktikë sipas Dr. Afet Mamuti hasen kur funksionari kërkon të realizoj dobi për vete apo për të tjerët, furnizimet publike që kryhen nga organet shtetërore, dhënia e disa informatave paraprake nga nëpunësi zyrtar për të fituar tenderin një konkures, gjatë ushtrimit veprimeve diskrecionale etj.<sup>275</sup> Këtu pavarësisht se është nëpunësi shtetëror i cili e kryen aktin korruptiv, përgjegjës për dëmin e shkaktuar të tretëve nga ky veprim është shteti i cili ky ka të drejtën për të kërkuar kompensin për atë çfarë ka paguar, ndaj funksionarit fajtor.

Në Konventën Civile për Korrupsionin në nenin 3 të saj parashikohet se:” *secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar, për personat që janë dëmtuar si rezultat i korrupsionit, të drejtën për të inicuar një veprim në mënyrë që të marrin kompensim të plotë për një dëmtim të tillë.*

2. *Një kompensim i tillë mund të mbulojë dëmtimin material, humbjen e përfitimeve dhe humbje jomonetare.*”

Për të provuar këtë dëm të ardhur nga akte korruptive në gjykim sipas nenit 4 të Konventës duhet që:

- i akuzuari ka kryer ose ka autorizuar aktin e korruptimit, ose ka dështuar në

<sup>270</sup> “Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.”

<sup>271</sup> “Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet.”

<sup>272</sup> “Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që premtim ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.”

<sup>273</sup> “Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.”

<sup>274</sup> “Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet”.

<sup>275</sup> Afet Mamuti, “Përgjegjësia juridike civile për shpërbllimin e dëmit në Maqedoni “ Disertacion për marrjen e gradës shkencore “doktor”, Tiranë , 2013, faqe 107.

- ndërmarrjen e hapave të duhur për të parandaluar aktin e korrupsionit;
- akuzuesi ka pësuar dëmtimin;
- ka një lidhje shkakësore midis aktit të korrupsionit dhe dëmit.
- Përgjegjësinë solidarë të bashkëpandehurve/ të akuzuarve për aktin korruptiv.
- kompensimi të reduktohet ose nuk pranohet kur i dëmtuari nga gabimet e veta ka ndihmuar dëmtimin ose keqësimin e tij (neni 6).
- E drejta e ngritjes së padisë është jo më pak se tre vjet nga dita që i dëmtuari ka ditur për dëmin, aktin korruptiv dhe për personin përgjegjës por kurrësesi jo më tej 10 vjet nga data e kryerjes së aktit korruptiv.

Mendojmë se reflektimi në ligjin nr. 8510/1999 duke shtuar pikën “dh” tek neni 3 nuk është i mjaftueshëm për të zbatuar detyrimet që Shqipëria ka marrë përpara Këshillit të Europës për këtë Konventë. Siç e cekëm dhe më lart Konventa kërkon një ligj të posaçëm, rregullime të posaçme se kush është përgjegjës, mënyra dhe kushtet që duhet të plotësohen etj. Ligji aktual për përgjegjësinë jashtëkontraktore të administratës shtetërore edhe për rastet korruptive nuk i plotëson kriteret e kërkuara dhe mbetet i vakët për gjykimet të tilla për dëmet e shtetasve nga veprimet e korrupsionit. Për këtë arsye, mbetet që në të ardhmen të miratohet një ligj në respektim të detyrave që rrjedh nga kjo Konventa ku ne e kemi nënshkruar pa asnjë lloj rezerve në mënyrë që dhe shtetasve tu jepet mundësia për tu njohur dhe për ta zbatuar të dretjen e tyre për dëmet morale, materiale që u kanë ardhur apo do u vijnë në të ardhmen nga akte korruptive të personave juridik publik apo funksionarëve të tyre.

### **3.5.11 Dëme në rastet e shpronësimeve bazuar në ligjin nr. 8561/1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”**

Sipas nenit 31 të Kushtetutës “1. E drejta e pronës private është e garantuar.

...

3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.

4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.”

Pra, e drejta e pronës është një e drejtë Kushtetuese e mbrojtur dhe nga neni 1 Protokollit 1 i KEDNJ ku parashikohet se:” Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

*Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera”*

Po në nivel kushtetutes rregullohet edhe situata kur pronarit i merret prona për arsye madhore siç është ajo e interesit publik përkundrejt një shpërblimi të drejtë dhe real. Specifikisht shpronësimet publike rregullohen me ligjin nr. 8561/1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”. Kur pala nuk është e kënaqur me shpërblimin ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e duhur bazuar tek ligji 8510/1999. Këtë të drejtë e njeh neni 24 i ligjit nr. 8561/1999 i cili parashikon se: “...2. Ankimi kundër vendimit të Këshillit të Ministrave

për shpronësimin nuk pezullon zbatimin e këtij vendimi dhe procedurën përkatëse të regjistrimit të pasurisë së shpronësuar.

3. Lidhur me masën e shpërblimit të shpronësimit, nëse nuk bëhet ankimi në gjykatë brenda afatit tridhjetë ditor, sipas këtij ligji, vendimi i Këshillit të Ministrave për shpronësimin përbën titull ekzekutiv.

4. Shqyrtimi gjyqësor bëhet në përputhje me dispozitat ligjore lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative të Kodit të Procedurës Civile.”

Pra kemi dy raste: 1) kur dëmi bëhet pa u marrë vendimi i shpronësimit nga KM dhe 2) kur dëmi bëhet pasi del VKM për shpronësim. Në të dy rastet i drejtoresh gjykatës ku si masë provizore mund të kërkosh pezullimin e veprimeve të shpronësimit kur provon rrethana të veçanta që rëndojnë kushtet ekonomike, sociale, familjare si i pastrehë, kur nuk ka interes publik etj.

I gjithë gjykimi ka karakterin e një mosmarrëveshje administrative dhe i përmbahet ligjeve të sipërcituar, Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

Në çështjen nr.189 datë 07 mars 2013 të Gjykatës së Lartë mes palëve Z.K dhe Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Tiranë rezulton se kjo e fundit ka miratuar projektin teknik për sistemimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës në “Bllokun 50 Vjetori duke u zgjeruar rruga dhe ambientet e gjelbëruara. Pas një njoftimi me shkresë, për ekzekutim vullnetar ndaj pronarit Z.K, Bashkia Tiranë ka prishur murin rrethues dhe një një pjesë truallit është përdorur për zgjerim të rrugës dhe ndërtimit të ambienteve të gjelbra.

Këtu paditësi ka zgjedhur ti drejtohet fillimisht Bashkisë Tiranë për shpërblimin e dëmit, dhe pas refuzimit të kërkesës, ka ngritur padi në Gjykatë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar Bashkinë Tiranë që të dëmshpërblejë paditësin Z.K në shumën që i korrespondon dëmit që i është shkaktuar paditësit si rezultat i përdorimit të truallit dhe prishjes së murit rrethues të pronës së tij.

### **3.5.12 Dëmi nga ndryshimi i një situate juridike ose faktik me origjinë nga akte të administratës shtetërore**

Kjo situatë edhe pse nuk është e parashikuar në nenin 3 të ligjit n. 8510/1999 del nga përmbajtja e nenit 7§1 të këtij ligji ku parashkohet se: “Nëse dëmi shkaktohet nga ndryshimi i një situate juridike ose faktike, e cila nga ana e saj, e ka origjinën në një akt të administratës shtetëror, organi kompetent i kësaj administrate mënjanon pasojat, nëpërmjet rivendosjes se gjendjes se mëparshme ose, kur një gjë e tillë është e pamundur, nëpërmjet vendosjes se një gjëndjeje të ngjashme. “

Tipik është rasti kur një vendimarrja e organeve të administratës publike ka ndërprerë veprimtarinë ose ka ndryshuar rrjedhën e punës, situatën ekonomike të personit fizik a juridik etj. por që më vonë ka rezultuar një vendimarrje e administratës e paligjshme p.sh kur një kontratë anulohet për shkak të procedrave të gabuar të tenderimit. Tashmë pretendimet mes ish-kontraktuesve duhet të bëhen jo sipas kontratave administrative të lidhura më parë mes tyre por për shkak të ligjit 8510/1999 pasi ka ndryshuar një situatë juridike.<sup>276</sup>

<sup>276</sup> Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 59 datë 05 shkurt 2015, prish vendimarrjen e Gjykatës së Apelit dhe lë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës e cila ka rrëzuar padinë e Shoqërisë ndaj IEVP RRogozhinë dhe IEVP Lushnje me arsyetimin se fondet për furnizimet me ushqime të të burgosurve paguhen sipas të ligjit të posaçëm nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për



Në çështjen civile me nr. 2819 datë 22 dhjetor 2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë rezulton se me aktin administrativ nr.298 dt.22.12.2004, që ka hyre në fuqi me datë 28.12.2004, Shoqërisë “Media +” shpk (pronare edhe e “TV Shijak”) i është hequr licenca nr. 039/TVL, me afat 5 vjeçar, për periudhën 03.01.2001-03.01.2006 (e dhëne me vendimin nr.30 date 14.12.2000 të KKRT-së).

Me vendimin nr.1732 date 30.03.2005 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë që është lënë në fuqi me vendimin nr. 217 date 26.02.2006 nga Gjykata Apelit Tirane, është ndryshuar akti administrativ i mëspërm në reduktimin e kohës, licencës deri në 50% të saj. Pas këtij vendimi vetë KKRT vendos: *“Te shfuqizoj vendimin nr.298 daë 22.12.2004 të KKRT. “Shoqeria “Media +” në rast se është e interesuar të vazhdojë veprimtarinë e mëtejshme për televizionin privat vendosr “TV Shijak” të depozitoj dokumentacionin përkatës për rinovimin e licencës në përputhje me nenin 25 të ligjit dhe Rregullores “Mbi procedurat e riliçensimit të operatorve privat RTV” brenda datës 31.05.2006”. Ngarkohet administrata e KKRT” për veprime të mëtejshme sipas ligjit”.*

Gjykata e Apelit vlerëson të drejtë kërkesën e paditësit për shpërblim të dëmit jashtëkontraktor të ardhur nga vendimarrja e paligjshme e KKRT me arsyetimin se: *“Duke qenë se dëmi i shkaktuar palës paditese, është rrjedhojë e drejte për drejte e një shtate juridike të krijuar nga akti administrativ nr.298 date 22.12.2004, pala e paditur KKRT-ja, ishte e detyruar që në atë kohë të menjanonte këto pasojë, nëpërmjet një rivendosje të gjendjes së mëparshme, duke e paisur me license shoqerine “Media+” (TV Shijak).*

*Pala paditese, me vendimin nr.30 date 14.11.2000 të KKRT, është paisur me licencën nr.039/TVL në fushën e trasmetimeve toksore për periudhën 03.01.2001- 03.01.2006 që ka hyrë në fuqi, kur është botuar në fletoren zyrtare nr.101 të vitit 2004. Në këtë kohë këtij subjekti i kishte ngeluar akoma nga kjo license me afat 5 vjeçar, (që do të perfundonte me date 03.01.2006) edhe 1 (një) vit e 5 dite kohë....“*

Pra, konkludojmë se kur një vendimarrje sjell dëme organi publik duhet të kthejë të dëmtuarin në gjëndjen e mëparshme dhe të shpërblejë të gjitha dëmet e ardhura nga kjo situatë e re.

Organi administrativ që ka sjell situatën e paligjshme nuk i lihet në dorë që të ndërhyjë vetëm pasi i dëmtuari i drejtohet por në situatë të tilla OAP duhet të kryej të gjitha veprimet në zbatim të vendimit të gjykatës për të kthyer palën e dëmtuar njësoj sikur të mos ketë ndodhur gjë ose në një situatë tjetër të ngjashme.

Kjo mënyrë shpërblimi parshikohet edhe në nenin 7§2 i ligjit të posaçëm nr. 8510/1999 ku: *“administrata mënjanon pasojat, nëpërmjet rivendosjes se gjendjes se mëparshme ose, kur një gjë e tillë është e pamundur, nëpërmjet vendosjes se një gjendjeje të ngjashme.*

*Zhdukja e shkaqeve që sjellin demin nuk zbatohet kur rivendosja e gjendjes se mëparshme ose e një gjendjeje të ngjashme është e pamundur. Ky lloj dëmshpërblimi nuk zbatohet, gjithashtu, kur gjendja ekzistuese është shkaktuar nga një akt administrativ, i cili është bere i pakundërshtueshëm për të dëmtuarin”.*

I dëmtuari e humbet të drejtën e kthimit në gjëndjen e mëparshme kur ajo është e pamundur për arsye objektive që nuk varen OAP dhe kur akti administrativ që ka sjellë pasojën është bërë i pakundërshtueshëm si p.sh është parashkruar e drejta e

---

prokurimin publik”. Për pasojë nëse nuk lidhen kontrata dhe marrëveshjet sipas këtij ligji atëherë marrëdhëniet e krijuara janë të paligjshme dhe në kundërshtim flagrant...Në këto kushte, sipas gjykatës pala paditese në rastin e furnizimeve të bëra përmes I EVP Lushnjë përtej një tenderi të rregullt, mund t'i drejtohet gjykatës për shpërblim dëmi jashtë kontraktor të organeve shtetërore, të cilat me veprimet e tyre i kanë shkaktuar dëm në kuptim të ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999.

ankimit ndaj këtij vendimi, është shfuqizuar ligji në bazë të të cilit ishte nxjerrë ky akt administrati etj.

Me kërkesën nr.371/1 date 15.11.2006, ky subjekt i është drejtuar palës së paditur, për shpërblimin e dëmit si pasojë e vendimeve të padrejta të marra në adresë të shoqërisë “Media+”, por KKRT me vendimin nr.565 dt.29.01.2007 ka vendosur rrezimin e saj.

### 3.5.13 Dëme për çdo shkak tjetër të parashikuar me ligj

Në nenin 116 të KPRA i 2015 parashikohet se për arsye të mbrojtjes së jetës apo të shëndetit të njerëzve apo të sigurisë publike mund të vendoset shfuqizimi i aktit administrativ pa ardhur dëmi (*Për të parandaluar thotë neni*) ose gjatë, pas ardhjes së dëmit (*për të eliminuar thotë neni*) shfuqizimin e një akti administrativ të ligjshëm. Po ashtu kërkohet edhe kusht tjetër që ky parandalim a eliminim i dëmit nuk mund të bëhet në mënyra tjera që çënojnë më pak të drejtat apo interesat e ligjshëm të fituara të palës.

Neni 116§2 parashikon se:” *Pala përfituese, në rast të shfuqizimit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, ka të drejtën e kompensimit nëse ka hyrë në marrëdhënie financiare nga të cilat nuk mund tërhiqet ose mund të tërhiqet vetëm duke pësuar dëme që nuk do të ishte e arsyeshme të kërkohen nga ajo.*” Për ilustrim do të ishte rasti kur KM ka miratuar legalizimin e disa banesave informale. Rezulton nga matjet sizmike se ajo nuk është tokë e përshtatshme për banim e në këto kushte KM vendos që aktin e saj të ligjshëm ta revokoj a shfuqizoj. Të gjithë qytetarët që kanë marrë hua bankare për të mbuluar shumën e legalizimit apo kanë bërë investime në banesat e tyre do të kompensohen nga vetë KM ose organi i deleguar nga ai për dëmin e shkaktuar.

Masat e kompensimit do të jetë në një masë të arsyeshme pavarësisht se pala e dëmtuar mund të pretendoj se interesat e saj janë shumë më të larta nëse do të kishte fuqi akti i shfuqizuar. Po ashtu pala nuk përfiton as fitim të munguar.<sup>277</sup>

Afati për shfuqizimin apo anulimin e aktit administrativ bëhen në çdo kohë, ose në rast tjetër brenda 30 ditëve nga dita kur organi publik është njohur me faktet që çojnë në anulimin ose shfuqizimin, por jo me vonë se 5 vjet nga njoftimi i aktit administrativ.<sup>278</sup>

Nga ana tjetër çdokush që ka marrë pagesa apo kontribute nga pala e dëmtuar apo nga organi publik sipas parashikimeve të atij akti të anuluar/shfuqizuar duhet të kthehen, në të kundërt përgjegjësi mund të paditet për begatim pa shkak.<sup>279</sup>

Në aktin e anulimit, OAP llogarit edhe masën që duhet të kthehet e përlloritur sipas nenit 656 të KC mbi begatimin pa shkak që do të thotë: llogariten vlera reale e sendit së bashku me të ardhurat që ka nxjerrë ose duhet të nxirrte, shpenzimeve që ka bërë, sipas dispozitave për kërkimin e sendit nga poseduesi i paligjshëm. Për poseiduesin e paligjshëm me mirëbesim i paguhen shpenzimet e nevojshme dhe të

<sup>277</sup> Neni 116§3 i KPRA 2015 “3. Masa e kompensimit nuk duhet të tejkalojë interesin e arsyeshëm që ka pala në vazhdimin e sjelljes së pasojave juridike të aktit që shfuqizohet. Pala nuk përfiton kompensim për fitimin e munguar.”

<sup>278</sup> Neni 117 i KPRA 2015.

<sup>279</sup> Neni 188 “Kthimi i pagesave dhe kontributeve në rastin e anulimit” i KPRA 2015 :” 1. Të gjitha pagesat apo kontributet, të cilat tashmë janë paguar nga pala dhe/ose nga organi publik, në bazë të një akti të anuluar, duhet të kthehen. 2. Masa e kthimit të pagesave dhe kontributeve, e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, përcaktohet në aktin e anulimit dhe llogaritet nga organi publik, sipas dispozitave për begatimin pa shkak, në përputhje me legjislacionin civil”

dobishme që i kanë shtuar vlerën sendit (neni 299 i KC), për poseduesin e paligjshëm me keqbesim i kthehen vetëm shpenzimet e nevojshme (neni 300 i KC) dhe në asnjë rast nuk paguhen shpenzimet e luksit (neni 301 i KC).

Për dëme të tjera të cilat parashikon në ligje të posaçme më të rëndësishmin përmëdim ligjin nr. 8519/1999. Neni 3 i tij paraqet edhe raste të tjera të llojeve të dëmeve jashtëkontraktore që KPRA nuk i njeh.

Po ashtu ekzistojnë një sërë ligjesh të cilët për dëmet e shkaktuara nga OP referojnë drejtpërdrejtë tek ligji nr. 8510/1999 ose tek përgjegjësia jashtëkontraktore sipas Kodi Civil ose thjesht u njihet e drejta për shpërblim dëmi pa referuar ndonjë ligj përkatës (pra referencë blankete). Gjithësesi, për të gjitha rastet për shpërblim të dëmit jashtëkontraktor nga OAP do të jenë bazë ligjore nenet 608 e vijues të KC, neni 44 i Kushtetutës, ligji nr. 8510/1999 apo ligje të tjera të posaçme.

Paraqesim rastet e dëmeve jashtëkontraktore të OP tek ligjet e posaçme:

- Neni 14 § fundit i ligjit nr. 9780 datë 16 korrik 2007 “Për inspektimin e ndërtimeve” i ndryshuar parashikohet se: *”Në rast se në bazë të vendimit të formës së prerë të gjykatës, vendoset pranimi i padisë, i dëmtuari ka të drejtë të kërkoj nga inspektoriati që ka dhënë vendimin, dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar.”*

Në çështjen “A...projects”shpk kundër Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar Tiranë dhe INUK Dega Shkodër, paditësi ka ankuar vendimarrjen e INUK Tiranë për pezullim të punimeve të një godine polifunkionale në qendër të Shkodrës, duke u llogaritur sipas paditësave dëmi në 4000 euro. Kjo vendimarrje e INUK Tiranë i mbajtur nga inspektorët e Degës Shkodër u konsiderua i absolutisht i pavlefshëm pasi kishin dalë jashtë kompetencave të tyre lëndore. Në këto kushte, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 69 datë 04 shkurt 2014 la në fuqi vendimet e shkallëve më të ulëta për shpërblimin e dëmit të pësuar nga pezullimi i ndërtimit për dhjetë ditë meqenëse pezullimi vjen nga një akt administrativ i paligjshëm bazuar tek nenet 608 e vijues të K.Civil.

Një ligj tjetër që parashikon shpërblim për një veprim të padrejtë të organeve të administratës publike si p.sh Komisarariatet e Policisë, Drejtoritë e Policisë së Qarqeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve etj. (përjashto këtu organet e pushtetit gjyqësor dhe prokurorinë) është ligji nr. 9381 datë 28 prill 2005 “Për kompensimin për burgim të padrejtë.” Të tillë janë rastet kur një person është mbajtur në dhomat e paraburgimit pa të drejtë nga ana e Komisarariatit Përkatës apo e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale ku po vuan masën e sigurimit “Arrest në burg” apo në ndonjë IIEVP tjetër të DPB personi i dënuar nuk lirohet në kohën e duhur sipas disponimit të gjykatës por mbahet në burg pa të drejtë.

Ky ligj vjen në zbatim të nenit 5 § 5 e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut e cila parashikon se: *“5. Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim.”*

Sipas nenit 44 të Kushtetutës: *“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti , veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”.*

Sipas nenit 268 të K.Pr.Penale, në të cilin ndër të tjera parashikohet se *“Ai që është deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë ka të drejtën e kompensimit për paraburgimin e vuajtur, me përjashtim të rasteve kur është provuar që vendimi i gabuar ose moszbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij...”*

Objekti i ligjit është të rregulloj rastet e kompensimit për burgim të padrejtë, masën e mënyrën e llogaritjes së tij, si dhe procedurat për kërkimin, pagesën dhe

kompensimin për burgim të padrejtë. Neni 3 përcakton se përfiton nga e drejta për kompensim për kohën e burgimit të vuajtur personi:

1. që është deklaruar i pafajshëm;
2. ose për të cilin është pushuar çështja me vendim gjykate të formës së prerë apo të prokurorit;
3. është mbajtur në burg tej kohës së caktuar në vendimin e dënimit.

Termi burgim i padrejtë nuk duhet kuptuar vetëm koha e burgut me një vendim gjyqësor të formës së prerë por edhe koha e paraburgimit apo ajo e arrestit në shtëpi.

I detajojmë si më poshtë:

1. periudha e paraburgimit:

- a. për një çështje ose akuzë, për të cilën prokuroria ka pushuar hetimet ose gjykata ka dhënë pafajësi ose ka pushuar çështjen;
- b. periudha e paraburgimit më tepër nga sa është dënuar me vendim të formës së prerë;
- c. kur, me vendim gjykate të formës së prerë, është vërtetuar se akti ishte nxjerrë pa respektuar kushtet e parashikuara në nenet 228 e 229 të Kodit të Procedurës Penale;
- d. periudha e paraburgimit kur, me vendim gjykate të formës së prerë, është vërtetuar se akti ishte nxjerrë pa respektuar kushtet e parashikuara në nenet 228 e 229 të Kodit të Procedurës Penale;
- e. periudha e paraburgimit tej kufijve ligjorë të afateve të lejuara për kohën e paraburgimit;
- f. përjashtohen rastet kur me vendim gjykate është vërtetuar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, për shkak të shfuqizimit të dispozitës përkatëse, e drejta e kompensimit nuk njihet për atë pjesë të paraburgimit të vuajtur para shfuqizimit.
- g. Nuk njihet periudha e paraburgimit të vuajtur, e llogaritur për efekt të caktimit të kohës së dënimit me burgim, në rastet e parashikuara në nenin 465 të Kodit të Procedurës Penale.

2. periudha e burgimit:

- a. në zbatim të një vendimi, i cili, pas vënies në ekzekutim, është prishur dhe është dhënë pafajësi ose është pushuar çështja me vendim të formës së prerë me përjashtim të rasteve kur është provuar se vendimi i gabuar ose moszbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij;
- b. periudha e burgimit më tepër nga sa është dënuar me vendim të formës së prerë;
- c. e shkaktuar nga gabimi në urdhrin e ekzekutimit të vendimit;
- d. këtu përjashtohet rasti kur personi i burgosur për një vepër, që ndiqet me ankim pushohet për shkak pajtimi.

3. periudha e vuajtjes së arrestit në shtëpi në rastet e përcaktuara në shkronjat "a", "c", "ç" dhe "d" të këtij neni.

Sipas nenit 5,6 të ligjit, masa e kompensimit për burgim të padrejtë është deri në 2 000 (dy mijë) lekë për një ditë burgim, deri 3 000 (tre mijë) lekë për një ditë paraburgim dhe jo më shumë se ½ (një e dyta) e shumës së caktuar për burgimin pra jo më shumë se 1000 lekë për çdo ditë arrest në shtëpi.

Po ashtu sipas nenit 7 të ligjit "Për kompensimin për burgim të padrejtë", gjykata mund të urdhëroj dhe rikthimin në punë për çdo të paraburgosur apo person të arrestuar në shtëpi( pra jo të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë), në rastet kur ka qënë izolimi i tij shkak që të zgjidhen mardhëniet e punës.

Megjithatë rastet janë shteruese kur mund të urdhërohet kthimi në punë kjo për çdo punëdhënës (nënkupto privat apo publik) citojmë: kur është vendosur pushimi i çështjes ose është dhënë pafajësi në favor të tij, sepse nuk ka kryer veprën që akuzohet, fakti nuk ekziston, fakti nuk përbën vepër penale ose fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Në fakt ky nen duhet kuptohet se zbatohet vetëm për punëdhënësit, organ publik pasi vetëm në këtë mënyrë harmonizohet me nenet 146§3, 155§3 të Kodit të Punës (i ndryshuar së fundim me 22 qershor 2016) i cili parashikon se kthimi në punë zbatohet nga punëdhënësi kur ka vendim gjyqësor të formës së prerë për punëmarrësit në administratën publike dhe jo për atë në fushën private si shoqëritë tregtare, personat fizik tregtar, shoqëritë e thjeshta etj.

Në lidhje me gjykimin e padive të tilla mund të themi se legjitimohen të ngrenë padi jo vetëm personi i burgosur, i paraburgosur apo i arrestuari në shtëpi por edhe trashëgimtarët për sa kohë e drejta nuk i është parashkruar në kohën kur ai ishte gjallë. Kjo e drejtë parashkruhet brënda tre viteve nga data e lindjes së të drejtës. Për një person të paafte mendërisht apo edhe të mitur, e ngre padinë kujdestari ligjor.

Edhe pse afati i parashkrimit është e njëjtë si ajo e parashikuar nga ligji nr. 8510/1999 mund të themi se të drejtën për të kërkuar shpërblim për dëmin e shkaktuar drejtëpërdrejtë i takon vetë individit dhe jo trashëgimtarëve. Sipas nenit 13 të ligjit, trashëgimtarët kanë të drejtë të kërkojnë shpërblim si të dëmtuar jo të drejtëpërdrejtë.

Gjykata kompetente është gjykata e rrethit gjyqësor që ka dhënë vendimin e dënimit ose në territorin e së cilës ndodhet organi, që është ngarkuar për pagesën e kompensimit për burgim të padrejtë. Meqënëse sipas nenit 9§2 parashikohet se kompensimi përballohet nga Buxheti i Shtetit do të thotë që organi përkatës që ka legjitimitet pasiv është Zyra e Thesarit të Ministrisë së Financave pranë çdo Bashkie. Po ashtu në cilësinë e personit të tretë edhe sipas praktikës gjyqësore thirret edhe Prokuroria pranë Gjykatës që ka dhënë vendimin.

Pas krijimit të Gjykatave Administrative datë 04 nëntor 2013, pavarësisht se në nenin 8 § 4 të ligjit parashikohet se shqyrtimi gjyqësor bëhet sipas rregullave të gjykimin të padisë civile në procesin penal, këto lloj padish janë cilësuar si padi me natyrë administrative pasi paditet një organ administrativ publik siç është Ministria e Financave dhe Dega e Thesarit nën varësinë e saj.

Në vendimin nr.00-2014-823 datë 21.04.2014, Kolegji Civil i GJL pasi u ngrit çështja e kompetencës lëndore u shpreh “7.2. Në nenin 15/a të ligjit nr.49/2012, është përcaktuar se të drejtën e padisë në gjykatën administrative e ka çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik. Në rastin në gjykimin paditësi pretendon se i janë cenuar të drejtat e tij nga veprimet e organeve publike. 8. Gjithashtu, kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është gjykata administrative edhe në referim të germave “e”, “dh” dhe “f” të nenit 17/1, të ligjit të sipërcituar, në të cilat është përcaktuar se padia para gjykatës administrative ngrihet: “(dhe) për saktësimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet paditësit dhe organit publik; e) për detyrimin e organit publik për të kryer apo për të ndaluar kryerjen e një veprimi tjetër administrative, të nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave apo të interesave të paditësit; f) “për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, sipas ligjit të posaçëm” (këtu nënkupto ligji nr.8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i ndryshuar, sipas të cilit organet e administratës shtetërore detyrohen për të shpërblyer dëmin që këto organe i’u kanë shkaktuar interesave të personave privatë në ushtrim e sipër të funksioneve të tyre publike).”

Në rast se përfituesi rimerret në përgjegjësi penale në të njëjtën çështje, edhe për të njëjtën vepër, ekzekutimi i vendimit gjyqësor për kompensim pezullohet dhe nëse është kryer i gjithë ekzekutimi përfitimet kthehen, tërësisht ose pjesërisht.

Praktika gjyqësore është e konsoliduar për këtë intsitut sa civil, penal dhe administrativ. Përpara hyrjes në fuqi të ligjit të posaçëm, ishin Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr.3/2003 që njësuani praktikën gjyqësore mbi natyrën e kërkesës, palët pjesmarrëse, mënyrën e matjes së dëmit etj. Të gjitha këto interpretim u përfshin më pas në ligjin nr. 9381/2005. Megjithatë Gjykata unifikoi faktin se pjesmarrës duhet të tjetë në cilësinë e personit të trete edhe Prokuroria e cila ka filluar ndjekien penale përkatëse.

Po ashtu Gjykata interpretoi se nuk vihen shenja barazimi mes dëmeve të shkaktuar sipas nenit 640 të Kodit Civil dhe kompensimit për burgim të padrejtë por me ligj duhet të përcaktohen kriteret përkatëse të kompensimit. I bie barra paditësit të provoj sepse masa e dëmit shkaktuar është maksimale për të cilën kërkon edhe shpërblimin maksimal dhe gjykatat nuk duhet të japin apriori masën prej 3000 lekë për çdo ditë paraburgim, 2000 lekë për çdo ditë burgim etj.

Një sërë vendimesh janë dhëne edhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë si vendimi 00-2015- 3676 (558)558 datë 27 tetor 2015, nr. 00-2014-3921 datë 23.09.2014, nr. 00-2014-3529 datë 30.09.2014 mbi shpërblimin e dëmit nga ana e organit publik për burgim a paraburgim të padrejtë të individëve.

**KREU IV****GJYKIMI I PADIVE MBI DËMIN JASHTËKONTRAKTOR NDAJ ORGANEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE***4.1 Hyrje**4.2 Juridiksioni i gjykimit të kërkimeve**4.3 Gjykatat kompetente**4.4 Legjitimimi pasiv i organit shtetëror**4.5 Provat që mund të merren në gjykim**4.6 Barra e provës**4.7 Disponimi i gjykatës mbi shpërblimin e dëmit**4.8 Parashkrimi i padive për shpërblim të dëmit jashtëkontraktor**4.9 Afati për parashkrimin apo dekadencën**4.10 Vendimarrja e Gjykatës***4.1 Hyrje**

Duke qënë se shumë mosmarrëveshje mbi shpërblimin e dëmit përfundojnë si konflikt gjyqësorë është e rëndësishme të ndalemi edhe tek karakteristikat e gjykimit të padive mbi dëmin jashtëkontraktor të OP.

Sipas nenit 18 të ligjit nr. 8510/1999 ” *Procedurat për kërkimin dhe përmbushjen e dëmshpërblimit bëhen në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"*. Por tashmë kjo referencë ligjore me hyrjen e KPRA të Ri në 28 maj 2016 zëvendësohet me ligjin nr. 44/2015 “Për Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Pasi në nenin 187 të këtij ligji parashikohet se:”*Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, çdo referim që dispozitat ligjore dhe nënligjore bëjnë në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, apo dispozita të veçanta të tij, vlerësohet si e bërë në këtë Kod, për aq sa është e mundur*”. Pra, rregullimi i gjykimeve të këtyre padive bëhet sipas dispozitave të KPRA të Ri, ligjit nr. 49/2012 “Për organizmin dhe funksionin e gjykatave administrative dhe për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe Kodit të Procedurës Civile për aq sa ndonjë moment nga procedura e gjykimit nuk është përcaktuar apo rregulluar nga legjislacionet primare.

Herë pas here mund t’u referohemi edhe KPRA 1999 meqënëse në dispozitat tranzitore të Ligjit të ri parashikohet se procedurat e nisura administrative do të vazhdojnë të gjykohen me KPRA e 1999.

**4.2 Juridiksioni i gjykimit të kërkimeve**

Pretendimi për një dëm jashtëkontraktor të shkaktuar nga OAP mund të bëhet si përpara organit administrativ që ka nxjerë aktin dhe ka sjellë pasojën, ose tek organi epror i tij. Nëse organi publik nuk kthen përgjigje brenda afatit të përcaktuar në ligj zakonisht brenda 30 ditëve, i dëmtuari legjitimohet ti drejtohet organit më të lartë të tij. Po ashtu edhe nëse ky nuk kthen përgjigje mund ti drejtohet gjykatës administrative (nëse padia dorëzohet pas 04 nëntorit 2013 kur filluan funksionimin këto gjykata).<sup>280</sup>

<sup>280</sup> Në vendimin nr. 00 - 2015 – 2609, datë 12 maj 2015, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vendosi të lërë në fuqi vendimin e GJRRGJ Tiranë që nuk kishte nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit

Por ankesa paraprake për t'iu drejtuar organeve administrative, nuk përbën kusht që i dëmtuari të mos ketë të drejtë të drejtohet gjykatës. Pra, kjo është në diskrecionin e të dëmtuarit nëse kërkon operativitet dhe shpëjtësi duke iu drejtuar organeve administrative apo t'i drejtohet gjykatës për ta zgjidhur përfundimisht çështjen por që mund të zgjatet në kohë deri në vendimarrjen e formës së prerë.

Në vendimin nr. 310 datë 01 korrik 2010 të Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil ka trajtuar në mënyrë të detajuar natyrën e dëmit jashtëkontraktor të pretenduar ndaj një OAP. Kështu Shoqëria "A..." sh.a padit Ministrinë e Financave për dëmin e shkaktuar si rezultat i anulimit pa të drejtë të licencës për ushtrim të lojrave të fatit. Vendimarrja e padrejtë e MF u konstatua absolutisht e pavleshme nga një gjykim i mërrparshëm i formës së prerë. Menjëherë pas këtij fakti, paditësi kërkon sipas nenit 608 e vijues të KC shpërblimin e dëmit të ardhur nga ndërprerja e veprimtarisë. Kolegji Civil duke gjetur të drejtë vendimin e GJRRGJ Tiranë për mosnxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor shprehet se: " ... Sipas nenit 36§1 të Kodit të Procedurës Civile janë në juridiksionin gjyqësor të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta. Për rrjedhojë, paditë që themelohen në dispozitat e Kodit Civil dhe në ligjin nr.8510, datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore" janë mosmarrëveshje civile që i përkasin ekskluzivisht juridiksionit gjyqësor. Mjafton vetëm shkaku i padisë i themeluar mbi këto dispozita për të detyruar gjykatën të marrë në shqyrtim çështjen dhe pas shqyrtimit gjyqësor të shprehet me vendim përfundimtar. ... Kjo e drejtë nuk kushtëzohet nga detyrimi që, subjekti para se të ngrëjë padinë, domosdoshmërisht duhet t'i drejtohet në rrugë administrative palës së paditur.."

Në fakt të konfondon, dispozita e 18-të e ligjit nr. 8510/1999 ku parashikon se procedurat për kërkimin dhe përmbushjen e dëmshpërblimit bëhen në përputhje me kërkesat e KPRA. Ashtu siç do ta trajtojmë edhe më poshtë sa kohë që po në këtë ligj, nuk referohet se kush është organi epror ku dhe kur mund të bëhet ankimi administrativ nuk mund të themi se rruga e rekursit administrativ është e detyrueshme. Referenca tek KPRA, vazhdon më tej argumentin Kolegji Civil në vendimin e mësipërm: "është më tepër detyruese për OASH se në rast kërkesë për shpërblim dëmi jashtëkontraktor, të respektojë parimet që përshkojnë administratën publike dhe, për aq sa është e mundur, të zhvillojë një procedurë hetimore administrative në vërtetimin ose jo të pretendimeve të subjektit."

Në vendimin nr. 2819 datë 22 dhjetor 2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë Gjykata ka vendosur detyrimin e të paditurit Këshillit Kombëtar të Radio Televizionit Publik Privat në Shqipëri të shpërblej paditësin Shoqëria "Media +" shpk (TV Shijak) në shumën 112.861.320 leke dhe rrezimin e padisë për pjesën tjetër në shumën 30.741.908 lekë.

Sipas fakteve të çështjes rezulton me vendimin nr. 298 date 22.12.2004 pala e paditur KKRT ka bere te pavlefshme licencën për shoqërinë "Media +" shpk në pronësi të të cilës është edhe televizioni "TV Shijak" dhe e ka hequr ate, duke ndërprerë menjëherë transmetimin. Po ashtu sipas urdherit nr. 2 dt.10.01.2005 i KKRT Drejtorja e Pergjithshme Tatimeve, me proces-verbalin date 07.03.2005, ka kryer ç'bllokimin me "Ç'kycje" te kabullave e paisjeve "Radio-Rele" qe lidhin studiot, me paisjet transmetuese.

---

gjyqësor duke arsyetuar se pala paditëse ishte ankuar ndaj urdërit të Ministrit të Transportit dhe infrastrukturës, tek vetë ky organ, i cili nuk i kishte kthyer përgjigje për më tepër se një muaj. Në këto kushte ankimi administrativ është ezauruar dhe çështja i takon juridiksionit gjyqësor. Paditësi nuk kishte detyrim ta ndiqte këtë ankim administrative e aq më tepër të ankohej tek Kryeministri pas heshtjes së Ministrit.



Kjo vendimarrje e KKRT-së është gjetur e kundërligjshme nga gjykatat e dy niveleve ku me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 217, datë 26.02.2006 është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr.1732 date 30.03.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë:”Pranimin e pjesshem te padise se ngritur nga Shoqëria “Media +” Sh.a. (TV Shijak). Ndryshimin e Aktit Administrativ te vendimir nr.298 date 22.12.2004 te K.K.R.T-se për sa i perket sanksionit administrative duke vendosur ndaj paditesit masen e uljes së afatit të liçences deri ne 50% te saj. Masa konkrete e shprehur në përqindje i lihet në diskrecion palës së paditur KKRT-se duke u bazuar në kriteret ligjore të përcaktuara në këtë vendim”. Refuzimin e kerkese të palës paditese per vënjen e këtij vendimi në ekzekutim të përkohshem”.

Pas këtij vendimi, KKRT me datë 27 prill 2006 ka vendosur:”1. Shfuqizimin e vendimit nr.298 datë 22.12.2004 të KKRT “Për mbylljen e aktivitetit transmetues te “TV-Shijak”.2. Shoqeria “Media +” në rast se është e interesuar të vazhdojë veprimtarine e mëtejshme për televizionin privat vendor “TV Shijak”, të depozitojë dokumentacionin përkates për rinovimin e liçences në perputhje me nenin 25 te ligjit dhe Rregullores “Mbi procedurat e rilicensimit te operatorve privat RTV” brenda dates 31.05.2006”.

Shoqëria “Media +” shpk i drejtohet KKRT për shpërblimin e dëmit si pasojë e vendimeve të padrejta të marra në adresë te shoqerise “Media+”. Kërkese që me vendimin nr.565 dt.29.01.2007 të palës së paditur rrëzohet. Këtë vendimarrje paditësi e paraqet si konflikt gjyqësor para GJRRGJ Tiranë për shpërblim të dëmeve pasurore dhe jopasurore të shkaktuar nga ana e saj.

Në këtë rast pala ka preferuar t’i drejtohet organit administrativ përpara se t’i drejtohet gjykatës.

Nëse i referohemi ligjit nr. 8510/1999 nuk parashikohet ndonjë mënyrë për tu ankuar për dëmin e shkaktuar nga organet e administratës publike. Po ti referohemi Kreut IV të këtij ligji “Për procedurat për kërkimin dhe pagimin e dëmshpërblimit” parashikohet se ato bëhen në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8485, date 12. 05. 1999 "Kodi i Procedurave Administrative te Republikës së Shqipërisë" (neni 18) dhe pas hyrjes në fuqi me datë 28 maj 2016 të KPRA i Ri proçedurat do bëhen në bazë të këtij ligji.

Neni 129 i KPRA i Ri ashtu edhe neni 16 i ligjit nr. 49/2012 kanë përmbajtje identike. Tek të dy këto nene parashikohet se shterimi i ankimit administrativ është kusht paraprak për t’iu drejtuar gjykatës kompetente adminsitative me padi. Ndërsa si raste përjashtimore të dy këto nene parashikojnë:

- a) ligji nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë administrativ nuk është konstituuar;
- b) ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t’u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtpërdrejt në gjykatë;
- c) organi më i lartë në shqyrtimin e një ankimi administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, të drejtat apo interesat personale të ligjshëm të një personi, i cili nuk ka qenë palë në procedimin administrativ.

Ligji nr. 8510/1999 po në kreun mbi proçedurat për kërkimin e pagimit të dëmshpërblimit parashikon se :”Vendimi i organit te administratës shtetërore për njohjen e përgjegjësisë ne shkaktimin e demit, për pagimin e dëmshpërblimit përkatës dhe te masës se tij, përbën titull ekzekutiv. ” Megjithatë ky parashikim nuk mund të konsiderohet se pala është e detyruar të shteroj ankimin adminitrativ për sa kohë ligji nuk ka parashikuar organin administrativ që i drejtohet për të bërë ankimin, nuk ka parashikuar afatin që i drejtohesh etj. kjo edhe në referencë të vendimit unifikues me nr. 1/2010 të KB të GJL e cila njësoi praktikën se:” Ndjekja e rrugës administrative (të

apelimit administrativ) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative përpara se subjekti t'i drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhëniet juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse, parashikon shprehimisht se ndaj aktit administrativ mund të ushtrohet ankim administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative tek të cilët eventualisht, sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ. ... Në çdo rast, pavarësisht nëse parashikohet apo jo shprehimisht në ligjin e posaçëm, pas dhënies së vendimit nga organi a organet administrative të ngarkuar nga ligji, pala që kishte ushtruar ankimin administrativ ka të drejtën t'i drejtohet rrugës gjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative. Nëse ligji i posaçëm nuk parashikon shprehimisht ndryshe, zbatohen afatet dhe procedurat e parashikuara për këtë qëllim nga Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurave Administrative.”

Pra për sa më sipër themi se ligji nr. 8510/1999 përfshihet në ato raste përjashtimore kur nuk është parashikuar organi më i lartë ku mund të bëhet ankimi dhe i dëmtuari mund t'i drejtohet drejtpërdrejtë gjykatës pa iu drejtuar më parë organit administrativ që i ka shkaktuar dëmin apo ndonjë eprori të tij.

Praktika paraqet raste ku palët i kanë kërkuar organit administrativ që ka shkaktuar dëmin që ta njohë dëmin e shkaktuar në mënyrë që me atë vendim të shkohet direkt në ekzekutim meqenëse përbën titull ekzekutiv. Më së shumti, praktika gjyqësore në Shqipëri tregon se palët e dëmtura zgjedhin t'i drejtohen gjykatës për të kërkuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga OAP kjo si një mënyrë për tu ballafaquar përfundimisht me këtë organ, duke u nisur nga fuqia që ka vendimi gjyqësor i formës së prerë.

Shtetasit E.K, E.A dhe S.R kanë paditur Komunën Kashar, Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekturës së Qarkut Tiranë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të dëmshpërblejnë paditësat për dëmin e shkaktuar për shkak të regjistrimeve në të njëjtën kohë të njëjtës pronë në emër të dy pronarëve të ndryshëm dhe për dëmin e shkaktuar nga mospërdorimi i ligjshëm i pronës së përfutur me ligjin nr. 7501/1991 “Për tokën” i ndryshuar.

Gjykata administrative e Shkallës së parë Tiranë (më tej GJASH i-rë Tiranë) ka rrëzuar kërkesën e të paditurve për nxjerrjen jashtë juridiksionit të pikës 3 të objektit mbi dëmshpërblimin pasi nuk kishin paraqitur më parë ankim administrativ pranë Komunës dhe ZVRPP sipas KPRA së 1999, ligjit nr. 8510/1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve shtetërore” dhe nenet 66, 67 të ligji nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë pasi la në fuqi vendimin e shkallë së parë u shpreh se: “...kërkimi ka të bëjë me dëmshpërblim prej organeve shtetërore siç janë ish Komisioni i Ndarjes së Tokave (sot Komuna Kashar dhe Qarku Tiranë) si dhe ZVRPP Tiranë. Më të drejtë gjykata administrative ka arritur në përfundimin se legjislacioni nuk parashikon detyrueshmërisht rrugën administrative dhe ndonjë organ administrativ për të shqyrtuar një kërkim të tillë dhe përcaktuar dëmshpërblimin e kërkuar nga paditësit për shkeljet e pretenduar të institucioneve të sipërpërmendura në regjistrimin e pasurisë.”<sup>281</sup>

Megjithatë duhet bëhet kujdes në lidhje me kundrejtimin e kërkesave karshi OAP pasi në rast se janë kundërshtuar veprimet përmbarimore të cilat janë gjetur në shkelje të ligjit, organi mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar gjatë këtyre veprimeve përmbarimore ose qofte edhe vetë zyra përmbarimore. Por dëmi i pretenduar nga

<sup>281</sup> Shih më tej vendimin nr. 00-2015- 2649 datë 14 maj 2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë tek [www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al).

vonesa në ekzekutimin e detyrimit, nuk mund të kërkohet nëpërmjet ligjit nr. 8510/1999 pasi veprimet apo aktet e përmbaruesit janë veprime juridike të posaçme që rregullohen nga nenet 510 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe nuk përbëjnë veprime, mosveprime apo akte administrative.

Po ashtu edhe veprimtaria e tyre nuk përbën një veprimtari të centralizuar, ekzekutive urdhërdhënëse, por është një profesion i lirë publik i rregulluar me ligje të veçanta njësoj si profesioni i avokatit, noterit etj.

Në vendimin nr. 11/2011 të Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi Shoqëria “El..oti” shpk pretendon se Zyra e Përmbarimit Elbasan në kundërshtim me ligjin nuk ka ekzekutuar një vendim gjyqësor të formës së prerë që e urdhëron të vazhdoj veprimet përmbarimore në favor të kërkuesit si kreditori i Zyrës Rajonale Arsimore Elbasan. Mbi pretendimin e kërkuesit për shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga Zyra Përmbarimore Elbasan si rezultat i moszekutimit për dy vjet me rradhë të këtij vendimit të Gjykatës. GJK u shpreh se:” Për sa i përket kërkimit për kompensimin e dëmit, si rezultat i ekzekutimit me vonesë të vendimeve gjyqësore, Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se ky është një kërkim i ri, i cili mund të paraqitet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në bazë të dispozitave të Kodit Civil, që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit të shkaktuar, si rrjedhim i vonesës në pagimin e një shume të hollash (neni 450 i Kodit Civil). Vetëm pas shterimit të mbrojtjes juridiksionale, kërkuesi mund të vërë në lëvizje procedurat kushtetuese, në bazë të nenit 131, shkronja "f" të Kushtetutës (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.27, datë 20.6.2007 dhe nr.6 datë 6.3.2009).Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa për dëmshpërblim nuk mund të merret në shqyrtim prej saj.”

Këtë qëndrim ka mbajtur edhe më së fundi Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 32 datë 30 mars 2017 ku shtetasi A.M pretendonte se vendimi i hapjes së procedurës së falimentimit të Shoqërisë L.. shpk nuk është gjykuar brenda 30 ditëve sipas nenit 6 dhe 7 të ligjit nr. 8901/2002 “Për falimentimin” i ndryshuar. Pra nga vendimi i Shkallës së Parë me datë 18.12.2012 e Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë ka disponuar me datë 29.04.2014 përtej afatit 30 ditë. Gjykata konstatoi cenim të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda një afati të arsyeshëm. Ndërsa në lidhje me kërkimin për shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror në vlerën 20.000.000 lekë vendosi rrëzimin e kërkimi pasi nuk ishte nënshtruar juridiksionit të zakonshëm të gjykimit.

Pra, padia për shpërblimin e dëmit të ardhur nga veprimet, mosveprimet, aktet e paligjshme etj. të administratës shtetëror/publike mund të ngrihet si një gjykim normal duke ndjekur të gjitha shkallët e pushtetit gjyqësor dhe jo si një kërkim i ri vetëm në Gjykatën Kushtetuese e cila në lidhje me gjykimet për shkelje të të drejtave kushtetuese sipas nenit 131 shkronja “f” e Kushtetutës shërben si “shkallë e katërt” e pushtetit gjyqësor.

Vlen të përmendet se ligji nr. 8510/1999 nuk mund të jetë baza ligjore e duhur për të pretenduar shpërblim nga cënimi i të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Madje vetë Gjykata Kushtetuese çmon se:”ligji nr. 8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” ka për objekt rregullimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore, përgjegjësi që mund të lindë si pasojë e veprimtarisë administrative të tyre, dhe jo parashikimin e mundësisë për të pretenduar cenimin dhe për të rivendosur të drejtën kushtetuese për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, e drejtë kjo që konsumohet brenda kuadrit të një procesi gjykimi të zhvilluar prej gjykatave të pushtetit gjyqësor... Si rrjedhim, Gjykata Kushtetuese çmon se ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” nuk

përbën një mjet juridik për të rivendosur të drejtën kushtetuese për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshem. ...Gjykata Kushtetuese konkludon se dispozitat e mësipërme kushtetuese ..., nuk mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë për të kërkuar në gjykatë riparimin/rivendosjen e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshem”.<sup>282</sup>

Padi të tillë mund të jenë bashkim kërkimesh me padinë kryesore, por mund të ngrihen edhe si padi më vehte drejtpërdrejtë në gjykatën administrative. Kjo rezulton nga neni i ligjit nr. 49/2012. Ndërsa neni 325 i KPRC (tashmë i shfuqizuar) i shtuar në KPRC me ligjin nr. 8491, datë 27.5.1999, e parashikonte qartë se kjo padi ngrihej edhe më vehte duke e lënë në diskrecion të vetë të dëmtuarit.<sup>283</sup>

### 4.3 Gjykata kompetente

Kompetenca lëndore e gjykatave administrative dhe mosmarrëveshjet që gjykohen prej saj është e parashikuar në nenin 7 të ligjit nr. 49/2012 konkretisht: “Gjykatat administrative janë kompetente për: a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik; b) mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik; c) mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet organeve të ndryshme administrative në rastet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative; ç) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është organ i administratës publike; d) kërkesat e paraqitura nga organet administrative për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, për të cilat ligji parashikon heqjen e lirisë deri në 30 ditë, si një lloj të dënimit administrativ për kundërvajtësin; dh) kërkesat e paraqitura nga kundërvajtësit për zëvendësimin e dënimit administrativ me heqje lirie deri në 30 ditë me dënimin me gjobë.”

Në këtë nen nuk është parashikuar shprehimisht se paditë mbi shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar nga OAP të jenë në kompetencë lëndore të Gjykatave Administrative. Kjo del si rezultat i shkronjave a dhe b të nenit 7 ku thuhet se Gjykatat Administrative gjykojnë mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik si dhe mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik. Në këto dy lloj mosmarrëveshjesh hasim formë të dëmeve që parashikohen nga ligji nr. 8510/1999 si p.sh dëme të ardhura nga shpronësimet publike të padrejta, dëmet të ardhura nga aktet administrative individuale, por që kanë sjell pasojë tek të tretët, dëmet që vijnë nga veprimet e paligjshme apo mosveprimet e OAP etj.

<sup>282</sup> Shih vendimin nr. 12/2012 e GJK me palë A.K ndaj K.K.R.T etj.

<sup>283</sup> Neni 325 “Padia, sipas nenit 324 të këtij Kodi, mund të ngrihet kur paditësi argumenton se akti administrativ është i paligjshëm dhe se atij i cenohen interesat dhe të drejtat e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, individualisht ose në mënyrë kolektive.

Padisë, për gjykimin e një akti administrativ, i bashkëlidhet një kopje e aktit administrativ që kundërshtohet dhe çdo dokument tjetër provues.

Kërkimi i shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga akti administrativ i kundërligjshëm mund të kërkohet sipas rregullave të përgjithshme edhe me padi të veçantë.”

Gjithashu kompetenca lëndore e gjykatave administrative del edhe nga neni 17 “Objekti i padisë” i po këtij ligji ku parashikohet se:”*Padia ngrihet...: f) për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, sipas ligjit të posaçëm;*”

Në çështjen D.S kundër Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave kërkohet kthimi i shumës prej 204,600 Lekë si begatim pa shkak i palës së paditur sipas nenit 653 deri 655 të KC. Paditësi pretendon se kjo tarifë padrejtësisht është kërkuar nga ana e palës së paditur për ndjekur programin e doktoraturës, pasi ai si student i shkëlqyer përjashtohet nga kjo tarifë bazuar edhe në ligjin “Për arsimin e lartë”. Arsyeja pse pala paditëse e ka paguar është për të mos e humbur e drejta e studimit në ciklin e tretë.

GJRRGJ Tiranë me vendimin nr.2418, datë 24 mars 2016 ia ka kaluar çështjen për shqyrtim, GJASH I-rë Tiranë, meqënëse pala e paditur është organ publik. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. 00-2016-2081, datë 17.06.2016 me argumentimin se:” *10. Për çështjen objekt gjykimi, Kolegji Civil vëren se mosmarrëveshja ndërmjet palëve ndërgjyqëse ka të bëjë me të drejta të lindura nga përgjegjësia e institucionit publik, në kushtet e ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të këtij të fundit. Në këto rrethana, thelbi i kërimit të paditësit konsiston në detyrimin e institucionit publik palë të paditur, për të shpërblyer dëmin e shkaktuar interesave të paditësit, si rezultat i begatimit pa shkak të palës së paditur.*

*11.Për sa më sipër, në kushtet kur pretendimi i palës paditëse, lidhet efektivisht me dëmin e shkaktuar nga cenimi i pretenduar i të drejtave dhe interesave të tij, nga ana e një institucioni publik, mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative dhe për rrjedhojë, kompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e saj është gjykata administrative.”*

Mendojmë se e drejta e disponimit të padisë pra përcaktimi i objektit dhe shkakut ligjor ku personi mbështet të drejtën e tij subjektive i takon ekskluzivisht paditësit në përputhje me nenin 5 të KPRC. Paditësi ka pretenduar se shuma që ai ka paguar pa të drejtë palës së paditur është begatim pa shkak dhe ka referuar nenin 653, 654, 655 të KC, duke e paraqitur mosmarrëveshjen e tij si çështje civile.

E njëjta situatë paraqitet edhe në vendimin nr. 00-2016-2519 datë 22.09.2016 të Kolegjit Civile të Gjykatës së Lartë ku është lënë në fuqi vendimi i GJRRGJ Lezhë që ka dërguar çështjen në GjASH I-re Shkodër edhe pse padia kishte objekt dhe bazë ligjore që dukej si padi civile pra, “Shpërblim dëmi jo kontraktual sipas nenit 608, 640 të KC”. Nisur nga palët ndërgjyqëse të padisë pra Shoqëria tregtare “P.” ndaj Drejtoria e Policisë Qarkut Lezhë, Gjykata e Lartë ka konkluduar se ka një mosmarrëveshje administrative.

Instituti i begatimi pa shkak është një quasi-kontratë e cila është tipike në mardhëniet juridike civile dhe nuk është institut i së drejtës administrative (shih KPRA të 2016, ligjin e posaçëm nr. 8510/1999, ligjin nr. 49/2012 ku mungon termi begatimi pa shkak i organeve të administratës publike). Madje edhe në të vetmin nen që përmendet ky institut tek KPRA i Ri, neni, 118§2 -Kthimi i pagesave dhe kontributeve në rastin e anulimit” pranohet se ai është një institut që rregullohet nga KC:” *1. Të gjitha pagesat apo kontributet, të cilat tashmë janë paguar nga pala dhe/ose nga organi publik, në bazë të një akti të anuluar, duhet të kthehen.*

*2. Masa e kthimit të pagesave dhe kontributeve, e parashikuan në pikën 1, të këtij neni, përcaktohet në aktin e anulimit dhe llogaritet nga organi publik, sipas dispozitave për begatimin pa shkak, në përputhje me legjislacionin civil.”*

Pra, vihet re se nëse ka një akt të ligjshëm i cili më pas anulohet nga vetë organi administrativ, çdo gjë që pala ka paguar në përputhje me këtë akt, duhet t'i kompensohet dhe masa e anulimit llogaritet sipas dispozitave për begatim pa shkak konkretisht sipas neneve 655, 656 të KC ku parashikohet të kthehet çdo gjë që është

fituar ose nëse kthehet sendi edhe të ardhurat e marra prej tij duke zbritur shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen.

Sa më sipër, mendojmë se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet ta kishte trajtuar çështjen civilisht dhe t'ia dërgonte për kompetencë lëndore përsëri GjRREGJ Tiranë. Do ishte kjo gjykatë e cila do të vlerësonte nëse një organ administrativ publik begatohet pa shkak për veprimet e tij të paligjshme apo pala duhet të kishte ngritur padinë ndaj Fakultetit të Shkencave Sociale të shpërblimit të dëmit nga një akt i paligjshëm, në kundërshtim me ligjin për arsimin e lartë.

Në lidhje me kompetencën tokësore i referohemi nenit 11 të ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon kompetencën tokësore të gjykatave që gjykojnë çështje që lidhen me: kundërshtimin e një veprimin administrativ, mbi marrëdhëniet e punësimit, paditë me objekt mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm, që rrjedhin nga sendet e paluajtshme, nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar.

Pika 5 e këtij neni parashikon se: *“Kur kompetenca tokësore nuk mund të përcaktohet në këtë mënyrë, atëherë kompetente është gjykata, në territorin e së cilës ka qendrën organi publik i paditur”*. Në këtë mënyrë konkludojmë se përsa kohë legjislatori nuk e ka parashikuar në mënyrë specifike rastin e padive mbi shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor padia do të ngrihet në gjykatën ku ka qendrën organi publik i paditur.

Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 69 datë 04 shkurt 2014 i cili ka vlerësuar se GjRREGJ Shkodër ka gabuar ku ka vazhduar gjykimin mes shoqërisë “A... projects” shpk ndaj INUK Dega Shkodër dhe INUKombëtar Tiranë pasi çështja duhet të ishte transferuar për kompetencë në GjRREGJ Tiranë, seksioni administrativ si gjykata kompetente ku ndodhet qendra e organit administrativ që ka nxjerrë aktin administrativ që kundërshtohet dhe dëmet e ardhura prej tij. GjRREGJ Shkodër është gjykata në territorin e së cilës ndodhet dega e INUK, por dega nuk ka të drejtë vendimmarrje. Megjithatë Kolegji Administrativ edhe pse konstaton se gjykatat e faktit nuk kanë qenë kompetente për gjykimin e çështjes, në zbatim të nenit 467/b të K.Pr.Civile meqenëse çështja është zgjidhur drejt në themel nga gjykata e apelit, vlerësoi se nuk është vendi që vendimet e gjykatave më të ulëta të cenohen, por i vë në dukje gjykatës së apelit të kishte konstatuar këtë parregullsi.

Në shkallë të parë këto lloj padish gjykohen nga një gjyqtar. Kjo del nga neni 12 i ligjit nr. 49/201 “Mbi përbërjen e trupit gjykues” i cili parashikon se: *“Gjykata administrative e shkallës së parë gjykon me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë mosmarrëveshjet lidhur me kontratat administrative publike dhe kërkesat e paraqitura në zbatim të shkronjave “d” dhe “dh” të nenit 7 të këtij ligji. Të gjitha mosmarrëveshjet e tjera shqyrtohen me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar.”*

Sipas nenit 12§ 2 të po këtij ligji parashikohet se në Gjykatën e Apelit këto çështje gjykohen me tre gjyqtar pasi me pesë gjyqtarë gjykohen vetëm paditë ndaj aktit nënligjor normativ. Ndryshimet që iu bënë pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr. 49/2012 me ligjin nr.100/2014 hyrë në fuqi më 16 shtator 2014, parashikohet se Kolegji Administrativ në Gjykatën e Lartë gjykon në dhomë këshillimi me 3 gjyqtarë të gjitha çështjet që në gjykatën e shkallës së parë gjykohen nga një gjyqtar që do të thotë edhe paditë e shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor të OP. Në të njëjtën mënyrë gjykohen edhe çështjet që kanë për objekt mosmarrëveshjet e kompetencave. Çështjet e tjera gjykohen me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë.<sup>284</sup>

<sup>284</sup>Para këtyre ndryshimeve, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjykonte vetëm me pesë gjyqtar.

**Së pari** - Zakonisht për të përcaktuar nëse një çështje që ka të bëjë me shpërblim të dëmit karshi OAP përveç subjektit të paditur i cili është Organ i Administratës Publike kusht tjetër thelbësor i cili përcakton kompetencën lëndore të çështjes është edhe shkaku ligjor në të cilën paditësi pretendon e gjen mbështetje e drejta e tij subjektive. Mund të ndodh që një organ është pjesë e administratës shtetërore/ publike, por në rastin konkret nuk ka ushtruar vullnetin e saj në një veprimtari administrative publike, por si person juridik publik duke shkaktuar një dëm jashtëkontraktori civil jo të parashikuar në ligjin nr. 8510/1999.

E ilustruam me një shëmbull të praktikës: deputeti V.K padit Bashkinë Tiranë, inspektoriatin Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar se me datë 28 shtator 2013 ka shpifur publikisht me lajmin shpërndarë në media se pesë shtetas këtu përfshi edhe deputetin V.K kishin ndërtuar pa leje. Me padinë drejtuar GjRREGJ Tiranë, paditësi pretendon bazuar në nenin 608, 609, 618 dhe 625 të Kodit Civil dhe neni 44 të Kushtetutës të R.Sh: *“1)Deklarimin e të paditurit Bashkia Tiranë si përgjegjëse për shkaktimin e dëmit ndaj paditësit V.K si rezultat i publikimit të rremë në median e shkruar dhe audiovizive të një kallëzimi penal që nuk është depozituar në Prokurorinë e Tiranës, apo në atë të Përgjithshme.*

2) *...si rezultat i mashtrimit të publikut nëpërmjet publikimit të rremë në median e shkruar dhe audiovizive të një vepre penale që nuk është kryer nga ana e paditësit.*

3)*Deklarimin fajtor të të paditurit për dëmtimin e rëndë të reputacionit, cenimin e imazhit qytetar, politik, publik dhe të biznesit të tij me përfshirjen padrejtësisht në publikimin në media të kallëzimit i cili nuk ekziston, mashtrimit të publikut duke goditur figurën e një qytetari që për pak kohë do të betohet si anëtar i Parlamentit të Republikës së Shqipërisë.*

4)*Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë të botojë një përgënjeshttrim publik në të gjitha mediat e shkuara dhe audiovizive duke pranuar se ka mashtruar qëllimisht për qëllime përfitimi politik.*

5) *Detyrimin e të paditurit për t'i paguar paditësit shpërblimin e dëmit jo pasuror të shkaktuar për sa më lart, në vlerën prej 2 milionë lekë.”*

Në këtë rast, me të drejtë Gjykata e Lartë, Kolegji Administrativ me vendimin nr. 00-2014-1480, datë 22 prill 2014, ka prishur vendimin e GjRREGJ Tiranë për moskompetencë lëndore dhe ka dërguar përsëri çështjen në të njëjtën gjykatë, me arsyetimin se kjo çështje civile nuk i takon për tu gjykuar GjASH i-rë Tiranë pasi dëmi i pretenduar nga Bashkia Tiranë nuk është si pasojë e ndërhyrjes së paligjshme të organit administrativ (Bashkia Tiranë dhe INUK) gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre publike por si pasojë e publikimit në media të informacioneve të pretenduara të rreme. Nëse GjRREGJ Tiranë do të kishte hetuar me kujdes se cila ishte baza ligjore ku mbështeteshin pretendimet e paditësit dhe faktit se në ç’kuadër e ka paditur INUK dhe Bashkinë Tiranë, nuk do të ishte referuar ligjit nr. 8510/1999 dhe neneve neneve 4, 7/b, 15/a dhe c dhe 17 2 e f dhe ‘f’ të ligjit nr.49/2012<sup>285</sup> e cila e ka çuar në gabim për të vendosur moskompetencën lëndore të çështjes në GjASH I-rë Tiranë. As vetë paditësi nuk gjen mbrojtje të të drejtës subjektive tek këto referenca ligjore prandaj gjykata në këto kushte nuk ka pse të shtojë shkaqe ligjore që vetë paditësi nuk i ka përmendur.

Parimi *iura novit curia* (gjykata e njeh ligjin) nuk cënohet nëse përveç shkakut ligjor që ka vënë paditësi gjykata evidenton e drejta subjektive e tij, gjen mbrojtje edhe në norma të cilat paditësi nuk i njeh, nuk i ka shënuar në pjesën hyrëse të padisë apo në përmbajtje të saj. Sipas vendimit unifikues nr. 3 datë 29 mars 2012 KB të GJL

<sup>285</sup> Parashikojnë kompetencën e Gjykatave administrative për rastet e dëmëve jashtëkontraktore sipas ligjit nr. 8510/1999.

interpretuan se: " ... gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkaku që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit si kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar."

Përpos kësaj, gjykata nuk mund të vendos përtej një shkaku ligjor që pala paditëse ka vënë në tërë kërkesë padinë për të mbrojtur interesat e saj pasi çon gjykatën në disponim të padisë, në keqkuptim të parimit *iuria novit curia* dhe dalje nga roli i saj si arbitër. Në rastin konkret, paditësi V.K ka mbështetur padinë në të drejtën civile duke konsideruar mosmarrëveshjen për shkaktim dëmi jashtëkontraktor me karakter civil sipas neneve 608 e vijues të KC, ndërsa gjykata duke tejkaluar rolin e saj, e ka konsideruar çështjen administrative dhe përgjegjësinë jashtëkontraktore bazuar në ligjin nr. 8510/1999.

Vihet re se praktika e Gjykatës së Lartë, Kolegji Administrativ nuk është i njëjtë mbi trajtimin e deklaratave për shtyp si pjesë e veprimtarisë administrative apo jo. Pothuaj në të njëjtën rast, por tashmë mes Shoqërisë "A...ol" shpk ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për të shpërblyer dëmin jopasuror si dhe për të përgenjështuar rastin, bazuar tek nenet 608 e vijues të KC, është dërguar për tu gjykuar në GJASH I-rë Tiranë me arsyetimin se dhënia e deklaratave të shtypit ku përmbahen informacione të rreme, shpifje ndaj paditësit përbëjnë veprimtari administrative, pasi janë botuar edhe në faqen zyrtare të një OP prandaj kemi të bëjme me një çështje publike.<sup>286</sup>

**Së dyti-** Duhet bërë kujdes mbi dhënien e të drejtës së ankimit, palëve ndërgjyqëse kur çështja kalon për moskompetencë lëndore apo tokësore nga një gjykatë në tjetërën. Nëse Gjykatat e Rretheve Gjyqësore shpallin moskompetencën lëndore për gjykimin e një çështje që i takon Gjykatave të Shkallëve të Para Administrative, sipas nenit 62 të KPRC<sup>287</sup> njihet e drejta e ankimit të veçantë për këtë vendim moskompetence. Ankimi bëhet në Gjykatën e Lartë brenda pesë ditëve për palët e pranishme dhe brenda pesë ditëve për palët që janë në mungesë. Afati i ankimit fillon nga dita e nesërme e shpalljes apo e njoftimit sipas vendimit unifikues nr. 2 datë 27 mars 2012 të KB të GJL.<sup>288</sup> Ndërsa në rast se Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë çmon se nuk ka kompetencë tokësore dhe ia dërgon një tjetër Gjykatë Administrative apo nuk ka kompetencë lëndore dhe ia dërgon një Gjykatë të Rrethit Gjyqësor, ky vendim sipas nenit 13§3 i Ligjit nr. 49/2012<sup>289</sup> nuk ankimohet përveç se me vendim përfundimtar.

Kjo ndarje në varësi se cila është gjykata që shpall moskompetencën, kuptohet me atë se cili është edhe ligji që rregullon gjykimin e çështjeve civile apo administrative. Çdo gjykatë do të veproj në bazë të ligjit të saj organik. Në Gjykatat e

<sup>286</sup> Shih vendimin nr. 00 - 2014 - 4166 datë 09 tetor 2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

<sup>287</sup> Neni 62 i KPRC parashikon se: "Kundër vendimit të gjykatës që ka shpallur moskompetencën për gjykimin e mosmarrëveshjes, si dhe kundër vendimit të saj mbështetur në nenin 60 të këtij Kodi, mund të bëhet ankimi i veçantë nga palët dhe nga prokurori, kur ka ngritur padi ose ka marrë pjesë në gjykimin e mosmarrëveshjes, në Gjykatën e Lartë."

<sup>288</sup> Kolegjet e Bashkuara unifikuan praktikën se: "kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë ose nga gjykata e apelit, në mungesë të njëjës palë, afati i ankimit (apel, rekurs) për këtë palë fillon të llogaritet përkatësisht nga e nesërmeja e marrjes njoftim të vendimit, sipas rregullave të përcaktuara nga dispozitat e neneve 316 dhe 148 të K.Pr.Civile."

<sup>289</sup> Neni 13§3 mbi kompetencën tokësore dhe lëndore të Gjykatave Administrative parashikon se: "Gjykata shpall me vendim moskompetencën e saj për shkaqet e parashikuara në këtë nen dhe urdhëron dërgimin e akteve gjykatës kompetente. Vendimi për shpalljen e moskompetencës dhe vendimi për rrëzimin e kërkesës për shpalljen e moskompetencës ankimohen së bashku me vendimin përfundimtar."



Rrethve gjyqësore e gjithë veprimtaria rregullohet sipas Kodit të Proçedurës Civile kjo referuar nenit 1§1 ku: ”Kodi i Proçedurës Civile i Republikës së Shqipërisë cakton rregulla të detyrueshme, të njëjta e të barabarta, për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile e të mosmarrëveshjeve të tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta..” Ndërsa në nenin 1<sup>290</sup> të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” parashikon se Kodi i Proçedurës Civile plotëson atë çfarë ky ligj nuk ka rregulluar për gjykimin administrativ, pra KPRC është ligj komplementar.

Jo paqëllim ndalemi tek ky moment pasi vihet re në praktikën gjyqësore se nuk u jepet e drejta e ankimit të veçantë palëve në rast se një gjykatë e Shkallës së Parë Civile shpall moskompetencë lëndore për një çështje administrative, duke zbatuar pikërisht nenin 13§3 të ligjit nr. 49/2012 me interpretimin se ndaj këtij vendimi bëhet ankim së bashku me vendimin përfundimtar. Ashtu siç edhe Gjykata e Lartë ka raste kur nuk merr në shqyrtim të tillë ankime dhe pushon çështjen me arsyetimin se është bërë ankim i vecantë ndaj një vendimi që nuk mund të bëhet ankim, paçka se moskompetencën e ka shpallur një gjykatë civile e shkallës së parë dhe jo një gjykatë administrative e shkallës së parë dhe harrohet se çdo gjykatë do i referohet ligjit të saj organik.

Në vendimin nr. 00-2014 -560, datë 04 mars 2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë pushohet gjykimi i çështjes me arsyetimin se:” ... Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur moskompetencën e saj, duke u shprehur që në momentin e shqyrtimit të kësaj padie konstatohet që kjo gjykatë në referim të ligjit nr.49/2012 si dhe shkakut ligjor të kërkesëpadisë së paraqitur për shqyrtim të shpien në përfundimin se mosmarrëveshja objekt gjykimi duhet të konsiderohet si mosmarrëveshje e natyrës administrative dhe jo të natyrës civile dhe për rrjedhojë ka vendosur dhe dërgimin e akteve në gjykatën kompetente që është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

13. I ndodhur në këto rrethana Kolegji Administrativ arrin në përfundimin se kjo çështje nuk mund të gjykohet për shkak se, ligji nuk lejon që ndaj një vendimi të tillë të mund të paraqitet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë, prandaj në rastin objekt gjykimi duhet të vendoset pushimi i gjykimit të çështjes.”

**Së treti-** Gjykata heton mbi kompetencë lëndore administrative duke: (i) përcaktuar drejt natyrën juridike të marrëdhënies që është bërë shkak i mosmarrëveshjes në gjykim dhe personalitetin e palës së paditur, si “organ publik”; (ii) bërë një identifikim të elementeve dhe/ose kritereve ligjore që për rastin konkret shërbejnë për përcaktimin e kompetencës lëndore.<sup>291</sup>

<sup>290</sup> Neni 1 “1. Ky ligj përcakton rregulla të detyrueshme për:

- a) organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative, si dhe statusin e gjyqtarëve që shërbejnë në to;
- b) juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave administrative;
- c) parimet dhe procedurën e gjykimit, palët në proces dhe personat e tjerë në gjykimin administrativ;
- d) vendimet gjyqësore administrative dhe ekzekutimin e tyre.

2. Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Proçedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.”

<sup>291</sup> §11 i vendimit nr. 00-2016-1113 datë 25.02.2016 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në çështjen S.S ndaj Bashkia Skrapar me objekt: “Detyrimin e të paditurit t’i shpërblejë paditësit dëmin e shkaktuar nga prishja e objektit tip garazh ndodhur në lagjen “Estref Caka” Çorovodë në pronësi të paditësit në bazë të lejes së dhënë nga Komiteti Ekzekutiv K.P. Qytetit Çorovodë me nr. 559 prot., datë 23.12.1991, bashkëlidhur dhe planimetria e ndërtimit të këtij objekti.”

Kështu, KA i GJL në çështjen S.S kundër Bashkisë Skrapar lë në fuqi vendimin e GjRGGJ Berat për të kaluar për kompetencë lëndore çështjen në GJA të SHK i-rë Vlorë duke argumentuar se:” 14. Ky kolegji vlerëson se janë pikërisht veprimet administrative të kryera nga organi shtetëror, Bashkia Skrapar, të cilat, sipas palës paditëse, përbëjnë shkakun e demolimit të garazhit dhe dëmit të shkaktuar që, njëkohësisht përbëjnë dhe shkakun e padisë në gjykim (arsyet e kërimit).

14.1. Ndryshe nga sa pretendohet në ankim, ky kolegji, nisur nga kërkitimi i fiksuar në objektin e padisë dhe në shtjellimin e saj në raport me shkakun e padisë, ndonëse referohet në dispozitat edhe të Kodit Civil dhe të Procedurës Civile, për rastin, vlerëson se kur shpërblimi i dëmit i kërkohet organit administrativ, sipas neneve 2, 7/b, 15/a dhe 17/f të ligjit nr. 49/2012 kompetente nga pikëpamja lëndore është gjykata administrative dhe jo ajo civile.”<sup>292</sup>

Pra vlen të theksohet se në rastin e padive të shpërblimit të dëmit nga organet administrative, gjykatat nuk duhet të nisen apriori në shkakun ligjor i vendosur në padi siç është baza ligjore vetëm tek neni 608 i KC dhe neni 32 e vijues i KPRC por në rast se konkludojnë se dëmin e pretenduar, pala ia kundrejton një OAP i cili në ushtrim të veprimtarisë së të administrative, ka nxjerrë një akt administrativ apo nuk ka vepruar etj. duke sjell pasojë, në thelb rezulton se padia përbën lëndë të së drejtës administrative, e konkretisht të ligjit nr. 5810/1999, nenet 2 e 3 të KPRA dhe në nenet 2, 7, 8, 15, 16 e 17 të ligjit nr. 49/2012 dhe tek parimet e së drejtës.

#### 4.4 Legjitimimi pasiv i organit shtetëror

Prezumohet se OP ka përgjegjësi të drejtëpërdrejtë në shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor për veprime të paligjshme, të padrejta, të parregullta. Sipas neni 3 të ligjit nr. 8510/1999 parashikohet se :” 1.Në ushtrimin e funksioneve shtetërore, punonjësit e organeve të administratës shtetërore nuk përgjigjen për dëmet shkaktuar personave fizikë a juiridikë privatë në rastet e parashikuara në nenin 3.

2. Punonjësit e organeve të administratës shtetërore, përjashtimisht, përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë privatë, kur vërtetohet se ata kanë vepruar me keqbesim.

3. Në rastet e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, organi shtetëror punëdhënës, pasi dëmshpërblen palën e dëmtuar, ka të drejtë të kërkojë nga punonjësi fajtor kthimin e shpërblimit që ka paguar.”

OAP pasi shpërblen palën e dëmtuar, mund të kërkojë nga punonjësi i cili ka vepruar me keqbesim kthimin e shumës që ka paguar. Pra, punonjësi mban përgjegjësi vetëm në një rast, kur ka vepruar me keqbesim.

Gjatë gjyimit, paditësi mund të zgjedh që të padisë OAP bashkë me punonjësin e tij në mënyrë që të dëgjohen të gjithë personat që kanë marrë pjesë në ngjarje. Nëse del se punonjësi ka vepruar me keqbesim, ka legjitimitet pasiv vetëm punonjësi dhe OAP shkarkohet nga përgjegjësia. Nëse del se punonjësi ka vepruar me mirëbesim ose nuk ka faj, OAP mban përgjegjësi dhe padia ndaj punonjësit mund të rrëzohet për mungesë të legjitimitetit pasiv.

Edhe në ato raste kur personi nuk është në dijeni se kush është shkaktuesi i vërtetë i dëmit, mjafton që të padisë OAP dhe padia nga pikëpamja e legjitimitetit pasiv është e drejtë. Kjo përgjegjësi presumohet bazuar në nenin 4 të ligjit nr.8510/1999. Nëse OAP provon se dëmi ka ndodhur për faj dhe keqbesim të punonjësit i njihet e drejta që të kërkojë zëvendësimin procedural sipas neni 184 të KPRC<sup>293</sup> ose të pres

<sup>292</sup> Po aty.

<sup>293</sup> Neni 184 i KPRC “Zëvendësimi i palëve:” Kur gjatë gjyimit del se padia është ngritur nga një

përfundimin e gjyqimit në mënyrë që të kërkoj me padi regresive atë çfarë ka paguar për paditësin për efekt të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

Në vendimin me nr. 1594, datë 26 mars 2015 të GJASHK i-rë Tiranë, është gjykuar padia e trashëgimtarëve Durdaj, ku i afërmi i tyre ishte një nga 26 personat që u vranë nga shpërthimi në Gërdec me datë 15 mars 2008.

Sipas vendimit penal nr. 381, datë 12.03.2012 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, (faktet e së cilit merren të provuara në gjykimin civil sipas nenit 70 të Kodit të Procedurës Penale<sup>294</sup>) janë dënuar Drejtori i Ndërmarrjes shtetërore MEICO, punonjësi i ndërmarrjes MEICO, Administratori i shoqërisë Albademil sh.p.k. dhe Drejtori i fabrikës së demontimit për veprën penale të “Shkeljes së rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive” e parashikuar nga neni 282 i Kodit Penal, me pasojë vdekjen dhe plagosjen e shumë personave. Ndërsa Ministri i Mbrojtjes nuk u gjykua nga Gjykata e Lartë për shkak të imunitetit si deputet.

GJASHK i-rë Tiranë, në vlerësimin e legjitimitetit pasiv të të paditurve Ministria e Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave (ne mungese), Ndërmarrja “MEICO, Shoqëria “Albademil” shpk, vlerësoi se legjitimohen të gjithë pasi nga veprimet direkte të tyre kanë ardhur pasoja e shpërthimit të barutit, armëve etj. Gjykata shprehet se:” Sipas analizës së fakteve rezultoi se i padituri Albademil sh.p.k ka pasur kontratë me shoqërinë Southern Ammunition Company inc. Kjo shoqëri e detyrohet ka pasur një marrëdhënie kontraktore me ndërmarrjen MEICO shpk, sipas autorizimit të drejtëpërdrejtë nga Ministria e Mbrojtjes. Procesi me një rrezikshmëri të lartë i demontimit të armatimeve është kryer në bazë të urdhërave të drejtëpërdrejtë të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas detyrave që atij i ngarkohen nga ligji nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nga VKM nr. 138 dt. 14.03.2007 “Për procedurën e trajtimit të armëve, teknikës dhe pajisjeve të forcave të armatosura, të hequra nga armatimi dhe përdorimi”.

Këshilli i Ministrave ka urdhëruar në pikën IV.4 të këtij vendimi që: “Procesi i çmilitarizimit e çmontimit të kryhet nën mbikëqyrjen dhe sigurinë ushtarake të reparteve të Forcave të Armatosura, duke regjistruar me hollësi të dhëna për regjimin, lëvizjen dhe sasinë e municioneve të dorëzuara dhe të atyre të çmontuara e të çmilitarizuara, si dhe të produkteve të tyre, pas çmontimit dhe çmilitarizimit.”

I gjithë operacioni i demontimit të armëve nuk ka qenë një veprimtari brenda qarkullimit civil. Veprimtaria e demontimit të armatimeve është një funksion publik, detyrë e autoriteteve shtetërore, të cilat në bazë të ligjit të posaçëm të cituar në bazën ligjore të VKM nr. 138 dt. 14.03.2007, mund të kryhej vetëm me disponimin e posaçëm të Këshillit të Ministrave, nën mbikëqyrjen e forcave të armatosura, të cilat drejtohen në kohë paqjeje nga Ministri i Mbrojtjes... Ky operacion është kryer nën përgjegjësinë e Forcave të Armatosura, ndërmarrjes shtetërore MEICO, të gjithë në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe me pjesëmarrjen e shoqërive SAC dhe Albademil sh.p.k. Secili nga këto subjekte ka pasur rolin e vecantë në veprimtari, qoftë përmes

---

person, që nuk ka të drejtë ta ngriejë, ose është ngritur kundër një personi ndaj të cilit nuk duhej të ngriejë, me kërkesën e palës së interesuar gjykata mund të lejojë zëvendësimin e paditësit ose të të paditurit të parë, me paditësin që i përket e drejta që të ngriejë padinë ose me të paditurin kundër të cilit duhej të ngriejë padia. Për këtë zëvendësim gjykata duhet të marrë më parë pëlqimin e të dy palëve dhe të personit që hyn në vend të tyre si palë.”

<sup>294</sup> Neni 70 “Efektet e vendimit penal për gjykimin civil dhe administrativ “1. Vendimi penal i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës vetëm përsa i përket faktit nëse vepra penale është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari. 2. Vendimi penal që zgjidh rastësisht një fakt që lidhet me një çështje civile, administrative ose penale nuk ka efekt detyrues në asnjë proces tjetër.”

*pjesëmarrjes direkte në veprimet e demontimit, qoftë edhe përmes facilitimit apo mbikqyrjes së veprimtarisë.”*

Pra, sipas gjykatës edhe nëse krijohet përshtypja se shkaktari i drejtpërdrejtë i një pasoje mund të jetë vetëm subjekti privat tregtar Albademil shpk, duhet të ndiqet zinxhiri se si ka marrë autorizimin për të demontuar armë. Kjo kompetencë i takon ekskluzivisht Ministrisë të Mbrojtjes dhe po ashtu mban përgjegjësi për vlerësimin e kapaciteteve, aftësive, inspektimin dhe mbikqyrjen e demontimit që kryen shoqëria tregtare.

Mbi Këshillin e Ministrave kjo gjykatë është shprehur se nuk ka pasur faj në ardhjen e pasojës pasi nuk ka kryer ndonjë veprim të paligjshëm a mosvprim i cili ka sjell pasojë në ngjarjen përkatëse të shpërthimit apo edhe të vdekjes së të miturit E.D, i cili po luante në oborrin e tij në kohën e shpërthimit.<sup>295</sup>

Në lidhje me shoqërinë amerikane SAC inc, Gjykata u shpreh se gjykata penale ka përcaktuar se pasojë e vrasjes dhe e dëmtimeve ka ardhur edhe nga veprimet e kësaj shoqërie e cila e filloi aktivitetin për demontim dhe çmilitarizimit në Shqipëri, pikërisht në një zonë ushtarake, në ish-repartin e Tankeve Gërdec. Prandaj, kjo nuk i heq të drejtën paditëseve që të ngrenë në të ardhmen padi civile edhe ndaj personave të tjerë (brenda afatit 3 vjeçar nga data e marrjes së formës së prerë të vendimit të gjykatës penale më 13.02.2013), siç është shoqëria amerikane SAC, e cila nuk është pjesë e këtij gjykimi, pasi paditesat hopen dore prej saj.<sup>296</sup>

Mund të ndodh që gjatë gjykimit të evidentohen shkaktuesit e vërtetë të dëmit i cili mund të jetë nga veprimtaria, pasiviteti etj. i organeve administrative por kjo e fundit për të kryer këtë veprim mund të ketë kontraktuar ndonjë subjekt tjetër privat me kontratë porosie, sipërmarrje. Praktika gjyqësore tregon se nga veprimet e shoqërive tregtare apo personave që mund të ketë kontraktuar a nënkontraktuar OP, duke qënë në mospërmblidhje të detyrimit kontraktual apo në kapërcim të saj këta persona të tretë të kenë sjellë pasojë tek qytetarët.

Nëse i dëmtuari, ka dijeni për këtë lidhje kontraktuale mes OP dhe shoqërisë tregtare/ personit fizik mund ta thërrasë në gjykim në cilësinë e palës së paditur për të ndarë përgjegjësinë me njëri-tjetrin apo të personit të tretë për t'iu dhënë mundësi për marrë përsipër detyrimin nëpërmjet zëvendësimit procedural siç e parashikon neni 198 të KPRC.

Në rast se palët nuk e kërkojnë futjen në gjykim të personit të tretë, i cili ka shkaktuar dëmin për efekt të kryerjes së një veprimtarie administrative është gjykata e cila sipas nenit 193 dhe 194 të KPRC mund ta thërrasë kryesisht kur vlerëson se vendimi përfundimtar mund të afektoj interesat pasurore apo jo pasurore të tij. Në vendimin nr. 212 datë 10 shkurt 2016, Gjykata Administrative e Apelit me palë I.V karshi Bordit të Kullimit Gjirokastër, ka prishur vendimin e GJASH i-rë Gjirokastër dhe e ka kthyer për rishqyrtim. Nga faktet rezulton se Shoqëria „Salillari“ shpk e kontraktuar nga pala e paditur për sistemin e Argjinaturës së lumit Drino ka shkatërruar totalisht, pronën kufitare prej 27 dy kullotë në pronësi të paditësit. Sipas GJAA shoqëria tregtare „Salillari“ shpk rezulton të mos jetë thirrur në gjykim nga GJASH i-rë Gjirokastër. Pjesëmarrja e kësaj pale sipas Gjykatës do të kishte sqaruar nëse dëmi i shkaktuar në pronën e paditësit është kryer nga OP apo dëmtimet janë kryer nga zbatuesi i punimeve për pastrimin e shtratit të lumit Drino.

<sup>295</sup> Shih vendimin nr. 1594 datë 16 mars 2015 të GJASH I-rë Tiranë faqe 15, 38.

<sup>296</sup> Neni 19- Pushteti i deleguar “*Ne rast se subjekti, që shkakton dëmin, nuk është organ i administratës shtetërore, por vepron në bazë të autorizimit nga pushteti publik, përgjegjësinë e mban autoriteti publik, i cili ka kompetencën fillestare. Ne rast se subjekti i deleguar e shkakton dëmin për faj të tij, autoriteti delegues mund të kërkojë dëmshpërblim, sipas nenit 15.*”

#### 4.5 Provat që mund të merren në gjykim

Gjykimi i padive me objekt shpërblim i dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar nga organet e administratës publike është si çdo gjykim administrativ. Gjykatat e Shkallëve të Para Administrative janë të lira për të pranuar për efekt të provimit çdo lloj prove të parashikuar nga Kodi i Proçedurës Civile si dëshmitarë, prova shkresore, ekspertime, pohime të palëve, kqyrje në vënd kur pretendohet dëm material si shkatërrim banese etj. Megjithatë vlerësojmë se provat më të rëndësishme në këtë gjykim<sup>297</sup> ose ku më së shumti mbështet gjykata janë provat shkresore ku mbështetet pretendimi se pala ka pësuar dëm, por edhe mendimi i ekspertit kontabël për të matur dëmet ekonomikisht, ekspertit topograf apo për rastet e dëmeve jopasurore eksperti psikolog, eksperti mjekoligjor, psiko-ligjor, vlerësues të dëmeve në shëndet për matjen e dëmit jopasuror tek individët etj.

Në nenin 11 të ligjit nr. 8510/1999 parashikohet nga vetë ligji që për të matur se sa ka ndikuar me faj i dëmtuari në ardhjen e masës totale të dëmit, gjykata mund të marrë mendimin e një eksperti. Citojmë :” *Roli i palës së dëmtuar në shkaktimin e dëmit dhe masa e dëmshpërblimit që paguhet në këto rast, përcaktohen nëpërmjet vlerësimeve të ekspertit, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të Kodit të Procedurës Civile.*<sup>298</sup> ”

Ndërsa në nenin 82§3 i KPRA i Ri i njihet e drejta palës së dëmtuar që bashkë me kërkesën e tij të bashkangjisë provat shkresore, dokumente dhe fakte të tjerë për të filluar proçedurën hetimore administrative.<sup>299</sup>

Megjithatë me KPRA i Ri, palës së dëmtuar direkt apo indirekt, punonjësve apo organit të administratës, u jepet mundësi më e madhe për tu dëgjuar, për të paraqitur prova të shumëllojshme që i vlejnë gjykimin mbi gjetjen e shkaktuesit të dëmit, për të provuar fajsinë, mbi masën e dëmit të ardhur, llojet e dëmit etj.

Në të dy Kodet e Proçedurave Administrative paditësit i lihet një afat që gjatë hetimit administrativ të paraqes prova për të mbështetur pretendimin (neni 84 i KPRA i Ri) në rast se ky nuk përgjigjet, OP ka për detyrë që në kuadër të vendimarrjes së drejtë të marrë vetë provat që i duken të domosdoshme për hetimin.<sup>300</sup>

Në nenin 80 të KPRA i Ri parashikohet se: “*1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund:*

- a) *të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertë;*
- b) *të marrë dokumente apo dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;*
- c) *të vizitojë dhe të kontrollojë mallrat apo vende të përfshira.*

<sup>297</sup> Pavarësisht se pranohet se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar por ato vlerësohen njësoj në harmoni me njëra-tjetrën.

<sup>298</sup> Neni 224/ a i KPRC parashikon se: “*Kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve, që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim kërkohen njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës ose të artit, gjykata mund të thërrasë një ose më shumë ekspertë. Ekspertët caktohen sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod.*” Ndërsa KPRA 1999, në proçedurën hetimore në nenin 89 të tij parashikon se: “*. Ekzaminimet, raportet, vlerësimet dhe masa të tjera të ngjashme kryhen vetëm nga ekspertë (një ose disa) të specializuar...3. Mënyrat e emërimit të eksperteve dhe shpërblimi i tyre rregullohet me ligj.*”

<sup>299</sup> Neni 82§3 i KPRA i Ri “*. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t’i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e proçedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.*”

<sup>300</sup> Neni 85§2 i KPRA i Ri:” 2. *Mungesa e përgjigjes ndaj njoftimit mund të merret në konsideratë për qëllimet e të provuarit, në përputhje me rrethanat e çështjes, por në asnjë rast kjo nuk e çliron organin publik nga detyrimi për t’i kërkuar vetë provat dhe faktet dhe për të dhënë një vendim përfundimtar.*”

2. Dispozitat e parashikuara ligjin për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative mbi mjetet e provave zbatohen për aq sa është e mundur në procedurën administrative, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.

3. Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme. “

Në çështjen “Media+” shpk ndaj KKRT<sup>301</sup> paditësi pretendoi bazuar në nenet 608 të KC dhe ligjit nr. 8510/1999 dëm pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga pala e paditur si rezultat i heqjes së licencës dhe mbylljes së veprimtarisë për pesë vjet, vendimarrje e cila me vendim gjyqësor të formës së prerë (2006) u konsiderua e marrë në kundërshtim me ligjin. Paditësi pretendoi se ishte i pajisur me licencën nr.039/TVL në fushën e trasmetimeve toksore që me datë 14.11.2000 dhe në kohën kur e paditura KKRT i ka hequr licencën për periudhën 03.01.2001- 03.01.2006 , i kishte ngelur edhe 1 (nje) vit e 5 dite kohe që nuk ka arritur ta shfrytëzojë.

Gjykata e Apelit ka prishur vendimin e GjRRGJ Tiranë që kishte rrëzuar padinë dhe e ka pranuar pjesërisht sipas vlerësimit të grupit të ekspertëve kontabël për këto zëra:

1. Shpenzime të energjise elektrike dhe defekteve të kryera nga pala paditese për periudhen Qershor 2005-Korrik 2008 që është 4.695.035 lekë.
2. Faturat tatimore te shitjes nga Studioja M... Albania shpk per bleresin “TV Shijak” sh.a, me vlerë 7.959.248 leke”,
3. Liste pagesat e punonjesve për periudhen Janar 2005 deri me 16.07.2008 ne shumën 48.615.000 leke”,
4. Amortizimi si element i shpenzimeve për periudhen Janar 2005-16.07.2008 në shumën 22.715.160 lekë,
5. Pagesa për shërbim satelitor-13.740.000 lekë,
6. si dhe vlere e interesave bankare që zë shumën 15.137.942 lekë.

Në fakt, paditësi kërkonte si dëm pasuror: - largimin e klientëve të cilët bënin reklama në TV Shijak. si “H.L.Group” sh.p.k., “Viki” sh.p.k., “Birra Stela” sh.p.k., “Jakaj” sh.p.k., “Birra Tirana” sh.p.k., “Pekomeri” sh.p.k. për të provuar pagesat mujore të këtyre subjekteve, pala paditëse kërkoi që këto çmime të krahasohen me televizione analoge si “Ora News” apo “Koha TV”. Ky dëm u kërkua të përlloraget nga data 07.03.2005 (heqja e licencës), deri në Korrik 2008 (data e dhënies së licencës si dhe dëmi moral i shkaktuar nga mbyllja arbitrare e televizionit në shumën prej 200.000 euro me pasojë uljen e reputacionit dhe mundësisë për të konkurruar në treg. Gjykata e Apelit Tiranë i ka rrëzuar me pretendimin se nuk ishin të bazuar në prova.

Ajo çfarë vlen të përmëndim është se padia u rrëzua me arsyetimin se mospatja e një bilanci ku të pasqyrohej veprimtaria nuk mund përlloraget dot nga ekspertja kontabël as dëmi i mundshëm real as moral. GjRRGJ Tiranë argumenton se: “*Bilancet e shoqërisë paditëse , jane dokumentacion i nevojashem për efekt të tatimeve dhe taksave dhe gjejne zbatim në kushtet normale të veprimtarisë private të subjektit “Media +”, por ky dokumentacion nuk është i detyrueshem për llogaritjen e fitimit dhe humbjeve të pësuarra të shoqërisë.*”

Në këtë mënyrë, GjRRGJ Tiranë jo domosdoshmërisht do ishte mbështetur në opinionin e një ekseptri që nuk mund të llogarisë nëse nuk ka dokumente në përputhje me ligjin nr. 9228 date 29.04.1998 “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar. Për sa kohë plotësohen të katër elementët e kërkuar nga nenet 608, 609 e Kodit Civil dhe është e dukshme se ndërprerja e licencës para kohe si dhe mosdhënia

<sup>301</sup> Vendimi nr. 2891 datë 22 dhjetor 2011 e Gjykatës së Apelit Tiranë.

për pesë vjet rrjesht i ka shkaktuar dëm një shoqërie, televizioni i së cilës ka qënë aktiv, ka pasur klientë , ka pasur shtrirje transmetimi në një territor të konsiderueshëm të Shqipërisë, ka përvojë etj. Gjykata nuk duhet të bëhet “rob”i opinioneve që jep një ekspert. Është e qartë se njohuritë e gjykatës në një fushë nuk mund të krahasohen me ato të një specialisti, por roli i saj është të harmonizoj provat dhe të nxjerr në pah faktin dhe të drejtën objektive që e mbron ose jo këtë fakt juridik.

Nëse një eksperte nuk arrin dot të kthej përgjigje pyetjeve të gjykatës apo palëve, gjykata detyrimisht në përputhje me nenin 229 të KPRC duhet të bënte ripërsëritje të aktit të ekspertimit.<sup>302</sup> Tashmë jo me një ekspert por me grup ekspertësh (tre zakonisht për të mos pasur problem në votim të aktit), kjo shkon edhe në përputhje me vështërsinë që ka çështje për sa kohë(me KPRC e kohës, neni 35) çështja gjykohët me tre gjyqtarë, faktit se vlera e dëmit të pretenduar është në masën 30,742,020.86132 lekë mendoj se domosdoshmërisht që në fillim duhet të merrej një grup ekspertësh. Rezultoi që në Gjykatën e Apelit Tiranë, grupi ekspertëve mati masën e dëmit pasuror të shkaktuar Shoqërisë “Media +”.

Një tjetër moment është rasti kur personi i dëmtuar pretendon dëm të shkaktuar nga ana e OP por sipas akteve normative nuk konsiderohet dëm. E ilustruam me një shëmbull nga praktika gjyqësore. Familja e A.M me banim në Vorë, nga aksidenti teknologjik të ndodhur me datë 15 mars 2008 në Gërdec, nga shpërthimi i fabrikës së demontimit të armëve luftarake u dëmtuan një sërë fshatrash të zonës së Durrësit, Tiranës, Vorë etj. Për këtë arsye doli VKM nr. 315, datë 21.3.2008 “Për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve në bashkinë Vorë, ne Komunitat Kashar e Preze të Qarkut të Tiranës the në Komunitat Maminas, Manzë dhe Bubq, të Qarkut Durrësit, të shkaktuara nga aksidenti teknologjik” . Komisioni i vlerësimit i përbërë nga përfaqësues të Ministrive, të Organeve të pushstetit vendor etj. kanë plotësuar formularët F1 dhe F2 për vlerën e dëmeve të ndërtesës dhe të orendive të A.M në lidhje me 4 objekte: 1) banesë në qytetin e Vorës, 2) biznes (kapanon) 3) biznes në qytetin e Vorës 4) biznes tregtim materiale ndërtimi në qytetin e Vorës. Këta formularë i janë dërguar më pas Entit Kombëtar të Banesave për vazhdimin e procedurës së kompensimit të dëmeve.

Ky Ent ka nxjerrë vlerën prej 1, 400, 000 lekë për paditësin A. M në lidhje me objekt (biznes kapanon). A.M i drejtohet GjRRGJ Tiranë për shpërblim të diferencës së vlerës së dëmit real të pambuluar nga të paditurit Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave pasi Enti nuk ka vlerësuar fare dëmin e dy pajisjeve pirun transporti dhe makineri për prerje blloqesh si dhe nuk ka llogaritur saktë vlerën e dëmeve të shkaktuara në kapanon.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 905, datë 11.02.2011 ka vendosur:”Rrëzimin e padisë” ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 2823, datë 23.12.2011 ka vendosur:”Ndryshimin e vendimit nr.905 datë 11.02.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke pranuar padinë dhe detyruar palët e paditura Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave që t’i paguajnë paditësit A.M vlerën 2,500,000 lekë si diferencë midis llogaritjes së formularëve F1+F2 dhe vlerës së përcaktuar nga akti i ekspertimit për dëmin total të shkaktuar paditësit në proces.”

Këtë vendim Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e gjeti të drejtë duke e prishur e lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë me arsyetimin se llogaritja e vlerës së kompensimit nga Enti është kryer në mbështetje VKM-së nr. 315 datë 21.03.2008 pasi janë evidentuara ato sipas procesverbalit F1 me zëra punimesh.

<sup>302</sup> Neni 229 -Përsëritja e ekspertimit “Kur shihet se ekspertimi është i metë ose i paqartë, si dhe kur ka ndryshim mendimesh midis ekspertëve, gjykata, kryesisht ose me kërkesën e ndonjëres nga palët, mund të kërkojë sqarime plotësuese ose të urdhërojë kryerjen e një ekspertimi të ri, duke thirrur ekspertë të tjerë.”

Ndërkohë, dëmtimet në dy makineri nuk janë evidentuar dhe vlerësuar për shkak se paditësi nuk i ka provuar këto pajisje me dokumentacion të depozituar në organet tatimore, siç kërkon VKM nr. 315 datë 21.03.2008.

Nëse i referohemi kësaj VKM parashikohet disa kritere për të matur dëmin e ardhur në familjet e dëmtuar nga shpërthimi në Gërdec pavarësisht se në vitin 2008 informaliteti në Shqipëri si për blerjen e sendeve të luajtshme apo edhe të paluajtshëm ka qënë një fenomen prezent. Konkretisht pika 6 e VKM nr. 315/2008 parashikon: “a) për objektet e shkatërruara tërësisht, sipas kostos së ndërtimit për m<sup>2</sup> miratuar me udhëzimin nr.2, datë 4.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banësive, dhe të koeficientit “k”, për vitin 2007” (për qytetin e Tiranës);

b) për objektet e ndërtimit me karakter bujqësor, të tilla si stalla, hangarë etj. kostoja e ndërtimit të llogaritet sa 0.2 e kostos për m<sup>2</sup>, të llogaritur në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) për kategoritë e tjera të dëmtimeve në objekte, llogaritja të bëhet me çmimet, sipas zërave të punimeve të ndërtimit, miratuar për qytetin e Tiranës, për vitin 2007 të Entit Kombëtar të Banësive.

7. Vlerësimi i makinerive dhe i pajisjeve të dëmtuara të kryhet në përputhje me dokumentacionin e depozituar në organet tatimore<sup>303</sup>.

8. Vlerësimi për orenditë dhe pajisjet e dëmtuara të kryhet si më poshtë vijon:

a) Familjet, banesat e të cilave, janë shkatërruar tërësisht, të dëmshpërblehen me 200 000 (dyqind mijë) lekë për frymë, por jo me pak se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për familje;

b) Për familjet e tjera, vlerësimi i pajisjeve dhe orendive shtëpiake të dëmtuara, të evidentuara si të tilla, të kryhet sipas çmimit të tregut, marrë nga organet tatimore;

c) Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në gjënë e gjallë të kryhet sipas çmimeve të tregut, marrë në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”

Vlerësojmë se fakti që paditësi nuk ka pasur dokumentacion kontabël për të dhënë vlerën e blerjes së këtij mjeti “makineri prerje blloqesh”, “makineri e pirunit te transportit” nuk ia mohon të drejtën e tij për të mos u shpërblyer kur ai provon faktin se i ka ato mjete por në gjëndje të dëmtuar nga shpërthimi në Gërdec. Këtë e provon me CD, fotografi të makinerive në objekt dhe listë çmimesh të nxjerra nga interneti në kohën e kryerjes së blerjes.

Pala e paditur, Këshilli i Ministrave e ka njohur informalitetin e Shqipërisë deri në vitet 2008 ku jo për çdo blerje, blerësi pajisje me fatura tatimore shitje, për këtë arsye për orenditë, nuk kërkon dokumente tatimore që provojnë blerjen por i merr të mirëqena vlerën e çmimit të tregut (shih pikën 6 shkronja “b” e VKM së sipërcituar). Sipas ekspertit kontabël dhe atij mekanik dëmi i shkaktuar për dy këto makineri bashkë me dëmtimet në konstrukcionin e biznesit ku ushtronte veprimtarinë është 3,971,481 leke dhe jo 1,400,000 leke sa ka tërhequr nga banka BKT sh.a, të derdhur nga të paditurit.

Mendojmë se parashikimet e VKM kanë qënë formula për të vlerësuar mesatarisht dëmet e ardhura nga ky aksident teknologjik për ato familje që kanë pasur ndërtime të thjeshta, ashtu edhe për ato që kanë pasur ndërtime më luksoze që të vlerësohen sipas kostos mesatare të ndërtimit të banësive, nga Enti Kombëtar i Banësive. Po ashtu si ato familje që kanë pasur banesa të shkatërruara, por që mund të mos i kenë patur të gjithë orenditë shtëpiake edhe si ato familje që i kanë pasur tërë orenditë shtëpiake përsëri trajtohen njësoj me 200 000 lekë për frymë.

<sup>303</sup> Kjo i referohet VKM nr. 559, datë 16.8.2006 “Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së, për makineritë dhe pajisjet e importuara, si dhe energjinë elektrike, të importuar nga KESH Sh.A.” (shënim R.M).



Fakti që i dëmtuari nuk ka dokumente tatimore, por e provon me foto, CD, nuk e rrëzon pretendimin e tij se ka pasur në pronësi a përdorim këtë send, makineri etj. Gjykata duhet të harmonizoj provat dhe të shikoj edhe sjelljen e të dëmtuarit i cili që në vlerësimin fillestar që i ka bërë komisioni e ka ankimuar në Bashkinë e Vorës, në Entin Kombëtar të Banesave duke treguar se reagimi i tij nuk ka qënë abuziv por i qëndrueshëm dhe serioz për të kërkuar vlerën e dëmit të pësuar.

Vihet re se si KM ashtu edhe MF synon që të vlerësojë mesatarisht dëmin pa bërë dallim mes familjeve, duke u nisur me prezumime. Mendojmë se në një situatë të tillë emergjente kjo mund të jetë shpërblimi më optimal dhe i shpejtë për banorët. Gjithësesi në VKM duhet të ishte parashikuar që në rast se qytetarët arrijnë të rrëzojnë këtë prezumim, pra vlera e dëmit të tyre është më e lartë, shpërblimi do të jetë real dhe i plotë për ta. Kjo do të shkonte në harmoni me parimin e e shpërblimit të plotë të dëmit. Të tilla rastesh për aq sa ato provojnë duhet të shpërblehen sipas nenin 11§2 të ligjit nr. 8510/1999 i cili shprehet se dëmi matet nëpërmjet vlerësimeve të ekspertit, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të Kodit të Procedurës Civile.

#### 4.6 Barra e provës

Barra e provës sipas prof. Lamanit është detyrimi për të paraqitur prova mbi një fakt të caktuar.<sup>304</sup>

Ndërsa KPRC parashikon se provat synojnë të vërtetojnë apo të rrëzojnë pretendimeve apo prapësimet e palëve në proces.

Në fakt që të kenë vlerë ato duhet të merren në formën e parashikuar në KPRC (neni 11), p.sh për deklaratimet e shtetasve merret dëshmia përpara gjykatës dhe jo deklaratimet e qytetarëve para noterit publik.

Si rregull në të drejtën civile, ai që pretendon një të drejtë ka detyrimin që të provoj faktet ku mbështet pretendimet (neni 12).

Ky parim, i barrës së provës kryesisht për paditësin, rrëzohet në gjykimet administrative pasi sipas nenit 3§3: *“Organi i administratës publike, si rregull, ka detyrimin të provojë bazueshmërinë në ligj dhe në fakt të veprimeve të kryera prej tij.”* Ndërsa në procedurën hetimore administrative, në KPRA e Ri (edhe në KPRA e 1999<sup>305</sup>) parashikohet në nenin 82 “Barra e Provës” se: *“1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.*

*2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Sipas nenit 35 të ligjit nr. 49/2012 i takon kryesisht të paditurit që të provoj se veprimtaria e atij administrative ka qënë korrekte përkundrejt personi të dëmtuar apo jo. Kështu sipas nenit 35§1 i ligjit organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë:

- e aktit administrativ;

<sup>304</sup> Alqiviadh Lamani: (Doc-Kandidat i Shkencave Juridike): Procedura Civile e R.P.SH – Botim i Universitetit shtetëror të Tiranës, 1962, faqe 120.

<sup>305</sup> Mban të njëjtin numër neni i barrës së provës në të dy Kodet.

- e kontratës administrative që ka nënshkruar;
- dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit;
- si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë;
- në mardhëniet e punës, të provojë ligjshmërinë e veprimeve nga e cila ka lindur mosmarrëveshja, objekt gjykimi.

Në rastet e tjera parashikon neni 35§2 i ligjit të posaçëm, pala paditëse ka detyrimin të provojë faktet, në të cilat bazon pretendimin e saj. Në fakt ligji nr. 8510/1999 mbi barrën e provës në të tillë gjykimesh nuk rregullon asgjë. Në këto kushte referimi do të bëhet drejtpërdrejtë tek ligji nr. 49/2012 për gjykatat administrative dhe gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative. Në rastin konkret neni 35 i këtij ligji parashikon cilat raste OP ka barrën e provës. Ndërsa për raste të tjera, ku përfshihen edhe pretendimet mbi dëm të shkaktuar për veprime të paligjshme, i takon vetë paditësit të dëmtuar që të provojë në mënyrë kumulative kushtet e parashikuara në ligjin nr. 8510/1999 dhe ato të parashikuara në nenin 608 të KC.

Në vendimin nr. 123 datë 01 mars 2016 KA i GJL interpreton se kujt i takon barra e provës në të tillë gjykimesh: “29. Referuar ligjit të kohës kur është shkaktuar dëmi, si dhe atij kur është zhvilluar gjykimi, është pikërisht pala paditëse ajo që ka barrën e provës për të vërtetuar dëmin që i është shkaktuar nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të palës të paditur, veprimet konkrete të paligjshme të kryera nga pala e paditur si dhe faktin që, dëmi që i është shkaktuar është rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të kundërligjshëm të palës së paditur.

30. Në çështjen objekt shqyrtimi, pala paditëse ka provuar me prova shkresore se: a) cili është dëmi që i është shkaktuar dhe në çfarë mase është ai, b) cilat janë veprimet e paligjshme të anës së paditur; c) ku qëndron lidhja shkakësore midis këtyre veprimeve, si dhe pasojës së ardhur; si dhe d) përse konsiderohen me faj dhe të paligjshme veprimet e anës së paditur.”<sup>306</sup>

Pavarësisht se barra e provës i takon të dëmtuarit në gjykime administrative mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore të OAP ka edhe raste kur gjykata, edhe kryesisht, me vendim të ndërmjetëm, mund të vendosë kalimin e barrës së provës tek organi publik. Në këtë rast, sipas nenit 35§fundit të ligjit nr. 49/2012 i kalon përgjegjësia për të provuar dëm OP kur ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova me shkresë, që vërtetojnë se organi publik fsheh apo nuk paraqet me dashje fakte dhe prova të rëndësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ky vendimi i ndërmjetëm për kalim të

<sup>306</sup> Në çështjen me nr. 123 datë 10 mars 2016 Paditësi P.N paditë Inspektoriatin Ndërtimor Urbanistik Bashkia Tiranë për prishje të banesës në Bulevardin “Bajram Curri” si ndërtim pa leje ndërtimi. Në gjykim paditësi nëpërmjet provave shkresore por edhe mendimin e një eksperti gjyqësor topograf provoi se kishte marrë lejen e ndërtimit nr. 113, datë 10.01.1992 “Për ndërtimin e një godine 3 katëshe me sipërfaqe 109 m<sup>2</sup>” të lëshuar nga ish-Komiteti Ekzekutiv i KP të Rajonit nr.1, ka blerë truallin mbi të cilën do të ndërtohej objekti e provuar me mandat pagesa në favor të AKP-së me nr. 255519 serial e vitit 2003 nga Agjensia Kombëtare e Privatizimit, në vlerën 25,600 lekë dhe ka përfunduar ndërtimin me shpenzimet e veta, duke qenë edhe në rolin e investitorit, ka regjistruar pronën pranë ZVRPP Tiranë, duke u pajisur dhe me certifikatë pronësie dhe e ka poseduar qetësisht atë deri në vitin 2008.

Nga ana tjetër, më datë 19.09.2008, Inspektorët e Inspektoratit të Urbanistikës së Bashkisë Tiranë, kanë ushtruar kontroll në objektin pronë e paditësit, kanë lëshuar procesverbalin e konstatimit të kundrvajtjes administrative dhe me vendimin nr. 1611, datë 29.09.2008 vendosin “Urdhërimin për prishjen e objektit të banimit dhe shërbimit si ndërtim pa leje” bazuar në nenin 5/d të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, si dhe nenet 45, 48 dhe 75 të Ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Kryetari i Bashkisë Tiranë me cilësinë e Kreut të INUV Bashkia Tiranë.

barrës së provës nga i dëmtuari tek OP mund të ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar, kjo në mënyrë që procesi gjyqësor të ketë një linjë vazhduese, të mos pezullohet deri në pritje të vendimarrjes së një gjykate më të lartë dhe i dëmtuari të kompensohet sa më parë.

#### 4.7 Disponimi i gjykatës mbi shpërblimin e dëmit

Pas analizimit të ekzistencës së katër elementëve për të konkluduar se ka dëm të shkaktuar pasuror apo jo pasuror, detyra e dytë e gjykatës është ajo e shpërblimit të çdo dëmi. Në lidhje me dëmin pasuror shpërblimi është mëse objektiv referuar nenit 640 të KC. Po aq objektiv në matje paraqitet dëmi pasuror për shkak të humbjes së aftësisë për punë sipas neneve 641,642, 646,647 të KC dhe dëmi pasuror në lidhje me shpenzimet e bërë nga familjarët në rast të vdekjes së të ndjerit apo ato spitalor e parashikuar neni 64 i KC.

Ajo çfarë paraqitet si sfidë për gjyqtarët është matja e dëmit jopasuror dhe figurave të tij për sa kohë që ajo çfarë vlerësohen janë pasuri të luajtshme të pa gjendura në treg, që nuk qarkullojnë e për këtë arsye paraqitet pamundësi për ti vlerësuar objektivisht. Po ashtu, duke qënë se dëmi jopasuror bën fjalë për dhimbjen që pëson një individ, për ndryshimin e cilësisë së jetës, dëmin biologjik etj. për çdo njëri kjo është individuale, pasi çdo person është unik, për jetën dhe mardhëniet që ka me të tjetër prandaj edhe vlera e humbjeve në sferën personale do jetë e pakrahasueshme, pa etalon vlerësues.

Megjithatë, sugjeroj që në matjen e vlerave të jepet në zë të veçantë për çdo dëm të pësuar në mënyrë që edhe i dëmtuari të bindet se sa është vlerësuar dëmi në shëndet, dëmi moral, dëmi ekzistencial i tij apo i paditësave të tjerë.

Zakonisht në praktikën gjyqësore shpërblimet e dëmeve jepen si p.sh” *Detyrimin e palëve të paditura Ministria e Mbrojtjes, Ndermarrja “Meico”, Shoqeria “Albademil” sh.p.k. që solidarisht të shpërblejnë dëmin pasuror dhe jopasuror, biologjik, moral, ekzistencial:*

- *paditesit F.D (babait) për humbjen e jetës së të ndjerit E:D, si pasojë e shpërthimit të Gërdecit më 15.03.2008 në masën 8.699.381 lekë (tete milion e gjashtëqind e nënëtdhjetë e nënte mijë e treqind e tetëdhjetë e një) lekë....Z.D (nënës) ... në masën 8.699.381 lekë (tetë milion e gjashtëqind e nënëtdhjetë e nëntë mijë e treqind e tetëdhjetë e një) lekë. G.D (vëllai) ... në masën 7.421.601 lekë (shtate milion e katerqind e njezetë e një mijë e gjashtëqind e një) lekë dhe I.D (motra)... 7.421.601 lekë (shtate milion e katërqind e njëzetë e një mijë e gjashtëqind e një) leke.”<sup>307</sup>*

Në rastet e shpërblimit kur i dëmtuari është nën moshën 18 vjeç dhe nuk punon (është e pamundur të imagjinohet se cila do të ishte profesioni që do të kryente i mituri), merret si bazë e vlerësueshme për të llogaritur dëmet shëndetësor a biologjik, paga minimale në rang vëndi në kohën e ndodhjes së ngjarjes sipas të Institutit të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT). Pra për tu mos u pasuruar apo për të mos u nënvleftësuar, gjykata merr këtë referencë pasi minimalisht paga që do të merrte një individ qoftë i arsimuar qoftë analfabet nuk mund të jetë më e vogël se aq sa përcakton shteti në nivel kombëtar për vitin e ngjarjes. Në këtë mënyrë nuk kemi diskriminim të askujt për shkak të gjëndjes ekonomike, sociale, preardhje krahinor etj.

Gjykatat zakonisht bazohet edhe në afërsinë gjinore, masin dëmin moral deri në vlerën e marzhit maksimal. Kështu GJSHA I-rë në rastin e familjarëve të viktimës së Gërdecit shprehet se:”... duke qënë se vlera e dëmit biologjik do të llogaritet në bazë të aktit të ekspertimit, dëmi moral për shkak të lidhjes së ngushtë familjare që kanë

<sup>307</sup> Faqe 34.

*paditësit me të ndjerin, dhimbjes shpirtërore të shkaktuar nga vdekja e parakohshme e tyre dhe moshës së viktimave, do të jetë në masën 1/2 e dëmit biologjik. Paditësit kërkojnë prezumimin ligjor të vlerësimit deri në kufirin maksimal, sepse i ndjeri ishte i mitur, familjarët kanë përjetuar agoni të gjatë shpirtërore të pashlyeshme, ndërsa vetë i ndjeri ka përjetuar dhimbje e vuajtje të mëdha deri në humbjen e jetës për shumë ditë me rradhë, si pasojë e djegies në masën 80% të trupit deri në ditën kur organizmi e humbi betejën për jetën.”*

Gjykata e gjeti te bazuar pretendimin e paditesave dhe çmon se dëmshpërblimi që do t’u jepet paditësve, duhet të jetë në kufirin maksimal të përcaktuar edhe në vendimin Nr. 12 dt. 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

#### 4.8 Parashkrimi i padive për shpërblim të dëmit jashtëkontraktor

Parashkrimi shues i padisë është e drejta për të kërkuar përpara organeve kompetente shtetërore, të drejtën subjektive brënda afateve të përcaktuar nga e drejta objektive. Me kalimin e afateve që ligji material, kryesisht Kodi Civil përcakton, padia në kuptimin objektiv nuk mund të ngrihet pasi është e shuar.

Këtu nuk duhet konfondohet me padinë në kuptimin subjektiv e cila mund të ngrihet në çdo kohë pasi askush nuk mund të pengohet ti drejtohet gjykatës me dokumente. Sesa gjen mbështetje kjo kërkesë-padi i takon gjykatës që ta shqyrtoj porse ajo nuk mund ta kthejë një kërkesë-padi në çdo kohë që ngrihet pa i hyrë themelit dhe pa debatuar qoftë edhe parashkrimin shues.

Koncepti i parashkrimit është përcaktuar në nenin 112 të KC<sup>308</sup> si:” *E drejta e padisë që nuk është ushtruar brenda afatit të caktuar në ligj, shuhet dhe nuk mund të realizohet më me anë të gjykatës ose të organit tjetër kompetent.*” Në Kod ka edhe padi që nuk parashkruhen asnjëherë,<sup>309</sup> ashtu siç ka edhe padi me afat të posaçëm parashkrimi.<sup>310</sup> Në të gjitha rastet afati maksimal i parashkrimit të një padie të parashkrueshme është dhjetë vjet.<sup>311</sup>

Sipas ligjit nr. 8510/1999, në nenin 17<sup>312</sup> parashikohet se padia përkundrejt OASH parashkruhet dhe se afati i parashkrimit është tre vjet. Ky afat shkon në analogji edhe me nenin 115 të KC<sup>313</sup> ku paditë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor parashkruhen brënda të njëtit afat tre vjeçar. Edhe ligji nr. 49/2012 referon tek ligji i posaçëm mbi afatin se kur duhet paraqitur padia për shpërblimin e dëmeve jashtëkontraktore.<sup>314</sup>

Në lidhje me faktin se kur fillon llogaritja e këtij afati, neni 117 i KC parashikon se afati i parashkrimit fillon nga momenti i lindjes të së drejtës. Ketu, merren parasysh çasti i shkaktimit të dëmit si dhe organi që e ka shkaktuar dëmin.

<sup>308</sup> Neni 112 i Kodit Civil “*E drejta e padisë që nuk është ushtruar brenda afatit të caktuar në ligj, shuhet dhe nuk mund të realizohet më me anë të gjykatës ose të organit tjetër kompetent*”.

<sup>309</sup> Neni 113 i Kodit Civil.

<sup>310</sup> Neni 115 i Kodit Civil.

<sup>311</sup> Neni 114 i Kodit Civil.

<sup>312</sup> Neni 17§1 “*Kërkimi i shpërblimit për demet e shkaktuara nga organet e administratës shtetërore parashkruhet brenda 3 vjetësh nga çasti kur i dëmtuari merr dijëni për demin dhe organin që e ka shkaktuar atë.*”

<sup>313</sup> Neni 115 “*Parashkruhen brenda afateve prej: dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jo kontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë.*”

<sup>314</sup> Neni 21 “*4. Paditë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor paraqiten në gjykatë, sipas afateve të parashikuara në ligjin e posaçëm.*”

Neni 120 i KC, afatin e parashkrimit për kërkimin e shpërblimit të dëmit jokontraktor e llogarit nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar. Në të drejtën civile, njihet edhe prezumimi se kur mund të ketë ditur i dëmtuari për dëmin ndërsa në të drejtën administrative faktet duhet të jenë të provuara. I bie barra paditësit të provoj se kur i ka ndodhur dëmi (datën e saktë) dhe kur ka rënë në dijeni për organin që e ka shkaktuar. Pra në asnjë rast nuk ka vënd për prezumime.

Në praktikë momenti i marrjes dijeni për shkaktimin e dëmit konsiderohet rasti kur i dëmtuari direkt është koshient për humbjen e pësuar nga veprimet a mosveprimet e OAP. Pra duhet që të arrijë të kuptojë se ka pësuar një dëm pasuror ose jo pasuror nga një OAP.

Momenti i dytë kumulativ është kur personi i dëmtuar të indentifikojë dhe të kuptoj se cili është OP që i ka shkaktuar këtë dëm. Pra mendojmë se nuk është e mjaftueshme që i dëmtuari të hamendësoj apo të përceptojë se logjikisht dëmi i ka ardhur nga institucion shtetëror por të ketë prova të mjaftueshme mbi këtë.

Kjo kërkesë për parashkrimin shkon në harmoni edhe më kerkesën procedurale të ligjit nr. 49/2012, ku në nenin 21 të saj parashikohet se kërkesë-padia përmban elementët e parashikuar nga neni 154, 154/a i KPRC, pra nënkupton që padisë t'i bashkangjiten edhe provat e mundshme ku mbështetet padia<sup>315</sup> (zakonisht akti administrativ nga ku ka ardhur pasoja në pasuri ose interesa të tjera personale). Nëse i bashkangjitet akti adminsitrativ do të thotë se i dëmtuari njeh mirë se kush është personi që i ka shkaktuar dëmi. Po ky do ishte rasti më i lehtë për ilustrim. Shpesh palët mund të kenë rrezikuar në humbjen e afatit të parashkrimit deri se kanë zbuluar autorin e vërtetë të shkaktimit të dëmit ose deri në pritje të një zgjidhje jashtëgjyqësore me të.

Në një vendim të Gjykatës Apelit Administrativ Tiranë<sup>316</sup> katër paditësit dhe dy ndërhyrësit kryesor, ish-punonjës të ambasadës shqiptare në Republikën ish-jugosllave të Serbisë paditën Ministrinë e Punëve të Jashtme e cila nuk morri masa të hershme për t'i njoftuar në një shkëputje/tërheqje normale nga ambasada nga sulmet e NATO-s në Serbi në mars 1999.

MPJ urdhëroi lënien e mënjëhershme të selisë së ambasadës dhe kthimin bashkë me familjet në Shqipëri. Paditësit pretendojnë se orenditë, veshjet, sendet personale e deri tek sende me vlerë i kishin lënë në rezidencat e tyre që u plaçkitën nga huliganë serbë. Paditësit pretendojnë se po të ishin njoftuar normalisht nga MPJ ky dëm pasuror nuk do të ndodhte. Pala e paditur kërkoi rrëzimin e padisë si e parashkruar.

Gjykata e Apelit argumenton se padia është parashkruar pasi që nga data 03.05.2001, kohë kur paditësit i janë drejtuar palës së paditur për dëmshpërblimin vetëm në tetor 2007 u hartua projektvendimi për zhdëmtim drejtuar KM. Këtu kemi një ndërperje të afatit të parashkrimit dhe pretendohet se afati ka filluar në tetor 2007 ku Ministrinë e Financave dhe të Drejtësisë kanë dhënë mendim. Paditësat dhe ndërhyrësit kryesorë i janë drejtuar gjykatës me datë 11.10.2011 pra pas katër vjetësh.

Në një rast tjetër në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë,<sup>317</sup> është rrëzuar padia për shpërblim dëmi jashtëkontraktor e Shoqërisë A..Shqipëri shpk ndaj Degës së Doganës Shkodër. Gjykata konstatoi se padia ishte e parashkruar me arsyetimin se: *“Pala paditëse ka pretenduar se dëmi jashtëkontraktor i është shkaktuar nga Dega e Doganës Shkodër si rrjedhojë e bllokimit të aktivitetit tregtar të saj për shkak të*

<sup>315</sup> Neni 154 i KPRC: *Kërkesëpadia shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë:... “- tregimin e fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese dhe të së drejtës mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia;...”*

<sup>316</sup> Vendimi nr. 81 datë 23 janar 2015 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.

<sup>317</sup> Vendimi nr.72 datë 14 janar 2014 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.

ekzistencës së një borxhi doganor në shumën 26.350.747 lekë. Ligjshmëria e ekzistencës së këtij borxhi doganor ka qënë objekt shqyrtimi gjyqësor. Me vendim gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Shkodër nr.155 datë 18.04.2005 është deklaruar se ky borxh duhet të shuhet duke u detyruar gjyqësisht Dega e Doganës Shkodër të nxjerrë aktin administrativ për shuarjen e tij. Në zbatim të këtij vendimi gjyqësor të formës së prerë në datë 03.04.2006 duke nxjerrë aktin administrativ për këtë shkak, pala e paditur e ka njoftuar palën paditëse se ky borxh është shuar përfundimisht. Llogaritja e afatit të parashkrimit të padisë duhet të fillojë pikërisht nga data 03.04.2006 dhe nga kjo datë e drejta e padisë duhet të ushtrohej deri në datë 03.04.2009, ndërkohë që padia është ngritur jashtë afatit në datë 19.05.2010.”

Së dyti- Një afat tjetër se kur mund të llogaritet parashkrimi shues i padisë është ajo e parashikuar nga neni 17§2 i ligjit nr. 8510/1999 “Ne rastin kur dëmi shkaktohet nga ndryshimi i situatës, në vend të marrjes dijeni për dëmin, futet koncepti i marrjes dijeni për rrethanat, të cilat e kane bërë situatën të kundërligjshme. “

Ndryshimi i situatës si formë e shkakimit të dëmit nuk është e parashikuar nga neni 3 i këtij ligji. Ai mund të përfshihet tek rastet e parashikuar nga neni 3 shkronja a,b dhe d të ligjit nr. 8510/1999.<sup>318</sup> Në këto raste, afati i fillimit të ngritjes së padisë është momenti kur i dëmtuari merr vesh për rrethanat e reja të kundërligjshme që passollën dëmin si dhe kur njeh organin që ka shkakuar këtë dëm. Ky parashikim është më tepër teorik sesa i ndeshur në praktikë.

Megjithat gjykatat duhet të jenë të kujdesshëm nëse çështja hyn në lëmin e ligjit nr. 8510/1999. Në një rast në Gjykatën e Apelit Tiranë është rrëzuar padia ndaj Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë me arsyetimin se e drejta për të kërkuar diferencën e papaguar nga llogaritja e padrejtë e pensionit parashkruhet brenda 3 vjetëve sipas nenit 115/dh të KC dhe neni 17 të ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve shtetërore”.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 133 datë 05 mars 2015 e ka gjetur të padrejtë këtë vendim duke arsyetuar se:”në lidhje me parashkrimin e padisë, gjykata i është referuar në mënyrë të gabuar rregullimeve të dy ligjeve dhe konkretisht nenit 19 të ligjit nr. 8097/1996 “Per pensionet shtetërore suplementare te personave qe kryejne funksione kushtetuese dhe te punonjesve te shtetit” dhe nenet 17 ligjit nr. 8510/1999. Këto ligje nuk kanë të bëjnë me çështjen objekt gjykimi. Nuk jemi para një mosmarrëveshje të një dëmi jashtëkontraktor, që të zbatohet e drejta e parashkrimit e parashikuar në ligji nr. 8510/1999. Jemi para kërimit për rivendosjen e një të drejtë në lidhje me rillogaritjen e masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, e cila nuk parashkruhet. Po ashtu ligji nr. 8510/1999 nuk rregullon fare situatën e afatit të paraqitjes së kërkesës për rillogaritjen e pensioni të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, pasi ky ligj bën fjalë për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.<sup>319</sup>

#### 4.9 Afati parashkrimi apo dekadence

Për të ngritur padinë e kërimit të dëmshpërblimit, parashikohet si në ligjin e

<sup>318</sup> Neni 3”a) kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme, b) kur kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, por që sjellin dëmtimin e interesave të ligjshme të personave fizikë a juridikë private dhe ... ç) kur, për shkak të mosfunksionimit të mjeteve teknike me të cilat organet e administratës shtetërore ushtrojnë veprimtarinë e tyre, persona fizikë a juridikë privatë cenohen në interesat e tyre të ligjshme; ...”

<sup>319</sup> Ky qëndrim është mbajtur edhe në vendimet e tjera të Gjykatës së Lartë, Kolegji Administrativ nr. 201 datë 26 mars 2015, nr. 202 datë 26 mars 2015, nr. 257 datë 29 prill 2015, nr. 289 datë 07 maj 2015, nr.325 datë 21 janar 2015, nr.383 datë 10 qershor 2015, nr. 606 datë 13 nëntor 2014.

posaçëm ashtu edhe në Kodin Civil një afat tre vjeçar. Këtij afati i referohet edhe neni 18§4 i ligjit nr. 49/2012 i cili parashikon se:” 4. Paditë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor paraqiten në gjykatë, sipas afateve të parashikuara në ligjin e posaçëm”.

Ajo çfarë paraqetet paksa kontradiktore është pika 7 e po këtij neni ku parashikon se:”Afatet e mësipërme janë të prera dhe shkelja e tyre shkakton humbjen e së drejtës së padisë. Këto afate shqyrtohen nga gjykata edhe kryesisht.”

Në këtë mënyrë afatet për ngritjen e padisë së shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor sipas ligjit nr. 49/2012 paraqiten prekluzive dhe jo afate parashkrimi.

Neni 140 i KC sqaron një karakteristikë të afatit prekluziv, si një afat që merret parasysht nga gjykata ose arbitrazhi kompetent me nismën e vet, edhe pa u kërkuar nga pala e interesuar.

Sipas nenit 137 të KC “Kur një e drejtë duhet të ushtrohet brenda një afati prekluziv, nuk zbatohen dispozitat që rregullojnë ndërprerjen e parashkrimit. Gjthashtu, nuk zbatohen shkaqet pezulluese, përveç rasteve përjashtimore, kur vetë ligji lejon pezullimin e afatit prekluziv” Afatet prekluzive janë afate që nuk zgjaten, nuk pezullohen dhe as ndërpriten dhe nëse padia nuk ngrihet brenda këtij afati, shuhet tërësisht dhe as rivendoset e drejta e padisë apo e ankimit etj.<sup>320</sup>

Megjithatë të krijohet përshtypje se afati për ngritjen e kësaj padie është afat prekluziv për shkak të parashikimit të bërë nga neni 18§7 i ligjit nr. 49/2012, në fakt vlerësojmë se është një afat parashkrues me argumentin se:

- Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar vetë referon tek ligji i posaçëm, nr. 8510/1999, për afatin e ngritjes së padisë për shpërblim të dëmit jashtëkontraktor ndaj administratës.
- Afatet prekluzive janë të përcaktuar posaçërisht në ligj. Kjo del në interpretim të nenit 139 të KC ku “Palët nuk mund të ndryshojnë urdhërimet ligjore që rregullojnë prekluzivitetin, dhe as mund të heqin dorë nga afati prekluziv i plotësuar kur ky afat është caktuar me dispozita ligjore të veçanta”.
- Vetë ligji nr. 8510/1999 e parashikon këtë afat tre vjeçar specifikisht si afat parashkrimi ku shprehet se:”Kërkimi i shpërblimit për demet e shkaktuara nga organet e administratës shtetërore parashkruhet brenda 3 vjetësh nga çasti kur i dëmtuari merr dijeni për demin dhe organin që e ka shkaktuar atë.”

Pra mund të themi se afati tre vjeçar i ngritjes së padisë për demet jashtëkontraktore karshi OAP është një afat parashkrimi dhe jo dekadent. Në këto kushte ato i nënshtrohen të gjitha rregullimeve të bëra nga Kodi Civil nga nenet 112 deri 128 ku mund të zgjaten, pezullohen, ndërpriten apo rivendosen. Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë në çështjen e palëve V.L etj. dhe ndërhyrësit kryesor F.N ndaj Ministrisë së Punëve të Jashtme për tu rivendosur në afat të drejtën e padisë duke argumentuar se:” Gjykata e Apelit Administrativ terheq vemendjen mbi faktin se ne rigjykim, gjykata e shkalles se pare duhet te veçoje kerkimet administrative, pjese e objektit te padise, me qellim qe pretendimet per pagim demi jashtekontraktor, te shqyrtohen vetem pasi te kete marre forme te prere vendimi tjetër gjyqësor lidhur me kerkesen per rivendosje ne afatin e humbur ligjor te kerkimit te ketij demshperblimi”<sup>321</sup>

<sup>320</sup> Neni 151 të KC – Rivendosja në afat “Kur palët ose prokurori që ka ngritur padi, për shkaqe të arsyeshme kanë humbur afatin ligjor ose atë të caktuar nga gjykata, mund të kërkojnë prej saj rivendosjen në afat, përveç kur afatet kanë karakter prekluziv.”

<sup>321</sup> Vendimi nr. 81 datë 23 janar 2015 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.

Lind pyetja nëse bashkë me padinë shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor mund të ngrihet kërkitimi për rivendosje në afat të padisë? Këto kanë gjykime kanë karakteristika të ndryshme, e para gjykim gracioz, me kërkesë dhe person të tretë ndërsa e dyta me gjykim kontencioz mes dy palëve kundërshtare. Po ashtu afatet e ankimit për një kërkesë për rivendosjen në afat sipas nenit 151 të KPRC është ankimi i veçantë (5 ditë) ndërsa padia e themelimit ka një afat ankimi të përgjithshëm (15 ditore).

Kolegji Administrativ i GJL me vendimin nr.65 datë 28 janar 2016 ka pranuar se këto dy kërkitime mund të ngrihen bashkë dhe janë të ndërvarura me njëra-tjetrën. Sipas nenit 159 të KPRC, argumenton GJL "gjykata e shkallës së parë ishte kompetente për të dy kërkitimet dhe shqyrtimi i tyre së bashku nuk sillte vështirësi lidhur me gjykimin, pavarësisht se zgjidhja e njërit mund të ndikonte në zgjidhjen e kërkitimit tjetër. Po kështu, Kolegji vëren se nuk ka asnjë dispozitë ligjore, që ndalon shqyrtimin e kërkitimit të padisë së themelit me kërkitimin për rivendosjen në afat, madje nuk ka kuptim që ato të gjykohen në mënyrë të veçantë. Në këtë rast jemi para dy kërkitimeve që kanë lidhje me njëri tjetrin dhe zgjidhja e njërit kushtëzon zgjidhjen e kërkitimit tjetër. Thënë ndryshe, gjykata ndodhet para një bashkimi të ndërvarur të dy kërkitimeve në një padi."

Duke prishur dhe kthyer për rigjykim çështjen në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, Kolegji Administrativ orienton palët dhe gjykatës se nuk mund të qëndrojnë bashkë si kërkitime fakti se padia nuk është parashkuar por afatet janë pezulluar dhe ndërprerë disa herë me pretendimin për rivendosje në afat të së drejtës së padisë, citojmë "Kolegji thekson se të dy këto raste janë të ndryshme dhe duhen dalluar nga njëri tjetri. Vetë paditësit dhe ndërhyrësit kryesor në gjykim kanë pretenduar ndërprerjen dy herë të parashkrimit të padisë. Në një rast të tillë, ligji material civil ka parashkuar qartë rastet e pezullimit apo ndërprerjes së afateve të parashkrimit dhe pasojave që kanë pezullimi dhe ndërprerja e parashkrimit në afatet e të drejtës për të ngritur padi.

Në këtë drejtim, ndërprerjen e afateve të parashkrimit të së drejtës për të ngritur padi, gjykata duhet ta shqyrtojë në kuadër të kërkitimit të themelit, pra atij të shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor. Kjo pikërisht për faktin se pala që e paraqet kërkitimin e shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor e konsideron veten në afat dhe nëse në gjykim prapësohet parashkrimi i padisë, ajo është e detyruar të argumentojë dhe vërtetojë ndërprerjen e afateve të parashkrimit dhe kohën e kësaj ndërprerje.

Në të kundërt, nëse paditësit dhe ndërhyrësit kryesor e konsiderojnë të humbur afatin e parashkrimit, atëherë ata duhet të paraqesin arsyet madhore që kanë çuar në humbjen e këtij afati, duke vërtetuar pamundësinë e tyre për realizimin e të drejtës së tyre për të ngritur padinë brenda afatit të parashkrimit, me qëllim vërtetimin e pretendimeve të tyre lidhur me kërkesën për tu rivendosur në afat."

#### 4.10 Vendimarrja e Gjykatës

Ashtu si në gjykimin civil, edhe në gjykimin administrativ, gjykatat kanë kufij deri kur mund të shtrihet vendimarrja e tyre bazuar edhe në kërkitimet e palëve ndërgjyqëse. Sipas nenit 37 të ligjit nr. 49/2012 parashikohet se gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ. Kjo do të thotë se në rastin e padive me objekt shpërblim të dëmit jashtëkontraktor gjykata jo domosdoshmërisht duhet të ketë si provë një vendim të mëparshëm gjyqësor apo të një organi më të lartë administrativ i cili ka shqyrtuar ligjshmërinë e veprimit administrativ nga ku ka ardhur dëmi.



Paditët me objekt të shumëfishë si: “Pavlefshmëri të aktit administrativ të lëshuar nga pala e paditur dhe shpërblimin e dëmit të ardhur prej tij” apo thjesht me padinë “Shpërblim të dëmit jashtëkontraktor të ardhur nga verpimet e kundërligjshme të të paditurit” etj. kombinime të nenit 15 të KPRRA dhe nenit 3 të ligjit nr. 8510/1999 bashkë me nenet 608 e vijues të KC janë brënda kufijvë të Gjykatës Administrative.

Vendimi i KB të GJL nr. 5/2012 ka unifikuar praktikën gjyqësore ku pavlefshmëria absolute e një veprimi juridik konstatohet edhe kryesisht nga gjykata dhe jo domosdoshërisht kërkohet të jetë një kërkim më vete, por gjykata do marr dhe do të zgjidhë ato pasoja që kanë kërkuar palët kur rrjedhin drejtpërdrejtë nga kjo pavlefshmëri.

Prandaj mendojmë se janë të gabuara qëndrimet që mund të mbajnë gjykatat kur domosdoshmërisht kërkohet që padia e shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor duhet të ketë edhe objektin primar të anulimit të vendimit administrativ që ka sjell këtë dëm. Në këtë rast padia është ndërtuar duke i kërkuar gjykatës direkt pasojën që vjen llogjikshëm nga një vendimarrje absolutisht e pavlefshme.

Në mosqoftë e paparashtruar specifikisht në padi, domosdoshmërisht në përmbajtje të saj paditësi e më pas gjykata në vendim, do të analizojnë sipas nenit 608 të KC lidhjen shkak pasojë, ku do të vlerësohet sepse dëmi i ardhur vjen nga një veprim a mosveprim i paligjshëm. Prandaj ky moment superohet minimalisht nga kjo analizë. Në vendimin nr. 109 datë 19 shkurt 2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka prishur vendimin e Gjykatës e Apelit Tiranë, nr. 1309, datë 29.05.2012, ndër të tjera thuhet se:”... pavlefshmëria absolute e akteve/vendimeve administrative për prishje objekti, që është pretenduar nga paditësat, nuk mund dhe nuk duhet të ishte vënë në diskutim nga gjykata e shkallës së parë, përse kohë padia nuk kishte një lloj kërkimi të tillë....por shpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga shkatërrimi me 17 prill 2007 i tre objekteve të ndërtuara nga pala paditëse në fshatin Jalë, Vuno, Rrethi Vlorë, si më poshtë: Dëmin efektiv në shumën 46.2 milionë lekë. Dëmin moral në shumën 17.933.000 lekë.”

Sipas Gjykatës së Lartë prishja e një vendimi të shkallës së parë duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e parashikuar nga neni 465 të KPRC, ndërsa marrja e një prove mund të bëhet edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë pasi ka cilësi të dyfishtë (gjykatë revizioni dhe fakti) dhe nuk do të sillte zvarritje të çështjeve, por përkundrazi gjykim të saj brenda një afati të arsyeshëm.

Në vendimin nr.310 datë 01 korrik 2010, Kolegji Civil i GJL shprehet se:” Me vendimin përfundimtar, gjykata do të marrë në analizë e të vlerësojë konform kërkesave të ligjit nëse palës paditëse i është shkaktuar ose jo dëm dhe ku konsiston ky dëm; nëse dëmi i pretenduar është rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimeve apo mosveprimeve të palës së paditur (lidhja shkakësore) dhe nëse këto veprime a mosveprime janë të kundërligjshme apo janë në ushtrim të veprimtarisë normale e brenda kompetencave të anës së paditur, që nuk rrjedhojnë në shkaktimin e ndonjë dëmi anës paditëse dhe nëse ekziston ose jo faji i anës së paditur në ardhjen e dëmit të mundshëm.”

Në rastin kur ligji i jep organit publik të drejtën për zgjedhje alternative, në nxjerrjen e një akti administrativ apo në kryerjen e veprimit tjetër administrativ, gjykata shqyrton edhe nëse:

- a) zgjedhja nga organi publik është bërë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit;
- b) zgjedhja nga organi publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit;
- c) zgjedhja nga organi publik është në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

Në rastin e aktit nënligjor normativ, gjykata shqyrton ligjshmërinë e aktit që kundërshtohet, duke vlerësuar të tre kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

Në vendimin nr. 1594/2015, çështja e familjarëve të një prej viktimave të Repartit të Demontimit Gërdec GJASHK i-rë Tiranë u shpreh se: "Nisur nga kjo logjikë e përdorur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Gjykata arrin në konkluzionin se Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga te paditurit ne kete gjykim, Ministria e Mbrojtjes, Ndërmarrja MEICO apo personave të tjerë privatë të autorizuar nga autoritetet shtetërore, janë përgjegjëse për humbjen e jetës së 26 personave në Gërdec në datën 15.03.2008, jo vetëm bazuar mbi legjislacionin shqiptar, por edhe mbi Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, pasi kanë dështuar në marrjen e të gjitha masave të nevojshme për shmangien e humbjes së jetës së të ndjerit E.D.

Gjykata vlereson se veprimtaria e demilitarizimit dhe demontimit të municioneve luftarake, sikurse edhe ajo e prodhimit, transportimit, depozitimit dhe përdorimit të tyre, janë veprimtari ekstremisht të rrezikshme, që përfaqësojnë gjendjet klasike të burimit të rrezikut të shtuar. Për këtë arsye, ushtrimi dhe mbikqyrja e veprimtarisë nga të paditurit për transferimin, transportimin, depozitimin, demontimin e municioneve luftarake, si dhe ajo për depozitimin e barutit dhe lëndëve të tjera shpërthyesë të mbetura nga ky proces teknologjik, përbëjnë një veprimtari burimi rreziku të shtuar, gjë që sipas nenit 622 të Kodit Civil, passjell vetvetiu përgjegjësinë objektive të autoriteteve shtetërore për çfaredo lloj dëmi të shkaktuar nga një veprimtari e tillë."

Megjithatë duhet të kemi kujdes se padia e shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor është një padi ndryshe nga padia për begatim pa shkak<sup>322</sup> apo e pagimit të padetyruar.

Vihet re në praktikë gjyqësore ku pala paditëse mbi pretendimet e saj për shpërblim dëmi jashtëkontraktor i referohet nenit 655 i KC "Begatim pa shkak" edhe tek neni 3 i ligjit nr. 8510/1999. Kihet parasysh që të mos konfondohet këto dy padi pasi kanë shkaqe ligjore krejt të ndryshme. Neni 658 i KC parashikon se :*"padia për begatimin pa shkak nuk mund të ngrihet kur i dëmtuari mund të ngrejë një tjetër padi për të kërkuar shpërblimin e dëmit të pësuar"* Pra, nëse provohet se paditësi ka pësuar një dëm në person a pasuri nga veprime a mosveprime të padrejta të të paditurit, dhe provohet kjo lidhje shkakësore qoftë i padituri me faj a pa faj ngrihet padia e shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor. Nëse është pala shkaktuese e dëmit organ shtetëror apo OAP bazohemi përveç neneve 608 e vijues të KC por edhe tek neni 44 i Kushtetutës, Parimi i Përgjegjshmërisë së KPRA dhe tek ligji nr. 8510/1999. Pra në mënyrë kategorike këto dy padi përjashtojnë njëra-tjetrën.

Jo pa qëllim legjislatori i ka ndarë këto padi pasi tek begatimi pa shkak, domosdoshërisht kërkohet që shkaktuesi i dëmit të ketë fituar për vete diçka në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet kursimit si dhe ky fitim të bëhet në mungesë të një shkakut të ligjshëm, por jo në mënyrë të kundërligjshme.<sup>323</sup> Ndërsa në përgjegjësinë

<sup>322</sup> Neni 665 i KC parashikon se: *"Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të begatimit."*

<sup>323</sup> Gjyqtari i Gjykatës së Lartë Prof. Xhezair Zaganjori në mendimin e pakicës në vendimin nr. 408 datë 25 qershor 2015 të Kolegjit Administrativ shprehet mbi begatimin pa shkak se: *"nuk jemi në kushtet ligjore të begatimit pa shkak, pasi mes palëve ndërgjyqëse ka ekzistuar një marrëdhënie kontraktore dhe sipas ligjit, nuk mund të kryheshin veprime jashtë saj. Siç u parashtrua më lart për punime të tjera të paparashikuara në kontratë, duhej lidhur kontratë shtesë, fakt i cili nuk ka ndodhur. Në këto kushte, pala paditëse në kundërshtim me ligjin ka kryer veprime për të cilat nuk mund të kërkojë shpërblimin për to nga pala e paditur. Begatimi pa shkak nënkupton përfitimin e një pale në dëm të një pale tjetër pa pasur një shkak të ligjshëm, por asnjëherë ky shkak nuk mund të jetë i kundërligjshëm. Pra, kuptimi i begatimit pa shkak është i lidhur me përfitimin e një të drejtë të ligjshme. Jam i mendimit se nuk mund të pretendohet begatim pa shkak nga pala paditëse, pasi vetë ajo ka vepruar në kundërshtim dhe nuk ka respektuar ligjin për prokurimin publik. Vetëm kështu do të garantohet mbrojtja e fondeve publike, detyrim i organeve të administratës publike në ushtrimin e veprimtarisë së tyre."*

jashtëkontraktore nëse rezulton se dëmtuesi të ketë fituar diçka nga ky veprim a mosveprim i padrejtë (i cili paraqitet si rast përjashtimor) Gjykata e llogarit këtë përfitim, duke i shtuar tërësisht ose pjesërisht në shpërblimin e dëmit që merr i dëmtuari.<sup>324</sup>

Në çështjen civile me vendim nr. 408 datë 25 qershor 2015 të Gjykatës së Lartë rezulton se Shoqëria “B...”shpk ndaj Bashkisë Tiranë pala paditëse ka kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar, nga begatimi pa shkak i saj në shumën prej 79,025,841 lekë, e cila përfaqëson vlerën e shërbimeve shtesë të kryera për shkak të shtimit të sipërfaqeve të rrugëve që fshiheshin dhe laheshin dhe shtimit të volumit të mbetjeve urbane në zonën e kontraktuar, për periudhën nga data 01.06.2006 deri me datë 08.02.2008.

Ndërsa si bazë ligjore ka vendosur ndër të tjera nenet “Nenet 32 dhe 154 të K.Pr. Civile, nenet 855, 851, 860, 862, 608, 436 e vijues, 640, 6555 të Kodit Civil. Ligji Nr. 8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore. Kontrata e sipërmarrjes Nr. 3498 prot, datë 06.06.2002 “Për pastrimin e pjesës perëndimore të qytetit të Tiranës”, shtesa e kontratës Nr. 3670 prot. datë 06.06.2007 dhe shtesa Nr. 7291 prot, datë 08.10.2007.”

Në këtë mënyrë as vetë paditësi nuk e ka të qartë se ku e mbështet të drejtën e tij subjektive, dëme që vijnë nga mospërbushja e kontratës së sipërmarrjes meqënëse ka vendosur nenet 855 të KC që i takojnë kësaj kontrate. Në rast se kemi dëm kontraktual përjashtohet mundësia të kemi dëm jashtëkontraktual apo begatim pa shkak. Nëse kjo referencë është një lajthitje juridike, gjykojmë vendosjen e neneve 655 të begatimit pa shkak dhe neneve 608 mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore në Kodin Civil dhe ligjit nr. 8510/1999. Dy referencat e fundit ligjore qëndrojnë dhe plotësojnë njëra-tjetrën përsa i përket përgjegjësisë jashtëkontraktore të administratës shtetërore karshi privatëve ndërsa begatimi pa shkak është po aq lajthitje sa të vendosësh dispozita që i referohen kontratave. Pasi siç e shprehëm edhe më lartë, begatimi pa shkak është padia e fundit që ngrihet kur e drejta nuk gjen asnjë mbështetje ligjore në të drejtën objektive.

Sipas nenit 19 të ligjit nr. 8510/1999 vendimi i i organit të administratës shtetërore për njohjen e përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit, për pagimin e dëmshpërblimit përkatës dhe të masës së tij, përbën titull ekzekutiv. Kjo do të thotë se vendimi i organit administrativ pasi merret edhe urdhëri i ekzekutimit në Gjykatë sipas nenit 510 shkronja “e” e KPRC i dërgohet zyrës së përbarimit për ekzekutim.

Nëse është gjykata administrative që vendos për shpërblimin e paditësit për dëm jashtëkontraktor nga OAP sipas nenit 41 të ligjit nr. 49/2012 ajo duhet të shoqërohet me afate për kryerjen e tyre dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit nga administrata publike. Ky vendim është i ekzekutueshëm direkt nga përbaruesi gjyqësor, pas marrjes formë të prerë, pasi bashkë me vendimin përfundimtar të shkallës së parë, nxirret edhe urdhëri i ekzekutimit.<sup>325</sup>

<sup>324</sup> Neni 644”Kur personi që ka kryer veprimin apo mosveprimin e paligjshëm krahas dëmit të shkaktuar, ka patur edhe një përfitim të dukshëm, gjykata me kërkesën e palës së dëmtuar duke patur parasysh natyrën e dëmit, shkallën e fajësisë e rrethana të tjera të çështjes mund të llogarisë në shpërblimin e dëmit, tërësisht apo pjesërisht përfitimin”.

<sup>325</sup> Duke qënë se ligji nr. 49/2012 i referohet KPrC për aq sa nuk ka parashikime më të detajuara apo të parregulluara interpretohet se bashkë me vendimin përfundimtar, gjyqtari i çështjes nxjerr edhe urdhërin e ekzekutimit sipas nenit 310/1 të KPRC (ndryshime të hyrë në fuqi më 01 shtator 2013). Me marrjen formë të prerë kancelari i gjykatës së Shkallës së Parë kur vendimi nuk ka pasur ndryshime, e vulos për ta bërë të ekzekutueshëm nga përbaruesi gjyqësor, urdhërin e ekzekutimit. Në rast se vendimi i shkallës së parë ka pasur ndryshime, është Gjykata e Apelit që nxjerr urdhërin e ekzekutimit bashkë me vendimin e zbardhur (transkriptuar) të saj sipas nenit 466/1 të KPRC.

**KREU V****SHPËRBLIMI I DEMIT JASHTEKONTRAKTOR PREJ ADMINISTRATËS PUBLIKE**

- 5.1 *Shpërblimi i dëmit pasuror dhe kriteret që merren parasysh*
  - 5.1.1 *Mënyrat e shpërblimit të dëmit pasuror*
  - 5.1.2 *Shpërblimit i dëmit jopasuror, në mënyrë fillestare në natyrë*
  - 5.1.3 *Shpërblimi i plotë i dëmit Ndryshueshmëria e shpërblimit të dëmit*
  - 5.1.4 *Mënyra e copëzimit të shpërblimit (pagesa me këste)*
- 5.2 *Mënyrat e shpërblimit të dëmit jopasuror dhe kriteret që merren parasysh*
  - 5.2.1 *Parimi i shpërblimit të plotë (restitutio in integrum)*
  - 5.2.2 *Shpërblimi i drejtë*
  - 5.2.3 *Shpërblimi në mënyrë unike*
  - 5.2.4 *Mënyra e shpërblimit simbolik ose deklarues*
- 5.3 *Kriteret që merren parasysh për shpërblimin e dëmit*
- 5.4 *Shpërblimi i dëmit sipas jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut (nenet 13 dhe 41)*
- 5.5 *Shpërblimi i dëmit në mardhëniet ndër-shtetërore sipas Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara*

Mbas analizës së ekzistencës së dëmit, detyra e dytë që i mbetet gjykatës apo organit *administrativ* epror për të vlerësuar është se si duhet të shpërblehet personi i dëmtuar direkt apo indirekt. Kjo konsiderohet një e drejtë kushtetuese ku sipas nenit 44 të Kushtetutës parashikohet se: "Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin..." Në fakt qëllimi i legjislatorit është të rikthehet gjëndja e mëparshme e të dëmtuarit për aq sa ajo është e mundur nëpërmjet rehabilitimit dhe nëse kjo nuk është e mundur të konvertohet kjo gjëndje në shumë monedha dhe të zhdëmtohet.

Parimi kryesor që vepron në deliktet është ajo e *restitutio in integrum* pra, rikthimi i plotë i situatës njësoj sikur i dëmtuari të mos ketë pësuar dëmin, as të mos e varfëroj dhe as të mos e pasuroj të dëmtuarin, duke përfutur në mënyrë të padrejtë. Megjithatë në nenin 9 të ligjit nr. 8510/1999 parashikohet se nuk mban përgjegjësi organi i administratës shtetërore në qofte se dëmi nuk do të mund të shmangej edhe me një kujdes normal, të nevojshëm të treguar nga nëpunësit e organit. Ndërsa në të gjitha rastet administrata publike mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar kur ai vjen si rezultat i mosfunksionit të mjeteve teknike si semaforët, tabelat e qarkullimit rrugor, ndriçuesit për rregullimin e trafikut ajror, detar etj.

Teoria mbizotëruese në shpërblimin e dëmit në Shqipëri është e njëjtë me atë të mos përmbushjes së detyrimeve, ku synohet që debitori të përmbush në natyrë detyrimin dhe nëse kjo nuk është e mundur, në të holla. Kjo nënkupton që i dëmtuari të rikuperohet a rehabilitohet duke u kryer ato veprime të cilët e sjellin të dëmtuarin identik, në gjëndjen e mëparshme. Ndërsa shpërblimi në të holla është një alternative plotësuese nëse kjo situatë identike nuk është e mundur.

Në çështjen nr. 57/1996/676/866 datë 25 shtator 1997, Aydin kundër Turqisë, GJEDNJ duke interpretuar legjislacionin turk mbi përgjegjësinë e punonjësve të ushtrisë të cilët kishin tortuar dhe përdhunuar një vajzë të komunitetit kurd u shpreh se: "Nga ana tjetër çdo veprim i paligjshëm i cili mund të përbëjë krim ose dëm jashtëkontraktor i cili shkakton dëm moral apo pasuror legjitimon të dëmtuarin për të

*ngritur padi për kompensim në gjykatat civile, karshi dëmtuesit pavarësisht fajit: me dëshirë, me neglizhencë, vetbesim i tepruar etj. Humbjet pasurore dhe jopasurore duhet të dëmshpërblehen sipas neneve 46, 47 të Kodit Civil Turk.*”

### 5.1 Shpërblimi i dëmit pasuror dhe kriteret që merren parasysh

Shpërblimi i dëmit pasuror sipas nenit 640 të Kodit Civil përbëhet nga: 1) humbja e pësuar dhe 2) fitimi i munguar si dhe shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur ose pakësuar dëmin, ato që kanë qenë të nevojshme për të përcaktuar përgjegjësinë dhe masën e dëmit, si dhe shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore.

Shpërblimi i dëmit pasuror nga veprime të administratës paraqitet në ligjin nr. 8510/1999 me:

1. Kthimin e gjëndjes së mëparshme nëpërmjet veprimeve aktive të administratës që realizohet me:

- a) Zhdukjen e shkaqeve që sollën pasoja duke mënjanuar pasojat, nëpërmjet rivendosjes së gjëndjes së mëparshme ose, kur një gjë e tillë është e pamundur, nëpërmjet vendosjes së një gjendjeje të ngjashme.
- b) Dhe/ose kthimin fizik të një sendi apo rivendosjen e një të drejte të pezulluar për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të administratës shtetërore (neni 5)<sup>326</sup>;

2. Shpërblimin monetar ose në të holla. Kjo nënkupton pagimin e një sasive të hollash për të baraspeshuar një dëm, i cili nuk mund të ndreqet në mënyrë të drejtpërdrejtë, (neni 6)<sup>327</sup> Shpërblimi monetar është subsidiar i shërblimit në natyrë të dëmeve pasuror. Kjo do të thotë se kur zhdukja e shkaqeve dhe/ose kthimi i gjëndjes së mëparshme nuk janë të mundur (neni 8) administrata publike mund të kompensoj humbjen, dëmin e shkaktuar me vlerën e konvertuar në të holla.<sup>328</sup> P.sh nëse një shtetas humbet vëndin e punës për shkak se legalizimi i dokumentave nga ana e Ministrisë së Jashtme nuk u krye në kohë, kjo e fundit mund të shpërblej dëmin pasuror dhe moral të shkaktuar qytetarit por nuk garanton se me legalizimin e dokumentave në kohë, do të fillonte punë.

Shërblimi monetar është tipik për 1) dëmet jopasurore (morale dhe dëme të tjera jopasurore) si dhe 2) për raste kur shpërblimi në natyrë është e pamundur, 3) kur gjendja ekzistuese është shkaktuar nga një akt administrativ, i cili është bërë i pakundërshtueshëm për të dëmtuarin. Në rastin e shpërblimit pasuror në të holla, të dëmtuarit i njihet e drejta për të kërkuar fitimin e munguar (neni 10) i cili nënkupton fitimi që mund të nxirrej në kushtet e zakonshme të tregut nga pasuria e humbur a

<sup>326</sup> Neni 5 “Kthimi, në kuptimin e këtij ligji, ka të bëjë me kalimin fizik të një sendi ose me rivendosjen e një të drejte, gëzimi i se cilës ishte pezulluar për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të administratës shtetërore të parashikuara në nenin 3.”

<sup>327</sup> Neni 6 “Shpërblimi qëndron në pagimin e një sasive të hollash për të baraspeshuar një dëm, i cili nuk mund të ndreqet në mënyrë të drejtpërdrejtë”.

<sup>328</sup> Neni 8-Raportet ndërmjet llojeve të dëmshpërblimeve “Në rastin e shkaktimit të dëmit pasuror, organi kompetent i administratës shtetërore vendos të pranojë kërkesën e të dëmtuarit për kompensim në të holla në vënd të zhdukjes së shkaqeve dhe të kthimit, vetëm në rast se kjo zhdukje e shkaqeve dhe kthimi nuk janë të mundur.

Në rastin e shkaktimit të dëmit moral, shpërblimi bëhet në të holla. Dëmi moral konkurron me dëmin pasuror dhe me dëmet e tjera jopasurore”.

pakësuar.<sup>329</sup> Masa e shpërblimit të dëmit pasuror llogaritet nga momenti kur është shkaktuar dëmi deri në ekzekutimin e vendimit nga përmbartuesi gjyqësor.

### 5.1.1 Mënyrat e shpërblimit të dëmit pasuror

Si dëmet pasurore ashtu edhe ato jopasurore udhëhiqen nga disa norma bazë në të cilën gjyqtari duhet ti marrë parasysh në vlersimin e dëmit dhe shpërblimin e tij. Në fakt, matja e dëmit pasuror është shumë e lehtë dhe shpërblimi i tij është matematikor, megjithatë meqenëse dëmi pasuror mund të jetë i ndryshueshëm apo në të mund të ndikojë dhe sjellja e të dëmtuarit, gjykatës i nevojitet mbajtja parasysh e parimeve.

#### 5.1.1.1 Shpërblimi i dëmit jopasuror, në mënyrë fillestare në natyrë

Në organet administrative parimi kryesor është ai i shpërblimit në natyrë. Pra, të kryhet apo të zhduket ai veprim a mosveprim i cili ka sjellë si pasojë dëmin për personat e interesuar. Nëse kjo nuk është e mundur synohet shpërblimi i dëmit me të holla.

Kuptimin e shpërblimit në natyrë e gjejmë tek mënyra e ekzekutimit të detyrimeve, pjesa e përgjithshme e Kodit Civil kur kreditori kërkon ndaj debitorit ekzekutimin në natyrë të detyrimit si dorëzimin e sendit ose kryerjen e punimeve etj.<sup>330</sup>

Siç u cek edhe më lart, legjislatori tek neni 8510/1999 edhe në rend kronologjik të neneve tek Kreu II “Llojet e dëmshpërblimit” prezeanton nenin 5 “Kthimi”, neni 6 “Shpërblimi”, nenin 7 “Zhdukja e shkaqeve që sjellin dëmin”, nenin 8 “Raportet ndërmejt llojeve të dëmshpërblimeve”. Gjithashtu, parashikohet se në rastin e shkaktimit të dëmit pasuror, dëmi në të holla mbetet mundësia e vetme e të dëmtuarit pasi organi administrativ është përpjekur të zhdukë shkaqet e ardhjes së pasojës dhe/ose të kthejë gjëndjen e mëparshme të dëmtuarin.

Për dëmin moral dhe dëme të tjera jopasurore nisur edhe nga natyrë e dëmeve që prekin personalitetin, shëndetin, gjëndjen shpirtërore etj. e vetmja mundësi e zhdëmtimit të individit është ajo në të holla dhe në të tillë rasti, shpërblimi në natyrë është e pamundur të realizohet si p.sh të kthehet humbja e gjymtyrës, të zhduket gjëndja e ankthit, e pagjumësisë, të rikthehet personaliteti i mëparshëm etj.

Në praktikë, ka raste kur paditësit në përgjithësi kërkojnë shpërblimin në të holla edhe pse rikthimi i situatës në të njëjtën gjëndje fizike është i mundur si p.sh ndërtimi i një muri të prishur, i një rrethimi, dhënie e një akti administrativ me informacionin e duhur etj. Në vendimin nr. 125 datë 26 shkurt 2015, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka pranuar padinë e paditësit LL.M ndaj INUK, Bashkia Tiranë duke e konstatuar të pavlefshëm vendimin për prishjen e një muri rrethues me arsyetimin se ndërtimi me mbulëse llamarine, garazhd ishte pa leje ndërtimi.

Kërkesa e dytë në objektin e padisë është që: “*të mënjanoje pasojën nëpërmjet rivendosjes së gjëndjes së mëparshme duke u detyruar të rindërtojë murin rrethues në pjesën e prishur, nga ana veriore e banesës së paditësit Ll.S, me gjatësi 14, 3 m dhe lartësi 1, 8 m*”.

<sup>329</sup> Koncept i marrë nga neni 486 i KC në rast të mospërmbushjes së detyrimit. “Dëmi që duhet të shpërblehet nga debitori për mosekzekutimin e detyrimit përbëhet nga të gjitha humbjet e pësuarat nga pakësimi i pasurisë, si dhe fitimi që mund të nxirret në kushtet e zakonshme të tregut (fitimi i munguar).”

<sup>330</sup> Neni 476 “Çdo mangësi në ekzekutimin e detyrimeve e detyron debitorin të shpërblejë dëmin që ka pësuar kreditori, përveç kur ai provon se mospërmbushja nuk ka ndodhur për fajin e tij. Në këtë rast kreditori ka të drejtë: a) të kërkojë ekzekutimin në natyrë të detyrimit, veçanërisht dorëzimin e sendit ose kryerjen e punimeve, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit; ose b) shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosekzekutimi i detyrimit.”

Dy gjykatat e shkallëve të para e kanë pranuar këtë kërkim ndërsa Gjykata e Lartë e ka ndryshuar duke vendosur: *“Detyrimin e palës së paditur inspektoriat Ndërtimor dhe Urbanistik, Bashkia Tiranë të shpërblejë paditësin LL.S në shumën 288,000 Lekë, për dëmin e shkaktuar nga prishja e murit rrethues të banesës së tij në rrugën "Ali Demi" nr.28, në Tiranë.”*

Gjykata e Lartë, në këtë rast, mospranimin e shpërblimit në natyrë të dëmit e ka arsyetuar: *“se administrata publike mban përgjegjësi ndaj subjekteve private për dëmet që mund t’u shkaktohen atyre nga vendimet, veprimet apo mosveprimet e paligjshme të kësaj administrate, rehabilitimi i këtyre dëmeve kryhet me anë të dëmshpërblimit përkatës, i cili qëndron në pagimin e një sasive parash, që përcaktohet në bazë të kritereve dhe procedurave të parashikuara në ligj....Gjykata mundet të detyrojë organin administrativ, vetëm të kryejë ose moskryerje një apo disa veprime administrative apo të nxjerrë aktin përkatës, por jo të kryejë veprime të tjera që nuk kanë natyrë administrative”*

Ndryshe nga çfarë ka arsyetuar Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mendojmë se parimi kryesor i shpërblimit të dëmit të ardhur është ai i kthimit të palës njësoj sikur dëmi të mos kishte ndodhur, pra në rastin konkret njësoj sikur muri rrethues të mos ishte shembur.

Në Kushtetutë, por edhe në ligjin e posaçëm parashikohet që palët kanë të drejtë të rehabilitohen dhe në rast se kjo nuk është e mundur, kanë të drejtë të shpërblehen në vlerën monetare të tyre. Rezulton se Gjykata e Lartë, ka interpretuar se ndërtimi i një muri apo kryerja e veprimeve rehabilituese del përtej natyrës së saj administrative. Mendojmë se kjo veprimtari është brënda detyrës së saj për të ndrequr dëmin jashtëkontraktor. Jo domosdoshmërisht mund të jetë organi administrativ, i cili do të realizojë veprën në terren por ai mund të kontraktojë persona të tretë për të zbatuar shpërblimin në natyrë të dëmit.

Nëse do të ishte qëllimi i legjislatorit për të përjashtuar OP për të bërë veprime konkrete në natyrë, nuk do e parashikonte llojin në natyrë të shpërblimit por vetëm atë në të holla. Por në fakt, nga dispozitat e nenit 8510/1999 edhe pse pala e paditur është OP (i vetëm apo i bashkëpaditur, persona fizik a juridik privatë) fillimisht njihet shpërblimi i zhdukjes së shkaqeve që sjellin dëmin dhe e kthimin e një sendi apo e një të drejte më pas i rivendosjes së gjëndjes së mëparshme apo i një gjëndje të ngjashme dhe në fund shpërblimi në të holla.

Ndryshe paraqitet situata tek dëmi jopasuror ku shpërblimi është vetëm monetar. Ndërsa për dëmin pasuror sipas nenit 8, rregullon raportet llojeve të shpërblimit ku parashikon se: *“Në rastin e shkaktimit të dëmit pasuror, organi kompetent i administratës shtetërore vendos të pranojë kërkesën e të dëmtuarit për kompensim në të holla në vend të zhdukjes së shkaqeve dhe të kthimit, vetëm në rast se kjo zhdukje e shkaqeve dhe kthimi nuk janë të mundur”.*

Në rastin e mësipërm, vlerësimi nga Gjykata e Lartë e dëmit pasuror vetëm sipas aktit të topografisë passjell një shpërblim jo të plotë të dëmit pasi vlerëson se: *“gjatësia lineare e murit të prishur ka qenë prej 14.3 m dhe lartësia 1.8 m”, vlera e murit rrethues të banesës së prishur është 258 000 lekë plus vlera e derës 30,000 Lekë, (fq. 50-63 e dosjes gjyqësore e shkallës së parë ku ndodhet akti i ekseprimit topografik)”. Kjo detyron paditësin mbi ndërtimin e murit duke gjetur vetë brigadën e puntorëve, pagimin e hakut të punës së tyre, kohën e shpenzuar për të kryer këto veprime etj. ku sipas ligjit nr. 8510/1999, parimeve kushtetuese dhe të Kodit Civil ai duhet të priste që muri të ishte i rregulluar nga organi që e prishi pa të drejtë.*

### 5.1.1.2 Shpërblimi i plotë i dëmit

Shpërblimi i plotë i dëmit është mënyrë klasike si për dëmin kontraktor, deliktor (jashtëkontraktor), pasuror, jo pasuror etj.

Kjo mënyrë synon një barazvlefshmëri mes dëmit dhe shpërblimit. Sipas autores franceze Viney “ *Duhet të paguhet i gjithë dëmi por asgjë më tepër përveç dëmit.*”<sup>331</sup> Pra, të dëmtuarit duhet t’i jepet shpërblimi që synon ta kthejë atë në gjendjen që ai ishte para se të kryhej dëmi, njësoj sikur të mos kishte ndodhur ndonjëherë.

Kjo mënyrë është kryesore në shpërblimin e dëmit pasuror apo jopasuror tek ligji nr. 8510/1999 për dëmin që duhet të shpërblejnë organet e administratës shtetërore. Sipas këtij ligji synohet në fillim mënjanimi i pasojave të ardhura duke u rivendosur gjëndja e mëparshme, nëse kjo nuk është e mjaftueshme personit i jepet një shpërblim në të holla që mat tërësisht dëmin e shkaktuar.

Për efekt të kësaj mënyre janë një sërë aktesh nënligjore, ligjore që kanë parashikuar rastet kur qytetarët kanë pësuar dëme pasurore nga veprimet e padrejta të OAP dhe pa shkuar në konflikt gjyqësor, vetë shteti, organi përkatës shtetëror i administratës ka shpërblyer të dëmtuarit. p.sh VKM nr.527 date 27.11.1997 “*Për dhënien ndihmë falas në interes të familjeve të dëmtuara nga shpërthimi i nje depoje me lëndë plasëse në fshatin Kolsh të Komunës Kolsh në rrethin e Lezhës*“. Në pikën 1 parashikohet se: “*Ndihma të jetë 140 18000 lekë, që perballohen nga fondi rezerve i Keshillit të Ministrave. 2. Vlera prej 140 18 000 lekësh i akordohet këshillit të Rrethit të Lezhës. Masa e përfitimit për çdo familje të dëmtuar të jetë sipas tabelave që i bashkëngjitet ..5. Për familjet banesat e të cilëve kane pësuar dëme të pjesshme mendohet të jepet ndihmë në masën 60% të vlerës së dëmit.*“ Pavarësisht se është trajtuar si një ndihmë falas, për sa kohë që depoja me lëndë plasëse është nën administrimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Këshillit të Ministrave, me iniciativën e saj, OP ka filluar shpërblimin e dëmit pasuror të familjeve të dëmtuar në masë të plotë ose të pjesshme.

VKM nr. 1354, datë 10.10.2008 “Per Përcaktimin e kriterëve per caktimin e vlerës së dëmit të shkaktuar në fondin kullisor” është një tjetër VKM ku masa e shpërblimit të dëmit tek pronari i një fondi kullisor vlen edhe për rastet e dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar nga OP (rast i marrë për analogji). Në pikën 5 të tij parashikohet se:” *Për vlerësimin e dëmit në secilin element përbërës të infrastrukturës së kullotave e livadheve, drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor ose njësia e qeverisjes vendore përcakton:*

- a) objektin konkret të dëmtuar, sipas përcaktimeve të pikës 6 të këtij vendimi;
- b) shkallën e dëmtimit të objektit;
- c) koston financiare të objektit të dëmtuar;
- ç) shpenzimet, që nevojiten për ta riparuar e rikthyer në gjendjen e mëparshme.”

Në çështjen me nr. 212 vendimi, datë 10 shkurt 2012 të Gjykatës Administrative të Apelit, shtetasi I.V, pronar i 27 dy kullotë, paditi Bordin e Kullimit Gjirokastër për shkatërrimin tërësisht të pronës së tij për shkak të rregullimit të Argjinaturës së Lumit Drino. Baza ligjore ku referohej paditësi është neni 608 i KC dhe VKM me nr. 1354/2008 e sipërcituar dhe bazuar në këtë akt nënligjor GJASH i-rë Gjirokastër ka llogaritur edhe dëmin e shkaktuar paditësit 1000 lekë/m<sup>2</sup>.

Në fakt, parimin e shpërblimit në natyrë e hasim edhe tek pika 6 e kësaj VKM ku parashikohet se :”6. *Dëmtuesi i objekteve infrastrukturore të kullotëse: (rrugë, ura,*

<sup>331</sup> Geneviève VINEY ” Les obligations, La responsabilité : effets” L.G.J.D 1988 faqja 80.



tombino, prita malore, lera, çezma, korita, kanale, shenja kufi dëftuese, tabela, rrethime me tel e drurë, ngrehina etj.) në marrëveshje, me shkrim, me drejtorinë përkatëse të shërbimit pyjor, merr përsipër ta riparojë vetë dëmin, deri në kthimin e situatës në gjendjen e mëparshme....

7. Në rast se riparimi nuk është kryer sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje, dëmtuesi detyrohet të shpërblejë vlerën e dëmit.“

GjedNJ në matjen e dëmit jopasuror të pretenduar nga palët zakonisht ka një tjetër qasje, atë të parimit të drejtësisë dhe analogjisë. Në çështjen Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar në vendimin e 13 mars 2012 gjykata duke vlerësuar pretendimin e prindërve të viktimës i cili u vra nga shoku i dhomës në Spitalin e të Sëmurëve Psïqik kërkuan shpërblim për ankthin, depresioni, dhimbjen për humbjen e djalit si dhe stresin e vazhdueshëm, gjëndjen shëndetësore që po vuajnë si rezultat i humbjes traumatike dhe friksimin se nuk do të trajtohen drejtësisht. Këtë pretendim gjykata e pranoi dhe bazuar në analogjinë me çështje të ngjashme akordoi shumën prej 20,000 £ për dëm jopasuror.<sup>332</sup>

### 5.1.1.3 Ndryshueshmëria e shpërblimit të dëmit

Shpërblimi i dëmit pasuror në pamje të parë duket si i pandryshueshëm pasi i dëmtuari shpërblehet për aq sa humbi objektivisht pasurinë e tij në momentin e dëmit. Megjithatë në rastin e dëmit pasuror shëndetësor sipas nenit 642 të KC<sup>333</sup>, njihet si një shpërblim i ndryshueshëm dhe jo fiks në varësi të përmisimit apo përkeqësimit në të ardhmen të shëndetit, apo shtimin apo pakësimit e aftësisë për punë të të dëmtuarit. Dëmi pasuror shëndetësor është humbja në të ardhura mujore ose vjetore që pëson i dëmtuari direkt ose indirekt nga dëmi i ndodhur. Ky lloj dëmi pasuror për shkak të humbjes së aftësisë për punë duhet dalluar nga dëmi biologjik që kanë elaboruar Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 12/2007.

E njëjta gjë ndodh edhe kur i dëmtuari është një person nën moshën 14 vjeç, i cili me mbushjen e moshës 16 vjeç mund të kërkojë shpërblim sipas pagës që ai merrte nëse punonte në rast të kundërt pagën mesatare që merr punonjësi i së njëjtës kategori kualifikimi me të cilin i barazohet puna (neni 646 i KC). Me mbushjen e moshës 18 vjeç ka të drejtë të kërkojë rritjen e shpërblimit me pagë mesatare të një punonjësi të kategorisë me të cilën mund të barazohet edhe puna që kryente ose mund të kryente i dëmtuari në këtë moshë dhe në këtë kualifikim (neni 647 të KC).<sup>334</sup>

### 5.1.1.4 Mënyra e copëzimit të shpërblimit (pagesa me këste)

Kjo mënyrë i lë hapsirë gjyqtarit që shpërblimin për dëmin pasuror, të vendosë që i dëmtuari ta jap në tërësi ose edhe të copëzuar me këste mujore. Kjo në varësi të llojit të dëmit pasuror p.sh në rast se ai vjen si rezultat i një humbje të një pasurie fikse,

<sup>332</sup> §106 i çështjes nr. 46477/99 datë 15 mars 2002, Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar

<sup>333</sup> Neni 642 “Masa e shpërblimit të dëmit mund të ndryshojë në të ardhmen, në varësi të përmirësimit apo rëndimit të shëndetit ose të shtimit apo pakësimit të aftësisë për punë të të dëmtuarit, në krahasim”

<sup>334</sup> Neni 467 “I mituri i dëmtuar, kur mbush moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk ka pagë nga puna e tij, ka të drejtë që në vend të shpërblimit që merr për jetesë, të kërkojë të shpërblehet për humbjen e aftësisë së tij për punë me pagën mesatare të një punonjësi, sipas kriterëve të nenit 646 të këtij Kodi.Me mbushjen e moshës tetëmbëdhjetë vjeç ka të drejtë që në vend të shpërblimit që merr, të kërkojë të shpërblehet me pagën mesatare të një punëtori të asaj kategorie që do të kishte fituar ose duhej të kishte fituar po të mos ishte shkaktuar dëmtimi i shëndetit.”

ekzistuese të të dëmtuarit zakonisht kjo masë vendoset në një këst. Në rast se humbja e pasurisë vjen si rezultat i mospërfitimit të pagave mujore për shkak të paaftësisë në shëndet dhe pamundësisë për të punuar, masa e shpërblimit do të jetë me këste për të sjellë tek i dëmtuari të njëjtën situatë sikur dëmi të mos ketë ndodhur. Pra shpërblimi do të jepet njësoj si paga mujore që merrte i dëmtuari më përpara dhe tashme nuk e merr për shkak të dëmit të ndodhur.

Ky parim shprehet qartë në nenin 643 të KC kur parashikohet shpërblimi i dëmit pasuror tek familja e të dëmtuarit, si rezultat i vdekjes së tij si:

-shpenzimet për ushqim e jetesë të fëmijëve të tij të mitur, të bashkëshortes dhe prindërve të paaftë për punë që kanë qenë në ngarkim të të vdekurit, plotësisht ose pjesërisht, si dhe të personave që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit;

- shpenzimet e duhura për varrimin e të vdekurit, në masën që ato i përgjigjen rrethanave personale e familjare të të vdekurit.

Parashikohet po në këtë nen se gjykata, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, mund të vendosë që shpërblimi të jepet në natyrë, ose në para, njëherësh ose me këste. Në këtë rast shpërblimi i dëmit pasuror paraqitet si një rentë jetore mujore.<sup>335</sup> Megjithatë këto janë dy koncepte të ndryshme. Renta jetore është një kontratë e cila nënkupton dhënien e çmimit të një sendi të shitur, të dhuruar a të lënë me testament në formën e kësteve mujore a vjetore në mënyrë të përkohshme a të përhershme. Kriteret e përcaktimit që do merren parasysh në përcaktimin e shumës mujore a vjetore që do paguhet mund të trajtohen edhe bazuar tek kriteret e përcaktimit të masës së rentës mujore. Kjo lloj analogjie është trajtuar në veçanti nga ana jonë.<sup>336</sup>

Gjyqtare Mataj mbi rentën jetore lidhur me kriteret e përcaktimit të masës së rentës jetore shprehet se *“nëse renta jetore është formuar në bazë të një kontrate shitjeje masa e saj në total nuk duhet të kaloj çmimin e objektit të shitjes. Po ashtu nëse është shumë e kapitalizuar për shkak të një dëmi jashtëkontraktor a kontraktor, debi-rentieri duhet t’i paguaj kredi-rentierit një masë rente jetore që në total nuk duhet të kaloj këtë masë dëmshpërblimi.”* Po ashtu si kritere të tjera të masës së rentës janë edhe mosha e përfituesit, indeksimi etj.<sup>337</sup>

## 5.2 Mënyrat e shpërblimit të dëmit jopasuror dhe kriteret që merren parasysh

Përkufizimin e dëmit jopasuror dhe konfigurimi i tyre jepet nga neni 625 i Kodit Civil<sup>338</sup> dhe neni 12 i ligjit nr. 8510/1999<sup>339</sup> ku në përmbledhje të të dyve mund të

<sup>335</sup> Neni 1065” Renta jetore mund të krijohet kundrejt shpërblimit (me titull barrësor) nëpërmjet tjetërsimit të një pasurie të luajtshme ose të paluajtshme ose të një shume parash.

Renta jetore mund të krijohet edhe me anë dhurimi ose me testament, duke respektuar kërkesat e ligjit për veprime juridike të tilla.”

<sup>336</sup> Rezarta Mataj “Mbi kontratën e rentës jetore”, Shkolla e Magjistraturës, Revista “Jeta Juridike nr.1” Tiranë (2011), faqe 53.

<sup>337</sup> Po aty.

<sup>338</sup> Neni 625- Përgjegjësia për dëmin jopasuror “Personi që pëson një dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet kur:a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij;

b) është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij;

c) është cenuar e drejta e emrit;

ç) është cenuar respektimi i jetës private;

d) është cenuar kujtimi i një të vdekuri. Në këtë rast bashkëshorti i personit të vdekur ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror.”

<sup>339</sup> Neni 12-Demet jopasurore “1. Në rastet kur dëmi ka të bëjë me cënimin e paprekshmërisë trupore, të shëndetit, të lirisë ose të personalitetit, shpërblimi bëhet në të holla, duke mbajtur gjithnjë parasysh rolin

konludojmë se dëmi jopasuror është çënimi i paprekshmërisë së integritetit psiko-fizik të njeriut (pra nënkupto trupit dhe shëndetit), të lirisë peronale, dinjiteti i njeriut, emri i mirë (reputacioni), personaliteti i çdo personi, i të drejtës për të gëzuar jetën private dhe për të mos e prishur atë.<sup>340</sup> Pra dëm jopasuror është çdo lloj dëmi i cili shkakton tek personi transformim negativ për të mos jetuar natyrshëm.

Në rastin e shpërblimit të dëmit jopasuror ka pasur kritika nëse mund të arrihet të “mbushet” shpirtërisht një person i cili ka pësuar humbje morale, shpirtërore për dëmin që një organ administrative mund t’i shkaktoj të dëmtuarit. Për shëmbull Pacchioni (1922) shprehet se “*Është e qartë që asnjë formë dëmshpërblimi nuk mund të eliminoj vuajtjen apo ta vëndosësh qetësinë që i dëmtuari kishte më përpara*”.<sup>341</sup>

Teorikisht ka mbizotëruar teoria e mundësisë së shpërblimit të këtij dëmi. Kështu prof. Mehdi Hetemi shprehet se: “*fakti që dëmi moral nuk ka një vlerë pasurore nuk do të thotë që nuk do të dëmshpërblëhet me një kompensim pasuror. Megjithëse nuk ka funksion dëm shpërblyes në kuptimin e ngushtë, duhet zbutur vuajtja e provokuar nga një fakt i paligjshëm nëpërmjet kënaqësisë që paraja mund ti ofroj atij që e merr. Shpërblimi i dëmit nuk është e domosdoshme të bëhet në të gjitha rastet sipas kritereve ekonomike por bëhet edhe sipas kritereve të drejtëshmërisë.*”<sup>342</sup> Ndërsa autori Italian Mantelet (1907) shprehet se: “*E drejta që mbron pasurine tonë ekonomike duhet të mbrojë edhe pasurinë tonë morale e në vecanti dëmshpërblim i dëmit moral i përgjigjet mbrojtjes së personalitetit njëzëz.*”<sup>343</sup>

### 5.2.1 Parimi i shpërblimit të plotë (restitutio in integrum)

Në shtete të ndryshme mënyra e trajtimit të dëmit jopasuror është e ndryshme prandaj janë krijuar një sërë teorish që merren në momentin e matjes dhe shpërblimit të dëmit jopasuror. Duke qënë se është një dëm tepër subjektiv këto teori ndihmojnë gjykatën në përcaktimin e një vlerë që do të kënaqë realisht palën dëmtuese për një shpërblim i drejtë.

Në rastin e një dëmi jopasuror siç e cekëm dhe më lart, shpërblimi monetar është i vetëm pasi nga vetë natyra e tij është e pamundur të merret gjëndja shpirtërore e të vihet në vend si përpara dëmit, apo personaliteti i të dëmtuarit, reputacioni i personit juridik etj. Në këto kushte e vetmja mënyrë është shpërblimi monetar për ti dhënë mundësi të dëmtuarit që të shpërfaqet në një formë tjetër apo të ndërtojë një reputacion të rij, një emër më të mire etj. Nëpërmjet këtij parimi synohet që të dëmtuarit t’i jepet aq sa i takon dhe asgjë më tepër, duke mos kaluar në teprime dhe në pasurime të padrejta të viktimës. Dhënia e një shpërblimi më tepër sesa i takon të dëmtuarit do të sillte tregëtimin e këtyre vlerave jopasurore të njeriut, por edhe një shumë më e vogël nuk do të përmbushte funksionin kompensues dhe riparues të situatës.<sup>344</sup>

*e të dëmtuarit në shkaktimin e dëmit, sipas nenit 11. ...*

<sup>340</sup> Dëmtim i gjëndjes shpirtërore aktuale dhe të reflektuar në të ardhmen duke humbur motivin për jetën, për ta gëzuar atë, për të shijuar kënaqësitë e jetës etj.

<sup>341</sup> Giuseppe CRICENTI “Il danno non patrimoniale” Seconda edizione CEDAM 2006 faqja 14

<sup>342</sup> Prof.Dr.Mehdi J.HETEMI “Detyrimet dhe kontratat”Shtëpia botuese ‘Luarasi’Tiranë 1998 faqja 16

<sup>343</sup> Marrë nga Giuseppe CRICENTI “Il danno non patrimoniale” Seconda edizione CEDAM 2006 faqja 17

<sup>344</sup> Mataj R. Aspekte teorike dhe praktike mbi dëmin jopasuror dhe shpërblimin e tij në Republikën e Shqipërisë” Shkolla e Magjistraturës, Temë dipolome Tiranë. (2007) faqe 71.

## 5.2.2 Shpërblimi i drejtë

Matja e dëmit jopasuror dhe shpërblimi i tij nuk ka vlera të sakta dhe risku për të pasur “firo” edhe mund të ekzistojë për të dëmtuarin. Në mënyrë që të eliminohen maksimalisht (pasi për një shpërblim njëqind për qind të drejtë do të ishte utopi të pretendohet) pakënaqësi të tilla apo edhe pretendime të të paditurit, se i dëmtuari është pasuruar, synon që gjykata të caktojë një shpërblim të drejtë, aq sa edhe një qytetar i thjeshtë ta vlerësoj si të tillë. Parimi i shpërblimit të drejtë është trajtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese e RSH në vendimin nr. 34 datë 20.12.2005, GJK ka vlerësuar si antikushtetues nenin 1 të ligjit nr.9260 datë 15.07.2004 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”. Në pjesën arsyetuese të vendimit, GJK pranon se “*Shteti demokratik i dëmshpërblen e kompenson këta persona sipas kushteve e mundësive ekonomike e financiare, duke u bazuar kryesisht në parimet e rëndësishme të drejtësisë dhe të barazisë*”

Për përcaktuar shpërblimin sa më të drejtë tek dëmi pasuror, gjykata i referohet humbjeve, fitimeve të munguara dhe shpenzimeve të tjera të bëra.<sup>345</sup> Në rastin e shpërblimit të dëmit jopasuror gjykata mund të përdor edhe praktikën gjyqësore dhe të qenit sa më i drejtë dhe objektiv mbi rastin.

Ky lloj parimi mesë shumti haset tek shtetet që bazohen tek Common Laë dhe tek Equity si Britania e Madhe, SHBA etj. Kështu gjyqtari<sup>346</sup> në dhënien e shpërblimit për dëmin jopasuror bazohet në tre parime bazë atë të aksesibilitetit, të uniformitetit (duke u bazuar në çështje të tjera të ngjashme) dhe parashikueshmërisë (të dhënit një shpërblim masa e së cilit parashikohej nga gjithë).

Këtë parim e ka përqafuar edhe Italia e cila ka nxjerrë tabelat e Gjykatës së Milanos që sot janë të zbatueshme në tërë Republikën duke lënë pas tabelat e Gjykatës të Romës. Këto tabela kanë qënë konkurrenca të kahershme që zbatoheshin nga disa gjykata. Sipas vendimit të Gjykatës së Kasacionit nr. 12408 datë 07.06.2011. Duke pasur një kriter vlerësimi në të gjithë Italinë, pra tabelat milaneze, eliminohet mënyra e llogaritjes së dëmit jopasuror më e ulët në ato vende që nuk kanë standardin e jetesës si në Milano dhe anasjelltas. Po ashtu eliminohet edhe praktika “forum shopping” ku palët zgjedhin mes gjykatave kompetente, gjykatën e cila është më “bujare” në masën e shpërblimit.

Edhe në Francë me daljen e ligjit nr.26 të datës 5 korrik 2011, Gjykatat detyrohen të botojnë periodikisht tabelat e masave të shpërblimit të aplikuara për të gjitha llojet e dëmeve, në mënyrë që nga gjykatat të bëhet edhe një unifikim në marzhet minimale dhe maksimale ku të bazohen në dhënien e vendimit.<sup>347</sup>

Me vendimin nr. 12/2007 të KB të GJL edhe në Shqipëri është përkrahur kjo praktikë, për të përmbushur edhe parimin tjetër të shpërblimit e plotë të dëmit jopasuror të pësuar. KB kanë vendosur marzhe minimale dhe maksimale për dëmin jopasuror ekzistencia dhe moral ku nuk mund të kalojnë të dyja në total më tepër se  $\frac{1}{4}$  deri në  $\frac{1}{2}$  e dëmit biologjik të matur objektiviht nga mjeku/psikatro ligjor dhe vlerësuesi i dëmeve shëndetësore. Madje ky Kolegj citon se Gjykatat në matjen e dëmit moral :”*e cakton atë mbeshtetur në parimin e dhenies së drejtësisë sipas bindjes se saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tëresinë e tyre, duke u mbeshtetur edhe në kritere eventuale normative të zbatueshme sipas natyres së të drejtës së cenuar ose, në mungesë të tyre, në kritere dhe elemente vlerësimi të konsoliduar nga praktika gjyqësore në zgjidhjen e çështjeve analoge ose në pervoja*

<sup>345</sup> Shih nenin 640 e më tej të të Kodit Civil

<sup>346</sup> John Munkaman “Damages for personal injuries and death” tenth edition Butterworths.

<sup>347</sup> Geneviève Viney “Les obligations, La responsabilité : effets” L.G.J.D 1988 faqe 207.

*përkatese jashtegjyqesore, duke patur gjithnje parasysh zhvillimin aktual ekonomik e social te vendit, perfshire vleren e parase ne ekonomine kombetare”.*

Këtë mendim kemi dhënë që në qershor 2007, pa dalë akoma vendimi unifikues ku kemi sugjeruar se:”... edhe për gjyqtarin shqiptarë do të ishte mjaft lehtësuese që të ekzistonin tabela statistikash mbi marzhet e shpërblimit që mund të jepen për lloje të ndryshme të dëmeve jopasurore aq më tepër që në praktikën shqiptare gjyqësore janë hasur jo vetëm vlera jo të drejta shpërblimesh, por shpesh edhe abuzive...në mënyrë që çdo qytetarë ta kuptojë dhe ta parashikojë masën e shpërblimit që mund të japë gjykata në këtë çështje duke shmangur abuzimet dhe çdo hipotezim të padrjetë”.<sup>348</sup>

### 5.2.3 Shpërblimi në mënyrë unike

Parimi i shpërblimit unik ose me një këst (prestim) është e kundërta e parimit të shpërblimit me këste. Në përgjithësi ky parim vlen për dëmet jopasurore ku të arrihet të përcaktohet përfundimisht masa e dëmit moral, ekzistencial apo biologjik që ka pësuar i dëmtuari direkt apo indirekt kur ka ndodhur fakti i paligjshëm dhe maksimalisht kur bëhet matja nga ekspertet gjyqësorë. Ndërsa masa e dëmit nga ky moment deri në ekzekutimin e vendimit kur merr formë të prerë llogaritet për çdo ditë vonesë.

Shpërblimi për dëmin moral është masa që i paguhet të dëmtuarit për turbullimet e përkohshme shpirtërore të ndodhura.<sup>349</sup> Nisur nga fakti se dhimbja, stresi, pagjumësi etj. janë të përkohshme (e kundërta, do trajtohej si patologji psiçike) bën më të qartë kornizën e llogaritjes matematikore të shpërblimit të një dëmi të përfunduar në të kaluarën. Po ashtu edhe për dëmin ekzistencial i cili konsiderohet si dëmi në pamundësinë e të dëmtuarit për t’u ushtruar hobe, kënaqësi jete, socializim që bënte dhe nuk i realizon më pas vdekjes.<sup>350</sup> Dëmi biologjik si një formë e tretë e dëmit jopasuror ka të bëjë me shëndetin, gjëndjen e mirë të individit, integritetin psiko-fizik të tij duhet dalluar nga dëmi pasuror shëndetësor, i cili përbën humbjen e të ardhurave për shkak të pamundësisë për të punuar. Edhe në këtë rast, shpërblimi i këtij dëmi duke qënë se ai matet saktë nga ekspert-mjeko ose psikiatro-ligjor për aq sa është humbur në tërësinë (100%) të trupit të shëndoshë të njeriut.

Pra, vihet re se dëmet në sferën afektive, sociale, në tërësinë e integritet psiko – fizik<sup>351</sup> janë ato që lidhen me të kaluarën e personit përpara se të ndodhte dëmi dhe në momentin e dëmit dhe nuk ka shkaqe të tjera të së ardhmes që mund të ndryshojnë kriterin vlerësues. Parimi i shpërblimit unik është i duhuri. Po ashtu edhe praktika gjyqësore në Shqipëri është konsoliduar duke dhënë shpërblime fikse, me një shumë të vetme për çdo zë të dëmeve jopasurore dhe nuk ka asnjë rast kur shpërblimi të jetë dhënë me këste.

Kjo logjikë është mëse e pranuar pasi për sa kohë që personi pretendon për një dëm të së shkuarës, në personalitet apo në nder etj. shpërblimi më i mirë do të ishte i shuma e plotë dhe e menjëhershme pasi i cënuari nuk pretendon që reputacioni i tij të vazhdojë e të jetë i cënuar edhe në të ardhmen apo krahu i prerë a verbëria të rikthehet. Nëpërmjet kësaj padie realizohet mëse miri funksioni kompensues i shpërblimit të menjëhershëm synuar që ky nder i cënuar ti vihet në vënd sa më shpejtë dhe të rikthehet në gjëndjen e mëparshme për aq sa është e mundur. Gjykata duke u marrë parasysh

<sup>348</sup> Rezarta Mataj, “Aspekte teorike dhe praktike mbi dëmin jopasuror dhe shpërblimin e tij në Republikën e Shqipërisë”. Shkolla e Magjistraturës, Temë dipolome Tiranë. (2007) faqe 71.

<sup>349</sup> Shih më tej konceptin i definuar nga KB të GJL me vendimin nr. 12/2007, faqe 18.

<sup>350</sup> Koncepti i definuar nga KB të GJL me vendimin nr. 12/2007, faqe 19.

<sup>351</sup> Dëmi biologjik edhe ky koncept përcaktohet nga KB të GJL me vendimin nr. 12/2007, faqe 16.

gjithë kriteret e mundëshme synon që shpërblimi të jetë përfundimtar, pra të vlerësohet një herë dhe përgjithmonë dhe çdo padie për të njëjtin fakt të paligjshëm do të përbëjë gjë të gjykuar.

#### 5.2.4 Mënyra e shpërblimit simbolik ose deklarues

Ky lloj shpërblimi është e kundërta e shpërblimit të plotë. Në këtë lloj dëmi kërkuesi me kërkesë të tij, shpërblehet në mënyrë simbolike me një shumë prej një Lek ose një Euro e deri në 100 euro etj. kur në fakt masa e dëmit që provohet e shkaktuar është shumë më e madhe.

Ky lloj shpërblimi përdoret zakonisht tek dëmet jopasurore ku paditësi pretendon se humbja e pësuar zëvendësohet vetëm nëse gjykata jep një shumë simbolike dhe deklaron se ka pasur shkelje të së drejtës nga ana e shtetit. P.sh në rastin *Camenzind kundër Switserland*<sup>352</sup> paditësi për një kontroll të padrejtë banesë të oficerëve të Zyrës së Postës dhe Telekomunikacionit, i kërkoi Gjykatës një shumë simbolike prej 100 Franga Zvicerane për shkelje të KEDNJ, nenit 8 “Jeta Private” dhe nenit 13 “Mjet ankimi efektiv”. Gjykata vlerësoi se konstatimi se ka shkelje të kësaj Konvente është mëse i mjaftueshëm si një shpërblim i drejtë.

Këtë lloj mënyre të shpërblimit, vetëm me deklarimin e shkeljes së të drejtës nuk është e parashikuar në KPRA, në ligjin nr. 49/2012 apo në ligjin nr. 8510/1999 megjithatë gjykatat administrative për analogji munde të përdorin nenin 30 të KPRC.

Ky nen njuh publikimin e vendimit përfundimtar si formë e rehabilitimit moral të të dëmtuarit, pra *“Kur çmohet se publikimi i vendimit përfundimtar i shërben riparimit të dëmit, gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, urdhëron botimin e vendimit në një ose disa gazeta të caktuara.*

*Kur njoftimi nuk jepet në afatin e caktuar nga gjykata, pala, në favorin e së cilës është dhënë vendimi, ka të drejtë të kërkojë botimin, me shpenzimet e personit që detyrohet.”*

Mendojmë se publikimi i vendimit të formës së prerë në një media të shkruar gazetë kombëtare, lokale për disa ditë rrjesht apo edhe në media vizive është një formë e njohjes së publikut me faktin se organi shtetëror a shteti është gjetur në faj e në kundërligjshmëri.

Në të njëjtin parashikim ka edhe KPRP ku në nenin 399 -“Publikimi i vendimit për të riparuar dëmin jopasuror” parashikohet: “1. Me kërkesën e paditësit civil, gjykata urdhëron publikimin e vendimit të dënimit, si mënyrë e riparimit të dëmit jopasuror të rrjedhur nga vepra penale.

2. Publikimi i vendimit bëhet i plotë ose me shkurtime, në gazetata e treguara nga gjykata, me shpenzimet e të pandehurit dhe të paditurit civil.

3. Në qoftë se publikimi nuk bëhet në afatin e caktuar, paditësi civil mund të veprojë vetë me të drejtën për të kërkuar shpenzimet nga i dënuari”.

Mendojmë se ligji nr. 49/2012 “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative” në nenin 41§1, “f” parashikon se shpërblimi i dëmit nga ana e administratës shtetërore bëhet sipas ligjit. Kjo referencë nënkupton tek ligji nr. 8510/1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”. Mënyra që parashikon ky ligj është ajo e shpërblimit në natyrë duke kthyer situatën e paligjshmërisë aty ku ka qënë më parë, e nëse kjo nuk është e mundur të zëvendësohet me shpërblim monetar. Mënyrat e shpërblimit janë shteruese në ligjin e posaçëm. Sa më sipër konkludojmë se në gjykimet administrative për të tillë çështjesh as palët dhe as gjykata nuk mund të vendos si

<sup>352</sup> Çështja me nr. 136/1996/755/954 datë 16 dhjetor 1997§59,60.

mënyrë shpërblimi të dëmit jopasuror botimin e vendimit në një gazetë/media kombëtare, lokale etj.

Mendoj se duhet bëhen ndryshime në ligjin nr. 8510/1999 mbi këtë mënyrë shpërblimi. Për sa kohë si një mënyrë shpërblimi është edhe botimi i vendimit në gazetë duhet të parashikohet specifikisht në ligj apo të bëhet referenca tek KPRC në rastet e dëmeve jopasurore të shkaktuar nga organet publik. Kështu gjykatat për analogji mund të vendosin botimin e vendimit kur gjejnë një organ administrativ në shkelje të veprimtarisë së tyre por që kanë sjell dëm personit.

Në të dy Kodet e procedurave si ai penal dhe civil, gjykata nuk mund ta vendos këtë lloj dëmshpërblimi *ex officio*, por vetëm me kërkesë të paditësit, i cili më mirë se kushdo di se me çfarë mënyrë shpërblimi mund të kompensohet makismalisht, pra vetëm ai ka të drejtë të kërkojë publikimin e vendimit gjyqësor si një formë e shpërblimit të dëmit të tij jopasuror.

### 5.3 Kriteret që merren parasysh në shpërblimin e dëmit jopasuror

Kriteret që duhen zbatuar në shpërblimin e dëmit jopasuror të shkaktuar nga organet e administratës publike janë të njëjtat me ato që parashikon Kodi Civil dhe interpretimet e Gjykatës së Lartë etj. mbi normat e këtij Kodi. Këtë referim e lejon vetë ligji nr. 8510/1999 i cili parashikon në nenin 1 të tij se përgjegjësia jashtëkontraktore do rregullohet me normat e këtij ligji dhe ato të bazuar në Kodin Civil.

Në fakt edhe pse ka hyrë në fuqi që në vitin 1999, ky ligj ishte i pari që parashikoi dëmin moral si një lloj të dëmit jopasuror si dhe njohu mundësinë që qytetarët nga veprimet e padrejta të OP mund të pësojnë dëme pasurore dhe dëme të tjera jopasurore.<sup>353</sup> Kriteret që merren parasysh tek dëmi pasuror janë matematikore, objektive dhe prandaj nuk është moment që ia vlen të ndalet.

Ndërsa dëmi jopasuror meqënëse është një dëm me karakter subjektiv dhe i matshëm vetëm në mënyrë abstrakte për të qënë më rigoroz dhe për të përmbushur një parim, atë të shpërblimit të plotë dhe të drejtë të të dëmtuarit, legjislatori ka marrë parasysh dhe e ka normëzuar në nenin 476/a me ndryshimet dhe shtesat që iu bëne Kodit Civil me ligjin nr. 17/2012, pas daljes së vendimit unifikues të KB të GJL.

Kriteret që merren parasysh janë ato të përcaktuara si në vendimin unifikues të KB të GJL ashtu edhe ato të përcaktuar në nenin 746/a të KC.

Për rastin e dëmit jopasuror, për cenimin e nderit, personalitetit ose reputacionit të personit merret parasysh:

- Proporcioni mes të drejtës së shkelur dhe dëmit të pësuar. Kjo nënkupton se dëmet të cilat nuk kanë cënuar ndonjë të drejtë thelbësore, kushtetuese etj. nuk mund të shpërblehen. Po ashtu sa më e rëndësishme të jetë e drejta dhe liria e shkelur aq më i madh është edhe shpërblimi i dhënë. Gjykata Italiane e Kasacionit nëpërmjet parimit të proporcionit përjashtoi nga shpërblimi ato të drejta të cilët nuk janë të mbrojtur në Kushtetutë apo nuk kanë ndonjë rëndësi.<sup>354</sup>
- Rrethanat e çështjes. Gjyqtari civil, ashtu si gjyqtari penal i cili synon në individualizimin e masës së dënimit, synon gjetjen e një shpërblimi që përputhet me dëmin e shkaktuar. Personi i dëmtuar as nuk duhet të varfërohet dhe as të pasurohet nga shpërblimi përkatës. KB të GJL në vendimin nr. 12/2007 janë shprehur se për dëmet jopasurore të karakterit subjektiv si ai moral, ekzistencial etj. gjykata përveç marzheve të saj duhet të marr parasysh dhe: “*rrethana konkrete të*

<sup>353</sup> Neni 8§ fundit “*Demi moral konkurron me demin pasuror dhe me demet e tjera jopasurore.*”

<sup>354</sup> Vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkura nr. 26972 datë 11.11.2008.

çështjes për të çmuar së pari shkallen efektive të dhimbjes e vuajtjes shpirtërore të shkaktuar dhe, në lidhje me të, natyrën e faktit të paligjshëm apo rrezikshmerine e saj nëse përbën veper penale, shkallën e fajësisë dhe në tëresi mënyrën e sjelljes së shkaktuesit të dëmit në raport me ngjarjen dhe personat e cënuar, natyrën e së drejtës së cënuar dhe të pasojave të shkaktuara nga fakti i paligjshëm, kushtet subjektive të të dëmtuarit si moshë dhe shkalla individuale e ndjeshmerisë ndaj cenimit të pësuar, si dhe rrethanat që lidhen me kushtet sociale dhe ekonomike të të dëmtuarit”. Po ashtu mund të merren parasysh nga praktikatat gjyqësore për raste të ngjashme, luhatje e monedhës ndër vite, niveli kombëtare i ekonomisë etj.

- Për përcaktimin e përgjegjësisë civile dhe masës së dëmit jopasuror për shpifje, fyerje etj. gjykata mban parasysh edhe rastet e cituar specifikisht në nenin 647/a të KC pra:
  - a) Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve;
  - b) Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve;
  - c) Format dhe shkallën e fajësisë;
  - ç) Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë;
  - d) faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit;
  - dh) Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik;
  - e) Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme;
  - ë) Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje;
  - f) Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar;
  - g) Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi;
  - gj) Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit.

#### 5.4 Shpërblimi i dëmit sipas jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut (nenet 13 dhe 41)

Konventa e Këshillit të Europës ka hyrë në fuqi në vitin 1953. Referuar nenit 122 të Kushtetutës është pjesë e padiskutueshme e legjislacionit tonë të brëndëshme që me ratifikimin e saj me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.

Të drejtat dhe liritë e garantuar në këtë Konventë (më tej Konventa, KEDNJ), sipas nenit 17 të Kushtetutës nuk duhet të kufizohen më tej parashikimeve të saj për asnjë lloj arsye.

Republika e Shqipërisë njeh juridiksionin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (më tej GJEDNJ) mbi interpretimin dhe zbatimin e Konventës bazuar tek parimi i reciprocitetit.

Dy janë nenet që kanë qasje me të drejtën e individit për të gjetur një rrugë efektive në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive që parashikon KEDNJ dhe më pas për tu shpërblyer plotësisht, nenet 13 “E drejta për zgjidhje efektive” dhe neni 41 “E drejta për një shpërblim të drejtë”.



Neni 13 parashikon se “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive (an effective remedy) para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

Po ashtu neni 41 parashikon se “Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar”.

Edhe në nenin 5§5 “E drejta per liri dhe siguri”, parashikon të drejtën për të kërkuar shpërblimi për heqje në mënyrë të padrejtë të lirisë personale “5. Çdo person, që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, ka të drejtën e një dëmshpërblimi.”

Kuptimin e nenit 13 të Konventës e jep jurisprudenca tepër dinamike (case-law) e GjEDNJ tek çështja nr. 30240/96 datë vendimi 2 Maj 1997, *D. kundër Mbretërisë së Bashkuar* “69. Gjykata vëren se neni 13 i Konventës (art. 13) garanton mundësinë e shteteve për të pasur një mjet efektiv të brendshëm për të zbatuar thelbin e të drejtave dhe lirive të Konventës në çfarëdo forme që mund të ndodhë shkelja. Efekti i këtij neni (art. 13) është pra të kërkojë sigurimin e një mjete të brendshëm që lejon autoritetin kompetent kombëtar si për t'u marrë me thelbin e ankesës përkatëse për shkelje të të drejtave të Konventës por dhe të dhe të garantoj një shpërblim të duhur pavarësisht se shtetet mund të kenë diskrecioin që të përshtatin detyrimet e tyre sipas nenit 13 të Konventës.”. Gjykata ka vlerësuar se kërkesat e tij janë më të ngushta dhe përthithen nga kriteret e nenit 6§1 për të drejtën për akses në gjykatë, prandaj kur GjEDNJ konstaton shkelje të aksesit në drejtësi ka nënkuptuar në shumë raste edhe shkelje të nenit 13 të Konventës.<sup>355</sup>

Ajo çfarë ka vlerë për këtë studim është se edhe vetë Koventa njih parimet që udhëheqin në përgjithësi, përgjegjësinë jashtëkontraktore të administراتës publike:

- Për çdo veprim/mosveprim të drejtë a të padrejtë të shkaktuar nga individët apo nga vetë personat që ushtrojnë detyra publike, i dëmtuari duhet të dëgjohet dhe ka të drejtë të gjej një zgjidhje përpara organeve shtetërore kombëtare. Shteti mban përgjegjësi edhe kur ky veprim a mosveprim është kryer nga ana e nëpunësve që ushtrojnë funksione publike, në krye të detyrës.

Praktika gjyqësore për këto dy nene nuk është ndër më të elaboruarat nëse i bëjme një krahasim me nenin 6 “E drejta për një process të rregullt apo nenit 1 protokollit 1 “E drejta pronës, gjithësesi prurjet dhe interpretimet e bëra nga GjEDNJ do jenë pjesë e këtij kapitulli për të kuptuar se në çfarë standardi intepretohen shpërblimi i dëmit nga shteti dhe organet e tij.

1. Së pari- Personi i cili legjitimohet për të pretenduar shkelje të nenit 13 dhe 41 të Konventës është çdo person i cili i janë dhunuar, shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në Konvetë. Në interpretim literal të fjalës së parë të nenit 13 “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë...” do të thotë se veprimi i shkeljes ka përfunduar. Kjo provohet me një vendim të formës së prerë të Gjykatave të Kombëtare, me një vendim deklarativ të GjEDNJ apo edhe kur e pohon vetë shteti shkeljen e bërë.

Kështu, në çështjen në çështjen nr. 25781/94 datë 10 maj 2001, *Qipro kundër Turqisë*, Gjykata gjeti faktore qeverinë turke për enklavën greko-qipriote në Qipron e Veriut dhe dha vendimin deklarativ se “ka pasur shkelje të nenit 2 në lidhje me mosveprimin e autoriteteve të shtetit të paditur për të drejtuar një hetim efektiv

<sup>355</sup> Shih § 158 të vendimit Osman Kundër Mbretërisë së bashkuar (1996).

*lidhur me vendodhjen dhe fatin e personave greko-qipriotë të zhdukur, ka pasur shkelje të nenit 5 për shkak të mosveprimit të autoriteteve të shtetit turk për të ndërmarrë një hetim efektiv mbi vendodhjen dhe fatin e personave greko-qipriotë të zhdukur, shkelje të nenit 3 pasi heshtja e autoriteteve të shtetit të paditur përballë shqetësimeve reale të të afërmeve arrinte në nivelin e një ashpërsie që mund të kategorizohej si trajtim çnjerëzor, shkelje të nenit 1 protokollit 1 dhe nenit 8 të Konventës për shkak se pronarët e pasurive të paluajtshme në veri të Qirpos po u mohojnë posedimin, gëzimi dhe disponimi i pronave të tyre si dhe çdo mundësi kompensimi për këtë shkelje, ka pasur shkelje të nenit 10 pasi librat e shkollës fillore të destinuara për përdorim ishin nënshtruar masave të tepruara të censurës, shkelje të nenit 2 protokollit 1 për shkak se nuk kishte pasur mundësi të përshtatshme shkollimi tetëvjeçar për greko-qipriotët që jetonin në veri të Qirpos, shkelje të nenit 13 për të shkak të mungesës së mjeteve efektive ndaj ndërhyrjeve nga ana e autoriteteve në të drejtat e greko-qipriotëve që jetonin në veri të Qipros, shkelje të nenit 6 në lidhje me praktikën ligjore të autorizimit të gjykimeve të civilëve nga gjykata ushtarake. Ndërsa në lidhje me nenin 41 të Konventës Gjykata u shpreh se nuk ishte gati për të vendosur.”*

Ky vendim shërbeu që gjykata pas 11 vitesh të shqyrtonte përsëri kërkesë e Qeverisë Qipriote për të matur dëmin e shkaktuar nga shkeljet që gjykata konstatoi në këtë vendim. Në çështjen nr. 25781/94, datë 12 maj 2014, *Qipro kundër Turqisë*, gjykata u morr vetëm me masën e shpërblimit të dëmit të deklaruar në vendimin e vitit 2001, cilët do të trajtojmë më poshtë.

2. Së dyti- Ankuesi për të përfutur shpërblim dëmi duhet të provoj se në vëndin e tij mungojnë mjete për zgjidhje dhe shpërblim të këtyre shkeljeve ose masa e shpërblimit nuk është e plotë (just satisfaction). Sipas çështjes nr. [7136/75](#) datë 25 Mars 1983, *Silver dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* kërkesa për tu shpërblyer, duhet të jetë e argumentuar, e provuar dhe jo haptazi e pambështetur.
3. Së treti- Edhe pse në përkthimin zyrtar të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut <sup>356</sup> fjala angleze “*an effective remedy*” përkthehet si “një zgjidhje efektive” në fakt sipas Gjykatës në jurisprudencën e saj kuptimi i saktë i saj është jo vetëm zgjidhje por edhe shpërblim të drejtë. “Zgjidhje efektive” nënkupton që të gjesh mekanizma kombëtare që vlerësojnë se ka pasur shkelje të të drejtave dhe lirive të Konventës dhe së dyti të garantohet se ndreqja e kësaj shkelje do të realizohet në mënyrë të drejtë nëpërmjet shpërblimit apo mënyrave të tjera të përshtatshme (çështja nr. 22414/93, datë 15 nëntor 1996 *Chahal v. Mbretërisë së Bashkuar*, çështja nr. 14038/88 datë 07 Korrik 1989 *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*.)<sup>357</sup>. Madje edhe mosdhënia mundësisë së ankuesit që të hetoj, investigoj për të drejtën e tij të shkelur mbrohet nga neni 13 i Konventës (çështja nr. 27229/95 datë 03 prill 2001, *Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

Në çështjen nr. 57/1996/676/866, datë vendimi 25 September 1997, *Aydin kundër Turqisë*, GjEDNJ konstatoi shkelje të nenit 13 të Konventës për arsye se

<sup>356</sup> Ligj nr.8137 datë 31.7.1996 “Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, shtuar me ligjin nr.8641, datë 13.7.2000 (protokoll shtesë), me ligjin nr.9264, datë 29.7.2004 (protokoll shtesë) dhe ndryshuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005 (protokoll shtesë) .

<sup>357</sup> “120. Neni 13 garanton mundësinë e ankimit në nivel kombëtar për tu zbatuar në thelb të drejtat dhe liritë e Konventës pavarësisht se në çfarë lloj forme mbrohen nga legjislacioni i brëndëshëm (shih rastin e sipërcituar Boyle dhe Rice, Series A nr. 131, f. 23, § 52). Efekti i nenit 13 ka të bëjë me thelbin e ankimit për të drejtat e Konventës dhe gjithashtu të garantohet një zbutje e përshtatshme e shkeljes (shih, inter alia, Silver dhe të Tjerët datë 25 Mars 1983, Series A nr. 61, f. 42, § 113 (a)).

shteti nuk kishte garantuar një hetim të plotë të kallzimit të ankueses për torturë dhe përdhunim nga punonjësit e policisë në Komisaratin e Derikut në Turqi, kur ajo ishte vetëm 17 vjeçe. Moshetimi i plotë i kallzimit të saj duke mos marrë ekspertë të specializuar gjinekolog që të hetonin mbi momentin e përdhunimit, mbyllja e dosjes për mungesë provash përbën shkelje të nenit 13.<sup>358</sup>

4. Së katërti- Në gjetjen e një zgjidhje efektive dhe shëprlimin e dëmit GJEDNJ nëkupton që në fund i dëmtuari të kthehet në gjëndjen e tij të mëparshme për aq sa është e mundur. Pra efektet e vendimeve të Gjykatës së Strasburgut janë jo vetëm konstatim të shkeljes, dhënie shpërblimi por ngarkojnë organet përkatëse shtetërore që të pushojnë shkeljen, të ndryshojnë legjislacioni përkatës dhe të merren masa që të tilla rastesh të mos përsëriten më. Ja si shprehet Gjykata në çështjen Qipro kundër Turqisë (2014) “ *Në këtë drejtim, nuk duhen ngatërruar, nga njëra anë, procedurat para Gjykatës, e cila është kompetente për konstatimin e shkeljeve të Konventës, dhënien e vendimeve përfundimtare<sup>359</sup> të cilat janë të detyrueshme për Shtetet palë (neni 19, i marrë së bashku me nenin 46 § 1) dhe akordimin e shpërblimit të drejtë kur është rasti (neni 41) dhe, nga ana tjetër, mekanizmi mbikëqyrës i ekzekutimit të vendimeve, ‘përgjegjësi’ e Komitetit të Ministrave (neni 46 § 2).*

*Sipas nenit 46, Shteti palë është i detyruar jo vetëm të paguaj shumat e dhëna nga Gjykata personave përkatës si shpërblim i drejtë, por edhe të marrë masa e duhura individuale apo të përgjithshme në rendin e brendshëm juridik, ose të dyja bashkë, për të t’i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe për të korrigjuar efektet, duke pasur si qëllim kthimin e kërkuarit, sa më shumë të jetë e mundur, në pozitën që ai do të kishte qenë nëse detyrimet sipas Konventës do të ishin respektuar (ibid., § 85).... këto janë dy forma të dallueshme të korrigjimit të situatës së krijuar nga shkelja e konstatuar dhe e para në asnjë mënyrë nuk përjashton të fundit.”*

5. Së katërti- Garantimi i mbrojtjes së të drejtave themelore dhe gjetjes një zgjidhje, shpërblimi i dëmit për shkelje shtrihet deri tek punonjësit publik si autorë shkelje. Në shumë çështje GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se punonjësi publik si në rastet e pakujdesisë ashtu edhe kur vepron me dashje, mban përgjegjësi për shkeljet karshi personit edhe nëse legjislacioni i brendshëm u ka dhënë imunitet. Për GJEDNJ është e rëndësishme që çdo person të shpërblehet, duke e kthyer ankuesin në gjëndjen e mëparshme.

Në rastet kur nuk ka pasur ligje që e vishnin me përgjegjësi punonjësin publik për dëmet e kryera gjatë veprimtarisë së tij, Gjykata ka konstatuar shkelje, ka detyruar shtetet për shpërblim dhe në mënyrë indirekte u kanë kërkuar që të ndryshojnë legjislacionin përkatës për të zgjeruar rastet e përgjegjësive edhe për punonjësit publik.

Më poshtë po paraqesim disa çështje dhe interpretimet që Gjykata ka bërë për rasteve, ku shtete si Mbretëria e Bashkuar, Zvicra njihnin imunitetin e punonjësve publik për shpërblim të dëmit të qytetarëve, gjatë kohës që ushtronin detyrën.

-Në çështjen nr. 87/1997/871/1083 datë 28 Tetor 1998, *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata është marrë gjatë me interpretimin nëse mbajnë përgjegjësi për pakujdesi të treguar në hetim, punonjësit e një rajoni policie ku me ankesat e bëra në mënyrë të vazhdueshme ishin vënë në dijeni se një djalë 14 vjeç dhe familja përndiqej nga një mësuesi i obsesionuar pas nxënësit.

<sup>358</sup> §109”Në dritën e vlerësimeve të mësipërme, konkludohet se asnjë heim i plotë dhe efektiv nuk u realizuar mbi pretendimet e ankueses dhe ky dështim minon efektivitetin e çdo shpërblimi tjetër që mund të pretendohet nisur edhe nga roli kyç që ka prokurori në këto lloj gjykimesh, përfshi edhe pretendimin për kompensim.”

<sup>359</sup> Për pranueshmërinë dhe themelin.

Ankuesit (Znj. Osman dhe i biri Ahmet Osman 14 vjeç (nxënës) pretenduan shkelje të neneve 2, 8, 6, 13 të Konventës për mosruajtje të jetës së babait të tyre, të mossigurimit të qetësisë familjare nga persekutimi disa mujor i mësuesit dhe mos pasjes mundësi në Mbretërinë e Bashkuar që të paditësh policinë për pakujdesi dhe mosveprim në kohë me pasojë dy vrasje dhe dy plagosje nga mësuesi i sëmurë mendërisht.

Gjykata u shpreh se “137. ... ankuesit nuk kishin asnjë të drejtë në Mbretërinë e Bashkuar, e interpretuar edhe nga Gjykata e Lordëve në rastin Hill, për padi ndaj policëve për pakujdesi në mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurisë së qytetarëve ... 139. Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se ankuesit duhet të kishin të drejtën që të dëgjoheshin për themelin e pretendimeve të tyre se kishin vënë në dijeni policinë për çdo gjë, vrasja e kryefamiljarit dhe plagosjes së të miturit Ahmet Osman, vrasja e nëndrejtoreshës dhe plagosja e të birit, ishte e parashikueshme dhe nuk ishte e drejtë dhe e arsyshme që rasti i tyre të përjashtohej sipas rastit Hill... 1. Arsyet që udhëhoqën gjykatën e Lordëve në çështjen Hill ishte për të mbrojtur me imunitet policinë nga veprimet neglizhuese, bazuar në interesin publik. Gjykata atje u shpreh se, shërbimi i policisë to të jetë më efektiv në luftën kundër krimit nëse nuk janë në rrezik të vazhdueshëm për paditë mbi operacionet e tyre ... 154. Rregulli përjashtues që u aplikua në rastin konkret, përbën një kufizim shpërpjestimor të të drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe shkel nenin 6§1 të Konventës”.

-Mungesa e ligjit dhe pamundësia për të pasur zgjidhje ose dëmshpërblim për shkelje të të drejtave themelore të Konventës është gjetur edhe në çështjen nr. 20605/92 datë 25 qershor 1997, *Halford kundër Mbretërisë së Bashkuar*. Ankuesja, oficere policie, pretendonte se telefonatat e bëra nga zyra janë përgjuar për ti përdorur nga punëdhënësi në procesin gjyqësor për diskriminim në punë.<sup>360</sup>

Këtu gjykata u shpreh se” 65. ...Znj.Halford kishte ankim me prova të pakundërshtueshme që telefoni i zyrës përgjohej dhe kjo përbën shkelje të nenit 8 të Konventës. Ajo kishte të drejtën për një mjet ankimi efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës. Megjithatë, ashtu siç edhe *Qeveria Britanike* e pranoi se nuk ka asnjë parashikim ligjor që të rregulloj përgjimet telefonike për telefonatat e zyrave publike siç ishte edhe stacioni i policisë së *Merseyside*. Ankuesja, e kishte të pamundur të kërkonte kompensim përpara gjykatave kombëtare në lidhje me telefonat e zyrës. Prandaj, ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës në lidhje me këtë.”

- Në çështjen nr. 136/1996/755/954, datë 16 Dhjetor 1997, *Camenzind kundër Zvicrës*, dy punonjësve të PTT të Zvicrës kishin bërë kontroll në banesën e tij përtej asaj çfarë kishte qënë qëllimi (zbulimi i një linjë e pa regjistruar nga ankuesi). Ankuesi nuk kishte pasur mundësi të kishte seancë para Gjykatës Federale të Zvicrës, për tu dëgjuar mbi shpërblimin e dëmit për shkelje të nenit 8 të KEDNJ mbi kontrollin disa orësh të banesës. Sipas legjislacionit të brëndshëm nuk mund të kërkohej shpërblim dëmi kur situata e ligjshme/paligjshme ka përfunduar. Në këto kushte Gjykata Federale duke vlerësuar se kontrolli ka përfunduar, nuk morri në shqyrtimin ankimin. U konsiderua se kontrolli i bërë në banesën e ankuesit nga punonjësit e PTT (Posta Telegraf Telefon) Zvicër ishte e domodoshme në një shoqërie demokratike dhe nuk ka shkelje të nenit 8 të KEDNJ por nga ana tjetër gjeti shkelje të nenit 8 dhe 13 të KEDNJ për mosdhënies mundësi të ankuesit për të kërkuar shpërblim të dëmit ndaj tij.

Gjykata edhe pse u shpreh se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të KEDNJ pasi kontrolli ishte i domodoshëm në një shoqëri demokratike, vlerësoi se ankuesi nuk ka pasur

<sup>360</sup> Ankuesja pretendonte për ngritje në detyrë pasi kishte eksperiencën më të madhe se kolegët e saj, por diskriminohej për shkak të gjinisë.

mjete të rëndësishme për tu dëgjuar për shpërblimin e dëmit material dhe moral të shkaktuar ku përfshihet refuzimi i padisë për shpërblim dëmi ndaj punonjësve të PTT Zvicër nga Gjykata Penale Administrative se telefonata nuk pranohej si provë për një veprë penale sipas ligjit për përgjimet telefonike të 1985.

Në çështjen nr. 21787/93 datë 18/12/1996 *Valsamis kundër Greqisë*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 13 bashkë me nenin 2 të protokollit 2 (E drejta për edukim) dhe nenit 9 (Liria e ndërgjegjies dhe e besimit), meqënëse mbi masën disiplinore të përjashtimit për një ditë nga mësimi të aplikueses, nxënëse e fillores, nuk parashikohej asnjë mundësi ankimi në një gjykatë administrative etj. Nxënësjë ishte përjashtuar për faktin se ajo bashkë me prindërit ishte praktikante e besimit “Dëshmitarë të Jehovahit” prandaj nuk morri pjesë në paradën e shkollës apo ushtarake që do kalonte në qytet për ditën e festës kombëtare. Pamundësia për të vlerësuar nga një gjykatë nëse vendimi i Drejtorisë ishte i paligjshëm, i mohon të drejtën për të kërkuar shpërblim dëmi për këtë veprim të paligjshëm të shkollës.

II. Në lidhje me shpërblimin e dëmit sipas nenit 41 të Konventës, gjykata ka referuar disa standarde të cilat mund të merren parasysh edhe nga gjykatat shqiptare në momentin kur gjykojnë paditë e shpërblimit të dëmit karshi organeve të administratës publike.

Vihet re se tek matja e dëmit pasuror gjykata bazohet në mënyrën e humbjes së pësuar për të cilën ka rëndësi provat që provojnë këtë humbje dhe bashkë me këtë, jepet edhe interesi përkatës. Ndërsa pak më evasive jepet shpërblimi i dëmit për dëmet jopasurore. Këtu gjykata citon se në përcaktimin e vlerave të saj do të bazohet jo tek kriteret dhe praktika gjyqësore e brëndshme por tek praktika e GJEDNJ për raste të ngjashme.

1. Mbi kriteret që merren parasysh në shpërblimin e dëmit- Në çështjen nr. [25376/06](#), datë 16 dhjetor 2014, *Rolanda Ceni kundër Italisë*, aplikuesja kishte lidhur një kontratë paraprake shitjeje me një Shoqërinë ndërtimore X dhe kishte paguar të tërë çmimin e apartamentit në vlerën 214.627 EUR. Shoqëria X nuk e firmos kontratën përfundimtare të kalimit të pronësisë. Gjatë gjykimit në Gjykatën e Firenzës për kalimin përfundimtar të pronësisë sipas kontratës, Shoqëria X u deklarua në gjëndje falimenti dhe administratori i falimentimit deklaroi të zgjidhur kontratën me ankuesen Ceni. Ky apartament u shit me ankand një të treti, por për shkak se ankuesja jetonte aty, detyrohet të riblej sendin blerësit të ankandit në vlerën 190 000 Euro.

Paditësja pasi shteroi të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror, pretendoi para GJEDNJ shumën totale prej 201.404,20 EUR nga ku 190 000 Euro ishte vlera e riblerjes së sendit dhe 11.404,20 EUR shpenzime noteriale, rregullimet urbanistike etj. Po ashtu ajo pretendoi se nga viti 1997 i moslidhjes së kontratës ka përjetuar ankth, depresion për të cilën është mjekuar, bashkëshorti i saj i është dashur të punoj në Siberi për të riblerë apartamentin etj.

Gjykata gjeti shkelje të nenit 1 protokollit 1 dhe nenit 13 të Konventës” *§18për efekt të detyrimeve që rrjedhin nga neni 1 i protokollit 1 të Konventës, shteti duhet të vendoste një kuadër ligjor që i garantonte një mbrojtje minimale, blerësve në mirëbesim në fushën e ndërtimit. Tashmë, një mbrojtje e tillë nuk ekziston në ligjet italiane për pamundësinë e zgjidhjes së kontratës paraprake të shitjes të pasurive të paluajtshme të regjistruara, mundësisë për të jetuar të blerësit, nuk parashikohej as detyrimi i ndërtuesve për të nënshkruar një garanci në rast falimentimi”.*

Gjykata argumentoi masën prej 50,000 euro të shpërblimit të dëmit pasuror dhe jopasuror si më poshtë:

1. Së pari- aplikuesja nga veti shteti Italian ka marrë kompensim për dëmin e shkaktuar, 12,541. 50 Euro në proçedurën e falimentimit, shumën prej 13,617.63 Euro nga fondi i viktimave të falimentimit të shoqërive ndërtuese pra një shumë totale 26.159,13 EUR.<sup>361</sup>
2. Së dyti- mundësinë për të marrë përsëri të ardhura nga proçedura e falimentimit, pavarësisht se në rradhë preferimi mund të jetë shumë poshtë, ekziston mundësia e shpërndarjes së masës së falimentimit.
3. Së treti- merret parasysh se në shkëlqje të të drejtave të garantuar nga neni 1 protokollit 1 dhe neni 13 i Konventës, ka shkaktuar ndjenja të pafuqishmërisë dhe të frustrimit, zhgënjimit dhe demoralizimit ( shën. R.M), e për këtë dëmi moral duhet të riparohet në mënyrë të drejtë.

Duke marrë parasysh të tre këto elemente shuma për shpërbllim moral dhe pasuror është në vlerën 50 000 EUR.

- Në çështjen *Osman ndaj Mbretërisë së Bashkuar*, gjykata rrëzoi pretendimin e ankuesit se shpërblimi të jetë i tillë sa mund të përfitojë personi nëse do të kishte ngritur padi civile ndaj punonjësve të policisë në Mbretërinë e Bashkuar. Gjykata argumentoi se masa e shpërblimit vendoset sipas praktikës gjyqësore (case-law), kritereve dhe shkallëzimeve që marrin parasysh gjykatat e brendshme dhe jo të shteteve antarë të saj.<sup>362</sup>

2. Lënie afat për shqyrtim- Gjykata për tu treguar sa më objektive në matjen e dëmit pasuror, në disa raste u ka lënë afat ankuesve që të vlerësojnë me ekspert se sa është dëmi i shkaktuar nga organet publike në mënyrë që të matet shpërblimi para saj. Konstatohet se përgjithësisht ky qëndrim është mbajtur në rastet kur shpërblimi i kërkuar është disa miliona euro dhe kërkohet një shtjellim më i detajuar i pretendimeve në seancë të veçantë.

Në çështjen nr. 13092/87 dhe 13984/88 datë 09 Dhjetor 1994, *Manastiret e Shenjta kundër Greqisë*, gjykata për të vlerësuar shkëlqje të nenit 1 protokollit 1 të Konventës mbi mënyrën joproporcionale të shpronësimit të pronave të disa Manastireve Ortodokse u la afat 6 muaj atyre që të provonin dhe të identifikonin pronat pra manastiret, kishat, ndërtesat me titull dhe ato pa titull ligjor të cilat ishin prekur nga cënimi i të drejtës për pronësi dhe më pas të vlerësohej dëmi i pësuar.

Edhe në çështjen nr. [14902/04](#) datë 20 shtator 2011, *Shoqëria Oao Neftyanaya Kompaniya Yukos kundër Rusisë*, për pretendimin mbi dëmin pasuror në masën 81 billion euro dhe një interes ditor prej 29,577,848 euro dhe si dëm jopasuror jo më pak 100,000 euro dhe shpenzime 171,444.60 euro, gjykata u shpreh unanimisht se nuk ishte gati për vendim dhe u la palëve një afat prej tre muajsh që të sjellin observacionet e tyre me shkrim dhe të bëjnë me dije Gjykatën nëse arrihet marrëveshje mes tyre gjatë kësaj periudhe.

3. Natyra ndëshkuese e shpërblimit të dëmit- interpretimi i nenit 41 i Konventës u bë në mënyrë të mirfilltë në çështjen nr. 25781/94 datë 12 maj 2014 *Qipro kundër Turqisë*. Gjyqtar Pinto de Albuquerque dhe gjyqtar Vučinić e kanë cilësuar këtë vendim kontributi më i rëndësishëm për paqen në Evropë, në historinë e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ("Gjykata").

Më 25 nëntor 2011, Qeveria e Republikës Qipro i paraqiti "Kërkesë për shpërbllim të drejtë (neni 41), në emër të Republikës së Qipros", duke vënë theksin mbi procedurën

<sup>361</sup> Po aty, §24.

<sup>362</sup> Shih §164 të çështjes Osman kundër Turqisë të sipërcituar.

e zbatimit të vendimit kryesor Qipro kundër Turqisë (2001), nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës dhe duke i kërkuar Gjykatës ndërmarrjen e hapave që do të lehtësonin zbatimin e këtij vendimit.

Ky vendim ngërthen të drejtat e njeriut, të drejtën ndërkombëtare publike dhe të drejtat administrative dhe civile për shpërblim të dëmit të shkaktuar nga shteti.

Në këtë vendim për herë të parë, gjykata pranoi kërkesën kolektive të shtetit qipriot ndaj shtetit turk, për shpërblim të dëmit pasuror dhe jopasuror të shkaktuar greko-qipriotëve të larguar nga tokat e tyre në Qipron Veriore (tashmë Qipro turke) në genocidin turk në muajt korrik, gusht të vitit 1973. Shpërblimi prej 30 milion euro u dha jo në mënyrë nominale por në tërësi për të gjitha familjet, të afërmit e të cilët janë zhdukur dhe shumën 60,000,000 (gjashtëdhjetë milion euro), në lidhje me dëmet jo materiale që u janë shkaktuar banorëve greko-qipriotë në enklavën e gadishullit Karpas pa u përfshirë fitimi i munguar dhe plus çdo taksë që mund të jetë e zbatueshme mbi këtë shumë.

Mbi mënyrën sesi është vlerësuar ky dëm vërehet se jeta e çdo personi të humbur barazohet mesatarisht me shumën 20,000 euro secili ndërsa viktimat e enklavës turke janë vlerësuar në shumën prej 50,000 euro secili.

Për studimin tonë ka vlerë mendimi paralel i gjyqtar Pinto de Albuquerque dhe gjyqtar Vučinić ku kanë interpretuar se çfarë është dëmi jopasuror, kur shpërblimi i dëmit është i drejtë dhe i plotë citojmë:

- *“Së pari, Gjykata ka urdhëruar kompensim, pa ndonjë pretendim për shpërblim tërësor nga kërkuesi. Vetë gjykata u tregua e gatshme për shpërblim të dëmit të ardhur nga shkelja e neneve 3,5 të Konventës, pa ndonjë specifikim të llojeve të dëmit, bazuar tek "karakterin absolut i të drejtës së shkelur,<sup>363</sup> "karakterin veçanërisht serioze të shkeljeve",<sup>364</sup> "ashpërsinë e shkeljes"<sup>365</sup>, "rëndësinë thelbësore të të drejtës së shkelur"<sup>366</sup>.*

*Në rastet e tjera kërkuesi kërkon kompensim por nuk e paraqet masën, gjykata shpërblen aq sa mendon se është e drejtë në rastin përkatës.<sup>367</sup> Ka raste kur kërkuesi kërkon shpërblim të plotë duke përcaktuar një masë të dëmit jopasuror dhe gjykata akordon një masë më të madhe.<sup>368</sup> Në këtë rast natyra e shpërblimit të dëmit nuk është kompensues por ndëshkues. Qëllimi i këtij shpërblimi nuk është të vendosë të dëmtuarin në të njëjtin pozitë që ka qënë para shkaktimit të dëmit. Qëllimi kryesor i këtij lloj dëshmpërblimi është ndëshkimi për veprime a mosveprime të paligjshme të shtetit dhe përsëritjen e tij në të ardhmen.*

<sup>363</sup>Chember kundër Ruisë, nr. [7188/03](#), § 77, 3 Korrik 2008 (10,000 euro); X kundër Kroacisë, nr. [11223/04](#), § 63, 17 Korrik 2008 (8,000 euro); Igor Ivanov kundër Ruisë, nr. [34000/02](#), § 50, 7 Qershor 2007 (5,000 euro); Mayzit kundër Ruisë, nr. [63378/00](#), §§ 87-88, 20 Janar 2005 (3,000 euro); Nazarenko kundër Ukrainës, nr. [39483/98](#), § 172, 29 Prill 2003 (2,000 euro).

<sup>364</sup>Bursuc kundër Romanisë, nr. [42066/98](#), § 124, 12 Tetor 2004 (10,000 euro).

<sup>365</sup>Gorodnitchev kundër Ruisë, nr. [52058/99](#), § 143, 24 Maj 2007 (10,000 euro).

<sup>366</sup>Rusu kundër Austria, nr. [34082/02](#), § 62, 2 Tetor 2008 (3,000 euro); Crabtree kundër Republikës Çeke, nr. [41116/04](#), § 60, 25 Shkurt 2010 (2,000 euro); Khudyakova kundër Ruisë, nr. [13476/04](#), § 107, 8 Janar 2009 (5,000 euro).

<sup>367</sup>Për shëmbull Celik dhe Yuldz kundër Turqisë, nr. [51479/99](#), §§ 30-31, 10 Nëntor 2005, Davtian kundër Gjeorgjisë, nr. [73241/01](#), § 70, 27 Korrik 2006.

<sup>368</sup>Për shëmbull, Stradovnik kundër Slovenisë, nr. [24784/02](#), §§ 23-25, 13 Prill 2006, ku Gjykata shpërbleu me 6,400 euro për te zgjatje të procesit gjyqësor dhe kërkuesi kishte kërkuar vetëm 5,000 euro.

- Së dyti, Gjykata ka krijuar dëmshpërblimin simbolik me qëllim të dukshëm për të fajësuar dhe turpëruar shtetin e paditur, duke e bërë këtë ndëshkim, shëmbull për shtetet e tjera<sup>369</sup>.
- Së treti-, Gjykata ka dhënë edhe një shpërblim të drejtë në rastet kur kërkuesi ankohet për të drejtën e brëndshme, pa treguar ndonjë dëmtim personal të veçantë përveç shqetësimit të shkaktuara nga ekzistenca e vetë ligjit.<sup>370</sup> Është qartë se shpërblimi i drejtë pasohet edhe nga ndëshkimi për shtetin përgjegjës që ka nxjerrë ligje që nuk përputhen me konventën.
- Së katërti- gjykata ka urdhëruar një shpërblim të drejtë (R.M nënkupto të plotë), për një dhunim të mundshëm të Konventës.<sup>371</sup> Edhe këtu, qëllimi i shpërblimit është që të kufizoj dhe të ndëshkoj shtetin përgjegjës për sjelljen sesa të kompensoj ankuesin për një dëm që akoma nuk ka ardhur.
- Së pesti, Gjykata nuk ka përjashtuar mundësinë që ankuesi të mund të ketë pasoja nga shkelja e gjetur, humbja e mundësive në të ardhmen. Në këtë rast një shpërblim i drejtë nuk justifikohet për sa kohë nuk ka dëm të ardhur faktisht tek ankuesi dhe ka dyshime nëse pasojat materializohen. Sjellja me faj e shtetit është ajo që kërkon gjykata të dënoj.<sup>372</sup>
- Së gjashti, Gjykata ndonjëherë shpërblen edhe në mungesë të provave apo kur ka kontradikta në parashtrimeve e ankuesit sa i takon humbjeve të pësuar. Shpërblimi i lihet në diskrecion gjykatës. Në këtë rast, shpërblimi i drejtë nuk jepet për sa kohë ka mungesë provueshmërie për dëmin por ndëshkohet shteti për sjellje të padrejtë.
- Së shtati, në rastet e interesit të përgjithshëm, Gjykata përcakton shpërblimin e drejtë duke marrë parasysh efektin e saj shëmbullor.<sup>373</sup> ”

Megjithatë sipas këtij mendimi paralel, shpërblimi ndëshkues nuk duhet të mungoj asnjë herë në rastet kur synohet parandalimi i shkeljeve të mëtejshme të të drejtave të njeriut dhe për të ndëshkuar qeveritë në veprime a mosveprime të paligjshme. Veçanërisht dëm ndëshkues apo dëm shëmbullor cilësohen minimalisht këto tre raste:

1) Shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, intensive në kohë, të përsëritura për një kohë të gjatë ose një shkelje të vetme të vazhdueshme gjatë një periudhe të konsiderueshme;

2) Mospërputhje e zgjatur, e qëllimshme e një vendim të gjykatës nga një shtet i pabindur;

3) Kufizimi apo kërcënimi i të drejtave të ankuesit me qëllim që të shmanget, dëmtohet a kufizohet aksesin në Gjykatë.

Po sipas gjyqtar Pinto de Albuquerque dhe gjyqtar Vučinić shpërblimi i drejtë që të jetë i tillë duhet të jetë i plotë dhe këtu përfshihet edhe kur llogaritet edhe ndëshkimi a shëmbulli që duhet ti jepet shtetit përgjegjës” 14. Kështu, ekzistenca e dëmeve ndëshkuese apo shëmbullore sipas Konventës është prezent në praktikën e Gjykatës. Shpërblimi i drejtë jepet në rastet kur autoritetet kombëtare nuk kanë bërë një zhdëmtim

<sup>369</sup>Për shëmbull, Engel dhe të tjerë kundër Hollandës (Neni 50), 23 nëntor 1976, § 10, Series A nr. 22 (100 gilde hollandeze), Vaney kundër France, nr. [53946/00](#), § 57, 30 nëntor 2004 (një euro).

<sup>370</sup> Për shëmbull në S.L. kundër Austria, nr. [45330/99](#), § 52, ECHR 2003-I, Gjykata dha shpërblim për dëm jopasuror edhe pse neni që kundërshtohet i Kodit Penal Austriak u shfuqizua dhe tashme ankuesi kishte arritur pjesërisht synimin e tij.

<sup>371</sup> Për shëmbull Mokrani kundër France, nr. [52206/99](#), § 43, 15 Korrik 2003 dhe Gürbüz kundër Turqisë, nr. [26050/04](#), § 75, 10 nëntor 2005 (shih mendimin e kundërt të gjyqtarëve Caflisch dhe Türmen).

<sup>372</sup> Sporrong dhe Lönnroth k. Suedisë (Neni 50), 18 Dhjetor1984, § 25, Series A nr. 88; Bönisch k. Austria (Neni 50), 2 Qershor1986, § 11, Series A nr. 103; dhe Sara Lind Eggertsdóttir k. islandës, nr. [31930/04](#), § 59, 5 korrik 2007.

<sup>373</sup> *Xenides-Arestis k. Turqisë* (shpërblim i drejtë), nr. 46347/99, 7 dhjetor 2006, dhe *Ananyev dhe të tjerë k. Turqisë* nr. 42525/07 dhe 60800/08, 10 Janar 2012.



të plotë. Neni 41 përjashton çdo shpërblim që e tejkalon shpërblimin e plotë por ky mund të arrihet kur nevoja për parandalim dhe ndëshkim përmbushen nëpërmjet shpërblimit nisur nga rrethanat specifike të ngjarjes. Vetëm atëherë shpërblimi është i drejtë. Shpërblimi për humbjet e pësuar mund të mos jetë i mjaftueshëm dhe detyrimi për rehabilitim të plotë mund të përfshijë dëmin ndëshkues që shkon përtej dëmit pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga persona të caktuar.”

Pra sipër këtij mendimi paralel, shpërblimi i drejtë është më i gjërë se shpërblimi i plotë. Koncepti duhet zgjeruar shpesh herë jo vetëm për të kthyer të dëmtuarin në gjëndjen e mëparshme për të dhënë shëmbull a ndëshkuar shtetin në mënyrë që të mos ketë situatë të ngjashme apo të marrë masa për parandalim. Përgjithësisht ky lloj shpërblimi ndëshkues aplikohet në vënden e common law ndërsa shpërblimin e plotë jepet kryesisht nga gjykata e familjes civil law me qëllim që i dëmtuari të mos pasurohet nga dëmi i shkaktuar. Këtë mënyrë shpërblimi kanë përfshirë edhe ligje të tjera ndërkombëtare ku nuk e njohin shpërblimin ndëshkues të shkaktuar mes shteteve si p.sh Kombët e Bashkuara.

4. I dëmtuari shtet apo individ – Po në këtë vendim, Gjykata mori në konsideratë edhe parimet e së drejtës ndërkombëtare publike. Neni 31 pika 3 të Konventës së Vienës “Mbi përgjegjësinë e Shtetit në Komisionin e të Drejtës Ndërkombëtare” parashikon se një shtet mund të konsiderohet viktimë për një dëm të shkaktuar nga një shtet tjetër. Po ashtu duhet që paditë të ngrihen nga personat që drejtëpërdrejtë janë dëmtuar. Qeveria turke në çështjen *Qipro kundër Turqisë* (2014) pretendoi se “2. Duke iu referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës, akordimi i shpërblimit të drejtë në bazë të nenit 41 të Konventës, ishte menduar të mbulonte trauma fizike ose psikologjike, dhimbje apo vuajtje, stresin, ankthin, frustrimin, ndjenjën e padrejtësisë dhe poshtërimit, pasigurinë e zgjatur, shqetësimet jetësore etj. Këta faktorë kanë të bëjnë ekskluzivisht me vuajtjet e një kërkuesi individual, d.m.th. të një personi fizik dhe nuk kanë kuptim në një çështje ndër-shtetërore. Për sa i përket Rregullores së Gjykatës, Qeveria e paditur argumentoi se përdorimi i përemrave pronor në gjuhën angleze “his” dhe “her” (në vend të “its”)<sup>374</sup> në nenin 60 § 1 të Rregullores tregon se ky rregull lidhet vetëm me individët dhe jo Shtetet.”

Gjykata u shpreh se që në punimet paraprake të kësaj konvente, neni 41 është parashikuar jo vetëm për individët por edhe për mardhëniet ndër-shtetërore duke u bazuar tek parimet e së drejtës ndërkombëtare publike ku një Shtet i dëmtuar ka të drejtë dëmshpërblehet nga Shteti i cili nëpërmjet një veprimi ndërkombëtarisht të gabuar i ka shkaktuar një dëm.<sup>375</sup> Sipas gjykatës “3. ... Qeveria qipriote ka paraqitur pretendime për shpërblim të drejtë në lidhje me shkeljet e të drejtave të Konventës në dy grupe njerëzish, saktësisht dhe objektivisht të identifikueshëm pra 1,456 personat e pagjetur dhe banorët greko-qipriotë në enklavat e gadishullit Karpas. Me fjalë të tjera, shpërblimi i drejtë nuk është kërkuar me qëllim dëmshpërblimin e Shtetit për shkeljen e të drejtave të tij, por për të përfituar viktimat individualisht, siç është përshkruar në paragrafin 45 më sipër. Në këto rrethana, dhe për aq sa përfshihen personat e zhdukur dhe banorët e Karpasit, Gjykata vlerëson se Qeveria Qipriote ka të drejtë të bëjë një kërkesë sipas nenit 41 të Konventës dhe se akordimi i shpërblimit të drejtë në rastin në fjalë është i justifikuar.”

<sup>374</sup> Në gjuhën angleze përemrat pronor ‘his’ dhe ‘her’ që në gjuhën shqipe përkthehen ‘i tij’ dhe ‘e saj’ përdoren për njerëzit ndërkohë që ‘its’ që në gjuhën shqipe përkthehet gjithashtu “i tij ose e saj” është një përemër që përdoret për objektet, shtetet, kafshët pra për jo humanët.

<sup>375</sup> Shih §40, 41 të çështjes *Qipro kundër Turqisë*, variant shqip të sipërcituar.

- Shpërblimi i dëmit civil është i pavarur nga gjykimi penal - Në çështjen nr. 16825/02, *Diana Plotina ndaj Letonisë* Gjykata pranoi se mund të ngrihet padia civile për shpërblim dëmi si ndaj punonjësit të policisë, bashkëpunorët të tij por edhe ndaj Shërbimit të Sigurisë pa përfunduar çështja penal me vendim të formës së prerë dhe nuk e gjeti të arsyeshme qëndrimin e ankueses që në pritje të një vendimi penal të tillë nuk kishte ngritur asnjëherë padi civile për shpërblim. Faktet e çështjes paraqiten si vijon: paditësja duke pirë kafe në një bar të qytetit ishte plagosur nga arma e një punonjësi policie K. i cili ia kishte dhënë ta provonte një shtetasi tjetër P. Ndaj punonjësit të policisë vetëm u morr masa disiplinore ndërsa nuk u dënua për plagosje për shkak se nuk u arrit ekstradimi i tij nga Bjellrusia për më shumë se 10 vjet e në këto kushte Prokuroria pushoi çështjen. Ndërsa për shtetasin tjetër P. kreu dënimin prej 8 muajsh të plagosjes nga pakujdesia të ankueses dhe kishte edhe një detyrim civil për të shlyer ankueses. Në gjykimin penal, ankuesja paraqiti edhe padinë civile për kompensimin e të gjithë dëmeve pasurore për mjekimin e saj. Kjo padi u veçua nga gjykata penale. Detyrimi financiar tek vendimi penal nuk u arrit të ekzekutohej pasi i dënuari P. kishte vite që jetonte në Rusi.

- Shpërblimi i dëmit apriori për raste specifike

Vëndi- Gjykata çështjen 71463/01 datë 28 June 2007, *Silih kundër Sllovenisë*, në mënyrë të hapur ngarkoi shtetet të cilët në shkelje të nenit 13, 2, 41 të Konventës duke mos pranuar gabimet e stafeve të tyre i çojnë qytetarët në kalvar gjyqesh. Sipas gjykatës në rastet e padive për shpërblim dëmi për mjekim të pakujdesshëm, spitalet shtetërore dhe private duhet të jenë të gatshme të marrin përgjegjësinë. Çdo sjellje ku spitalet dinë gabimin e stafit të tyre dhe nuk e pranojnë, çojnë qytetarët në kalvar gjykimesh, kjo përbën shkelje të Konventës.

Mbi përgjegjësinë e institucioneve mjeksore për vdekjen e një 20 vjeçar, nga një reaksion të injeksionit për të qetësuar urtikarien akute, Gjykata u shpreh “117... neni 2 i Konventës kërkon që shtetet jo vetëm të mbrojnë marrjen e jetës në mënyrë të qëllimshme por edhe për të marrë masat e nevojshme për të siguruar jetën e shtetasve. Në veçanti, ky nen detyron shtetet që të sigurojnë një sistem të pavarur kështu që vdekja e pacientëve nga pakujdesia e mjekëve si në sektorin publik apo privat duhet shqyrtohet dhe ato që janë përgjegjës të japin llogari. ...

132. Duke pasur parasysh sfondin e mësipërm dhe faktit se u deshën 12 vjet që të gjykohehin kallzimi penal dhe padia civile gjendet akoma e pezulluar, për gjykatën nuk mund të pranohet se kjo është një hetim efektiv për shkaktarin dhe përgjegjës për vdekjen e djalit të kërkuesëve...

133. Së fundi, Gjykata kërkon që në mënyrë të përgjithshme të vë në pah dhe të bëjë thirrje për një shqyrtim të shpejtë të rasteve që kanë të bëjnë me vdekjet në një mjedis spitalor. Njohja e fakteve dhe e gabimeve të mundshme të kryera gjatë kujdesit mjekësor janë thelbësore për të mundësuar institucioneve në fjalë dhe stafin mjekësor për të korrigjuar mangësitë e mundshme dhe për të parandaluar përsëritjen e gabimeve të ngjashme. Ekzaminimi i shpejtë i rasteve të tilla është e rëndësishme për sigurinë e përdoruesve të të gjitha shërbimeve shëndetësore (shih Byrzykowski, cituar më lart, § 117). 134. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se ka pasur shkelje procedurale të nenit 2 të Konventës.”

-Kategori vulnerabël si të izoluarit, dënuarit etj. Gjykata u shpreh se padi të tilla për shpërblim dëmi nga shteti i cili detyrohet të marrë të gjitha masat për të ruajtur jetën e një të burgosuri a paraburgosuri duhet të trajtohen me kujdes të ndjekin mjekimin pavarësisht nga dëshira e të burgosurit etj., pasi është e dukshme që vetë individi nuk ka asnjë mundësi për tu kuruar vetë, për të zgjedhur spitalin ku do kurohet etj. Gjykata

në çështjen nr. [4353/03](#), datë 14 dhjetor 2006, Tarariyev kundër Ruisisë shtoj se “73. Në situatën e të dënuarve, gjykata e ka nënvizuar tashmë se personat në izolim janë në kushte vulnerable dhe autoritetet shtetërore kanë detyrimin që ti mbrojnë ato. I takon detyrimi çdo shteti të jap llogari për çdo dëmtim të personave në izolim dhe aq më tepër ky detyrim shtohet kur individët vdesin (shih rastet Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar § 91, dhe Salman k. Turqisë [GC], nr. [21986/93](#), § 99, ECHR 2000-VII). 74. Këto parime zbatohen edhe në sferën e shëndetit publik. ... Për më tepër, kur një spitali është një institucion publik, veprimet dhe mosveprimet e stafit të tij mjekësor bëjnë që edhe shteti të jetë përgjegjës në bazë të Konventës (shih Glass k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 61827/00, § 71, GJEDNJ 2004- iI).”

Sipas fakteve të kësaj çështje Z. Tarariyev kishte qenë në paraburgim në burgun e Khadyzhensk. Ky institucion kishte qenë plotësisht i vetëdijshëm për problemet e tij shëndetësore sidomos me ulçerën. Gjatë kohës së qëndrimit atje është trajtuar me bimë që i bënte vetë i burgosuri. Në kartelën e tij nuk kishte koherencë në të dhënat e tij mjekësore, shumica e të cilave ishin të paplota. Ditën e ngjarjes, ai u transferua menjëherë në një spital shtetëror ku ekspertiza vërejti se operacioni kishte difekte dhe penjtë ishin zgjidhur. Mjekët në Spitalin Apsheronsk autorizuan dërgimin e tij në spitalin e burgut në dijeni të plotë të komplikimeve post-operative që kërkonin kirurgji të menjëhershme. Stafi i spitalit të burgut e trajtuan si një pacient të zakonshëm duke sjell një operacion të dytë të vonuar, humbje masive të gjakut e për këtë arsye ndërroi jetë.

Ekzistenca e një lidhje shkakësore midis ndihmës mjekësore jo të saktë dhe vdekjes së z Tarariyev u provuan me ekspertë mjeko-ligjor prandaj gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës për shkak të dështimit të autoriteteve ruse për të mbrojtur të drejtën e z Tarariyev për jetën. Gjykata e gjetin shkelje të nenit 2 dhe 13 të Konventës faktin se pushimi i çështjes për mjekim të pakujdesshëm ndaj mjekut dhe spitalit publik në prokurori, mohoi ankueses të drejtën për të kërkuar shpërbllim të dëmit civilisht kjo pasi shanset për ta fituar këtë çështje sipas praktikës gjyqësore ishte zero. Po ashtu u gjet edhe shkelje të nenit 3 për trajtim degradues nga autoritetet publike ku aplikanti në spital mbahej me pranga në duar dhe u transportua me kamion të zakonshëm nga spital civil për në spitalin e burgut.

III. E drejta për kompensim për burgim të padrejtë (neni 5 § 5) parashikohet në mënyrë të veçantë ndryshe nga rastet e tjera ku neni 41 ndërthuret edhe me nene të tjera të Konventës që mund të jenë shkelur. Sipas nenit 5 § 5 "Çdokush që ka qenë viktimë e arrestimit ose ndalimit në kundërshtim me dispozitat e këtij neni do të ketë të drejtë për kompensim".

Kjo e drejtë në Shqipëri është rregulluar me ligjin nr.9381, datë 28.4.2005 “Për kompensimin e burgimit të padrejtë” i pandryshuar asnjëherë. Vihet re se masat e shpërbllimit që nga ky vit e deri më sot janë të përcaktuar tek neni 5 §2 i këtij ligji:

- Për çdo ditë burgim të padrejtë kompensohesh me 2000 (dy mijë) lek/ditë;
- Për çdo ditë paraburgim të pa drejtë kompensohesh me 3000 (tre mijë) lek/ditë;
- Dhe për çdo ditë arrest në shtëpi sa gjysma e masës së burgut pra kompensohesh me 1000 (një mijë) lek/ditë

Sipas Udhëzuesit për nenin 5, botimi i GJEDNJ (2014),<sup>376</sup> në mënyrë të përmbledhur njihen këto karakteristika të shpërbllimit të dëmit për izolim të padrejtë të personit:

<sup>376</sup> “Guide on Article 5 of The Convention, Right to Liberty and Security”, Council of Europe/European Court of Human Rights, 2014, [http://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_5\\_ENG.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_5_ENG.pdf), akses gusht 2016.

- Duhet të ketë një izolim nga autoritetet vendase (përfshi edhe gjykatën) në kundërshtim me nenin 5 nga paragrafët 1 deri në 4 të Konventës (çështja NC v. Italisë § 49; Pantea k. Romanisë, § 262; Vachev k. Bullgarisë, § 78);

- Arrestimi ose ndalimi mund të jetë e ligjshme sipas ligjit vendas, por në shkelje të Nenit 5 të Konventës (çështja Harkmann k. Estonia, § 50);

- E drejta për të kërkuar shpërblim të drejtë mund të zbatohet direkt përpara gjykatave kombëtare dhe jo vetëm duke iu drejtuar Gjykatës së Strasburgut (çështja A. dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar § 229 dhe çështja Storck kundër Gjermanisë, § 122);

- Shpërblimi duhet të jepet jo vetëm nga gjykatë por edhe vetë autoritetet që e konstatojnë këtë fakt (çështja Stanev k Bullgarisë § 183-84). Ato duhet të parashikohen në ligj por dhe të jepen në praktikë. (Çështja Dubovik k. Ukraine, § 74, çështja Chitayev dhe Chitayev k. Ruisë, § 195).

- Në shqyrtimin e kërkesave për kompensim, autoritetet vendore duhet të interpretojnë dhe të zbatojnë ligjin e brendshëm në frymën e nenit 5, pa formalizëm të tepërt dhe duke mos kërkuar prova të shumta të dëmtuarit për masën dhe llojin e dëmit të shkaktuar (çështja Shulgin k. Ukrainë, § 65; Houtman dhe Meeus k. Belgjikës, § 46).

- Kompensimi është vetëm i natyrës monetare dhe jo lirimin e personit të arrestuar pasi kjo mbulohet nga neni 5 § 4 të Konventës. Po ashtu ditët e izolimit të padrejtë nuk mund të shërbejnë si kredi për tu përdorur nga i dëmtuari për të shlyer një dënim tjetër (çështja Włoch v. Poland (nr. 2), § 32).

- Shpërblehet ai dëm pasuror dhe jopasuror që provohet nga burgimi/paraburgimi i padrejtë por standardi i provës nuk duhet të jetë domosdoshmërisht në nivelet më të larta apo në tepër formal. (Danev v. Bullgarisë, §§ 34-35).

6) Shuma e kompensimit duhet të jetë në përputhje me ashpërsinë e shkeljes duke mos qënë as minimal dhe as i tepruar prandaj duhet vërejtur edhe praktika e GJEDNJ në raste të ngjashme (çështja Ganea k. Moldova, § 30;.. Cristina Boicenco k. Moldavisë, § 43).

#### **5.4 Shpërblimi i dëmit në mardhëniet ndër-shtetërore sipas Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara**

Kemi marrë si shëmbull Ligjin “Mbi përgjegjësinë e shteteve për veprime ndërkombëtare të paligjshme” të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2001<sup>377</sup>, për të krahasuar kuptimin dhe mënyrën e shpërblimit të dëmit që shtetet mbajnë parasysh kur shpërblejnë dëmin karshi njëri-tjetrit. Në këtë mënyrë, kjo frymëzon legjislatorin për të kuptuar sesi duhet të mbahet përgjegjësi karshi shtetasve kur kryejnë veprime të paligjshme dhe si duhet të dëmshpërblehen ato.

Ky ligj rregullon çdo veprim të padrejtë në fushën ndërkombëtare që një shteti i shkakton një shteti tjetër në kuadër të mospërmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare ose kur kjo përgjegjësi jashtëkontraktore parashikohet në kuadër të të drejtës ndërkombëtare (neni 2).

Sipas nenit 29 të këtij ligji pavarësisht dëmit të shkaktuar, shteti përgjegjës e ka për detyrë të vazhdoj përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare karshi shtetit të dëmtuar, i pa ndikuar nga veprimi i padrejtë. Pra për analogji, OAP pavarësisht shkaktimit të dëmit një qytetari duhet të vazhdojnë funksionin e tij dhe t’i përgjigjet

<sup>377</sup> Ky ligj gjendet i botuar në Anualin e Komisionin e të Drejtës Ndërkombëtare, 2001, VOL.II (Pjesa II).

sipas ligjit në përmbushje të detyrimeve karshi të dëmtuarit por edhe karshi qytetarëve të tjerë

Gjithashtu, detyra e dytë e shtetit përgjegjës sipas nenit 30 të këtij ligji është që 1) të stopoj veprimin e padrejtë nëse është duke vazhduar, 2) të ofroj garanci dhe sigurinë e duhur për mospërsëritje. Në këtë mënyrë shtetet e tjera garantohen se dëmi nuk do të vijë më sapo akti i padrejtë pushojn dhe se asnjë veprim i tillë nuk do të përsëritet më në të ardhmen.

Ky ligj bën dallimin mes shpërblimit të plotë ose riparimit të plotë të situatës (full reparation) dhe shpërblimit ndëshkues (punitive damages).

Sipas autorit James Crawford, Raportuesi Special i emëruar nga Komisioni (1998 deri 2000), për të amenduar nenet e këtij ligji, argumenton se shteti ka përgjegjësi për një riparim të plotë të dëmit të shkaktuar, ku me dëm kuptohet si ai material dhe moral dhe se neni 31 nuk njeh asnjë lloj dëmi “ndëshkues”.<sup>378</sup>

Neni 31 me titullin “Riparimi” parashikon se “1. Shteti përgjegjës ka detyrimin të riparoj plotësisht për dëmin (injury) e shkaktuar nga veprime të paligjshme ndërkombëtarisht. 2. Dëmi (injury) përfshin çdo dëm (damages) si ai material dhe ai moral të shkaktuar nga veprimet e paligjshme ndërkombëtarisht të shtetit.” Vihet re se ka një kuptim më të gjërë fjala “injury” (ang. dëm) ku ndahet në damages (ang. dëm) moral dhe atë material. Sipas prof. Crawford ky nen duhet parë me kujdes jo vetëm në dallimin e termave të dëmit por edhe faktit se me dëm moral është synuar të përfshihet çdo lloj humbje jo materiale e cila mund të jetë e kompensueshme.<sup>379</sup>

Në kapitullin e II të Pjesës së Dytë të ligjit me titullin “Riparimi i dëmeve (Riparation of injury)” parashikohen disa forma të ndreqjes së dëmit të shkaktuar në mardhënie ndërkombëtare ndër shtetërore. Format kryesore të ndreqjes/riparimit të dëmit janë:

1. Kthimi i gjëndjes si më parë (Restitution) që nënkupton sipas nenit 35 “*të rivendos situatën e cila ka ekzistuar përpara se akti i padrejtë të ndodhte përveç:*
  - a. *kur ajo është e pamundur;*
  - b. *ose në krahasim me mënyrën e kompensimit, mënyra e kthimit ka më shumë shpenzime sesa përfitime.*”
2. Nëse dëmi nuk është ndrequr nëpërmjet kthimit, shteti sipas nenit 36 duhet të shpërblej, kompensoj financiarisht shtetin e dëmtuar në atë vlerë që ka dëmi duke përfshirë edhe fitimin e munguar deri në momentin kur ai të paguhet.
3. Nëse dëmi nuk është riparuar nëpërmjet kthimit apo kompensimit shteti përgjegjës për një akt ndërkombëtarisht të padrejtë detyrohet të jap kënaqësi (give satisfaction) shtetit të dëmtuar. Të japësh kënaqësi do të thotë sipas nenit 37§2 në njohjen e shkeljes, një manifestim keqardhje, një ndjesë formale ose një tjetër mënyrë të përshtatshme (R.M që kënaq “sedrën” e shtetit të dëmtuar). Gjithësesi kjo dhënie kënaqësie apo sadisfaksion sipas nenit 37§3 nuk duhet të jetë në shpërpjestim me dëmin dhe nuk mund të përbëj formë të poshtërimit për shtetin përgjegjës.

Sipas prof. Crawford i takon shtetit të dëmtuar që të zgjedh llojin e riparimit të dëmit që ai preferon, në fillim sugjerohet kthimi në natyrë e nëse kjo nuk është e mundur ose ka shumë shpenzime kalohet në një mënyrë tjetër më të favorshme siç është ajo e shpërblimit në të holla (kompensimit) dhe nëse kjo nuk kënaq pritshmëritë e shtetit të dëmtuar, kërkohet edhe forma tjetër e ndreqjes ajo e shpërblimit sadisfaksues si p.sh

<sup>378</sup> James Crawford “Articles on Responsibility of states for internationally wrongful acts”, United Nations, 2012, Faqe 5, [www.un.org/law/avl](http://www.un.org/law/avl), akses gusht 2016.

<sup>379</sup> Po aty faqe 5.

falje publike, pranimi i fajësisë etj.<sup>380</sup> Pra këto forma në disa raste paraqiten alternative të njëra-tjetrës dhe në disa raste paraqiten komplementare.

Gjithashtu përveç shpërblimit në të holla, me qëllim që të kemi një ndreqje, riparim të plotë gjithmonë paguhet edhe interesi i cili do të llogaritet me përqindjen dhe modalitetet që të arrihet qëllimi final. Interesi llogaritet që nga data kur detyrimi kryesor duhet të ishte paguar dhe deri në datën kur paguhet (neni 38).

Në përlllogaritjen e dëmit sipas nenit 39 të ligjit merren në konsideratë veprimet me dashje apo nga pakujdesia e vetë shtetit të dëmtuar ose të çdo personi fizik a juridik për të cilën kërkohet riparimi i dëmit.

Bashkë me këto ndreqje të dëmit sipas pjesës së dytë të ligjit, parashikohet se shteti i dëmtuar mund të marrë edhe kundërmasa (countermeasures) në mënyrë që të pushoj dhe të riparoj situatën e shkaktuar nga ana e shtetit përgjegjës. Këto masa të parashikuara nga neni 49 janë të përkohshme dhe kanë qëllim që të nxis shtetin që të përmbush detyrimet që rrjedhin nga pjesa e dytë e ligjit pra atë të riparimit të dëmit me kthim, kompensim apo shpërblim sadsifaksues.

Kundërmasat paraqesin disa specifika të cilët janë të parashikuara nga neni 49 deri 53 të përmbledhura si më poshtë:

1. janë të kufizuara në moskryerjen për momentin e detyrimeve ndërkombëtare të shtetit duke marrë masat në drejtim të shtetit përgjegjës;
2. janë të përkohshme;
3. duhet të jetë proporcionale me dëmin e shkaktuar, duke marrë parasysh rëndësinë e aktit të padrejtë ndërkombëtarisht, të drejtat në fjalë;
4. gjatë kësaj kohe shteti i dëmtuar nuk përmbush asnjë detyrim ndërkombëtar karshi shtetit përgjegjës;
5. duhet të respektojë detyrimet e marra sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara duke mos përdorur forcë ushtarake etj. apo detyrimet e tjera sipas normave të detyrueshme e së drejtës ndërkombëtare.
6. të respektojë paprekshmërinë e agjentëve diplomatike ose konsullore, lokalet, arkivat dhe dokumentet.
7. të ketë njoftuar paraprakisht shtetin e dëmtuar për kundërmasat që do ndërmerren nëse ajo nuk negocion ;
8. pushojnë kur veprimi i paligjshëm ndërkombëtarisht ka pushuar, apo çështja është në gjykim përpara një gjykate ndërkombëtare.
9. veprime të paligjshme që ndodhin jo në shkëlqje të normave ndërkombëtare por si pasojë e kundërmasave përjashtohen nga dëmshpërblimi sipas neneve 29 e në vijim të pjesës së dytë.

Vihet re se edhe në fushën e së drejtës ndërkombëtare publike, parimet dhe mënyrat e shpërblimit të dëmit në të drejtën administrative janë të njëjta. Megjithatë vihet re se shpërblime të tilla si ajo e deklaratës së sadsifaksionit, mënyrat e matjes së shpërblimit duhet të rregullohen në legjislacionin tonë në mënyrë po aq të detajuar sa edhe ligje të tjera ndërkombëtare që rregullojnë të njëjtin institut por në nivel ndërkombëtar. Po ashtu edhe kundërmasat që shteti i dëmtuar ndërmerr është një mënyrë që mund të parashikohet edhe për palën e dëmtuar në ligjin tonë në formën e mospagimit të detyrimeve të tjera që ky i dëmtuar mund t'i ketë organit përgjegjës. Në këtë mënyrë, ky i fundit nxitet që të ndreq pasojat e ardhura nga ana e veprimit a mosveprimit të paligjshëm.

---

<sup>380</sup> Po aty faqe 6.

## KREU VI VËSHTRIM KRAHASUES NDËRKOMBËTAR MBI PËRGJEGJËSINË JASHTËKONTRAKTORE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

### 6.1 Italia

#### 6.2 Franca

##### 6.2.1 Përgjegjësia me faj e organeve të administratës publike

##### 6.2.2 Përgjegjësia pa faj e organeve të administratës publike në Francë

#### 6.3 Gjermania

##### 2.4 Anglia

##### 2.5 Shtetet e Bashkuara të Amerikës

#### 6.6 Kosova

### 6.1 Italia

Në Republikën e Italisë, përgjegjësia e administratës shtetërore karshi të tretëve është e njohur në Kushtetutë (hyrë në fuqi më 01 janar 1948). Në nenin 28 të saj parashikohet se: *”Funksionarët dhe nepunësit e Shtetit dhe të institucioneve publike janë përgjegjës drejtpërdrejtë, sipas ligjeve penale, civile dhe administrative, për veprimet e kryera duke shkelur të drejtat. Në raste të tilla përgjegjësia civile shtrihet te Shteti dhe tek institucionet publike.”*<sup>381</sup>

Në Itali, përgjegjësia civile e administratës publike ndahet nga doktrina në përgjegjësi: 1) kontraktore, 2) parakontraktore dhe 3) jashtëkontraktore. Pra, kemi përgjegjësi të Administratës Publike për veprime të padrejta të zyrtarëve publik duke zhdëmtuar personin që ka pësuar nga ky veprim a mosveprim i padrejtë. Për rastet kur dëmi mund të jetë shkaktuar nga ana e nëpunësve apo funksionarëve të shtetit, mban përgjegjësi shteti apo institucionet publik ku ky nëpunës është i punësuar. Pra, njihet përgjegjësia solidare ndaj të dëmtuarit. Në çdo rast shteti mund ti kërkojë nëpunësit me padë regresi atë çfarë ka paguar të tretëve.

Kjo përgjegjësi nuk e përjashton nëpunësin nga përgjegjësia penale nëse fakti përbën veprë penale si p.sh në rastin e një shpërdorimi detyre apo nga përgjegjësia administrative duke pasqullë shkarkimin e tij nga puna.

Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Italisë, i miratuar me ligjin nr. 104/2010 i ndryshuar, parashikon në pikën 30 të saj se padia për përgjegjësinë administrative mund të ngrihet bashkë me një padi tjetër, si kërkim i veçantë ose për dëmin e ardhur nga ushtrimi i një veprimtarie të paligjshme administrative, për mos ushtrim të detyrës etj.

Në rastet e juridiksionit të veçantë<sup>382</sup> mund të kërkohet shpërblimi i dëmit *“për cenim të të drejtave, bazuar në parashikimet e nenit 2058 të Kodit Civil”*.

3. *Shpërblimi për cënim të interesave të ligjshme duhet të ngrihet brënda afatit prekluziv 120 ditë duke nisur nga momenti i ndodhjes së ngjarjes. Në përcaktimin e shpërblimit, gjyqtari vlerëson të gjitha rrethanat e faktit dhe sjelljen e palëve, duke*

<sup>381</sup> [http://www.didaweb.net/liste/002\\_ftp/Spaziolista/CostituzioneItaliana\\_trad\\_albanese.pdf](http://www.didaweb.net/liste/002_ftp/Spaziolista/CostituzioneItaliana_trad_albanese.pdf)

<sup>382</sup> Në librin V *“Dispozita të fundit”* në pikën 133 parashikohen si çështje të juridiksionit ekskluziv të gjyqtarit administrativ përveç parashikimeve të tjera edhe: a) mosmarrëveshjet e themelit si: 1) shpërblimi i dëmit të padrejtë e shkaktuar si pasojë e mosrepektimit me faj të kohës kur duhet të përfundonte proçesi administrativ. ...omissis ”

përrjashtuar shpërblimin e dëmeve që mund të shmangeshin me një përkujdesje të zakonshme, e provuar përmes mjeteve që parashikon ligji”.

4. Për shpërblimin e dëmit të mundshëm si pasojë e mosrespektimit të afatit të arsyeshëm të përfundimit të procesit administrativ, afat i parashkrimit nuk fillon sa kohë shkëlja vazhdon. Ky afat fillon gjithësesi pas një vit nga përfundimi i afatit të parashikuar.

5. Në rast se ishte ngritur një padi pavlefshmërie, kërkesa për shpërblim mund të bashkohet me të gjatë gjykimit, por jo më shumë se 120 ditë nga dita kur vendimi ka marrë formë të prerë.

6. Çdo kërkesë për shpërblim të dëmit gjykohen nga gjyqtari administrativ.”

U desh hyrja në fuqi e Kodit të procedurave Administrative në Itali që të parashikohet specifikisht e drejta dëmshpërblimit jashtëkontraktor nga ana e administrata publike. Deri atëherë kjo lloj përgjegjësie jashtëkontraktore nuk ishte aq e disiplinuar si në Shqipëri ku ekziston një ligj i veçantë si ai nr. 8510/1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore.” Por doktrina dhe jurisprudence Italiane kanë konkluduar në këtë mënyrë pas një sërë vendimesh gjyqësore.

Në fakt përpara këtij rregullimi ligjor nuk njihet e drejta e qytetarëve të kërkonin shpërblim të dëmit nga organet e administratës publike deri sa veprimi apo akti administrative që ka sjellë pasojën nuk ishte atakuar me vendimi gjyqësor të formës së prerë. Më pas të dëmtuarit i lindte e drejta për të kërkuar sipas nenit 2043 të KC shpërblim të dëmit si një gjykim civil.<sup>383</sup>

Një rast i cili ka ndryshuar jurisprudencën Italiane mbi këtë institut është Vendimi nr. 500/1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit në Itali. Deri në atë kohë, gjykata administrative mund të konstatonte pavlefshmërinë e një akti administrativ apo ta anulonte, por nuk shprehej për pasojat tek të tretët në mungesë të një bazë ligjore. Gjykata administrative nuk guxonte t’i referohej nenit 2043 të Kodit Civil<sup>384</sup> e cila njihet e drejtën e shpërblimit të dëmit pasuror pasi e konsideronte atë, si një dispozitë që rregullonte vetëm mardhëniet civile mes privatëve dhe nuk ishte lëndë e së drejtës administrative.

Me këtë vendim Gjykata e Kasacionit në Itali, njësoi praktikën se në rast kur dëmet kanë ardhur nga një akt administrativ i cili është anuluar si pavlefshëm nga vetë administrata apo gjykata, shteti mban përgjegjësi për dëmet e ardhura nga ky akt.

Në mënyrë të përmbledhur faktet e çështjes paraqiten si vijon: Me datë 01 prill 1996, Z.Giorgio Vitali padit në Gjykatën e Firences, Komunën e Fiesoles për shpërblim të dëmit për mos përfshirje të pronës së tij mes zonave ku do të ndërtohet sipas planit të përgjithshëm rregullues të Komunës (datë 16 korrik 1971). Në 1964, kjo pronë ishte e përfshirë në marrëveshjen e Menaxhimit nga organet publike lokale. Akti administrativ (plani rregullues) u anulua nga Këshilli i Shtetit (Consiglio di Stato) me vendimin e datës 22 janar 1990 pasi u vlerësua, se nuk ishte zbatuar Marrëveshja e vitit 1964. Si rrjedhim, marrëveshja duhet të shpërblente dëmet pasurore që janë shkaktuar shtetasve në zonën e ndërtimit.

Pas kësaj vendimarrje, Z.Vitali paditi Komunën duke kërkuar shpërblim për dëmin e shkaktuar pse prona e tij nuk ishte futur në zonën ndërtuese. Gjykata e Kasacionit unifikoi praktikën e deriatëhershme që një e drejtë e cila ishte cënuar nga një akt administrativ i anuluar si i pavlefshëm nga gjykata administrative, ka efekt

<sup>383</sup> Shih Conti S. “La responsabilità risarcitoria della pubblica amministrazione” datë 17 maj 2007, <http://www.amcorteconti.it/convegni/trento%20conti.htm>.

<sup>384</sup> Neni 2043- Shpërbimi i dëmit jashtëkontraktor “ Kushtdo që i shkaktonte me faj një dëm të padrejtë detyrohet të shpërblej atij që i ka shkaktuar dëmin”.



prapaveprues dhe legjitimon individin të kërkoj dëmshpërblim. Kjo ndryshe u quajt *legjitimitet nga e kundërta*. Individu mund të ngre padi përpara gjykatës administrative për shfuqizim të aktit, më pas tek gjykata civile për shpërblim dëmi apo rregullim të pasojave të tjera materiale.<sup>385</sup>

Gjykata arsyeton se deri në atë kohë, gjykatat kanë hezitur të shpërblejnë individin i cili është cënuar nga një akt administrative, i anuluar si i pavlefshëm me arsyetimin se ajo nuk përbën rast i cili mbrohet nga neni 2043 të Kodit Civil. Gjykata duhet të hetojë më thellësisht se cila ka qënë sjellja, qëndrimi subjektiv jo vetëm i punonjësit por edhe i administratës publike si aparat, që cënojnë parimin e paanshmërisë, përgjegjshmërisë, korrektesës dhe administrimit të mirë. Elementë të cilët mund ta ndihmojnë gjykatën civile në matjen e shpërblimit të dëmit.

Tashmë, me daljen e këtij vendimi si dhe me hyrjen në fuqi të KPRA në Itali, padia për shpërblimin e dëmit mund të kërkohe bashkë ose veçmas nga një proces administrative. I njëjti qëndrim vazhdohe të mbahet në jurisprudencë si p.sh në vendimin nr.204/2004 të Gjykatës Kushtetuese e cila u shpreh se nuk përbën zgjerim të juridiksionit të gjykatës administrative kur i kërkohe të shprehet edhe për riparimin e pasojave, shpërblimin e dëmit të pësuar nga një akt administrativ por ajo jep drejtësi qytetarit karshi administratës publike.<sup>386</sup>

Në Itali, mes juristësh kanë lindur debate nëse kjo lloj përgjegjësie përfshihet si përgjegjësi kontraktore apo përgjegjësi jashtëkontraktore, duke ndarë edhe Kolegjet e Gjykatës së Kasacionit në qëndrimin e tyre. Ka disa autorë si Marcho Machia, Alfredo Moliterni,<sup>387</sup> Prof. Rossana Summa<sup>388</sup> që mbrojnë idenë bazuar edhe në disa vendime gjyqësore Italiane se: *“përgjegjësia e administratës nuk është si përgjegjësi “aquiliane”, ku palët nuk kanë aspak lidhje të mëparshme me njëri-tjetrin*<sup>389</sup>. Në veçanti, në fushën e së drejtës së shpërblimit të dëmit, ka një mardhënie specifike mes administratës dhe qytetarit. Ky kontakt njihet si *“kontakti i veçantë shoqëror”* ose *“përgjegjësia e kontaktit”* e cila pasqyrohet tek sjellja e administratës, korrektesia, procedura administrative e deri në nxjerrjen e aktit administrative.<sup>390</sup> Pra qytetari ndodhet në një mardhënie me administratën publike, merr pjesë në procesin administrative, godet aktin administrativ për të rregulluar pasojat kontraktore mes qytetarit dhe administrates publike por jo jashtë kësaj përgjegjësie.

Ky grup juristësh argumenton se përgjegjësia aquiliane është tipike përgjegjësi civile dhe nuk haset në të drejtën administrative. Në vendimin e Gjykatës së Kasacionit nr. 157/2003 thuhet që: *“në mardhëniet që ka qytetari me administratën është e qartë që administrata ka një detyrim për të sjellë karshi qytetarit me paanësi, korrektësi bazuar edhe në vendimin nr. 500/1999 të KB të GJK. ... Për gjyqtarin civil, interesa të tillë si pjesëmarrja në procesin administrativ, për të marrë dokumente dhe akses në administratën publike, për të pasur vendimin e arsyetuar etj. përbën të drejtën subjektive të mbrojtur ... omissis.... Fenomeni klasik i njohur si cënimi i interesave legjitime përbën në realitet cënim të të drejtës për një padi administrative dhe përfshihet më shumë tek përgjegjësia kontraktore.”*

<sup>385</sup> Shih paragrafin 5.1§5 të vendimit nr. 500 datë 22 korrik 1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit në Itali.

<sup>386</sup> Shih Conti S. *“La responsabilità risarcitoria della pubblica amministrazione”* (2007) faqe 3.

<sup>387</sup> Machia M. dhe Moliterni A. *“La responsabilità civile della pubblica amministrazione”*- Giornale di diritto amministrativo 12/2014, faqe 1189, [www.academia.edu](http://www.academia.edu) akses janar 2015.

<sup>388</sup> Summa R., *“La responsabilità civile della P.A”*, leksion për *“Scuola di Specializzazione per la professione legale”*.

<sup>389</sup> Palët nuk janë të panjohur me njëri-tjetrin.

<sup>390</sup> Vendimi nr. 2642 datë 22 maj 2013 e Gjykatës Campania Napoli.

Një tjetër përgjegjësi e njohur tek administrata publike është edhe ajo parakontraktuale. Kjo trajtohet për analogji me përgjegjësinë parakontraktuale të palëve për tu sjellë me korrektesë dhe me mirëbesim karshi njëri tjetrit para se të finalizohet kontrata. Ky kriter i cili zbatohet dhe për administratën publike parashikohet në nenin 1337 të Kodit Civil me titull “Tratativat dhe përgjegjësia parakontraktuale” ku “*Palët, në zhvillimin e tratativave dhe në krijimin e kontratës duhet të sillen me mirëbesim.*” Në rast se një organ publik në Itali bën përpjekje me një palë tjetër për të lidhur një kontratë e cila rezulton e pasuksesshme për faj të shtetit pasi ka shkelur parimin e mirëbesimit, korrektesës etj. mbahet përgjegjësi për dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar palës tjetër. Praktika gjyqësore e ka orientuar kryesisht këtë rast tek skualifikimet e padrejta të shoqërive ofertuese në procedurat e prokurimeve publike.<sup>391</sup>

### **Elementët e dëmit jashtëkontraktor tek administrate publike në Itali trajtohen duke analizuar katër elementë:**

**-Fakti i paligjshëm:** Në përgjithësi pranohet në të drejtën Italiane se për të pasur përgjegjësi organet administrative duhet të provojnë se kanë vepruar me dashje apo pakujdesi të rëndë karshi individit dhe ky provon se ka pësuar një dëm në pasurinë apo të mirat e jetës (*bene della vita*). Po ashtu një rast tjetër ku administrata mban përgjegjësi është për shkak të vonesave në procedimin administrative me pasoja direkte në jetën e të dëmtuarit, jo vetëm në formën e ndonjë fitimi të munguar.<sup>392</sup>

**-Lidhja shkakësore:** Në kuadrin e lidhjes shkakësore *conditio sine qua non* mbahet përgjegjësi nga ana e organit administrative. Këshilli i Shtetit në vendimet e tij është shprehur se ndryshe nga lidhje shkakësore në të drejtën penale e cila kërkon domosdoshmërisht që veprimi i kryer nga i pandehuri të jetë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, në të drejtën administrative apo civile mbi përgjegjësinë aquiliane ekziston rregulli i mundësisë ose i më të mundëshmit (*preponderanza*), e cila nuk garanton siguri absolute për çdo dyshim të arsyeshëm. Nëse ka disa shkaqe të mundëshme që sjellin pasojën duhet të vlerësohen me kujdes rast pas rasti, pa u thjeshtëzuar tek parimi pesëdhjetë përqind plus një.<sup>393</sup>

**-Dëmet:** Në lidhje me llojet e dëmeve që mund të pësoj një individ nga veprimet e mosveprimet e administratës publike pranohen si nga legjislati, jurisprudenca dhe doktrina ai pasuror e parashikuar nga neni 2043 i KC dhe jopasuror e parashikuar nga neni 2059 i KC. Gjithësesi referuar edhe vendimit unifikues nr. 26972 datë 11 nëntor 2008 dhe vendimi nr. 18356 datë 19 gusht 2009 kërkohet që paligjshmëria e AP të jetë e tillë që të mos sjellë vetëm një shqetësim të dëmtuarit por fakti të përbëj një vepër penale.

Në rastet kur nuk përbën vepër penale, i dëmtuari mund të kërkoj shpërblim të dëmit jopasuror kur ligji shprehimisht e ka parashikuar si rast paligjshmërie, në rastet e diskriminimit, cënimit të të dhënave personale apo kur fakti ka dëmtuar rëndë të drejtat e patjetërsueshme, themelorë të njeriut, dhe në rastet që ligj ia lë në diskrecion gjykatës.<sup>394</sup>

<sup>391</sup> Shih vendimin nr. 1365 të 20 mars 2014 të Seksionit të Tretë të Këshillit të Shtetit, Vendimi nr. 9636 datë 12 maj 201 të Gjykatës së Kasacionit, Seksioni I, Itali.

<sup>392</sup> Vendimi nr. 4804 datë 28 shkurt 2014 të Gjykatës Kushtetuese të Italisë dhe vendimi nr. 318 datë 22 janar 2014 të Këshillit të Shtetit. Sipas nenit 100 të Kushtetutës, Këshilli është organ konsulence juridiko-administrative dhe mbikqyr gjykatat administrative apo procedurën administrative.

<sup>393</sup> Vendimet të Këshillit të Shtetit nr. 2708 datë 27 maj 2014, nr. 2195 datë 28 prill 2014.

<sup>394</sup> Machia M.dhe Moliterni A. “*La responsabilita civile della pubblica amministrazione*”- Giornale di diritto amministrative 12/2014, faqe Faqe 1198, [www.academia.edu](http://www.academia.edu) akses janar 2015.

-**Shpërblimi:** Vlen parimi i *parum integrale*, pra i shpërblimit të plotë njësoj sikur dëmi të mos kishte ndodhur. Në rastin e dëmit material vlerësohet e mira material e humbur në momentin e ndodhjes së ngjarjes, duke i shtuar vlerën sipas indeksit vjetor të INSTAT në rast se ka një investim konkret mbi këtë shumë, si p.sh në fushën e ndërtimit deri në momentin e dhënies së vendimit nga ana e gjykatës. Në rastin e dëmit jopasuror do merren parasysh matjet që bëhen nga praktika gjyqësore, lidhur edhe me rrethanat specifike të ngjarjes.<sup>395</sup>

---

<sup>395</sup> Po aty faqe 1198.

## 6.2 Franca

Franca është djepi i të drejtës administrative. Gjatë ekzistencës së monarkisë ekzistonte parimi se “Mbreti është shteti dhe shteti nuk bën gabime”. Përgjegjësia e shtetit ndaj veprime të padrejta të nëpunësve, funksionarëve u shfaq me ligjin e 17 shkurtit 1800 “Mbi ndarjen e territorit të Republikës dhe administratës». Ky ligj rregullonte për herë të parë këtë përgjegjësi, ku neni 4 parashikonte se: “ Këshilli i prefektuerës vendos për:

a) kërkesat e individëve që kanë të bëjnë me mbajtjen e taksave apo zvoglimin e kontributeve direkte.

b) Mbi vështërsite që mund të ngrenë kontraktuesit e punëve publike dhe administratës, lidhur me kuptimin apo zbatimin e marrëveshjes së tyre.

c) Mbi ankesat e individëve që mund të pësojnë dëme jashtëkontaktore dhe dëme të tjera shkaktuar nga veprime personale të sipërmarrësve dhe jo për faj të administratës.

d) Mbi kërkesat dhe mosmarrëveshjet që lidhen me kompensimin për shkak të shpronësimeve për të bërë rrugë, kanalet dhe vepra të tjera publike.

dh) Mbi çështjet që mund të ngrihen për rrugët kryesore.

e) Për mosmarrëveshjet mes komunitetit të qyteteve urbane, rurale dhe fshatrave etj.

ë) Mbi mosmarrëveshje të tjera shtetërore.”<sup>396</sup>

Konstatohet se përgjegjësia e administratës përsëri nuk ishte aq e gjërë sa sot. Fillimisht është njohur e drejta Këshillit të Prefekturës që të gjykojë mbi ankesat e individëve për dëmet e pësuar nga sipërmarrësit e punëve publike të kontraktuar nga ana e prefekturës si p.sh personat që merren me ndërtimin e rrugëve, kanalet etj. Akoma nuk njihet përgjegjësia direkte e organeve, nëpunësve shtetëror francez ndaj qytetarëve.

Sipas Dr. Kristo Floqit tek botimi “Administrata ose e drejta Sundimore” ai përshkruan se në Francë njihet përgjegjësia e komunave si organe administrative lokale për veprime që kanë karakter penal si p.sh prej njerëzve të armatosur kur kanë shkaktuar dëm individëve, pasurisë shtetërore, komunare etj. Megjithatë Dr. Floqi shpjegon si ndahet përgjegjësia dhe shpërblimi për dëmin, citojmë:”Shumën e të hollave që buron prej dëmeve të shkaktuara në qarkun e komunës për të cilët është e përgjegjshme komuna, pjestarët ndajnë analogjisht në mest tyre. Në tjetrën anë komuna ka të drejtë të heq në gjyq fajtorët e vërtetë edhe shkaktarët e dëmeve edhe të lyp shpërblim.” Në vazhdim Dr. Floqi shpjegon se komuna mund të shkarkohet nga përgjegjësia kur provon se kishte marrë të gjitha masat për të kapur fajtorët dhe i ka identifikuar ata, kur dëmi ka ardhur si dëm lufte apo kur dëmi është shkaktuar nga policia vendore, e cila nuk është nën varësi të kryetarit të komunës.<sup>397</sup>

### 6.2.1 Përgjegjësia me faj e organeve të administratës publike

Një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe praktika gjyqësore në konsolidimin e konceptit të përgjegjësisë jashtëkontaktore kësisoj, ashtu si edhe në shtetet të tjera mund të thuhet se jurisprudenca ka projektuar përmbajtjen e këtij instituti deri në ligjet aktuale. Vendimi Blanco, datë 8 shkurt 1873 i Këshillit të Shtetit, për herë të parë diskuton të drejtën e qytetarit për tu shpërblyer nga veprimet e padrejta të nëpunësve të administratës publike.

<sup>396</sup> <https://www.legifrance.gouv.fr>, akses maj 2016.

<sup>397</sup> Kristo Floqi “Administrata ose e drejta sundimore”, Pjesa e përgjithshme, Shtypshkronja “Vlora”, Vlorë, (1923) faqe 334.

Vogëlushja 5 vjeçare Anjeza Blanco, goditet dhe plagoset rëndë nga vagonat e duhanit të drejtua nga katër puntor të Ndërmarrjes së Duhanit të Bordos, të cilët po kalonin rrugën që ndante magazinat e grumbullimit.

I ati i fëmijës, padit në Gjykatën e Bordos sipas nenit 1382 të Kodit Civil<sup>398</sup> të katër puntorët që shkaktuan drejtëprdrejtë plagosjen e vajzës dhe ndaj Shtetit si përgjegjës për sjelljen e punonjësve të tij, duke kërkuar dënimin e puntorëve dhe shpërblimin solidar të tyre dhe shtetit në shumën 40 000 Franga.

Gjykata Civile me vendimin e 17 korrikut 1872 deklaroi moskompetencën lëndore (mungesë juridiksioni) për të gjykuar veprimet e punonjësve dhe të shtetit si të paparashikuar në Kodin Civil. Debatu u përqëndua mes juridiksionit civil apo administrativ dhe të drejtës së qytetarit për tu shpërblyer për dëmet e pësuar nga një fakt i paligjshëm i administratës sipas nenit 1382 të Kodit Civil, në mungesë të një ligji tjetër.

Ky debat vazhdoi edhe mes Gjykatës së Kasacionit dhe Këshillit të Shtetit në Francë ku qëndrimi i tyre ishte i qartë se gjykata e zakonshme (civile) nuk ka kompetencë lëndore për të gjykuar paditë për dëmet jashtëkontraktore të qytetarëve karshi shtetit apo nëpunësve të saj.

Problemi qëndonte se për të tillë padi kush do ishte organi kompetent. Gjykata e Mosmarrëveshjeve<sup>399</sup> në 1851 pas një analize të çështjes nëse të punësuarit që kanë shkaktuar dëmin në kohën e punës, brënda kompetencave të tyre përfundimisht vendosi se kjo mosmarrëveshje është lëndë e gjykatave administrative, të cilët deri në atë kohë nuk ekzistonin.<sup>400</sup> Gjykata në fund të arsytimit shprehej se: *“Duke e konsideruar përgjegjësinë që i takon shtetit për dëmet e shkaktuar të tretëve nga të punësuarit e tij në shërbimin publik, nuk mund të rregullohet nga parimet e Kodit Civil për mardhëniet individ-individ. Kjo përgjegjësi nuk është as e përgjithshme dhe as absolute, ajo ka rregullimet e saj të veçanta që ndryshojnë sipas nevojave të shërbimit, të drejtave të shtetit dhe të privatëve që vetëm pushteti administrative mund t’ua njoh.”*

Pas këtij qëndrimi në shumë ligje të tjera pasuese si “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” 16 gusht 1790<sup>401</sup>, Ligji i 27 prill deri 25 maj 1971 “Për organizimin e ministrive” parashikohej një ndarje mes gjykimit të çështjeve administrative dhe çështjeve të tjera gjyqësore.

Kushtetuta e Republikës Franceze e miratuar me datë 4 tetor 1958 është shumë parimore dhe nuk e përmban ndonjë kapitull mbi të drejtat dhe liritë themelore të individëve. Kësisoj nuk është e parashikuar e drejta e individit për tu shpërblyer nga veprimet e padrejta të administratës publike, ndryshe nga Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë apo të Italisë. Por ajo është e parashikuar në Kodin e Drejtësisë Administrative në nenin 312 deri 314 ku parashikohet se: *“Padia mbi përgjegjësinë e krijuar jo nga një kontratë apo kuazi kontratë civile ndaj shtetit, nga persona të tjerë publikë ose organizma private që kryejnë shërbim publik mund të ngrenë padi:*

1. Kur dëmi mund të vijë si rezultat i një vendimi gjyqësor administrativ, në këtë gjykata administrative;

<sup>398</sup> Neni 1382 Kodi Civil francez *“Çdo person që i shkakton tjetrit një dëm, detyrohet ta shpërblejë dëmin e ardhur për faj të tij”*—Code Civil “éditions Dalloz 1995-96, 11 rue Soufflot, 75240 Paris.

<sup>399</sup> Gjykata e Mosmarrëveshjeve (Le Tribunal de Conflicts) është e përbërë nga antarë të Gjykatës së Kasacionit dhe të Këshillit të Shtetit dhe gjykon rastet e mosmarrëveshjeve të kompetencës dhe juridiksionit mes organeve të administratës publike apo të gjykatave të ndryshme me njëra-tjetrën. <http://www.tribunal-conflits.fr/>, akses janar 2016.

<sup>400</sup> Komente mbi vendimin Blanco.

<sup>401</sup> Neni 13 *“Funksionet gjyqësore janë të ndara një herë e përgjithmonë me funksionet administrative ... dhe nuk mund të gjykojnë veprimet e aparatit administrativ për shkak të detyrës së tyre”*

2. Dëmi i shkaktuar vjen nga një punë publike ose i shkaktuar nga një aksident i transportit ose nga një veprim administrativ, kompetente është gjykata ku ka ndodhur dëmi .
3. Në të gjitha rastet, është kompetencë e gjykatës administrative ku ndodhet banesa e shkaktuesit ose vendbanimi a selia e të parit shkaktues i rënditur në padi.”

Po ashtu, përveç njohjes së përgjegjësive së administratës publike janë parashikuar edhe përgjegjësia e shtetit për dëmet e ardhura nga tubimet dhe mitingjet (neni r811-10-1 pika 3), përgjegjësia e shtetit për zgjatjen e paarsyeshme të procedurës përpara juridiksionit administrativ (neni r311-1 pika 5).

Në fakt doktrina dhe jurisprudenca njeh dy lloj përgjegjësi të administratës publike ndaj qytetarëve: ajo kontraktore dhe ajo jashtëkontraktore. Kjo e fundit ndahet bazuar tek vendimi i Gjykatës së Mosmarrëveshjeve datë 30 korrik 1873 (rasti Pelletier) në përgjegjësi të administratës nga shërbimet e saj dhe përgjegjësi personale e punonjësve. Qytetari në këto raste mjafton të provoj se ka një lidhje shkakësore mes dëmit të ardhur dhe veprimeve apo mosveprimeve të administratës. Kjo e fundit prezumohet se ka faj dhe i kalon barra e provës të provoj se nuk ka pasur përgjegjësi apo fakti ka ndodhur për një rast faktor etj.

1. **Përgjegjësia e shërbimeve të administratës** në vetvete ndahet në përgjegjësi me faj të rëndë dhe përgjegjësi me faj normal (të thjeshtë)<sup>402</sup>. Ajo mund të haset në formën e :

- a. dëmeve që shkaktohen nga përdorues të veprave publike të ndërtuara nga shteti si p.sh rrugët, pallatet dhe materialet me të cilat ai ka ndërtuar etj. Në vendimin e 14 mars 1980, Këshilli i Shtetit në çështjen e Komunitetit të Bordos u shpreh se: “M.Garry mbeti viktime me datë 20 korrik 1976, në orën 17.15 kur po ngiste motorçikletën. Ai hasi në një lëng mazuti (vaj i trashë i papërpunuar) të pa pastruar nga punojesit e Bashkisë e Bordosë duke mos vendosur as shenja kujdesi. Për faktin e ndodhur qytetarit, nuk i ngarkohej ndonjë veprim a masë që ai nuk e kishte realizuar, dëmi ishte faj i drejtëpërdrejtë i Bashkisë prandaj është tërësisht përgjegjëse ndaj viktimës”.
- b. Tjetër përgjegjësi që shkaktohet nga shërbimet publike është ajo nga shërbimet mjeksore, të zjarrfikseve, policisë etj. Edhe këtu, kërkohet që administrata përkatëse të ketë vepruar me faj të rëndë si p.sh kur për faj të veprimeve të mjekut, infermierit etj. personi humbet jetën, pëson paralizë, sëmuret me sëmundje infektive si HIV/AIDS etj. mban përgjegjësi spitali përveç kur provon se operacioni ishte ekstremisht i vështirë dhe pasoja mund të ndodhte edhe në një spital privat apo në rast fakteq.

Megjithatë me çështjen *Epoux V., të Këshillit të Shtetit datë 10 prill 1992* rasti u interpretua se : “Duke marrë parasysh gabimet e shkaktuar sipas raportit të ekspertizës që passollën aksidentin e ndodhur tek Znj. V, përbën një gabim mjeksor për të cilën duhet të mbaj përgjegjësi spitali ,prandaj Z. dhe ZNj. V. legjitimohen që të kërkojnë ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Ruenit që rrëzoi pretendimet e tyre.” Pas kësaj date përgjegjësia nga mjekimi përfshihet edhe përgjegjësi me faj të thjeshtë dhe jo detyrimisht si përgjegjësi me faj të rëndë të institucioneve mjeksore. Po ashtu edhe përgjegjësia e organeve të institucioneve penitenciare karshi të burgosurve,

<sup>402</sup> Shih Gjykatën e Konfliktëve në 1873, e cila për herë të parë bën këtë ndarje.

të paraburgosurve për dëmin që u ndodhte në shëndet, humbje të jetës etj. (*shih vendimin e datës 23 maj 2003 e Këshillit të Shtetit, rasti Chabas*).<sup>403</sup>

2. Ndërsa përgjegjësia personale e punonjësit të administratës ndahet në tre lloje:

- a. Kur punonjësi është gjatë orarit të punës, por kryen dëmin për veprimet e tij personale që nuk kanë lidhje fare me detyrat normale në punë por janë veprime të pakujdesshme apo me vetbesim të tepruar të tij që passjellin faktin e paligjshëm. Interesante për ilustrim paraqitet vendimi i Këshillit të Shtetit, datë 18 nëntor 1949, (Rasti i Znjsh. Mimeur) ku e dëmtuara kërkonte të shpërblehej për dëmin e shkaktuar nga kamioni i ushtrisë franceze, ku ushtari Desertenne humbi kontrollin dhe goditi me kamion murin e saj. Në këtë rast Minsitria e Mbrojtjes refuzoi të paguante dëmin me arsyetimin se itinerari i drejtuesit të mjetit ishte tjetër, por kishte zgjedhur të kalonte në rrugë më të gjatë që të takonte familjarët e tij. Këshilli e konsideroi shoferin Desertenne personalisht përgjegjës për dëmin e Znjsh. Mimeur.
- b. Kur personi është gjatë orarit të punës dhe kryen veprime keqdashëse ose me një pakujdesi të rëndë, të pajustificuar apo kur kryen veprime të ndaluara. Për ilustrim paraqitet vendimi i Këshillit të Shtetit, datë 12 prill 2002, *çështja M.Papon*, ku nisur nga faktet e pranuar në vendimin penal Z. Papon në cilësinë e sekretarit të Përgjithshëm të Prefekturës së Girondës nga 1942-1944 ka ndikuar aktivisht në arrestimin dhe internimin e 76 hebrenjëve të deportuar më pas në Aushvic ku atje u gjetën të vdekur. Në analizë të detyrave të tij, ky veprim nuk ishte kryer si shërbim i organeve shtetërore por ishte një sipërmarrje individuale e të paditurit pa ndonjë urdhër të eprorit të tij. Prandaj këto veprime të kryer zbatim të urdhërave të dhëna nga pushtuesi gjerman, përbënin përgjegjësi personale të Z.Papon karshi jetës së hebrenjëve dhe fëmijëve të tyre, të vendosur pas deportimit të prindërve në disa familje franceze. Për këtë fakt, detyrimi i tij për shpërblimin e dëmit civil për familjaët e viktimave ishte në masën 719 559 euro. Fajësia e të cilit u bazua tek vendimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda të Gironde datë 12 prill 1998 ku Z.Papon u dënua me dhjetë vjet burgim dhe dhjetë vjet punë në shërbim publik.

Në çështjen Thepaz të Gjykatës së Mosmarrëveshjeve datë 14 janar 1935 ushtari Mirabel duke synuar të shmangte një automjet të autokolonës ushtarake, godet një çiklist që kalonte aty pranë (paditësin Thepaz). Ushtari u dënua nga Gjykata e Disiplinës sipas nenit 320 të Kodit Penal Ushtarak, me gjobë 25 franga dhe shpërblim të familjarëve të viktimës në masë 7000 Franga. Në gjykatën e Apelit të Chambery, paditësi pretendoi të zëvendësohej i padituri civil me vetë shtetin por gjykata vlerësoi se kjo është përgjegjësi personale.

- c. Veprime që punonjësi i kryen jashtë orarit të punës ose i ka shkëputur mardhëniet me punën në momentin kur ndodh ngjarja, konsiderohet si një qytetar i thjeshtë.<sup>404</sup>

<sup>403</sup> <http://www.conseil-etat.fr/fr/base-de-jurisprudence>.

<sup>404</sup> Augustine Mpressa, Lucile Stahl, Elise Untermaier "La Responsabilité Administrative Pour Faute", 30 Mars 2009, Seminar virtual, Universiteti Lionit 3.

Vendime të Këshillit të Shtetit të 13 mars 1998, 29 prill 1998 ku Këshilli njohu përfundimisht përgjegjësinë me faj të thjeshtë të administratës publike dhe jo më me përgjegjësi të rëndë për veprimet që kryejnë karshi të tretëve.

## 6.2.2 Përgjegjësia pa faj e organeve të administratës publike në Francë<sup>405</sup>

Kjo përgjegjësi është një prodhim i jurisprudencës në Francë. Ndryshe nga përgjegjësia me faj që mban administrata publike për shkak të organeve të saj apo të punonjësve të saj në rastin konkret, administrata mban përgjegjësi pa pasur faj. Për herë të parë ky koncept u elaborua nga *Këshilli i Shtetit në vendimin e datës 21 qershor 1895*, ku shtetasi Cames duke punuar për të rregulluar artlerinë e ushtrisë së Tarbes, u godit nga një çekiç dhe pësoi atrofi në dorën e majtë duke humbur aftësinë për të punuar. Këshilli i Shtetit gjykoi padinë për një dëmshpërblim më të madh për shkak të humbjes së aftësisë për punë. Në këtë rast duke qënë se asnjëra prej palëve nuk kishte faj në dëmin e ardhur dhe në mungesë të skemës së sigurimeve shoqërore, u vendosi që shteti të shpërblej punonjësit që punojnë në veprimtari të rrekzishme kur kanë pasoja në shëndet, jetë etj.

- Përgjegjësia e administratës pa faj përbëhet nga përgjegjësia për shkak të riskut e themeluar si koncept nga vendimet më të rëndësishme të përgjegjësive administrative. *Vendimi Regnault-Desroziers i Këshilli i Shtetit, datë 28 mars 1919*, paraqet rastin kur gjatë luftës së parë Botërore, ushtria franceze depozitoi në qytetin Saint-Denis në veri të Francës, municion dhe granata të shumta për të dërguar ato më shpejt në front. Më 4 mars 1919, një shpërthim aksidental ndodhi në deponë e municionit duke shkatërruar plotësisht qytetin dhe duke pasjell një dëm të konsiderueshëm. Këshilli anuloi vendimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe njohu të drejtën për tu shpërblyer banorët e zonave përreth pasi sjellia e ushtrisë përmbante elementë me rrezik që kalojnë kufijtë e fqinjësisë.

Kjo përgjegjësi ndahet në dy nënloje:

1. Për shkak të rrezikut që vjen nga një veprim, send apo metodë e rrezikshme e njohur ndryshe si bashkëpunëtor profesional apo rastësor.
2. Përgjegjësia për shkak të riskut të krijuar nga të punësuarit e administratës, si
  - 1) përgjegjësia për shkak të një aksidenti rrugor në transportin publik,
  - 2) përgjegjësia për shkak të kurimit të një sëmundje të rrezikshme ose duke përdorur metoda të rrezikshme. *Këshilli i Shtetit në vendimin Bianchi nr. 69336 datë 9 prill 1993* shpërbleu paditësin në shumën 1 500 000 Franga për shkak të mostrajtit të arterografisë vertebrale para dhe post-operacionit nga një përrsoneli mjekësor në Spitalin e Timone, Marsejë. Këshilli vlerësoi se shteti mban përgjegjësi si për dështimin e operacionit ashtu edhe për mos përmisimin e gjëndjes së pacientit,
  - 3) rreziqet e krijuara nga të tretët që aksidentalisht pësojnë dëm nga administrata si p.sh nga sende, metoda, situata të rrezikshme apo dëmet aksidentale që vijnë nga punët publike. Në këtë nënloj përfshihen dëmet e shkaktuara nga lëndët shpërthyesë, nga energjia bërthamore, dhe përgjegjësia që vjen nga një rast përjashtimor rreziku.

Në rastin *Thouzellier, Këshilli i Shtetit në vendimin e datës 3 shkurt 1956*, deklaroi përgjegjëse institutin Publik Arsimor « Anian » që në një shëtitje në fshat, u kishin shpëtuar nga vëzhgimi dy të rinjë, të cilët kishin vjedhur banesën e Thouzellier.

6. Rasti i dytë i përgjegjësive pa faj është në rast të shkeljes së parimit të trajtimit të barabartë të personave nga organet publike ku përfshihen:

1. [Përgjegjësia që vjen nga aktet normative si nga ligji, nga konventat ndërkombëtare, aktet administrative etj.](#) për shkak të një dëmi të veçantë apo të moszbatimit të një akti normativ. *Në çështjen Komuna e Gavarnier, datë vendimi 22 shkurt 1963*,

<sup>405</sup> Sevgili Gençay F.D, “*Les Regimes Legislatifs De Responsabilite Administrative En France*”, Gazi Üniversitesi Hukuk Fakültesi Dergisi C. Xix, Y. 2015, Sa. 2, faqe 246.



vendimi i Kryetarit të Bashkisë për të ndryshuar itinerarin e rrugëve i kishte sjellë dëm shtetasit Z.X i cili në rrugën e vjetër kishte dyqan suveniresh që bliheshin nga drejtuesit e makinave, udhëtarët e tjerë. Me ankimin e tregtarit, Gjykata Administrative e kishte anuluar vendimin e Kryetarit të Bashkisë. Këshilli i Shtetit vlerësoi se ky veprim i organit administrativ edhe pse i ligjshëm, i ka sjellë dëm qytetarit duke e trajtuar atë në mënyrë të padrejtë e duke i sjellë dëm në aktivitetin e tij e për këtë asye ai duhet shpërblyer.

2. Rast tjetër është përgjegjësia pa faj e administratës për moszbatim të akteve normative të cilat nuk zbatohen për të mbrojtur interesin publik. Në rastin Couitéas, Këshilli i Shtetit me vendimin datë 20 nëntor 1923 vendosi të mos zbatoj një vendim gjyqësor ku ishte njohur pronësia Z.Couiteas për 38 000 hektar në Tunizi dhe kërkonte ekzekutimin me forcë, qoftë edhe me ndërhyrje ushtarake të dëbimit të 8000 personave autoktonë. Shteti refuzoi të zbatoj këtë kërkesë për të mos cënuar interesin e përgjithshëm të 8000 personave përkundrejt të drejtës së pronësisë së paditësit të cilit iu njoh e drejta për kompensim financia nga shteti.
3. Përgjegjësia nga dëmet e përheshme që vijnë nga veprat publike. Në çështjen nr.172915 datë 18 nëntor 1998, Këshilli i Shtetit<sup>406</sup> e gjeti të drejtë pretendimin e Shoqërisë « Shtëpitë e Sofies» dhe Z dhe Znj.X për dëmet që i vinin nga ndërtimi i autostradës dhe e lotit nr. 46 në Lion. Paditësit pretenduan se punimet dhe përfundimi i autostradës në të ardhmen i kishin sjellë humbje të konsiderueshme krahasuar me fitimet e mëparshme duke penguar klientelën që të hynte në dyqanin e tyre, apo të shikonin mallrat në vitrinë dhe humbjen e klientëve potencial në ardhmen. Për Këshillin ky dëm i përhershëm që u shkaktonte shoqërisë dhe bashkëshortëve X. përbënte një dëm të përhershëm nga veprat publike prandaj detyroi Autoritetin Rrugor t'i shpërblentë në shumën 1 300 000 Franga.

---

<sup>406</sup>[https://www.legifrance.gouv.fr/affichJuriAdmin.do;jsessionid=502BD606F83E4EB1368AEE0869F19CB.tpdjo03v\\_1?oldAction=rechExpJuriAdmin&idTexte=CETATEXT000007981218&fastReqId=4139045&fastPos=7](https://www.legifrance.gouv.fr/affichJuriAdmin.do;jsessionid=502BD606F83E4EB1368AEE0869F19CB.tpdjo03v_1?oldAction=rechExpJuriAdmin&idTexte=CETATEXT000007981218&fastReqId=4139045&fastPos=7)

### 6.3 Gjermania

Në ligjin themelor të Republikës Federale të Gjermanisë (*Grundgesetz*), miratuar më 23 maj 1949 parashikohet si një e drejtë themelore e qytetarit, shpërblimi për veprimet e padrejta të kryera nga nëpunësit e administratës publike.

Në nenin 34 me titull "Përgjegjësia për shkeljen e një detyre administrative" mbi organizimin e Federatës dhe Landeve parashikohet "*Çdo person, që në ushtrim të detyrave të tij publike, shkel detyrën përkundrejt të tretëve, përgjegjësia parimisht i takon shtetit ose organit publik që e ka punësuar atë. Në rast të një shkelje me qëllim ose të një neglizhence të rëndë, nga një organ publik, njihet e drejta e padisë drejtëpërdrejt tek nëpunësi publik. Gjykatat mund të trajtojnë edhe ankimet për kompensim apo shpërblim.*"

Në nenin 74 të Ligjit Themelor parashikohet ndër të tjera se: "*Pushtete të tjera jo legjislative mund ti shtrijnë kompetencat e tyre, duke miratuar: 1. Ligje civile, penale,, organizimin e gjykatës dhe procedurat gjyqësore (përveç ligjin mbi masat e sigurimit personal), profesionet e lira si, noterine dhe këshillimin ligjor...*

*25. përgjegjësinë e shtetit. ...*

*6. Ligjet mbi pikën 25 dhe 27 të paragrafit 1 kërkojnë edhe miratimin e Bundesratis<sup>407</sup>"*

Përveç kësaj në kreun e parë mbi të drejtat themelore të qytetarëve parashikohet e drejta e ankimit (padisë) në nenin 17 ku çdo person ka të drejtën që personalisht apo bashkë me të tjerët, ti drejtohet me kërkesë me shkrim ose gojarisht organeve kompetente apo legjislatorit. Ndërsa në nenin 19 parashikohet kufizimi i të drejtave themelore dhe shpërblimi i tyre :"*1) Për sa kohë që, sipas Ligjit Themelor, një e drejtë bazike mund të kufizohet si rrjedhojë e një ligji, ky duhet të zbatohet për të tërë dhe jo vetëm për një rast. Po ashtu, ligji duhet të specifikoj të drejtën themelore që preket dhe nenin që parashikon. 2) Në asnjë rast thelbi i të drejtës nuk duhet të preket. 3) Të drejtat themelore mund të zbatohen gjithashtu edhe tek personat juridik për aq sa natura e tyre e lejon. 4) Nëse një e drejtë e personit shkelet nga një autoritet publik, ai ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës. Nëse nuk është krijuar një gjykatë e veçantë, kompetente është gjykata e zakonshme. Fjalja e dytë e paragrafit 2 të nenit 10<sup>408</sup> nuk preket nga ky paragraf."*

Në krahasim me Kushtetutat e tjera, Gjermania e parashikon në mënyrë më të detajuar të drejtën e shtetasit për të kërkuar shpërblim në rast se çënohet nga veprime a mosveprime të padrejta të administratës publike dhe punonjësve të saj.

Ligji më i rëndësishëm të drejtës administrative në Gjermani është *Verwaltungsverfahrensgesetz (VwVfG)* ose Ligji i Proçedurës Administrative i miratuar më 25 Maj 1977. Në nenin 79 parashikon se gjykimet për shpërblimin e dëmit që vjen nga një akt administrativ rregullohen nga Kodi i Proçedurës së Gjykatës Administrative dhe legjislacioni shtesë i saj përveç kur këto ligje parashikojnë ndryshe. Ndërsa në Kodin e Proçedurës së Gjykatës Administrative në nenin 40 të saj rregullohet kompetenca lëndore e çështjeve ku: "*çështjet e gjykatës administrative janë ato me*

<sup>407</sup> Bundesrati është një organ legjislativ, i cili përmbledh përfaqësues të 16 landeve të Republikës Federale të Gjermanisë.

<sup>408</sup> Neni 10- E drejta e korrespondencës, postës dhe e telekomunikacionit:" E drejta e fshehtësisë së korrespondencës, postës dhe e telekomunikimeve është e padhunueshme.2) Kufizimet bëhen vetëm kur janë të parashikuara në ligj. Nëse kufizimi shërben për të mbrojtur rendin e lire e demokratik apo ekzistencën apo sigurimin e Federatës apo të një Landi, ligji mund të parashikoj që personi nuk mund të informohet për kufizimin dhe e drejta për t'ju drejtuar gjykatës mund të zëvendësohet me rishikimin e rastit nga agjenci apo agjenci të posaçme të krijuara nga legjislatori".

karakter publik dhe që nuk janë në kompetencë të ndonjë gjykate tjetër sipas ligjit federal. Mosmarrëveshjet të të drejtës publike në fushën e pronës i takojnë një tjetër gjykate sipas përcaktimeve të bëra nga ligji i Landit.

2) Paditë për çështje të shpërblimit për shpronësim dhe për sigurimet shoqërore ashtu si edhe paditë për kompensim për shkelje të detyrimeve jo kontraktore të organeve publike, ashtu si mosmarrëveshjet mbi shpronësimin publik dhe masën e kompensimit sipas nenit 14§1, fjalia e dytë e Ligjit Themelor (Grundgesetz).<sup>409</sup>

Parashikimet e veçanta për shërbimin civil gjithashtu ato mbi padinë për kompensimin e cënimit të pasurisë për shkak të anulimit të një akti administrativ të paligjshëm, do të mbetet i paprekur”

Ajo çfarë vlen të theksohet është se përgjegjësia e organeve administrative publike përkundrejt shtetasve ndryshe nga shumë shtete të tjera, në Gjermani parashikohet në kapitullin mbi dëmin jashtëkontraktor (Titulli 27) në Kodin Civil (1 janar 1900).

Neni 839 të KC parashikohet se: “1) nëse një zyrtar, nëpunës me dashje apo nga pakujdesia shkel detyrat që i janë caktuar përkundrejt të tretëve, duhet të kompensoj atë për çdo dëm<sup>410</sup> të ardhur. Nëse pakujdesia i ngarkohet nëpunësit, ai mund të ketë përgjegjësi vetëm nëse i dëmtuari nuk mund të kompensohet në mënyrë të tjera.

2) Nëse ndonjë nëpunës shkel një nga detyrat e tij, ai nuk do të jetë përgjegjës për dëmet që vijnë kur shkelja e detyrës nuk përbën një vepër penale e cila rregullohet nga ligji. Ky parashikim nuk zbatohet në rast kur shkelja e detyrës përbën refuzim apo vonesë në ushtrim të detyrës.

3) Detyrimi për të kompensuar nuk ngrihet kur i dëmtuari me dëshirë ose nga pakujdesia ka harruar të kërkoj shpërblimin”.

Ky nen në ndërthurje me nenin 34 të Ligjit themelor (1958) përbëjnë kornizën ligjore të të drejtës objektive të përgjegjësisë së shtetit për dëmin jashtëkontraktor që shkaktojnë administrata apo nëpunësit e saj. Pra kërkohen kumulativisht që të ekzistojnë elementet e nenit 34 të Ligjit themelor dhe të nenit 839 të KC:

- Subjekti është nëpunësi,
- Dëmi të jetë kryer gjatë ushtrimit të detyrës;
- Në ushtrim të vullnetit shtetëror;
- Me pasojë shkeljen e detyrave që ligji apo akt tjetër i ka caktuar;
- Dëmi ka ardhur drejtpërdrejtë individit të dëmtuar;
- Sjellja e nëpunësit të jetë me faj: dashje apo nga pakujdesia;
- Ekzistenca e lidhjes shkakësore mes shkeljes së detyrës nga nëpunësi dhe dëmit pasuror dhe jopasuror të shkaktuar;
- Ardhja e një pasoje, e cila është dëm në jetën, fizikun, shëndetin, pasurinë, dinjitetin e të dëmtuarit, lirinë personale, paprekshmërinë seksuale.<sup>411</sup> Dëmi kështu në Gjermani është pasuror dhe jo pasuror;

<sup>409</sup> Parashikohet që paditë për kompensim të padrejtë për shpronësim publik të bëra nga shteti, gjykohen nga gjykatat e zakonshme.

<sup>410</sup> Kuptimin e dëmit e jep neni 823 -“Mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore” -i KC Gjerman ku parashikohet: “1) një person i cili me qellim ose nga pakujdesia, dëmton në mënyrë të paligjshme jetën, trupin, shëndetin, lirinë, pronën apo të drejtë tjetër të tij është i detyruar të kompensoj dëmet shkaktuar palës tjetër.

2) Të njëjtën përgjegjësi ka edhe personi i cili shkel detyrën që ka për të mbrojtur personin tjetër. Nëse, sipas përmbajtjes së detyrës (llojit të punës shën. R.M) dëmi mund të vij edhe pa faj atëherë përgjegjësi për kompensim do ketë vetëm për dëm me faj.”

<sup>411</sup> Shih nenit 253§2, 839, 847 të Kodit Civil të RFGJ.

- Gjykata civile mund të vendos kompensimin monetar të dëmit si pasuror, ashtu dhe jopasuror pasi në të tillë rastesh shpërblimi në natyrë është i vështirë. Nëse gjykatat administrative mund të detyrojnë organin administrativ të nxjerr një akt që rikuperon situatën, gjykatat civile trajtojnë vetëm shpërblimin e dëmit të ardhur tek i dëmtuari nga një akt administrativ i padrejtë i autoritetit publik.<sup>412</sup>
- Kusht tjetër për përgjegjësinë jashtëkontraktore janë :1) të mos jetë shpërblyer për dëmin nga një person i cili është bashkëdebetor me organet publike (neni 839§2 i KC të RFGJ), të mos jetë subjekt me imunitet ku përgjegjësia civile pretendohet nga vendimarrjen e tij si gjyqtarët, përveç kur kryejnë veprë penale gjatë ushtrimit të detyrës 3) të mos ketë ndikuar tërësisht sjellja e vetë të dëmtuarit, 4) kur organi publik ka vepruar sipas diskrecionit, lirisë së veprimit që i është dhënë në ligj.

Jurisprudenca e Gjykatës Federale Administrative e cila është gjykata më e lartë e drejtësisë administrative në RFGJ ka elaboruar një sërë qëndrimesh mbi nenin 34 të Ligjit Themelor.<sup>413</sup> Në Gjermani, shteti mban përgjegjësi direkte dhe të plotë kur nëpunësi ka vepruar brënda detyrës së tij dhe i ka shkaktuar dëme individit (neni 389§1) dhe mban përgjegjësi indirekte kur nëpunësi ka kryer këtë veprim me keqdashje ose nga pakujdesia. Kjo lloj përgjegjësie në Angli sipas Prof. Dr Raulph Sauma do të konsiderohet përgjegjësi e shtetit për të tretët.<sup>414</sup>

Në rastin *BGH LM §839[fg] BGB Nr.5 dhe BGH NJW 1996*<sup>415</sup>, shtetasi i dëmtuar nga një vjedhje ka paditur Policinë e qytetit pasi nuk kishte marrë masa të mëparshme për të gjetur dhe për të ndjekur penalisht, antarët e bandës që e grabitën edhe pse, policia kishte sinjalizime të mëparshme apo ankesa për këtë bande. Kjo pakujdesi e theksuar e policisë u konsiderua nga gjykata, shkelje të detyrave të policisë për të hetuar, ndjekur dhe proceduar autorët e veprave penale dhe si pasojë për mosushtrim të kësaj detyrë me faj, qytetari pësoi dëm në pasurinë e tij. Gjykata Supreme e Gjermanisë e gjeti këtë padi të drejtë dhe shpërbleu qytetarin për dëmin e shkaktuar bazuar në nenin 839 të KC dhe nenit 34 të Kushtetutës.

Në çështjen *BGH NJW 1998, 751*, Gjykata Supreme<sup>416</sup> gjeti fajtor prokurorinë e cila në bazë të një kallzimi të rremë dhe hetimi jo të plotë për "Mashttrim të punëmarrësit" pasolli pushimin e procedimit penal dhe lirimimin e punëdhënësit, i cili deri në ekstradimin e tij në Gjermani, qëndroi për dy muaj në Itali me masë sigurimi arrest në burg. Si pasojë, i pandehuri, ortak i një shoqërie tregtare V. humbi kontratën që kishte me shoqërinë P. me të ardhura vjetore 50.180 Marka Gjermane.

I pandehuri paditi Prokurorinë për shpërblim dëmi pra, humbjen e pësuar nga kontrata me shoqërinë V., shpenzimet gjyqësore, fitimin e munguar bazuar në ligjin "Për kompensimin për masat e hetimeve paraprake" (*Gesetz über die Entschädigung für Strafverfolgungsmaßnahmen - StrEG*). Gjykata Supreme Gjermane la në fuqi vendimin Gjykatës së Apelit që shpërbleu shumën prej 160.990,78 Marka Gjermane, për shkelje të detyrave publike të prokurorisë. Gjykata arsyetoi se mbi veprimtarinë e prokurorisë nuk gjykohet në themel të akuzës, por kur haptazi, bazuar në prova, nuk ka asnjë dyshim të arsyeshëm për vendosjen e masës së sigurimit ndaj qytetarit.

<sup>412</sup> Ralph Surma "Comparative Study of the English and German Judicial Approach to the Liability of Public Bodies in Negligence" (2000) Oxford University Comparative Law Forum, faqe 16.

<sup>413</sup> [http://www.bverwg.de/informationen/english/federal\\_administrative\\_court.php](http://www.bverwg.de/informationen/english/federal_administrative_court.php).

<sup>414</sup> Ralph Surma "Comparative Study of the English and German Judicial Approach to the Liability of Public Bodies in Negligence" (2000) Oxford University Comparative Law Forum, faqe 26.

<sup>415</sup> <http://germanlawarchive.iuscomp.org/?p=172>

<sup>416</sup> <https://law.utexas.edu/transnational/foreign-laë-translations/german/case.php?id=710>, askes janar 2016.

Në çështjen *BGH NJW 1980, 2194*<sup>417</sup>, një shtetase duke u përpjekur të merrte kthesën në një rrugë nacionale, u përplas me një automjet duk gjetur vdekjen. Bashkëshorti i saj paditi drejtuesin e automjetit tjetër dhe Bashkinë përkatëse, pasi pretendonte se arsye kryesore e aksidentit ishte karrexhata e lartë prej 1.2 m e vendosur nga punonjësit Bashkisë në kundërshtim me Kodin Rrugor, duke zvogluar fushëpamjen në kthesë. Gjykata Supreme Gjermane, njohu përgjegjësinë e shtetit për këtë fakt por ktheu çështjen për rishqyrtim me arsyetimin se asnjë prej gjykatave nuk kishte hetuar se sa ishte përqindja e fajit nga ana e lartësisë së karexhatës dhe sa ishte sjellja e pakujdesshme e viktimës apo edhe pamundësia për të parë e drejtuesit të mjetit.

Në çështjen *OLG Hamm VersR 1994, 677*<sup>418</sup>, Gjykata Supreme e RFGJ pranoi padinë e dy prindërve të cilët paditën institutin Lokal të Mirëqëniës së Fëmijëve, të cilët nuk kishin informuar gjatë procesit të birësimit prindërit e rinj, se fëmija dyshohej për prapambetje mendore. Paditësit pretenduan humbjet pasurore pasi bashkëshortja kishte lënë punën për të rritur fëmijën, shpenzimet spitalore si dhe çdo lloj shpenzimi për një adoptim të dytë në të ardhmen. Të gjitha këto iu ngarkuan organit publik si përgjegjës për mosinformim me detaj të prindërve të rinj mbi rastin adoptiv. Në gjykim u provua se institucioni kishte të dhëna se fëmija 2 vjeç në kohën e birësimit, për shkak të një dëmtimi të hershëm në tru, kishte një zhvillim sa një foshnje 8 muajshe. Po ashtu, në kërkesën e tyre, shprehurazi, paditësit kishin kërkuar një fëmijë pa probleme mendore.

---

<sup>417</sup> <http://germanlawarchive.iuscomp.org/?p=129>

<sup>418</sup> Ralph Surma “*Comparative Study of the English and German Judicial Approach to the Liability of Public Bodies in Negligence*” (2000) Oxford University Comparative Law Forum, faqe 26.

## 6.4 Mbretëria e Bashkuar

Mbretëria e Bashkuar në rrugëtimin e saj mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike ka pasur një “ngurim” për të pranuar këtë përgjegjësi. Kjo, për shkak të interpretimeve të cases law (jurisprudencës) angleze dhe atë të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Tashmë në Mbretërinë e Bashkuar, është i qartë qëndrimi që organet e administratës publike kanë përgjegjësi karshi të tretëve për veprimet e paligjshme të saj apo të punonjësve.

Në Mesjetë nuk njihej asnjë përgjegjësi për veprimet e paligjshme të mbretit dhe personave me tituj aristokrat si lordët feudalë, pasi konsideroheshin si pasardhësit e Zotit dhe ishin të pagabueshëm.<sup>419</sup>

Në çështjen *Entick v. Carrington* (1765)<sup>420</sup> Sekretari i përgjithshëm i shtetit Earl i Halifaxit, dërgoi Nathan Carrington dhe tre korrierët e mbretit tek banesa e John Etinck ku morën letra të rëndësishme dhe i shkatërruan shtëpinë. Gjykata e Padive të Zakonshme (Court of Common-Pleas), pranoi padinë e Entick ndaj Carringtonin dhe tre korrierëve duke arsyetuar se veprimet e sekretarit të shtetit duke vepruar nën autoritetin mbretëror nuk mund të konsiderohen veprimet të ligjshme përsakohë që një i tretë do të mbante përgjegjësi. (Lord Camden).

Më pas, autori i parimit “rule of law”, Dicey<sup>421</sup> shpjegoi se në të drejtën angleze nuk ka ndonjë vijë ndarëse mes të drejtës publike dhe të drejtës private, kështu që si privatët ashtu edhe shteti dhe organet e tij mbajnë përgjegjësi karshi të tretëve me të njëjtat kushte për dëmet jashtëkontraktore (tort) mes personave privatë. Praktika gjyqësore ka zbatuar normat civile për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve publike duke zhvillur dy lloj përgjegjësish: ajo e organeve publike për shkak të pakujdesisë dhe ajo e moskryerjes së detyrave nga punonjësit e saj.

Organet e administratës publike në MB mbajnë këto lloj përgjegjësish karshi dëmeve jashtëkontraktore të shkaktuar të tretëve:

- Përgjegjësia personale e punonjësve që veprojnë për organet e administratës publike;
- Përgjegjësia e organeve të administratës publike për dëmet jashtëkontraktore të shkaktuar nga punonjësit e tij;
- Përgjegjësia direkte që kanë organet e administratës publike.

Sipas Prof. Surma përgjegjësia jashtëkontraktore për çdo organ publik, person fizik a juridik privat nuk është e parashikuar në ndonjë ligj të veçantë, por jurisprudenca kërkon domosdoshmërisht tre elementëve: detyrimi i të paditurit për të pasur kujdes në veprimet dhe mosveprimet e tij karshi paditësit, shkelja e këtij detyrimi, si dhe parashikueshmëria dhe njohja e të drejtës së të dëmtuarit për të kërkuar shpërblimin e atij lloj dëmi të hasur.<sup>422</sup>

Çështja e parë që pati impakt në të drejtën e përgjegjësive jashtëkontraktore të organeve publike ishte vendimi Dhomës së Lordëve, *Dorset Yacht Co Ltd v Home*

<sup>419</sup> Blachly F.L, Oatman M.E “Approaches to governmental liability in tort: a comparative survey”, faqe 183.

<sup>420</sup> Konsiderohet një nga kononet e së drejtës publike shih, [http://www.constitution.org/trials/entick/entick\\_v\\_carrington.htm](http://www.constitution.org/trials/entick/entick_v_carrington.htm), akses 14 janar 2016.

<sup>421</sup> Ralph Surma “Comparative Study of the English and German Judicial Approach to the Liability of Public Bodies in Negligence” (2000) Oxford University Comparative Law Forum, faqe 5 .

<sup>422</sup> Dicey, A. V. Lectures on the Relation between Law and Public Opinion in England. Indianapolis, IN, USA: Liberty Fund Inc., 2008. ProQuest ebrary. Web. 14 January 2016.

*Office* (6 marsit 1970)<sup>423</sup>. Në 1962, dhjetë djem të Institucionit të Korrektimit po punonin në portin e ishullit Brownsea nën mbikqyrjen e tre oficerëve të Ministrisë së Brëndshme (Home Office). Shtatë nga këta djem u arratisën kur punonjësit po flinin dhe kishin lënë grupin pa mbikqyrje. Të arratisurit rrëmbyen një jaht në mol dhe u përplasën me një tjetër jaht në pronësi të shoqërisë Dorset Yacht Co. e cila paditi për dëmin e shkaktuar Ministrinë e Punëve të Brëndshme.

Dhoma e Lordëve me shumicë votash pranoi padinë me arsyetimin se tre punonjësit e Ministrisë, kishin treguar pakujdesi të theksuar në lënien të lirë, pa mbikqyrje totale të djemve 15 deri 21 vjeç me rekorde kriminale të mëparshme, duke ditur se në vëndin ku kryenin punën kishte anije, jahte që do i ndihmonin të arratiseshin, gjë që e kishin tentuar edhe herë të tjera.

Lord Reid në interpretimi e tij u shpreh se: “Nëse punonjësit do të kishin zbatuar detyrime e tyre do të ndalohej arratisja e kësaj edhe dëmi i shkaktuar paditësive. Oficerët duhet të mbajnë përgjegjësi disiplinore dhe civile për dëmin” Ndërsa pyetjes së cili do të mbaj përgjegjësi Ministria e Punëve të Brëndshme apo punonjësit që shkaktuan dëmin me pakujdesi, Lord Reid u përgjigj se nuk shikonte arsye pse duhet të shkarkohet organi publik nga përgjegjësia.<sup>424</sup>

Një tjetër çështje, gur themeli për përgjegjësinë civile të organeve të administratës shtetërore është edhe <sup>425</sup>*Ann's kundër Merton LBC (1977) vendimi i Dhomës së Lordëve*. Paditësit, ishin qiramarrës në një bllok pallatësh të ndërtuar në vitin 1960, nga Autoriteti i Ndërtimeve të Qytetës së Mertonit me një garanci në ndërtim prej 99 vjetësh. Në janar 1970 paditësit konstatuan se muret e tyre po çaheshin dhe dyshemeja kishte rrëshqitje, prandaj paditën si shoqërinë e ndërtimit për mosrespektimi të kontratës dhe me shkelje të Ligjit për Ndërtimet (1957) pasi kishin ndërtuar në një shesh të papërshtatshëm.

Po ashtu të paditur ishte edhe organet lokale të qytetës së Mertonit Londër pasi kishin dështuar në inspektimin e themeleve të pallateve. Padia u rrëzua pasi ishte ngritur pas gjashtë vjetësh nga koha e ndodhjes së ngjarjes.

Ajo çfarë vlen për doktrinën është se Lord Wilberforce shtjelloi teorinë e dy shkallëve të analizës, për të tilla rastesh:

1. Nëse autoritetet lokale kanë përgjegjësi përkundrejt pronarëve ose qiramarrësve të këtyre shtëpive sa i takon inspektimit gjatë ndërtimit;
2. Sa është afati i parashkrimit të padisë përkundrejt autoriteteve lokale.<sup>426</sup>

Argumentet e Lord Wilberforce, të cilit iu bashkuan shumica e gjyqtarëve, ishin që organet e pushtetit lokal nuk kanë pasur diskrecionin të inspektionin në mënyrë të vazhdueshme nëse punimet po kryeheshin mirë apo jo nga shoqëria ndëtimore. Për sa kohë është miratuar çdo plan projekt, vepra është dorëzuar e rregullt dhe qytetarët kanë hyrë, organet e pushtetit lokal nuk mund të marrin iniciativën që të kontrollojnë punimet për sa kohë që nuk ka ndonjë indicie për ndërtim jashtë plani. Përgjegjësia e inspektimit të autoriteteve publike përgjithësisht (prima facie) duhet të jetë as minimale dhe as maksimale që të sigurohet se veprimet e ndërtuesit nuk janë në përputhje me kërkesat ligjore. Përgjegjësia e drejtëpërdrejtë e pasojës së ardhur i shkon ndërtuesit dhe autoritetetve publike për të cilët ka për detyrë të shpërblej humbjet ose ti gjej apartamente të tjera ku mund të strehohen.

<sup>423</sup> ILQ volume 60 issue 1 Cover and Back matter. (2011). *International & Comparative Law Quarterly*, 60(1), b1-b28. doi: 10.1017/S0020589311000029.

<sup>424</sup> [1970] AC 1004 (HL)

<sup>425</sup> <http://www.nadr.co.uk/articles/published/ConstructionAdjudicationLawReports>, akses 14 janar 2016.

<sup>426</sup> Arbitration, Building & Construction Law Reports “*Ann's v Merton London Borough Council [1977] ABC.L.R. 05/12*”. Typeset by NADR. Croën Copyright reserved. [1977] UKHL 4.

Gjykata si përfundim vlerësoi se: autoritetit publik nuk mund t'i ngarkohet përgjegjësia për shkak të pakujdesisë në inpektim apo mungesës në inspektim për sa kohë nuk i bënë me dije problemin kur ai ndodhi. Këshilli mund të jetë përgjegjës nëse provohej se inspektori i saj ka ushtruar detyrën pasi ka ndodhur defekti dhe ka kontrolluar nëse janë zbatuar rregullat e ndërtimit.<sup>427</sup>

Ky arsyetim ka vazhduar deri më 1990 ku Dhoma e Lordëve për vendimin *Caparo industries plc v Dickman* vendosi testin e trefishtë për të arritur në përfundimin nëse ka pasur përgjegjësi për dëmin e ardhur apo jo.

Shoqëria Fidelity shpk e cila prodhonte pajise elektrike po blihej pjesë pjesë nga Shoqëria Caparo Industries shpk derisa në mars të 1984 arriti 29.9 % të pjesëve si ortak. Sapo mori kontrollin, Caparo konstatoi se llogaritë e Fidelity-së ishin më të këqija seç kishin raportuar audituesit.

Gjykata në testin e trefishtë të përgjegjësive vlerësoi se nuk mund të mbajë përgjegjësi punonjësi i një shoqërie nëse ortakun zhgënjehet në pritshmëritë e tij të fitimit pasi:

- dëmi duhet të jetë qartë dhe i parashikueshëm;
- të ketë një lidhje shkakësore të mjaftueshme mes sjelljeve të palëve;
- përgjegjësia që i ngarkohet të paditurit duhet të kalojë testin e arsyeshmërisë, të ligjshmërisë dhe të së drejtës (just, fair and reasonable test)<sup>428</sup>.

Jurisprudenca mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve publike ka vendosur se: përgjegjësia vjen nga ligji, për shkak të veprimit apo mosveprimit të punonjësve të organit të administratës publike (rasti *Dorset Yacht*), duke passjell dëm pasuror dhe jopasuror por edhe për çdo lloj të drejte të rëndësishme të shkelur nga organet publike. Gjithësesi janë të pakta rastet kur shpërblehet dëmi pasuror dhe një vlerësim më i madh i jepet dëmit jopasuror.

Po ashtu, praktika ka cilësuar si grup organesh publike me imunitet gjyqtarët. Megjithatë në rastin e *Hill kundër Kryetarit të Policisë së Yorkshirit Perëndimor*, Dhoma e Lordëve nuk e vlerësoi neglizhente sjelljen e të paditurit, për mosarrestimin më parë të vrasësit të vajzës së paditëses, i cili në pesë vjet kishte kryer 20 vrasje femrash. Policia nuk kishte ndonjë detyrë për tu kujdesur specifikisht për të ndjerën Hill për sa kohë nuk ishte identifikuar si ndonjë viktimë potenciale dhe se detyrat e kryera nga policia për gjetjen e vrasësit ishin mbi standardin mesatar.

E kundërta ndodhi në rastin *Wk. Essex CC (2000)* ku Dhoma e Lordëve, pranoi padinë e fëmijve dhe prindërve të tyre që për pakujdesi të institutit të Birësimeve të qytetit të Essexit, kishin marrë në kujdestari një djal 15 vjeçar, i cili ishte abuzues seksual i njohur për policinë dhe për Institutin, pasi kishte abuzuar me motrën dhe dyshohej për një përdhunim tjetër.

Edhe pse paditësit, e kishin vënë kusht në marrjen kujdestarisë që të përjashtohen të tillë kategorish, përsëri instituti i kishte vendosur djalin në kujdestari të tyre. Të gjithë fëmijët e paditësit 8 deri 12 vjeç, një djalë dhe tre vajza të abuzuar për një muaj nga i birësuarit kishin pësuar çrregullime psikike.

Për këtë pakujdesi, Dhoma e Lordëve e gjeti insitutin me faj dhe përgjegjëse për dëmin psikik të shkaktuar paditësave (fëmijë), ndërsa dëmin psikik të shkaktuar prindërve nuk e pranoi me arsyetimin se viktima dytësore nuk mund të mbrohet kur pëson një shok të momentin kur njoftohet për ngjarje ne ndodhur por duhet të jetë një dëm më serioz në psikikën e të dëmtuarit.

<sup>427</sup> Po aty faqe 6.



Pakujdesia e organit publik identifikohet si shfaqje e kujdesit nën standardin e lejuar të një organi publik karshi individit. Matja e pakujdesisë është objektive pasi çdo punonjës e konstaton lehtësisht krahasuar me kujdesin normal.

Në Angli ndryshe ky test quhet testi Bolam<sup>429</sup> sipas çështjes *Bolam kundër Komitetit të Menaxhimit të Spitalit Friern (1957)*. Dhoma e Lordëve vendosi që në rastet e mjekimit të pakujdesshëm, duhet të vlerësohet se për të njëjtin pacient çdo mjek do të kryente të gjitha veprimet që ka kryer mjeku përkatës apo kujdesi ka qënë nën standardin e kërkuar. Nëse mjeku ka treguar kujdes si për çdo pacient tjetër dhe të njëjtin mjekim do kishin kryer edhe mjekë të tjerë, mjeku konkret nuk mban përgjegjësi.

Dhoma e Lordëve me *vendimin Stovin kundër Wise (1996)* nuk e gjeti organet shtetërore përgjegjëse tërësisht. Në të tillë veprimesh me mjete me rrezik të shtuar, kur rruga ka një pengesë dhe kishte tre aksidente të mëparshme, drejtuesit e mjetit duhet të kenë përgjegjësinë më të madhe për të drejtuar automjetin me kujdes. Shtuar faktit se kur zgjedhin të kalojnë në atë rrugë, prezumohet se dinë edhe gjëndjen e rrugës ku mund të kalojnë prandaj duhet të rregullojnë sjelljen e tyre. Gjykata vlerësoi se përgjegjësia për dëmin në shëndet është 70% paditësit dhe 30% e të paditurit, autoritetit rrugor i cili duhet të kishte marrë masa për të rritur sigurinë e përdoruesve në autostrada.

---

<sup>429</sup> Testi i katërfisht i përgjegjësisë: 1) ka një përgjegjësi të doktorit ndaj pacientit, 2) të provohet se është shkelur detyra për tu kujdesur ndaj pacientit, 3) duhet të tregohet se ka një lidhje shkakësore mes shkeljes së detyrës, kujdesit dhe dëmit në shëndet. 4) Duhet të provohet se dëmi është imediat, jo shumë i largët.

## 6.5. Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës deri në vitin 1946 ka ekzistuar doktrina e papërgjegjshmërisë së shtetit për veprimet që kryen karshi qytetarëve. Ky qëndrim ishte huazuar nga e drejta angleze. Në Kushtetutën dhe amendamentet e saj(1787)<sup>430</sup> nuk parashikonin të drejtën e qytetarit për t'u shpërblyer për dëmet e shkaktuara nga organet e administratës publike.

Në amendamentin e XI në vitin 1795 parashikohet qartë se ka imunitet pushteti gjyqësor i Shteteve të Bashkuara nga çdo padi. Në këtë mënyrë mund të interpretohet nga e kundërta se në vitin 1795 njihet e drejta e këtyre subjekteve që të padisin organet e pushteteve të tjera për çdo lloj padie të bazuar në ligj apo nga e drejta e pashkuar zakonore (equity). Për juristët e kohës ishte e pakonceptueshme se ndaj atij që krijon ligje të ngrihen padi për veprime të padrejta.<sup>431</sup>

Në vitin 1946, Kongresi miratoi ndryshime në ligjin "Mbi procedurën gjyqësore dhe pushtetin gjyqësor", ku në titullin IV shtoi dispozita të reja me titullin "Mbi ankimet federale ndaj dëmeve jashtëkontraktore" ose siç njihet ndryshe FTCA (Federal Tort Claims Act).

Sipas prof. Robert D. Lee Jr.<sup>432</sup> dëmet në SHBA i ndajmë në:

- 1) dëme jashtëkontraktore që vijnë si shkelje të të drejtave Kushtetuese;
- 2) dëme jashtëkontraktore për shkelje të drejtave zakonore (Common law) ku shfaqen në formën e sjelljes neglizhente, shpifje, ngacmimit seksual, streset;
- 3) dëme që vijnë nga përgjegjësia jashtëkontraktore federale (federal tort law).

Ky ligj parshikon përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve shtetërore për dëmet që u shkaktojnë qytetarëve.

Në kohën kur doktrina e imunitetit të shtetit ishte absolute, u konsiderua jo ligjore dhe diskriminuese që këto dëme të mbeteshin pa u shpërblyer.

Në çështjen e Bombarduesit B25, i cili u përplas në ndërtesën Empire State Building në 1945, për faj të pakujdesisë së një piloti të ushtrisë amerikane, familjarët e njëmbëdhjetë viktimave që gjëndeshin aty, përfituan të drejtën me ligjin e ri, (me pasojë retroaktive) që të padisin shtetin për dëmet pasurore dhe jopasurore që pësuan nga humbja e të afërmëve të tyre.<sup>433</sup>

Në ligjin FTCA<sup>434</sup> në nenin 1346 parashikohet se çdo padi e shtetasve për veprime të padrejta të nëpunësve, ngrihet përkundërt shtetit dhe ai përfaqësohet nga Prokurori i Përgjithshëm. Ky nen mban titullin "*SHBA-të si të paditur*" ku parashikohet se gjykatat e çdo distrikti kanë kompetencë lëndore dhe tokësore për: *1) çdo padi kundër Shteteve të Bashkuara për mbledhje apo kërkim të taksave në mënyrë të padrejtë ose për ndonjë gjobë të mbledhur pa ndonjë autorizim ose ndonjë shumë të vendosur tepër ose gabimisht në kundërshtim me ligjet për të ardhurat kombëtare.*

<sup>430</sup> Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara "Outline of the U.S Legal System", Congressional Quarterly INC. 2001, faqe 177.

<sup>431</sup> Karl Singewald "*The doctrine of non-suability of the state in the United States*" John Hopkin Press, Baltimore 1910, faqe 10.

<sup>432</sup> Profesor i së drejtës Administrative në Universitetin Shtetëror të Pensilvanisë.

<sup>433</sup> Miratimi i FTCA mori nxitje nga ky aksident saqe jo vetëm u miratua disa muaj pas ndodhjes së aksidentit, por u parashikua një dispozitë kalimtare që efektet e këtij ligjit të vitit 1946 do të shtrihen për çdo të dëmtuar për dëme të shkaktuar nga 01 janar 1945.

<sup>434</sup> Biem dakort për ti thënë ligj pasi në këtë formë njihet edhe në SHBA, por në fakt ato janë një grup dispozitash nga neni 1345 e vijues brënda ligjit "Për pushtetin gjyqësor dhe procedurat gjyqësore".

2) çdo padi kundër Shteteve të Bashkuara deri në 10 000\$, sasi e përcaktuar sipas Kushtetutës, ligjeve të Kongresit, akt normative ekzekutive, të vendosur në kontratë etj.

...

Sipas parashikimeve të kapitullit 171 të këtij titulli, gjykatat e shkallëve të para (distrikteve) të Shteteve të Bashkuara, përfshi edhe të Zonës së Kanalit dhe të ishujve Virgjin, kanë juridiksion ekskluziv për paditë ndaj Shteteve të Bashkuara për dëme pasurore, dëme jopasurore ose vdekje të shkaktuar nga pakujdesia ose veprim ose mosveprim i gabuar i ndonjërit prej punonjësve të qeverisë përsa kohë vepron si nëpunës ose i punësuar në rastet kur Shtetet e Bashkuara, do të jenë përgjegjës sipas ligjit ku veprimi ose mosveprimi ndodhi.

3) Asnjë person i dënuar për ndonjë krim të rëndë, i cili ishte i burgosur në pritje të ekzekutimit të dënimit ose kur e vuan atë, nuk mund të padisë Shtetet e Bashkuara, një organ apo nëpunësin a të punësuarin e tij për dëm në shëndetin mendor ose emocional pa pasur një dëmtim fizik....<sup>435</sup>

Pas këtij parashikimi çështje me e njohur e Gjykatës Supreme<sup>436</sup> është *Bivens kundër Gjashtë Oficerë të Panjohur të Zyrës Federale të Narkotikëve (1971)*. Oficerët hynë në banesën e shtetasit Webster Bivens dhe e arrestuan atë pa ndonjë urdhër arresti. Akuzat për drogë ndaj tij u rrëzuan nga gjykata. Paditësi paditi Zyrën Federale të Narkotikëve për shkelje të Amendamentit 4 të Kushtetutës për shkelje të jetës private dhe dhunim të banesës. Kjo padi u rrëzua si e pabazuar në ligj nga Gjykata e Distriktit. Gjykata Supreme prishi vendimin dhe ktheu për rishqyrtim edhe një herë çështjen për të hetuar nëse paditësi mund të ngrejë këtë padi përpara Gjykatës Federale. Megjithatë, në rishqyrtimin e dytë, Gjykata Supreme vendosi se shpërblimi për shkelje të të drejtave kushtetuese ngrihet vetëm ndaj vetë individëve dhe jo ndaj nëpunësve të shtetit.

FTCA u ndryshua në vitin 1988 me ligjin Westfall ose i njohur ndryshe si ligji "Për kompensimin e dëmeve jashtëkontraktore dhe përgjegjësinë e punonjësve federal" ku mund të themi se punonjësit rifituan imunitetin nga disa padi që mund të ngrinin qytetarët.<sup>437</sup> Rezultoi më pas se, këto ndryshime e tejkaluan qëllimin e Kongresit.<sup>438</sup> Debatet të tilla se cila janë gjykatat kompetente, ato të shteteve apo gjykatat federale si dhe nëse çështja është kryer duke ushtruar detyrën si i punësuar ose jo, vazhdojnë edhe sot. Shkak i miratimit të këtij ligji ishte çështje Westfall Kundër Erwin (1988).

Çifti Westfall ishte i punësuar në depot e ushtrisë ku pësuan djegie nga një efekt kimik i pluhurit të sodës toksike e cila ishte depozituar gabimisht nga mbikqyrësi i saj. Gjykata e Distriktit rrëzoi padinë me arsyetimin se organi administrativ dhe punonjësit e paditur kanë imunitet absolut për dëm jashtëkontraktor ndaj punonjësve të tyre kur ato veprojnë brenda kompetencave, detyrave zyrtare dhe brenda diskrecionit që i jep ligji.<sup>439</sup>

<sup>435</sup> § 1346. Shtetet e bashkuara si të paditur: <https://www.law.cornell.edu/uscode/text/28/1346>, akses 16 janar 2016.

<sup>436</sup> Gjykata në hierarki më e larta në nivel federal në SHBA dhe kompetente për të interpretuar Kushtetutën dhe ligjet federale dhe për të praktikën e njësuar, me forcën e ligjit për gjitha gjykatat më të ulëta.

<sup>437</sup> Lee, R. D. (1996). Federal Employees, Torts, and the Westfall Act of 1988. *Public Administration Review*, 56(4), 334–340. <http://doi.org/10.2307/976374>.

<sup>438</sup> Federal Statutes — Westfall Act — D.C. Circuit Holds that U.S. Officials Are Immune from Alien Tort Statute Claims. — Ali v. Rumsfeld, 649 F. 3d 762 (D.C. Cir. 2011). (2012). Federal Statutes — Westfall Act — D.C. Circuit Holds that U.S. Officials Are Immune from Alien Tort Statute Claims. — Ali v. Rumsfeld, 649 F. 3d 762 (D.C. Cir. 2011). *Harvard Law Review*, 125(4), 1080–1087. Retrieved from <http://www.jstor.org/stable/41349904>, faqe 1084.

<sup>439</sup> Arsyetim i vendimit u la në fuqi i nga Gjykata e Qarkut të Njëmbëdhjetë ashtu edhe nga Gjykata Supreme.

Menjëherë pas këtij vendimi, Kongresi miratoi ligjin "Për kompensimin e dëmvë jashtëkontraktore dhe përgjegjësinë e punonjësve federal", duke shprehur shqetësimin për vendimet e Gjykatave pasi ekspozonin punëmarrësit, zhveshnin mbikqyrësin apo organin epror ndaj padive të qytetarëve. Të tilla janë paditë për gabime materiale nëpër dokumente, paditë karshi punojësve për dëmet e shkaktuara në parqe dhe ndaj punonjësve të pajisjeve elektrike të rëna në dysheme apo të sanitarëve për dyshemën e lagur.<sup>440</sup>

Ligji Westfall<sup>441</sup>, në praktikë më tepër shërbeu si kuadër ligjor për paditë e punonjësve të dëmtuar ndaj organeve të tyre eprore sesa e qytetarëve karshi organeve administrative, kjo pasi për kategorinë e fundit mund të kishte edhe referenca të tjera ligjore si Kushtetuta etj.

Kongresi synonte zvoglimin e shpenzimeve të shtetit nëpërmjet padive të regresit ndaj punonjësve kur këta kanë vepruar jashtë kompetencave.

Paditësi detyrohet fillimisht të ngre pretendimin për shpërblim ndaj organit publik në një afat prej dy vjetësh nga momenti kur ka ditur dëmin dhe shkakun.<sup>442</sup> Nëse brënda gjashtë muajve organi publik nuk kthen përgjigje ose e rrëzon kërkesën, paditësi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Federale të Distriktit përkatës ku ka ndodhur dëmi. Të tilla padi gjykohen pa juri. Përfaqësues i të paditurit është Prokurori i Përgjithshëm i Distriktit. Për dëme me vlerë mbi 25 000 USD (dollarë amerikan) për vendimarrjen e saj, organi administrative merr edhe miratimin me shkrim të Prokurorit të Përgjithshëm të Distriktit përkatës të cilët mund të trajtojnë ankesa me vlerë deri në 1 milion USD.<sup>443</sup> Ankesat me vlerë dëmi deri në 2500 USD paguhen nga agjencia e punëdhënësit që paditet. Paditë me vlerë mbi 2500 USD paguhen nga të ardhurat kombëtare të përgjithshme.

Ajo çfarë ka rëndësi në cilësinë e provave në këto lloj gjykimesh është certifikata "Mbi Qëllimin e organit administrativ ose të Detyrës" që lëshon Prokurori i Përgjithshëm, i cili në SHBA është edhe përfaqësues i Departamentit të Ministrisë së Drejtësisë (Attorney Generale).<sup>444</sup> Ky opinion në disa shtete është i formës së prerë, në bazë të të cilës, gjykatat vlerësojnë nëse i padituri ka vepruar brënda kompetencave që i jep detyra.<sup>445</sup> Nëse ka vepruar brënda kompetencave dhe detyrave të tij, punonjësi zëvendësohet procedurialisht me shtetin dhe kompetente është gjykata federale e distriktit ku ka ndodhur dëmi dhe si bazë ligjore është ligji për FTCA.

Ka shtete, ku certifikatën e marrë nga Prokurori i Përgjithshëm i shtetit, e vlerësojnë njësoj si provat e tjera, madje shumë herë edhe e rrëzojnë përmbajtjen e saj<sup>446</sup>. Gjykatat mbasi zhvillojnë hetimin gjyqësorë dhe interpretojnë ligjin sipas qëllimit, historikut etj. vendosin nëse organi administrativë nga ku ka ardhur dëmi, ka

<sup>440</sup> Lee, R. D. (1996). Federal Employees, Torts, and the Westfall Act of 1988" *Public Administration Review*", 56(4), Faqe 335.

<sup>441</sup> I quajtur ligji Westfall (1988), pas u miratua si reflektim i legjilastorit karshi kësaj çështje.

<sup>442</sup> Çështja "United States kundër Kubrick", 444 U.S. 111, 120 (1979).

<sup>443</sup> Shih nenet 2401, 2402, 2675 të ligjit të FTCA.

<sup>444</sup> Certifikata e vlerësimit të Prokurorit të Përgjithshëm për herë të parë u elaborua nga Gjykata Supreme në çështjen *Gutierrez de Martinez kundër Lamagno*, 515 U.S. 417 (1995) ku Gjykata shprehet se: "Kur një punëmarrës federal paditet për një veprim të gabuar apo të pakujdesshëm, i jep të drejtë prokurorit të Përgjithshëm që të certifikoj, vlerësoj se i punësuar po vepron brënda detyrës së tij ose punës së tij, në kohën kur ndodhi fakti për të cilën është ngritur padi. Bazuar nga kjo certifikatë, punonjësi largohet nga gjykimi dhe vëndin e tij e zë shteti si i paditur. Rasti tashmë është nën rregullimin e FTCA."

<sup>445</sup> Lee, R. D.. (1996). Federal Employees, Torts, and the Westfall Act of 1988, *Public Administration Review*, 56(4), Faqe 338.

<sup>446</sup> Çështja *Osborn kundër Haley*, 127 S. Ct. 881 (2007).

qënë brënda kompencave të tij e në këtë rast ose padia rrëzohet ose pranohet duke i dhënë shpërblimin përkatës paditësit.

Megjithatë ekzistojnë disa raste përjashtimore kur të tilla padi nuk mund të ngrihen përkundrejt shtetit si p.sh *çështja Feres kundër Shteteve të Bashkuara, (1950)*<sup>447</sup>, Gjykata e Lartë e njohu si një rast të paparashikuar në të drejtën e një ushtari për të kërkuar shpërblim për plagosjen nga pakujdesia gjatë një shërbimi ushtarak.

Në SHBA mbas elaborimit të rastit Feres, u zhvillua praktika e mos paditjes së punonjësve të Forcave të Armatosura për dëmet e shkaktuar gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Madje, asnjë shpërblim nuk u pranua në rastet e shumta në çështjet Atkinson<sup>448</sup>, Browns, etj. ku gra ushtarake paditën Shtetet e Bashkuara për mjekim të pakujdesshëm tek spitalet ushtarake me pasoje lindjen e foshnjave të vdekura apo të dëmtura, me arsyetimin se në doktrinën Feres, mardhënia mes punonjësit dhe forcave të armatosura rregullohet nga ligji federal, FTCA dhe se ka mënyrë të tjera alternative të rregullimit të dëmeve, siç është skema e pensioneve për veteranët etj.

Tepër interesante paraqitet fakti se nëse punonjësit që i shërbejnë forcave të armatosura nuk mund të padisin shtetin e tyre për dëmet apo vdekjen gjatë kryerjes së detyrë, të afërmit e tyre, bashkëshortja, fëmijët etj. mund ta padisin Shtetet e Bashkuara si të dëmtuar jo të drejtpërdrejtë, pasi këto padi nuk mbrohen nga FTCA.

Në çështjen *Henkie kundër Shteteve e Bashkuara*<sup>449</sup> (1984), bashkëshortja e një ushtaraku paditi për lindjen e fëmijës me të meta mendore, të rrjedhura nga defektet gjenetike që kishte pësuar i ati i fëmijës, nga rrezet atomike gjatë shërbimit ushtarak, i pa informuar për pasojat. Kjo padi nën mbrojtjen e doktrinës Ferie nuk u pranua.

Në vitin 1984, FTCA pësoi disa ndryshime pikërisht për dëmet që testet atomike shkaktonin tek personat që merrnin pjesë në eksperimente. Në nenet 1631 u shtuan nenet që lejonin çdo person i cili kishte pësuar dëme në shëndet dhe trashëgimtarët e atij që kishte humbur jetën (Warner Amendment)<sup>450</sup> të padiste Shtetet e Bashkuara. Ky rast ishte përjashtimor i FTCA, por që në një farë mënyrë nuk ngarkonte shoqëritë tregtare që realizonin këto eksperimente deri më atë kohë, të përgjigjeshin civilisht për dëmet tek këto individ, kur dihej që këto shoqëri tregtare nuk ishin gjë tjetër veçse nënkontraktues të qeverisë amerikane për të realizuar këto eksperimente.

Në këtë mënyrë, SHBA-të, haptazi morën përsipër përgjegjësinë dhe parashikuan në detaj rastet sipas ligjit "Mbi Kompensimin nga ekspozimet nga rrezet atomike"<sup>451</sup> (1990). Kështu parashikohen se shpërblehen: 50 000 USD, çdo person i cili pëson leuçemi ose tumore të tjera të listuara pasi ka jetuar në zonën ku janë zhvilluar eksperimentet bërthamore për periudhën 1951 deri 1962, 75 000 USD për personat që kanë pësuar këto sëmundje për shkak se kanë marrë pjesë në këto testime po në këtë periudhë si dhe 100 000 dollarë për çdo person të punësuar nga vitet 1947 deri 1971 në një minierë uranium dhe ka pësuar kancer në mushkëri apo një sëmundje në organet e

<sup>447</sup> 340 U.S. 135.

<sup>448</sup> Në çështjen Atkinson kundër Shteteve të Bashkuara, fakti se një ushtarake për shkak të punës që kryente pati dhimbje që çuan një lindje të parakohshme, dëmtime fizike dhe mendore në Spitalin Ushtarak. Mjeku nuk mbajti përgjegjësi pasi paditësja nuk gjindej duke zbatuar apo performuar ndonjë mision ushtarak në kohën e ndodhjes së dëmit, nuk ka lidhje të mëparashme mes trajtimit mjekësor të Atkinsonit dhe disiplinën ushtarake që synonte të zbatonte paditësja.

<sup>449</sup> Hinkie v. United States, 715 F.2d 96 (3d Cir. 1983), cert. denied, 465 U.S. 1023, (1984)

<sup>450</sup> Nenet 1631 e vijues të P.L. 98-525, 42 U.S.C. § 2212

<sup>451</sup> "On the Radiation Exposure Compensation Act", 42, U.S.C. § 2210 (1990).

frymarrësjes etj.<sup>452</sup> Ndërsa në ligjin “Mbi Përgjegjësinë për eksperimentet atomike”<sup>453</sup> (1990) parashikohet se çdo person i dëmtuar nga ekspozimi i radioaktivitetit të armëve atomike nga veprimi a mosveprimi i kontraktuesit të Shteteve të Bashkuara, padit këtë të fundit dhe jo shoqërinë kontraktuese.<sup>454</sup>

---

<sup>452</sup> Henry Cohen, Vanessa K. Burrows “ Raporti i Shërbimeve të Kongresit i vitit 2007 mbi ligjin “Për paditë federale mbi dëmet jashtëkontraktore” FTC “Order Code 95 vizë 177, Faqe 19.

<sup>453</sup> “On Atomic Testing Liability Act”, 42 U.S.C. § 2210 (1990).

<sup>454</sup> Henry Cohen, Vanessa K. Burrows “ Raporti i Shërbimeve të Kongresit i vitit 2007 mbi ligjin “Për paditë federale mbi dëmet jashtëkontraktore” FTC “Order Code 95 – 177” Faqe 19.

## 6.6 Kosova

Në Republikën e Kosovës, Kushtetuta e miratuar me datë 9 prill 2008, në kapitullin II “Të drejtat dhe liritë themelore” parashikonin në nenin 32 se: “*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.*” Përveç kësaj, është e parashikuar edhe neni 58 me titullin “Përgjegjësitë e shtetit”. Por ndryshe nga kuptimi *prima face* që të jep titulli, në përmbajtje flitet për përgjegjësinë e shtetit për të mosdiskriminuar minoritetet që përbëjnë popullsinë e Kosovës.

Ligji më i rëndësishëm ku parashikohet përgjegjësia e organeve të administratës shtetërore është ligj nr. 02/L-28 “Për procedurën administrative” ku e drejta e qytetarëve për të kërkuar shpërblim në rastet kur dëmtohen interesat nga veprimet e administratës janë:

- Për gjëndje të jashtëzakonshme, u njihet e drejta për dëmshpërblim, personave fizikë dhe juridikë të dëmtuar nga aktet administrative.<sup>455</sup> Të dëmtuarit kanë të drejtën e kompensimit në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë përgjegjësinë e administratës publike. Ndryshe nga KPRA i Ri në Shqipëri, ku përgjegjëshmëria e OP përcaktohet në një nen të veçantë, në Kosove nuk ekziston një parashikim i tillë parimor.
- Në situatë normale legjitimohen grupi i personave interesat e të cilëve shkelen apo persona që janë dëmtuar individualisht nga kjo veprimtari e administratës shtetërore.<sup>456</sup> Po ashtu personat e dëmtuar nga një akt administrativ relativisht i pavlefshëm<sup>457</sup> apo nga akte reale kanë të drejtën të kthehen në gjendjen e mëparshme ose organet administrative asgjesojnë të gjitha dëmet e shkaktuara të tretëve.<sup>458</sup>

Nga parashikimet e ligjit “Për procedurën administrative” rregullimi i pasojave që vijnë nga një akt i ligjshëm ose i paligjshëm i administratës realizohet:

- Me asgjesimin e dëmeve të shkaktuara;
- Duke u kthyer palët në gjendjen e mëparshme përpara daljes së aktit të pavlefshëm (neni 95);

Rregullat në të cilët shërbejnë për të shpërblyer personat e dëmtuar do të jenë ato të parashikuar nga ligji nr. Nr. 02/L-28, “Për procedurën administrative”<sup>459</sup>, kur nuk ka rregullime të tjera të posaçme .

<sup>455</sup> Në nenin 3<sup>455</sup> parashikohet parimi i ligjshmërisë mbi të cilën vepron administrata publike por edhe rastin kur nxirret një akt i paligjshëm i cili në proporcion sjell dëme më të vogla.

<sup>456</sup> Neni 35.3 i ligjit “Për procedurën administrative” *Në mënyrë që të mbrohen interesat publike, të cilat mund të preken nga një procedim administrativ, e drejta për të filluar një procedim administrativ ose për të marrë pjesë në të, u njihet edhe subjekteve të mëposhtme:*

a) *personave të cilëve procedimi administrativ iu shkakton një dëm në të drejtat e tyre të përbashkëta të tilla si: shëndeti publik, arsimimi, trashëgimia kulturore, ambienti dhe cilësia e jetës;*

b) *personave të cilët jetojnë në brendësi ose në afërsi të një prone publike, e cila mund të dëmtohet nga procedimi administrativ; ...”*

<sup>457</sup> Neni 95.3 “*Pas revokimit apo shfuqizimit formal të aktit administrativ relativisht të pavlefshëm, organi përkatës i administratës publike kujdeset për kthimin e gjendjes që ekzistonte përpara nxjerrjes së aktit relativisht të pavlefshëm. Në qoftë se kthimi në gjendjen e mëparshme nuk është i mundur, organi kompetent merr në shqyrtim dhe zgjidh pretendimet e palëve të dëmtuara nga akti administrativ relativisht i pavlefshëm.*”

<sup>458</sup> Neni 138.

<sup>459</sup> Neni 3 - Parimi i ligjshmërisë.” 3.1. *Organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në përputhje me legjisllacionin në fuqi në Kosovë, brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca.*

Administrata shtetërore në Kosovë rregullohet nga ligji nr. 03/L-189 “Për administratën shtetërore në Republikën e Kosovës” e botuar në Fletorën Zyrtare 21 tetor 2010.

Në administratën shtetërore përfshihen: organet, autoritetet dhe organizmat e tjerë të administratës shtetërore si: Ministrinë, Organizatat e administratës shtetërore dhe organet e tjera të administratës, organet e tjera në nivel qendror ose lokal, themelatat<sup>460</sup> dhe personat e tjerë juridik kur autorizohen për të kryer punë publike (neni 5).

Në të gjitha këto institucione punët kryhen nga nëpunësit shtetëror por për dëmin që organet e administratës shtetërore u shkaktojnë të tretëve, mban përgjegjësi vetë shteti, Republika e Kosovës ( shih nenet 12, 13). Pra, përgjegjësia e shtetit karshi të tretëve del e plotë dhe direkte vetëm ndaj tij dhe jo solidarisht me punonjësin e saj që ka vepruar nën urdhërat dhe udhëzimet e institucionit. Në këtë mënyrë kjo lloj forme ngjan me përgjegjësinë e administratës shtetërore në Gjermani. Në nenin 1.7 të këtij ligji është e shprehur qartë se kush i kryen punët shtetërore dhe se çfarë përgjegjësie kanë ato.

Mund të konkludojmë se parimi i përgjegjësise së organeve shtetërore për dëmet e shkaktuara të tretëve, jo palë në një procedim administrativ i takon shtetit, kur punonjësi ka vepruar në përputhje me autorizimin, kompetencat që vetë ligji apo norma të tjera i kanë dhënë.<sup>461</sup> Përgjegjësi mban shteti edhe kur punonjësi ka vepruar me dashje apo në pakujdesi të rëndë. Por, shteti mund të ngrejë padinë e regresit karshi punonjësit përveç masave të tjera disiplinore apo kallzim penal që mund të bëjë ndaj tij.

Format se si ushtron veprimtarinë e saj administrata publike, janë të përcaktuar në ligji për “Procedurën administrative” dhe në ligjin “Për administratën shtetërore”, ku ushtrimin e pushtetit shtetëror e kryejnë nëpunësit e saj dhe shteti mban përgjegjësi për veprime të ligjshme dhe të paligjshme.

Mënyrën se si dëmshpërblehet i dëmtuari, ligj për procedurat administrative e referon tek ligji për administratën shtetërore dhe kjo e fundit tek ligji nr.03/L-149 “Për shërbimin civil të Republikës së Kosovës”.<sup>462</sup> Konkretisht në nenin 14.2 e tij parashikohet se :”6. Të drejtat, detyrimet, përgjegjësitë dhe autorizimet e nëpunësve të administratës shtetërore përcaktohen me dispozitat e ligjit për shërbimin civil dhe atij të pagave të shërbyesve civil.” Pra, pavarësisht se shteti është organi drejtpërdrejtë përgjegjës në Kosovë ka të drejtë të shkarkoj përgjegjësinë e tij tek nëpunësi civil referuar delegimeve ligjor që një ligj bën tek ligji tjetër. Në mënyrë më të qartë paraqitet përgjegjësia e nëpunësit civil në parimet e funksionimit, parimi i përgjegjshmërisë ndaj

3.2. Organet e administratës publike sigurojnë zbatimin e akteve administrative të tyre. 3.3. Aktet administrative të nxjerra në gjendje të jashtëzakonshme, në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji, do të jenë të vlefshme për aq sa rezultati i kërkuar në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme nuk mund të arrihet me mjete të tjera. 3.4. Personat fizikë dhe juridikë të dëmtuar nga aktet administrative, sipas paragrafit 3 të këtij neni, kanë të drejtën e kompensimit në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë përgjegjësinë e administratës publike..”

<sup>460</sup> Shoqërite tregtare.

<sup>461</sup> Për analogji është edhe parshikimi që jep neni 153 I ligjit nr. 04/l-077 “Për marrëdhëniet e detyrimeve” ku në nenin 153- Përgjegjësia e personit juridik për dëmin e shkaktuar nga organi i tij.”

1. Personi juridik përgjigjet për dëmin të cilin organi i tij ia shkaktonte personit të tretë gjatë ushtrimit ose lidhur me ushtrimin e funksioneve të tij.

6. Në qoftë se për rastin e caktuar nuk është parashikuar ndryshe me ligj, personi juridik ka të drejtë në shpërblim nga personi i cili e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia e rëndë.

3. Kjo e drejtë parashkruhet brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh nga dita e pagimit të shpërblimit të dëmit”.

<sup>462</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2679>



vendimeve, veprimeve dhe mos veprimeve që kryjnë gjatë ushtrimit të pushtetit shtetëror,<sup>463</sup> mund të jetë penale, civile apo disiplinore.

Një nga format e kësaj përgjegjësie parashikohet posaçërisht edhe tek neni 65 i po këtij ligji kur nëpunësit veprojnë në kundërshtim me ligjin dhe me faj ose janë të paafte profesionalisht janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar tek qytetarët a institucionit.<sup>464</sup> Institucionit shtetëror i njihet e drejta të inspektoj dhe të vërej se cilët janë shkaqet e vërteta të ardhjes së dëmit tek të tretët, nëse konstatohet se dëmi ka ardhur për shkak të veprimeve të padrejta të vetë punonjësit ndaj tij merret masa disiplinore deri në shkarkim<sup>465</sup> dhe kallzim penal për shpërdorim të detyrës.

Megjithatë institucioneve u njihet e drejta e regresi ose e kthimit të shumës brënda 6 muajve referuar nenit 152<sup>466</sup> të ligjit nr. 04/1-077 “Për marrëdhëniet e detyrimeve”, pa dallim publik a privat, ndaj punonjësve të tij vetëm kur provohet se ai ka vepruar me dashje apo nga pakujdesia e rëndë.

Në vendimin nr. Ac.1336/11 datë 23 tetor 2012 Gjykata e Qarkut Prishtinë la në fuqi vendimin e Gjykatës Komunale të Glllokoçit për çështjen e paditësit A.S ndaj organit administrativ Këshillit të Glllokoçit për shkaktim të dëmit.

Organi administrativ i kishte dhënë në vitin 1992 shtetasit SH.S një ngastër toke prej 32m<sup>2</sup> për të ndërtuar një dyqan. Në 1996 ky vendim u anulua meqënëse SH.S nuk e ndërtoi brënda afatit biznesin përkatës. Në vitin 1996, ngastra iu dha paditësit A.S me të njëjtin motivacion për të ndërtuar dyqanin dhe të shfrytëzonte ngastrën e tokës bashkë me 60 subjekte të tjerë për ndërtime lokalesh.

Paditësi A.S në sipërfaqen 64m<sup>2</sup> ndërtoi dyqanin dy katësh. Në vitin 2001 Këshilli urdhëroi pronarët për të larguar objektet tregtare. Ndaj kësaj vendimarrje banorët e zonës u ankuan dhe Gjykata Komunale e Glllogocit dhe ajo e Qarkut Prishtinë pranuan kërkesën për sigurim të padisë së qytetarëve për mos rrënimin e dyqaneve të tyre (vendim i formës së prerë).

Me 2 mars 2015 edhe pse kishte dijeni për pezullimin e ekzekutimit të atij vendimi deri sa të shprehej gjykata administrative mbi padinë e paditësave, përsëri Këshilli rrënoi lokalit e paditësit AS.

<sup>463</sup> “1.5. Përgjegjësia - Nëpunësit civilë janë të detyruar që të raportojnë, shpjegojnë dhe të përgjigjen për pasojat e vendimeve, veprimeve dhe mosveprimeve të tyre administrative.

1.6. Paanësia dhe pavarësia profesionale - Nëpunësve civilë nuk u lejohet njëanshmëria, që do të thotë të ketë një predispozitë në favor të një rezultati të caktuar gjatë vlerësimit të një situatë, duke shkaktuar si rrjedhojë një dëm të pajustificueshëm për interesin e përgjithshëm ose për të drejtën e palëve të tjera të interesuara.”

<sup>464</sup> Neni 65-Përgjegjësia për dëmet “1. Nëpunësit civilë janë përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuara qytetarëve ose institucionit gjatë ushtrimit të detyrës si rezultat i paafësisë profesionale, neglizhencës së rëndë ose veprimeve të qëllimshme, të paligjshme.

6. Pas përcaktimit të përgjegjësisë, do të bëhet sanksionimi i nëpunësit civil, i cili i ka shkaktuar dëm institucionit ose qytetarëve”.

<sup>465</sup> Po aty neni 64.

<sup>466</sup> Neni 153- Përgjegjësia e punëdhënësit për punëmarrësin “1. Personi juridik ose fizik me të cilin punonjësi ka punuar në kohën e shkaktimit të dëmit është përgjegjës për dëmin e shkaktuar ndaj personit të tretë nga punonjësi gjatë punës apo në lidhje me punën, përveç nëse provohet se punonjësi ka vepruar ashtu siç ka qenë e nevojshme në rrethanat konkrete.

6. Pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit drejtpërdrejt nga punonjësi në rast se dëmin e ka shkaktuar me dashje.

3. Secili person që dëmshpërblen palën e dëmtuar për dëmin e shkaktuar nga punonjësi me dashje apo nga pakujdesia e rëndë ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumës së paguar nga punonjësi.

4. Kjo e drejtë shuhet gjashtë (6) muaj pas ditës së pagesës së kompensimit.

5. Me dispozitën e paragrafit 1. të këtij neni nuk preket në rregullat e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme ose nga veprimtaritë e rrezikshme.”

Paditësi kërkoi në gjykim shpërblimin e dëmit të shkaktuar për : 1) 60 800 euro për lokalin e rrënuar prej 64 m<sup>2</sup>, 2) kompensim për sendet e humbura në masën 4250 euro, 3) për fitimin e munguar 600 euro/muaj që nga 01 mars 2005, 4) për vuajtjet shpirëto 7000 euro, 5) caktimin e një ngastre tjetër të ngjashme për lokal, 6) kamatat për shumat konkrete të kompensimit sipas depozitave të kursimit për bankat e Kosovës dhe 7) shpenzimet procedurale në masën 1004 euro.

Gjykata e Qarkut të Prishtinës në analizën e dëmeve u shpreh se Këshilli në kundërshtim me ligjin për administratën lokale pa pritur të përfundonte kontrata me qytetarin dhe pa i lënë një afat për të liruar ngastrën për shkak të zbatimit të planit urbanistik, prishi dyqanin e qytetarit pa dëshirën e tij. Po sipas kësaj gjykate, që në vitin 2005 Kosova nuk ka pasur ligj të veçantë për përgjegjësinë e organeve lokale për dëmet që u shkaktojnë individëve për shkak të neglizhencës prandaj ligji i zbatueshëm do të jetë ligji “Për mardhëniet detyrimore” e vitit 1978<sup>467</sup> si dhe neni 1 protokollit 1 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut si dhe rregulloren e UMNİK/ut nr. 2000/45 “Mbi vetqeverisjen e Komunave në Kosovë” ku organet e personit juridik mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë individëve për veprime të paligjshme të tyre. Këshilli i Gilloçit nuk arsyetoi pse kishte urgjencë në krijimin e sheshit “Skënderbe” dhe prishjen pa pritur vendimin e gjykatës mbi themeltesinë e aktit administrativ për të liruar ngastrat publike të paditësëve.

---

<sup>467</sup> Ligji Nr. 04/L-077 “Për mardhëniet e detyrimeve” është miratuar me 10 maj 2012 i cili shfuqizoi dhe ligjin e mëparshëm mbi marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/78, 39/85, 57/89).

**KREU VII****TRAJTIMI I DËMEVE JASHTËKONTRAKTORE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE NGA GJYKATA EUROPIANE E BASHKIMIT EUROPIAN***7.1 Hyrje**7.2 Parashikimet në të drejtën komunitare mbi përgjegjësinë civile të Institucioneve të Bashkimit Evropian dhe të tjera raste**7.3 Kushtet për të ekzistuar përgjegjësia jashtëkontraktore sipas të drejtës komunitare dhe jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian**7.4 Përgjegjësia jashtëkontraktore sipas të drejtës komunitare për shkaqe të paligjshme (unlawful acts)**7.5 Përgjegjësia jashtëkontraktore për akte të paligjshme (unlawful acts) të kryera nga punonjësi i institucionit të Bashkimit të Evropian**7.6 Përgjegjësia jashtëkontraktore e shtetit sipas të drejtës komunitare për akte të ligjshme**7.7 Faji si element i rëndësishëm i përgjegjësisë jashtëkontraktore në të drejtën komunitare**7.8 Llojet e dëmeve në përgjegjësinë jashtëkontraktore në të drejtën komunitare.**7.9 Mënyrat e shpërblimit nga Institucionet Komunitare për përgjegjësinë jashtëkontraktore**7.10 Parashkrimi i të drejtës për të kërkuar shpërblim dëmi nga Institucionet e Bashkimit Evropian***7.1 Hyrje**

E drejta administrative e Bashkimit Evropian ka pësuar një zhvillim të hovshëm dy dekadat e fundit. Pavarësisht se Shqipëria nuk është vënd anëtar i saj, sipas Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit të vendeve anëtare të Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë (2006)<sup>468</sup> janë marrë një sërë të detyrimesh të përafritit të legjislacionit administrativ në Shqipëri por edhe të ligjeve të tjera me *aquis communautaire* (e drejtë komunitare). Një nga këto detyrime është edhe rritja e përgjegjësisë që mbajnë organet shtetërore si ato të pushtetit gjyqësor dhe ato të administratës publike, për veprimet e kryera nga funksionarët e tyre gjatë ushtrimit të detyrës.<sup>469</sup>

Kjo përgjegjësi është e parashikuar që në fillim të funksionimit të Traktatit të Komunitetit Ekonomik (KEE) në nenin 215, më pas në nenin 288 të Traktatit të Nicës dhe më pas në nenin 340 në Traktatin e Lisbonës. Por ajo që i ka dhënë konfigurim më të qartë normës dhe autonomisë së zbatimit të saj në vendet anëtare është padyshim jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (ish Gjykata Evropiane e Drejtësisë). Ashtu siç thotë edhe autorja Iva Zajmi, normat e së drejtës komunitare nëse janë të qarta mbi detyrimet, pa detajime të mëtejshme, janë të afta të sjellin pasoja të drejtpërdrejta.<sup>470</sup>

<sup>468</sup> Miratuar me Ligjin Nr. 9590, d27.7.2006 “Për Ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”

<sup>469</sup> Shih më tej VKM Nr. 404, datë 13.5.2015 “Për Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2015 – 2020” dhe VKM Nr. 463, Datë 5.7.2006 “Për Miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit”

<sup>470</sup> Prof. Asoc. Dr. Iva Zajmi “Autonomia e zbatimit të ligjit komunitar” Revista Shqiptare për Studime

Në këtë mënyrë edhe normat e sipërcituara mbi përgjegjësinë civile të institucioneve të Bashkimit Europian, punonjësit e saj dhe vetë Bashkimi si entitet, kanë impakt te shtetet anëtare mbi rastet e përgjegjësive, llojet e saj, masën etj., karshi të dëmtuarve, qofshin ato shtetas të tyre apo jo.

Normat e së drejtës komunitare për t'u njohur të drejtën individëve për shpërblim dëmi nga organet e administratës publike (nënkupto institucioneve komunitare) duhet të jenë jo më pak efektive sesa normat e të drejtës së brendshme për këto raste. Parime të tilla si ai i subsidiaritetit, i proporcionalitetit, i barazisë dhe i efektivitetit duhet të udhëheqin gjithmonë institucionet e BE.<sup>471</sup>

## 7.2 Parashikimet në të drejtën komunitare mbi përgjegjësinë civile të Institucioneve të Bashkimit Evropian dhe të tjera raste

Përgjegjësia e organeve të BE karshi qytetarëve të shteteve anëtare, parashikohet sot në Traktatin e Lisbonës<sup>472</sup> në nenin 340 ku parashikohet se: *“Përgjegjësia kontraktuale e Bashkimit bazohet te ligji i aplikueshëm ku është mbështetur kontrata.*

*Në rast të përgjegjësive jashtëkontraktore, Bashkimi Europian bazuar edhe në parimet e përgjithshme të përbashkëta te shteteve anëtare, shpërblen çdo dëm të shkaktuar nga institucionet e tyre ose nga nëpunësit gjatë kryerjes së detyrave.*

*Pavarësisht paragrafit të dytë, Banka Qëndrore Europiane, sipas parimeve të përbashkëta të legjislacionit të shteteve anëtare, shpërblen çdo dëm të shkaktuar nga ajo apo nëpunësit e saj gjatë ushtrimit të detyrës së tyre.*

*Përgjegjësia vetjake e nëpunësve përkundrejt Bashkimit, do të bazohet në rregulloret e brëndshme ose në kontratat e punësimit që zbatohen per to.”*

Në fakt, neni mori këtë formë me ndryshimet që iu bënë të drejtës komunitare, funksionimit të institucioneve të BE-së me Traktatin e Lisbonës ose *“[Treaty on the Functioning of the European Union \(TFEU\)](#)”<sup>473</sup>.*

Që nga fillimi i veprimtarisë së Komunitetit Ekonomik Europian (KEE) në 1955 dhe më pas me rregullimet në Traktatin e Mاستrihtit (1992)<sup>474</sup>, përgjegjësia kontraktore dhe jashtëkontraktore e Komunitetit Europian normohej nga neni 215 në të cilin parashikohet: *“Përgjegjësia kontraktore e Komunitetit do të udhëhiqet nga ligji i zbatueshëm i kontratës përkatëse. Në rastin e përgjegjësive jashtëkontraktore, Komuniteti në përputhje me parimet e përbashkëta të përgjithshme të të drejtave të Shteteve Anëtare, mban përgjegjësi për çdo dëm të shkaktuar nga institucionet e saj dhe nga punonjësit gjatë kohës së ushtrimit të detyrës.*

*Ky paragraf do të zbatohet në të njëjtën mënyrë edhe për dëmet e shkaktuara nga Banka Europiane Qëndrore (ECB) ose nga punonjësit e saj gjatë ushtrimit të detyrave. Përgjegjësia personale e punonjësve karshi Komunitetit do të udhëhiqet nga parashikimet në Rregulloren e Personelit ose në Kushtet e Punësimit të tyre.”*

Neni 215 u ndryshua nga neni 288 në Traktatin e Bashkimit Evropian (Nicë, 2001) ku parashikohet se: *“Përgjegjësia kontraktore e Komunitetit udhëhiqet nga ligji*

Ligjore, volumni 1, 2011, faqe 100.

<sup>471</sup> R.Matefi dhe M.Musan “ECJ case law and its impact on the evolution of administrative liability; State liability for infringement”, Bulletin of the Transilvania University of Braşov, vol.4 (53), No.1-2011, faqe 118.

<sup>472</sup> Traktati i Lisbonës ka hyrë në fuqi më 01 janar 2009, i quajtur “Traktati i Funksionimit të Bashkimit Europian”, përveç antarësimeve të reja, ndryshoi Traktatin e BE dhe atë të KE”, version i azhurnuar i ndodhur në Fletoren Zyrtare O.J. 2010, C 83/1.

<sup>473</sup> Gazeta Zyrtare Nr. C326/1 datë 26 tetor 2012, volume 55.

<sup>474</sup> Traktati i Funksionimit të Bashkimit Evropian, Gazeta Zyrtare C 19, Volume 35 datë 29 Korrik 1992.

*i zbatueshëm për kontratën përkatëse. Në rastin e përgjegjësië jashtëkontraktore, Komuniteti në përputhje me parimet e përgjithshme të përbashkëta të Shteteve Anëtare, mban përgjegjësi për çdo dëm të shkaktuar nga institucionet e saj apo nga nëpunësit gjatë ushtrimit të detyrës.*

*Paragrafi i mësipërm, do të zbatohet për të njëjtat kushte për dëmet e shkaktuara nga Banka Qëndrore Europiane (ECB) ose nga punonjësit e saj gjatë ushtrimit të detyrave.*

*Përgjegjësia personale e punonjësve përkundrejt Komunitetit do të udhëhiqet nga parashikimet e Rregullores së Stafit ose në Kushtet e Punësimit që zbatohen për ta.”*

Sipas autores Katrin Arend Gjykata e Drejtësisë duhet të vendosë bazuar në parimet e përbashkëta të së drejtës së 29 shteteve anëtare pasi ka disa shtete e mbështesin shpërblimin për dëmet e ardhura në të drejtën e pronësisë dhe disa shtete të tjera si Gjermania apo Franca kanë dispozita të veçanta në Kodin Civil dhe nuk kërkojnë vetëm parime.<sup>475</sup>

Megjithatë, si në çështjen *FIAMM Nr. T-69/00,(2005)*<sup>476</sup>, Gjykata konstatoi se BE mban përgjegjësi për dëme të ardhura edhe në rast e ajo nuk ka vepruar në mënyrë të paligjshme, rast i cili nuk ishte parashikuar në ndonjë nga shtetet anëtare, por shkon në frymën e vetë Traktatit dhe BE, për të qenë e përgjegjshme për dëmet që u vijnë shtetasve për shkak të veprimeve të BE.

Në fakt Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Europian (më tej GJDE ose GJE e BE) me vendimet e saj, e ka krijuar “shtrojën” e vërtetë ligjore për interpretimin e rasteve të përgjegjësisë, gamën e dëmeve që mund të mbulojnë, rastet përjashtimore etj. Kjo në respektim edhe të nenit 41 “E drejta për administrim të mirë” e Kartës Europiane të të Drejtave Themelore ku parashikohet se: “Çdo njeri ka të drejtë që pretendimet e tij të trajtohen në mënyrë të paanëshme, drejtë dhe në një kohë të arsyeshme nga institucionet dhe organet e Bashkimit.

## *2. E drejta përfshin:*

*- e drejta për t’u dëgjuar para se për të të merret ndonjë masë personale që prek atë;*

*- e drejta e çdo personi që të ketë akses në dosjen që i përket atij, duke respektuar interesat e ligjshme për konfidencialitet dhe për ruajtje të sekretit profesional dhe tregtar;*

*-detyrimi i administratës të arsyetojë vendimet e saj.*

*3. Çdo person ka të drejtë të ketë shpërblim nga Komuniteti për çdo dëm të shkaktuar nga institucionet apo punonjësit e saj gjatë ushtrimit të detyrave të tyre në përputhje me parimet e përgjithshme të përbashkëta të çdo shteti anëtar.*

*4. Çdo person ka të drejtë t’u shkruajë institucioneve të Bashkimit në një gjuhë të traktatit dhe duhet të ketë një përgjigje në të njëjtën gjuhë”*

Pra, nëse dëmi i shkaktuar ka ardhur nga performanca e dobët apo gabime të punonjësve apo të institucioneve si BE, Banka Qëndrore Europiane etj., këto të fundit mbajnë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar qytetarëve apo personave juridikë të regjistruar në vende të BE-së dhe shpërblejnë këtë dëm jashtëkontraktor. Gjithësesi, në lidhje me përgjegjësinë vetjake të nëpunësve, ajo rregullohet nga legjislacioni i brendshëm i çdo shteti anëtar apo kontrata e lidhur me punonjësin fajtor.

<sup>475</sup> K. Arend, “EC Liability in the Absence of Unlawfulness. The FIAMM Case”, *Göttingen Journal of International Law* 1 (2009) 1, 199-218 faqe 214.

<sup>476</sup> *Fabbrica Italiana Accumulatori Motocarri Montecceio SPA kundër Këshillit dhe Komisionit (FIAMM), T-69/00, (2005).*

Në këtë nen parashikohet se Banka Qëndrore Europiane mban përgjegjësi vetë, të pavarur nga BE për dëmet e shkaktuara nga Institucionet apo nëpunësit e saj gjatë ushtrimit të detyrave. Në traktatin e Mاستrihtit apo edhe në atë të Nicës, këtë përgjegjësi jashtëkontraktore të Bankës dhe të punonjësve të saj e mbante vetë Komuniteti.

Por cilët janë institucionet e Bashkimit European?

Në rastin e përgjegjësive jashtëkontraktore BE shpërblen dëmet e ardhura personave fizikë dhe personave juridikë të regjistruar ose jo në BE, por mjafton që dëmi të ketë ardhur nga veprimtaria ose jo e punonjësve të saj, organeve të saj apo edhe vetë kur BE ka marrë pjesë si një subjekt më vete në marrëdhëniet ndërkombëtare si p.sh., në rastin kur hyn në marrëdhënie ekonomike me Organizatën Ndërkombëtare të Tregtisë. Në mënyrë të përmbledhur aktualisht në BE funksionojnë këto organe legjislativë, ekzekutive dhe në fushën e drejtësisë:

1. Parlamenti European;
2. Këshilli i Bashkimit European;
3. Komisioni European
4. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European (GJD e BE ose GJED)
5. Banka Qendrore Europiane (BQE)
6. Gjykata Europiane e Auditorëve (ECA)
7. Shërbimi European i Veprimit të Jashtëm (EEAS)
8. Komiteti Social Ekonomik European (KESE)
9. Komiteti i Rajoneve (KR)
10. Banka Europiane e Investimeve (EIB)
11. Avokati i Popullit (Ombudsmani)Evropian
12. Mbikqyrësi European i të Dhënave Personale (EDPS)
13. Organet e tjera ndërinstitucionale<sup>477</sup> si Zyra e Publikimeve, Zyra

Europiane e Përzgjedhjes së Personelit, Shkolla Europiane e Administratës dhe një sërë agjencishë për çdo fushë si të aviacionit, të azil-kërkuesave, të emigracionit, të mjedisit, të peshkimit etj.<sup>478</sup>

Në nenin 268 (ish-neni 235<sup>479</sup>) të TFEU (Traktatit të Lisbonës) parashikohet se: *“Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European ka juridiksion për çështje që lidhen me kompensimin e dëmeve për paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 340.”* Pra, kompetente për gjykimin e të tilla çështjeve sipas nenit 340 §2, 3 të TFEU, është Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit European. (më parë Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata Europiane e Drejtësisë e cila gjykonte si shkallë e dytë ankimet ndaj vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë).<sup>480</sup>

Si palë paditëse (njihen edhe si palë kërkuese ose ankuuese) paraqiten persona fizikë ose juridikë, banues ose jo në shtetet anëtare të BE-së, por mjafton që të provohet se dëmi është shkaktuar nga një institucion i BE-së, Banka Qendrore Evropiane apo edhe punonjësit e tyre, dhe këto palë legjitimohen të paraqesin një padi të tillë. Sipas praktikës së GJDE, si palë e paditur është thirrur Këshilli ose Komisioni i Bashkimit European, apo të dyja së bashku.

<sup>477</sup> [https://europa.eu/european-union/about-eu/institutions-bodies\\_en](https://europa.eu/european-union/about-eu/institutions-bodies_en).

<sup>478</sup> Shih më tej agjencitë e decentralizuara të BE: [https://europa.eu/european-union/about-eu/agencies/decentralised-agencies\\_en](https://europa.eu/european-union/about-eu/agencies/decentralised-agencies_en).

<sup>479</sup> Neni 235 i Traktatit të Komunitetit European kishte këtë parashikim *“Gjykata e Drejtësisë ka juridiksion për mosmarrëveshjet mbi dëmet që lidhen me paragrafin e dytë të nenit 288.”*

<sup>480</sup> [http://www.lisbon-treaty.org/wcm/images/12002E\\_EN.pdf](http://www.lisbon-treaty.org/wcm/images/12002E_EN.pdf), Gazeta Zyrtare e Komunitetit European datë 24 dhjetor 2002, Nr. C325/33.

### 7.3 Kushtet e përgjegjësive jashtëkontraktore sipas të drejtës komunitare dhe jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian

E drejta komunitare njihet parimet e përbashkëta të së drejtës së shteteve anëtare mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike karshi shtetasve përse i përket llojeve mënyrëve të shpërblimit, parimet që udhëheqin ato në përfundimin nëse ka përgjegjësi apo jo.

Në mënyrë të përmbledhur kushtet për të pasur përgjegjësi jashtëkontraktore, një organ i BE-së ose vetë shteti anëtar, sipas nenit 340 (ish-288§) të TFEU por, edhe jurisprudencës së Gjykatave të BE përmbledhen tek vendimi T-113/04, datë 12 Dhjetor 2007, *Atlantic Container Line AB kundër Komisionit*, i Gjykatës së Shkallës së Parë (First Instancë Court). Në këtë vendim është vendosur se:

1. Sjellja e institucionit me veprimet a mosveprimet e tij, duhet të jetë e paligjshme.<sup>481</sup>
2. I dëmtuari duhet të ketë pësuar një dëm aktual dhe të materializuar.
3. Të ekzistojë një lidhje shkakësore direkte midis aktit të paligjshëm të shtetit apo të institucionit të tij apo të BE-së, dhe dëmit të ardhur.<sup>482</sup>

Këto janë tre pyetje klasike që shtrihen Gjykata në analizimin e përgjegjësive jashtëkontraktore qoftë kur aktet e kryera nga institucionet e BE-së janë të ligjshme qoftë kur janë të paligjshme, mungesa qoftë edhe një kushti, çon gjykatën në rrëzimin e kërkesës pa hetuar nëse kushtet e tjera janë plotësuar apo jo.

Në çështjen T-184/95, datë 28 prill 1995, *Dorsch Consult Ingenieurgesellschaft mbH, kundër Komisionit dhe Këshillit*, provohet se ankuesi ishte një shoqëri gjermane që ushtronte veprimtari në fushën e konsulencës inxhinierike. Që nga viti 1975 kishte marrëdhënie të rregullta kontraktore me Ministrinë e Punës dhe të Ndërtimit dhe të Republikës së Irakut. Për kontratat e fundit të lidhura për punimet në autostradën e shpejtë Irak Nr. 1 (Expressway Irak Nr.1) kjo e fundit kishte detyrime monetare të pashlyera. Në muajin Shkurt të vitit 1990 Ministria urdhëroi Rafidian Bank për të realizuar transferimet bankare.

Me datë 06 Gusht 1990, Këshilli i KEE miraton Rregulloren nr. 2340/90 duke vendosur hembargo ndaj Kuvajtit dhe Irakut, si rezultat i pushtimit të Kuvajtit nga Iraku (pushtim i shpallur me Rezoluën e OKB me datë 02 Gusht 1990).

Këshilli sipas nenit 1 të kësaj Rregullore parashikon se ndalohen që nga data 7 Gusht 1990 futja në territorin e Komunitetit të të gjitha mallrave, produkteve me origjinë ose tranzit nga Iraku apo Kuvajti, dhe ndalohet eksporti në ato vende të të gjitha mallrave ose produkteve me origjinë apo, që vijnë nga Komuniteti.

Neni 2 i kësaj rregullore parashikon se ndalohen që nga data 7 Gusht 1990 të gjitha aktivitetet ose transaksionet tregtare, tashmë të lidhura ose të kryera pjesërisht mbi promovimin e eksportit të çdo malli ose produkti me origjinë, apo që vjen nga Iraku apo Kuvajti, shitja ose furnizimi i çdo malli ose produkti, kudo që buron ose vjen nga Iraku apo Kuvajti dhe çdo aktivitet që synon nxitjen e shitjeve apo furnizimeve të tilla.

Me datë 16 Shtator 1990, Këshilli i Lartë Revolucionar i Republikës së Irakut, duke iu referuar "vendimeve arbitrare nga qeveritë e caktuara" vendosi mbrojtjen e pronës, interesave dhe të drejtave të Irakut ndaj vendeve të tjera, duke sekuestruar të gjitha pronat dhe asetet, të ardhurat e shtetasve/shteteve që kishin miratuar "vendime arbitrare" kundër Irakut.

<sup>481</sup> Këtu nënkupto dhe rastet kur akti është i ligjshëm. Më poshtë do të analizohet çështja FIAMM mbi interpretimin e zgjeruar të nenit 288 jo vetëm për aktet e paligjshme por edhe ato të ligjshmet;

<sup>482</sup> Pargrafi 28 i vendimit.

Shoqëria “Dorsch” i kërkoi Këshillit dhe Komisionit për të kompensuar dëmin e shkaktuar si pasojë e huave të pashlyera nga Qeveria irakene në përgjigje të miratimit nga ana e Komunitetit të Rregullores Nr. 2340/90. Gjatë gjykimit, kërkuesit pranuan se nuk i ishin drejtuar më parë shtetit iraken për të shlyer detyrimet e konsulencës inxhinierike për Autostradën Nr. 1 Irak.

Gjykata u shpreh në analizë të nenit 288 të Traktatit të KEE se:

“59. Që Komuniteti të ketë përgjegjësi jashtëkontraktore si pasojë e një akti të ligjshëm apo të paligjshëm, është e nevojshme të provohet se dëmi është i vërtetë, ekziston një lidhje shkakësore midis aktit dhe dëmit të pretenduar. (shih më tej çështjen 26/81 *Oleifici Mediterranei kundër EEC* [1982] ECR 3057, paragrafi 16, T-481/93 dhe çështjen T-484/93 *Exporteurs Letters-Varkens dhe të tjerët kundër Komisionit* [1995] ECR II -2941, paragrafi 80, çështjen T-175/94 të *Procurment International Services kundër Komisioni* [1996] ECR II-729, paragrafi 44, çështjen T-336/94 *EFISOL kundër Komisioni* [1996] ECR II-1343, paragrafi 30, *Cas çështjen e T -267/94 Oleifici Italiani kundër Komisioni* [1997] ECR II-1239, paragrafi 20, dhe çështjen T-113/96 *Dubois et Fils kundër Këshilli dhe Komisioni* [1998] ECR II-125..... Prandaj është e nevojshme të merret në konsideratë nëse ekziston dëmi i pretenduar, në kuptimin se është "i vërtetë dhe i sigurt", nëse dëmi është rezultat i drejtpërdrejtë i miratimit të Rregullores Nr. 2340/90 të Këshillit, dhe nëse dëmi i pretenduar është i tillë si për ta bërë Komunitetin përgjegjës në lidhje me një akt të ligjshëm në kuptim të jurisprudencës së lartpërmendur.”

Sipas autores Kathleen Gutman, këto tre kushte njihen si kushte thelbësore të shpërblimit të dëmit në të drejtën europiane<sup>483</sup> dhe po ashtu ekzistojnë dhe kushte të tjera formale të këtij instituti. Këto kushte të tjera që merren parasysh nga Gjykata janë jo më pak të rëndësishme dhe ndahen në materiale ose formale si:

1. Duhet të jenë shkelur interesat dhe të drejtat themelore të individit si p.sh., e drejta e pronës, e drejta për mosdiskriminim, e drejta e jetës familjare, ushtrimi i përgjegjësisë prindërore etj. Nuk mbrohen dëmet që i vijnë shtetit nga një shtet tjetër pasi rregullohen me akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara ose nga marrëdhëniet reciproke mes vetë shteteve.<sup>484</sup>
2. Nuk shpërblehet çfarëdo lloj dëmi i pretenduar por ai duhet të jetë i sigurt, aktual dhe jo i ardhshëm. Pra kërkohet një pasojë e materializuar te individi i dëmtuar dhe nuk mund të kërkosh shpërblim për një dëm i cili mund të vijë me probabilitet nga shkelja e të drejtës komunitare.<sup>485</sup>

Gjykata në lidhje me një dëm të ardhshëm në çështjen *Cofradía de Pescadores de “SanPedro” de Bermeo* u shpreh se: “... ankuesi kërkon kompensim për dëmin e ardhshëm por dështoi për të bindur gjykatën se ka një dëm eminent, me një

<sup>483</sup> Dr. Kathleen Gutman “The evolution of the action for damages against the european union and its place in the system of judicial protection” *Common Market Law Review* 48: 695–750, 2011, United Kingdom.

<sup>484</sup> Në çështjen T-4 15/03, datë 19 Tetor 2005 “Cofradía de pescadoresde ‘SanPedro’ deBermeo” kundër Këshillit , Gjykata u shpreh se: “kur kemi të bëjmë me legjitimitet për kërkesën e shpërblimit të dëmit, duhet që personat (fizikë apo juridikë) t’u jenë dëmtuar të drejtat e tyre të cilat mbrohen përpara çdo gjykate të brëndshme. Parimi i marrëdhënieve të qëndrueshme mes shteteve nuk japin mbi individët të drejta direkte, Rregullorja Nr. 3760/92, bën ndarjen e kuotave të peshkimit mes antarëve, nisur nga nevojat e veçanta të rajonev. Popullsia që janë lidhur veçanërisht me nevojat e peshkimit, nevojat e industrisë që varen nga peshkimi etj., të trajtohen ndryshe. Gjykata rrëzoi kërkesën për shpërblim dëmi pasi parimi i marrëdhënieve të qëndrueshme mes shteteve anëtare dhe nenit 161 (1) (f) të Ligjit të Anëtarësimit nuk kanë për qëllim të japin të drejta mbi individët prandaj nuk është e nevojshme të konsiderojmë se shkelja e kësaj rregullore është aq e rëndë, për sa kohë nuk janë shkelur të drejtat e individëve por marrëdhëniet mes shteteve anëtare”.

<sup>485</sup> Ibid. paragrafin 102, 103.



*parashikueshmëri të sigurtë për dëmin në të ardhmen (shih çështjen Hameico Stuttgart dhe të Tjerë k. Këshillimit dhe Komisionit paragrafi 63)."*

3. Në analizën e lidhjes shkakësore, i dëmtuari duhet të provojë që ka pasur një sjellje të arsyeshme për të shmangur apo për të kufizuar masën e dëmit.<sup>486</sup> Në rast se provohet se lidhja shkakësore është ndërprerë nga një pakujdesi e të dëmtuarit, ky nuk dëmshpërblehet nëse veprimi i tij ka qenë shkak i menjëhershëm dhe determinant në ardhjen e pasojës.  
Lidhja shkakësore është analizuar hollësisht te çështja *Schneider Electric SA* ku gjykata shprehet se analiza e lidhjes shkakësore nuk mund të fillojë nga një premisë e gabuar por duhet të bazohet në një krahasim midis sjelljes së paligjshme dhe situatës nëse sjellja e institucionit do të ishte sipas ligjit, ose analizohet nëse do të kishte ardhur kjo pasojë në mungesë të këtij shkak.<sup>487</sup>
4. Po ashtu një kriter formal-procedural që duhet të përmbushë padia është ajo e barrës së proves që takon palës së dëmtuar. Këtu përfshihen: ekzistenca e dëmit, masa dhe llojet, lidhja shkakësore mes aktit të shkelur dhe dëmit të shkaktuar, etj.<sup>488</sup>  
Shkelja e të drejtave themelore të individit duhet të jetë serioze dhe e rëndë që nënkupton rastet kur institucionet shkelin hapur kompetencat e tyre dhe i shpërfillin ato.<sup>489</sup>
5. Këto kushte janë cituar edhe një herë në vendimin *Bergaderm dhe Goupil kundër Komisionit European*, ku Gjykata shprehet se *"Tre janë kushtet që një person të shpërblehet për dëmet e shkaktuara nga institucioni shtetëror për shkelje të të drejtave të mbrojtura nga e drejta komunitare: 1) ligji i shkelur çënon të drejtat e individëve, 2) shkelja duhet të jetë mjaftueshmërisht e rëndë, 3) duhet të ketë një lidhje direkte shkakësore mes shkeljes së detyrimeve që ka shteti karshi të drejtës komunitare dhe dëmit të pësuar nga individit.*  
*Në lidhje me kushtin e dytë përbën shkelje të rëndë kur Shteti Anëtar ose institucioni i Komunitetit kanë shpërfilluar haptazi dhe dukshëm kufijtë e kompetencave të tyre. Nëse këta kanë kufizuar ose jo kompetencat duke shkelur të drejtën komunitare mund të përbëjë shkelje mjaftueshmërisht të rëndë"*.<sup>490</sup>

<sup>486</sup> Paragrafi 31, 32 i vendimit.

<sup>487</sup> Çështja Nr. T-351/03, datë 11 Korrik 2007 *Electric SA* kundër Komisionit të Komunitetit Evropian, paragrafi 264, 269.

<sup>488</sup> Shih çështjen T-4 15/03, datë 19 Tetor 2005 *"Cofradía de pescadores de San Pedro de Bermeo"* kundër Këshillit paragrafi 34.

<sup>489</sup> Çështjet e bashkuara Nr. 116/77 dhe 124/77, datë 05 dhjetor 1979, *G. R. Amylum N.V dhe Tunnel Refineries Limited, London*, mbi interpretimin e nenin 215 të Traktatit të KEE, GJED shprehej se: *"Një situatë që rrjedh nga një masë legjislative si ligji, rezulton e kundërligjshme, në vetvete nuk është mjaftueshme që Komisioni të konsiderohet përgjegjës. Tashmë në disa raste Gjykata ka konsoliduar praktikën gjyqësore në vendimin e saj të datës 25 Maj 1978 *Bayerische HNL* kundër Këshillit dhe Komisionit ([1978] ECR 1209). Në këtë vendim interpretohet se nuk kemi përgjegjësi jashtëkontraktore (civile) për masat ligjore të marra në fushën ekonomike nëse nuk janë në shkelje mjaftueshmërisht të rëndë të një të drejtë themelore mbi mbrojtjen e lirisë të individit. Pra nisur nga parimi i përgjegjësisë së autoriteteve publike për dëmet e shkaktuara individëve për masat legjislative të marra, gjykata ka çmuar se në kontekstin e legjislacionit ka të drejtë të ushtrojë diskrecion të gjërë për implementimin e politikave bujqësore dhe përgjegjësia e Komunitetit mund të pretendohet vetëm në rastet kur institucionet në mënyrë të hapur dhe të rëndë shpërfillin kufijtë e kompetencave të tyre."*

<sup>490</sup> Çështja Nr. T-199/9616 Korrik 1998 kundër, *Laboratoires Pharmaceutiques Bergaderm SA* Komisionit të KEE, paragrafi 42-43.

Edhe në çështjen *Mytravel Group plc* kundër Komisionit të Komunitetit Evropian, Nr. T-212/03, datë 09 shtator 2008, paragrafi 40 Gjykata u shpreh se *"... Kur institucioni ka një reduktim të konsiderueshëm ose jo të kompetencave që ka passjell një shkelje të lehtë të së drejtës komunitare, mund të përbëjë një shkelje mjaft serioze të së drejtës komunitare"*.

Pra, nëpërmejt foljeve “përbën” dhe “mund të përbëjë” shkelje të rëndë, Gjykata ka ndarë rastet. Nuk ka mundësi interpretimi kur institucioni vepron në shpërfillje të hapur dhe të rëndë të kompetencave të saj ndërsa ndërsa kur ka vepruar në tejkallim të kompetencave të tij është në diskrecion të gjykatës përkatëse përcaktimi nëse kemi të bëjmë me shkelje mjaftueshmërisht të rëndë për të shpërblyer dëmin.

Po në këtë çështje, Gjykata u shpreh se natyra e individuale apo e normative e aktit administrativ nuk përbën kriter deciziv për të identifikuar masën e kompetencave të institucionit në fjalë.<sup>491</sup>

Nëse sjellja e institucionit apo punonjësve të tij është në shkelje të së drejtës komunitare dhe nuk manifeston sjelljen e tyre normale, përbën një shkelje mjaftueshmërisht të rëndë për të kërkuar shpërblim. Hetimi identifikon se cila ka qenë sjellja normale e institucionit apo punonjësve për të njëjtën situatë, nëse kemi të bëjmë me një shkelje me dashje të së drejtës apo është një rast sporadik. Ja, si thotë për këtë moment Gjykata në çështjen *Mytravel kunër Komisionit*: “...në rastin konkret nisur edhe nga parimet e vënë në rastin *Bergadern, palët tashmë e kanë të qarta se koncepti i shkeljes mjaftueshmërisht të rëndë nuk përfshin gabimet të cilat edhe pse të rënda, nuk përputhen me sjellje normale të institucionit përgjegjës ...”*

6. Një kusht formal që përmend Dr.Gutman është ajo e parashkrimit. Sipas nenit 46 të Statutit të Gjykatës i dëmtuari duhet të paraqesë ankimin brenda pesë viteve nga moment i shkakimit të demit ose nga momenti i vënies në dijeni për të.

Në çështjen T-124/99 datë 17 Janar 2001, *Autosalone Ispra Dei Fratelli Rossi k. Komitetit Evropian i Atomit dhe Energjisë (EAEC)* e përfaqësuar nga Komisioni paditësi pretendonte shpërblim dëmi si rezultat i përmbytjes me datë 02 Qershor 1992 të banesës së tij nga mosfunksionimi i kanaleve ujëmbledhëse të bllokuara me inerte. Ankuesi i ishte drejtuar institucioneve të ndryshme kombëtare, komunitare dhe pasi nuk kishte gjetur zgjidhje me datë 21 Maj 1999 i drejtohet Gjykatës së Shkallës së Parë. Kjo e fundit rrëzoi kërkesën si të parashkruar meqenëse shkaku i paligjshëm kishte ndodhur me datë 2 Qershor 1992 për të cilën ankuesi kishte rënë në dijeni atë ditë, ndërsa padia ishte paraqitur në datë 21 Maj 1999, një kohë tepër e gjatë pas kalimit të afatit të parashkrimit, datë 02 qershor 1997.

#### **7.4 Përgjegjësia jashtëkontraktore sipas të drejtës komunitare për akte të paligjshme (unlawful acts)**

Që në fillimet e jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë (GJED), neni mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve dhe institucioneve të KEE (më pas BE) lidhej ngushtë me parimet e përbashkëta që udhëheqin të drejtën e shteteve anëtare mbi këtë institut. Ashtu si edhe në të drejtën e brendshme, një padi e tillë përpara gjykatës për shpërblim të demit jashtëkontraktor paraqitet kur akti është i paligjshëm dhe së dyti, i dëmtuari nuk është i detyruar t'i drejtohet gjykatës kombëtare për të konstatuar dhe anuluar një akt të tillë por drejtpërdrejtë mund të kërkojë shpërblimin e demit nga një akt i paligjshëm.

Pra, themi se padia për shpërblim dëmi për akte të paligjshme të institucioneve të BE-së është një padi autonome. Ky qëndrim është që më datë 05 Dhjetor 1979 nga Gjykata në çështjet e bashkuara Nr. 116/77 dhe 124/77, *G. R. Amylum N.V dhe Tunnel Refineries Limited, London*. Ankuesit kundërshtuan politikën ekonomike të vendosur me Rregulloren Nr. 1111/77 të Këshillit pasi diskriminonte një prodhues izogluoze në

<sup>491</sup> Shih po aty paragrafin 42 të vendimit.

krahasim me prodhuesit e sheqerit, duke e tatuar më shumë, aq sa passolli edhe falimentimin e fabrikës.

Në fund gjykata interpretoi natyrën autonome të ankimeve për shpërblim dëmi: *“Pra, megjithëse në paditë për dëmshpërblim sipas nenit 178 dhe 215 të Traktatit, përbën një padi të pavarur, ajo duhet të mbështetet nisur nga sistemi ligjor që mbron të drejtat e individit. Nëse një individ pretendon se është dëmtuar nga masat ligjore të Komunitetit, ai ka mundësinë që kur ky ligj të implementohet në vendin e tij, ta godasë përpara një gjykate vëndase kundër autoritetit të brendshëm që e zbaton këtë ligj. Gjykata ka mundësinë që edhe të ngrejë pyetje paraprake për interpretim përpara Gjykatës së Drejtësisë në lidhje me vlefshmërinë e këtyre masave.”*

Edhe pse gati 30 vite nga ky vendim, ky qëndrim mbahet përsëri nga ana e Gjykatës mbi autonominë e kësaj padie. Në çështjet OJ C 294 datë 02 dhjetor 2006, *Reynolds Tobacco dhe të Tjerët kundër Komisionit*<sup>492</sup> apo në çështjen Nr. T-415/03, datë 19 Tetor 2005 *Cofradía de Pescadores de ‘San Pedro’ de Bermeo kundër Këshillit*, është konsoliduar praktika gjyqësore se paditë për shkaktim dëmi janë të pavarura nga paditë për konstatimin e aktit të paligjshëm ndaj të cilit pretendohet dëmi. Prandaj anulimi i një akti që ka sjellë dëmin ose deklarimi i pavlefshmërisë nuk kërkohet përpara se të paraqitet padia e shpërblimit të dëmit të shkaktuar.

Gjykata shprehet se individëve nuk u mohohet e drejta për t’u drejtuar gjykatës për shpërblim dëmi sipas nenit 235 dhe nenit 288§2 i TEC, sepse akti mund të anulohet gjyqësisht ose nuk është anuluar më parë, por mjaftohen që të provohet që sjellja e institucionit ka një natyrë që përbën përgjegjësi për Komunitetin.

Kjo tregon se padia për shpërblim dëmi jashtëkontraktor të shkaktuar nga BE apo nga BQE është një padi që kërkon të plotësohen kriteret e nenit 340 (ish-neni 288 i Traktatit të KEE) pa u varur nga detyrimi që në fillim të filtrohet në një gjykim tjetër nëse veprimi i institucionit është i paligjshëm e më pas të kërkohen shpërblimi i dëmit të pësuar.

Ndikim të madh në paditë e shpërblimit të dëmit dhe përgjegjësinë e shtetit të nxirret nga triumviratet e vendimeve të GJED, Francovich, Brasserie dhe Köbler ku janë dhënë interpretime sipas kërkesave paraprake për mendim që shtetit i kanë kërkuar Gjykatës.

Në të gjithë doktrinën e së drejtës komunitare për përgjegjësië jashtëkontraktore të institucioneve të BE-së është e pamundur të mos gjesh të cituara këto vendime, duke shërbyer si gurë themeli për jurisprudencën dhe studiuesit e ardhshëm. I shqyrtojmë një nga një për të kuptuar se çfarë është konsoliduar në to:

1. Çështjet e bashkuara C-6 & 9/90, datë 19 nëntor 1991 *Francovich dhe të Tjerët, [1991] ECR I-5357 Francovich kundër Republikës së Italisë.*

Z. Francovich punonte për Cdn Elettronica Snc në Vicenza Itali, por kishte marrë vetëm pagesa sporadike prandaj ai paraqiti padi përpara Gjykatës së Qarkut të Vicenzës e cila urdhëroi të paditurin Cdn Elettronica Snc për të paguar rreth 6 milionë lira në favor të Z.Francovich. Për shkak se çështja nuk po ekzekutohej nga përmbarimi Z. Francovich paditi shtetin Italian për të zbatuar garancitë që jepte Direktiva nr. 80/987 ose ndonjë mundësi kompensimi.

Në çështjen tjetër, Danila Bonifaci dhe 33 punonjës, paraqitën padi përpara Gjykatës së Qarkut të Bassano Del Grappa, duke deklaruar se ishin punësuar nga Gaia Confezioni Srl, e cila kishte falimentuar më 5 Prill 1985, duke lënë rreth 253 milion lira detyrim të papaguar ndaj punëmarrësve. Edhe pse procedura e falimentimit zgjati më

<sup>492</sup> Idem. Paragrafi 84.

tepër se 5 vjet akoma nuk ishte paguar asgjë dhe se ishte krejtësisht e pamundur shpërndarja e masës së falimentimit në favor të tyre. Si pasojë, paditësit paditën Republikën Italiane për të zbatuar Direktivën 80/987 e cila duhet të paguajë prej 23 Tetor 1983 pagat e pamarra, ose të paktën pagat e tre muajve të fundit apo ndonjë kompensim. Gjykatat italiane përpara së cilës po gjykonin çështjet ngritën këto çështje përpara GJED:

1. *Së pari - A mundet një individ i cili është cënuar nga mos implementimi i Direktivës 80/897, të kërkojë nga një Shtet Anëtar garancitë që ky shtet duhet të parashikonte dhe të kërkojë shpërblim të dëmit dhe të humbjes që ka pësuar për mos zbatim të së drejtës që i vjen nga kjo direktivë?*
2. *Së dyti - A mund të interpretohen nenet 3<sup>493</sup> dhe 4<sup>494</sup> të Direktivës 80/987 se nëse një shtet nuk ka përcaktuar afate është i detyruar të paguajë punëmarrësit?*
3. *Së treti - Nëse jo, cilat janë garancitë minimale për një punëmarrës, që shteti i duhet të parashikojë sipas direktivës 80/897, për pagat e pamarra?*

Në vendimin e saj, GJED dha këtë përgjigje: *“Dispozitat e Direktivës së Këshillit Nr. 80/987 / KEE datë 20 Tetor 1980 “Mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me mbrojtjen e të punësuarve në rast të falimentimit të punëdhënësit të tyre”, duhet të interpretohet se personat në fjalë nuk mund të zbatojnë të drejtat e tyre duke paditur shtetin përpara gjykatave kombëtare se nuk ka marrë masa implementuese për direktivën brënda afatit të parashikuar. Por, një shtet anëtar duhet të shpërblejë dëmet e individëve të prekur kur provohet se ka dështuar të transpozojë direktivën 80/987/EEC.”*

Gjykata vlerëson se sipas direktivës çdo shtet anëtar duhet të marrë masa për organizimin, funksionimin dhe financimin e institucioneve të garancisë por kjo nuk do të thotë që shteti të paditet si personi përgjegjës për pretendimet e papaguara.<sup>495</sup>

Ndërsa në lidhje me përgjegjësinë e shteteve për dëmet që u vijnë qytetarëve nga mosrespektimi i së drejtës komunitare nga vetë shtetet, interpreton se *“37. Detyrimi i shteteve anëtare për të shlyer dëmet parashikohet në nenin 5 të Traktatit në fuqi (bëhet fjalë për Traktatin e Nicës), sipas të cilave Shtetet Anëtare detyrohen të marrin të gjitha masat e duhura, qoftë të përgjithshme ose të veçanta, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të tij sipas të direktivës komunitare ndërmjet të cilave është edhe detyrimi për të anuluar pasojat e shkeljes të së drejtës komunitare. E drejta komunitare detyron shtetet Anëtare për të shpërblyer dëmet e shkaktuar individëve nga shkeljet e të drejtës komunitare e zbatuar direkt....*

<sup>493</sup> Neni 3 *“1. Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që institucionet e garancisë sipas parashikimeve të nenit 4 të paguajnë punonjësve, pagat që rrjedhin nga kontrata e punës, ose mardhënie punësimi para datës së caktuar.*

*2. Data e përmendur në paragrafin e parë është në diskrecion të shteteve anëtare: të jetë e njoftimit të pa aftësisë paguese të punëdhënësit, të jetë data fillimit të falimentimit të punëdhënësit ose data e ndërprerjes së kontratës së punës ose marrëdhënies së punës për shkak të falimentimit të punëdhënësit.”*

<sup>494</sup> Neni 4 *“1. Shtetet Anëtare mund të kufizojnë përgjegjësinë e institucioneve të garancisë, të përmendura në nenin 3.*

*2. Derisa sa Shtetet Anëtare ushtrojnë mundësisë e përmendur në paragrafin 1, ata duhet:*

*- në rastin e përmendur në nenin 3, paragrafi 2, të paguajnë pagat te tre muajve të fundit të kontratës punës apo të mardhënieve të punës që bien brenda një periudhe prej gjashtë muajsh para datës së shfaqjes së falimentimit të punëdhënësit,*

*- Në rastin e përmendur në nenin 3, paragrafi 2, të sigurojnë pagesën e tre muajt e të fundit të kontratës së punës ose marrëdhënies së punësimit para datës së njoftimit të ndërprerjes së punës për shkak të falimentimit të punëdhënësit,*

*- Në rastin e përmendur në nenin 3, paragrafi 2, të siguroj pagesën e kërkesave të papaguara për tetëmbëdhjetë muajt e fundit të kontratës së punësimit ose të marrëdhënies së punës...”*

<sup>495</sup> Shih paragrafin 25 të vendimit të cituar.

40. Që të njihet e drejta e shpërblimit duhet që direktiva të parashikojë të drejta për individët, e individualizuar në nene përkatëse, ekzistenca e një lidhje shkakësore mes shkëljes së detyrimeve që ka shteti mbi këtë direktivë dhe dëmit të shkaktuar individit nga kjo shkëlje.... Po ashtu shpërblimi nga shkëlje e të drejtës komunitare nuk mund të kryhet në mënyrë më pak të favorshme nëse shkëlja do të kishte ndodhur për ndonjë normë të brëndshme të shtetit.”

2. Çështjet e bashkuara Nr. C-46/93 and C-48/93, datë 5 Mars 1996, Brasserie du Pêcheur SA kundër Republikës Federale Gjermane.

Gjykata mori në shyrtrim kërkesat për mendim paraprak të gjykatave të brendshme gjermane që shqyrtonin rastet Brasserie du Pêcheur SA dhe Republika Federale e Gjermanisë dhe, nga ana tjetër, Factortame Ltd dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar.

Për rastin e parë, Brasserie du Pêcheur, një kompani franceze u detyrua të ndërpresë eksportet e berrës në Gjermani në fund të vitit 1981 për shkak se autoritetet kompetente gjermane cilësuan berrën që ata prodhonin jo aq të pastër sa kërkohej nga ligji “Mbi detyrimet për prodhimin e Berrës”(1952).

Në lidhje me këtë ligj, Komisioni me vendimin e datës 12 Mars 1987 kishte vlerësuar se binte ndesh me nenin 30 të Traktatit të KEE pasi ndalonin në mënyrë të padrejtë importimin e berrës pa aditivë. Brasserie du Pêcheur pas këtij vendimi të Komisioni, ngrihi padi kundër Republikës Federale të Gjermanisë për shpërblimin e dëmit nga kufizimi i eksportit nga viti 1981 deri në vitin 1987 drejt Gjermanisë në masën 1 800 000 marka Gjermane.

Pyetjet paraprake që iu parashtruan Gjykatës së Drejtësisë nga gjykata gjermane ishin:

1. *Parimi sipas të cilit shtetet anëtare shpërblejnë dëmin e pësuar nga një individ, si rezultat i shkëljeve të së drejtës komunitare nga vetë shteti, zbatohet edhe kur një shkëlje e tillë përbëhet nga një dështim për të përshtatur ligjin kombëtar me aktin më të lartë të së drejtës komunitare?*

2. *Mundet sistemi ligjor i çdo shteti të sigurojë që e drejta për kompensim t'i nënshtrohet të njejtave kufizime si ato që zbatohen kur një ligj kombëtar shkel aktin hierarkik më të lartë në shtet p.sh, kur një ligj i zakonshëm Federal shkel Kushtetutën e Republikës Federale të Gjermanisë?*

3. *Mundet që sistemi ligjor kombëtar të parashikojë që e drejta për kompensim duhet të kushtëzohet nga faji (me dashje dhe nga pakujdesia) për mos adoptimin e legjisilacionit?*

4. *Nëse po për pyetjen e 1 dhe jo për pyetjen 2:*

a. *A mundet që detyrimi për të paguar dëmin sipas ligjit kombëtar të kufizohet tek dëme të veçanta si pasuria. Kërkohet shpërblim i plotë në këtë rast: humbje dhe fitim i munguar?*

b. *Detyrimi për të shpërblyer dëmin kërkon gjithashtu riparimin e bërë përfishtë dëmin e ardhur si në rastin në rastin Nr. 178/84 datë 12 Mars 1987, Komisioni Kundër Gjermanisë?*

Në rastin e dytë - Më 16 Dhjetor 1988 Factortame dhe të tjerët, kërkuan para GJED paligjshmërinë e ligjit datë 01 Dhjetor 1988 “Mbi lundrimin tregtar” për shkak të mospërputhjes, me nenin 52 të Traktatit të KEE. Ky ligj u shfuqizua më 31 Mars 1989. Në të parashikohet se për regjistrimin e mjeteve lundruese kërkohet shtetësia e pronarit, vendqëndrimi, vëndbanimi dhe në rast të mungesës së këtyre të dhënave, anija nuk regjistrohet dhe nuk lejohej të peshkonte. Më 4 Gusht 1989 Komisioni pezulloi efektet e këtij ligj dhe në datë 2 Nëntor 1989 miratoi një ligj të ri.

Me datë 2 Tetor 1991, Gjykata e Divizionit shqyrtoi padinë e Factortame II për kohën që nuk kishte pasur licencë peshkimi nga 1 Prill 1989 deri më datë 2 Nëntor 1989. Gjykata gjermane shtroi këto pyetje për mendim paraprak GJED:

1. *Legjislacioni i një shteti anëtar që parashikon kushte lidhur me shtetësinë, vendbanimin, vëndqëndrimin e pronarit apo administratorit të mjetit peshkues apo të aksionerëve në rast se pronari është shoqëri tregtare është në kundërshtim me të drejtën komunitare.*
2. *Nëse po, çfare kriteresh merr parasysh gjykata kombëtare për të vlerësuar:*
  - a. *Shpenzimet, humbjet, interesin e munguar;*
  - b. *Humbjet e vazhdueshme në shitje për vlerësim më të vogël të mjeteve apo të aksioneve të këtyre shoqërive, etj.*
  - c. *Humbjet si pasojë e pagesave të bonove, gjobave, shpenzime të tjera;*
  - d. *Humbjet e vazhdueshme për pamundësinë e pronarëve të marrin ose të veprojnë me mjete të tjera;*
  - e. *Humbja e tarifave;*
  - f. *Shpenzimet për të ndërmejtësuar;*
  - g. *Dëmet shëmbullore/ndëshkuese nëse pretendohen? "*

Mbi këto pyetje të shtruara si nga gjykata italiane dhe ajo gjermane, GJED interpretoi në këtë mënyrë: "1. Parimi se shtetet anëtare janë të detyruara të shpërblejnë dëmin e shkaktuar individëve nga shkeljet e të drejtës komunitare:

1. Është i zbatueshëm nëse organet e shtetit janë përgjegjës për shkeljen në fjalë.  
 2. Kur shkelja e të drejtës komunitare nga një Shtet Anëtar i atribuohet organeve që kanë një diskrecion të gjerë për të bërë zgjedhje të ligjit dhe individët pësojnë humbje ose dëm, legjitimohen të kërkojnë shpërblim kur shkelja është mjaft e rëndë dhe ka një lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore midis shkeljes dhe demit. Në varësi të këtyre kriterëve, shteti duhet të shpërblejë pasojat e humbjes në përputhje me të drejtën e brëndshme për përgjegjësinë jashtëkontraktore.

3. Në bazë të legjislacionit kombëtar që zbatohet, shpërblimi i demit për shkak të shkeljes së të drejtës së komunitare nga organi shtetëror, nuk mund kushtëzohet nga faji i rëndë (me dashje apo nga pakujdesia).

4. Shpërblimi nga Shtetet Anëtare, si rezultat i shkeljeve të të drejtës komunitare duhet të jetë në proporcion me humbjen ose dëmin e pësuar. Në mungesë të dispozitave përkatëse të Komunitetit, është legjislacioni i brëndshëm i çdo vendi anëtar që përcakton kriteret për të matur shkallën e dëmshpërblimit. Megjithatë, këto kriteret nuk duhet të jenë më pak të favorshme se ato që zbatohen për pretendime të ngjashme në të drejtën e brëndshme dhe nuk duhet të jenë të tilla që në praktikë të bëjnë të pamundur apo tepër të vështirë marrjen e dëmshpërblimit. Për më tepër, duhet të jepen edhe për shpërblime të veçanta si p.sh, atë ndëshkuese të parashikuar nga e drejta angleze, për padi të bazuara në të drejtën komunitare nëse shpërblime të tilla njihen edhe në legjislacionin e brëndshëm.

5. Detyrimi i shteteve anëtare për të shpërblyer dëmin individëve për shkelje të së drejtës komunitare nuk mund të kufizohet te momenti kur është dhënë vendimi nga gjykata për shkeljen përkatëse. Legjislacioni kombëtar i cili nuk jep edhe fitimin e munguar bashkë me humbjen është në kundërshtim me të drejtën komunitare."

3- Çështja Nr. C-224/01, datë 30 Shtator 2003 Gerhard Köbler kundër Republikës së Austrisë.

Z. Köbler, nga data 1 Mars 1986 deri më datë 01 Mars 1996 ka punuar si profesor me kohë të plotë në Unversitetin e Austrisë në Innsbruck.

Me datë 28 Shkurt 1996, aplikon për një pagë më të lartë pasi kishte 15 vjet shërbim si profesor nga ku 10 vite të plotë në Austri dhe vitet e tjera në shtete anëtare të BE-së. Gjykata e Lartë Administrative në datë 24 Qershor 1998 rrëzoi kërkesën e Z. Köbler me arsyetimin se paragrafi 50A i ligjit “Për pagën” (1956) nuk i njeh si vjetërsi vitet e punës në një universitet tjetër por vetëm ato të kryera brënda Republikës së Austrisë. Eksperiencat në shtetet e tjera shërbejnë për ndonjë bonus për të motivuar këtë kategori punonjësish dhe jo për efekt të rritjes së pages.

Z. Köbler paditi Republikën e Austrisë për dëm të shkaktuar, nga shkelje e të drejtës komunitare me efekt të drejtpërdrejtë, për mospagim të pagës bazuar në vjetërsinë totale të punës si profesor e duke interpretuar gabim ligjin “Mbi pagën”. Gjykata Civile e Vienës e ngriti këto çështje për mendim paraprak para GJED:

1. Në lidhje me përgjegjësinë e shtetit, cili institut është përgjegjës për dëmin kur ai vjen nga shkelja e qëllimshme e së drejtës komunitare nga Gjykata më e Lartë e atij shteti, si p.sh., e Gjykatës e Lartë Administrative e Austrisë (Verwaltungsgerichtshof)?
2. A përcakton jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë se cili është organi që do të gjykojë këtë sjellje të paligjshme të gjykatës së lartë të një shteti anëtar siç është rasti i Gjykatës e Lartë Administrative e Austrisë (Verwaltungsgerichtshof)?
3. Nëse përgjigja në pyetjen nr. 2 është po, interpretimi ligjor i bërë nga Gjykata e Lartë Administrative lidhur me eksperiencën e punës, shkel të drejtën komunitare direkt të zbatueshme, neni 48 i Traktatit atë të ndalimit të diskriminimit dhe jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë?
4. Nëse përgjigja për pyetjen nr. 3 është po, a është kjo normë direkt e zbatueshme sa të legjitimojë (t’i japë një të drejtë subjektive) në procesin para gjykatës kombëtare?
5. Nëse përgjigja në pyetjen nr. 4 është po: A ka Gjykata e Drejtësisë informacion të mjaftueshëm që të rregullojë veten ose Gjykatën e Lartë Administrative në kushtet kur nga gjykimi duket që ka tejkaluar kompetencat e saj apo i takon gjykatës kombëtare të merret me këtë çështje?
6. Me pak fjalë, gjykata shtron pyetjen nëse parimi që shtetet anëtare duhet të shpërblejnë qytetarët për shkelje të të drejtës komunitare, a zbatohet kur shkelja vjen edhe nga vendimi i gjykatës më të lartë të atij shteti dhe nëse po, i takon çdo shteti që të krijojë një gjykatë kompetente për të gjykuar të tilla mosmarrëveshje?
7. Në arsyetimin e saj Gjykata shpjegon se tashmë është e konsoliduar praktika e saj gjyqësore<sup>496</sup> se nëse ka shkelje të së drejtës komunitare nga shteti anëtar, pavarësisht se cili është organi përkatës ligjvënës, i pushtetit ekzekutiv apo pushtetit gjyqësor, ai do të mbajë përgjegjësi si një entitet i vetëm përkundrejt dëmeve të shkaktuara individit. Kjo është tashmë e njohur edhe në përgjegjësinë e shtetit në të drejtën ndërkombëtare publike.<sup>497</sup>

Gjykata Europiane e drejtësisë interpretoi se:

- *Parimi se shtetet anëtare janë të detyruara të shlyejnë dëmin e shkaktuar individëve nga shkeljet e së drejtës komunitare, zbatohet edhe kur një vendim i gjykatës më të lartë të atij shteti (nënkupto vendim i formës së prerë), shkel të drejtën e individit. Shkelja është e rëndë dhe ka një lidhje shkakësore mes shkeljes dhe dëmeve të*

<sup>496</sup> Rastet C-6/90 and C-9/90 Francovich dhe të Tjerë [1991] ECR I-5357, paragrafi 35; Brasserie du Pêcheur dhe Factortame, 31; rasti C-392/93 British Telecommunications [1996] ECR I-1631, paragrafi 38; Rasti C-5/94 Hedley Lomas [1996] ECR I-2553, paragrafi 24; Rastet e Bashkuara C-178/94, C-179/94, C-188/94, C-189/94 and C-190/94 Dillenkofer dhe të Tjerë [1996] ECR I-4845, paragrafi 20, Rasti C-127/95 Norbrook Laboratories [1998] ECR I-1531, paragrafi 106, rasti Haim, paragrafi Shih paragrafët 30-32 të vendimit Köbler kundër Republikës së Austrisë.

shkaktuar palës së dëmtuar. Me qëllim për të indentifikuar nëse shkelja është serioze (e rëndë), gjykata kompetente kombëtare merr parasysh natyrën specifike të çështjes nëse shkelja është e dukshme. Çdo shtet anëtar duhet të krijojë gjykata kompetente që gjykojnë këto lloj shpërblimesh.

- Neni 48 i Traktatit të KE-së (tani, pas ndryshimit, neni 39 KE) dhe Nenit 7 (1) të Rregullores të Këshillit (EEC) Nr 1612/68, datë 15 Tetor 1968 mbi lirinë e lëvizjes për punëtorët brenda Komunitetit, përjashtojnë shpërblimet për rastet kur punonjësit kanë një eksperiencë të gjatë (kjo sipas Gjykatës së Lartë Administrative u konsiderua si një bonus vjetërsie).
- Një shkelje e së drejtës komunitare, siç ishte ajo e vendimit të Gjykatës së Lartë Administrative i datës 24 Qershor 1998, nuk ka karakterin e një shkelje të dukshme të së drejtës komunitare nga një gjykatë me e lartë e shtetit anëtar.
- Në çështjen Nr. C-224/01, datë 30 Shtator 2003, Gerhard Köbler kundër Republikës së Austrisë, në pyetjen paraprake të ngritur nga Gjykata e Lartë Administrative nëse ligji për pagat i vitit 1956 bie në kundërshtim me të drejtën komunitare duke mos i njohur si vite pune ato të kryera në shtetet të tjera të Komunitetit nuk përbën ndonjë shkelje serioze (shih qëndrimin e Gjykatës Evropiane e Drejtësisë në vendimin Schböning-Kougebetopoulou kundër Gjermanisë). Leximi jo si duhet i interpretimit të Gjykatës dhe faktit se akoma nuk ishte sqaruar se përbën diskriminim moskonsiderimi si bonus vjetërsie (shpërblim vjetërise) i eksperiencës në vende të tjera, përbën shkelje por jo ndonjë shkelje shumë të rëndë.”

### 7.5 Përgjegjësia jashtëkontraktore për akte të paligjshme (unlawful acts) të kryera nga punonjësi i institucionit të Bashkimit European

Kryesisht, shkak për të ngritur padi ndaj një organi shtetëror për shkelje të së drejtës komunitare kanë qenë rastet kur individëve u ka ardhur dëm si rezultat i një akti i konsideruar më pas i paligjshëm pasi ka qenë në kundërshtim me të drejtën komunitare. Në këto kushte, GJED ka legjitimuar të gjithë personat të cilët kanë pasur pasoja ekonomike apo te ndonjë lloji tjetër nga një akt i tillë (shih çështjen Pecheur du Brasserie, çështjet e bashkuara T-440/03, 121, 171, 208, 365 & 484/04, Arizmendi dhe të tjerë kundër Këshillit dhe Komisionit, [2009] ECR II-4883). Megjithatë njihen edhe rastet kur individët paraqesin padi për veprime a sjellje të paligjshme të punonjësit të organeve të Bashkimit Evropian (ose të ish Komunitetit Ekonomik Evropian)

Në çështjen Nr. T-451/93, datë 16 Nëntor 1994, *San Marco Impex Italiana sa kundër Komisionit dhe Këshillit*, u paraqit ankim për mos nënshkrim të disa faturave (invoices) nga delegati i Komisionit të KEE, cili kishte për detyrë të përgjigjej financiarisht për çdo kërkesë të qeverisë Somaleze gjatë ndërtimit të pesë urave me fondet e Komunitetit European. Për shkak të mungesës së një materiali ndërtimi, rritjes së çmimit të çimentos, çelikut dhe bitumit, Komisioni pranoi ndryshimin e projektit të sugjeruar nga inxhinierët vendas dhe urdhëroi pagesë të një fondi shtesë prej 750 000 Euro, fond i cili nuk u lëvrua për shkak të mos nënshkrimit të faturave nga ana e delegatit të KEE pasi mungonin prova të rritjes së çmimit në vendin e tyre të origjinës.

Firmat ndërtuese paraqitën çështjen përpara gjykatës për shkaktim dëmi jashtëkontraktor pasur sipas nenit 255 të KEE nga veprimet e paligjshme të nëpunësit të KEE. Gjykata në vendimin e saj vlerësoi që një punonjës të jetë në kushtet e përgjegjësisë jashtëkontraktore duhet të analizohet:

- **Së pari-** ai vepron *ultra vires* (përtej kompetencave);<sup>498</sup>

<sup>498</sup> Shih paragrafin 45 të vendimit.



- **Së dyti** -. përbën një shkelje të detyrës;
- **Së treti**- shkel parimin e pritshmërisë së ligjshme. Gjykata analizoi se ankuesi nuk kishte pretendime të bazuara për të pritur se do të shpërblehej në të ardhmen për sa kohë që pas miratimit të kërkesës për fond shtesë për shkak të devijimit të projektit nuk u akodrua asnjë fond për materialet e blera. Arsyetimi i mosakordimit ishin se faturat e blerjes së materialit nuk kishin asnjë provë për çmimin e tregut somalez. Ky parim është sqaruar edhe në çështjet e bashkuara Nr. T-466/93, T-469/93, T-473/93, T-474/93 dhe T-477/93 datë 13 korrik 1995, *O'Dëyer dhe të Tjerë kundër Këshillimit*. Me pritshmëri të ligjshme do të thotë që në parim ankuesi nuk mund të pretendojë se reduktimi i sasisë së qumështit për vitet 1992-1993, pa kompensim sipas Rregullores Nr 816/92, përbënte një shkelje të pritjeve të tyre legjitime. Për gjykatën, një operator ekonomik i mirë-informuar dhe i kujdesshëm, nga momenti kur Këshilli njofton se nuk do të ketë kompensim nuk mund të pretendojë se priste diçka tjetër nga ligji në të ardhmen. Kjo strategji ekonomike ishte botuar dhe shpallur publikisht për prodhuesit e qumështit. Gjykata në rrëzimin e këtij pretendimi u shpreh se: “71. Në lidhje me mungesën e kompensimit, vlerësohet se Rregullorja Nr. 816/92 është brenda skemës së masave të marra për tatimet shtesë. Në këtë kontekst, aplikantët ishin të vetëdijshëm se kompensimi i parashikuar në Rregulloren Nr. 775/87, e ndryshuar me Rregulloren Nr. 1111/88 dhe Rregulloren Nr. 3882/89, do përfundonte më datë 31 Mars 1992 dhe se nuk kishte rinovim. Për më tepër, ulja e sasisë së qumështit pa kompensim për vitin 1992-1993 ishte e parashikueshme prandaj nuk mund të pretendohet shpërblim i dëmit për të ardhurat e ligjshme të pritshme nga ana e aplikuesve.” Pra vetë natyra e një pritshmërie legjitime do të thotë se në një mënyrë të vazhdueshme ka pasur pasoja, veprime a mosveprime përkatëse të ankuesit, bazuar në një rregullim ligjor, që pretendohet se është shkelur.
- **Së katërti** – punonjësi nuk mban përgjegjësi kur dëmi ka ardhur nga mosorganizimi i duhur i shërbimeve nga ana e institucionit përkatës. Në vijim të vendimit të sipërcituar, gjykata rrëzoi ankesën e shoqërisë me arsyetimin se delegati me të drejtë nuk ka firmosur shpenzimet shtesë të projektit pasi u konstatua se çmimet e rritura të materialeve nuk ishin reale, ishin të pa provuara dhe të pa miratuara më parë si çmime referuese nga Autoriteti Mbikqyrës Somalez. Gjykata u shpreh se i bie barra e provës ankuesit të identifikojë së paku disa nga keqfunksionimet e administراتës në të kundërt, ankimi bie.<sup>499</sup>
- **Së pesti**- shteti mban përgjegjësi edhe kur gjyqtari vendas keqintepreton me dashje ose jo, të drejtën komunitare duke sjellë pasoja për shtetasit. Në çështjen C-173/03, datë 13 qershor 2006, *Traghetti Del Mediterraneo kundër Italisë*, në përgjigjet mbi çështjet e ngritura për interpretim paraprak Gjykata argumentoi se: “E drejta komunitare ndalon legjislacionet kombëtare të përjashtojnë në përgjithësi shtetin nga dëmshpërblimi kur gjykata më e lartë e shtetit si rezultat i vlerësimit të provave, interpretimit të gabuar të ligjit ka shkelur të drejtën komunitare. E drejta komunitare gjithashtu ndalon legjislacionet kombëtare që e kufizojnë përgjegjësinë vetëm për rastet e kryer me dashje dhe në shkelje të rënda” Bashkimi Evropian edhe vendimit datë 24 Nëntor 2011 mes Komisionit Evropian dhe Republikës së Italisë, i kërkoi Republikës Italiane të rishikonte ligjin Nr. 117/88 qoftë edhe kur gjykatat veprojnë në pakujdesi të rëndë.

<sup>499</sup> Shih paragrafin 10 të vendimit.

**Së gjashti-** BE nuk mban përgjegjësi për punonjësit e tyre për veprime qofshin edhe të paligjshme që kryejnë punonjësit jashtë kohës së punës. Ilustrojmë me një rast ku pretendohet se dëmi jo-pasuror, vuajtje shpirtërore e prindit nga mostakimi i fëmijëve, është shkaktuar nga veprimet e padrejta të një punonjësi të Komisionit të BE. Në çështjen T-124/04 datë 26 tetor 2005, *Ouariachi kundër Komisionit* rezulton se ankuesi është banues në Marok dhe aty i martuar me një shtetase franceze kanë lindur dy fëmijë. Pas shkurorëzimit të tyre, bashkëshortes i'u caktua kujdestaria ndaj të miturve. Zoti C. ishte punonjës me imunitet, Kryetar i Adminsitratës së Delegacionit të Komisionit të BE në Sudan (8 Gusht 2000 deri më 16 Maj 2004). Bashkë me titullarin e tij Zotin M. ishin të vetmit punonjës të Komisionit në këtë shtet. Madje në mungesë të titullarit Zoti C. kishte edhe të drejtë firme.

Me një note-verbale datë 20 qershor 2002, drejtuar Ministrisë së Jashtme të Sudanit, të firmosur nga Zoti C. dhe njëkohësisht partneri i Znj. R (ish-bashkëshortes së ankuesit) kërkon të trajtohet me përparësi me vizë Znj. R., dhe dy fëmijët e saj që vijnë nga Maroku për në Sudan.

Në përfundim të vizës turistike, Znj. R nis procedurat për të marrë leje qëndrimi sudanez. Po ashtu, me një notë verbale të nënshkruar nga vetë Zoti C. i kërkohej Ministrisë së Jashtme të Sudanit që të trajtohet me shpejtësi me leje qëndrimi sudanez, Znj. R dhe dy fëmijët e saj. Autoritetet kompetente sudaneze pranojnë kërkesën. Gjatë vitit shkollor 2002-2003, të dy fëmijët e aplikantit dhe Znj. R. ndoqën shkollën franceze në Khartum.

Në nëntor të vitit 2003 me vendim të Gjykatës së Apelit në Rabat, Znj. R. humbi kujdestarinë e dy fëmijëve të saj dhe kjo i kaloi ankuesit. Ndërkohë Znj.R., dhe dy fëmijët kishin lënë Sudanin dhe ishin vendosur në Belgjikë, ku fëmijët ndoqën edhe vitin shkollor 2003-2004 në Et, Belgjikë.

Më 25 Shkurt 2004, kërkuesi i drejtohet Gjykatës së Shkallës së Parë të KEE për t'u shpërblyer dëmi jopasuror i pësuar për shkak të veprimeve të paligjshme që kreu një punonjës i Komisionit.

Në vazhden e përpjekjeve të tij për të ri-kontaktuar fëmijët e tij, dhe për të siguruar ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit të Gjykatës së Apelit Rabat, i drejtohet autoriteteve belge dhe më datë 6 Maj 2004, Gjykata e Apelit në Liège (Belgjikë) urdhëroi kthimin e fëmijëve në Marok për t'u bashkuar me babain.

Gjykata rrëzoi kërkesën e dytë të ankuesit me arsyetimin se në vëndet në zhvillim, procedurat administrative zgjasin dhe është e zakonshme që një anëtar i Delegacionit të Komisionit të dërgojë një notë-verbale për të përshpejtuar procedurat apo për ta mbështetur sa më parë kërkesën e aplikuesit. Po ashtu, nuk ekziston një lidhje shkakësore midis sjelljes së punonjësit dhe të drejtës së ankuesit për të takuar fëmijët e tij, për më tepër që ishte vetë Ministria e Jashtme e Sudanit e cila vlerësoi se kësaj shtetase mund t'i jepet leja e qëndrimit bashkë me dy fëmijët e saj, duke ushtruar në këtë mënyrë sovranitetin e tij si shtet pa u ndikuar as nga kërkesat përshpejtuese të Zotit C. Gjithashtu për gjykatën është përgjegjësi edhe e ish-bashkëshortes së tij në mosrespektimin e një vendimi gjyqësor, për të drejtën e takimit të fëmijëve me babain, prandaj nuk jemi në rastin e parashikuar nga neni 288 të Traktatit.<sup>500</sup>

Gjithashtu kërkuesi pretendoi se Zoti C., ka marrë rolin e babait për fëmijët e tij pa të drejtë, pasi në shkollën franceze në Khartum dhe nga shkolla belge në Et, raportet e prindërve janë nënshkruar nga ish-bashkëshortja dhe Zoti C., i cili nuk ushtronte ndonjë kujdestari apo përgjegjësi prindërore ndaj fëmijëve dhe nuk kishte marrë pëlqimin e aplikantit për të nënshkruar dokumentet në vendin e tij. Prandaj kërkuesi

<sup>500</sup> Ibid. paragrafet 22, 23.

pretendon se i ishte mohuar të drejtat e tij prindërore dhe Zoti C. kishte ndërhyrë qëllimisht në mënyrë që t'i shkaktojë atij lëndime.<sup>501</sup> Gjykata e rrëzoi edhe këtë pretendim me arsyetimin se Komisioni nuk mban përgjegjësi për veprimet e kryera nga një punonjës i tij, jashtë kohës së ushtrimit të detyrës.

## 7.6 Përgjegjësia jashtëkontraktore e shtetit për veprime të ligjshme të Institucioneve

Neni 340§2 i TFEU është një dispozitë referuese të parimet e përbashkëta të shteteve anëtare mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore të shtetit.

Interpretimi i zgjeruar se Institucionet e BE-së kanë përgjegjësi edhe për veprime a mosveprime të ligjshme që çenojnë të drejtat dhe interesat e individëve i takon ekskluzivisht jurisprudencës së GJED (sot GJD e BE). Kjo e fundit është referuar tek parimet e përbashkëta të shteteve anëtare ku shpërblejnë dëmin që administrata publike i shkakton individëve dhe kur veprojnë në përputhje me kompetencat e tyre.

GJED, për herë të parë për përgjegjësinë e institucioneve të Komunitetit Ekonomik Europian për akte të ligjshme është shprehur në çështjen Nr. 59/83 datë 06 Dhjetor 1984 *Biovilac kundër Komisionit*. Niveli i tepërt i stoqeve të pluhurit qumështit të skremuar, çoi Komisionin, në miratimin e Rregullores (EEC) Nr.1753/82 datë 1 korrik 1982, duke marrë "masa të veçanta" për shitjen me tender të pluhurit të skremuar si ushqim të derrave dhe shpendëve.

Në vitin 1974 kërkuesi, SA Biovilac NV një ndërmarrje belge, filloi të prodhojë ushqime bazë të kafshëve dhe ushqime të cilësisë së lartë për shpendë dhe gica. Që nga viti 1978 ajo prodhon ushqime të markës "Kulactic" dhe që nga viti 1980 ushqime të markës "Bioblanca" konkurrencte me pluhurin qumësht të skremuar.

Pas daljes së rregullores, ankuesi i atribuon shitjen e pakët të produkteve të tij nga muaji Nëntor i vitit 1982 dhe uljen drastike të shitjeve të tij nga data 01 Mars 1983 duke i sjellë humbje të mëdha nga konkurrenca që po i bënte qumështi pluhur i skremuar me çmim tepër të ulët.

Vendimi i gjykatës ka rëndësi pasi edhe pse rrëzoi ankimin interpretoi se: "27. Për të mbështetur pretendimin e ankuesit sipas së drejtës gjermane "Sonderopfer" dhe konceptit të së drejtës franceze "l'Egalite devant les charges Publiques" duhet të analizohet nëse mungesa e paligjshmërisë së komunitetit e bën apo jo atë përgjegjës sipas paragrafit të dytë të nenit 215 të Traktatit të KEE, për të shpërblyer çdo humbje të pronës si pasojë e masave të përgjithshme të ligjshme por që kanë çenuar dhe dëmtuar në mënyrë të jashtëzakonshme dhe të veçantë, ankuesin dhe të gjithë tregtarët dhe prodhuesit e tjerë. ...gjykata ka mbajtur një linjë konstante jurisprudence, mbi paditë për shpërblim të dëmit sipas nenit 215 të Traktatit, për një akt legjislativ të paligjshëm kur dëmi i pretenduar përbën një rrisht të zakonshëm. Ky parim do të zbatohej akoma më tepër në rastin e përgjegjësië pa faj të pranuar nga e drejta komunitare."

Në një interpretim literal të nenit 340 (ish neni 288) dhe nenit 235 të Traktatit të Lisbonës, vihet re se flitet për përgjegjësi jashtëkontraktore për veprimet e paligjshme të organeve të shteteve anëtare apo të institucioneve të BE-së karshi individëve, personave juridikë të saj dhe nuk parashikohet literalisht kjo lloj përgjegjësie. Deri në vendimin FIAMM (14 dhjetor 2005) rastet e përgjegjësisë jashtëkontraktore për akte të ligjshme të institucioneve të KEE ishin paraqitur si hipotetike. Në fakt në mënyrë tangenciale gjykata e ka cekur dhe e ka pranuar me finesë tek vendimi *Biovilac* se kur

<sup>501</sup> Ibid, paragrafi 28.

mbahet përgjegjësi për akte të ligjshme të institucioneve të Komunitetit duke venodur katër kushte: 1) të ketë ardhur një dëm nga ky akt, 2) ai të jetë i jashtëzakonshëm, 3) dëmi të jetë i një natyre të veçantë, i ardhur specifikisht të dëmtuarit në ndryshim nga të tjerët, 4) dëmi nuk duhet të përbëjë një rrisht ekonomik normal.

Ky qëndrim u pasua edhe te çështja Nr. T-184/95 datë 28 prill 1998, *Dorsch Consult kundër Këshillit dhe Komisionit* e cila shprehet se kur dëmi është shkaktuar nga sjellja jo e paligjshme e institucioneve të Komunitetit mund të hasim në përgjegjësi jashtëkontraktore kur ka një dëm aktual të ardhur, ekziston lidhje shkakësore mes dëmit dhe sjelljes së institucionit dhe ka një dëm të natyrës së veçantë dhe të jashtëzakonshme.<sup>502</sup>

Me dëm të veçantë nënkupohet ai dëm që ndikon në mënyrë të shpërpjestuar te një grup i veçantë i operatorëve ekonomikë në krahasim me operatorët e tjerë dhe me dëm të jashtëzakonshëm kuptohet dëmi i cili i kalon kufijtë e një rreziku ekonomik dhe nuk justifikohet as nga interesi i përgjithshëm ekonomik i masës legislative përkatëse që passolli këtë dëm.<sup>503</sup>

Përveç kësaj, si burim i përgjegjësive jashtëkontraktore në të drejtën komunitare u njohën edhe ato forma të përgjegjësive quasi kontraktore si: begatimi pa shkak (*de in rem verso*<sup>504</sup>) dhe gjerimi i punëve të tjetrit (*negotiorum gestio*). Në vendimin Nr. C-47/07 datë 16 dhjetor 2008, *Masdar (UK) Ltd kundër Komisionit dhe Komunitetit Evropian*, gjykata mohoi ekzistencën e përgjegjësive jashtëkontraktore por pranoi se në rast se asnjë përgjegjësi jashtëkontraktore nga akte të paligjshme ose të ligjshme nuk mbulon këtë përgjegjësi, këto dy burime të përgjegjësive quasi-kontraktore, mbeten të fundit për t'u shfrytëzuar.

Vendimi Nr. C-120 & 121/06 datë 09 Shtator 2008, *FIAMM kundër Komisionit dhe Këshillit*, është një përpykë e Gjykatës së Shkallës së Parë për të pranuar përgjegjësinë e Komunitetit Evropian për sjellje të ligjshme të tij. Megjithatë mund të themi se rasti i përgjegjësië së Bashkimit Evropian (ish-KEE) si një entitet përbën një përjashtim dhe kryesisht haset në mardhëniet me Organizatën Botrore të Tregtisë ku Bashkimi është anëtar që nga data 01 Janar 1995.<sup>505</sup>

Shoqëria Fabbrica Italiana Accumulatori Motocarri Montecchio SpA (FIAMM), me seli në Itali dhe Fabbrica Italiana Accumulatori Motocarri Montecchio Technologies LLC me seli në Deluer, SHBA, kërkuan përpara GJED rrezimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për mos shpërblim të dëmit që pësuan nga rritja e taksave të importit të bananeve sipas marrëveshjes së paligjshme që Bashkimi Evropian kishte nënshkruar me Organizatën Botërore të Tregisë.

BE është pjesë e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT ose WTO per world Trade Organisation) ashtu si edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Më datë 13 Shkurt 1993 Rregullorja e Këshillit (EEC) Nr.404/93 "Mbi organizimin e përbashkët të tregut në të bananeve" përcaktonte disa vende preferenciale të importimit të bananeve që vinin nga Vendet ACP (Afrika, Karaibet dhe shtetet e Bashkuara të Amerikës që lagen nga Oqeani Paqësor).<sup>506</sup>

<sup>502</sup> Idem. Para. 174.

<sup>503</sup> Çështja T-170/00 Forde-Reederei [2002] ECR II-515 paragrafi 56 dhe çështja T-184/95 Dorsch Consult kundër Këshillit dhe Komisionit, paragrafi 80, 150, çështjt e bashkuara T-64/01 dhe T-65/01, datë 10 Janar 2004, Afrikanische Frucht-Compagnie dhe Internationale Fruchtimport Gesellschaft weichert kundër Këshillit dhe Komisionit, paragrafi 89, 151, C-282/05 datë 19 Prill 2007 P, Holcim AG kundër Komisionit.

<sup>504</sup> Shih më tej kuptimet e tyre tek nenet 10, 11 i rregullores nr. 864/2007 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Mbi ligjin e zbatueshëm të përgjegjësive jashtëkontraktore"

<sup>505</sup> [https://www.wto.org/english/thewto\\_e/countries\\_e/european\\_communities\\_e.htm](https://www.wto.org/english/thewto_e/countries_e/european_communities_e.htm).

<sup>506</sup> Të njohura si ACP states- African, Carabeann and Pacific States.

Kjo rregullore për shkak të ankesave të disa shteteve, përfshi këtu edhe SHBA, u shqyrtua nga Autoriteti i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve (Dispute Settlement Body – DSB) i OBT, një organ që zgjidh mosmarrëveshjet mes shteteve anëtare. Me datë 25 Shtator 1997, DSB e gjeti Rregulloren e KEE të papajtueshme me detyrimet e marrëveshjes së OBT-së dhe u vendos një afat deri më datë 1 Janar 1999 që Komuniteti të rregullonte regjimin doganor përkundrejt shteteve të diskriminuara. Ky afat nuk u respektua nga KEE.

Më datë 28 Tetor 1998, Komisioni miratoi rregulloren (EC) Nr. 2362/98 të 28 Tetor që përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullores Nr. 404/93 lidhur me importet e bananeve që do të hynte në fuqi në datë 1 Janar 1999.

SHBA në këtë rregullore përsëri gjeti elementë në shkelje të marrëveshjes së OBT dhe të vendimit të datës 25 Shtator 1997 të DSB dhe më datë 14 Janar 1999 i kërkoi Autoritetit të pezullojë zbatimin e koncesioneve tarifore për Komunitetin dhe Anëtarët e saj, në shumën prej 520 milion USD.

Autoriteti i mosmarrëveshjes (DSU) dërgoi këtë çështje në arbitrazh të cilët me vendimin e datës 9 Prill 1999, i gjetën pretendimet e SHBA të drejta dhe vendosën që Komuniteti të shpërblejë SHBA në masën 191.4 milion USD në vit, për të riparuar dëmin e shkaktuar nga ky regjim importi i paligjshëm.

Me datë 19 Prill 1999 DSB, autorizoi SHBA të vendos tarifë doganore në vlerën prej 100 % që të vjelë shumën prej 191.4 milion USD/ vit mbi artikuj që kanë origjinën nga Komuniteti. Në të njëjtën ditë, autoritetet e SHBA zbatuan vendimin dhe vendosën tarifa të larta doganore për mallrat që vinin nga Austria, Belgjika, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Portugalia, Spanja, Suedia dhe Britania e Madhe. Këto mallra kishin përshkrimin “*bateri me furnizim acidi ose të tjera lloje që përdoret për të kryer ndezjen e pistonave të motorit ose që shërben si burim për motorët e makinerive elektrike*” dhe artikujt “*që mbahen në xhep, me një sipërfaqe të sheshtë plastike ose të përforcuar me peçikllas*”.

Regjimi i komunitetit për importimin e bananeve u rregullua më tej me Rregulloren Nr. 216/2001 datë 21 Janar 2001 që ndryshoi rregulloren Nr. 404/93<sup>507</sup>.

Më 11 Prill 2001, SHBA dhe Komuniteti nënshkruan një Memorandum mirëkuptimi ku KE ndërmori një tarifë ekskluzive për importin e bananeve deri më date 01 Janar 2006 dhe SHBA vendosën për të pezulluar përkohësisht rritjen e tarifave doganore ndaj importeve të Komunitetit. Nga data 01 Korrik 2001 tarifa e importit për bateri makinash dhe për kapak të sendeve të thyeshme me vend origjine nga Komuniteti do të reduktohen në 3.5 % për të parën dhe 4.6 % për të dytën nga 100% tarifë doganore që kishte vënë më parë SHBA.

Ankuesit importonin nga SHBA për në disa shtete antare të BE, FIAMM- bateri makinash dhe Fedon- kapakët që mbajnë syze. Në blerjen e fundit, SHBA i ngarkoi një tarifë doganore më të lartë FIAMM etj. si rezultat i mos rregullimit të regjimit doganor në kohë mes KE dhe OBT.

Në këto kushte, FIAMM paditi Komunitetin, Komisionin dhe Këshillin Europian përpara Gjykatës së Shkallës së Parë (First instanc Court) për dëmet e shkaktuara si rezultat i mosveprimit për rregullimin në kohë të regjimit doganor të importeve, sipas kërkesave të bërë nga OBT.

Paditësit pretendojnë se nga 19 Prill 1999 dhe deri më 30 Qershor 2001 kanë pësuar dëm nga vendosja e tarifave doganore të larta nga SHBA për shkak të mos zbatimit nga KE të marrëveshjes me OBT. Gjykata e Shkallës së Parë kishte rrëzuar padinë sipas nenit 288§2 I Traktatit të KE me arsyetimin se përgjegjësia e institucioneve

<sup>507</sup> Gjendet në fletoren zyrtare të BE, OJ 2001 L 31, faqe 2.

të Komunitetit rrjedh kur nuk zbatojnë traktetet, parimet e vendosura nga Traktati i KEE dhe jo nga shkella e rregullave të OBT.

GJED gjeti interpretimin e Gjykatës së Shkallës së Parë mbi nenin 288§2 të Traktatit tepër të ngushtë, duke u shprehur se: “170. Përgjegjësia e Komunitetit për një veprim të ligjshëm sipas të drejtës komunitare do të ekzistojë nëse plotësohen tre kushtet e kërkuar të përgjegjësive jashtëkontraktore sipas nenit 288, konkretisht ekzistenca e dëmit, lidhja shkakësore dhe ekzistenca e faktit të pazakontë ose të vecantë që ka sjellë këtë dëm. Po ashtu, ky nen i Traktatit i referohet edhe parimeve të përbashkëta të shteteve anëtare mbi këtë lloj përgjegjësie, ku administrata publike mban përgjegjësi dhe dëmshpërblen për veprime të ligjshme dhe të paligjshme të organeve të saj.

175. Pra edhe veprimet a mosveprimet e paligjshme qoftë edhe në fushën legislative, i nënshtrohen parimeve të përgjegjësive jashtëkontraktore....

184. Masat legislative të Komunitetit të cilat kanë passjellë një kufizim të së drejtës së pronës, apo të lirisë së ushtrimit të tregtisë apo profesionit, duke cënuar thelbin e këtyre të drejtave në mënyrë joproporcionale dhe pa pasur mundësi për një shpërblim, legjitimon palën e dëmtuar që të ngre padi për përgjegjësi jashtëkontraktore ndaj Komunitetit.“

Ankuesit, kërkuar të shpërbleheshin edhe për veprime të paligjshme të Gjykatës së Shkallës së Parë si për procedurat e zgjatura të gjykimit dhe interpretimit të gabuar të përgjegjësive jashtë-kontraktore të Komunitetit.

GJED konstatoi se mbi ankesat për afatet e tejzgjatura duhen marrë parasysh kompleksiteti i çështjes, sjellja e palëve dhe e organit, etj.<sup>508</sup> Jurisprudenca ka konsideruar shkak të paarsyeshëm të zgjatjes së procesit kur gjykata ka vendosur të bashkojë 6 çështje, të gjitha në gjuhë të ndryshme, ose rifillimin e gjykimit nga e para për shkak të ndryshimit të trupit gjykues etj.

### **7.7 Faji si element i rëndësishëm i përgjegjësive jashtëkontraktore në të drejtën komunitare**

Në nenin 340§2 të TFEU nuk parashikohet në mënyrë eksplicite faji si element i përgjegjësive jashtëkontraktore të institucioneve të BE por ajo del nga parashikimi se shpërblimi i dëmit bazohet edhe në parime të përbashkëta që udhëheqin të drejtat e çdo shteti anëtar mbi këtë institucion. Gjithësesi gjykata ka interpretuar se faji i institucioneve paraqitet si në formën e dashjes, qëllimit dhe në formën e pakujdesisë. Dallimi mes tyre qëndron se i dëmtuari shpërblehet më shumë kur insitucioni apo punonjësi i BE ka vepruar me qëllim, dashakeqësi sesa nga pakujdesia dhe neglizhenca.

Në çështjen C-47/07 P, datë 16 Dhjetor 2008, *Masdar (UK) LTd kundër Komisionit* rezultoi se ankuesi ishte një shoqëri e nënkontraktuar nga shoqëria greke Helmico për të realizuar në projekt me fermerët në Moldavi, në kuadër të programit të Komunitetit të Ndihmës Teknike të Shteteve të Pavarura të Commonwealthit, (TACIS) dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane.

Gjatë vitit 2000 dhe 2001, Masdar kontakoi Komisionin për të shqyrtuar mundësinë e pagesës që i kishte marrë Helmico dhe nuk i kishte shpërndare. Më datë 1 Shkurt 2002, Komisioni sqaroi se dy urdhërat e pagesës ishin lëshuar më 4 Prill 2000 për Helmico për një total prej 2 091 168,072 Euro dhe 1 236 200,91 Euro për kontratën me Moldavinë.

Ankuesi paditi Komisionin për humbje pasurore dhe fitim të munguar nga viti 1998 kur duhet të merrte shumën përkatëse e deri kur po gjykohej çështja para Gjykatës.

<sup>508</sup> Shih paragrafin 212 -215 të vendimit.

GJED argumentoi se: “90. Pakujdesia lidhur me një veprim a mosveprim nga ku pala përgjegjëse shkel detyrimin e të sjellurit me kujdes prandaj institucioni mban përgjegjësi për atë që ka pasur dijeni, kompetenca dhe mundësi (çështja C-308/06 Intertanko dhe të Tjerët [2008] ECR I-0000, paragrafi 74 deri 77).

91. Prandaj administrata e Komunitetit përgjigjet për sjellje të paligjshme kur dështojnë që të veprojnë me të gjithë kujdesin e nevojshëm duke vonuar interesat e personit (çështja 145/83 Adams k. Komisionit [1985] ECR 3539, paragrafi 44, dhe çështja C-331/05 P Internationaler Hilfsfonds. Komisionit [2007] ECR I-5475, paragrafi 24).

... 93. Ky detyrim i kujdesit vjen nga parimi për një administratë të fuqishme. Ajo zbatohet në përgjithësi tek aktet administrative publike të Komunitetit. ...

94. Qëllimi i detyrimit për të qenë i kujdesshëm ... nënkupton që administrata e Komunitetit duhet të veprojë me kujdes dhe duke parandaluar dëmin pa marrë përsipër që në mënyrë absolute t’u heqë operatorëve ekonomikë të gjithë dëmin që vjen nga një rrezik normal tregtar...”

Në përgjithësi, përgjegjësia për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor edhe sipas nenit 340 (ish neni 288) është ajo me faj në formën e dashjes dhe të pakujdesisë, megjithatë ka pasur edhe raste kur Gjykata ka njohur dhe ka trajtuar përgjegjësinë pa faj.

Duhet të theksohet se, parimi i përgjegjësive pa faj njihet në të drejtën komunitare, me kushtin që të plotësohen tre kushte kumulative: 1) dëmi i pretenduar duhet të ketë ardhur efektivisht, 2) të provohet lidhja shkakësore mes dëmit dhe veprimit nga ana institucionit të Komunitetit dhe 3) dëmi të jetë i një natyre të jashtëzakonshme dhe të veçantë.

Në çështjen Nr. T-195/00 datë 10 prill 2003, *Travelex Global and Financial Services and Interpayment Services kundër Këshillit dhe Komisionit*, rezulton se Thomas Cook Group Ltd (tani Travelex Global dhe Financial Services Ltd) dhe degës së saj, Services Interpayment Ltd ('ISL'), janë dy kompani angleze që kryejnë biznes në shërbimet financiare në udhëtimet ndërkombëtare.

ISL operon nëpërmjet institucioneve financiare dhe agjencive të udhëtimit, të cilat shpërndajnë dhe shesin çeqe udhëtarësh tek konsumatori. Në Bashkimin Europian, ISL ka regjistruar një markë tregtare në formën e një shenje figurative në Itali në vitin 1991, në Gjermani, Spanjë dhe Suedi në vitin 1992 dhe në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 1993, një "C" apo formë hëne me dy paralele të valëzuara horizontalisht, e ngjashme me shënjën e Euros, monedhës së Eurozonës.

Sipas paditësit duke përdorur për identifikim të Euros një shënjë e cila njihet si markë të regjistruar në emër të ankuesit, Bashkimi Europian i ka shkelur ndër të tjera të drejtën e pronës industriale, të drejtën e pronësisë sipas nenit 1 të protokollit 1 të KEDNJ si duke e shpronësuar atë nga prona e tij.

Sipas GJED në këtë çështje njihet përgjegjësinë pa faj të Komunitetit si një formë e përgjegjësive që njihet në neni 288§2 i Traktatit të KEE por nuk është në rastin e ankuesit.

Gjykata interpreton: “161. Duhet të theksohet se, parimi i përgjegjësive pa faj njihet në të drejtën komunitare, me kushtin që të plotësohen tre kushte kumulative: dëmi i pretenduar duhet të ketë ardhur efektivisht, lidhja shkakësore mes dëmit dhe veprimit nga ana institucionit të Komunitetit të ekzistojë, dhe të ketë ardhur një dëm i një natyre të jashtëzakonshme dhe të veçantë. (Rasti C-237/98 P Dorsch Consulty kundër Këshillit dhe Komisionit [2000] ECR I-4549, paragrafët 17 deri më 19, dhe rasti T-196/99 Area Cova dhe të Tjerët kundër Këshilli dhe Komisionit [2001] ECR II-3597, paragrafi 171.

162. Barra e provës për të provuar ekzistencën e dëmit të pësuar i takon ankuesit. Ai nuk mund të jetë abstrakt. ... Simboli zyrtar euro për të treguar monedhën e përbashkët, nuk është përdorur për të identifikuar një mall identik a të ngjashëm me atë që përdor ankuesi prandaj nuk ka pasur as konfuzion tek konsumatorët. ... Pretendimi i ankuesve bazuar në përgjegjësinë pa faj të Komunitetit duhet rrëzohet pasi nuk provohet një dëm aktual.”

## 7.8 Lojet e dëmeve në përgjegjësinë jashtëkontraktore në të drejtën komunitare

Tre janë llojet që shpërblehen nga GJD e BE në lidhje me dëmin e pësuar nga veprimet e ligjshme a të paligjshme të punonjësve të saj, institucioneve apo vetë BE si entitet:

1. Dëmi pasuror që përbëhet nga humbjet e pësuar, fitimi i munguar dhe shpenzimet për avokat, shpenzimet për shërbimin e Gjykatës Europiane dhe çdo fitim;
2. Dëmi jopasuror;
3. Dëmi eventual nëse është i dukshëm dhe i sigurtë se do të vijë në të ardhmen. Për këtë të fundit Gjykata në vendmim Nr. C-325/06 P, datë 12 Dhjetor 2007, Galileo International Technology LLC kundër Komisionit është shprehur se: “*Mosnjohja e një dëmi eminent, të pashmangshëm dhe me siguri të mjaftueshme se do të vijë në të ardhmen përbën shkelje të së drejtës për shpërblim të drejtë të të dëmtuarit.*”

Dëmi, në të gjithë format e saj duhet të jetë i sigurt, i matshëm dhe aktual. Ai nuk duhet të jetë as hipotetik dhe as i pavlerësueshëm.

Në çështjen Nr. T-285/03 datë 17 Mars 2005, *Agraz CA kundër Komisionit*, rezultojnë këto fakte: Komisioni, pasi nuk kishte arritur të merrte një çmim reference të domates që importohet nga Kina, kishte miratuar rregulloren Nr. 1519/2000 me një çmim të saj, e cila ishte kundërshtuar nga prodhuesit e domateve nga Spanja, Franca, Greqia, Italia dhe Portugalia. Këta pretendonin se çmimi i domates së importuar ishte shumë i lartë dhe granti ishte i pamjaftueshëm. Edhe pse Ministri i Bujqësisë së Portugalisë i kërkoi Komisionit të shikonte edhe një herë grantin, Komisioni iu përgjigj se shuma për vitin 2000 ishte në përputhje me Rregulloren.

Komisioni në vitin 2003 refuzon të ndryshojë rregulloren mbi masën e grantit edhe pse kishte prova nga Krahina Xinjiang në Kinë se çmimi i deklaruar nga Ministri Portugez dhe nga Minsitria e Bujqësisë Spanjolle ishin reale.

Mbi dëmin e shkaktuar nga Komisioni për nxjerrjen e një akti të paligjshëm, gjykata analizoi se për të vlerësuar nëse sjellja e Komisionit ka qenë mjaftueshëm e rëndë duhet vlerësuar nëse ka vepruar si zakonisht, në situatë të ngjashme (neni 288 paragrafi 2 të Traktatit). Rezulton se kompetencat e Komisionit për të caktuar çmimet e granteve janë të pakufizuara. Megjithatë në rastin e caktimit të tyre duhet të bëhen disa llogaritje për të gjetur diferencën mes çmimit të paguar nga prodhuesit europianë dhe çmimit të paguar nga vendet e treta si dhe merret parasysh çmimi i lëndës së parë në shtetin e origjinës, çmimi i lëndës së parë të shtetet anëtare, masa e ndihmës së dhënë vitet e mëparshme, etj.

Gjykata konstatoi se vendosja e çmimit nga ana e Komisionit pa marrë një përgjigje zyrtare nga ana e Qeverisë Kineze përbën shkelje të parimit të një administrate të përgjegjshme.<sup>509</sup> Heshtja dhe përgjigjia me vonesë nga ana e Republikës Popullore Kineze është një sjellje e njohur nga ana e Komisionit. Ky duhet ta kishte marrë informacionin me mënyra të tjera si p.sh., kontaktimi me telefon nëse ka ndonjë ndryshim me çmimin e referencës së një viti të mëparshëm.

<sup>509</sup> Ibid. para.52.



Aplikuesit pretenduan para gjykatës se kanë pësuar një dëm i cili është sa diferenca mes cmimit të caktuar nga granti i Komisionit në Rregulloren Nr. 1519/2000 dhe çmimi që do të ishte aplikuar në qoftë se Komisioni do kishte marrë parasysh çmimet kineze.

Në lidhje me dëmin e pësuar, gjykata e rrëzoi këtë pretendim për sa kohë që ankuesi nuk provoi çfarë dëmi pësohet. Sipas jurisprudencës së gjykatës dëmi duhet të jetë aktual dhe i sigurtë në ardhjen e tij. Komisioni provoi se ka marrë parasysh në caktimin e çmimit edhe situatën ekonomike ndërkombëtare si dhe nuk ka shkelur nenin 4 të Rregullores e cila i jep kompetencë të caktojë fonde deri në nivelin e diferencës mes çmimit të origjinës dhe çmimit të tregut komunitar dhe jo detyrimisht të japë maksimumin e kësaj difference.

Dëmet jopasurore janë tepër të vështira për t'u identifikuar nga gjykata dhe për t'u shpërblyer për sa kohë që ato paraqiten tepër subjektive. Gjithësesi rasti i parë që gjykata i njohu dëmin jopasuror të pësuar një shoqërie iraniane ishte shumë më vonë në krahasim me praktikën e konsoliduar për dëmet pasurore. Bëhet fjalë për çështjen Nr. T-384/11 datë 25 Nëntor 2014, *Safa Nicu Sepahan Co ndaj Këshillit të BE*. Nga faktet e çështjes rezulton se aplikuesi, Safa Nicu Sepahan Co, është një kompani iraniane. Bashkimi Europian kishte marrë masa kufizuese ndaj Republikës Islamike të Iranit për t'i dhënë fund aktiviteteve bërthamore dhe përhapjes së armëve bërthamore. Me vendimin e Këshillit Nr. 2011/299 / CFSP të 23 Maj 2011, shoqërisë i'u vendosën masa kufizuese si shoqëri e përfshirë në veprimtarinë bërthamore të Republikës së Iranit dhe emri i saj u regjistrua në Shtojcën II të këtij vendimi. Po me vendimin e Këshillit Nr. 2011/299 emri i kësaj shoqërie u vendos edhe në Aneksin VIII të Rregullores Nr. 961/2010, pasi furnizon me pajisje objektin ilegal Fordow.

I vënë në dijeni nga njëri prej partnerëve, aplikanti i drejton letër Këshillit të Bashkimit Europian më datë 7 Qershor 2011 për korigjimin dhe plotësimin e listës me të gjitha shoqëritë që mbajnë emrin "Safa Nicu" dhe heqjen e emrit të saj pasi kishin të dhëna të gabuara për të.

Me anë të letrës të datës 5 Dhjetor 2011 Këshilli njoftoi ankuesin se emri i saj do të vazhdojë të jetë e shënuar në Shtojcën II dhe në Aneksin VIII pasi argumentet e paraqitur nga ankuesi nuk e justifikon heqjen e masave kufizuese. Ai shpjegoi se listimi i subjektit të identifikuar si "Safa Nicu" në të vërtetë i referohet aplikuesit, pavarësisht se nuk kishte vendosur emrin e plotë të tij. Më pas, me Vendimin e Këshillit 2014/222/CFSP të datës 16 prill 2014 emri i ankuesit u heq nga lista e Aneksit II të vendimit 2010/413 dhe nga listat e tjera.

Ankuesi i drejtohet GJD së BE për shpërblym dëmi pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga Këshilli për shkak të masave kufizuese të paligjshme kundër tij.

Në argumentimin e saj në favor të ankimit gjykata shprehet se: "22. *Natyra kumulative e tre kushteve që rregullojnë përgjegjësinë jo kontraktore do të thotë se, në qoftë se njëri prej tyre nuk është përmbushur, padia për dëmet duhet rrëzuar në tërësi dhe nuk ka nevojë për të shqyrtuar kushtet e tjera (vendimi i 8 Maj 2003 me T. Port Komisionin v, C-122/01 P, ECR, BE: C: 2003: 259, paragrafi 30; gjykimi në Schneider Electric Komisionin v, BE: T: 2007: 212, paragrafi 120).*

57. *Në rastin në fjalë, së pari, vendosja e masave kufizuese që rrjedhin nga miratimi i akteve të kontestuara shkel dispozitat përkatëse të Rregullores Nr. 961/10 dhe Rregulloren Nr. 267/2012... rezulton se Këshilli nuk ka asnjë informacion ose dëshmi që justifikon masat kufizuese në lidhje me ankuesin. ... Gjykata çmon se një organ administativ, në ushtimin e detyrës së tij me kujdes, ka barrën e provës për të mbledhur të gjithë informacionin dhe provat përpara se të marrë masat kufizuese në*

*lidhje me ankuesin në mënyrë që në rast kundërshtimi të kishte të gjitha provat para Gjykatës Europiane.*

*68. Përsa kohë që këshilli ka kryer shkelje të rëndë të rregullave që mbrojnë të drejtat dhe liritë e individit ai mban përgjegjësi.*

*...82. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kur një subjekt i nënshtrohet masave kufizuese për shkak të mbështetjes ndaj armëve bërthamore, ajo është paraqitur publikisht si një kërcënim serioz për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, kjo passjell përbuzjen dhe dyshimin ndaj kësaj shoqërie (e cila në këtë mënyrë ndikon reputacionin e saj) dhe për këtë arsye është shkaktuar dëm jopasuror.”*

Në lidhje me dëmin e shkaktuar, kërkuesi pretendoi shpërblim për të dy dëmet: pasuror dhe jopasuror si rezultat: 1) I mbylljes së disa llogarive bankare dhe pezullimin e pagimit të tij me euro, nga bankat europiane, 2) nga mosvazhdimi i marrëdhënieve me furnizuesit europianë dhe 3) nga fakti që ishte e pamundur të zbatonte tërësisht ose pjesërisht, katër kontrata të lidhura me klientë. Përveç humbjes të paguhet edhe një interes vjetor prej 5% nga 01 Janari 2013 si dhe 4) dëm për cënim të të drejtës së personalitetit të tij e veçanërisht të reputacionit prandaj kërkon një shpërblim prej 2 000 000 euro. Gjykata në përfundim vendosi: “1. Anullimin sa i takon shoqërisë Safa Nicu Sepahan Co.:

– pikës 19 pjesa I.B e Aneksit I të Rregullores zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 503/2011 datë 23 Maj 2011 mbi zbatimin e rregullores për zbatimin e masave kufizuese ndaj Iranit;

– pikës 61 pjesa I.B e Aneksit I të Rregullores zbatuese të Këshillit (EU) No 267/2012 e 23 Mars 2012 mbi zbatimin e masave kufizuese ndaj Iranit dhe shfuqizimin e rregullores (EU) No 961/2010;

2. Urdhëron Këshillin e Bashkimit Evropian të paguaj Safa Nicu Sepahan shpërblimin prej 50 000 Euro për dëm jo-pasuror;

3. Urdhëron të paguhet edhe interesi mbi këtë shumë, sipas nivelit të interesit të Bankës Qëndrore Europiane plus 2% mbi këtë shumë.

4. Rrëzon pretendimet e tjera sit ë paprovuara.

5. Ndarjen e shpenzimeve gjyqësore në mënyrë të barabartë mes palëve.”

## **7.9 Mënyrat e shpërblimit nga Institucionet Komunitare për përgjegjësinë jashtëkontraktore**

Mbi mënyrën e shpërblimit, Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian bazohet te parimeve e përbashkëta të çdo shteti anëtar mbi mënyrën se si shpërblehen të dëmtuarit nga një akt i administratës publike. Shpërblimi duhet të jetë i drejtë (just satisfaction) dhe jo për të pasuruar apo pakësuar pasurinë në mënyrë të padrejtë të të dëmtuarit.

Kryesisht njihet mënyra e shpërblimit monetar i zbatuar në dëmet pasurore dhe jopasurore apo dëme të mundshme dëme të ardhshme. Po ashtu janë të njohur edhe forma shpërblimi si: 1) ndërprerja e efekteve të aktit të kundërligjshëm; 2) konfiskimin ose shkatërrimin e ndonjë sendi, objekt gjykimi dhe 3) publikimi i vendimit me shpenzime të Komisionit, në revista të caktuara dhe faqet e internetit.<sup>510</sup>

Gjykata nuk njeh shpërblimin shëmbull ose ndëshkues siç e njeh e drejta anglosaksone. Në rregulloren (EC) Nr 864/2007 të datës 11 Korrik 2007 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit “Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet jo-kontraktuale”

<sup>510</sup> Shih çështjen T-19/07, Systran SA dhe Systran Luxembourg SA k. Komisionit, datë 16 dhjetor 2010, çështja C-103/11 P, Komisioni k. Systran SA dhe Systran Luxembourg SA).

(Rome II) parashikohet se "ky ligj nuk mund të sjellë kompensime të tilla të tepërta si ato të dëmeve ndëshkuese apo dëmeve shëmbullore pasi kjo përbën një tejkalim të politikës publike dhe me ligjet e shteteve anëtare dhe të jurisprudencës së gjykatës."

Po ashtu as Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 44/2001 e datës 22 Dhjetor 2000 mbi juridiksionin dhe njohjen dhe ekzekutimin e Vendimeve në Çështjet Civile dhe Tregtare dhe as Rregullorja e Këshillit (KE) Nr 2201/2003 e datës 27 Nëntor 2003 nuk e njohin këtë lloj shpërblimi.

Gjithashtu gjykata nuk njeh në formë kompensimi detyrimin e Komisionit për të urdhëruar që në të ardhmen të mos kryehet një veprim i caktuar si p.sh., të mos përdoret fjala Galileo në të ardhmen nga vetë Komisioni, të tretët etj. Për gjykatën të tilla kërkesa janë të papranueshme, pasi neni 340 (2) TFEU (ish 288 (2) EC) lejon kompensim vetëm për dëmin e kaluar dhe nuk synon të japë urdhëra parandalues për të ardhmen. Ky lloj kompensimi bie në kundërshtim me parimet e përgjithshme të përbashkëta të përgjegjësive jo kontraktore të shteteve anëtare, përfshirë edhe kompensimin në natyrë për të bërë ose jo diçka.<sup>511</sup>

Një tjetër mënyrë është edhe ajo që përdoret shpesh nga GJEDNJ, thjesht konstatimi i shkeljes, pa dhënë asnjë shpërbim monetar. E ilustruam me rastin nr. 300/07, datë 09 Shtator 2010, *Evropaiki Dynamiki-Proigmena Systimata Tilepikoinonion Pliroforikis kai Tilematikis AE. (Greqi) kundër Komisionit*.

Në këtë çështje ankuesi pretendon se përgjzgjedhja e një firme tjetër në fushën e telekomunikacionit, nuk ishte e drejtë e për këtë kërkon anulimin e vendimit të Komisionit dhe shpërblimin e dëmit për shumën e humbur. Gjatë gjykimit, Komisioni shpjegoi se ashtu siç i është kthyer përgjigjje ankuesit, ai bashkë me shoqërinë e përzgjedhur kishin marrë pikët e nevojshme por firma fituese ishte me pikë më të larta se ankuesi. Sipas gjykatës kjo procedurë tenderimi duhet anuluar për shkak të arsytimit të gabuar në përzgjedhje. Megjithatë gjykata nuk e gjeti si rast që Komisioni ka vepruar në paligjshmëri ose dëmi ka ardhur për shkak të një veprimi të paligjshëm të Komisionit. Gjykata nuk arriti të konkludojë nëse vendimi kishte mungesë transparence, kishte pakujdesi apo dashje në diskriminimn e aplikuesve. Në këtë rast sipas Gjykatës, ankuesi duhet të kenaqet vetëm me anulimin e këtij tenderi dhe përsëritjen e tij në të ardhmen.

Për dëmet pasurore mënyra e shpërblimit sipas këtyre parimeve paraqitet më e thjeshtë, pra humbje e pësuar plus fitim i munguar dhe shpenzime të tjera të hasura.

Ndërsa te dëmi jopasuror, në aq pak raste sa ka trajtuar GJD e BE, mënyra e shpërblimit ka qënë tepër abstrakte dhe e pa shtjelluar se përse u arrit në atë masë, kjo ndoshta edhe nga mungesa e praktikës për të marrë si referencë vendime të tjera. Një mënyrë që GJEDNJ e përdor shumë. Në llogaritjen e dëmit i bie barra ankuesit të provojë sa është dëmi dhe ka shumë raste kur gjykata ka rrëzuar ankimin sepse ankuesi nuk ka arritur të kalojë këtë detyrim.

Kur pranon padinë për shpërblim dëmi, gjykata i lë një afat prej tre muajsh institucionit përkatës të BE për të ekzekutuar këtë vendim ose minimalisht për të informuar Gjykatën se si po ecën procedura e zbatimit të këtij vendimi, ose u lë afat për të arritur një marrëveshje për masën e shpërblimit final dhe për t'ia paraqitur marrëveshjen për miratim Gjykatës.

Kështu, në çështjen Nr. 256/81 datë 18 Maj 1983, *Pauls Agriculture Limited kundër Këshillit dhe Komisionit të KEE*, Gjykata urdhëroi Komunitetin Ekonomik Europian të paguajë sasinë e babartë të rimbursimeve të miellit të misrit nga data 1 Gusht deri ne datë 19 Tetor 1997 plus një inters 6% mbi këtë shumë e llogaritur nga

<sup>511</sup> Po aty faqe 737.

dita e dhënies së këtij vendimi. Për tre muaj duhet të informohet Gjykata për arritjen e marrëveshjes për pagimin e kësaj shume në të kundërt palët duhet të njoftojnë gjykatën për shumën që pretendojnë.

Në lidhje me kamatë vonesat, Gjykata në çështjen nr. T-351/03, datë 11 Korrik 2007, *Schneider kundër Komisionit* është shprehur se pagesa e interesave është një pjesë e pandarë e të drejtës për shpërbllim nga një dëm i ardhur sipas nenit 288 §2 i Traktatit. Ajo synon riparimin e situatës për viktimën.<sup>512</sup> Gjykata Europiane nuk mund të shpërfillë kohën nga momenti i materializimit të humbjes dhe deri në momentin e pagesës së të dëmtuarit. Data kur fillon llogaritja e fitimit të munguar është data e shpalljes së vendimit nga Gjykata Europiane dhe nëse nuk paguhet në këtë datë, do të llogariten për çdo ditë vonesë deri në pagesën e plotë, intersi ditor i Bankës Qëndrore Evropiane. Ky shpërbllim nuk i nënshtrohet asnjë takse të së drejtës së brendshme.

Në çështjen C-282/05 datë 19 Prill 2007 P, *Holcim AG undër Komisionit*, gjykata gjeti si fitim të munguar përqindjen bankare prej 4.5% në vit, që paguante për masën e garancisë të ngrirë në favor të Komisionit nga data 3 Maj 1995 deri në atë 2 Maj 2000 që të siguronte shlyerjen e gjobës. Duke qenë se kjo gjobë u konsiderua e padrejtë, nga Gjykata e Shkallës së Parë të Investimeve, GJED pranoi në formë shpërbllimi shpenzimet për ruajtjen e garancisë bankare, shpenzimet e avokatëve për anulimin e gjobës si dhe shpenzimet për ngrirjen e garancisë në favor të Komisionit. Gjykata vlerësoi se masa e dëmit të shkaktuar do të llogaritet nga data kur është materializuar dëmi, pra kur ka filluar të ngrihet garancia në favor të Komisionit.<sup>513</sup>

Masës së shpërbllimit të dëmit i zbritet masa e shtuar nga veprimet e pakujdesshme të të dëmtuarit. Sipas praktikës së Gjykatës së Drejtësisë dhe bazuar edhe në parimet e përgjithshme të përbashkëta të shteteve anëtare, pala e dëmtuar duhet të tregojë kujdes të arsyeshëm në shmangien ose kufizimin e shkallës së dëmit ose të mënjanojë çdo rrezik tjetër që shkakton pasojën. Edhe nëse sjellja e Institucioneve të BE mund të sjellë dëmin, kjo lidhje shkakësore mund të prishet nga pakujdesia e palës së dëmtuar, nëse ajo është) determinante në ardhjen e pasojës. Kjo linjë e praktikës gjyqësore në lidhje me kujdesin e arsyeshëm të aplikantit vjen që nga *çështja Brasseurie*.<sup>514</sup>

Ndërsa mbi mënyrën e shpërbllimit të dëmit jopasuror i referohemi përsëri vendimit *Safa Nicu Sepahan Co ndaj Këshillit të BE (2014)* ku gjykata parashikon disa kriteret që duhet merren parasysh në matjen e tij në mënyrë sa më objektive: “83. Dëmtimi i reputacionit të subjektit në fjalë është edhe më e rëndë pasi ajo nuk është bërë nga shprehja e opinionit të një personi për një deklaratë zyrtare të një institucioni të BE-së, e cila është publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimi Evropian edhe pasojë të detyrueshme juridike.

84. Në lidhje me shumën e kompensimit që do të jepet gjykata gjen se së pari si formë e përshtatshme është anulimi i rregullores për përfshirjen e tij si një nga shoqëritë mbështetëse të armëve bërthamore. Megjithatë, në rrethanat e çështjes në fjalë, anulimi i listës së aplikantit është e tillë që shpërblen pjesërisht dëmin por jo tërësisht. Fakti se për tre vjet emri i saj ka qëndruar në emrat e shoqërive që financojnë armët bërthamore dhe veprimtaritë e tjera bërthamore e prandaj BE ka marrë masa kufizuese për to, nuk mund të kompensohet vetëm me konstatimin e akteve të paligjshme. ...

91. Aq më tepër se rrethana të tilla si: emri i shoqërisë është konsideruar një kërcënim për paqen ndërkombëtare dhe sa kohë është menduar që financon Iranin në projektet e tij bërthamore, së dyti mungesa e provave dhe informacioneve të Këshillit

<sup>512</sup> Shih paragrafin 2343 të vendimit të cituar.

<sup>513</sup> Shih paragrafin 23 të vendimit.

<sup>514</sup> Po aty faqe 729.

për një klasifikim të tillë, së treti listë me emrin e kërkuarit, i cili u botua në Fletoren Zyrtare, mund të ishte tërhequr nga Këshilli në çdo kohë por ajo u mbajt për gati tre vjet, pavarësisht kundërshtimeve të aplikantit. ...

92. Prandaj, duke vlerësuar dëmin jopasuror të pësuar nga aplikanti *ex aequo et bono* (të drejtë dhe të mirë), Gjykata çmon se një shpërblim prej 50 000 EUR do të përbënte kompensimin e duhur.

### 7.10 Parashkrimi i të drejtës për të kërkuar shpërblim dëmi nga Institucionet e Bashkimit Europian

Në jurisprudencën e saj gjykata ka rrëzuar mjaft ankime si të parashkruara edhe pse ankuesi mund të ketë pësuar një dëm i cili mund të ishte pranuar sipas nenit 340§2 I TFEU.

Në lidhje afatin e parashkrimit të padisë për shpërblim dëmi, sipas nenit 46 të Traktatit të Lisbonës parashikohet se: “Gjykimet në lidhje me paditë e përgjegjësisë jashtëkontraktore kundër Bashkimit Europian parashkruhen brenda pesë viteve nga data kur ka ndodhur ngjarja.

Afati i parashkrimit ndërpritet nëse ka filluar gjykimi para Gjykatës së Drejtësisë ose në qoftë se para se të fillojnë procedurat gjyqësore është bërë një kërkesë nga pala e dëmtuar, në institucionin përkatës të Bashkimit.

Në rastin e fundit procedura duhet të fillojë brenda një periudhe prej dy muajsh të parashikuar në nenin 263 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Europian.

Dispozitat e paragrafit të dytë të nenit 265 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Europian zbatohen sipas rastit.

Ky nen zbatohet edhe për procedurat kundër Bankës Qendrore Evropiane në lidhje me përgjegjësinë jo-kontraktore.”

I dëmtuari e ka në diskrecion t’i drejtëgjyket GJD së BE apo t’i drejtëgjyket institucionit të BE që ka shkaktuar dëmin. Ky i fundit ka një afat prej dy muajsh të japë vendim për kërkesën për shpërblim të dëmit kërkuarit. Nëse është çelur një procedurë para gjykatës dhe njëkohësisht është paraqitur një ankim në organin e BE, gjykata pezullon vetëm dy muaj çështjen deri sa të pritë disponimi i institucionit përkatës, në të kundërt gjykata vazhdon gjykimin edhe nëse institucioni nuk ka arritur të marrë një vendim apo ka marrë vendim negativ.

Në çështjen T-554/93 datë 16 Prill 1997, *Saint dhe Murray k. Komisionit dhe Këshillit*, gjykata mori në shqyrtim ankesën për shpërblim dëmi sipas nenit 215 të Traktit të KEE (aktualisht nenit 340) pasi ndalimi i shitjes së qumështit ishte bërë nga një Rregullorë Nr. 857/84 që më pas u anulua nga GJED me vendimin Mulder II, datë 28 Prill 1988.

Në lidhje me kohën e parashkrimit të kërkesës, ankuesi argumentoi se sipas qëllimit të nenit 43 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë, kjo kërkesë nuk është e parashkruar pasi afati fillon në datën kur u mor vendimi *Mulder*.<sup>515</sup> Në këtë datë mori dijeni se rregullorja është e paligjshme prandaj llogaritja e afatit të parashkrimit duhet të fillojë këtu.

Këshilli prapësoi mbi këtë fakt duke argumentuar se data 5 Gusht 1987 është data kur kanë pësuar dëmin prandaj dhe këtu fillojnë afatet e parashkrimit. Madje, praktika gjyqësore është e konsoliduar se padia e shpërblimit të dëmit është autonome

<sup>515</sup> Idem para.60 i vendimit.

dhe ngrihet pa pasur një vendim që deklaron rregulloren apo ndonjë akt tjetër të paligjshëm.<sup>516</sup>

Gjykata në këtë vendim u shpreh se afatet e parashkrimit fillojnë kur dëmi është pësuar tek personi dhe deklarimi i pavlefshëm i Rregullores Nr. 857/84 nuk është shkak pa të cilën nuk mund të pretendohet shpërblim të dëmit jashtëkontraktor nga Komuniteti.

Sipas nenit 215 të Traktatit, përgjegjësia e organeve dhe institucioneve komunitare është autonome nga paditë për pavlefshmëri të akteve të tyre prandaj është e pabazë të pretendohet se kjo padi ngrihet pas anullimit të aktit. Sipas gjykatës afatet fillojnë më datë 01 Prill 1984 kur hyri në fuqi rregullorja që ndaloi aplikuesit të shpërndajnë qumësht, përveç kur nuk ka akte që kanë shtyrë afatin e parashkrimit<sup>517</sup> ku arsyetohet se: “88. Dëmi nuk është shkaktuar në mënyrë të menjëherëshme por ka pasur vijimësi, për sa kohë që ankuesit kanë qenë të ndaluar të tregtonin qumësht çdo ditë.

89. Si pasojë, e drejta për shpërblim lidhet me periudhën që nuk ka mbushur afatin e parashkrimit pesë vjeçar ... ankuesit afati i parashkrimit i ndërpritet me datë 29 Tetor 1993 kur paraqiti ankesën në Gjykatën e Drejtësisë...

91. Nisur nga paditë e shumta të ndërmarrjeve të dëmtuara nga rregullorja nr. 857/84, institucionet e shkaktare vendosën të mos merrnin parasysh afatin e parashkrimit sipas nenit 43 të Stautit të Gjykatës së Drejtësisë deri në një afat që do të miratohet me një akt të mëvonshëm. Konkretisht në nenin 10 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 2187/93 u parashikuan si afat të fundit i parashkrimit ai datë 30 Shtator 1993.

92. Në këtë rast, aplikantët më datë 29 Tetor 1993 paraqitën kërkesën për shpërblim në bazë të Rregullores Nr. 2187/93 për dëmet e pësuar para datës 30 Shtatorit të vitit 1993 ... Përfundimisht gjykata deklaroi se të paditurit duhet të shpërblejnë kërkuarit bazuar në rregulloren Nr. 857/84 të datës 31 Mars 1984 për dëmin e pësuar nga data 5 Gusht të vitit 1987 deri më datë 28 Mars 1989. Ky shpërblim duhet paguhet brënda 12 muajve nga dita e dhënies së këtij vendimi.”

---

<sup>516</sup> Idem para. 78 i vendimit.

<sup>517</sup> Idem para.80 i vendimit.

## **KREU VIII**

### **PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

1. Përgjegjësia e shtetit, organeve të tij administrative apo e nëpunësve karshi shtetasve të tij është njohur që nga koha e Perandorisë Bizantine (për aq sa tregojnë dokumentet por kjo nuk përjashton faktin se mund të jetë edhe më e hershme si institut i së drejtës) duke u zhvilluar progresisht deri më sot. Duket qartë se fillimisht kjo përgjegjësi në Mesjetë dhe në kohën e Perandorisë Osmane shkarkohej drejtëpërdrejtë tek personi i veshur me pushtet shtetëror ndërsa më pas kjo përgjegjësi u mbajt e përbashkët mes shtetit dhe nëpunësit të tij (shih Statutin Themeltar të Republikës dhe të Mbretërisë së Shqipërisë e në vijim).

2. Po ashtu mënyra e zhdëmtimit të individëve përpara pavarësisë së Shqipërisë ishte vetëm me detyrimin e ofiqarëve, nëpunësve për të mos kryer atë veprim apo me ndalimin e për të bërë keq banorëve etj. dhe nuk ndahej nga përgjegjësia disiplinore apo penale ku në rast rëndimi të situatës dhe ofiqari vazhdonte të përsëriste veprimet passillte shkarkimin e tij dhe dënimin deri me vdekje.

3. Me krijimin e shtetit shqiptar u njohën format e riparimit të dëmit të personit të dëmtuar dhe institucionet shtetërore mund ti kërkonin punonjësit me padi regresi atë çfarë kishin paguar për dëmin e shkaktuar me faj të tij. Për shkak të ideologjisë së shtetit komunist, gjëndjes ekonomike të kohës etj. personi i dëmtuar nuk mund të pretendonte fitim të munguar, dëm moral etj. përveçse shpërblim të dëmit material të shkaktuar nga institucionet në formën e zëvendësimit, riparimit apo pagimin e çmimit të asaj çfarë mund të ishte dëmtuar.

4. Forma të reja të shpërblimit nga dëmet që i shkaktohen personave nga organet e administratës publike u parashikuan për herë të parë me ligjin nr. 8485 datë 12 maj 1999 "Kodin e Proçedurave Administrative" hyrë në fuqi në janar 2000 dhe më pas me ligjin nr. 8510 datë 15 korrik 1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore" i hyrë në fuqi në gusht 1999. Në këtë temë ky ligj paraqitet në mënyrë të detajuar për të gjitha rastet e përgjegjësive jashtëkontraktore të organeve publike të parashikuar jo vetëm në këtë ligj por të ndërthurura edhe me rastet e Kodin e Proçedurave Administrative të 1999 për efekte teorike pasi tashmë më 28 maj 2016 ky kod është shfuqizuar nga Kodin e Proçedurave Administrative të 2016.

5. Po ashtu në punim janë paraqitur në detaj llojet e dëmeve përkatëse që hasen tek të dëmtuarit e drejtëpërdrejtë, indirekt, mënyra e shpërblimit të tyre dhe subjektet përgjegjëse. Jo paqëllim është krahasuar me shtetet e tjera në botë por edhe me mënyrën e shpërblimit të dëmeve në gjykime civile pasi vetë ligji të referon tek Kodi Civil, tek jurisprudenca e Gjykatë Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Strasburg) Ndërsa mbi mënyrën dhe kriteret kushtëzuese për të ekzistuar përgjegjësia jashtëkontraktore e Organeve të Administratës Publike jemi mbështetur edhe tek përgjegjësia civile në nenet 608 e vijues të Kodit Civil, praktika gjyqësore në Shqipëri por edhe ajo e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit European (Luksemburg).

6. Ky ligj paraqet rëndësinë e vetë pasi është i pari dhe i vetmi ligj në Shqipëri që njihet në mënyrë të detajuar përgjegjësinë civile ose jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore karshi të dëmtuarve direkt a indirekt.

7. Ky ligj vlen edhe për përgjegjësinë e organeve publike, koncept më i gjërë i futur nga Kodin e Proçedurave Administrative i vitit 2016 duke qënë në harmoni me nenit 44 të Kushtetutës që kushdo duhet të kompensohet dhe rehabilitohet nga dëmet e shkaktuar nga çdo organ shtetëror. Me hyrjen në fuqi të KPRA të Ri u rikonceptua organi publik i cili përfshin 1) organe të administratës publike plus, 2) çdo person juridik të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi e drejta e ushtrimit të funksioneve të administratës publike por, edhe 3) çdo person fizik që vepron si punonjës i policisë së shtetit, inspektor të drejtorisë rajonale të tatimeve, nëpunës i gjëndjes civile apo çdo punonjës tjetër i punësuar në organe publike të pushtetit vendor a qendror dhe tashmë në çdo ligj Pra, termi organ publik është termi që do të unifikoj në vitet në vijim termin organ publik apo organ shtetëror. Megjithatë duhet të kemi të qartë se edhe në ato raste ku në ligj vazhdon të citohet termi "administratë shtetërore" apo "organ i administratës shtetërore" "organ i administratës publike" duhet të kuptohet organ publik.

8. Ky institut është një ndërthurje e rregullimit të përgjegjësisë jashtëkontraktore në fushën civile me përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve publike. Prandaj jurisprudenca, doktrina për përgjegjësisë jashtëkontraktore në të drejtën civile vlen edhe për rastet e përgjegjësisë civile të organeve të administratës publike karshi personave të dëmtuar. Kjo është arsyeja sepse në këtë temë i tërë ligji nr. 8510/1999 është analizuar në përputhje me nenet 608-652 të Kodit Civil dhe praktika gjyqësore e Kolegjit Administrativ, Kolegjit Civil, vendimi unifikues nr. 12/2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë etj. mbi institutin e *padisë aquiliana*, format e dëmeve dhe mënyrën e shpërblimit të dëmeve pasurore dhe jopasurore.

9. Ligji nr. 8510/1999 paraqitet për kohën avangardë pasi për herë të parë parashikoi dëmin moral si lloj të dëmit jopasuror. As Kodi Civil në nenin 625 dhe as neni 44 i Kushtetutës apo ligje të tjera nuk i njihnin më parë këtë dëm. Më pas ky lloj dëmi është elaboruar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 12/2007 duke njohur si lloj të dëmit jopasuror, pikërisht dëmin moral që njihet ky ligj por edhe dëmin ekzistencial dhe dëmin biologjik. Tashmë këto forma të dëmit jopasuror, në praktikën gjyqësore mund të kërkohen nga të dëmtuarit përkundrejt administratës publike.

10. Interpretimet e ligjit nr. 8510/1999 nga jurisprudenca shqiptare janë modeste megjithatë ato janë të plota dhe në referencë të nenit 14 të Kodin e Proçedurave Administrative të 1999, neni 15 i Kodin e Proçedurave Administrative i vitit 2016 dhe nenit 44 të Kushtetutës, pra të pa shkëputura nga njëra –tjetra. Me "lindjen" e Gjykatave Administrative kjo jurisprudencë do jetë me pasur dhe më cilësore gjë që është pasqyruar me shtimin e kërkesë-padive të tilla dhe gjykimin më me shpejtësi dhe cilësi nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, Gjykata e Apelit Administrativ apo gjashtë Gjykatat Administrative të Shkallëve të Para që janë veprone në vënd.

11. Në rrethin e subjekteve që mbajnë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar personave janë organet publike. Pra, këtu përfshihen edhe çdo organ tjetër që kryen veprimtari administrative gjatë ushtrimit të detyrës. Në Itali ndryshe nga Shqipëria gjyqtari mban përgjegjësi civile për veprimet e tij qoftë si organ i pushtetit gjyqësor por



edhe kur kryen veprime të thjeshta administrative për efekt të detyrës kushtetuese. Në Shqipëri i vënti rast kur gjyqtari indirekt mban përgjegjësi civilisht është i parashikuar në nenin 467/a § 1 të Kodit të Proçedurës Civile. Pra kur çështja prishet dhe i dërgohet për rigjykim përsëri gjykatë së shkallë së parë, kjo e fundit është e detyruar t'i përmbahet vendimit të gjykatës së apelit për çdo veprim procedural të vendosur në të si p.sh thirrja e personavë të tretë, marrja e një mendimi eksperti, pyetja e dëshmitarëve, kqyrja në vënd etj. Mendoj se për të rritur përgjegjshmërinë maksimale edhe në gjykim, dhe gjyqtari duhet të mbaj përgjegjësi civile karshi të tretëve, palëve ndërgjyqëse për veprime qoftë gjyqësore qoftë administrative që kryen. Kjo rrit edhe sigurinë e palës se gjykimi i tij do të jetë i shpejtë dhe cilësor pasi në të kundërt shkaktari mban përgjegjësi për dëmin që i vjen.

12. Ligji nr. 49/2012 “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative” në nenin 41§1, “f” parashikon se shpërblimi i dëmit nga ana e administratës shtetërore bëhet sipas ligjit nr. 8510/1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”. Si mënyra që parashikon ky ligj është ajo e shpërblimit në natyrë dhe në mënyrë subsidiare është shpërblimi monetar. Mënyrat e shpërblimit janë shteruese dhe nuk parashikohet ndonjë mënyrë tjetër sa më sipër. Megjithatë në Kodin e Proçedurës Civile, Kodin e Proçedurës Penale dhe vetë Kodin Civil parashikohet se një formë tjetër kompensimi për dëmin jopasuror është ajo e botimit të vendimit gjyqësor në një gazetë/media kombëtare, lokale etj. si e çmon gjykata të nevojshme. Mendojmë se ligji nr. 8510/1999 duhet të ndryshohet duke e njohur edhe këtë mënyrë e shpërblimit të dëmij jopasuror, të botimit të vendimit në gazetë kur gjejnë një organ administrative në shkellje të veprimtarisë dhe që kanë sjell dëm personit. Aktualisht një zgjidhje mund të ishte botimi me analogji i vendimit në referencë të nenit 30 të Kodit të Proçedurës Civile.

13. Ndryshe nga e drejta penale ku nevoja ekstreme është rast i papërgjegjshmërisë penale në të drejtën civile kjo njihet si rast përgjegjshmërie për çdo dëm të ardhur, neni 612 i Kodit Civil. Mendojmë se, kjo dispozitë duhet riparë për tu shfuqizuar dhe për të mos u konsideruar veprimet që kryen nëpunësi publik, organi publik në nevojë ekstreme si rast ku do të mbajë përgjegjësi karshi të tretëve. Aktualisht duket se legjislatori kërkon ta paraqes si një rast përjashtues nga përgjegjësia por në fakt e ka konsideruar si rast ku mban përgjegjësi personi që kryen një veprim të tillë. Për analogji edhe në Kodin Penal veprat penale në kufijtë e mbrojtjes së nevojshme dhe ato të nevojës ekstreme passjellin padënueshmërinë e autorit, duke u barazuar me njëra-tjetrën këto dy raste.

14. Në ligjin nr. 8510/1999 por edhe në Kodin Civil duhet të përjashtohet përgjegjësia që vjen nga forcat madhore apo rastit fator. Nuk ka ndonjë përkufizim se çfarë është njëra apo tjetra por referuar edhe Kodit Civil francez dhe atij italian do kuptohen si rast fator, rastet e befasisme dhe të pamundura për tu ndaluar me çfardo lloj përpjekie ndërsa forcat madhore përfshihen forcat e natyrës si orteke, rrebesh, përmbytje, tërmet, vullkan dhe ato të shkaktuara nga njeriu si kryengritje, protesta që pengojnë personin të realizoj një detyrë.

15. Rezulton se nëpunësi publik i cili nuk ka patur ndërgjegjien e veprimeve duke qënë se i referohet Kodit Civil, mban përgjegjësi. Ky lloj parashikimi duhet të shfuqizohet nga Kodi Civil apo të parashikohet si rast përjashtues me ndryshime të

mundshme në ligj pasi ndryshe nga e drejta penale e drejta civile në nenin 616 të Kodit Civil i ngarkon përgjegjësi personit në këtë gjëndje. Në të drejtën penale, mospasja e ndërgjegjies për të kryer veprime paraqitet kur personi vuan nga ndonjë turbullim psikik ose neuropsikik dhe i pandehuri përjashtohet nga përgjegjësia penale (neni 17 i Kodit Penal). Sipas neni 10 të Kodit Civil parashikohet se personit madhor për shkak të sëmundjes psikike a zhvillimit të metë mendor mund ti hiqet ose kufizohet zotësia për të vepruar, kjo në varësi të shkallës së sëmundjes. Ashtu siç është sot neni 616 i Kodit Civil duhet interpretohet në favor të palës me nivel më të ulët intelektualisht. Pra nëse provohet se në momentin e shkakimit të dëmit, personi nuk ka ndërgjegjie për ngjarjen e ndodhur të mos ketë përgjegjësi për pasojat. Në Francë e Itali përgjigjet prindi, kujdestari ligjor për dëmin jashtëkontraktor të kryer në këtë gjëndje.

16. Në matjen matjen e vlerave të dëmit pasuror dhe sidomos jopasuror duhet të jepet nga gjykata shpërblimi në zë të veçantë për çdo dëm të pësuar në mënyrë që edhe i dëmtuari të bindet se sa është vlerësuar dëmi në shëndet, dëmi moral, dëmi ekzistencial i tij apo i paditësave të tjerë dhe të ketë mundësi të ankimoj vendimin vetëm për atë zë shpërblimi që mendon se nuk është dakort. Aktualisht në praktikë akoma hasen shpërblimi i dëmit pasuror apo jopasuror të shkaktuar nga organi publik me një shumë totale pa e ditur se sa është masa për llojet e dëmeve pasurore dhe jopasurore etj.

17. Bashkë me masën e shpërblimit të dëmit, është e drejtë pasurore e të dëmtuarit që të kërkoj edhe kamatvonesat përkatëse nga data e shkakimit të dëmit dhe deri në datën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Zakonisht këto maten nëpërmjet një eksperti kontabël por edhe nëse pala nuk e kërkon këtë të matur specifikisht dhe ka interes për to, gjykata mund të shpreh vetëm metodologjinë e matjes së kamatave të arrira sipas neni 450 të Kodit Civil. Sipas praktikës gjyqësore të tilla kamata janë konsideruar të barbarata me interesin efektiv nga depozitat bankare një vjeçare, të referuar nga Banka e Shqipërisë për atë vit.

18. Në praktikë gjyqësore njihet e drejta e të dëmtuarit që bashkë me padinë shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor të ngrihet kërkitimi për rivendosje në afat të padisë. Kolegji Administrativ i GJL njohu koneksitetin mes tyre, sipas neni 159 të KPRC. Pra, mund të paraqiten në një padi edhe pse kanë karakteristika të dukshme: e para gjykim gracioz, me kërkesë dhe person të tretë ndërsa e dyta me gjykim kontencioz mes dy palëve kundërshtare kërkesa për rivendosjen në afat sipas neni 151 të KPRC është ankimi i veçantë (5 ditë) ndërsa padia e themelimit ka një afat ankimi të përgjithshëm (15 ditë).

19. Në lidhje me shpërblimin e dëmit në Shqipëri nuk njihet shpërblimi ndëshkues ndaj të dëmtuarit si vëndet anglo-saksone por Shqipëria ka përqafuar vëndet ku shpërblimi i dëmit jepet për të kthyer palën në gjëndjen përpara dëmit. Praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore nuk njih shpërblimin shëmbull ose ndëshkues Për gjykatën të tilla kërkesash janë të papranueshme, pasi neni 340 (2) TFEU (ish 288 (2) EC) lejon kompensim vetëm për dëmin e ndodhur dhe nuk synon të japë urdhëra parandalues për të ardhmen. Ky lloj kompensimi bie në kundërshtim me parimet e përgjithshme të përbashkëta të përgjegjësive jo-kontraktuale të shtetet anëtare, përfshirë edhe kompensimin në natyrë për të bërë ose jo diçka.

20. Në ligjin nr. 8510/1999 duhet të merren parasysh edhe parimet në fushën e së drejtës ndërkombëtare publike sidomos ajo e Asamblesë së Përgjithshme të OKB mbi mënyrën e shpërblimit të dëmeve ndër-shtetërore. Dy janë format të cilat janë të panjohura në Shqipëri si mënyra të kompensimit të dëmit për të cilën është rasti edhe të përfshihen në ligjin e posaçëm. Deklarata e sadisfaksionit ku organi administrativ mund të dërgoj tek i dëmtuari se e njuh dëmin e shkaktuar dhe paraqet ndjesën e tij duke e paraprirë me një zgjidhje me pajtim të mosmarrëveshjes.

Një formë tjetër është edhe kundërmasat që i dëmtuari mund të marrë karshi organeve shtetërore kur ka një dëm të mëparshëm të shkaktuar. Në mardhënien shtet-person i dëmtuar, kundërmasa mund të jetë në formën e moshlyerjeve të detyrimeve tatimore karshi shtetit sq sa është edhe shpërblimi për dëmin jashtëkontraktor që shteti i ka shkaktuar personit, duke u kompensuar mes njëri-tjetrit.

21. E drejta për kompensim për burgim të padrejtë (neni 5 § 5) parashikohet në mënyrë të veçantë si një formë e kompensimit të shtetit për veprime të padrejta të organeve të saj. Kjo e drejtë në Shqipëri është rregulluar me ligjin nr.9381, datë 28.4.2005 “Për kompensimin e burgimit të padrejtë” i pandryshuar asnjëherë. Vihet re se masat e shpërblimit që nga ky vit e deri më sot janë tepër minimale duke mos reflektuar aspak ndryshimet kombëtare të gjendjes ekonomike. Prandaj në përputhje me parimin e shpërblimit të plotë të dëmit, ky ligj si një formë e dëmit jashtëkontraktor është e nevojshme të ndryshohet.

22. Ligjet e posaçme që njohin përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve publike dhe punonjësve të tyre, duhet të jenë të unfikuara kur referojnë tek ligji i posaçëm. Si rast merret ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ku në nenin 26 referon tek Kodi Civil për dëmet jashtëkontraktore që administrate i shkakton qytetarëve. Në fakt ky nen duhet ndryshuar duke referuar direkt tek ligji nr. 8510/1999 si i vetmi ligji i cili rregullon në mënyrë të detajuar këtë institut të së drejtës administrative.

23. Institucione të specializuar të cilët vëzhgojnë dhe japin opinione mbi zbatimin efektiv të ligjit nr. 8910/1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organit të administratës shtetërore” i ndryshuar si p.sh Avokati i Popullit kanë vërejtur si problematike mosnjohjen dhe moszbatimin e duhur të tij. Qytetarët janë në një nivel minimal të mosdijes së përgjegjësisë civile të organit publik. Edhe pse vendimarrja e gjykatave administrative<sup>518</sup> mbi rastet e dëmeve jashtëkontraktore përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë nga përmbarimi gjyqësor sipas nenit 19 të ligjit nr. 8510/1999 përsëri vihet re se personat e dëmtur pak i drejtohen gjykatave.

24. Shqipërisë në ndryshim nga shtetet e tjera përfundimtare i mbetet shumë për të bërë në lidhje përmisimin e raportit mes shtetit dhe qytetarit aq sa ky i fundit të besoj se shteti do dëmshpërblej me drejtësi dhe me shpejtësi. Për këtë arsye sugjerohet një fushatë më e gjërë qeveritare për njohjen e qytetarëve me këtë ligj dhe të drejtat e tyre për tu dëmshpërblyer në rast se kanë pasojë pasurore ose jopasurore nga veprimet e padrejta të organeve publike. Fushata informuese mund të bëhet me anë të publicitetit mediatic, broshurave, fletëpalosjeve ose tabela informuese për të drejtën e dëmshpërblimit në çdo institucion. Në këtë mënyrë jo vetëm ndërgjegjësohen personat

<sup>518</sup> Gjykatat Administrative në Shqipëri në tre nivele të saj, kanë filluar funksionimin më 4 nëntor 2013.

për të drejtën e tyre por rritet edhe përgjegjshmëria e nëpunësit publik ku vihet në dijeni me mundësinë për të paguar personalisht dëmin nëpërmjet padisë së regresit.

25. Në të gjitha ato raste gjyqësore që Avokatura e Shtetit ka qënë përfaqësuese e organit të administratës publike nuk rezulton që për dëmin e jashtëkontraktor që buxheti i shtetit i paguan të dëmtuarit, të kenë ngritur padi regresi (kthimi) ndaj fajtorit, organ administrativ apo punonjës qoftë, për të rimarrë shumën që i paguan debitorit.<sup>519</sup> Po të njëjtin problem për mosefiçensë maksimale të këtij ligji shpreh edhe Avokati i Popullit në raportin e veçantë të vitit 2012 “Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë”. Citojmë: “Në ligjin nr.8510, datë 15.7.1999, “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore, parashikohet përgjegjësia dhe detyrimi i organeve dhe i punonjesve të tyre, në rastet kur u shkaktojnë dëme pasuror dhe jopasuror personave fizike apo juridik private, vendas apo të huaj. Ky ligj bën pjesë në ato ligje që nuk ka gjetur zbatim dhe nuk ka justifikuar qëllimin e ligjvënësit.”

26. Vihet re një pasivitet të Kontrolli i Lartë i Shtetit që në rastet e auditimit të rasteve kur organi i administratës publike ka paguar për dëmin e punonjësit karshi qytetarit, nuk ka sugjeruar organin për ngritje të padive të regresit për të rikuperuar edhe situatën ekonomike të institucionit dhe të shtetit në përgjegjësi. Largimi nga puna apo masa disiplinore për shkelje të detyrës nga ana e nëpunësit publik nuk është e mjaftueshme për të rikuperuar financat e shtetit për dëme të shlyera në emër të punonjësit fajtor.

27. Neni 20 i ligjit nr. 8510/1999 parashikon se të gjitha detyrimet që nuk shlyhen menjëherë për pamundësi financiare futën si zë i veçantë në ligjin e buxhetit të shtetit për vitin pasardhës. Kjo toleron organet administrative në shtyrjen e ekzekutimit dhe passjell mos gjetjen e një zgjidhje të menjëhershme të çdo individit që ka pësuar dëme pasurore dhe jopasurore. Të dëmtuarit por edhe publiku nuk motivohen në vënien përpara përgjegjësise së administratës publike për veprimet e padrejta që ata kryejnë duke i zbehur “fuqinë” dhe “seriozitetin” ligjit, vjelja me vështirësi dhe vonesë e shpërblimit dhe nëpunësit fajtor do të familjarizohen me një situatë tillë duke ripërsëritur të njëjtin shkelje.

28. Ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 8510/1999 janë minimal, vetëm një ndryshim. Kjo tregon sesa pak është i zbatueshëm ky ligj dhe se praktika gjyqësore administrative është aq e “vakët” sa ka sjell të nevojshëm ndryshimin e saj vetëm një herë. Në nenin 3 të ligjit është shtuar pikën “dh” për njohjen si rast të përgjegjësise jashtëkontraktore për dëmet që vijnë nga veprime korruptive të nëpunësve të administratës publike por edhe vetë organit. Mendojmë se ky ndryshim është i pamjaftueshëm për të zbatuar detyrimet që Shqipëria ka marrë përpara Këshillit të Europës me ligjin nr. 8635, datë 6.7.2000 “Për konventën Civile për Korrupsionin”. Këshilli i ka lënë detyrë çdo shteti antarë që të miratoj ligj të posaçëm mbi personat përgjegjës për dëme që vijnë nga akti korruptiv gjatë ushtrimit të detyrës. Mbetet që në të ardhmen të miratohet një ligj i posaçëm në referencë të kësaj Konvente ku ne e kemi nënshkruar pa asnjë lloj reserve ose të bëhen ndryshime në ligjin nr. 8510/1999 më të detajuar duke implementuar normat e Konventës mbi rastin. Kështu shtetasve tu jepet mundësia për tu njohur dhe për ta zbatuar të drejtën e tyre për dëmet morale, materiale

<sup>519</sup> Shih Andoni G., “Për avokaturën e shtetit, opinion”, Revista “Avokatia 3”, organ I Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Tiranë 2014, faqe 45.

që u kanë ardhur apo do u vijnë në të ardhmen nga akte korruptive të personave juridik publik apo funksionarëve të tyre.

29. Në praktikë rezulton se pak janë rastet kur i dëmtuari i drejtohet drejtëpërdrejtë organeve publike për të kërkuar shpërblim të demit, kjo edhe për mosdijeni të ligjit dhe të kësaj të drejtë. Optimale do të ishte që vetë organi kur sheh se një vendimarrje sjell dëme duhet të kthej me iniciativë të saj të dëmtuarin në gjendjen e mëparshme dhe të shpërblej të gjitha dëmet e ardhura nga kjo situatë e re, pa e lënë rastin t'i drejtohet gjykatës apo organit epror. Ky veprim kryesisht i administratës parshikohej edhe në nenin 7§2 i ligjit të posaçëm nr. 8510/1999 ku: *“administrata mënjanon pasojat, nëpërmjet rivendosjes se gjendjes se mëparshme ose, kur një gjë e tillë është e pamundur, nëpërmjet vendosjes se një gjendjeje te ngjashme. ... ”*.

30. Ekzistojnë disa ligje të cilat në kundërshtim të hapur me nenin 13 të KEDNJ, nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 15 të KPRA i Ri nuk e njohin përgjegjësinë jashtëkontraktore nga veprimet e paligjshme të punonjësve të tyre karshi shtetit. I tillë është ligji nr. 9962/2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” i miratuar me shumicë të thjeshtë. Ajo çfarë paraqitet problematike është se këtë përjashtim të mospasjes së përgjegjësisë së Bankës së Shqipërisë, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, administratorët dhe çdo punonjës i saj për dëmet e shkaktuara të tretëve nuk rregullohet nga ligji i cilësuar, organik nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”. Por, kjo ndalesë parashikohet nga neni 132 i ligjit të miratuar me shumicë të thjeshtë ku parashikohet se efektet e ligjit nr. 8510/1999 nuk zbatohen tek punonjësit e bankave.

Kjo e drejtë e çdo qytetari për të kërkuar shpërblim dëmi për dëmet e shkaktuara nga ana e Bankës së Shqipërisë, është kufizuar në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës pra nuk është në interes të publikut, nuk ka proporcionalitet mes të drejtës së kufizuar dhe qëllimin e ligjvënësit për të kufizuar këtë të drejtë, duhet të jetë për një gjendje të jashtëzakonshme që e justifikon këtë kufizim.

Përjashtimi nga një parim kushtetues, nga një parim i parashikuar nga KPRA për mospasje përgjegjësi bie në kundërshtim edhe me nenin 13 të KEDNJ ku secili duhet të ketë mjete ligjore për tu kompensuar nga organet e shteteve antarë. Nëse ligjvënësi ka dashur të shmang përgjegjësinë e këtij organi shtetëror nga parimi i përgjegjëshmërisë do ta kishte bërë me ndryshimet që i ndodhen vetë ligjit “Për Bankën në Republikën e Shqipërisë” në vitet 1998, 2002, 2014.

Në këto kushte është urgjente që nga legjislatori apo edhe nga Gjykata Kushtetuese në rastin e një kontrolli incidental të shfuqizohet neni 132 pika 1, 5 e ligjit nr. 9962/2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

## **IX. BIBLIOGRAFIA**

### **1. AUTORË SHQIPTARE**

- Aleks Luarasi, “Aktet juridike. Për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri. Pjesa I”, SHBLU Tiranë 2001.
- Aleks Luarasi, “Akte Juridike për Historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri, pjesa II”, Shtëpia botuese “Luarasi”, Tiranë 1999.
- Grup autorësh Krisafi, Ballanca, Luarasi, Gjika, Zaganjori, Elezi, Nova, Omari, Hysi, Brozi, Gjilani, ”Akte Juridike për Historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri, pjesa II”, Shtëpia botuese “Luarasi”, Tiranë 1999.
- Kristo Floqi “Administrata ose e drejta sundimore”, Pjesa e përgjithshme, Shtypshkronja “Vlora”, Vlorë, (1923).
- Jani Çomo “E drejta administrative e Republikës Popullore të Shqipërisë, dispenca III”,
- Nikola D. Mole ”Konstitucionalismi”, Luarasi Tiranë 1997.
- Prof. Dr. Ermir Dobjani “E drejta administrative, pjesa e përgjithshme”, Shtëpia Botuese “Emal” Tiranë, 2016.
- Erajd Dobjani “Kontratat administrative në të drejtën shqiptare-desertacion për mbrojtine e gradës doktor” Tiranë (2015).
- Rezarta Mataj “Përgjegjësia civile e gjyqtarit, vështrim, krahasues në shtetet e rajonit” Konferenca Shkencore, faqe Universiteti “Aleksandër Moisiu”Durrës.
- Albjuris , “Kushtetuta e Shqipërisë me interpretime të Gjykatës Kushtetuese” Tiranë 2008
- Prof.Asoc.Dr Sokol Sadushi, cikël leksionesh mbi “Parime të përgjithshme të Administratës publike”, Shkolla e Lartë Jopublike “Luarasi , Tiranë 2013.
- Stavileci E. “Fjalor Shpjegues i termave administrative” Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Prishtinë(2010).
- Femi Sufaj “Sistemi i ndëshkimeve në Shqipëri, gjatë regjimit komunist”, desertacion për mbrojtien e gradës doktor, Fakkulteti i Historisë, Universiteti i Tiranës, 2015.
- Gavrosh Andoni, “Për avokaturën e shtetit, opinion”, Revista Avokatia 3, organ i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Tiranë 2014.
- Akademia e Shkencave E Shqipërisë , Instituti I Gjuhësisë dhe I Letërsisë, “Fjalor i gjuhës Shqipe “ Tiranë 2006.
- Dorian Droboniku “Përgjegjësia civile e gjykatësit” Revista e Universitetit Marin Barleti “Zëra Studentorë ” nr 15 . vitit 2013.
- Ardian Nuni, “E drejta e Biznesit, për fakultetin e Ekonomisë” Tiranë 2012.
- Rezarta Mataj “Aspekte teorike dhe praktike mbi dëmin jopasuror dhe shpërbllimin e tij në Republikën e Shqipërisë” Shkolla e Magjistraturës, Temë dipolome Tiranë (2007).

- Luan Omari “Parimet dhe institucione të së drejtës publike “ botimi i gjashtë Botimry “Elena Gjika” Tiranë 2004.
- “Obligimet dhe kontratat përgjithësisht” Shtëpia botuese Luarasi Tiranë 1998 botuar sipas origjinalit 1932.
- Rezarta Mataj “Rishikimi i dispozitave të dëmit jashtëkontraktor, kërkesë e kohës.” Jeta Juridike, nr. 1, Mars 2015.
- Eralda Çani “Non-contractual administrative responsibility as a means to better redress juridical and physical persons interests and better address public interests. Reforms needed to the albanian legislation and european standards”, [www.academia.edu](http://www.academia.edu).
- Rezarta Mataj “The Judiciary as Garant of Personal Data in Albania”, Lumen Conference, Iasi Rumani (2015).
- Rezarta Mataj “Mbi kontratën e rentës jetore”, Shkolla e Magjistraturës, Revista “Jeta Juridike nr.1” Tiranë (2011),.
- Prof.Dr. J. Mehdi “Detyrimet dhe kontratat”Shtëpia botuese ‘Luarasi’Tiranë 1998.
- Afet Mamuti “Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit në Maqedoni “ Disertacion për marrjen e gradës shkencore “doktor”, Tiranë , 2013.
- Prof. Asoc. Dr. Iva Zajmi“Autonomia e zbatimit të ligjit komunitar” Revista Shqiptare për Studime Ligjore, volumni 1, 2011.

## **2. AUTORE TË HUAJ**

- Robert Craig Waters “ Imuniteti gjyqësor k. proçes gjyqësor I drejtës : Kur duhet të paditet një gjyqtar ? “ .
- John Adenitire “Judicial independence in Europe. The Swedish, Italian, German Prespectives”.
- Oleksander Iegrashyn , Universiteti Europian Qëndror 31.03.2008 “Përgjegjësia e shtetit për gabimet gjyqësore. Analizë krahasuese në Mbretërinë e Bashkuar, Francë dhe Ukrainë” .
- Radu Iosof “Discussion on state liability for judicial errors in other trials than the criminal cases” (2009).
- Conti S. “La responsabilità risarcitoria della pubblica amministrazione” datë 17 maj 2007.
- Machia M. dhe Moliterni A. “La responsabilità civile della pubblica amministrazione”- Giornale di diritto amministrativo 12/2014..
- Summa R., “La responsabilità civile della P.A”, leksion për “Scuola di Specializzazione per la professione legale”.
- Augustine Mpressa, Lucile Stahl, Elise Untermaier “La Responsabilite Administrative Pour Faute”, 30 Mars 2009, Seminar virtual, Universiteti Lionit 3.
- Sevgili Gençay F.D, “Les Regimes Legislatifs de Responsabilite Administrative en France”, Gazi Üniversitesi Hukuk Fakültesi Dergisi C. Xix, Y. 2015, Sa.
- Ralph Surma “Comparative Study of the English and German Judicial Approach to the Liability of Public Bodies in Negligence” Oxford University Comparative Law Forum (2000).

- Blachly F.L, Oatman M.E “Approaches to governmental liability in tort: a comparative survey “.
- Dicey, A. V. “Lectures on the Relation between Law and Public Opinion in England” Indianapolis, IN, USA: Liberty Fund Inc., 2008. ProQuest ebrary.
- ILQ volume 60 issue 1 Cover and Back matter. (2011). International & Comparative Law Quarterly, 60(1), b1-b28. Doi: 10.1017/S0020589311000029.
- [1970] AC 1004 (HL)
- Arbitration, Building & Construction Law Reports “Anns v. Merton London Borough Council [1977] ABC.L.R. 05/12”. Typeset by NADR. Crown Copyright reserved. [1977] UKHL 4.
- Karl Singewald “The doctrine of non-suability of the state in the United States” John Hopkin Press, Baltimore 1910.
- Lee, R. D. (1996). Federal Employees, Torts, and the Westfall Act of 1988. Public Administration Review, 56(4).
- Rekomandime CM/Rec(2010)12 të datës 25.12.2012 Komisionit të Venecias mbi “Ligjin e gjyqtarëve në Serbi ” dhe Opinioni CDL (2013) 010.
  - Harvard Law Review, 125(4), 1080–1087.
- “On the Radiation Exposure Compensation Act”, 42, U.S.C. § 2210 (1990).
- Henry Cohen, Vanessa K. Burrows “ Raporti i Shërbimeve të Kongresit i vitit 2007 mbi ligjin “Për paditë federale mbi dëmet jashtëkontraktore” FTC “Order Code 95 vizë 177.
- Henry Campbell Black, M. A. “Black’law Dictionary 6th Edition” St. Paul, Minnesota, West Publishing Co.1990.
- G. Légier, “Le obligations (Detyrimet)” Botimet Papirus, Tiranë (2009).
- Michel Fromont “Sistemet e huaja më të mëdha të të drejtës” , Papirus Tiranë (2009)
- R.Matefi dhe M.Musan “ECJ case law and its impact on the evolution of administrative liability; State liability for infringement”, Bulletin of the Transilvania University of Braşov, vol.4 (53), No.1-2011, faqe 118.
- K.Arend, “EC Liability in the Absence of Unlawfulness. The FIAMM Case”, Göttingen Journal of International Law 1 (2009) 1, 199-218 faqe 214.
- Dr. Kathleen Gutman “The evolution of the action for damages against the european union and its place in the system of judicial protection” Common Market Law Review 48: 695–750, 2011, United Kingdom.
- Guide on Article 5 of The Convention, Right to Liberty and Security”, Council of Europe/European Court of Human Rights, 2014.

### **3. JURISPRUDENCË SHQIPTARE**

- Vendimi nr. 11 datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 11 datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 34 datë 20.12.2005 të Gjykatës kushtetuese.
- Vendimi nr. 72 datë 14 janar 2014 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.
- Vendimi nr. 201 datë 26 mars 2015 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr.383 datë 10 qershor 2015 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë



- Vendimi, nr. 606 datë 13 nëntor 2014 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 81 datë 23 janar 2015 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.
- Vendimi nr. 1594/2015 Gjykatës Adminsitrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Vendim nr. 408 datë 25 qershor 2015 të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 125 datë 26 shkurt 2015, Kolegji Administrativ i Gjykatë Së Lartë.
- Vendimin nr. 905, datë 11.02.2011 i Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Vendimi nr. 2609, datë 12 maj 2015 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimin nr. 2819 datë 22 dhjetor 2011 të Gjykatë së Apelit Tiranë.
- Vendimi nr. 00-2015- 2649 datë 14 maj 2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr. 12/2012 e Gjykatës Kushtetuese.
- Vendimi nr. 69 datë 04 shkurt 2014 i Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 00-2014-1480, datë 22 prill 2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi Unifikues nr. 3 datë 29 mars 2012 Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 1594, datë 26 mars 2015 të Gjykatës Adminsitrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Vendimi penal nr. 381, datë 12.03.2012 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimin nr. 1594 datë 16 mars 2015 të Gjykatës Adminsitrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Vendimi nr. 2891 datë 22 dhjetor 2011 e Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Vendimi nr.2689 datë 20.03.2012 të Gjykats së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 10877 /24.12.2009 Të Gjykatës Së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 2819 datë 22 dhjetor 2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Vendimi nr.1732 date 30.03.2005 te Gjykates Rrethit Gjyqsor Tirane.
- Vendimi nr. 59 datë 05 shkurt 2015 të Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë .
- Vendimi nr. 1163/2009 të Gjykats së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 473 datë 26 shkurt 2015 Kolegji Administrativ I Gjykatës së Lartë
- Vendimi nr. 1676 datë 12 maj 2014 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë
- Vendimi nr. 25/2014 të Gjykatës Kushtetutese.
- Vendimi nr. 414/2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë
- vendimi nr. 1259 datë 26 mars 2015 të GJASHK I-rë
- Vendimi nr. 72 datë 27 janar 2014 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë
- Vendimi nr. 12 datë 14 shtator 2007, çështja Yska, Alidmadhi, Baliqi kundër Byrosë Shqiptare të Sigurimit.
- Vendimi nr. 1954 datë 26 mars 2015 i Gjykatë Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Vendimi nr. 72 datë 27 janar 2014, Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë
- Vendimi nr. 12 datë 14 shtator 2007, çështja Yska, Alidmadhi, Baliqi kundër Byrosë Shqiptare të Sigurimit.
- Vendimi nr. 307 datë 23.03. 2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të R.Shqipërisë .

- Vendimi nr. 5194 datë 15.06.2009 të Gjykats Së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 193 datë 19 shkurt 2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë
- Vendimi nr. 837 datë 30 dhjetor 2014 i Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Shkodër
- Vendimi nr. 923 datë 06.02.2008 të Gjykatës Së Rrethit Gjyqësor Tiranë .
- Vendimi nr. 3855 datë 29.04.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë .
- Vendimi nr. Nr. 00-2016-2081, datë 17.06.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 310 datë 01.07.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 1856/29.02.2008 të Gjykatës Së Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Vendimi nr. 1594 datë 26 mars 2015 i Gjykatws Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në
- Vendimi nr. 6440 vendimi, datë 21 dhjetor 2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Vendimi nr. 377 datë 11 maj 2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
- Vendimi nr. 6301 datë 12 qershor 2013 tw të Gjykats së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 7758 datë 05 korrik 2013 i të Gjykats së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr.2689 datë 20.03.2012 të Gjykats së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- vendimi nr. 6301 datë 05 qershor 2013 të Gjykats së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Vendimi nr. 212 datë 10 shkurt 2016 të Gjykatës Administrative të Apelit.
- Vendimi nr.6 datë 28 janar 2016 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 00-2016-2519 datë 22.09.2016 të Kolegjit Civile të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 277 datë 30 nëntor 2016 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

#### **4. JURISPRUDENCË E HUAJ**

- Çështja Bradly k. Fisher dhe Stump k. Sparkman SHBA
- Çështja Magiera kundër ë Francës, GJEDNJ.
- Vendimi nr. 2642 datë 22 maj 2013 e Gjykatës Campania Napoli.
- Vendimin e Gjykatës së Kasacionit nr. 157/2003 Itali.
- Vendimi nr. 500/1999 Gjykata e Kasacionit në Itali
- Vendimi nr. 500 datë 22 korrik 1999 të Kolegeve të Bashkuara të Gjykatë së Kasacionit në Itali.
- Vendmi nr. 157/2003 Gjykatës së Kasacionit Itali.
- Vendimi nr. 4804 datë 28 shkurt 2014 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë.
- Vendimi nr. 318 datë 22 janar 2014 të Këshillit të Shtetit Francë.
- Vendimet të nr. 2708 datë 27 maj 2014 , nr. 2195 datë 28 prill 2014 tw Këshillit të Shtetit
- Vendimi datë 14 mas 1980 i Këshillit të Shtetit
- Vendimi datë 10 prill 1992 i Këshillit të Shtetit
- Vendimi datë 23 maj 2003 i Këshillit të Shtetit, Francë.

- Vendimi datë 14 janar 1935 i Gjykatës së Mosmarrëveshjeve, çështja Thepaz.
- Vendimi i datës 3 shkurt 195 i Këshillit të Shtetit, çështja Thouzellier.
- Vendimi i datës 22 shkurt 1963 i Këshillit të shtetit, çështja Komuna e Gavarnier.
- Vendimi datë 9 prill 1993 i Këshillit të Shtetit, çështja Bianchi.
- Çështja Stump k. Sparkman, SHBA.
- Çështja Entick v. Carrington (1765).
- Anns kundër Merton LBC (1977) vendimi i Dhomës së Lordëve.
- Çështje Westfall Kundër Erwin (1988) SHBA.
- Çështja "United States kundër Kubrick", 444 U.S. 111, 120 (1979).
- Çështja Gutierrez de Martinez kundër Lamagno, 515 U.S. 417 (1995).
- Çështja Osborn kundër Haley, 127 S. Ct. 881 (2007).
- Çështja, Stencel Aero Engineering Corp. v. United States, 431 U.S. 666, 671-672, (1977).
- Henkie kundër Shteteve e Bashkuara (1984).
- Hinkie v. United States, 715 F.2d 96 (3d Cir. 1983), cert. denied, 465 U.S. 1023, (1984).
- Vendimi nr. Ac.nr.1336/11 datë 23 tetor 2012 Gjykata e Qarkut Prishtinë.
- Çështja "Henkie kundër Shteteve e Bashkuara" (1984),
- Vendimi i Dhomës së dytë Civile të Gjykatës së Kasacionit datë 24 prill 1989, vendimi datë 19 shkurt 1997 (vendimi Samda).
- Çështja Smith kundër Leech Brain & Co në Britaninë e Madhe.
- Çështja Vosburg kundër Putney, Gjykata Federale e Winsconsit.
- Çështja Benn kundër Thomas, SHBA (1994 Çështja Kavanagh kundër Akhtar, Sidney Australi (1998).
- Çështja Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian janë çështjet e bashkuara C-120/06 P dhe C-121/06 P.
- Çështja nr. 46477/99 datë 15 mars 2002, Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar.
- Vendimi nr. 1365 të 20 mars 2014 të Seksionit të Tretë të Këshillit të Shtetit Itali.
- Vendimi nr. 9636 datë 12 maj 201 të Gjykatës së Kasacionit, Seksioni I, Itali.
- Vendimi nr. 32 datë 30 mars 2017 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

## **5. JURISPRUDENCA E GJYKATËS SË DREJTËSISË SË BASHKIMIT EVROPIAN**

- Çështja Fabbrica Italiana Accumulatori Motocarri Montecceio SPA kundër Këshillit dhe Komisionit (FIAMM), T-69/00, (2005).
- Çështja T-113/04, datë 12 dhjetor 2007, *Atlantic Container Line AB kundër Komisionit*.
- 184/95, datë 28 prill 1995, *Dorsch Consult Ingenieurgesellschaft mbh, kundër Komisionit dhe Këshillit*.
- Çështja Nr. T-351/03, datë 11 Korrik 2007 Electric SA kundër Komisionit të Komunitetit Evropian, paragrafi 264, 269.

- Çështja T-4 15/03, datë 19 Tetor 2005 “Cofradía de pescadores de ‘sanpedro’ de bermeo” kundër Këshillit.
- Çështjet e bashkuara Nr. 116/77 dhe 124/77, datë 05 dhjetor 1979 ,G. R. Amylum N.V dhet unnel Refineries Limited, London.
- Çështja T-124/99 datë 17 janar 2001, Autosalone Ispra Dei Fratelli Rossi k. Komitetit Evropian i Atomit dhe Energjisë (EAEC).
- Çështja Nr. T-199/9616 korrik 1998 kundër, Laboratoires Pharmaceutiques Bergaderm SA Komisionit të KEE.
- Çështja OJ C 294 datë 02 dhjetor 2006, Reynolds Tobacco dhe të Tjerët kundër Komisionit
- Çështjet e bashkuara C-6 & 9/90, datë 19 nëntor 1991 Francovich dhe të Tjerë, [1991] ECR I-5357 Francovich kundër Republikës së Italisë.
- Çështjet e bashkuara Nr. C-46/93 and C-48/93, datë 5 Mars 1996, Brasserie du Pêcheur SA kundër Republikës Federale Gjermane.
  - Çështja Nr. C-224/01, datë 30 Shtator 2003 Gerhard Köbler kundër Republikës së Austrisë.
- Çështja Nr. T-451/93, datë 16 nëntor 1994, San Marco Impex Italiana sa kundër Komisionit dhe Këshillit.
- Çështja Nr. T-466/93, T-469/93, T-473/93, T-474/93 dhe T-477/93 datë 13 korrik 1995, O'Dwyer dhe të Tjerë kundër Këshillimit.
- Çështja C-173/03, datë 13 qershor 2006, Traghetti Del Mediterraneo kundër Italisë.
- Çështja T-124/04 datë 26 tetor 2005, Ouariachi kundër Komisionit.
- Çështja Nr. 59/83 datë 06 dhjetor 1984 Biovilac kundër Komisionit.
- Nr. T-184/95 datë 28 prill 1998, Dorsch Consult kundër Këshillit dhe Komisionit.
- Çështja N vendimin Nr. C-47/07 datë 16 dhjetor 2008, Masdar (UK) Ltd kundër komisionit dhe komunitetit Evropian.
- Çështja Nr. C-120 & 121/06 datë 09 shtator 2008, FIAMM kundër Komisionit dhe Këshillit.
- Çështja C-47/07 P, datë 16 dhjetor 2008, Masdar (UK) ltd kundër Komisionit.
- Çështja Nr. T-195/00 datë 10 prill 2003, Travelex Global and Financial Services and Interpayment Services kundër Këshillit dhe Komisionit.
- Çështja Nr. T-285/03 datë 17 mars 2005, Agraz CA kundër Komisionit.
- Çështja Nr. T-384/11 datë 25 nëntor 2014, Safa Nicu Sepahan Co ndaj Këshillit të BE.
- Çështja T-19/07, Systran SA dhe Systran Luxembourg SA k. Komisionit, datë 16 dhjetor 2010, çështja C-103/11 P, Komisioni k. Systran SA dhe Systran Luxembourg SA).
- Çështja Nr. 300/07, datë 09 shtator 2010, Evropaiki Dynamiki – Proigmena Systimata Tilepikoinonion Pliroforikis kai Tilematikis AE. (Greqi) kundër Komisionit.
- Çështja Nr. 256/81 datë 18 Maj 1983, Pauls Agriculture Limited k. Këshillit dhe Komisionit të KEE.
- Çështja nr. T-351/03, datë 11 korrik 2007, Schneider kundër Komisionit.

- Çështja C-282/05 datë 19 Prill 2007 P, *Holcim AG undër Komisionit*.
- Çështja T-554/93 datë 16 prill 1997, *Saint dhe Murray k. Komisionit dhe Këshillit*.

## **6. LEGJISLACION SHQIPTAR**

- Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste e Shqipërisë.
- Kodit Civil të Republikës Popullore Socialiste miratuar me ligjin nr. 6340, datë 26.6.198.
- Ligji nr. 2359 datë 15 nëntor 1956 “Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet”.
- Ligji nr. 2360 datë 25 nëntor 1956 “Mbi zbatimin e ligjës Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet” rregullimi i detyrimeve të shtetit dhe organeve të tij karshi personave juridik a fizik të dëmtuar “.
- Dekret nr. 1400, datë 17.01.1952 “ Mbi përgjegjësinë penale për nxjerrjen e prodhimit të keq nga ndërmarrjet industriale dhe për vënien në shitje të prodhimit të keq nga ndërmarrje tregëtare.”
- Ligji nr.7692, datë 31.03.1993 “Për një shtojce ne ligjin nr. 7491, datë 29.04.1991 "Per dispozitat kryesore kushtetuese".
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë i miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994.
- Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë ” i ndryshuar.
- Ligji Nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë.“
- Ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”.
- Ligji nr. 8485 datë 12 maj 1999 “ Kodi i Proçedurave Adminitstrative “.
- Ligji nr. 44/2015 ”Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 7501/1991 “Për tokën” i ndryshuar.
- Ligji nr. 8873, datë 29.3.2002 "Për sigurimin e depozitave" “i shfuqizuar sot me ligjin nr. 53/14 “Për sigurimin e depozitave”.
- Ligj nr.9723, datë 3.5.2007 ”Për qendrën kombëtare të regjistrimit”.
- Ligji Nr. 65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes” .
- Ligj nr.9970, datë 24.7.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” .
- Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Ligji nr.8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit”.
- Ligji nr. 9228 date 29 .04. 1998 “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.
- Ligji nr. 9110 /2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimet e renda”.
- Ligji nr. 266 datë 01.12.1994 “Mbi proçedurën e shpërblimit për dëmet e shkaktuara individëve nga veprime të paligjshme të organeve hetimore, prokurorisë dhe gjyqësore “.
- Ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.
- Ligjin Nr.8737, datë 12.2.2001 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

- V.K.M Nr.70, datë 15.02.2001 “Për statusin e spitaleve universitare”.
- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
- Ligji nr. 9131 datë 08 shtator 2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Ligjit Nr.8561, date 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë prone private për interes publik”.
- Ligji nr. 9106, date 17.7.2003 “Per Sherbimin Spitalor ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar.
- Ligji nr. 9952, datë 14.7.2008 “Për Parandalimin dhe Kontrollin e Hiv/Aids-It”.
- 05.02.2014 me VKM nr.122 “ Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës)
- VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”
- VKM nr.122 datë 05.02.2014 “Për shpronësimin për interes public të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi I segmentit rrugor unaza e madhe e Tiranës, Komuna e Parisit- Rruga e Kavajës.”
- Ligji nr.9482 dt 03.04.2006 “Për legalizimin urbanizimin, dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.
- Vendimi Nr.1134, datë 18.11.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”.
- Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative ”.
- VKM nr. 315, datë 21.3.2008 “Për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve në bashkinë Vorë, ne Komunat Kashar e Preze të Qarkut të Tiranës the në Komunat Maminas, Manzë dhe Bubq, të Qarkut Durrësit, të shkaktuara nga aksidenti teknologjik”.
- VKM nr. 559, datë 16.8.2006 “Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së, për makineritë dhe pajisjet e importuara, si dhe energjinë elektrike, të importuar nga KESH Sh.A.”
- Ligji nr. 9106, date 17.07.2003 “Per Sherbimin Spitalore ne Republiken e Shqiperise”.
- Ligji nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për Ratifikimin e "Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare"
- VKM Nr. 404, Datë 13.5.2015 “Për miratimin e planit kombëtar për Integrimin Evropian 2015 – 2020” dhe VKM Nr. 463, Datë 5.7.2006 “Për miratimin e planit kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit”.
- Projektligji korrik 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të programeve të asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian në Republikën e Shqipërisë ”.

## **7. LEGJISLACIONE TË HUAJA**

- Traktati i Lisbonës hyrë në fuqi më 01 janar 2009, i quajtur “Traktati i Funkcionimit të Bashkimit Evropian”, përveç antarësimeve të reja, ndryshoi Traktatin e BE dhe atë të KE”, version i azhurnuar i ndodhur në Fletoren Zyrtare O.J. 2010, C 83/1.
- Traktati i Funkcionimit të Bashkimit Evropian, Gazeta Zyrtare C 19, Volume 35 datë 29 Korrik 1992. Gazeta Zyrtare Nr. C326/1 datë 26 tetor 2012, volume 55.
- Direktiva 94/19/KE e Parlamentit dhe e Këshillit “Mbi skemat e garantimit të depozitave”, e ndryshuar me direktivën 2009/14/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 11.3.2009.
- Kushtetutë e Republikës së Italisë , hyrë në fuqi më 01 janar 1948.
- Ligji nr. 117 datë 13.04.1988 “Shpërblimi i dëmeve të shkaktuar nga ushtrimi i funksioneve gjyqësore dhe përgjegjësia civile e gjyqtarit ” Itali.
- Ligji për “Dëmin jashtëkontraktor ”, 1972, Suedi.
- Federal Tort Claims Act 1946, SHBA -”Mbi ankimet federale ndaj dëmeve jashtëkontraktore” .
- Ligji Westfall (1988), SHBA.
- Kushtetuta e Republikës Federale të Gjermanisë (Grundgesetz), miratuar më 23 maj 1949.
- Ligji i Proçedurës Administrative i miratuar më 25 maj 1977, Gjermani.
- Kodin Civil Gjerman, hyrë në fuqi më 01 janar 1900.
- Ligji “Mbi përgjegjësinë e testeve atomike”, 42 U.S.C. § 2210 (1990).
- Ligji nr. 03/L-189 “Për administratës shtetërore në Republikën e Kosovës” .
- Ligji nr.03/L-149 “Për shërbimin civil të Republikës së Kosovës”.
- Ligjit nr. 04/l-077 “Për marrëdhëniet e detyrimeve” Kosovë.
- Ligji Nr. 04/ L-077 “Për marrëdhëniet e detyrimeve” është miratuar me 10 maj 2012 i cili shfuqizoi dhe ligjin e mëparshëm Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/78, 39/85, 57/89).
- Ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” 16 gusht 1790Francë.
- Ligji I 27 prill deri 25 maj 1971“Për organizimin e ministrive” Francë.
- Ligji ”Për kompensimin e dëmve jashtëkontraktore dhe përgjegjësinë e punonjësve federal” SHBA.

## **8. DOKUMENTE, RAPORTE ETJ.**

- Raporti i Euraliusit mbi “Imunitetin e gjyqësorit në Shqipëri ”, shtatori 2011.
- Raport i veçantë i vitit 2012 i Avokatit të Popullit “Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë”
- Karta universale e gjyqtareve datë 17.11.1999.
- Dokument i Këshillit Qëndror i Shoqatës Ndërkombëtare të Gjyqtarëve Taivan, 17.11.1999.

## 9. FAQE ONLINE

[www.didaweb.net/liste/002\\_ftp/Spaziolista/CostituzioneItaliana\\_trad\\_albanese.pdf](http://www.didaweb.net/liste/002_ftp/Spaziolista/CostituzioneItaliana_trad_albanese.pdf)

[www.hjpc.ba](http://www.hjpc.ba).

[http://www.didaweb.net/liste/002\\_ftp/Spaziolista/CostituzioneItaliana\\_trad\\_albanese.pdf](http://www.didaweb.net/liste/002_ftp/Spaziolista/CostituzioneItaliana_trad_albanese.pdf).

[http://www.bvereg.de/informationen/english/federal\\_administrative\\_court.php](http://www.bvereg.de/informationen/english/federal_administrative_court.php).

<http://germanlaearchive.iuscomp.org/?p=172>.

<https://law.utexas.edu/transnational/foreign-laë-translations/german/case.php?id=710>.

<http://germanlawarchive.iuscomp.org/?p=129>.

[http://www.crpm.org/pub/docs/402\\_tp\\_cpmr-\\_erika.pdf](http://www.crpm.org/pub/docs/402_tp_cpmr-_erika.pdf) , akses 26 janar 2016.

<http://www.fhf.edu.al/doktorata/Femi%20Sufaj.pdf>.

[http://www.parlament.al/ëeb/pub/legjislacioni\\_shqiptar\\_091945\\_1955\\_12266\\_1.pdf](http://www.parlament.al/ëeb/pub/legjislacioni_shqiptar_091945_1955_12266_1.pdf),

[www.object.cato.org](http://www.object.cato.org) .

[www.uab.ro](http://www.uab.ro).

, [www.venice.coe.int](http://www.venice.coe.int).

[www.academia.edu](http://www.academia.edu).

<http://www.tribunal-conflits.fr/>.

<http://www.conseil-etat.fr/fr/base-de-jurisprudence>.

<https://www.legifrance.gouv.fr>.

[http://www.constitution.org/trials/entick/entick\\_v\\_carrington.htm](http://www.constitution.org/trials/entick/entick_v_carrington.htm).

<http://www.nadr.co.uk/articles/published/ConstructionAdjudicationLawReport>

<http://doi.org/10.2307/976374>.

<https://www.law.cornell.edu/uscode/text/28/1346>.

<http://www.jstor.org/stable/41349904>.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2679>.

[http://ecologic.eu/sites/files/neës/2015/efface\\_directive\\_2004\\_35\\_ec\\_on\\_environmental\\_liability.pdf](http://ecologic.eu/sites/files/neës/2015/efface_directive_2004_35_ec_on_environmental_liability.pdf) .

<https://freelaeschooloutlines.ëordpress.com/11-case-briefs/torts-spring-case-briefs/>.

[http://curia.europa.eu/juris/document/document\\_print.jsf;jsessionid=9ea7d2dc30dd8ef116b1077c4c2da8e0f0db23077d49.e34KaxiLc3qMb40Rch0SaxuSaNj0?doclang=EN&text=&pageIndex=0&docid=71983&cid=790016](http://curia.europa.eu/juris/document/document_print.jsf;jsessionid=9ea7d2dc30dd8ef116b1077c4c2da8e0f0db23077d49.e34KaxiLc3qMb40Rch0SaxuSaNj0?doclang=EN&text=&pageIndex=0&docid=71983&cid=790016).

[www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al).

[www.gjykatatirana.gov.al](http://www.gjykatatirana.gov.al).

[www.gjykataeapelittirane.gov.al](http://www.gjykataeapelittirane.gov.al).

[www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al).

[www.gjykatatirana.gov.al](http://www.gjykatatirana.gov.al).

[https://europa.eu/european-union/about-eu/institutions-bodies\\_en](https://europa.eu/european-union/about-eu/institutions-bodies_en).

[https://europa.eu/european-union/about-eu/agencies/decentralised-agencies\\_en](https://europa.eu/european-union/about-eu/agencies/decentralised-agencies_en).

[http://www.lisbon-treaty.org/wcm/images/12002E\\_EN.pdf](http://www.lisbon-treaty.org/wcm/images/12002E_EN.pdf).

<https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/07/ORGANIZIMI-I-AGJENCISE-SE-AUDITIMIT-PER-ASISTENCEN-NGA-BE.pdf>.



## **ABSTRAKTI**

Ky punim synon të thellohet për herë të parë në drejtën e çdo personi për tu shpërblyer për dëmet pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga organi publik apo punonjësit e tij dhe detyrimin e shtetit për të rikuperuar situatën qoftë edhe financiarisht.

Hulumtimi në këtë institut u pa nevojshme nisur nga zhvillimet në dekadat e fundit në vënde të ndryshme si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vënde të Bashkimit Europian. Ndryshe nga vendet e tjera që mund të kenë vetëm një nen të përgjithshëm për këtë institut, në Shqipëri përgjegjësia civile e shtetit rregullohet që nga 1998 nga Kushtetuta (neni 44), që nga viti 1999 nga Kodi I Proedurave Administrative (ish-neni 14 dhe neni 15) por dhe 22 nene të ligjit e posaçëm nr. 8510 datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore". Megjithatë, volumi praktikës gjyqësore lë për të dëshiruar dhe qytetarët paraqiten në një nivel fillestar të njohjes së kësaj të drejte.

Ky punim me qëllim që ambjentoj këdo me përgjegjësinë civile të administratës publike mbi dëmet që shkakton bën një panoramë të evoluimit të tij në historinë e legjislacionit shqiptar, në nivel ndërrkombëtar, paraqet rastet se kur mund t'i drejtohet çdo qytetar organit publik, organit epror apo gjykatës për shpërblym dëmi civil, kriteret e matjes së dëmit, llojet e tij, krahason doktrinën dhe legjislacionet e shteteve të tjera, mënyrën e trajtimit të shpërblymit të dëmeve nga ana e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian (Luxemburgut) dhe asaj të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Strasburgut).

*Fjalët kyçe: përgjegjësi, organ public, shpërblym, dëm pasuror, dëm jopasuror, paligjshmëri.*

## **ABSTRACT**

For the first time, this thesis intends to deepen in such a level, on the right of compensation of any property and non-pecuniary damage caused by the public body or its employees and the obligation of the state to recover the situation, even if financially. Research in this institute was necessary basing by developments in recent decades in countries such as the United States of America, European Union countries.

Unlike other countries that may have only one general article for this institute, in Albania the civil liability of the state has been regulated since 1998 by the Constitution (Article 44), since 1999 by the Administrative Procedure Code (ex-Article 14 and Article 15) and 22 articles of special law no. 8510 dated 15.07.1999 "On the Non-Contractual Responsibility of the State Administration Bodies". However, the volume of court practice is not as desired and the citizens appear unaware on.

This work aims to enrich anyone with the civil liability of the public administration, makes an overview in the history of Albanian legislation, at the international level, presents the cases when every citizen can address for civil damages to the responsible public organ, to its superior or tribunal, it treats the criteria for measuring the damage and its types, compares the doctrine and legislations of other states, the manner of the European Court of Justice (Luxembourg) and the Court of Justice And Basic Human Freedoms (Strasbourg) deal with etc.

*Key words: responsibility, public body, compensation material damage, non-pecuniary damage, illegality.*